

INSTITUTI I SHKENCËVE DHE HISTORIS  
PRANË KQ TE PPSH

# ENVER HOXHA

## DITAR

### PËR ÇËSHTJE NDËRKOMBËTARE

(1980 — 1981)

1980  
13

TIRANË, 1985

INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE  
PRANË KQ TË PPSH

ANXON

DITAR

PËR ÇËSHJE NDRËKOMBËTARE

(1980 — 1981)

13

TIRAZHI 1000

1980

**MBËSHTETIM LUFTËN E POPULLIT  
TË AFGANISTANIT KUNDËR PUSHTUESVE  
SOVJETIKË**

Ta dënojmë e ta demaskojmë agresionin ushtarak të Bashkimit Sovjetik kundër popullit të Afganistanit. Për këtë ne duhet të botojmë një artikull<sup>1</sup>, ku të theksojmë se socialimperialistët sovjetikë dhe agjentura e tyre në Afganistan shfrytëzuan rrëzimin, në fillim, të mbretit Muhamed Zaher Shah, përmbysjen e princit Daud, si dhe dëshirën për çlirim të popullit afgan, i cili e ndiente shtypjen e monarkisë absolute dhe të miqve të saj të huaj, në radhë të parë të sovjetikëve që e financonin dhe e mbanin atë në fuqi.

Në këtë artikull të flasim mirë e ta vlerësojmë pozitivisht lëvizjen e rezistencës që po përhapet në Afganistan kundër pushtuesve sovjetikë. Lufta e popullit afgan në këtë drejtim është e drejtë dhe ajo nuk mund të shtypet. Populli i këtij vendi ka tradita të lashta në luftën kundër pushtuesve të huaj. Dikur ai u ka dhënë një mësim, që ta mbajnë mend mirë, edhe ushtrive të pushtuesve imperialistë anglezë.

Me këtë rast të shprehim edhe solidaritetin e popullit tonë me popullin afgan që lufton në male e në qytete ku-

---

<sup>1</sup> Artikulli u botua në gazetën «Zëri i popullit» më 5 janar 1980 me titullin «Jashtë agresorët nga Afganistani!».

ndër pushtuesve revizionistë, socialimperialistëve sovjetikë e veglave të tyre.

Artikulli ynë do të ndihmojë për të sqaruar edhe popujt, për t'i bërë këta të ndërgjegjshëm për agresionin ushtarak të Bashkimit revizionist Sovjetik kundër Afganistanit, për qëllimet e socialimperialistëve sovjetikë në këtë rajon të botës, si dhe për luftën e drejtë të popullit afgan kundër pushtuesve të huaj.

**E ENJTE**  
**3 JANAR 1980**

## **JASHTË AGRESORËT NGA AFGANISTANI!**

Pas takimit me shokët sekretarë të KQ, që pata sot në mëngjes, i dhashë dorën e fundit artikullit «Jashtë agresorët nga Afganistani!». Artikullin e plotësova me disa konsideracione të tjera politike. Tezat e zgjeruara të këtij artikulli i pata biseduar me shokun Ramiz më përpara.

Qëndrimet tona rreth ngjarjeve në botë ndiqen jashtë me vëmendje. Për to flasin agjencitë e ndryshme të lajmeve dhe shkruajnë edhe gazetat e huaja.

## AGRESIONI USHTARAK SOVJETIK NË AFGANISTAN DHE IMPERIALIZMI AMERIKAN

Në takimin e sotëm ditor me shokët sekretarë të Komitetit Qendror analizova situatën në Afganistan, në Iran e në disa vende të tjera të botës.

Sot presidenti amerikan Karter njoftoi se, në shenjë mosaprovimi për pushtimin ushtarak të Afganistanit, Shtetet e Bashkuara nuk do të përmbushin kontratën për shitjen e 17 milionë tonëve grurë Bashkimit Sovjetik, pra ai shpalli se e pezullon këtë kontratë. Karteri njoftoi, gjithashtu, se shtyn aprovimin e marrëveshjes SALT-2 nga ana e senatit dhe se do t'i furnizojë armë Pakistanit etj.

Me këto veprime Shtetet e Bashkuara të Amerikës përpiqen të ngrenë moralin e vet dhe atë të aleatëve të tyre. Do të shohim çfarë kundërmasash do të marrë Bashkimi Sovjetik, por me siguri ai i ka bërë llogaritë. Grurë sovjetikëve u japin edhe Kanada dhe Australia.

## SEKRETARI I DEPARTAMENTIT AMERIKAN TË MBROJTJES NË PEKIN

Dje mister Harold Brauni, sekretar i Departamentit Amerikan të Mbrojtjes, arriti në Pekin për t'u takuar me Hua Kuo Fenin dhe Ten Hsiao Pinin. Kjo ndodh pikërisht kur socialimperialistët sovjetikë pushtuan me tanke kryeqytetin e Afganistanit, Kabulin. Veçse ndër-sa në Kabul sovjetikët sollën me tanke Babrak Karmelin, Brauni i gjeti në fron, në Pekin, dhe Huanë dhe Tenin.

Bisedimet midis tyre, që, sipas agjencisë kineze të lajmeve, HSINHUA, Brauni, kur arriti në aeroportin e Pekinit, i quajti «me leverdi reciproke», me siguri kanë për objektiv konkretizimin dhe forcimin e aleancës së fshehtë ushtarake antisovjetike kino-amerikane. Pas Braunit patjetër në Kinë do të vijnë tanket, avionët dhe raketat e sofistikuara amerikane, por me vaporë. Kina përpiqet ta realizojë kështu pikën e katërt të «modernizimit» të udhëheqësve revizionistë kinezë, modernizimin e ushtrisë së saj agresive.

Kina, nëpërmjet luginave të thella të Pamirit, ka filluar të futë në Afganistan armë, municione e para për fiset afgane, që t'i nxitë ata kundër sovjetikëve dhe veglave të tyre. Por kjo gjë nuk ka të bëjë aspak me përkrahjen e revolucionit të popullit afgan. Përkundrazi, imperialistët, qofshin ata sovjetikë, amerikanë

apo kinezë, të gjithë luajnë me gjakun e popujve, me zjarrin, luftojnë për zona influence në këto anë.

Tre banditë, Brauni, Teni dhe Huaja, përgatitin luftën kundër banditit tjetër, Brezhnjevit.

E DITE  
15 JANAR 1980

E MARTË  
15 JANAR 1980

## MENDIME — TEZA PËR NJË ARTIKULL<sup>1</sup>

— Udhëheqja revizioniste bullgare po ngre lart veprat agresive të carëve të saj të vjetër, për t'u shërbyer zotërinjve të tyre të rinj, carëve agresorë të Kremlinit.

— Ne shqiptarët luftojmë për lirinë dhe drejtësinë. Trimat janë gjakftohtë, por, kur ndokush tenton t'ua shkelë lirinë, atëherë kërcet pushka.

— Borgjezia reaksionare ka zënë lozhat e teatrit botëror, bën sehir si në kohën kur Hitleri sulmonte popujt, njërin pas tjetrit, dhe bën pyetjen: «Ç'do të ngjasë në Jugosllavi pas Titos?».

Po ia themi ne shqiptarët se ç'do të ndodhë: Popujt e Jugosllavisë do të luftojnë me heroizëm kundër të gjithë atyre që do të tentojnë t'u cenojnë lirinë dhe pavarësinë.

Borgjezia reaksionare, me qëndrimet e saj tradhtarë, ndihmon dhe nxit agresorët socialimperialistë sovjetikë dhe përpiqet të demoralizojë e të frikësojë popujt e Jugosllavisë.

Popujt vëllezër të Jugosllavisë, jini vigjilentë ndaj

---

<sup>1</sup> Mbi bazën e këtyre tezave është shkruar artikulli me titull «Shantazhet e kërcënimet sovjeto-bullgare nuk kalojnë në Ballkan». «Zëri i popullit», 19 janar 1980.

miqve të rremë, se armiqtë e hapët e dini vetë ju si duhet t'i luftoni e t'i thyeni!

Luftë kundër agjentëve të imperializmit sovjetik, ustashë e serbomëdhenj, si brenda dhe jashtë Jugosllavisë!

E SHTUNË  
26 JANAR 1980

## DËMSHPËRBLIMEVE TË LUFTËS NGA RF E GJERMANISË T'U KUSHTOHET KUJDESI I DUHUR

Fola me Ramizin se si duhet të bisedojë ambasadori ynë në Vjenë me ambasadorin e Bonit atje për çështjen e dëmshpërblimeve të luftës. Për fat të keq, Ministria jonë e Punëve të Jashtme as e bën qejfin qeder për këtë problem. Asnjë variant të bisedimeve, asnjë formulim nuk ka paraqitur deri tani. Kjo tregon mungesë serioziteti dhe nxit mendimin se këtë problem ne e kemi ngritur vetëm për propagandë dhe jo si një e drejtë që na takon. Edhe Qeveria nuk po i vë rëndësi kësaj çështjeje.

**PËRSËRI PËR ÇËSHTJEN E DËMSPËRBLIMEVE  
DHE PËR ARIN E GRABITUR NGA ANGLEZËT**

U thashë sot shokëve në Komitetin Qendror se çështja e kërimit të dëmshpërblimeve të luftës nga RF e Gjermanisë dhe kthimi i arit tonë të grabitur nga Anglia, duhet të ndiqen më seriozisht dhe në mënyrë konkrete. Situata jonë e fuqishme politike mund të ndikojë të arrijmë suksese në këto çështje.

**NGJARJET QË PO ZHVILLOHEN NË VENDET  
MUSLIMANE DUHET TË SHIKOHEN NË DRITËN  
E MATERIALIZMIT DIALEKTIK E HISTORIK**

Aktualisht gjendja ndërkombëtare paraqitet mjaft e ndërë. Në shumë rajone të botës, e kryesisht në pellgun e madh të vendeve të naftës, sidomos të Azisë, lufta midis dy superfuqive imperialiste, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik, pa përjashtuar Kinën imperialiste dhe fuqitë e tjera kapitaliste, për ndarjen e rindarjen e tregjeve e të zonave të influencës, për t'i futur bërrylat njëri-tjetrit, ashtu siç është parashikuar me të drejtë prej kohësh nga Partia jonë, ka arritur përmasa të reja e të mëdha. Presionet e komplotet e tyre shoqërohen me përpjekjet dhe me zhurmën diplomatike e propagandistike për «ujdira e kompromise» gjoja për të ruajtur paqen dhe ekuilibrin e forcave. Në fakt, siç po tregojnë ngjarjet e kohëve të fundit, pavarësisht nga acarimi i madh i rivalitetit, ne shohim se ujdia dhe kompromisi janë ende parimi bazë i politikës së tyre ndaj njëri-tjetrit. Por një ditë rivaliteti midis tyre mund të arrijë në një pikë, të cilën nuk do të mund ta zgjidhin e ta kapërcejnë dot më, veçse me konfrontim luftarak. Pasojat e një konfrontimi të tillë, sikurse ka ndodhur edhe në luftërat e mëparshme imperialiste, do të bien mbi popujt.

Rezultati më i freskët i këtij rivaliteti është agresioni ushtarak i socialimperialistëve sovjetikë kundër Afganistanit, është pushtimi me forcën e armëve i këtij vendi nga njëra prej superfuqive imperialiste. Është fakt se ajo çka u bë tash në mënyrë të hapët e me forca të armatosura nga sovjetikët kundër sovranitetit të popullit afgan, është gatuar prej kohësh nga politikanët e nga ushtarakët shovinistë socialimperialistë sovjetikë dhe nga agjentët e tyre afganë. Si të parët, ashtu edhe të dytët, për të arritur aty ku arritën sot, shfrytëzuan rrëzimin, në fillim të mbretit Muhamed Zaher Shah në vitin 1973 dhe, më vonë, më 1978, përmbysjen e princit Daud. Për qëllimet e tyre të këqija, ata shfrytëzuan edhe dëshirën për çlirim shoqëror të popullit afgan, i cili e ndiente shtypjen e monarkisë absolute dhe të miqve të saj të huaj, në radhë të parë të sovjetikëve, që e financonin dhe e mbanin atë në fuqi. Pra, socialimperialistët sovjetikë, me gjithë «aleancën» që kishin me mbretin e Afganistanit, punuan dhe vepruan për rrëzimin e tij. Për të maskuar qëllimet e veta imperialiste, në fillim sollën në fuqi një-rëz gjoja me ndjenja më përparimtare. Pastaj edhe këta i ndërruan njëri pas tjetrit me veprime gjakderdhëse, me puçë e me tanke, u çuan në satër, siç ndodhi me Nur Muhamed Tarakin dhe me Hafizullah Aminin.

Por asnjë pushtues i huaj, sado i fuqishëm e i armatosur të jetë, nuk mund ta mposhtë përgjithmonë popullin ndaj të cilit ka bërë agresion. Pushtuesit e huaj, përveç klikave agjenturore, antikombëtare e antipopullore, kudo që janë futur janë pritur e priten nga popujt me urrejtje e rezistencë në fillim sporadike, pastaj me revolta më të organizuara që dalngadalë kthehen në kryengritje popullore, në luftëra çlirimtare. Këtë ne po e shohim të vërtetohet edhe në Afganistan, populli i të cilit është ngritur në këmbë e po lufton me ashpërsi në qytete, në

fshatra e në male kundër ushtrive pushtuese sovjetike. Kjo luftë e popullit afgan gëzon përkrahjen dhe simpatinë e popujve liridashës e të forcave revolucionare të mbarë botës. Atë e mbështet me të gjitha forcat edhe populli ynë. Lufta e popullit afgan kundër socialimperialistëve sovjetikë është një luftë e drejtë, prandaj ajo do të triumfojë.

Lufta aktuale e popullit afgan kundër agresionit ushtarak sovjetik si dhe kryengritja popullore antifeudale e antiimperialiste, antiamerikane e popullit iranian duhet të na bëjnë të mendojmë një çikë më shumë e më thellë, nga ana politike, teorike dhe ideologjike edhe për një problem tjetër të madh, që në situatat aktuale e në këtë zhvillim të ndërlikuar botëror po del gjithnjë e më shumë në pah: për kryengritjet popullore me «frymëzim islamik», siç duan t'i përcaktojnë këto lëvizje borgjezia dhe revizionistët vetëm sepse në pararojë të lëvizjes çlirimtare janë vënë popujt myslimanë të vendeve arabe dhe të vendeve të tjera. Ky është një fakt, një realitet objektiv, në këto vende ka lëvizje kryengritëse. Në qoftë se këto lëvizje e kryengritje të popujve myslimanë do t'i shohim e do t'i gjykojmë në mënyrë shumë simpliste, të sipërfaqshme, si lëvizje me karakter thjesht islamik, pa u thelluar në arsyet e vërteta që i shtyjnë përpara masat e gjera të popujve, mund të biem në pozitë e revizionistëve dhe të imperialistëve, vlerësimet e të cilëve ndaj këtyre lëvizjeve janë denigruese dhe fshehin synime skllavëruese ndaj popujve.

Ne, marksistë-leninistët, e kemi gjithnjë të qartë se feja është opium për popujt. Në asnjë rast nuk e ndërrojmë pikëpamjen tonë lidhur me të dhe nuk duhet të biem në gabimet e «socializmit fetar» etj. Edhe feja myslimane është e tillë. Megjithatë aktualisht shohim se masat e gjera të popujve myslimanë, në vendet arabe e

në vende të tjera, janë ngritur e po ngrihen në luftë kundër imperializmit e neokolonializmit për çlirimin e tyre kombëtar e shoqëror. Këta popuj, që jo pa qëllim ishin lënë në errësirë në të kaluarën, dhe gjenden akoma sot prapa në botëkuptimet e tyre, tani po i ndiejnë shtypjen e madhe dhe shfrytëzimin e egër që u kanë bërë kolonizatorët e vjetër, që vazhdojnë t'u bëjnë edhe kolonizatorët e rinj e klikat feudo-borgjeze kapitaliste të brendshme. Ata po i kuptojnë arsytet politiko-ekonomike të shtypjes, dhe, pavarësisht se janë myslimanë e të lënë prapa, janë duke treguar një vitalitet të madh dhe po japin një kontribut të rëndësishëm në revolucionin demokratiko-borgjez antiimperialist që i hap rrugën atij proletar. Janë regjimet shtypëse antipopullore dhe klerikët reaksionarë ata që kanë adoptuar dhe kanë përdorur fenë myslimane për të ushtruar shtypjen shoqërore mbi këta popuj dhe për t'i shfrytëzuar ata në mënyrë më të egër. Pushtetin e tyre gjakatar ata e kanë ruajtur dhe e ruajnë nëpërmjet armëve dhe përkrahjes që kanë marrë nga jashtë, domethënë nga fuqitë imperialiste e neokolonialiste grabitqare, si edhe duke nxitur e duke zhvilluar fanatizmin fetar. Kështu zhvillimi i ngjarjeve po vërteton gjithnjë e më shumë tezën marksiste-leniniste se armiqtë e brendshëm bashkëpunojnë ngushtë me armiqtë e jashtëm për të shtypur popujt e vet dhe se feja përdoret nga ana e tyre si armë për të mbajtur në errësirë dhe për të shtypur popujt.

Ngjarjet që po jetojmë tregojnë qartë se popujt arabë myslimanë janë luftëtarë. Kryengritjet e luftërat e tyre antiimperialiste, antikolonialiste dhe antif feudale shoqërohen dhe përfundojnë me përlëshje të armatosura. Këto luftëra e kryengritje e kanë burimin e tyre në shtypjen e egër që ushtrohet mbi këta popuj, në ndjenjat e tyre liridashëse e përparimtare. Po të mos jesh përparimtar e liridashës, nuk mund të ngrihesh në luftë

për liri e pavarësi kombëtare, kundër shtypjes së dyfish-të, të brendshme dhe të jashtme.

Një shkak tjetër shoqëror e nxitës i fortë për kryengritje antiimperialiste, antikolonialiste e antif feudale është gjendja e rëndë ekonomike e këtyre popujve, uria dhe vuajtjet që rëndojnë mbi ta. Pra nuk mund të mos marrim në konsideratë zgjimin politik, por deri diku edhe atë shoqëror të tyre.

Duke i hedhur një vështrim luftës së popujve me besim mysliman vëmë re se në zhvillimin e saj ka ndryshime të theksuara, ka ngjitje, por ka edhe rënie ose qëndrim në vend, ka amulli që krijohet nga faktorë të ndryshëm e sidomos nga borgjezia pseudoprogresiste që ndodhet, ose vihet në krye të këtyre popujve.

Kështu, për shembull, në Marok ka pasur njëfarë lëvizjeje, por lëvizja antif feudale dhe antiimperialiste e popullit të këtij vendi nuk është në lartësinë e vendeve të tjera, përkundrazi monarkia dhe feudalizmi dominojnë mbi këtë popull me dhunë, me pseudoreforma liberale, por duke përdorur edhe ndjenjat fetare.

Në Algjeri populli bëri luftën nacionalçlirimtare kundër kolonizatorëve francezë dhe, megjithëse nuk udhëhiqej nga një parti marksiste-leniniste, por nga borgjezia nacionale, lufta për çlirimin kombëtar përfundoi me largimin e pushtuesve të huaj, veç ajo nuk u çua më tej. Kjo ndodhi sepse borgjezia e re liberale që erdhi në fuqi, edhe pse populli algjerian bëri një luftë të madhe dhe të përgjakshme, pengoi evolucionin përparimtar të vendit, reformat ekonomiko-shoqërore qenë të pjesshme, nuk u çuan përpara dhe vendi ra në amulli politiko-ekonomike në disfavor të masave punonjëse.

Në Tunizi populli duket i përgjumur dhe paraqitet apatik, nuk po shihet që të zgjohet, sido që nuk është dhe aq i prapambetur. Kohët e fundit u fol atje për një lëvizje sindikaliste, u arrestua edhe sekretari i përgjith-

shëm i sindikatave, po asgjë më shumë nuk ndodhi më tej.

Në Egjipt, në vitin 1952, ndodhi, gjithashtu, një revoltë. Rrëzimi i monarkisë u bë pa gjakderdhje. Mbreti Faruk u dëbua nga Egjipti nga një grup oficerësh. Ata që e shfronësuan e shoqëruan deri në Aleksandri, i dhanë para, e hipën në vapor dhe e ndihmuan që të ikte e të shpëtonte. Me një fjalë i thanë monarkut të largohej më mirë vetë dhe të shpëtonte lëkurën, se në vend nuk mund të qëndronte më, atje s'kishte më rrënjë. Kështu grupi i oficerëve, me Naserin, Nagibin e Sadatin në krye, bënë si me thënë një *colpo di stato* ushtarak pa gjak kundër një monarkie krejtësisht të degjeneruar dhe morën në dorë fuqinë. Ç'ishte e ç'përfaqësonte grupi i oficerëve puçistë egjiptianë? Këta oficerë ishin njerëzit e borgjezisë, përfaqësuesit e saj, ishin antianglezë, por midis tyre kishte edhe prohitlerianë. Anvar el Sadati, siç e kam përmendur, deklaroi vetë se ka bashkëpunuar me «ujkun e shkretëtirës», feldmareshalin nazist Romel.

Kjo ngjarje, domethënë dëbimi i Farukut nga froni, u pompua jashtëzakonisht shumë derisa u quajt «revolucion». Por nga gjithë kjo populli egjiptian, masat punonjëse të këtij vendi, nuk patën ndonjë përfitim. Pothuajse asnjë lloj reforme nuk u bë në të mirën e popullit. Edhe njëfarë reforme agrare që filloi, përfundoi në favor të feudalëve e të pronarëve të pasur të tokave. Të riardhurit në fuqi, nën maskën e unitetit të popujve arabë, u përpoqën të bënë edhe «bashkimin» e Egjiptit me Sirinë. Po çdo përpjekje në këtë drejtim ishte e kotë, sepse edhe në Siri, në këto kohë, borgjezia kapitaliste në udhëheqjen e shtetit kishte ndërruar vetëm kuajt dhe padronin. Bashkimi Sovjetik imperialist kishte zëvendësuar atje Francën. Ai e sabotoi këtë «bashkim» pa baza dhe nguli thonjtë në këtë vend.

Edhe në Libi, siç dihet, në vitin 1969 pati një revoltë;

u rrëzua dinastia e mbretit Idriz dhe në fuqi erdhi një grup oficerësh të rinj, me Kadafin në krye, i cili hiqet si antiimperialist. Këtë revoltë, këtë lëvizje, në fillim ne mund ta cilësojmë si përparimtare, por më vonë kjo lëvizje u topit dhe aktualisht ka rënë në amulli. Kadafi që erdhi në fuqi, i cili e mban veten si kryetar i islamizmit, e shfrytëzoi fenë myslimane për ta paraqitur Libinë si një vend «përparimtar», bile e quajti edhe «socialist», por, në realitet, pasuria e madhe e vendit, nafta, po shfrytëzohet për qëllime të mbrapshta, aventureske e shumë të dyshimta. Natyrisht, për demagogji dhe për arsye se të ardhurat që sigurohen nga shitja e naftës janë me të vërtetë të mëdha, në jetën e popullit, në qytete, janë bërë disa përmirësime, por nomadizmi në shkretëtirë vazhdon të qëndrojë një plagë shoqërore. Kadafi, siç e dimë, ka qenë një nxënës i Naserit si në politikë, në ideologji e në bindjet fetare, ashtu edhe në synimet e tij.

Në kryeqytetin e Irakut, në Bagdad, ndodhi më 1958 një kryengritje diçka më e avancuar, më revolucionare, kundër monarkisë, që përfundoi me vrasjen e mbretit Faisal dhe të kryeministrit Nuri Said. Fuqinë atje e morën «komunistët» tok me gjeneral Kasemin, përfaqësues i oficerëve liberalë. Por 5 vjet më vonë, më 1963, atje ndodhi një grusht shteti dhe Kasemi u ekzekutua. Në vend të tij erdhi në fuqi një oficer tjetër, koloneli Aref. Në vitin 1968 doli në krye gjenerali Al Bakr dhe përsëri në fuqi erdhi partia «Baas», një parti e borgjezisë reacionare, feudale e kompradore.

Ngjarjet që po ndodhin në Iran e në Afganistan përbëjnë një shembull pozitiv për popujt e shteteve fqinje, për Pakistanin, për Arabinë Saudite, për Irakun, për Emiratet e Gjirit Persik, për Sirinë, për Egjiptin e shumë të tjerë, prandaj konsiderohen një rrezik i madh edhe për klikat sunduese të disa vendeve të këtij rajoni. Pra gjithë bota arabe është në lëvizje, në evolucion.

Jehona e kryengritjes popullore antifeudale e anti-imperialiste e popullit iranian që po e trondit imperializmin në bazat e tij ekonomike dhe në synimet për hegjemoni botërore, shtrihet deri në Indonezi, por atje lëvizja është më e dobët sesa në vendet e Azisë Qendrore, të Lindjes së Afërt e të Mesme, apo edhe të Afrikës Veriore, ku islamizmi si fe është më kompakt dhe pasuritë janë më të mëdha. Në këto rajone ka një zgjim progresist të masave, të cilin, tani për tani, siç po ndodh në Iran, e udhëheqin, në përgjithësi elementë fetarë që dinë t'i shfrytëzojnë ndjenjat për liri të këtyre popujve, ndjenjat e tyre kundër imperializmit shtypës, kundër krerëve monarkistë e klikave feudale grabitëse, vjedhëse e vrasëse të egra të tyre etj., etj. Prandaj ne duhet t'u bëjmë analizë marksiste-leniniste këtyre situatave. Ne nuk mund të pranojmë e të jemi dakord me zërat që po përhapin propaganda borgjezo-revizioniste, imperializmi amerikan dhe kapitalizmi botëror sikur Ajatollah Khomeini, iksi apo ipsiloni në Iran janë njerëz që nuk kuptojnë nga politika, ose janë aq të prapambetur sa kanë qenë imam Aliu, imam Hasani e imam Hyseini. Kjo nuk është e vërtetë. Përkundrazi, faktet tregojnë se njerëzit si ai dinë ta shfrytëzojnë si duhet lëvizjen aktuale të këtyre popujve, që në esencë dhe në fakt është një lëvizje progresiste, demokratiko-borgjeze dhe antiimperialiste.

Këto lëvizje, në rrugë e me mjete të ndryshme, po përpiqen t'i mbështetin e t'i bëjnë për vete, për qëllimet e tyre, edhe imperialistët e socialimperialistët e ndryshëm. Mirëpo ato aktualisht janë në disfavorin e tyre, janë kundër tyre. Kjo është aq e vërtetë sa socialimperialistët sovjetikë u detyruan të futnin regjimentet e tyre tankiste dhe dhjetëra mijë ushtarë sovjetikë në Afganistan, të kryenin, me një fjalë, një agresion të hapët fashist ndaj një vendi të pavarur, për të vënë e për të mbajtur në fuqi kukullat vendase të tyre, të cilat nuk

ishin në gjendje ta ruanin pushtetin pa ndihmën e bajonetave e të tankeve të ushtrisë sovjetike, të forcave të armatosura të Bashkimit Sovjetik.

Kuptohet se kjo ngjarje, ky pushtim i armatosur sovjetik i Afganistanit, do të shkaktonte reagime e shqetësime në opinionin publik ndërkombëtar, do të shkaktonte zemërim të madh e urrejtje te popujt liridashës dhe te forcat përparimtare dhe, nga pikëpamja strategjike, nervozizëm te rivalët e tyre për hegjemoni e sidomos te Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në fakt, po vëmë re se këto ditë presidenti amerikan Karter sikur kërkon të lëvizë ca, me sa duket për t'i nxjerrë ndonjë vështirësi Bashkimit Sovjetik dhe të forcojë pozitat e tij që po i dobësohen vazhdimisht, kërkon të marrë masa për të penguar një invadim të mundshëm sovjetik në Pakistan, ose, më mirë të them, të pengojë shfrytëzimin nga socialimperialistët sovjetikë, për qëllimet e tyre, të ndjenjave revolucionare antiimperialiste të popullit musliman të Pakistanit. Populli pakistanez ushqen simpati për lëvizjen antiimperialiste të fqinjëve të tij iranianë dhe mund të ngjasë edhe atje ajo që po ngjet në Iran. Pikërisht, për t'i dalë përpara këtij eventualiteti, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe presidenti i tyre Karter i kanë propozuar qeverisë pakistaneze që të dërgojnë në Pakistan 50 mijë ushtarë dhe të shtojnë furnizimet me armatime, gjoja për të përballuar rrezikun sovjetik. Shtetet e Bashkuara të Amerikës dërguan po ashtu në Kinë ministrin e tyre të Mbrojtjes për të konkretizuar dhe për të aktivizuar aleancën kino-amerikane. Gjatë kësaj vizite, të dyja palët shprehën shqetësimin e tyre për zgjerimin e ekspansionit të socialimperialistëve sovjetikë në këtë rajon dhe, lidhur me këtë, vendosmërinë e tyre për të mbrojtur interesat e vet imperialistë e të njëri-tjetrit. Shtetet e Bashkuara të Ame-

rikës i premtuan Kinës armatime moderne nga më të sofistikuarat.

Po a ekziston rreziku sovjetik për Pakistanin? Po, ekziston. Veç në Pakistan zemërimi kundër Zia ul Hakut, i shoqëruar me simpatinë për Khomeinin, mund të shpërthejë edhe pa ndërhyrjen e sovjetikëve. Vetë Zia ul Haku, për t'i shpëtuar një presioni sovjetik dhe kryengritjes së popullit pakistanez, mund të bashkohet me sovjetikët dhe këta e justifikojnë kështu ndërhyrjen e tyre në këtë vend. Prandaj edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës po aktivizojnë paktet e tyre ushtarake me Pakistanin.

Karteri përpiqet ta ruajë nga ana e tij ekuilibrin, sepse një ndërhyrje e Bashkimit Sovjetik në Pakistan përbën rrezik për imperializmin amerikan në këtë rajon të botës. Karteri ka e duhet të ketë influencë në Pakistan edhe për arsye se ky vend ka një «traktat të mbrojtjes» me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Përveç kësaj, Karteri, në situatat e reja që janë krijuar këto kohë në Azinë Qendrore, sheh edhe rreziqe të tjera, siç është rikthimi në fuqi i Indira Gandit, e cila po ndjek politikën e saj prosovjetike. Në rast se sovjetikët do të arrijnë t'i forcojnë pozitat e tyre në Indi, që është në konflikt me Pakistanin, ky i fundit mund të jetë më i prekshëm nga ana e sovjetikëve, me një fjalë rritet dhe bëhet më i lehtë depërtimi i influencës sovjetike atje. Ja, pra, përse imperialistët amerikanë kërkojnë t'i dalin përpara eventualitetit të një ndërhyrjeje ushtarake ose të rritjes së influencës së Bashkimit Sovjetik në Pakistan. Nga ana tjetër, Shtetet e Bashkuara janë shumë të shqetësuara nga mundësia e një presioni sovjetik edhe ndaj Iranit nën pretekstin e ndihmës kundër kërcënimeve që i bëhen këtij vendi nga imperializmi amerikan.

Është e qartë se popujt e këtij rajoni janë myslimanë dhe, kur e themi këtë, kemi parasysh faktin që shumica

e tyre besojnë, por besimi i tyre është relativ dhe nuk predominon mbi politikën. Ka atje edhe njerëz përparimtarë që Kuranin dhe fenë i besojnë dhe i respektojnë më shumë si zakon e si traditë. Kur flasim për shumicë dërrmuese, kemi parasysh atë pjesë të popullit, së cilës fenë myslimane ia kanë paraqitur si një fe liberale, përparimtare, që u shërben interesave të popullit dhe se gjithçka që predikohet në emër të saj, «është për të mirën e tij», mbasi «të marrësh avdes, të falesh, të agjërosh është në të mirën e shëndetit, të forcimit fizik e të kënaqësisë shpirtërore të njeriut» etj., etj. Me një fjalë njerëzve u thuhet se ritet e kësaj feje «janë të dobishme» jo vetëm për këtë jetë, por edhe për «jetën tjetër», pas vdekjes. Dhe kjo gjë predikohet hapur. Por mjerimi dhe shtypja, shkolla dhe njëfarë zhvillimi politik, ia kanë tronditur themelet këtij besimi.

Në përgjithësi, nga të gjitha këto ngjarje e zhvillime, shohim se si imperialistët, ashtu edhe socialimperialistët, në këto rajone të botës i kanë pozitat të vështira. Është e kuptueshme që tok me ta të vështira i kanë pozitat edhe kukullat e tyre. Si për të parët, edhe për të dytët, këto pozita shumë të vështira i shkakton lëvizja revolucionare, përparimtare, antiimperialiste, antikolonialiste e antifeudale e masave popullore të popujve arabë myslimanë, qofshin ata shiitë apo sunitë. Gjithë kjo gjendje në këtë rajon është pozitive, e mirë dhe flet për një situatë revolucionare, për një lëvizje të madhe të këtyre popujve. Por, në të njëjtën kohë, shohim se bëhen përpjekje nga ana e armiqve të tyre për ta frenuar këtë lëvizje, ose për t'i ndryshuar drejtimin dhe intensitetin.

Këto situata, këto luftëra e këto kryengritje të këtyre popujve ne duhet t'i shohim, pra, si lëvizje shoqërore, revolucionare, pavarësisht se në pamjen e parë ato kanë karakter fetar, e se i ndjekin njerëz besimtarë ose jobesimtarë, por që luftojnë kundër imperializmit të

huaj, neokolonializmit apo monarkive ose feudalizmit shtypës brenda vendit. Historia na jep plot shembuj pozitivë në këtë drejtim, kur lëvizje të gjera masash popullore e revolucionare, në pamjen e jashtme, kanë pasur karakter fetar. Të tilla kanë qenë: Lëvizjet Babide në Iran në vitet 1848-1851; lëvizja e Vahabitëve në Indi, që parapriu kryengritjen e madhe popullore kundër kolonizatorëve anglezë në vitet 1857-1859; lëvizjet fshatare në kohën e Reformacionit në shekullin e 16-të, që përfshinë shumicën e vendeve të Evropës dhe sidomos Gjermaninë. Vetë Reformacioni, ndonëse ishte veshur me petkun fetar, përfaqësonte në vetvete një lëvizje të gjerë shoqërore politike të ngritur kundër sistemit feudal dhe kishës katolike që mbronte këtë sistem.

Kur cenohen interesat jetikë të një populli, liria dhe pavarësia e tij, ai ngrihet në luftë kundër kujtdo agresori qoftë, edhe pse ai mund të ketë të njëjtën fe. Kështu ndodhi, për shembull, në Jemenin e Veriut në vitin 1962 kur Naseri dërgoi ushtrinë egjiptiane gjoja për ndihmë. Pas disa kohësh ai u detyrua të largonte nga Jemeni trupat që dërgoi, sepse filloi një konflikt i ashpër midis popullit të këtij vendi dhe ushtrisë egjiptiane, pavarësisht se të dyja palët besonin në një fe.

Në Jemenin e Jugut, ku jeton një popull mysliman që beson, ekzistonte një lëvizje revolucionare popullore kundër imperializmit anglez që zotëronte portin e Adenit. Vullnetarisht Anglia nuk do të largohej kurrë nga porti i Adenit, që përbën një kyç strategjik me rëndësi të madhe në Oqeanin Indian dhe në hyrjen e Detit të Kuq, por ishte lufta antiimperialiste e popullit të Jemenit që e detyroi atë të shkulej andej, sepse qëndrimi atje iu bë i pamundur. Pas kësaj, në vitin 1970 në Jemenin e Jugut u krijua një regjim «demokratiko-popullor», i cili hyri dalngadalë nën ndikimin e socialimperialistëve sovjetikë.

Lëvizja revolucionare kundër socialimperializmit sovjetik, në mos sot, nesër edhe këtu do të marrë zjarr.

Tani në gjithë principatën e Omanit ka lëvizje revolucionare antiimperialiste e antikolonialiste, si dhe kundër vetë sulltanit sundimtar të vendit. E njëjta situatë do të ndodhë edhe në Etiopi, në Somali, në vendet e Gjirit Persik etj.

Popujt e vendeve të këtij rajoni janë të tërë fetarë, njerëzit atje u besojnë Kuranit dhe Muhamedit dhe çështjen e luftës kundër shtypjes imperialiste ata e lidhin me fenë. Ky është një realitet. Por, gjithashtu, kuptohet se ne nuk mund të dalim në konkluzione se është feja ajo që i shkakton këto revolta dhe këtë zgjim revolucionar. Në asnjë mënyrë. Veçse nuk mund ta injorojmë faktin që këta popuj besojnë në fenë myslimane e, në të njëjtën kohë, luftojnë heroikisht kundër imperializmit të çdo ngjyre, për çlirimin e tyre shoqëror e kombëtar.

Në Shqipëri para Çlirimit kishte njerëz që besonin në fenë myslimane, po fanatizëm nuk kishte. Edhe në vendet arabe apo në ato myslimane të Azisë së Mesme, sidomos sot, nuk mund të ekzistojë fanatizmi klasik i dikurshëm. Një fanatizëm i tillë nuk mund të ekzistojë jo vetëm te myslimanët, por as te katolikët, te kalvinistët e shizma të tjera të kristianizmit. Të mos harrojmë epokën në të cilën jetojmë. Ne nuk mund të mos mbajmë parasysh sot zhvillimin e madh të shkencës, rritjen dhe fuqizimin e proletariatit revolucionar, përhapjen e ideve të marksizëm-leninizmit. Fanatizmin, në kuptimin klasik të tij, sot e nxitin në këto vende krerët reaksionarë fetarë, shërbëtorë të rendit feudal e të monarkive shtypëse të lidhur me ta, që duan t'i mbajnë popujt në errësirë e nën zgjedhë dhe të luftojnë lëvizjet e tyre çlirimtare.

Për sa i përket Khomeinit, ky është një udhëheqës fetar, një besimtar i devotshëm, një filozof idealist. Ai mund të jetë edhe fanatik, po shohim se në të njëjtën

kohë pajtohet e bashkohet me frymën revolucionare të popullit iranian. Khomeini ka marrë anën e kundërshtarëve të monarkisë. Borgjezia imperialiste, përkrahësit e monarkisë Pahlevi dhe forca të tjera reaksionare në botë thonë se ai kërkon të bëhet vetë monark. Le ta thonë këtë, por është fakt se lëvizja çlirimtare antiimperialiste, antikolonialiste e antifeudale në Iran është në ngritje dhe Khomeini vazhdon të qëndrojë në pozita të mira për sa i përket kësaj lëvizjeje.

Ajo çka po ngjet në Iran, mund të ngjasë edhe në Pakistan, mund të ngjasë edhe në vendet e Gadishullit Arabik, ajo mund t'i japë zjarr gjendjes revolucionare në ndonjë vend tjetër fqinj, mund t'i japë zjarr gjendjes edhe në vetë Bashkimin Sovjetik, për arsye se socialimperializmi dhe revizionizmi e bartin kudo me vete shtypjen nacionale dhe, si pasojë, ngjallin ndjenjat e çlirimit kombëtar të popujve. Vetëm socializmi dhe teoria marksiste-leniniste i japin zgjidhje në rrugë të drejtë çështjes nacionale. Sot të drejtat nacionale të kombeve e të popujve janë shkelur e janë marrë nëpër këmbë në Bashkimin Sovjetik dhe kudo ku sundojnë imperializmi amerikan dhe kapitalizmi ndërkombehtar. Atje ka shtypje të madhe, prandaj, logjikisht, me siguri ka dhe do të ketë edhe lëvizje.

Aktualisht në Iran ngjarjet ne duhet t'i shohim dhe t'i analizojmë ashtu si zhvillohen dhe këndeje të nxjerrim konkluzione në bazë të mësimave të teorisë sonë marksiste-leniniste. Në kryengritjen antiimperialiste dhe kundër monarkisë në këtë vend, në pararojë të forcave aktive janë fetarët, rinia studenteske, punëtorët, intelektualët. Pra nuk janë në udhëheqje të lëvizjes as proletariati dhe as partia e tij e vërtetë marksiste-leniniste. Në këtë çështje duhet të kemi parasysh edhe faktin se ne nuk dimë mirë forcën dhe bazën e korrenteve të ndryshme politike në këtë lëvizje. Nga eksperiencia jonë dimë që

edhe te ne klasa punëtore nuk ishte e zhvilluar, por megjithatë, duke ekzistuar faktori objektiv dhe subjektiv, në kushtet e okupacionit e të Luftës Nacionalçlirimtare, Partia e udhëhoqi popullin në fitore duke u bazuar në marksizëm-leninizmin, që do të thotë i vuri klasën punëtore dhe pararojën e saj, domethënë veten, në drejtim, në udhëheqje.

Në Iran nuk ndodh kështu. Ekziston në këtë vend një parti marksiste-leniniste, Partia Komuniste Punëtore e Fshatare e Iranit, parti e re që sapo është formuar, po kjo është ende e vogël, e pakalitur, jo e lidhur me klasën punëtore e me masat etj., ndërsa partia revizioniste «Tudeh» ka ekzistuar legalisht dhe në ilegalitet, tash prapë është legale, por ajo është vegël e Bashkimit Sovjetik. Kjo parti, duke u mbuluar me parulla marksiste-leniniste, saboton luftën revolucionare antiimperialiste të popullit iranian dhe përpiqet ta futë Iranin në sferën e influencës e të zgjedhës sovjetike. Prandaj ndodh që populli mysliman iranian, që është ngritur në revolucion, nuk e njeh marksizëm-leninizmin, as si teori, as si praktikë revolucionare. Studentët, që studiojnë në universitetet myslimane me tradita të mëdha të Iranit dhe të sektit shiit, edhe besojnë në fenë, edhe nuk besojnë. Për sa u përket elementëve përparimtarë laikë, ka nga ata që besojnë dhe luftojnë për një pushtet borgjezo-demokratik-liberal, ka nga ata që besojnë në një shoqëri kapitaliste «progresiste» por antikomuniste, ka nga ata që vazhdojnë të mendojnë se Bashkimi Sovjetik është një vend socialist, që përfaqëson dhe zbaton leninizmin. Është pikërisht kjo një nga arsyet që marksizëm-leninizmi i vërtetë ende nuk e ka fituar të drejtën e qytetarisë në Iran, prandaj atje po luftohet për çlirimin e popullit nga zgjedha e imperializmit amerikan dhe nga influenza sovjetike, por nën flamurin e islamizmit. Kjo do të thotë që klerikët myslimanë shiitë janë në udhëheqje, në pararojë të kësaj

kryengritjeje, por ne nuk kemi iluzione dhe e dimë që janë për një regjim borgjez kapitalist me predominancë fetare, pra teokratike. Se ç'rrugë do të marrë më tutje lëvizja antiamerikane dhe kundër monarkisë barbare dhe kompradore të Pahlevëve, kjo varet kryesisht nga forcat e brendshme që po ziejnë.

Cilat janë këto forca në bazë të një përcaktimi të përgjithshëm që mund t'u bëhet?

Në gjendjen aktuale botërore e në stadin e tanishëm të lëvizjes së popujve për çlirim të tyre shoqëror e kombëtar, revolucioni popullor në Iran përfaqëson një etapë të re. Këtë etapë ne duhet ta vëmë më mirë në evidencë dhe ta analizojmë në mënyrë kritike marksiste-leniniste, pa marrë parasysh çfarë bëjnë e çfarë thonë të tjerët.

Irani është një vend shumë i pasur me naftë, pra ka një klasë punëtore të përbërë nga naftëtarë, punëtorë industrie, por ka edhe artizanë. Nga një popullsi prej 33 milionë banorësh që ka Irani, afro 17 milionë veta janë në fshat, punojnë tokën. Këta janë të mjeruar, të shtypur, të shfrytëzuar në kulm nga mullahët, vakëfi, nga borgjezia e madhe e tokave në shërbim të Pahlevëve, nga borgjezia e pasur tregtare dhe uzurare e lidhur me monarkinë. 99 për qind e popullsisë së Iranit konsiderohet e besimit mysliman dhe shumica janë të sektit shiit.

Regjimi i Pahlevëve ishte nga më barbarët, nga më gjakatarët, nga më shfrytëzuesit dhe nga më të korruptuarit e botës së sotme. Ai shtypi me gjak e me terror çdo lëvizje përparimtare, çdo manifestim, qoftë edhe të zbehtë liberal, çdo protestë e çdo grevë të punëtorëve, të studentëve dhe çdo përpjekje për të zhvilluar një ekonomi të vogël ndihmëse për të jetuar. Diktatura e egër e Pahlevëve mbështetej te feudalët e mëdhenj, te pasanikët e mëdhenj që krijoi regjimi, tek ushtria reaksionare dhe kasta e saj drejtuese, si edhe te SAVAK-u, policia e

fshehtë, që, siç e cilësonte vetë shahu, ishte «shtet brenda në shtet». Pahlevët sundonin me terror, grabitnin popullin, pasuroheshin në mënyrë skandaloze, ata ishin personifikimi i degjenerimit moral dhe politik, ishin ortakë dhe të shitur tek imperializmi anglez, amerikan etj. Pahlevët ishin bërë xhandarët më të armatosur të Gjirit Persik nën urdhrat e CIA-s.

Irani shtypej, por populli ziente, megjithëse pushkatiemet në masë ishin në rend të ditës. Ajatollahët që u prekën nga regjimi lëviznin. Më 1951 Musadeku, një përfaqësues i borgjezisë, i mbështetur nga mullahët antishah dhe nga partia «Tudeh», mori fuqinë. Më 1953 shahu u largua, por rrëzimi dhe largimi nuk qenë përfundimtarë, pse CIA organizoi puçin, rrëzoi Musadekun dhe risolli shahun në Iran e në fron. Kështu Irani u bë pronë e amerikanëve dhe e shahut dhe nafta arma e tyre e fuqishme.

Karakteristikë e revoltës së popullit iranian është ajo që, me gjithë terrorin e madh, nuk u shua, por vazhdoi, me ndërprerje, në forma të ndryshme dhe me intensitete të ndryshme. Ky proces revolucionar i pandërprerë u ngrit në cilësi dhe e kapërceu stadin e frikës nga shtypja.

Në vitin 1977, me gjithë terrorin e madh, opozita kundër shahut filloi të manifestohej më me forcë, u bë më e hapët dhe më operuese. Po t'i shohim veç e veç këto rryma kundër shahut dhe regjimit të tij, do të konstatojmë se ato janë disi autonome, por me strategji të përbashkët. Kështu shohim kundërshtimin e musadekistëve, rezistencën e fetarëve, veprimet dhe demonstratat e studentëve, qëndrimet kundër regjimit të intelektualëve, nëpunësve, shkrimtarëve, poetëve, artistëve në mitingje, në universitete e në vende të tjera publike etj.; tok me të gjitha këto rryma shohim edhe vetëmbrojtjen e rezistencën e klasës punëtore dhe të të gjithë popullit që shtypej e shfrytëzohej. SAVAK-u godiste pa mëshirë, por

edhe shtypja e vrasjet shtonin zemërimin e masave. Kjo rezistencë u kthye në një veprimtari permanente.

Në të njëjtat periudha ne shohim rizgjimën e opozitës politike të musadekistëve të Frontit Kombëtar. Një nga elementët e këtij korrenti ishte edhe Shapur Baftjari, i cili, në pragun e përmbysjes së shahut Pahlevi, u bë kryeministër. Ky ishte fisheku i fundit i shahut dhe i imperialistëve amerikanë kundër revolucionit antiimperialist iranian dhe Khomeinit.

Gjatë peripecive të kësaj lëvizjeje nga opozita politike u shkëputën «Lëvizja e çlirimit të Iranit», «Partia e Iranit», «Liga socialiste e lëvizjes nacionale të Iranit», «Lëvizja e çlirimit të Iranit», që kishte në krye Bazarganin e që pas largimit të shahut u bë kryeministër, ishte më afër Khomeinit dhe imamëve të tjerë.

Duhet të kemi kurdoherë parasysh se, si të gjitha këto opozita politike, edhe opozita fetare kundër Pahlevëve nuk ishte e bashkuar. Një pjesë e atyre që e përbënin këtë opozitë ishte kundër së ashtuquajturës reforme agrare, kundër së drejtës së votës të grave etj. Kjo pjesë, e përbërë nga klerikë konservatorë, po e humbiste nga koha në kohë influencën në masat, të cilat afroheshin më shumë me klerikët që luftonin hapur diktaturën e shahut në bazë të principeve shiite të fesë islame. I tillë ishte Ajatollah Khomeini, që u burgos, u torturua, u riburgos, i vranë edhe djalin dhe u nxor jashtë në mërgim. Kjo ia shtoi influencën imami në popull, në «Bazar» (qendra kryesore e tregut të Teheranit), pra te tregtarët, por edhe te punëtorët. Në valën e agjitacionit e të demonstratave të mëdha kundër shahut kërkoheshin nga masat kthimi në atdhe i imami. Vdekja e djalit të tij, si edhe e personalitetit politik, Ali Shariat, në rrethana misterioze, bëri që elementët fetarë të dilnin në krye të përlëshjeve dhe me ta të bashkohej gjithë populli veçanërisht në Tabriz, më 18-19 shkurt të vitit 1977, si edhe në

Teheran, në Kom e në qytete të tjera iraniane. E tërë kjo dëshmon për shpirtin luftarak të popullit të Iranit. Kjo bëri që monarkia e Pahlevëve të mos u rezistonte dot sulmit dhe valëve të njëpasnjëshme të popullit kryengritës.

Në këtë klimë kryengritëse progresiste, pra, kundër feudalizmit, monarkisë dhe imperializmit, marksistë-leninistët duhet të bëjnë analizën e tendencave të ndryshme politike, të orientimeve të këtyre tendencave, të aleancave dhe të kontradiktave në mes tyre brenda në Iran dhe jashtë këtij vendi me botën kapitaliste, revizioniste.

Aktualisht shohim një unitet të kryengritjes në mënyrë aktive dhe luftarake kundër imperializmit amerikan e shahut dhe deri në njëfarë shkalle edhe kundër social-imperializmit sovjetik, e, në të njëjtën kohë, një rritje të vigjilencës dhe të kundërshtimit kundër të gjitha shteteve të tjera kapitaliste, por jo aq hapur e në mënyrë aktive sa kundër të parëve. Këto situata patjetër do të pësojnë evolucione. Ne shohim se universitetet në Iran janë bërë qendra të manifestimeve të zjarrta, qofshin këto me tendenca politike ose fetare, shohim po ashtu që edhe opozita fetare dhe ajo politike po bashkohen. Pra, musadekistët dhe khomeinistët, me gjithë kontradiktat që ekzistojnë në mes tyre, duket se po afrohen me njëri-tjetrin. Në Tabriz, që është një vend ku përveç punëtorëve të naftës, ekziston njëkohësisht një klasë punëtore e rëndësishme, mund të themi se u bë ky unitet. Po kështu ndodh në Abadan dhe në rajonet e tjera ku ekzistojnë fusha naftë dhe rafineri.

Forca dhe orientimet e klasës punëtore duhet të bëhen nga ana e marksistë-leninistëve iranianë, në mënyrë të veçantë, objekt i një analize në prizmin marksist-leninist dhe partia e tyre të mbështetet tek ajo, të futet te klasa, ta edukojë dhe ta sqarojë atë politikisht dhe

ideologjikisht dhe të kalitet tok me të në këtë luftë klasore revolucionare që sapo ka filluar, që nuk ka mbaruar dhe që do të marrë me siguri aspekte të ndryshme. Vetëm veprimtaria revolucionare e klasës punëtore dhe ideologjia marksiste-leniniste duhet të bëhen faktori vendimtar i orientimeve të drejta që duhet të marrë ky revolucion antiimperialist. Sigurisht, në gjendjen aktuale në Iran mund dhe duhet të përfitohet shumë nga forca revolucionare e klasës punëtore iraniane, nga elementët progresistë dhe veçanërisht nga studentët dhe fshatarësia e varfër dhe e mesme.

Do të jetë gabim në qoftë se marksistë-leninistët nuk i kuptojnë dhe nuk i shfrytëzojnë drejt situatat e krijuara, në qoftë se paraqiten si luftëtarë antifetarë, duke dëmtuar unitetin antiimperialist dhe antifeudal edhe me partizanët e Ajatollah Khomeinit dhe me lëvizjet demokratiko-borgjeze të musadekistëve, të Bazarganit ose me parti dhe lëvizje të tjera antiimperialiste.

Marksistë-leninistët iranianë, duke qenë antifetarë në parimet e tyre, nuk duhet të zhvillojnë në këto momente luftë kundër besimit fetar të popullit, që është ngritur në kryengritje kundër shtypjes dhe që politikisht bën një luftë të drejtë, por që ideologjikisht është i paformuar dhe ndodhet përpara një shkolle të madhe ku do të mësojë. Marksistë-leninistët duhet ta mësojnë popullin që t'i gjykojë ngjarjet që po zhvillohen në dritën e materializmit dialektik dhe historik. Por botëkuptimi ynë nuk mund të përvetësohet lehtë dhe i shkëputur nga hovi revolucionar i masave dhe as i izoluar nga rrymat antiimperialiste që përpiqen të qëndrojnë në udhëheqje dhe të manovrojnë për të penguar reformat demokratiko-borgjeze të revolucionit. Marksistë-leninistët dhe klasa punëtore iraniane duhet të luajnë një rol të madh në këto lëvizje revolucionare dhe të kuptojnë qartë momentet nëpër të cilat kalojnë; ata duhet të mos e lënë revolucionin

të bjerë. Klasa punëtore dhe pararoja e saj e vërtetë marksiste-leniniste duhet të mos kenë asnjë iluzion në veprimet dhe në reformat «e thella» demokratiko-borgjeze që mund të bëjnë klerikët shiitë ose elementët kundër shahut të borgjezisë nacionale të vjetër dhe të re. Me siguri, në rast se nga klasa punëtore, fshatarësia e varfër dhe studentët përparimtarë, besimtarë ose jobesimtarë, do të lihet që të bjerë hovi i revolucionit, gjë që do të thotë të mos ecet me ngulm, me pjekuri në aleanca e në veprime drejt reformave të njëpasnjëshme politike dhe ekonomiko-shoqërore, atëherë revolucionin do të ngëlë në mes të rrugës, masat do të zhgënjehen dhe shfrytëzimi i tyre do të vazhdojë në forma të tjera, nga të tjerë një-rëz pseudodemokratë të lidhur me aleanca të reja me imperialistët e ndryshëm.

Këto situata të veçanta, të reja dhe revolucionare, që po zhvillohen në popuj me besim fetar islamik, lypset të studiohen, të nxirren konkluzione dhe të gjenden forma të reja lufte, veprimi dhe aleancash. Këto situata revolucionare janë shumë më të avancuara nga situatat në Evropë dhe në Azi, bile deri në njëfarë shkalle edhe në Amerikën Latine, ku lëvizjet revolucionare kanë marrë një formë të ngrirë, të inkuadruar dhe të drejtuar nga socialdemokracia dhe revizionizmi modern, reformist e kundërrevolucionar.

Kështu në Evropë, ku ekziston një proletariat i madh e i fuqishëm, ne nuk shohim të ngjasin revolta të tilla me frymë të theksuar revolucionare e politike. Për ç'arsye? Për të gjitha ato arsye që dihen dhe që kanë të bëjnë me ndikimin e rëndë kundërrevolucionar e sabotues të socialdemokracisë e të revizionizmit modern. Këtu, në Evropë, klasa punëtore deri diku është borgjezuar, është futur në rrugën socialdemokrate të reformave. Nuk është çështja se në kontinentin tonë nuk ka shfrytëzim, prandaj nuk ka edhe lëvizje. Jo. Edhe këtu ka,

gjithashtu, shfrytëzim, ka edhe lëvizje, por këto janë të një natyrë tjetër. Ato nuk janë, siç i quajmë socialdemokratët, revizionistët e shërbëtorë të tjerë të borgjezisë kapitaliste, «lëvizje shumë të thella revolucionare marksiste-leniniste», që presin «të piqen situatat» etj. Jo. Vetë borgjezia kapitaliste dhe shërbëtorët e saj nuk lejojnë që të piqen situata të tilla e të ndodhë, siç ndodh aktualisht në vendet arabo-myslimane, ku masat revolucionare ngrihen në luftë dhe krijojnë situata të vështira për imperia-lizmin, feudalizmin dhe borgjezinë kapitaliste e kozmopolite.

Disa thonë se popujt arabë e të vendeve myslimane lëvizin se «janë të varfër»! Po, ata janë të varfër. Por, ata që thonë kështu, duhet të pranojnë se vetë janë borgjezuar, prandaj nuk ngrihen kundër shtypjes e shfrytëzimit, kurse e vërteta është se kudo kapitalizmi shtyp e shfrytëzon barbarisht popujt pa përjashtim.

Thonë, gjithashtu, se në vendet me fe islame, «masat janë prapanike», prandaj vihen lehtë në lëvizje. Kjo do të thotë se pretenduesit e këtij arsytimi, kanë degjeneruar dhe nuk janë për revolucion, sepse në një kohë kur kapitalizmi është në kalbëzim, njerëzit e ndershëm duhet të jenë revolucionarë dhe të ngrihen në luftë kundër kapitalizmit dhe armët që kanë në dorë t'i drejtojnë kundër atij. Por këtu, në Evropë, nuk e shohim një gjë të tillë, përkundrazi shohim të predikohet «teoria» e përshtatjes me situatën ekzistuese.

Debate politike organizohen në të katër anët e vendeve kapitaliste. Në këto vende është bërë e modës që si socialdemokratët, demokristianët, revizionistët e gjithfarëlloj njerëzish të tjerë të flasin për «revolucion» e për veprime gjoja revolucionare dhe në këtë mënyrë secili prej tyre përpiqet me këto slogane të hutojë e të mashtrtojë masat punonjëse. «Të majtët» çirren për «masa revolucionare», por pastaj caktojnë menjëherë kufirin,

«duke shpjeguar» se «jo kudo e në çdo fushë duhen ndër-marrë masa revolucionare», por vetëm «të bëhen disa ndryshime», pra, të jepet një kockë, pikërisht për të mashtruar masat që kërkojnë ndryshime rrënjësore revolucionare, për ta penguar e për ta sabotuar vrullin revolucionar të masave.

Këto situata e fenomene duhet t'i analizojmë edhe me artikuj teorikë apo me forma e më mjete të tjera të propagandës në rrugën marksiste-leniniste, me qëllim që të shpjegojmë thelbin e revoltës e të kryengritjeve të popujve kundër imperializmit, neokolonializmit e sundimtarëve të brendshëm, të shpjegojmë çështjen e besimit akoma në traditat e vjetra fetare etj. Kjo nuk përjashton përkrahjen e lëvizjeve çlirimtare nga ana jonë, sepse të këtilla lëvizje janë vërtetuar edhe para Marksit, siç përmendëm edhe më lart. Të presësh që të zhduket më parë feja, pastaj të bësh revolucionin, nuk është në favor të revolucionit e të popujve.

Në situatat e sotme njerëzit që janë ngritur në revoltë dhe që besojnë te feja, nuk janë më në stadin e ndërgjegjes e të vetëdijes së Spartakut, i cili u ngrit kundër Perandorisë Romake, kundër skllavopronarëve, por janë mbushur me ndjenjat e revoltës kundër shtypjes e shfrytëzimit dhe kundër politikës barbare të imperializmit e të socialimperializmit. Revolta e skllavëve, e udhëhequr nga Spartaku, siç e shpjegojmë Marksit dhe Engelsi, ishte përparimtare, ashtu edhe fillimi i kristianizmit.

Në këto situata shumë të rëndësishme vëmë re se edhe popujt e tjerë të Afrikës janë ngritur, por jo me forcën e me hovin revolucionar të popujve arabë, iranian etj. Ky është një problem tjetër që, gjithashtu, duhet parë për të gjetur shkaqet, përse nuk ngrihen e përse nuk frymëzohen edhe ata në të njëjtën shkallë si popujt që përmenda? Ç'është e vërteta edhe popujt afrikanë janë të shtypur, bile ata janë shumë më të shtypur nga ç'janë

popujt arabë, ai iranian etj. Edhe në Afrikë marksizmi ende nuk ka hyrë si duhet, pastaj edhe atje ekziston influenca e fesë, megjithëse jo në atë shkallë si në vendet myslimane. Në Afrikë duhet punuar që të përhapet më gjerë e më thellë teoria marksiste-leniniste. Atje gjendet një terren akoma më i virgjër, me popuj të shtypur, ku ndjenja e fesë është në një stad akoma foshnjor. Ka popuj në Afrikë që rrojnë më shumë me besimin të fuqia hyjnore e diellit, e hënës, të magjtitë etj., besime këto pagane që nuk janë kristalizuar në një ideologji e në një teologji konkrete, siç është feja myslimane, pa lëre pastaj fenë kristiane, budiste e sektet e tyre. Ndërsa në Afrikë ka një shtypje e shfrytëzimit të egër, lëvizja në këtë zonë të botës është më e ngadalshme. Kjo për arsye se edhe stadi i zhvillimit shoqëror në Afrikë është më i ulët.

Po t'i marrim e t'i shohim këto çështje në unitetin e tyre, do të vëmë re se në stadin aktual të zhvillimit, islamizmi, në përgjithësi, luan një rol aktiv në luftërat çlirimtare e antiimperialiste të popujve myslimanë, ndërsa në vendet evropiane e në disa vende të tjera, ku vepron feja katolike, e cila predikon nënshtrimin, që, siç thuhet në filozofinë kristiane, «po të të qëllonë në një rënfaqe, ktheji atij që të ra edhe faqen tjetër», shikojmë që udhëheqësit e saj mbajnë qëndrim reaksionar dhe përpiqen të pengojnë lëvizjen e masave, revoltën, kryengritjen e tyre për çlirim shoqëror e kombëtar. Në këto vende, natyrisht, është më e madhe edhe forca shtypëse e borgjezisë dhe e kapitalizmit, e socialdemokracisë, e revizionizmit modern, por edhe feja katolike shërben për të shtypur frymën revolucionare të masave, për ta mbajtur gjendjen në amull.

Popujt myslimanë, nga pikëpamja e zhvillimit ekonomik, janë mbajtur prapa; në dekadat e shkuara, si pasojë e pushtimeve kolonialiste e të shfrytëzimit kolonialist e neokolonialist, feja myslimane në këto ve-

nde është shtypur nga feja katolike ose protestante që përfaqësoheshin nga pushtuesit e huaj, gjë që nuk ka kaluar pa pasoja e pa rezistencë, dhe këtu mund të gjejmë dhe një arsye politike e ideologjiko-fetare të revolucionit antiimperialist të popujve myslimanë.

Çështja shtrohet që në të shikojmë tani stadin e zhvillimit të fesë myslimane në krahasim me shekujt e kaluar. Zhvillimi i shoqërisë njerëzore ka ndikuar që besimi fetar mysliman të bëhet gjithnjë e më pak operues, domethënë në të ka depërtuar njëfarë liberalizmi që duket në faktin se besimtari mysliman vërtetëson në fenë islame, por sot ai nuk është më si besimtari i shekujve të mesjetës apo të shekujve të fundit, të 17-s, të 18-s apo të 19-s.

Sot gruaja me çarçaf në vendet myslimane ka po ato ndjenja që kishte para Çlirimit gruaja jonë e mbuluar me çarçaf, siç ndodhte, fjala vjen, në Kavajë, por sigurisht jo plotësisht të një gruaje përparimtare në atë shkallë siç ishte gruaja jonë. Megjithatë ndjenjat e revoltës brenda në shpirtin e saj ekzistojnë dhe bile shprehen deri në atë masë që e lejon opinionin. Gratë iraniane janë angazhuar sot në lëvizjen e gjerë të popullit iranian kundër shahut e imperializmit.

Pra shohim që shtypja fetare ekziston edhe në vendet me popullsi myslimane, por si fe ajo ka bërë njëfarë evolucioni, sidomos në anën e saj të jashtme. Të kuptohemi, feja nuk është zhdukur në këto vende, por sot ka ardhur një kohë në të cilën fryma e revoltës nga njëra anë dhe liberalizimi i fesë nga ana tjetër, i bën njerëzit që besojnë te dogmat islamike të ngrihen kundër atyre që quhen fetarë e kërkojnë të ushtrojnë normat e mëparshme të fesë për t'i shtypur e për t'i mbajtur popujt në mjerim. Pikërisht me këtë lidhet edhe lufta e tyre kundër imperialistëve, të cilët vazhdojnë të quhen të pafë, domethënë armiq të tyre, armiq të fesë së tyre. Këta

popuj e kuptojnë se pushtuesit e huaj janë njerëz të besimeve katolike apo protestante, që kërkojnë t'i shtypin si vende e si fe. Këtë antagonizëm fetar, që ka përbrenda edhe antagonizmin klasor ndaj pushtuesve të huaj, përndimorët e quajnë vetëm luftë fetare ose i vënë epitete të tjera denigruese të padrejta. Kështu i trajtojnë sot ata luftërat çlirimtare të popujve myslimanë, të vendeve arabe e joarabe, në Azi e në Afrikë, bile edhe luftën çlirimtare të popullit irlandez, ku shumica e popullsisë është katolike, kundër pushtuesve të tyre anglezë, që janë protestantë. Në të njëjtën kohë, shfaqje të padrejta shohim edhe te popujt myslimanë që janë ngritur në revoltë. Edhe këta thonë: «Po na shtyp kauri, njerëzit pa din e pa iman, që janë kundër fesë sonë» etj. Kështu çështjen e çlirimit kombëtar ata e bashkojnë me çështjen fetare, pra shtypjen shoqërore dhe ekonomike që u bën imperializmi e shohin si shtypje fetare. Nesër edhe popujt e tjerë myslimanë në këto çështje patjetër do të arrijnë në atë stad zhvillimi që kanë arritur populli algjerian, ai i Sirisë apo i vendeve të tjera.

Këto luftëra çojnë jo vetëm në shtimin e simpatisë për popujt që ngrihen në revoltë, por edhe në bashkimin e tyre, sepse të tërë janë myslimanë. Nëse një popull ngrihet kundër imperializmit dhe krerëve reaksionarë sundues të vendit të vet, të cilët e përdorin fenë për shtypje, kjo kryengritje e shpartallon ndjenjën e fesë edhe tek ata që tani besojnë. Kur një popull ngrihet në kryengritje kundër shtypjes, atëherë tek ai zgjerohet e thellohet ndjenja revolucionare dhe njerëzit arrijnë në një stad që i bën të mendojnë një çikë më mirë për çështjen e fesë. Fshatari i varfër i Iranit deri dje thoshte vetëm «ishalla» dhe me këtë ngushëllohej, po tani e kupton që me «ishalla» nuk fitohet gjë. Përpara kudo te këta popuj thuhej «kështu ka qenë shkruar», por besimtarët tani janë ngritur në masë të bashkuar e dalin nëpër

rrugë me armë në dorë për të kërkuar të drejtat e tyre, lirinë e tyre. Dhe me siguri, kur të kërkojnë që të marrin tokën, fshatarët në këto vende patjetër që do të ndeshen edhe me pasuritë e mëdha të xhamive e të kishave, pra me klerin. Prandaj forcat e errëta të reaksionit bëjnë zhurmë të madhe rreth anës fanatike, rreth çështjes së rivendosjes së perçes së gruas etj., etj., sepse përpiqen ta diskreditojnë revolucionin iranian, edhe pse imperia-lizmi dhe kapitalizmi botëror te feja kanë një mbështetje të madhe, kolosale. Kështu është çështja edhe me Vatikanin, me politikën e kësaj qendre të madhe të obskurantizmit më reaksionar botëror, me mentalitetin dhe me botë-kuptimet e katolikëve. Por revolucioni e shpërndan mjegullën fetare. Kështu do të ngjasë patjetër edhe me popujt arabë, me popujt e tjerë myslimanë që ngrihen në kryengritje dhe me popujt me besime të tjera, domethënë do të ecet drejt zhdukjes, drejt eliminimit të besimeve fetare dhe të udhëheqjes fetare. Ky është një problem i madh.

Këtu është fjala për popujt të tërë që po ngrihen në revoltë në vendet myslimane, qofshin këto arabe ose jo. Në Evropë nuk ka lëvizje të këtilla. Në këtë kontinent veprojnë parti dhe forca socialdemokrate reformiste; numri i partive marksiste-leniniste këtu është ende i vogël, kurse ka parti revizioniste të mëdha, të cilat veprojnë në kundërshtim me interesat dhe me ndjenjat e njerëzve, kanë humbur besimin në popull, mbështetin kapitalizmin, imperializmin dhe socialimperializmin. Popujt myslimanë të vendeve arabe e joarabe nuk kanë besim as tek imperialistët amerikanë, as te socialimperialistët sovjetikë, sepse këta përfaqësojnë fuqi të mëdha që luftojnë t'i shtypin e t'i grabitin; dihet se ata nuk kanë besim, gjithashtu, edhe si myslimanë në besimet fetare të këtyre fuqive.

Si rezultat, kryengritja që po zhvillohet në Iran e në

Afganistan ka e do të ketë rrjedhime në gjithë botën myslimane. Prandaj, po t'i kuptojnë mirë e drejt grupet marksiste-leniniste, shokët tanë në këto vende e të tjera të kësaj zone çështjet që dalin nga ngjarjet në Iran, në Afganistan e në vendet e tjera myslimane, atëherë janë të gjitha mundësitë të bëhet nga ana e tyre shumë punë. Po, natyrisht, atje duhet punuar me kujdes. Fenë nuk ka se si ta zhdukësh me direktiva, me parulla ekstremiste, por as me analiza të padrejta. Ne, për të gjetur të vërtetën, duhet të analizojmë veprimtarinë e këtyre forcave në kushtet konkrete aktuale, sepse thuhet shumë gjëra, të qena e të paqena, siç ndodh edhe me Ajatollah Khomeinin. Ky vërtet është fetar, por pavarësisht nga kjo, duhet bërë analiza e qëndrimeve dhe e veprimtarisë së tij antiimperialiste që dashje pa dashje çon ujë në mullirin e revolucionit.

I gjithë ky zhvillim ngjarjesh është shumë interesant. Këtu, në simpatinë e solidaritetin midis popujve, plekset çështja e fesë me çështjet politike. Dua të them që, në qoftë se udhëheqja e iks vendi, për shembull, do të ngrihet kundër revoltës së popullit iranian, atëherë ajo do të humbasë pozitën politike brenda dhe populli i këtij vendi do të ngrihet kundër, do ta akuzojë qeverinë për lidhje me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me «kaurët», se këta janë kundër myslimanizmit. Ndodh kështu sepse për ta myslimanizmi është përparimtar, ndërsa Shtetet e Bashkuara përfaqësojnë atë forcë që shtyp popujt jo vetëm nga ana shoqërore, por edhe nga ana shpirtërore. Prandaj shohim se, në përgjithësi, asnjë prej këtyre vendeve nuk po del hapur për të dënuar ngjarjet në Iran.

Pengesa tjetër që nxjerr reaksioni për të sabotuar revolucionin e popullit të Iranit, është ajo e futjes së grindjeve dhe ngritja e çështjes së pakicave kombëtare. Për të dobësuar këtë kryengritje të madhe antiimperialiste dhe «promyslimane» të popullit iranian, reaksioni

nxit ndjenjat nacionale në Azerbajxhan, nxit kurdët etj., etj. Çështja e nxitjes së ndjenjave nacionale ka qenë dhe është një armë në duart e imperializmit dhe të socialimperializmit, të gjithë reaksionit për të sabotuar luftërat nacionalçlirimtare, luftërat antiimperialiste. Prandaj është e drejtë teza e Partisë sonë, sipas së cilës, aktualisht, çështja e zgjidhjes së problemeve të pakicave kombëtare nuk është një problem kryesor. Tani kurdi, taxhiku, azerbajxhanasi e të tjerë duhet të ngrihen në luftë kundër imperializmit dhe shërbëtorëve të tij dhe, po të jetë e mundur, të ngrihen sipas mësimeve dhe frymës marksiste-leniniste. Edhe kurdët, taxhikët e azerbajxhanasit që jetojnë në Bashkimin Sovjetik, që aktualisht janë të shtypur e të robëruar, duhet të ngrihen, në radhë të parë, kundër socialimperializmit rus.

Kështu paraqitet, në vija të përgjithshme, situata në këto rajone dhe këto janë disa nga problemet që dalin. Me siguri ngjarjet do të zhvillohen më tej. Detyra jonë është që këto situata dhe këto ngjarje, që po zhvillohen në botën myslimane, t'i analizojmë në bazë të teorisë marksiste-leniniste dhe të përcaktojmë qëndrimet tona në mënyrë që të ndihmojmë në kuptimin e drejtë të tyre dhe të japim kështu kontributin tonë në zhvillimin me sukses të lëvizjes revolucionare të popujve.

E MËRKURË  
13 SHKURT 1980

## PANORAMË E GJENDJES NDËRKOMBËTARE

Josip Broz Titoja është duke vdekur. Siç dihet, para pak ditësh atij i prenë këmbën, pse iu rrezikua nga gangrena. Me këtë operacion përkohësisht u duk sikur e kapërceu lumin, por operacioni i shkaktoi dobësimin e zemrës, të veshkave, të sistemit të tretjes etj.

Lëvizjes komuniste ndërkombëtare Titoja i bëri shumë dëm. Në historinë e kësaj lëvizjeje ai do të figurojë si një nga renegatët dhe tradhtarët kryesorë të kohëve tona. Ai u përpoq dhe deri diku i ndihmoi revizionistët sovjetikë që të forconin punën e tyre sabotuese, të cilën e kishin filluar me kohë Hrushovi me shokët e tij, dhe të punonin nën rrogëz për goditjen e tmerrshme që i dhanë socializmit në Bashkimin Sovjetik e në arenën ndërkombëtare.

Titoja dhe Kardeli, pas një sërë peripecish, të ndihmuar fuqimisht nga imperializmi amerikan dhe imperia- lizmi botëror, ndërtuan sistemin e tyre kapitalist që e quajtën vetadministrimi jugosllav. Kjo çështje njihet dhe s'është nevoja të zgjatemi, por gjatë sundimit të titizmit në Jugosllavi, kapitalet amerikane dhe ato të Evropës Perëndimore, në radhë të parë, pastaj edhe ato sovjetike kanë zënë vende të rëndësishme kyç në ekonominë jugosllave. Sistemi i vetadministrimit s'është gjë tjetër veçse një mbulesë e përciptë, e hollë e këtij sundimi ndërkom-

bëtar në Jugosllavi të kapitalit financiar amerikan, gjermanoperëndimor, sovjetik etj., etj. Këto kapitale brenda ekonomisë jugosllave kanë zonat e tyre të shfrytëzimit, dhe, si rrjedhim, kanë edhe influencën e tyre mbi njerëzit që drejtojnë Republikën Federative Socialiste të Jugosllavisë.

Përveç kësaj cipe të hollë që ka mbuluar formën e vërtetë të rendit kapitalist në Jugosllavi, Titoja e Kardeli me shokët e tyre kanë krijuar, gjithashtu, njëfarë udhëheqjeje «kolegjiale», e cila gjoja drejton, në mënyrë kolegjiale, edhe tash që Titoja është i sëmurë rëndë, por që do të drejtojë më konkretisht pas vdekjes së tij. Pra, sipas teorisë dhe punës konkrete organizative që kanë shtjelluar Titoja me Kardelin, kjo udhëheqje e Federatës «është siguruar» edhe pas vdekjes së Titos. Unë mendoj se nuk mund të ketë udhëheqje kolegjiale në një vend kapitalist. Në vendet kapitaliste ekziston sundimi i kapitalit financiar dhe i trusteve të mëdha kombëtare ose shumëkombëshe. Një gjë e tillë do të ndodhë, bile ajo ekziston që tani edhe në Jugosllavi.

Përveç kësaj ky vend është një Federatë e përbërë nga shumë kombe, të cilat, pas Traktatit të Versajës dhe Luftës së Dytë Botërore, hiqen sikur janë në harmoni e në unitet, po realiteti është ndryshe, ai është krejt i kundërt. Këto kombe kanë grindje të thella në mes tyre. Republikat e Federatës Jugosllave ndodhen midis kontraktash të mëdha politike, ideologjike dhe ekonomike. Gjatë sundimit Tito-Kardel-Rankoviç në sipërfaqe dukej se ekzistonte «bashkim-vëllazërimi». Të tre këta përpiqeshin, sa u ishte e mundur, dhe deri në njëfarë shkalle ia arritën, që për sy e faqe të dukej se Federata ekzistonte, bile se ajo drejtonte, pavarësisht pse kishin krijuar sistemin e vetadministrimit, por, në realitet, dihet se në mes serbëve dhe kroatëve, në mes sllovenëve dhe serbëve, në mes shqiptarëve dhe serbëve, në mes maqedo-

nasve, shqiptarëve dhe serbëve e kështu me radhë, kanë ekzistuar dhe ekzistojnë kontradikta të mëdha.

Sistemi i vetadministrimit, këto kontradikta jo vetëm nuk i ka shuar, por i ka shtuar. Në udhëheqjen kolegjiale secili klan manovron e vepron në interesin e kombit që përfaqëson e në dëm të kombit të klanit tjetër. Kështu serbët kanë punuar që të dominonin në Federatë dhe për këtë shkak janë goditur nga kroatët e sllovenët. Kroatët, nga ana e tyre, kanë luftuar të dominonin mbi serbët, por edhe këta kanë dështuar, se Serbia është një republikë me peshë të madhe politike, ekonomike dhe ushtarake.

Ne shohim se këto kontradikta janë rrjedhim i pa-barazisë së zhvillimit midis republikave, shohim se vet-administrimi, që nuk është veçse një pasqyrim i regjimit kapitalist të bankave dhe të kapitalit botëror, disa republika i ka favorizuar, disa të tjera i ka varfëruar. Në disa republika janë bërë investime të mëdha, në disa zhvillimi i ekonomisë është lënë krejt pas dore. Në Slloveni, për shembull, të ardhurat janë të mëdha, se janë bërë shumë investime, në Kroaci po ashtu, në Serbi më pak, ndërsa në Kosovë s'është bërë asgjë, në Maqedoni e në Mal të Zi po e njëjta gjë.

Kështu që sot njerëzit presin ç'mund të ngjasë në Jugosllavi pas vdekjes së Titos. Vendet kapitaliste trumbetojnë se Bashkimi Sovjetik do ta pushtojë Jugosllavinë dhe këtë zhurmë e këtë parashikim i kanë ngritur deri në atë shkallë sa që në të vërtetë i thonë Bashkimit Sovjetik ta bëjë një gjë të tillë. Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të tjerëve kjo gjë u shërben që ta trembin Jugosllavinë dhe ta bëjnë që pas vdekjes së Titos (në të vërtetë nën sundimin e tij Jugosllavia *de facto* varej më shumë nga kapitali perëndimor) të jetë nën sjetullën e plotë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të vendeve kapitaliste të Perëndimit. Për këtë gjë Karteri, në

një konferencë shtypi që mbajti dy-tri ditë përpara, midis të tjerave, deklaroi se ka biseduar me udhëheqësit e tjerë të vendeve aleate të Shteteve të Bashkuara të Amerikës për fatin e Jugosllavisë pas Titos dhe se, në qoftë se ajo do të kërkojë ndihmë, në rast të një sulmi sovjetik, kërkesa e saj do të studiohet me seriozitetin më të madh.

Mendimi im është se në këto situata ndërkombëtare Bashkimi Sovjetik nuk do ta sulmojë Jugosllavinë me ushtri. Ai do t'i bëjë Jugosllavisë shantazhe të shumëllojta dhe do ta frikësojë, por kufijtë e saj nuk do të cenohen nga trupat e Traktatit të Varshavës. Në periudhën e parë Bashkimi Sovjetik do të bëjë të gjitha përpjekjet që influenca e tij politike dhe ekonomike në Jugosllavi të shtohet nëpërmjet kredive dhe qëndrimeve politike gjoja dashamirëse. Nga ana tjetër, Bashkimi Sovjetik do të bëjë të gjitha përpjekjet që ta dobësojë klanin pro-perëndimor, proamerikan. Këtë gjë ai do ta bëjë me çdo mjet duke përdorur edhe subversionin, duke përdorur, gjithashtu, edhe elementët e lëkundshëm ose prorusë. A ekzistojnë në Jugosllavi elementë të tillë, shtresa të tilla? Nuk mund të themi se nuk ekzistojnë, por nuk është reale të mendohet se influenca e Bashkimit Sovjetik mbi popujt e Jugosllavisë është ashtu siç ishte në kohën e knjazëve, të Karagjorgjeviçëve dhe të Obranoviçëve.

Jugosllavët nuk e pranojnë pansllavizmin, sidomos dominimin rus. Miq të Bashkimit Sovjetik mund të ketë si në klanin serb, ashtu edhe në atë kroat, por në bazë të parimit ti në shtëpinë tënde, unë në shtëpinë time. I kë-tillë është mentaliteti i serbëve, i kroatëve, i sllovenëve, i shqiptarëve që jetojnë në trojet e tyre në Jugosllavi. Për maqedonasit nuk mund ta them këtë. Pra në këto forma do të përpiqet Bashkimi Sovjetik të shtojë kredinë e vet në Jugosllavi. Këto situata udhëheqja e ashtuquajtur kolegjiale jugosllave pas Titos, medoemos do t'i ketë parasysh, sepse e njeh situatën në vend më mirë nga ne

dhe shumë më mirë nga perëndimorët e nga rusët. Duhet thënë se titistët armiq i kemi pasur e armiq i kemi, por budallenj ata nuk kanë qenë dhe nuk janë. Serbët, kroatët, sllovenët dhe malazestë, për të mos folur për shqiptarët, pse këta janë vëllezërit tanë, nuk janë aq leshko sa të pranojnë dënglat e Brezhnjev it e të Suslovit ose ligjet e Traktatit të Varshavës, të lejojnë trupat e Zhivkovit ose propagandën e tij të depërtojnë lehtësisht në Jugosllavi e veçanërisht në Maqedoni.

Prandaj udhëheqja «kolegjiale» jugosllave pas vdekjes së Titos do të ketë si objektiv kryesor ruajtjen e Federatës dhe uniteti do të konsistojë në moslejimin e cenimit të kufijve të Jugosllavisë dhe ndjekjen e politikës së «mosangazhimit» jashtë dhe të vetadministrimit brenda.

«Mosangazhimi» jashtë do të theksohet vazhdimisht nga udhëheqja e pas Titos. Ajo, si deri tani, do të bëjë akrobaci në këtë drejtim, pse në fund të fundit nuk ishte vetëm Titoja ai që i bënte këto akrobaci, por i tërë klani i tij që luan «vallen mbi litar» sa nga Lindja, nga Perëndimi, domethënë që shtrinte të dy duart sa nga njëra anë, aq edhe nga ana tjetër. Udhëheqja «kolegjiale» do të shfrytëzojë me mjeshtëri kontradiktat që ekzistojnë në mes Lindjes dhe Perëndimit, në mes përpjekjeve të njërit dhe të tjetrit jo vetëm kundrejt Jugosllavisë, por në të gjithë skakierën ndërkombëtare dhe me një politikë të tillë pehllivanësh, kjo udhëheqje ka ndër mend të ruajë pavarësinë e Federatës Jugosllave.

Natyrisht kjo pavarësi do të mbrohet prej saj nëpërmjet ushtrisë dhe UDB-së, të cilat do të jenë arma e sigurt e klanit më të fuqishëm që do të dominojë në këtë udhëheqje gjoja kolegjiale, dhe ushtria në Jugosllavi do të ketë fjalën e parë dhe të fundit. Të gjitha veprimet politike, ekonomike, ideologjike do të mbështeten në forcën e armëve. Ushtria, pra, në të ardhmen do të luajë një

rol shumë të rëndësishëm në Federatën Jugosllave. Me fjalë të tjera, pa vendosur *de jure* dhe pa e shpallur publikisht, në Jugosllavi do të ketë një diktaturë ushtarake të klanit më të fuqishëm në pushtet, i cili do të vazhdojë të quhet vetadministrim jugosllav dhe Federata një «federatë socialiste» me një politikë «të paangazhuar», jashtë blloqeve.

Si do të zhvillohen situatat brenda, kjo është një çështje me rëndësi të madhe, që do të influencojë në qenien të fortë ose në dobësimin e Federatës, do të favorizojë shkaqet e ndërhyrjes dhe të rritjes së influencës të imperializmit amerikan dhe të kapitalizmit perëndimor apo të revizionizmit sovjetik dhe të influencës së Traktatit të Varshavës.

Këto kontradikta patjetër do t'i thellojë sistemi i vetadministrimit, se Serbia do të përpiqet të dominojë në Federatë, kroatët po ashtu dhe, kur ekzistojnë kontradikta në mes këtyre dy republikave më të fuqishme, është e natyrshme që rreth tyre të krijohen klanet mbështetëse, sllovenët do të mbështetin kroatët, mundet që edhe Vojvodina të mbështetë Kroacinë, kurse Mali i Zi mund dhe duhet të ketë tendenca të bashkohet me Serbinë; shqiptarët, natyrisht, do të luftojnë për llogari të tyre, për çlirimin e tyre të vërtetë, kurse Maqedonia do të influencohet shumë nga propaganda sovjeto-bullgare dhe do të ketë tendenca të mbështetë klanin serb.

Me këto të çara të theksuara aktuale dhe më të theksuara në të ardhmen, do të llogaritin dhe do të luajnë lojërat e tyre të fshehta e të hapëta si sovjetikët, ashtu edhe perëndimorët. Prandaj s'ka se si që një situatë e tillë të mos influencojë ose në dobësimin e Federatës, ose në forcimin e diktaturës ushtarake, në dhënien e goditjeve të forta kundër atij klani që, në stadin e sotëm ndodhet në pozita inferiore, por do të kërkojë të marrë epërsinë.

A do të shkojë një gjendje e tillë deri në një luftë të brendshme? Mund edhe të shkojë, por pas një periudhe disavjeçare, pse kryengritjet ose orvatjet për kryengritje menjëherë pas vdekjes së Titos do të goditen ashpërsisht nga udhëheqja gjoja kolegjiale dhe nga ushtria nën pretekstin e mbrojtjes së Federatës dhe të kufijve të saj. Çdo lëvizje në këtë drejtim ata do ta konsiderojnë si një veprim subversiv të nxitur nga socialimperialistët dhe nga imperialistët, pra do t'i zënë në gojë që të dy, me qëllim që të ruajnë balancën e qëndrimeve të tyre politike «të paangazhuara».

Në këto situata neve na vihet si detyrë të ndjekim me vigjilencë zhvillimin e ngjarjeve në Jugosllavi pas Titos derisa atje të stabilizohet situata. Në periudhën e parë ne duhet të vërejmë tendencat centrifugale dhe koncentrike që do të zhvillohen në udhëheqjen kryesore të Federatës, domethënë qëndrimet e grupimeve të ndryshme të kombësive, të republikave dhe të krahinave të Jugosllavisë.

Unë mendoj se gjatë kësaj periudhe mbrojtja jonë duhet të jetë në gatishmëri, pse situatat që do të krijohen mund të sjellin çdo gjë. Por mendoj se hëpërhë që në fillim nuk mund të krijohet një situatë që të vështirësojë gjendjen në Jugosllavi, e si pasojë edhe në Shqipëri. Sidoqoftë në kufirin me Jugosllavinë ne duhet të qëndrojmë të zgjuar, domethënë vigjilentë, pse mundet që në Kosovë disa shqiptarë që nuk e kuptojnë mirë zhvillimin e ngjarjeve të gabojnë në vlerësimin e tyre, ose vetë provokatorë serbomëdhenj të krijojnë brenda në krahinë situata të vështira e kështu t'u japin armë klaneve serbomëdha dhe kroatomëdha për t'i armiqësuar popujt e Jugosllavisë kundër shqiptarëve.

Në Kosovë, pra, mund të ketë edhe disa elementë të pafrenuar në «entuziazmin e tyre», të cilët të mendojnë se ka ardhur koha për veprime gjoja patriotike, mirëpo

veprime të tilla do të goditen nga udhëheqja e Federatës dhe s'është e pamundur që elementë të tillë të kërkojnë pastaj të vijnë në Shqipëri. Pikërisht këtu qëndron provokacioni i padëshirueshëm që mund të na shkaktojë vështirësi, jo ndonjë vështirësi të madhe, por situata të papëlqyera e të papajtueshme me qëndrimet tona të sotme, të cilat marrin parasysh rrezikun e madh kryesor që mund t'i vijë vendit tonë nga një sulm eventual kundër Jugosllavisë nga ana e forcave të Traktatit të Varshavës ose të ndonjë fuqie tjetër agresive. Në rast se Traktati i Varshavës vepron kundër Jugosllavisë me armë, atëherë shtrohet çështja çfarë do të bëjë NATO-ja. Do ta shikojë ajo një sulm të tillë ose luftën që në një rast të tillë do të zhvillohet midis sovjetikëve e jugosllavëve, duke lidhur duart apo duke bërë protesta me gojë e me shkrim kundër ndërhyrjes sovjetike në Jugosllavi, apo do të ndërhyjë edhe ajo?

Qëndrimin tonë ne e kemi deklaruar. Ne do të luftojmë së toku me jugosllavët, në rast se ata sulmohen nga cilado anë që të jetë. Pra për politikën tonë të drejtë ka rëndësi që Jugosllavia të qëndrojë kështu siç reklamohet, domethënë se gjoja është e paangazhuar, as nga Lindja, as nga Perëndimi. Kjo sepse ne e dimë se qëndrimi aktual i Jugosllavisë është dhe anon nga imperializmi amerikan dhe nga vendet perëndimore, por ajo e zgjat dorën edhe nga Lindja.

Do ta lënë Jugosllavinë të qëndrojë në këto pozita «të paangazhuara»? Këtë do ta shohim. Por me siguri të tërë do të manovrojnë. Vetë jugosllavët, në radhë të parë, do të përpiqen të mbajnë ekuilibrin në kontradiktat e brendshme dhe në arenën ndërkombëtare në mes NATO-s dhe Traktatit të Varshavës. Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Perëndimi kapitalist do ta ndihmojnë Jugosllavinë që të qëndrojë në këto pozita pseudoasnjëse, Bashkimi Sovjetik me fjalë do të kërkojë që Jugosllavia

të qëndrojnë në këto pozita, por me fakte do të përpiqet që të organizojë subversionin serbomadh dhe ustashtë kroatë. Me siguri një gjë të tillë do të bëjnë edhe perëndimorët. Në lidhje me të ardhmen e Jugosllavisë ekzistojnë, pra, kontradikta të jashtme dhe të brendshme, gjë të cilën ne lypset ta vëzhgojmë dhe të mbajmë qëndrime të përshtatshme me sigurimin e vendit tonë, me forcimin ekonomik dhe mbrojtjen e Republikës sonë, me forcimin e pozitave tona ndërkombëtare nëpërmjet një politike të zgjuar, të drejtë e të vendosur. Ne duhet të demaskojmë jo vetëm ato fenomene e zhvillime që do të kenë lidhje e do të influencojnë për ndryshime në Jugosllavi, në Greqi e gjetkë në Ballkan, por të themi fjalën tonë edhe për problemet e ndryshme aktuale ndërkombëtare, pse, siç po zhvillohen gjërat, ato marrin një rëndësi të jashtëzakonshme dhe po bëhen kërcënuese.

Edhe më parë situatat kanë qenë kërcënuese, por këto kërcënime dhe parapërgatitje të luftërave lokale apo të një lufte të përgjithshme po bëhen më të përcaktuara pas ngjarjeve në Iran dhe pas agresionit sovjetik kundër Afganistanit, domethënë pas pushtimit me tanke dhe me ushtri të këtij vendi nga ana e Bashkimit Sovjetik. Siç e kam trajtuar edhe herë të tjera, Lindja e Mesme, pellgu i madh i naftës, sot është bërë një vatër zjarri në botë, është ajo pjesë e globit tokësor ku përplasen e ku përleshën interesat grabitqarë politiko-ekonomiko-strategjikë të fuqive të mëdha e në radhë të parë ato të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Bashkimit Sovjetik, pastaj edhe ato të Kinës e të vendeve kapitaliste të Evropës Perëndimore, të Japonisë etj. Këtu, në këtë pellg, po zhvillohen edhe kryengritjet e popujve, të cilët rrojnë nën shfrytëzimin e shtypjen e dyfishtë të shoqërive të mëdha shumëkombëshe të naftës dhe të klikave, të mbretërve, të sheikëve, të feudalëve, të emirëve dhe të borgjezisë kapitaliste vendase.

Problemi i energjetikës në botë, që lidhet edhe me prodhimin dhe me shpërndarjen e naftës, që zë vendin e parë për sa i përket energjisë elektrike, është bërë shumë i mprehtë. Kjo ka shkaktuar thellimin e madh e të mëtejshëm të krizës së përgjithshme ekonomike botërore.

Rrëzimi i shahut, natyrisht, krijoi probleme të mëdha brenda dhe jashtë Iranit. Ana pozitive e kryengritjes së popullit iranian, pavarësisht se kush e udhëheq këtë kryengritje, është se çoi në rrëzimin e shahut, shërbëtor i imperializmit amerikan, dhe rrezikoi akoma më tej furnizimin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës me naftë. Përveç kësaj, Shtetet e Bashkuara pësuan edhe një goditje tjetër të madhe politike, pse populli e studentët iranianë sulmuan dhe pushtuan ambasadën amerikane në Teheran, mbajnë akoma rob gjithë personelin e kësaj ambassade dhe kanë shtënë në dorë të gjitha dokumentet e ambasadës që vërtetojnë veprimet kriminale të CIA-s dhe të shahut.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës nga ngjarjet në Iran u përpoqën të shpëtonin pa plagë, qofshin ato ekonomike apo politike, prandaj kërcënuan me sulm të armatosur, dërguan dhe po mbajnë në afërsitë e Gjirit Persik dhe në Oqeanin Indian flotën e tyre luftarake. Presidenti Karter shpalli një numër masash ekonomike e masa të tjera që do të merrte si mjete presioni kundër Iranit. Në të vërtetë këto masa nuk qe e mundur të viheshin në zbatim dhe të kishin efektin e dëshiruar për autorët e tyre, por ato krijuan shkaqet që priste Bashkimi Sovjetik, i përgatitur me kohë për të ndërhyrë në Afganistan, ku kukullat që ai kishte sjellë në fuqi po viheshin në rrezik nga kryengritja «popullore» islamike. Them «popullore», sepse në të vërtetë populli afgan është ngritur kundër kukullave sovjetike, por lëvizja udhëhiqet nga kinezët, nga amerikanët, nga pakistanezët. Pikërisht nga kjo situatë e turbullt dhe nga kërcënimet e Karterit

kundrejt Iranit, siç thashë, përfituan sovjetikët për të futur tanket e veta në Afganistan.

Natyrisht ky agresion e ky pushtim krijuan në botë një situatë të rrezikshme dhe e bënë Lindjen e Mesme një zonë shumë delikate ku superfuqitë u vunë afër e afër e në gjendjen e një lufte të ftohtë, e cila në çdo moment rrezikon të kthehet në një luftë të nxehtë.

Sidoqoftë imperializmi amerikan, pas veprimit të hapët agresiv të Bashkimit Sovjetik në Afganistan, i ka ulur ca pendët kundër Iranit, por kjo nuk do të thotë se ka hequr dorë nga manovrat dhe komplotet e brendshme, as nuk përjashton përpjekjet për të arritur me udhëheqjen aktuale iraniane disa kompromise, me qëllim që të evitohet zjarrin e luftës në pellgun e naftës. Megjithatë Shtetet e Bashkuara të Amerikës mbajnë luftanijet dhe kanë rritur numrin e forcave të këmbësorisë detare në këtë pellg, po forcojnë bazat ushtarake që kanë në Gjirin Persik, siç janë ato në Arabinë Saudite, në Emiratet e Bashkuara, në Oman dhe përpiqen të krijojnë baza të tjera në Somali, në Eritre dhe në Jemenin e Veriut për të kundërbalancuar pikat strategjike të rëndësishme që ka zënë socialimperializmi sovjetik në Jemenin e Jugut, në Etiopi e sidomos në Afganistan.

Në Afganistan sovjetikët gjetën rezistencë. Qeveritarët amerikanë e shfrytëzuan këtë në mënyrë të hapët, u morën vesh me udhëheqjen reaksionare të Pakistanit dhe deklaruan se do t'i japin, dhe i dhanë, ndihma ekonomike dhe ushtarake Pakistanit për t'u mbrojtur nga një sulm eventual sovjetik dhe për të financuar luftën guerile të afganëve.

Siç dihet në Islamabad u mbajt edhe mbledhja e vendeve myslimane. Atje u vendos që të gjithë popujt myslimanë ta ndihmojnë popullin afgan dhe të ashtuquajturin komitet që brenda në Afganistan drejton luf-

tën kundër sovjetikëve. Në këto veprime e manovrime, subversive dhe të hapëta, merr pjesë edhe Kina, e cila ka deklaruar se ndihmon refugjatët afganë në Pakistan me armë e me municione, u jep edhe ndihma ekonomike. Pra mund të themi se rreth kufijve të Afganistanit, brenda të cilit janë vendosur forcat sovjetike, ka lindur një konfrontim i ri: nga njëra anë është ushtria sovjetike që lufton kundër kryengritësve afganë, nga ana tjetër janë Pakistani e Kina dhe pas tyre Shtetet e Bashkuara të Amerikës që ndihmojnë kryengritësit. Pra në këtë zonë ekziston një ndeshje lokale e hapët midis sovjetikëve dhe afganëve dhe e maskuar midis sovjetikëve e amerikanëve në prapaskenë dhe zyrtarëve aktualë afganë e kinezëve po kështu në prapaskenë.

Në vendet e tjera të Lindjes së Mesme aktualisht ka, si me thënë, njëfarë statukuoje, në të cilën në të vërtetë vihet re një përpëlitje në pozitat e shteteve të ndryshme të vendeve të këtij pellgu në mbrojtje të revolucionit iranian e të popullit afgan, vihen re përpjekje për një lidhje më të hapur të disave me Bashkimin Sovjetik dhe të disa të tjerëve me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Me fjalë të tjera aleatët e Uashingtonit në këtë pellg të naftës përpiqen të konsolidojnë miqësinë e tyre në radhë të parë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe, nga ana tjetër, ta çojnë Iranin e Khomeinit në një ujdi me imperializmin amerikan. Sovjetikët, nga ana tjetër, përpiqen që Sirinë e Irakun të mos i lënë pas dore e të bëhen miq të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, por të qëndrojnë «miq e dashamirës» të Bashkimit Sovjetik.

Kështu gjendja në botën arabe vazhdon të jetë ajo e mëparshme, me një ndryshim që Egjipti dhe Izraeli vazhdojnë konsolidimin e aleancës dhe të miqësisë së tyre nën ombrellën amerikane, vazhdojnë ta ndjekin me vëmendje dhe me armiqtësi lëvizjen popullore në Iran,

vazhdojnë të gërthasin dhe të nxitin Shtetet e Bashkuara të Amerikës që të marrin ndaj Bashkimit Sovjetik masa akoma më shtrënguese nga ato të mosvajtjes në lojërat olimpike etj. Shohim, gjithashtu, se në Tunizinë e fjetur ka filluar ndërhyrja nga ana e Libisë së Kadafit, i cili dërgoi në qytetin Gafsa komandot e tij, bëri atje një katrahurë, e cila, natyrisht, u shtyp, por në arenën e kësaj zone solli një faktor tjetër, faktorin francez. Franca, në fakt, i dërgoi ndihmë ushtarake Tunizisë. Pra po duket akoma më qartë se Franca po përgatitet ushtarakisht për të mbrojtur shtetet frankofone të ashtuquajtura të pavarura dhe sovraane, ku kapitali francez ka interesa të mëdhenj shfrytëzues. Pikërisht ajo e bën Francën të mos angazhohet në konfliktin amerikano-sovjetik dhe të mbajë qëndrime politike të kundërta me propozimet e Karterit si, për shembull, me propozimin për të mos shkuar në lojërat olimpike dhe me propozimin tjetër me shumë rëndësi për thirrjen e një mbledhjeje të ministrave të Jashtëm të vendeve të Evropës Perëndimore dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës për të diskutuar agresionin sovjetik kundër Afganistanit dhe masat e propozuara nga Karteri. Edhe Gjermania Perëndimore nuk është bashkuar plotësisht me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në këtë çështje.

Pra ne shohim se në mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Francës e Gjermanisë ekzistojnë kontradikta për probleme të mëdha ndërkombëtare. Këto kontradikta vijnë për arsye se këto dy vende kapitaliste evropiane të zhvilluara me një industri të madhe kanë nevojë për naftën e Iranit dhe për naftën e vendeve anëtare të OPEK-ut, domethënë të vendeve të tjera të Lindjes së Mesme, të disa vendeve afrikane e të Venezuelës. Pra nuk dëshirojnë të futen në ingranazhin e turbullt të interesave amerikanë, por dëshirojnë të qëndrojnë të veçuara nga veprimet e administratës së Karterit, me fjalë

të tjera nuk duan të bëjnë lojën e CIA-s. Shohim, pra, se këto dy vende, Franca dhe Gjermania Perëndimore, për të mbrojtur interesat e tyre jetikë në çështjen e naftës, kërkojnë jo acarimin e situatave, por vazhdimin e «detantës» në mes Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Prandaj si Parisi, ashtu edhe Boni e dënuan hyrjen e forcave ushtarake sovjetike në Afganistan, por me zë të ulët, gjë që solli një kontradiktë në mes politikës amerikane dhe asaj të këtyre dy shteteve. Nga vendet e Evropës Perëndimore vetëm Anglia po tregohet një skifter më agresiv. Megjithëkëtë dhe ajo prapëseprapë, duke ndjekur Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nuk harron të bëjë, ose të vazhdojë të bëjë politikën e saj të zigaresë, të peshojë dhe nga Perëndimi dhe nga Lindja, të ketë një sy edhe në Evropë, edhe në Amerikë, edhe në Bashkimin Sovjetik, edhe në Evropën Lindore.

Për sa u përket vendeve të Evropës Lindore, satelite të Bashkimit Sovjetik, ato u detyrohen vendeve perëndimore miliarda dollarë. Kjo bën që kapitalistët perëndimorë, që kanë në këto anë interes të madh, të mos i prishin punët me Bashkimin Sovjetik dhe me satelitët e tij. Pra fuqitë perëndimore kanë burime tregjesh në këto vende, bëjnë investime dhe prandaj dëshirojnë dhe punojnë që në mes tyre dhe Bashkimit Sovjetik të evitohet një acarim i mëtejshëm i marrëdhënieve ashtu siç po zhvillohet në mes Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Politika e vendit tonë kundrejt të gjitha këtyre ngjarjeve dhe qëndrimeve politike në shkallë botërore është e drejtë. Ajo i analizon situatat dhe mban qëndrim në bazë të konkluzioneve që ne nxjerrim nga zhvillimi i ngjarjeve. Fakt është që qëndrimet tona politike, të shprehura në artikujt e në librat tanë, gjejnë jehonë të madhe në botë, pëlqehen dhe aprovohen. Diplomatië gati

nga të gjitha kontinentet, me të cilët diplomatët tanë kanë kontakte, e afirmojnë këtë aprovim të politikës sonë duke u shprehur me fjalë të mira e duke thënë se pavarësisht pse pikëpamjet tuaja (domethënë tonat) ideologjike janë në kundërshtim me pikëpamjet ideologjike tonat (domethënë të tyre), ne aprovojmë qëndrimet tuaja. E gjithë kjo për vendin tonë ka krijuar një situatë të favorshme në gjirin e masave të gjera të popujve ku arrin zëri i radios sonë dhe lexohen shtypi dhe literatura jonë.

Qëndrimet tona politike gjejnë po ashtu jehonë, sipas rastit e sipas koniunkturave, edhe në shumë qeveri borgjeze. Pse e them këtë? Sepse kur ne sulmojmë socialimperializmin sovjetik për aventurat e tij gjakatare, kur ne sulmojmë imperializmin amerikan për veprimet e tij agresive, ky qëndrim ynë i drejtë aprovohet edhe nga qeveritarët e shumë shteteve që bëjnë pjesë në bllokun e NATO-s ose të vendeve të tjera të Azisë, të Afrikës dhe të Amerikës Latine.

Ne konstatojmë se veçanërisht në Greqi, qoftë në qarqet qeveritare, qoftë në popull, midis intelektualëve dhe në opinionin e partive të ndryshme, politika jonë ka një hov të madh pozitiv. Gati të gjitha gazetatat greke nuk lënë pa e vënë në dukje, bile me një bujë të jashtëzakonshme, asnjë eveniment politik, kulturor ose ideologjik të Partisë dhe vendit tonë, gjë kjo që ka krijuar një opinion shumë të favorshëm për vendin dhe për Qeverinë tonë në Greqi.

Qëndrimet tona dashamirëse për Greqinë, të deklaruara haptazi se asaj kurrë nuk do t'i vijë e keqja nga vendi ynë, bile do të ndihmohet në qoftë se i ngjet ndonjë fatkeqësi, nga ndonjë agresion nga çdo anë që të jetë, ka bërë që politika jonë të pëlqehet nga populli grek dhe të lavdërohet.

E njëjta gjë ngjet edhe në Turqi. Opinioni përparim-

tar turk dhe Partia Marksiste-Leniniste Turke, bëjnë një propagandë të madhe e të theksuar në favor të Shqipërisë. Edhe atje gati të gjitha gazetatat shkruajnë pozitivisht për vendin tonë, zyrtarët turq, në bisedime me shokët e ambasadës sonë, flasin me simpati, bile shumë herë edhe me admirim për politikën e pavarur të shtetit tonë.

Tani në Turqi ka ardhur në fuqi Demireli, një grup ky më i djathtë se ai i Eçevitit dhe nga raportet e ambasadës sonë del se aktualisht po merren masa ndëshkimore kundër elementëve përparimtarë e të majtë. Natyrisht këto masa do të prekin edhe propagandën e favorshme që bëhet për vendin tonë nga komunistët marksistë-leninistë dhe nga elementët përparimtarë, por mund të themi se masa të tilla akoma nuk po duken ndaj politikës së drejtë të Partisë e të Qeverisë sonë.

Kurse Italia si kurdoherë mbetet një vend që e ka shikuar Shqipërinë socialiste me smirë armiqësore dhe zor që të shkeputet nga pozitat e saj të vjetra politike dhe ideologjike kundër vendit tonë.

Në Itali situata është jashtëzakonisht e turbullt, terrorizmi po përhapet në shkallë të gjerë dhe po parapërgatit ardhjen në fuqi të fashizmit. Partia fashiste italiane, që mban emrin «Movimento sociale italiano, destra nazionale» ka propozuar që Ministrinë e Brendshme ta marrin ushtarakët dhe të vendoset dënimi me vdekje. Ky është hapi tjetër që kërkon të bëjë reaksioni italian drejt vendosjes së fashizmit.

Sidoqoftë pushteti aktual në Itali është në një kaos të vazhdueshëm dhe nën presionin e një çorientimi të madh politik, të një degjenerimi moral-politik, nën presionin e grabitjeve të mëdha dhe të terrorizmit të paparë ndonjëherë në vendet kapitaliste. Me Italinë ne vazhdojmë të kemi marrëdhënie tregtare dhe mund të themi se ato shtohen. Italianët janë të interesuar të blejnë nga ne mallra që kanë nevojë dhe të na shesin mallra që ne

kemi nevojë. Në këtë drejtim mund të themi se është krijuar një situatë më e favorshme, por ajo është koniunkturale, për arsye se politikisht Italia ka qenë dhe është në kundërshtim me rendin tonë socialist.

Në bazë të kësaj panorame të gjendjes ndërkombëtare, për ne në rend të ditës duhet të qëndrojmë kurdoherë vigjilencia revolucionare dhe kjo vigjilencë revolucionare duhet të forcohet me ngritjen e mëtejshme politike dhe ideologjike të masave të gjera të popullit, e në radhë të parë të komunistëve. Kjo do të thotë që të shpjegohen sistematikisht dhe të kuptohen thellësisht nga të gjithë situatat nga ku kalojnë bota dhe vendi ynë, dhe duke pasur këtë parasysh, në të gjithë gamën duhet të forcohet mbrojtja e vendit. Me fjalë të tjera kjo do të thotë që parulla e Partisë sonë: «I gjithë populli ushtar», duhet të konkretizohet në jetë duke mos lejuar asnjë dobësi në disiplinën e stërvitjeve ushtarake të popullit dhe mungesa në kryerjen e detyrave për fortifikimet dhe për të gjitha problemet e tjera që i përkasin mbrojtjes.

Po ashtu të kuptohet mirë se këto situata lypin të realizohen planet ekonomike, me qëllim që të krijohen vazhdimisht rezerva për kohë të rrezikshme dhe mundësi të mira e të reja që niveli i jetesës së popullit tonë të ngrihet, pra, të luftojmë për ngritjen e mirëqenies së tij, duke e zhvilluar ekonominë tonë të shumanshme e të centralizuar dhe duke bërë edhe kursime. Këtë duhet ta bëjmë jo vetëm me masa administrative, por duke e ngritur ndërgjegjen e punonjësve që të mos priset, të mos cenohet e të mos dëmtohet asgjë, përkundrazi të forcohet disiplina proletare në punë, të forcohet morali proletar në njerëzit dhe në shoqëri dhe t'u bëhet ballë me sukses të gjitha vështirësitë që hasim brenda dhe në marrëdhëniet tregtare që kemi me shtetet e Lindjes dhe të Perëndimit.

**E MARTË**

**19 SHKURT 1980**

## **PROBLEMI I DËMSPËRBLIMEVE NGA REPUBLIKA FEDERALE E GJERMANISË DUHET TRAJTUAR MBI BAZA TË STUDIUARA E SERIOZE**

Dje kritikova ministrin e Punëve të Jashtme, Nesti Nasen, për trajtimin shumë të dobët të çështjes së dëmshpërblimeve që na detyrohet Republika Federale e Gjermanisë.

Shokët e Ministrisë së Punëve të Jashtme jo vetëm nuk kanë iniciativë, por edhe kur të tjerët u hapin perspektiva, ata nuk e vrasin mendjen, nuk punojnë dhe, për t'u gjendur në punë, bëjnë propozime foshnjore e të dëmshme.

Konkretisht: ka kaq kohë që ambasadori ynë në Beograd ka marrë kontakt me ambasadorin e Republikës Federale të Gjermanisë dhe i ka paraqitur kërkesat tona lidhur me dëmshpërblimet e luftës. Ai është përgjigjur se shuma që kërkojmë ne është e madhe, se ata nuk paguajnë më dëmshpërblime etj. Ne, ka thënë ambasadori gjerman, dëshirojmë të vendosim marrëdhënie diplomatike me ju, pastaj të gjejmë ndonjë formulë për zgjidhjen e çështjes që ngrini ju. Ministri ynë i Jashtëm bisedimet i transferoi nga Beogradi në Vjenë gjoja se këtu ambasadori gjerman na «qenka më i arsyeshëm». Dhe bisedojnë ambasadorët pa pushim, ndërsa ministri ynë e këshillon ambasadorin tonë që t'i vazhdojë bise-

dimet pa bukë. Gjermanët këtë duan, të lënë përshtypjen se Republika Federale e Gjermanisë e ka grurë me Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë. Kështu bisedimet midis ambasadorit tonë me atë të Gjermanisë Federale, me aprovimin e titullarit të Ministrisë sonë të Punëve të Jashtme, po kthehen si ato që zhvilloheshin dikur midis ambasadorit kinez me atë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Varshavë.

Për këtë problem të rëndësishëm kam folur me orë të tëra me Nesti Nasen e me Mehmet Shehun dhe u kam thënë se, në qoftë se duam të shkulum gjë nga gjermanët, kërkesat tona për dëmshpërblimet duhet të jenë sa më reale dhe t'u dalim atyre me propozime të reja, të faktuara dhe mundësisht më të pranueshme, pse gjermani nuk ka dalë në pjacë që të japë marka. Vetëm nga halli ai mund të na japë diçka. Dhe kështu kemi rënë dakord. Kurse Nesti Nase kërkon mendimin tim për pyetjen që ai mendon t'i bëjë ambasadori ynë ambasadorit të Bonit, kur të piqet me të: «Ç'kuptoni ju me marrëdhënie ekonomike?». Por këtë pyetje mund t'ia përsëritë gjermani ambasadorit tonë, pse i ka thënë me kohë se ne gjermanët nuk paguajmë dëmshpërblime, por mund t'ju japim kredi, që ju nuk merrni, dhe t'ju bëjmë favore të tjera ekonomike.

I thashë se nuk jam dakord me propozimet e me veprimet e tij të pathelluara. Duhet të ripërgatiten listat dhe propozime të reja dhe t'i paraqiten palës gjermane. Vetëm mbi këto baza të bëhen bisedime dhe jo mbi asnjë bazë ose mbi baza të djegura.

E ENJTE  
21 SHKURT 1980

### «FRYMËZIMI» I FUNDIT I TITIZMIT NË PRAGUN E VDEKJES SË «BABAIT» TË TIJ

Këto ditë një ndër zëdhënësit kryesorë të titizmit, anëtari i Kryesisë së Komitetit Qendror të së ashtuquajturës Lidhje e Komunistëve të Jugosllavisë, Aleksandër Grliçkov, foli në një aktiv të komunës Vozhdovac dhe u përpoq «të justifikojë» pozitat e errëta, revizioniste të kësaj «Lidhjeje» për disa çështje të gjendjes ndërkombëtare aktuale, si «detanta», «mosangazhimi», «bashkekzistenca paqësore», «socializmi vetadministrues» etj.

Nga përmbajtja e këtij fjalimi bien në sy shqetësimi dhe frika që i ka kapur titistët, në çastet kur Titoja është në agoni, për dështimin e politikës së tyre në planin e brendshëm dhe në atë ndërkombëtar, si dhe orvatjet për të maskuar me demagogji pasigurinë e tyre për të nesërmen.

Le t'u referohemi disa deklaratave që bëri Grliçkovi në Vozhdovac e që i transmetoi agjencia e lajmeve Tanjug.

Ai tha se bota «asnjëherë nuk ka qenë përballë rreziqeve kaq të mëdha, se asnjëherë nuk ka provuar kaq shumë të papritura dhe se asnjëherë nuk është gjendur para kaq shumë çështjeve të pazgjidhura... Mungesa e përgjigjeve të drejta për kontradiktat e sotme të botës edhe sot të çon deri në atë pikë saqë zgjidhja të kërko-

het në luftërat e kufizuara, lokale, në luftërat e ashtu-  
quajtura të pakontrolluara». Por ai nuk u fut dhe nuk  
mund të futej në analizën e shkaqeve dhe të faktorëve  
realë që e kanë shkaktuar këtë gjendje, sepse ideologjia  
reaktionare që përfaqëson dhe mbron, e pengon ta kup-  
tojë thelbin e luftës si vazhdim të politikës së klasave  
kundërshtarë me mjete dhune.

Të konstatojmë me kaq vonesë se kontradiktat e botës  
së sotme kanë çuar në luftëra lokale nuk është ndonjë  
punë e madhe. Këtë bota e ka mësuar prej kohësh. Pro-  
letariati, masat punonjëse, njerëzit revolucionarë e për-  
parimtarë e dinë se, përdërisa do të ekzistojnë kapitaliz-  
mi, imperializmi dhe socialimperializmi, do të ketë edhe  
luftëra grabitqare. Çështja është të shpjegohet se cila  
është rruga e zhdukjes së rreziqeve të luftës. Vetëm mar-  
ksizëm-leninizmi është ai botëkuptim revolucionar i kla-  
sës punëtore që shpjegon shkencërisht se rrezikun e luf-  
tës e zhdok revolucioni me dhunë. Kjo ideologji shken-  
core sqaron mendjet e miliona njerëzve në botë dhe i  
armatos ata me idenë e aksionit revolucionar për për-  
mbysjen e borgjezisë e të kapitalizmit dhe për vendosjen  
e socializmit e të diktaturës së proletariatit. Pikërisht  
këtyre ideve u shmanget me qëllim ky revizionist dhe  
manovron me termat e njohur të ideologëve borgjezë  
gjoja për të kritikuar sistemin botëror të marrëdhënieve  
aktuale ndërkombëtare.

Grliçkovi thotë se «mekanizmat e përputhjes së in-  
teresave të ndryshëm për zgjidhjen e konflikteve janë  
bërë gjithnjë e më pak efikasë... sa ky sistem marrë-  
dhëniesh do të çahet nëpër të qepurat e tij». Tashmë  
dihet se sistemi i shtypjes e i shfrytëzimit do të përmby-  
set një ditë, po kush e ka marrë në mbrojtje gjer më sot  
këtë sistem të padrejtë dhe mekanizmat e ndryshëm për  
t'i zgjatur jetën kapitalizmit? Ka qenë dhe është pikë-  
risht titizmi ajo ideologji antipunëtore dhe fund e krye

kapitaliste që është munduar të mbulojë qepjen me pe-  
të bardhë të sistemit aktual kapitalist botëror dhe të për-  
krahë mekanizmin e përputhjeve dhe të puthjeve të in-  
teresave të shumëllojshëm të shteteve të ndryshme ka-  
pitaliste, pra t'u zgjatë jetën sistemit kapitalist dhe shty-  
pjes kapitaliste mbi masat punonjëse.

Grliçkovi ka shprehur pikëpamjen se strukturat e  
deritanishme botërore, siç i quan ai, qenkan krijuar për  
të përputhur gjoja interesat e ndryshëm dhe për të ruaj-  
tur balancimin e paqen botërore(!). Por, duke qenë i bin-  
dur se këtë demagogji nuk do ta pranojë njeri, pse  
popujt e dinë që strukturat dhe organizmat e sotëm janë  
krijuar nga borgjezia për interesat e saj kundër lirisë  
dhe pavarësisë së popujve, është detyruar të pohojë se  
këto struktura «nuk janë të mjaftueshme të arrijnë këtë  
qëllim bile edhe kur bindja kombinohet me presione dhe  
me përdorimin e forcës» dhe pastaj ai vazhdon: «Në  
skenën botërore kanë dalë forca të reja shoqërore, të cilat  
kërkojnë ndryshimin me themel dhe tërësisht të marrë-  
dhënieve ndërkombëtare të mbështetura në të drejta të  
barabarta».

Të studiuar me kujdes këto deklarata tregojnë pa  
shumë fjalë se politika titiste e «valles mbi litar» ka  
dështuar. Titistët, ashtu si revizionistët e tjerë, për të  
përligjur me çdo mënyrë qëndrimin e tyre proimperialist  
në mbrojtje të mekanizmave kapitalistë ekzistues, duan  
të thonë se ata i kanë përkrahur këta mekanizma të ma-  
nipuluar nga superfuqitë, sepse paskan dashur të ruajnë  
paqen, por, meqenëse zhvillimi historik ka nxjerrë në  
skenë forca të reja shoqërore, ata tani na qenkan për  
marrëdhënie ndërkombëtare të mbështetura në të drejta  
të barabarta(!). Dhe tërë këtë arsyetim, ky zëdhënës i ti-  
tizmit e bën për të mbrojtur «detantën», e cila, sipas tij,  
vërtet ndodhet në krizë, por ideja e përgjithshme e saj  
nuk e paska marrë goditjen vendimtare.

Shpresat për «marrëdhënie ndërkombëtare, të mbështetura në të drejta të barabarta» ky «teoricien» i var te «detanta» dhe jo te revolucioni, të cilin e ka frikë si vdekjen, prandaj dhe bën thirrje për «detantën», e cila «do të siguronte paqen dhe bashkekzistencën paqësore... do të çlironte edhe forcat, të cilat luftojnë për pavarësinë kombëtare, transformimin shoqëror dhe socializmin». E tërë kjo teori revizioniste për të zëvendësuar revolucionin me «detantën», nuk është asgjë tjetër, veçse një thirrje drejtuar kapitalistëve, imperialistëve, pra, borgjezisë kapitaliste që të ulë tensionin për të shpëtuar nga revolucioni. Kjo gjë është e qartë si drita e diellit.

Dihet se në të gjitha rendet shoqërore, ku sundojnë marrëdhëniet ekonomike shfrytëzuese, tipike janë kontradiktat antagonistike. Metodot kryesore për zgjidhjen e këtyre kontradiktave janë lufta klasore revolucionare dhe revolucioni shoqëror, por asnjëherë nuk kanë qenë dhe nuk mund të jenë paqja shoqërore mikroborgjeze dhe bashkekzistenca paqësore revizioniste.

Duke u ndeshur në faktin se, me gjithë thirrjet për ruajtjen e «detantës», tensioni në marrëdhëniet ndërkombëtare po ngrihet dita-ditës, Grliçkovi, për t'u treguar gjoja realist, pranon se vetëm «detanta bipolare», domethënë ulja e tensionit në marrëdhëniet që manipulohen nga të dyja superfuqitë, imperializmi amerikan dhe ai sovjetik, ka pësuar krizë. Dhe sa për t'u bërë qejfin «Evropës së Bashkuar», Kinës dhe Japonisë, që aspirojnë të përfshihen në lojën e të mëdhenjve, ai shprehet se për jugosllavët një «detantë multipolare» «do të ishte më dialektike nga ajo e vjetra bipolare», sepse kështu «ndoshta do të shpreheshin dhe do të përputheshin më shumë interesa, do të kishte një bazë më të gjerë»(!).

Megjithëse nuk janë plotësisht dakord me «detantën multipolare», revizionistët jugosllavë e pranojnë këtë më me qejf edhe për arsye se ajo është më afër teorisë së

tyre të «mosangazhimit». «Detanta», që do ta dëshironin Grliçkovët, është ajo që ata e quajnë «detantë universale», që, sipas tyre, do të çoka në marrëdhënie «të qëndrueshme» në botë, pra në «paqen qiellore», në «paqen kristiane», në «zhdukjen» e kontradiktave me një të rënë të shkopit, siç predikon në thelb politika e «mosangazhimit». Këto ide metafizike e çojnë revizionistin jugosllav në arsyetimin banal që ai e përmbledh me këto fjalë: «Vetvetiu del konkluzioni se kontradiktat dhe ndryshimet në interesa, si dhe përcaktimi i interesave të përbashkët mund të zgjidhen vetëm me pjesëmarrjen me të drejta të barabarta dhe në mënyrë të pandarë të të gjithë popujve»(!). Po si mund të arrihet barazia e popujve në marrëdhëniet ndërkombëtare, pa revolucion?! Duke vijuar logjikën e revizionistit, përgjigjja do të ishte: «Me frymën e shenjtë! Amin»!

Në vazhdim të së ashtuquajturës kritikë kundër «bipolarizmit» të fuqive të mëdha, Grliçkovi thotë se ato, pra, superfuqitë, «do të ishin më pak realiste në qoftë se zgjidhjet e çështjeve më pluraliste se asnjëherë tjetër dhe, në të njëjtën kohë, më vendimtare për fatet e botës, do të përpiqeshin t'i vendosnin në vizionin dhe në kuadrin e bipolarizmit». Sido që qëndrimi i tij kundër-shtues ndaj «bipolarizmit» është tepër i matur, prapë del qartë se, edhe me këto që thuhet, «bipolaristët» s'qenkan treguar «të arsyeshëm», siç janë paraqitur gjer më sot nga revizionistët.

Duke folur për «bipolarizmin» në marrëdhëniet ndërkombëtare, Grliçkovi merr nëpër gojë Konferencën e Jaltës sikur kjo paska nxitur konflikte të reja dhe një përhapje të re të potencialeve ushtarake! Revizionisti, për qëllime aspak të ndershme, identifikon Konferencën e Jaltës me veprimet e imperializmit amerikan në bllokun e NATO-s dhe të socialimperializmit sovjetik në Traktatin e Varshavës. Ai ngatërron me dashjë na-

tyrën agresive dhe luftënxitëse të kapitalizmit botëror me marrëveshjen që u arrit në shkurt të vitit 1945 nga kryetarët e shteteve të Bashkimit Sovjetik, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Anglisë për kapitullimin pa kushte të Gjermanisë hitleriane dhe çmilitarizimin e saj, për krijimin e OKB-së etj.

«Koncepti i blloqeve dhe ai bipolar mbi detantën dhe balancimin botëror jo vetëm janë të pamjaftueshëm për mbajtjen e paqes, por gjithnjë e më shumë po bëhen burim i konflikteve të reja» deklaroi Grliçkovi në Vozhdovac, duke dashur të krijojë përshtypjen sikur tha ndonjë gjë të re. Edhe kjo është një manovër e hollë që synon të mbulojë politikën proimperialiste të Jugosllavisë titiste, sepse dihet që «detanta» dhe paqja nuk janë ruajtur e nuk do të ruhen nga superfuqitë dhe nga kapitalizmi botëror, një variant i të cilit është edhe vet-administrimi jugosllav. Janë pikërisht këta revizionistë që kanë ushqyer iluzionet më të çuditshme për ruajtjen e «detantës» nga fuqitë e mëdha dhe që sot, kur kanë rënë keq dhe e ndiejnë veten ngushtë, përpiqen të prezantohen sikur janë realistë në politikë dhe po zbulojnë të fshehtat e botës!

Revizionistët jugosllavë nuk mund të mos e shikojnë sot rivalitetin e superfuqive dhe mosbesimin që ekziston në marrëdhëniet midis tyre, prandaj dhe Grliçkovi tha se çdo marrëveshje midis superfuqive «është vetëm pranim i barazimit momental në potencialet e tyre, një pushim i shkurtër, i cili krijon fazën e re të rivalitetit». Veza e Kolombit e Grliçkovit! Po kush tjetër, vallë, përveç socialdemokratëve, titistëve dhe revizionistëve të tjerë, e ka ushqyer gjer më sot besimin ndaj ujqve kapitalistë? Popujt e botës, klasa punëtore dhe marksistë-leninistët e vërtetë nuk kanë harruar asnjëherë se midis shteteve imperialiste nuk mund të ekzistojë kurrë atmosfera e besimit reciprok. Në koniunktura të caktuara

po, superfuqitë mund të merren vesh, bile mund të hyjnë edhe në aleanca kundër të tjerëve për të mbrojtur interesat e vet, por prapë ato, nga natyra e tyre agresive, do të veprojnë hapur dhe fshehur kundër njëra-tjetrës. Kjo është dialektika e marrëdhënieve midis kapitalistëve.

Grliçkovi tha, gjithashtu, se pjesa më e madhe e vendeve, duke përfshirë këtu edhe një pjesë të mirë të vendeve që u përkasin këtyre blloqeve, mbrojtjen e tyre nuk e kërkojnë nën ombrellën e blloqeve. Në të vërtetë nuk është kështu. Pjesëmarrësit në blloqe ushtarake, ashtu si edhe padronët e tyre, po armatosen çdo ditë për t'i ngrënë kokën njëri-tjetrit. Superfuqitë po përpiqen të shtojnë sferat e ndikimit, duke përdorur si justifikim rrezikun e agresionit të rivalit. Të pretendosh dobësimin e blloqeve ushtarake për të mbrojtur bashkekzistencën paqësore dhe OKB-në, siç bën ky anëtar i Kryesisë së Komitetit Qendror të së ashtuquajturës Lidhje e Komunistëve të Jugosllavisë, do të thotë t'i bësh shërbim të keq botës së mbarsur me shumë rreziqe e të mbushur me vatra të nxehta tensioni.

«Paqja dhe bashkekzistenca paqësore janë bërë më shumë se asnjëherë më parë një koncept i pandarë» deklaroi Grliçkovi. Për të argumentuar tezën e paqes dhe të bashkekzistencës paqësore si një «fakt historik», ai deklaroi se këto janë shprehur në parimet e OKB-së. Ky «argument» ka po atë vlerë sa ka aktualisht edhe parulla e Revolucionit Demokratiko-Borgjez të Francës: «*Liberté, égalité, fraternité*»<sup>1</sup>. Për sa u përket revizionistëve jugosllavë, paqja dhe bashkekzistenca paqësore revizioniste vërtet janë bërë të pandara, por të pandara nga kreditë, nga dollarët dhe nga monedhat e tjera që ata marrin nga të katër anët si shpërblim për veprimtarinë e urreyer që zhvillojnë në dëm të lirisë, të pavarësisë dhe të sovranitetit të popujve.

1 Frëngjisht — liri, barazi, vëllazërim.

Për sa i përket OKB-së, Grliçkovi thotë se ajo nuk ka dhënë përgjigje për të gjitha çështjet e botës së sotme, megjithëkëtë «është ajo së cilës i përket më tepër nga të gjithë t'i kërkojë ato dhe është më e afta t'i gjejë ato». Pallavra! OKB-ja ka disa dekada që është krijuar, por asgjë më rëndësi s'ka zgjidhur dhe asgjë nuk mund të zgjidhë. Të drejtat, liritë, pavarësinë dhe sovranitetin e shteteve të botës asnjëherë nuk i ka mbrojtur OKB-ja. Ç'bëri kjo organizatë kundër agresionit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Vietnam e në vende të tjera? Ç'bëri për agresionin e Bashkimit Sovjetik revizionist kundër Çekoslovakisë më 1968 dhe aktualisht kundër Afganistanit? Asgjë. Përkundrazi shpeshherë flamuri i OKB-së është ngritur për të mbrojtur agresionet e superfuqive dhe për të shtypur viktimat e këtyre agresioneve. Vetëm lufta revolucionare, vetëm revolucionin dhe marksizëm-leninizmi mund të japin të vetmet përgjigje të sakta për zgjidhjen e kontradiktave të thella të botës së sotme. Më kot revizionistët jugosllavë i kërkojnë këto zgjidhje nga një organizatë, e cila ka kohë që është kthyer në një instrument që manipulohet nga superfuqitë.

Gjithë këto arsyetime banale për «detantën» dhe OKB-në, Grliçkovi i përdor për të dalë atje ku atij dhe shokëve të vet u djeg më tepër: te teoria e famshme dhe e qelbur e «mosangazhimit». Pikërisht këtu fle lepurititist. Por «lëvizja e mosangazhimit», që s'është tjetër veçse lëvizje e angazhimit total me kapitalizmin, ka falimentuar. Asaj, ashtu sikurse shpikësve dhe mbrojtësve të vet, i ka dalë boja. Kjo e ashtuquajtur lëvizje që është sajuar për t'iu kundërvënë revolucionit, është katan-disur si mos më keq. «Lëvizja e mosangazhimit», sipas Grliçkovit, na qenka mohimi i «detantës bipolare» dhe «multipolare», ajo qenka shprehje e «detantës univer-

sale»(!). Me shprehje të tilla bombastike, me «zbulime» të tilla sensacionale si «detantë universale», titistët kujtojnë se të tjerët do t'i çmojnë si njerëz që nxjerrin nga goja fjalë ari.

Duke e dredhur dhe duke e përdredhur gjykimin se gjoja një pjesë e kontradiktave të sotme në gjirin e «të paangazhuarve» janë pjellë e koncepteve «bipolare» e «multipolare» dhe jo të natyrës së rendit kapitalist, revizionisti Grliçkov kërkon t'u mbushë mendjen njerëzve që t'u besojnë koncepteve «universale», me të cilat ai kupton konceptin jugosllav mbi «mosangazhimit». Kontradiktat antagonistike në radhët e «të paangazhuarve» ai nuk i sheh në papajtueshmërinë e interesave të klasave, të grupeve dhe të forcave shoqërore, që janë në armiqësi të hapët me njëra-tjetrën dhe, për rrjedhim, edhe rru-gën e zgjidhjes së këtyre kontradiktave, nuk e gjen në luftën klasore revolucionare dhe në revolucionin sho-qëror, por në konceptin e «mosangazhimit» si «shprehje dhe bartës i detantës universale»(!).

«Për të evituar» këto kontradikta, ai u rekomandon «të paangazhuarve» «mbrojtjen e parimeve themelore të universalitetit të problemeve botërore dhe të demokratizimit të plotë të zgjidhjes së tyre»(!). Për një njeri që e njihë sadopak dialektikën materialiste, nuk do të ishte aspak e zorshme të kuptonte absurditetin e këtyre gjykimeve të revizionistëve jugosllavë. Megjithëse këta revizionistë «mohojnë» «bipolarizmin», duke i kundërvënë «detantën universale», imperialistët e socialimperialistët nuk i janë trembur kurrë këtij «universaliteti» të «të paangazhuarve», por e kanë përkrahur, e kanë ushqyer dhe e kanë mbajtur gjallë, duke mos i kursyer as dollarët, as rublat apo monedha të tjera.

Grliçkovi, duke bërë poza prej megalomani, ka marrë përsipër t'i shpjegojë botës edhe se si mund të parandalohen të papriturat. Çelësin magjik të kësaj zgjidhje-

je ai e ka gjetur te «kthimi në detantë si e vetmja rrugëdalje e mundshme», sepse shton ai, «përveç detantës, në fakt, nuk ka alternativë tjetër». Po revolucionin, si proces të kalimit nga një rend i vjetër në një rend të ri shoqëror, të cilin e rekomandojnë si të vetmen rrugëdalje klasikët e marksizëm-leninizmit, ku e lë ai? Për këtë nuk bëjnë fjalë «revolucionarët» e kallëpit të Titos dhe këlyshët e tij. Ata bëjnë thirrje për bisedime në kuadrin e «detantës», por, që të kenë jetë të gjatë marrëveshjet, thotë Grliçkovi, duhet që këto të mos mbeten çështje të teknikës diplomatike(!). Duke dëgjuar këto llafe, padashur lind pyetja: Si është e mundur që tani jugosllavët e trajtojnë si të pamjaftueshme «teknikën diplomatike», kur e tërë ideologjia dhe politika titiste nuk ka qenë dhe nuk është tjetër veçse një «teknikë e diplomacisë» e varur nga diplomacia e kapitalizmit botëror?! Këto janë pehliuanllëqe politike në orvatje për t'iu përshtatur kohës.

Funksionari i lartë titist, duke folur diku për revolucionin thotë se sot në botë, në të njëjtën kohë, po vazhdojnë tri revolucione: nacionalçlirimtar, shoqëror dhe teknologjik. Titizmi na nxori kështu tri revolucione që zhvillohen në «paqe», urtë e butë, pa ua prishur terezinë sundimtarëve kapitalistë, borgjezisë kapitaliste. Në të vërtetë titistët, sido që i zënë në gojë shkarazi luftërat nacionalçlirimtare, janë haptazi kundër tyre, ndërsa revolucionin proletar ata e «harrojnë», as që e zënë në gojë. Grliçkovi thotë: «Paqja e ruajtur me dhunën nacionale, dhunën klasore ose dominimin ekonomik, në radhë të parë, do të ishte paqe antihistorike dhe më pas si «e imponuar»». Sipas tyre del se revolucioni proletar qenka demoduar, sepse proletariati, nën udhëheqjen e komunistëve, duke bërë revolucionin për përmbysjen e borgjezisë, përdor dhunën e vet klasore kundër dhunës së borgjezisë, pra, prish «paqen klasore». Kjo logjikë e tyre të

çon në përfundimin që për hir të paqes, më mirë le të durohet shtypja, paqka se Karl Marksi, duke e parë luftën e klasave si forcë kryesore lëvizëse të zhvillimit të shoqërisë së ndarë në klasa antagoniste, ka argumentuar shkencërisht pashmangshmërinë dhe ligjshmërinë e zëvendësimit të mënyrave të prodhimit dhe vdekjen e pashmangshme të kapitalizmit; paqka se Vladimir Iliç Lenini ka theksuar se shkatërrimi i makinës shtetërore borgjeze është një domosdoshmëri historike.

Duke folur më tej për tri revolucionet, ashtu si i përfytyrojnë ato titistët, në fjalimin e revizionistit Grliçkov thuhet: «Revolucioni shoqëror paraqitet si monopol i një blloku... Revolucioni teknologjik manipulohet në interes të bllokut të dytë. Çlirimeve kombëtare përpiqen t'u ngjitin etiketa lindore ose perëndimore...». Me këto fjalë ai do të thotë se revolucionin shoqëror dhe kombëtar e ka monopolizuar Bashkimi Sovjetik, revolucionin teknologjik e kanë monopolizuar Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kurse titizmit i mbetet ta shkatërrojë këtë skemë me «mosangazhimin» dhe vetadministrimin, që t'u hapë rrugën «sigurimit të paqes në përparim dhe përparimit në paqe»! Këto fraza (për të cilat me sa duket titistët e kanë vrarë shumë mendjen për t'i gjetur) janë thurur që të ndërtohet «teoria e krimbur» ala titiste, me qëllim që revolucioni të mos bëhet kurrë.

Rrethi i «teorizimit» titist mbi revolucionin dhe socializmin mbyllet, duke thënë: «Vetëm detanta universale, me pjesëmarrjen e të gjithëve, mund të sigurojë një paqe të tillë të përgjithshme, që i nevojitet përparimit të shumëllojshëm, gjë që për ne do të thotë socializëm»(!).

Përveç sa u tha për revolucionin, titistët, duke vazhduar me konsekuencë politikën e tyre kundërrevolucionare edhe socializmin e konceptojnë jo si një rend shoqëror që vendoset me revolucionin proletar, me përmbysjen e sundimit të borgjezisë dhe me vendosjen e

diktaturës së proletariatit, ku baza e marrëdhënieve në prodhim është prona kolektive e mjeteve të prodhimit, por si një «sistem paqeje të përgjithshme dhe përparimi të shumëllojshëm!». Përkufizime të tilla mbi socializmin mund të jenë gjithçka, por marksiste kurrë. Këto qëndrime nuk na çuditin aspak, se nga ata që i kanë vënë vetes për detyrë të minojnë revolucionin dhe socializmin nuk mund të presësh gjë tjetër, veçse demagogji pa fre për të mashtruar naivët dhe për të kënaqur armiqtë e komunizmit.

Kështu mund të shpjegohet edhe qëndrimi që mbahet në fjalimin e Grliçkovit, dhe të udhëheqësve të tjerë titistë, kur thuhet: «Në terrenin e transformimeve shoqërore dhe të revolucioneve... është kapërcyer sistemi i monocentrizmit ideologjik dhe politik. Ai është bërë faktor kufizues në zgjerimin e socializmit si proces botëror. Forca, forma dhe manifestime socialiste ka gjithnjë e më shumë». Sipas titistëve mund të ketë aq lloj socializmasht në botë, sa mund të jenë edhe vendet që e quajnë veten socialiste. Kjo do të thotë se teoria marksiste-leniniste nuk qenka e vetmja doktrinë shkencore në bazë të parimeve universale të së cilës çdo vend mund të bëjë revolucionin dhe të ndërtojë socializmin në kushtet e veta. Përkundrazi cilido që pretendon se është vend socialist, sipas revizionistëve jugosllavë, mund të quhet i tillë, pavarësisht se atje sundojnë borgjezët ose feudalët dhe kjo qenka kështu, sepse çdo vend e ndërtoka socializmin sipas kuptimit dhe mënyrës së vet, qoftë kjo shoqëri krejt ndryshe nga ajo që në të vërtetë është socialiste.

(1) Socializmin e vërtetë shkencor zyrtari titist e quan «formë të kufizuar të socializmit në botë», sepse ligjet e përgjithshme të marksizëm-leninizmit, në bazë të të cilave ai ndërtohet, sipas tij s'janë orientime shkencore që duhet t'i ketë parasysh çdo revolucion socialist, por «kufizime të konceptit të zhvillimit të socializmit në bo-

të». Këtu, natyrisht, ai atakon ndërtimin tonë socialist, që, me keqdashje, e barazon me shoqërinë e sotme revizioniste sovjetike.

Grliçkovi, duke atakuar socializmin shkencor, kërkoi të përligjë si të mundet dhe sa të mundet «mosangazhimin», vetadministrimin dhe «socializmin» titist, prandaj në fjalën e tij vë në dukje: «Kemi parë nëpërmjet mosangazhimit rëndësinë e universalitetit të detantës. Kemi theksuar rëndësinë e rendit të ri politik dhe ekonomik ndërkombëtar. Perspektivën e socializmit e kemi gjetur në rrugët e pavarura të zhvillimit socialist, pushtetin e klasës punëtore e kemi afirmuar me vetadministrimin».

Këto deklarata pohojnë se revizionistët jugosllavë i janë kundërvënë hapur marksizëm-leninizmit. Largimin e tyre nga ky botëkuptim revolucionar i klasës punëtore komunistët dhe proletariati kurdoherë e kanë quajtur tradhti. Sajimet titiste «mosangazhim», vetadministrim etj., etj., Partia jonë i ka demaskuar me kohë në mënyrë të qartë, të plotë dhe bindëse. Ne shpeshherë i kemi trajtuar këto probleme dhe kemi vënë në dukje rrezikshmërinë e tyre, duke ngritur zërin për nevojën e një lufte të vazhdueshme parimore kundër revizionizmit jugosllav.

Duke e ndier pozitën e vështirë të mëparshme dhe të tanishme, si dhe peshën e demaskimit të rëndë të koncepteve revizioniste të teorisë dhe të praktikës së tyre në planin e brendshëm dhe në atë ndërkombëtar, si dhe duke dashur të fitojë bekimin e Titos në pragun e vdekjes, bashkëpunëtori i tij Grliçkov shprehet: «Në botë nuk mund të them se i pranojnë zgjidhjet tona, sepse edhe ne nuk kemi përgjigje për të gjitha pyetjet, por gjithnjë e më shumë ato i kërkojnë në drejtimin që kemi përcaktuar ne, të cilin e ka përcaktuar Titoja». Gjer më sot asnjë marksist-leninist i vërtetë, asnjë proletar dhe njeri i ndershëm në botë, përveç demagogjisë e

mashtimit, përveç cinizmit e poshtërsisë nuk ka gjetur gjë tjetër në teorinë e vetadministrimit jugosllav. Ata që kërkojnë përgjigje për zgjidhjen e problemeve nga jugosllavët mund të jenë kinezët dhe të tjerë renegatë të marksizëm-leninizmit, që janë revizionistë jo më pak se titistët.

Është fakt se gjendja e rëndë shëndetësore e Titos i ka shqetësuar bashkëpunëtorët e tij, të cilët e kanë të vështirë të vazhdojnë rrugën pa krye ku ishin futur bashkë me mësuesin e tyre. Tani brenda dhe jashtë Jugosllavisë është e natyrshme të diskutohet se ç'do të ndodhë me Federatën e Jugosllavisë pas Titos. Parashikimet janë nga më të ndryshmet, por midis tyre është zor të gjesh gjykime optimiste. Kur diçka bie erë, ambienti patjetër do të reagojë për mirë ose për keq. Ndaj aromës shprehet kënaqësi, ndaj erës së keqe neveri. Megjithëkëtë Grliçkovi, duke iu referuar komenteve që bëhen, letrave e telegrameve protokollare që i dërgohen kryetarit të shtetit për sëmundjen e rëndë të tij, i interpretoi ato me pompë. Ai bile arriti deri aty sa të thotë se «gjendja shëndetësore e shokut Tito shkaktoi edhe referendumin ndërkombëtar si për prestigjin e tij në botë, ashtu edhe për drejtësinë e politikës së jashtme të Jugosllavisë»(!). Këto fjalë në aktivin e Vozhdovacit tingëllojnë si ngushëllim jo vetëm për vdekjen e Titos, por edhe për ndyrësinë e veprës që ai lë pas, pasojat e së cilës do t'i vuajnë për shumë kohë popujt e Jugosllavisë.

«Energjia që disponojmë në luftën për zhvillimin tonë me sukses, tha Grliçkovi, është e pashtershme». Këtë zhvillim me «sukses» në Jugosllavinë kapitaliste të mbytur në borxhe dhe të shitur te fuqitë e mëdha, me siguri nuk e përfytyron dot as vetë ai që pohon një konkluzion të tillë, por s'ka se ç'të bëjë, ia do puna të flasë në këtë mënyrë, sepse për këtë gjendje kaotike, ku

është katandisur Jugosllavia, ka edhe ai përgjegjësinë e tij. Grliçkovi u betua në aktiv se e ashtuquajtura Lidhje e Komunistëve të Jugosllavisë me politikën e saj «vazhdimisht ka thënë të vërtetën» dhe shtoi se «e vërteta është aleati ynë më i madh në luftën për zhvillimin dhe kapërcimin e të gjitha vështirësive të brendshme dhe të jashtme»(!). Sa cinike janë këto fjalë në gojën e revizionistëve! E vërteta e tyre është e hidhur, ajo tregon tragjedinë e politikës që mbështetet në gënjeshtrenë dhe në hipokrizinë e pafund. Këtë gjë e ka provuar historia në mënyrë të pakundërshtueshme.

Mosaprovimin e socializmit fals dhe vetadministrimit titist, nga ana e popujve të Jugosllavisë dhe të proletarietit botëror, Aleksandër Grliçkovi e interpreton si presion të brendshëm dhe të jashtëm të atyre që nuk janë dakord me ta dhe e mbyll fjalën e tij, duke thënë se «gjendja shpirtërore dhe optimizmi i të gjithë neve ndaj së ardhmes sonë, e cila nuk do të jetë pa vështirësi dhe pengesa dhe as pa sulme nga armiqtë e jashtëm e të brendshëm, buron nga besimi... i ecjes së socializmit drejt demokracisë dhe i demokracisë drejt socializmit». Me kaq e mbylli revizionisti Grliçkov fjalimin e tij të zyrtë në pragun e vdekjes së Titos. Kjo është një *De profundis* i papohuar, por evident dhe tingëllues.

Sido që titisti në këtë fjalim bën përpjekje të mëdha, ai nuk ka mundur t'ia arrijë qëllimit për të fshehur atë brengë dërrmuese që shqetëson sunduesit e sotëm të Jugosllavisë, faktin që Federata e tyre ka marrë të çara, është zhytur në borxhe dhe shkon drejt falimentimit të plotë. Revolucioni është e ardhmja e popujve luftarakë të Jugosllavisë, ai do t'i fshijë nga faqja e dheut titistët dhe gjithë revizionistët. Sot ose nesër revolucioni do të shpërthejë. Për këtë domosdoshmëri historike ne, komunistët, jemi të bindur.

**E PREMTE**

**22 SHKURT 1980**

## **T'UA PRESIM OREKSIN TITISTËVE JUGOSLLAVË**

Dje lexova radiogramin e ambasadorit tonë në Beograd, me të cilin ai njoftonte se kryeministri jugosllav, Gjuranoviç, e kishte kërkuar në takim.

Pyeta sot Mehmet Shehun nëse kërkesa e Gjuranoviçit është për një takim protokollar, siç bën ai me ambasadorët e huaj që vijnë për herë të parë te ne, apo është një takim për t'i bërë ndonjë komunikim të posaçëm. Ai m'u përgjigj se nuk e dinte me siguri ç'karakter ka ky takim, por, siç më tha, mendon se mund të jetë fjala për një takim protokollar. I thashë që, po të jetë kështu, është çështje tjetër, por, në qoftë se është për ndonjë problem të posaçëm, natyrisht, duhet të mendojmë. I kujtova atij me këtë rast, por jo pa qëllim, se më kanë informuar në të kaluarën që, kur ka pritur ambasadorin jugosllav, ky i kishte propozuar shkëmbime delegacionesh në rang ministrash të Jash-tëm dhe «për këtë gjë ti nuk ishe përgjigjur», prandaj kam mendimin se mundet që ata, jugosllavët, këtë qëndrim ta kenë marrë për aprovim dhe, meqë «i dhe edhe urimet për shërimin e Titos», kodoshët jugosllavë mund të jenë inkurajuar dhe ta ripërsëritin propozimin që bënë. Mehmet Shehu më tha se do ta shikonte këtë gjë, por shtoi «besoj që ambasadori ynë në Beograd i ka mendtë në kokë dhe do ta vërë në korent më parë Qeverinë». I thashë se ai, natyrisht, që i ka mendtë në

kokë dhe nuk bën asnjë çap pa udhëzimin e Qeverisë, por, sidoqoftë, këtë punë duhet ta shohim.

Jugosllavëve oreksin ne do t'ua presim, ata nuk na futin dot në kllapë, duke u përpjekur të përfitojnë nga artikulli ynë botuar në gazetën «Zëri i popullit» më 19 janar të këtij viti<sup>1</sup>, ku deklarohet se populli shqiptar do t'u qëndrojë pranë popujve të Jugosllavisë në rast të ndonjë sulmi eventual kundër Jugosllavisë nga Bashkimi Sovjetik ose nga ndonjë fuqi tjetër. Kjo deklaratë jona përjashton çdo pajtim e takim politik dhe ideologjik me udhëheqësit revizionistë jugosllavë.

Në bisedat që shokët tanë bëjnë me jugosllavët, duhet të jenë shumë të matur. Ata duhet të jenë shumë të kujdesshëm dhe të vëmendshëm në fjalët që thonë e në mendimet që japin. T'u bëjnë interpretim të drejtë dhe të shpejtë, por edhe pa u ngutur, fjalëve, mendimeve e problemeve që ngrenë jugosllavët, duke u dhënë përgjigje të qartë, që kështu të mos lejojnë mendime ekui-voke.

Aktualisht, siç po e shikoj unë, edhe sëmundjen për vdekje që ka kapur Titon, jugosllavët po përpiqen ta shfrytëzojnë në interesin e politikës së tyre revizioniste kapitaliste. Ata kanë arritur deri aty sa të thonë, siç bëri ditët e fundit një nga udhëheqësit kryesorë të tyre Grliçkovi, në një fjalim që mbajti në aktivin e një komune se sëmundja e Titos është bërë një referendum ndërkombëtar për aprovimin e politikës së drejtë jugosllave nga e gjithë bota! Rreth kësaj pike ky Grliçkov tjierr pastaj teorinë e udhëheqjes jugosllave, para dhe pas Titos, duke pretenduar se kriza dhe katastrofa botërore aktuale mund të gjejë zgjidhje vetëm në kuadrin e teorisë së vetadministrimit jugosllav, të cilën e përgjithëson

<sup>1</sup> «Shantazhet e kërcënimet sovjeta-bullgare nuk kalojnë në Ballkan».

dhe e bën rrymë botërore për shkuarjen në «socializëm», ndërsa politikën e «mosangazhimit» e vë, në radhë të parë, përballë politikës së «bipolarizmit» të dy superfuqive e të «multipolarizmit» duke përmendur Evropën, Japoninë dhe Kinën.

Por, për fjalimin e këtij titisti dje kam bërë një sërë shënimesh të veçanta, në të cilat vë në dukje qartë tezat kapitaliste, revizioniste, tradhtare të titizmit jugosllav.

E PREMTE  
22 SHKURT 1980

## PESHA E KINËS «SË MADHE» NUK RËNDON NË BALANCËN BOTËRORE

Siç dihet, Mao Ce Duni ishte pluralist në çështjen e drejtimit të të ashtuquajturit shtet socialist kinez. Sipas teorisë së tij, të gjitha partitë e borgjezisë duhej të militonin për organizimin e tyre dhe të merrnin pjesë në qeverisjen shtetërore të Kinës me po ato të drejta që kishte edhe vetë Partia Komuniste e Kinës. Në fakt këto parti, edhe pa pasur një organizim të përsosur, vetë politika borgjezo-demokratike e Mao Ce Dunit i bënte të vepronin në liri të plotë, në politikën e «zhvillimit të 100 luleve dhe të konkurrimit të 100 shkollave».

Aktualisht, me ardhjen në fuqi të Hua Kuo Fenit dhe të Ten Hsiao Pinit, kjo punë po merr format më konkrete dhe më të gjalla. Këta të dy dhe grupet që përfaqësojnë i likuiduan të gjithë elementët përparimtarë e revolucionarë që bënë pjesë në udhëheqje të ndryshme të mëparshme, qoftë në krye, qoftë në bazë dhe rehabilituan gjithë reaksionin e goditur më parë. Elementët e reaksionit zunë postet drejtuese në instancat më të larta të shtetit. Tani vetë shtypi kinez po deklaron se filloi organizimi i plotë i partive të ndryshme «demokratike» dhe konstaton se po bëhen lëvizje të mëdha njerëzish, të cilët shpejtojnë të shkruhen në këto parti e t'i fuqizojnë ato. Në të njëjtën kohë shumë njerëz po largohen nga Partia Komuniste e Kinës për t'u bashkuar pikërisht me ato parti, ku mund të shprehin më qartë pikëpamjet e tyre borgjeze. Ky është një nga proceset

e fundit të evolucionit drejt demokracisë borgjeze, kapitaliste, të të ashtuquajturit shtet socialist kinez dhe të së ashtuquajturës Parti Komuniste e Kinës.

Pra, gradualisht ne do të vazhdojmë të konstatojmë se në Kinë do të formohen parti borgjeze me struktura të forta dhe se qeveria e ardhshme e Kinës do të përbëhet nga përfaqësuesit e këtyre partive, ndërsa Asambleja e Madhe Kombëtare do të vazhdojë të zgjidhet me vota të fshehta, por të gjitha partitë do të lejohen të propagandojnë e të kërkojnë që ato të bëhen në mënyrë të tillë që vendet në asamble të ndahen proporcionalisht dhe çdo parti, sipas numrit të deputetëve, të ketë pozitë e saj në të gjitha instancat e udhëheqjes së shtetit, qoftë në asamble, qoftë në qeveri.

Tani dhe Huaja në rivalitet midis tyre bashkëpunojnë dhe këtë herë nuk bëhet shumë bujë për sa u përket veprimeve, grindjeve, mosmarrëveshjeve. Çdo gjë bëhet pak a shumë në heshtje. Ndërkohë imperializmi amerikan dhe ai japonez janë futur thellë në Kinë dhe marrëveshjet e shtetit kinez me këto dy fuqi të mëdha janë të shumta e të shumanshme jo vetëm në fushën e marrëdhënieve tregtare dhe të shkëmbimeve tekniko-shkencore, por me siguri edhe në fushën e marrëdhënieve politike nëpërmjet marrëveshjeve të fshehta.

Tani është e qartë se Kina dhe imperializmi amerikan bashkëpunojnë ngushtë në rajonin që përfshin Afganistanin dhe Pakistanin. Kina tok me Shtetet e Bashkuara të Amerikës ndihmojnë Pakistanin me armë, me ushqime dhe me dollarë e jua, ndihmojnë, gjithashtu, luftën e fiseve afgane kundër pushtuesve sovjetikë. Patjetër, në këtë kohë kur imperializmi amerikan është disi i egërsuar me regjimin e Khomeinit dhe të Bani Sadrit, Kina përpiqet të mbajë gjallë marrëdhëniet e saj me Iranin dhe, në të njëjtën kohë, natyrisht në platforma të reja, të gjallërojë edhe miqësinë e vjetër amerikano-iraniane. Në këtë

punë Kina është në marrëveshje me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Për sa i përket Vietnamit, Kina nuk i ka hedhur armët, përkundrazi. Por aktualisht forcat e veta ajo i ka grumbulluar rreth kufijve të Afganistanit, Iranit dhe Laosit dhe, veç kësaj, në këto kohë Kina nuk guxon të bëjë një aventurë të re kundër Vietnamit. Tani për tani ajo dëshiron të shfrytëzojë propagandën që zhvillohet kundër Bashkimit Sovjetik për shkak të agresionit të tij kundër Afganistanit. Pra Kina nuk guxon ta përsëritë edhe një herë tjetër agresionin e saj kundër Vietnamit, sepse e di që opinionin botëror, në këto situata, do ta dënojë Kinën ashtu siç dënoi me të drejtë edhe Bashkimin Sovjetik që ndërhyri në Afganistan, ose siç dënoi dhe do të dënonte dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës për veprimet e tyre kundër Iranit.

Prandaj ne shohim që tani të mos flitet shumë për Kinën, shohim se veprimtaria e saj politike ka marrë forma dinake, hipokrite që godet dhe fsheh dorën, godet dhe pickon si gjarpri, por fshihet në ferra. Nga ana tjetër, shihet qartë se politika e Kinës nuk ka asnjë peshë në botë. Kina nuk dëgjohet për asnjë problem dhe kjo ndodh sepse nuk mban qëndrime, ose sepse qëndrimet e saj janë të gabuara dhe nuk i interesojnë askurrkujt, kështu që duket se Kina në arenën ndërkombëtare ka humbur edhe atë autoritet e atë prestigj që kishte fituar në kohën e Mao Ce Dunit. Në fakt, ky, pavarësisht nga idetë e tij të shtrembra, krijoi në botë një atmosferë të favorshme për politikën kineze, e cila maskohej me formulime të ashtuquajtura marksiste-leniniste dhe deri diku arrinte të gënjente një pjesë të opinionit botëror ose ta bënte atë të mendonte se pesha e Kinës për problemet e mëdha ndërkombëtare është e rëndë. Aktualisht puna ka ndryshuar dhe pesha e Kinës «së madhe» nuk rëndon në balancën botërore.

## MENDIME MBI INTERVISTËN E ZBIGNJEV BRZEZHINSKIT

Brzezinski<sup>1</sup> në një intervistë që i ka dhënë revistës amerikane «Junajtid Stejts njuz end uërllid riport» të 7 janarit të këtij viti, pohon në mënyrë të hapët se Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë një forcë agresive koloniale e tipit të ri, por edhe se ato ndodhen përballë dy sfidave kryesore: «Sfida e parë është ndaj pozitës së tyre gjeostrategjike në botë, dhe e dyta ka të bëjë me marrëdhëniet e tyre me dy të tretat e botës, që gjatë dy dekadave të fundit kanë pësuar papritur një zgjim të ndër-gjegjes së tyre politike». Me fjalë të tjera kjo do të thotë se pozita e imperializmit amerikan në këto vende është tronditur e po sfidohet, ose se «dy të tretat e botës» po luftojnë kundër zgjedhës së imperializmit amerikan.

Zëdhënësi i skllavëruesve amerikanë pohon në këtë intervistë se shteti i tij, që aspiro për hegjemoni botërore, kërcënohet nga një rival potencial dhe ky rival është Bashkimi Sovjetik, i cili, gjithashtu, aspiro për hegjemoni botërore. Përveç kësaj Brzezinski është i detyruar të pranojë se dalja papritur e vendeve të Azisë, të Afrikës dhe të Amerikës Latine në skenën botërore ka ndikuar për të lëkundur statukuonë aq shumë të dëshiruar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kjo, sipas tij,

<sup>1</sup> Zbignjev Brzezinski — ndihmës i presidentit Karter për Sigurimin Kombëtar.

do të thotë «fundi i periudhës eurocentrike në problemet botërore».

Për Brzezinskiin Irani, ku interesat e mëdhenj neokolonialistë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës janë rrezikuar fort, hyn në këtë sferë shqetësuese për to. Ky shqetësim, ose dezekuilibër, u shkaktua ngaqë politika amerikane në këtë vend e në arenën ndërkombëtare nuk ka qenë aktive(!). Kështu thotë ai, por në fakt e kundërta është e vërtetë. Politika dominuese, shtypëse dhe shfrytëzuese, deri edhe me luftëra të armatosura, siç ndodhi në Vietnam e gjetkë, e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në këtë rajon të botës e në arenën ndërkombëtare ka qenë vazhdimisht aktive. Pikërisht veprimet barbare dominuese, shtypëse e shfrytëzuese të imperializmit amerikan shkaktuan kundërshtimin e popujve të sulmuar ose të shfrytëzuar prej tij e që Brzezinski i fut në dy të tretat e botës që paskan pësuar «papritur një zgjim të ndër-gjegjes së tyre politike»! Tani Brzezinski në intervistën e tij thotë se «ne (domethënë Shtetet e Bashkuara) duhet të bëjmë më shumë përpjekje të vazhdueshme për zhvillimin e marrëdhënieve më kuptimplote me ato vende që», sipas këtij shërbëtori e mbrojtësi të tërbuar të imperializmit amerikan, «deri tani nuk kanë qenë aktive në arenën ndërkombëtare». Kjo do të thotë që imperializmi amerikan, dhe konkretisht qeveria aktuale amerikane, duhet të rishikojë taktikat, pa ndryshuar strategjinë. Brzezinski shprehet tekstualisht kështu në intervistën e tij: «Shpresoj se angazhimi gjithnjë e më i madh ndaj një politike të përkrahjes për t'i bërë ballë në mënyrë konstruktive një bote tërësisht të re» do të bëjë që «zemërimi të pakësohet», që Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe politika e tyre agresive të jenë më të pranueshme nga popujt(!).

Kjo do të thotë, siç e shpjegon vetë Brzezinski, se strategjia amerikane do të vazhdojë me «rritjen e fuqisë

amerikane» nëpërmjet shtimit të armatimeve sa më të sofistikuara, të rritjes së fuqisë së saj ekonomike, të ruajtjes dhe vazhdimit të politikës së nënshtrimit nën një kontroll të shumëfishtë ekonomik, politik dhe ushtarak prej saj të zonave të influencës, por duke manovruar me taktikën e njohur demagogjike të ofrimit të «karotës dhe të shkoptit» «për të ulur zemërimin» e popujve si në Iran e gjetiu.

Në këtë intervistë, duke iu referuar krizës iraniane e ngjarjeve të mëvonshme, Brzezinski pohon se politika e forcës dhe e ndërhyrjes së armatosur qëndron e palëvizshme. Ja si e shpreh këtë politikë ky zëdhënës i imperializmit amerikan: «...Nuk kam asnjë dyshim se përdorimi i fuqisë amerikane dhe gatishmëria e presidentit për ta përdorur atë në rast nevoje, nuk janë konsiderata të parëndësishme qoftë për vendin tonë, qoftë për vendet e palës tjetër». Këtu cinizmi amerikan, me të cilin trajtohet politika «antidemokratike», mbrojtja e «sovrانيتit të popujve», mbrojtja e «të drejtave të njeriut», aq shumë të trumbetuara nga Karteri, është krejt i dukshëm. Haptazi popujt e botës kërcënohen me goditje nga «forca amerikane», në rast se prekin interesat e Shteteve të Bashkuara dhe zonat e influencës së dollarit të vendosura, gjithashtu, me anë të forcës në rajone të ndryshme të botës.

Në mënyrën më të qartë, makiavelike, ndihmësi i Karterit për çështjet e sigurimit kombëtar amerikan, domethënë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në zonat e tyre të influencës në kontinente të ndryshme, thotë se në këto zona të botës «forca amerikane është burimi qëndror i stabilitetit që ekziston» dhe më poshtë shton se «ato vende që përkrahin politikën e moderuar (domethënë nuk cenojnë interesat amerikanë)... janë të ndërjegjshme për fatin e sigurimit të tyre të jashtëm dhe, si rrjedhim, edhe sigurimi i tyre i brendshëm varet shumë

nga forca amerikane e pranishme në rajon». Ky është konkluzioni i tij që, në të njëjtën kohë, është një paralajmërim në formë ultimatumi e kërcënimi ndaj popujve që janë ngritur ose po ngrihen për çlirimin e tyre kombëtar e shoqëror, kundër shtypjes e shfrytëzimit të superfuqive imperialiste e neokolonialiste.

Në këtë intervistë Brzezinski nuk thotë asgjë të re veçse konfirmon politikën e përhershme të imperializmit amerikan. Por ama në afirmimet e tij, imperializmi amerikan shpreh frikën që ka nga kryengritjet popullore që ngjiten dhe nuk e ndien veten aspak të sigurt, prandaj detyrohet të kërcasë dhëmbët e t'u thotë edhe klikave të këtyre vendeve, që kërcënohen nga popujt e tyre, se fati i qëndrimit të tyre në fuqi varet nga mbështetja te forca ushtarake amerikane. Dhe për t'u dhënë zemër vasaëve të tij, Brzezinski thotë se Shtetet e Bashkuara janë të pranishme me flotën e tyre në Gjirin Persik, se do të vëzhgojnë zhvillimin e situatave në këtë rajon dhe i siguron ata se «s'do të lejojnë ndërhyrje nga jashtë»!

Kështu, vetë imperializmi amerikan dhe socialimperializmi sovjetik tregojnë që përpara se, në komplotet për sabotimin dhe shtypjen e kryengritjeve popullore, kudo është gishti i Moskës ose i Uashingtonit. Për ta në këto kryengritje nuk ekziston faktori popull, i cili lufton për të fituar lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin që ia kanë grabitur imperialistët dhe socialimperialistët me kukullat e tyre. Me këtë botëkuptim ata duan të fshehin politikën e tyre të dominimit, të shfrytëzimit dhe të ndërhyrjes me armë, me intriga dhe me demagogji në dëm të popujve e të vendeve të tjera.

Imperializmi amerikan parashikon turbullira në të ardhmen dhe bën demagogji për ta fshehur këtë realitet. Kështu Brzezinski, ndërsa kërkon që të ndërtohet një politikë që t'u përshtatet kohës dhe rrethanave, pretendon se vendet e «botës së tretë», që formojnë shumicën,

«mbështetin» politikën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe këtë gënjeshtër përpiket ta vërtetojë e ta mbështetë në një votim të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, duke thënë se «në konfrontimin me Iranin, ne kemi një përkrahje unanime siç reflektohet në votat e Këshillit të Sigurimit 15 me 0». Mirëpo për fat të mirë revolucionet popullore nuk ndjekin rezultatet e votimeve në Këshillin e Sigurimit, por rrugën kundër atyre që votojnë për rezoluta pa asnjë vlerë për popujt e botës në këtë organ të OKB-së.

Për imperializmin amerikan kriza e madhe aktuale që ka përfshirë botën, si dhe revolucioni i popujve në ngjitje, duhet të nënshtrohen, të dominohen. Por për këtë Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk ndihen aq të fuqishme, prandaj Brzezinski hedh idenë se NATO-ja «mbetet aleanca kryesore në marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por ajo vepron në një botë në të cilën interesat tanë të sigurimit kolektiv janë zgjeruar më shumë se në të kaluarën. Sot ekzistojnë tri zona qendrore të ndërvarura siguri: Evropa Perëndimore, Lindja e Largme dhe Lindja e Mesme». Pra, vërtet Shtetet e Bashkuara të Amerikës mbrojnë Evropën Perëndimore, por kjo nuk duhet të lajë duart, si me thënë, nga ngjarjet në Azi, në Afrikë e gjetkë. Për Brzezinskiin ngjarjet dhe interesat janë të ndërvarur dhe Evropa Perëndimore nuk duhet t'i lërë vetëm Shtetet e Bashkuara të Amerikës në rolin e xhandarit ndërkombëtar. Duhet të gjithë së toku, si në mbrojtjen e Evropës Perëndimore, ashtu edhe në mbrojtjen e interesave amerikanë jashtë Evropës, të bëhen dhe ata xhandarë. Me fjalë të tjera, Shtetet e Bashkuara u thonë Francës dhe Gjermanisë Perëndimore të mos tregohen kaq «të pavarura» në vendimet e tyre në politikën që po ndjekin në pellgun e naftës, në Afrikë dhe ndaj Bashkimit Sovjetik. Imperializmi amerikan kërkon që këto shtete borgjezo-kapi-

taliste të Evropës të mos dalin nga radha, por të ecin në një çap me Karterin, siç vepron aktualisht Kina e Tenit dhe e Huasë.

Patjetër imperializmi amerikan nuk është dakord me intervistën që dha para disa ditësh presidenti i Francës Zhiskar d'Estën, në të cilën ai ngre zërin dhe thotë se Evropës duhet «t'i dëgjohet emri në botë» dhe jo t'i shuhet nga «dy të mëdhenjtë». Me fjalë të tjera, Franca predikon një bashkëpunim më të ngushtë me Gjermaninë Federale për të mbrojtur interesat e tyre ekonomike dhe politike në kontinentet e tjera e në zonat e tyre të influencës, ose në ato që do të përpiqen të krijojnë. Pra, Franca dhe Gjermania s'duan t'ua lënë të gjithë «gjahun» dy «luanëve», Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik. Ky oreks do t'u vijë më vonë edhe kinezëve që tash përpara amerikanëve sillen plot hipokrizi dhe përlulje. Japonia militariste, nga ana e saj, armatoset, forcohet, pret gjahun dhe nuk mungon herë pas here «të shtjerë pushkë» në qëndrimet mbi situatat që krijohen në kontinente të ndryshme të botës.

Brzezinski përpiket të vërtetojë se kryengritjet popullore kundër imperialistëve të huaj dhe aleatëve të tyre të brendshëm, veçanërisht në pellgun e naftës, nuk kanë karakter shoqëror dhe çlirimtar, por kanë karakter «besimi fetar», janë kryengritje «islame», krejt idealiste. Ai detyrohet të pohojë se «bota islamike po kalon një përtëritje politike dhe fetare», por, sipas mendimit të tij, nuk duhet që këto revolucione, që ai i quan «manifestime shpirtërore», të kthehen në «negative». Islamizmi, deklaroi Brzezinski, është «një besim në vet-vete», që ushtrohet nga 800 milionë njerëz. «Të mos e kthejmë islamizmin, thotë ai, në një armik të Perëndimit dhe veçanërisht të Shteteve të Bashkuara të Amerikës». Kështu Brzezinski kërkon që këta 800 milionë njerëz t'i nënshtrohen imperializmit amerikan dhe imperializmit në përgjithësi.

Pra për skllavëruesit imperialistë revolucionet kundër tyre dhe veçanërisht ato të popujve myslimanë nuk kanë karakter të çlirimit kombëtar dhe shoqëror, por karakter fetar. Feja islame konfondohe me kristianizmin dhe zgjimi i popujve për shkundjen e zgjedhës shoqërore konsiderohet vetëm si një ringjallje e besimit fetar. Sipas tyre «ksenofobia» e popujve myslimanë e ka, pra, burimin te feja. Demagogjia e imperialistëve dhe përpjekja e tyre për të mashtruar këta popuj arrin deri atje sa Brzezinski të thotë: vendet islamike «kanë një besim më të madh në vetvete; ato nuk janë më nën tutelë qoftë të britanikëve, të francezëve, apo të të tjerëve».

Natyrisht, sipas kësaj deklarate të Brzezinskit, «Shtetet e Bashkuara të Amerikës s'kanë asnjë vend ose popull nën tutelë»!

Brzezinski pranon se përpjekjet për ruajtjen e zonave të influencës mund të çojnë edhe në konfrontim midis dy superfuqive imperialiste në pellgun e vendeve myslimane. Por, sipas tij, bota myslimane, pavarësisht se midis saj dhe Shteteve të Bashkuara «ekzistojnë mosmarrëveshje gjithnjë më të mëdha», do t'i përmirësojë marrëdhëniet me ta, pse «ne jemi të interesuar për pavarësinë e të gjitha vendeve myslimane; ne respektojmë besimet e tyre fetare» etj.

Këto janë pjesë të «teorisë së re» të Karterit. Shtetet e Bashkuara të Amerikës besojnë në fenë, Bashkimi Sovjetik nuk beson, Shtetet e Bashkuara sundojnë nëpërmjet agjenturave të tyre të instaluar në këto vende nga CIA, sundojnë nëpërmjet investimeve të kapitaleve, nëpërmjet bankave, shoqërive të përbashkëta e shumëkombëshe dhe të gjitha këto të fuqizuara me baza ushtarake, me flota të fuqishme dhe me aviacion nga më të sofistikuarit, kurse Bashkimi Sovjetik, sipas Brzezinskit, «ushtron sundim të drejtpërdrejtë fizik mbi disa

dhjetëra milionë myslimanë». «Myslmanizmi me kristianizmin kanë shumë gjëra të përbashkëta», prandaj, sipas tij, «Shtetet e Bashkuara çdo gjë i bashkon me vendet myslimane, kurse me Bashkimin Sovjetik ateist ato çdo gjë i ndan»!

Ky është gjithë deduksioni i këtij imperialisti prepotent që i merr të tjerët për budallenj dhe veten e tij si shpikës të diçkaje të re që shkakton krizat dhe ballafaqimet politiko-ushtarake dhe shoqërore. Dhe, që të mashtrorë myslimanët, Brzezinski, në mes të tjerave, thotë: «...Po të isha thjesht mysliman, do t'i bëja vetes pyetjen se si mund të lidhem unë me një vend që u mohon myslimanëve të tjerë të drejtat e tyre fetare».

Popujt e botës, dhe veçanërisht popujt e atyre rajoneve të nxehta dhe shumë të nxehta që ka sot në botë, në bazë të ndodhive, të fakteve, të qëndrimeve politike dhe të veprimeve ushtarake që janë fare të qarta, duhet ta kuptojnë se të dyja superfuqitë imperialiste dhe aleatët e tyre, të organizuar në blloqe ose të lidhur e të ndërvarur me ta, luajnë në mënyrë tragjike me fatin e tyre. Çdo veprim e çdo aksion që ata organizojnë e ndërmarrin e bëjnë për interesat e tyre dhe vetëm të tyre, në dëm të interesave jetikë të popujve dhe të paqes.

Fuqitë e mëdha imperialiste luftojnë me çdo mjet të ruajnë tregjet dhe zonat e tyre të influencës që kanë sot në botë. Kur njëri e humb një treg në një zonë të dhënë, përpiqet ta sigurojë atë në një zonë tjetër, në kurriz të rivalit ose të rivalëve të tij. Këtej lindin dezbalancimet, këtej lindin dhe thellohen kontradiktat dhe mosmarrëveshjet që venë deri në konfrontime të armatosura, këtej lindin gara e armatimeve, luftërat e pjeshme lokale, që do ta çojnë njerëzimin në luftë të përgjithshme e grabitqare imperialiste.

Fuqitë imperialiste të mëdha dhe ato më pak të mëdha mendojnë, veprojnë dhe teorizojnë se janë ato që

kanë në dorë fatet e popujve dhe të njerëzimit dhe mbi këtë bazë kërkojnë t'i nënshtrojnë popujt. Këto fuqi agresive e nënvleftësojnë zhvillimin e fuqizimin dialektik të luftërave çlirimtare dhe të revolucioneve. Atyre u është errësuar pamja dhe nuk duan të kuptojnë se çdo hap i popujve përpara drejt kundërshtimit të shtypjes e të skllavërimit të dyfishtë, të jashtëm dhe të brendshëm, është një çarje që do të zgjerohet në murin e burgut kapitalist.

**Zgjidhja e popujve të botës është një fakt i pakontestueshëm. Ai ka ardhur në kundërshtim me dëshirat e imperialistëve dhe të kapitalistëve të ndryshëm.** Zgjidhja e popujve dhe luftën e tyre për fitore në fushën politike dhe shoqërore nuk e kanë sjellë as besimet fetare, as teoritë skllavëruese në shërbim të kapitalit. Pavarësisht se ç'orientim ka pasur faktori subjektiv në një kryengritje popullore, kjo kryengritje nuk mund të ketë qenë veçse një minus i rëndësishëm për regjimin e mëparshëm që sundonte dhe ky minus për reaksionin kthehet në një plus për zhvillimin e mëtejshëm të revolucionit popullor dhe për forcimin e faktorëve subjektivë përparimtarë që e çojnë revolucionin popullor në revolucion proletar.

Teoria jonë marksiste-leniniste na mëson se **thellimi i krizave në gjirin e botës kapitaliste është fillimi i agonisë dhe i gjendjes në komë i kësaj bote.** Prandaj bëhen përpjekje të mëdha nga kapitali botëror që të shpëtojë nga kjo darë e tmerrshme që e ka mbërthyer për fyti dhe që po e mbyt. Por shpëtimi është i pamundur, pse është vetë sistemi kapitalist që e krijon këtë krizë, që e ushqen, që e thellon deri në shkallën më të lartë. Kapitalizmi ka krijuar vetë varrmihësin e tij, proletariatin. Lufta e proletariatit dhe e popujve ia ka futur imperializmit «ethet e kalit». Kontradiktat ndërimperialiste janë rezultati i luftës së papajtueshme në mes proletariatit dhe borgjezisë. Tratativat dhe ujdite e përkoh-

shme koniunkturale ose me një afat relativisht të gjatë në mes imperialistëve, janë me karakter paliativ, janë të ndërtuara mbi rërë.

Në qoftë se Brzezinski e quan situatën në Bashkimin Sovjetik të pabalancuar, atëherë pse ta kenë frikë Shtetet e Bashkuara të Amerikës? Brzezinski i konsideron të konsoliduara Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Edhe kjo nuk është e vërtetë.

Agresiviteti i të dyja superfuqive është i njëjlojtë, ndërsa dobësimi i tyre shkon vazhdimisht duke u shtuar.

**Lufta e popujve, lufta e proletariatit kundër armiqve të tyre, duhet të ecë përpara, nëpërmjet krizës së madhe që ka pllakosur imperializmin botëror.**

## LAJME SENSACIONALE NGA KINA

Marrim vesh lajme të reja për çka po ndodh në Kinë. Njoftohet se atje është mbledhur Plenumi i 5-të i KQ të partisë, ku janë marrë shumë vendime. Disa prej këtyre vendimeve janë bërë të njohura nëpërmjet shtypit, si nga gazeta «Zhenminzhibao» etj., dhe janë transmetuar nga agjencia HSINHUA. Prandaj të gjitha këto lajme sensacionale e kanë burimin tek agjencia HSINHUA dhe nuk janë supozime.

Së pari, thuhet se Plenumi i 5-të i Komitetit Qendror të 11-të të Partisë Komuniste të Kinës vendosi t'i propozojë Asamblesë Popullore Kombëtare që të hiqet dispozita e nenit 45 të kushtetutës së RP të Kinës, e cila thotë se «qytetarët kanë të drejtë të flasin lirisht, të shprehin plotësisht mendimet e tyre, të zhvillojnë debate dhe të shkruajnë dacibao me hieroglifë të mëdha».

Pa fjalë të tepërta, çdo gjë kuptohet vetë, regjimi i Hua Kuo Fenit dhe i Ten Hsiao Pinit e fshiu dhe këtë «të drejtë demokratike», duke vendosur «demokracinë» ushtarake. Këtë veprim udhëheqësit kinezë e shoqërojnë me propagandën se «politika e partisë sonë është zbatimi i demokracisë socialiste, përsosja e sistemit të ligjshmërisë socialiste dhe garancia se masat kanë të drejtë të plotë dhe mundësi të shprehin mendimet e tyre mbi problemet shtetërore dhe të bëjnë sugjerime e të kritikojnë udhëheqësit e partisë e të qeverisë». Kjo s'do koment.

Së dyti, Plenumi i 5-të i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës miratoi gjoja «dorëheqjen e shokëve Van Dun Hsin, Çi Ten Kuei, Vu Teh dhe Çen Hsi Lien». Të gjithë këta ish-anëtarë të byrosë politike ishin në kundërshtim me pikëpamjet e Ten Hsiao Pinit. Në byronë politike këta ishin, si të thuash, një mbështetje për Hua Kuo Fenin. Pra, derisa ta katandisin në një kufomë, këtij ia hoqën edhe këtë mbështetje. Për ta përforcuar këtë «dorëheqje», HSINHUA-ja thotë se «sipas komunikatës së plenumit, ky vendim u mor në përputhje me mendimet e masave të gjera me dhe pa parti». Kjo është një gënjeshtër në mes të ditës.

Së treti, Plenumi i 5-të i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës rehabilitoi plotësisht Liu Shao Çinë. Në komunikatën e plenumit thuhet se «plenumi miratoi njëzëri rezolutën dhe vendosi të heqë cilësimet «renegat, tradhtar dhe grevëthyes» që i vuri shokut Liu Shao Çi Plenumi i 12-të i Komitetit Qendror të 8-të të partisë, të anulojë rezolutën e gabuar që e përjashtonte atë nga partia një herë e përgjithmonë dhe e hiqte nga të gjitha postet brenda dhe jashtë partisë». Sipas HSINHUA-së kjo ishte vepër e Lin Biaos. Kurse në të vërtetë ajo nuk ishte vepër e tij, por kryesisht ishte vepra e Mao Ce Dunit, i cili luftonte për pushtet, ashtu sikundër luftoi për pushtet edhe Liu Shao Çia.

Rehabilitimi i Liu Shao Çisë do të thotë hedhja e Mao Ce Dunit në koshin e plehrave. Natyrisht për këtë të fundit hëpërhë udhëheqësit kinezë nuk do të bëjnë një raport si ai që përgatiti Hrushovi për Stalinin, por dalngadalë do ta lënë Mao Ce Dunit në harresë dhe do të vënë në dukje meritat e Liu Shao Çisë. Me vendimin për rehabilitimin e tij përjetësohen pikëpamjet kapitaliste të grupit të Liu Shao Çisë. Kështu, për shembull, duke ndjekur traditat e kohës së Liu Shao Çisë dhe të Ten Hsiao Pinit, domethënë duke u bazuar në sistemin

e vendosur nga Kongresi i 8-të i partisë, Plenumi i 5-të i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës krijoi, gjithashtu, sekretariatit e Komitetit Qendror, në të cilin u zgjodhën, natyrisht, të gjithë ata persona që mbështetin politikën aktuale kapitaliste të udhëheqjes kineze. Si sekretar i përgjithshëm i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës u zgjodh Hu Jao Pan dhe pastaj me radhë një sërë sekretarësh, në mes të të cilëve edhe Fan Ji dhe Ku Mu, Ju Çiu Li, Jan Te Çio e të tjerë.

Ja një vendim i rëndësishëm që ka marrë tani së fundi udhëheqja e Partisë Komuniste të Kinës, që është vazhdë e traditës së krijuar nga Kongresi i 8-të. Sipas një komenti të gazetës «Zhenminzhibao» «ish-industrialistët dhe afaristët duhet të quhen «shokë» dhe të trajtohen këtej e tutje si të tillë në Kinë», thuhet në koment. «Udhëheqja e partisë, vazhdon komenti, nuk duhet të ngurrojë për t'i vënë në poste drejtuese ata ish-kapitalistë dhe agentët e tyre që kanë aftësi të posaçme, apo njohuri të veçanta dhe përkrahin vijën politike dhe praktikën e partisë komuniste».

Më poshtë komenti thekson se «Udhëheqësit jokomunistë që zgjidhen në vendet kyç me anë të zgjedhjeve, kanë të drejtë të votojnë dhe të zgjidhen ashtu si edhe komunistët e njerëzit e tjerë. Udhëheqësve jokomunistë u duhet dhënë pushteti në përputhje me postet e tyre. Anëtarët e partisë që janë vartës, duhet ta respektojnë pushtetin e tyre dhe t'i përkrahin ata në punët që u janë caktuar».

«Transformimi socialist i ndërmarrjeve tregtare dhe i ndërmarrjeve industriale private, vazhdon komenti, filloi pas çlirimit të vendit në vitin 1949, duke arritur kulmin në fushatën kombëtare të vitit 1956 (dhe kjo është politika e Liu Shao Çisë, por edhe e Mao Ce Dunit; raportin në Kongresin e 8-të, që shënon kul-

min e kësaj fushate, e mbajti Liu Shao Çia) për t'i kthyer ato të gjitha në ndërmarrje të përbashkëta shtetërore-private. Atëherë ish-industrialistët dhe afaristët punuan si drejtues apo në punë të tjera në fabrikat e ndërmarrjet tregtare që ata kishin, ndërsa merrnin kompensimin vjetor nga qeveria». Dhe më poshtë në koment thuhet: «Shumica e ish-kapitalistëve u kthyen në njerëz që jetojnë me djersën e tyre. Ata përkrahin udhëheqjen e partisë komuniste dhe socializmin, prandaj antagonizmi klasor midis tyre dhe klasës punëtore ka marrë fund». Me këtë Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Kinës i vuri pikën ndërtimit të socializmit në Kinë, dhe, siç duket qartë, kapitalistët u integruan në socializëm(!), ose më mirë socializmi në Kinë u shpartallua dhe atje u vendos një formë e hapët kapitaliste. Kjo, natyrisht, do të maskohet me propagandën se Kina «ndërton socializmin», se në udhëheqjen e Kinës pushtetin kryesor e mban gjoja Partia Komuniste e Kinës, por në bashkëpunim edhe me partitë e tjera ekzistuese, të cilat do të zgjedhin njerëzit e tyre. Për të vendosur këtë demokraci borgjeze kapitaliste, në Kinë kanë rehabilituar të gjithë kapitalistët, të gjithë pronarët, kanë lejuar që këta të vishen me pushtet dhe bile të kenë edhe ndërmarrjet e tyre private.

Komenti i gazetës «Zhenminzhibao» «marrëdhëniet e këtyre kapitalistëve me klasën punëtore» i cilëson si «marrëdhënie bashkëpunimi të mbështetura mbi bazën e shoqërisë, të farkëtuara nga interesi dhe dëshira e tyre e përbashkët për të modernizuar Kinën». Dhe për ta përcaktuar më mirë ç'janë këta industrialistë, në këtë koment vihet në dukje se «midis atyre që cilësohen ish-industrialistë dhe afaristë ka njerëz që kanë qenë tregtarë dhe artizanë të vegjël që drejtojnë dyqanet e tyre». Në fund komenti mbyllet me këto fjalë: «Këta njerëz duhen klasifikuar si punonjës të zakonshëm».

Pra, kapitalistët dhe afaristët, të mëdhenj e të vegjël, janë kthyer në «punëtorë të zakonshëm». Mbaroi faza e luftës klasore në Kinë, ose më mirë të themi filloi një fazë e re e luftës klasore, që duhet ta zhvillojë proletariati kinez në ilegalitet dhe me ashpërsinë më të madhe kundër kapitalistëve, industrialistëve dhe kastës burokratike ushtarake që erdhi në Kinë dhe që ka pushtetin shtetëror në duart e saj, që ka marrë në duart e veta ekonominë e Kinës dhe është lidhur me fuqitë imperialiste e kapitaliste të botës.

Çka kam shkruar më parë në Ditarin Politik, po vërtetohen të gjitha. Po vërtetohen pikëpamjet revizioniste e liberale të politikës së Mao Ce Dunit dhe të grupit të mëparshëm, që u luftua prej tij, i kryesuar nga Liu Shao Çia. S'kishte asnjë dyshim se transformimi që filloi në Kinë pas vdekjes së Mao Ce Dunit, do të merrte kurdoherë karakteristika të dukshme të një pushteti borgjezo-kapitalist dhe feudalo-ushtarak.

E MËRKURË  
5 MARS 1980

## NË KINË KAPITALIZMI PO VENDOSËT ME RITME TË SHPEJTA

Duke ndjekur zhvillimin e gjendjes politike në Kinë, shikoj se pikëpamjet tona, lidhur me vendosjen e kapitalizmit në këtë vend të madh, jo vetëm që janë vërtetuar plotësisht, por ritmet e vendosjes së këtij rëndi atje kanë marrë zhvillim të gjerë. Sipas të dhënave, në Kinë janë hapur 36 mijë tregje fshatare. Kjo nuk është një shifër e vogël. Në këto tregje shiten prodhime nga më të ndryshmet të fshatarëve kinezë, të cilët i mbjellin tokat e tyre me kultura të shumëllojta për të rritur të ardhurat. Agjencia HSINHUA njofton se fitimet nga tregu fshatar vitin e kaluar arritën në 1 miliard e 700 milionë juanë. Kështu që, sipas kësaj agjencie, është krijuar mundësia që «800 milionë fshatarë» të shtojnë të ardhurat. Shteti gjoja cakton çmimet brenda disa kufijve, por në kushtet kur në Kinë, në fshat dhe në qytet, po zhvillohet kapitalizmi, çmimet nuk mund të përcaktohen, sepse hyn në mes ligji i konkurrencës borgjeze, kapitaliste.

Kështu, përveç masave të shumta që ka marrë udhëheqja aktuale revizioniste kineze në qytete, në fabrika e në tregti etj., duke sjellë kapitalistët e shpronësuar në udhëheqje, bile duke marrë edhe vendime të tilla si ai i plenumit të fundit të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës, që të gjithë komunistët

t'u binden kapitalistëve që drejtojnë në ndërmarrje të ndryshme, edhe në fshat po ringjallet kulakëria. Nga dhënia ose shtimi i numrit të pronave personale për çdo fshatar për hesapin e tij do të zhvillohet më tej prona kapitaliste në fshat e, natyrisht, do të shkatërrohen komunat popullore, të cilat do të ndërtohen sipas tipit jugosllav ose më mirë sipas tipit të ndërmarrjeve kapitaliste amerikane.

Të gjitha këto vendime merren dhe vazhdojnë të thellohen akoma më shumë në lidhje të ngushtë me forcimin e pozitave të Ten Hsiao Pinit në udhëheqje. Siç e dimë, aktualisht ky kapitalist është bërë i fuqishëm pa qenë nevoja, hëpërhë, t'i zërë vendin ose të mënjanojë Hua Kuo Fenin nga postet që ky mban akoma tani për tani. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se në kongresin e ardhshëm, që po përgatitin kinezët, nuk do të merren edhe masa të tjera si ato që u morën këto ditë nga plenumi i KQ në lidhje me përjashtimin e katër anëtarëve të byrosë politike, që ishin mbështetja e Hua Kuo Fenit.

Në qoftë se do të lexojmë shkrimin me titull «Fjala e Ten Hsiao Pinit në plenumin e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës, në mars të vitit 1979», të botuar në gazetën franceze «Liberation», të bie në sy toni prepotent dhe arrogant i tij. Pavarësisht nëse është apo jo i vërtetë ky shkrim, toni i Tenit në të është i dukshëm që nga kreu e deri në fund.

Midis të tjerave, në këtë fjalim ai ka thënë se «gjatë 10 vjetëve të fundit në radhët e partisë sonë janë rrënjësuar zakone të këqija. Ato formojnë një abses të qelbëzuar që mund të shpërthejë në çdo çast nëse nuk e operojmë, sado me dhimbje që të jetë operacioni. Ja, e tillë është tani gjendja».

Teni ka thënë, gjithashtu, se e kanë akuzuar për humbjen që pësoi Kina në luftën kundër Vietnamit,

ku janë bërë sakrifica e është derdhur gjak kinez, dhe thotë përse duhet të akuzohet ai për këtë çështje, apo pse duhet gjetur patjetër një fajtor? Pas kësaj ai bën pyetjen: «Si mund të drejtosh vendin në një situatë të tillë me tension?».

Unë jam i bindur se këtë shkrim vetë kinezët e kanë dërguar për ta botuar jashtë. E them këtë, se zakonisht fjalimet që mbahen në Komitetin Qendror të PK të Kinës është e zorshme t'i marrë një gazetë e huaj, si në rastin konkret gazeta «Liberation», e cila e paska marrë shpejt e shpejt dhe e ka botuar! Kjo është një praktikë e njohur e kinezëve, të cilën ata e kanë përdorur shpesh. Bile kinezët janë shprehur edhe hapur në këtë drejtim. Dihet, për shembull, se Huan Huaja, ministri i Punëve të Jashtme të Kinës, në një fjalim që ka mbajtur me kuadrot, të cilin unë e kam komentuar gjerësisht që në prill të vitit 1978, ka thënë se, kur s'është nevoja të flasim drejtpërdrejt, ne mund t'i shprehim mendimet tona nëpërmjet të tjerëve.

Prandaj mendoj se këtë fjalim të Ten Hsiao Pinit e kanë nxjerrë jashtë Kinës vetë kinezët për t'ia bërë të njohur botës. Në këtë fjalim Teni thotë se «duhet zhdukur organizata në mbrojtje të të drejtave të njeriut dhe të pengohen masat e popullit që të kritikojnë partinë, qeverinë dhe ushtrinë; duhet shtypur kundërrevolucionin». Me fjalë të tjera ai kërkoi që në këtë drejtim të merren masa dhe, në fakt, u vendos të ndryshohet kushtetuta. Pra, në kongresin e ardhshëm të partisë kineze do të ndryshojnë edhe statuti i partisë, edhe kushtetuta. Në çdo kongres të Partisë Komuniste të Kinës hartohen nga një kushtetutë e re dhe nga një statut i ri, sipas nevojave që ka udhëheqja e re që merr fuqinë ose grupi që sundon në parti e në shtet, i cili e ka siguruar këtë sundim nëpërmjet puçeve, duke rrëzuar grupet e tjera kundërshtare.

Për sa u përket vështirësive ekonomike, Teni mbron tezën se «orquestra luan shumë bukur dhe radhët e prapme nuk arrijnë pas atyre që ecin përpara, tempi prishet, kurse abuzimet bëhen gjithnjë e më të mëdha. Abuzime ka pasur edhe në të kaluarën, por kjo bëhej për të marrë dy paund mish derri, një paund sheqer, ose dy bileta treni dhe një triskë për dhjetë jard pël-hurë». (Këtë na e ka thënë neve vetë Mao Ce Duni.) Kurse tani tregtia, sipas Ten Hsiao Pinit, «bëhet midis ndër-marrjeve dhe njësive prodhuese» dhe shton se bëhen abuzime të mëdha, po vidhet, po rrohet në luks, nuk i jepet llogari shtetit etj., etj.

Kur ndodhin gabime, thotë më në fund Ten Hsiao Pini, «njerëzit ia lënë fajin dhe përgjegjësinë atij që është më lart. Po unë kujt mund t'ia lë?». Dhe vazhdon: «Unë kam mundësi që vetëm t'i propozoj kryetarit Hua Kuo Fen të ulemi të gjithë së bashku në tavolinë për të analizuar çështjen, t'i mendojmë të gjitha, të gjejmë shkaqet e këtyre problemeve pa u ngutur, për të gjetur zgjidhje. Ja, kjo është gjithçka që mund të bëj unë».

Me fjalë të tjera kjo do të thotë që fajin për këto gjëra natyrisht e ka Mao Ce Duni dhe «katërshtja», kurse pas vdekjes së Maos fajin e kanë Hua Kuo Feni dhe njerëzit që e mbështetnin atë e që siç thashë, u eliminuan në mbledhjen e plenumit që, u mbajt kohët e fundit. Si përfundim, kjo thënie e Ten Hsiao Pinit, që duhet të jetë vërtet e tij, i përgatit një të ardhme të zezë, në plenumet e tjera ose në kongresin e ardhshëm, kryetarit Hua Kuo Fen.

E SHTUNË  
8 MARS 1980

## MBI PK TË PUNËTORËVE E FSHATARËVE TË IRANIT

Sekretari i përgjithshëm i Partisë Komuniste të Punëtorëve e Fshatarëve të Iranit, e quajtur edhe «Tufan», ndodhet në vendin tonë. Më 6 mars shokët tanë patën një takim me të. Mbase lexova informacionin mbi këtë takim, nxora këto konkluzione:

Duhet marrë me shumë rezervë thëniet e tij për ekzistencën e një «partie komuniste të gjerë» relativisht komuniste, për çështjen e «demonstratave» të tyre me pjesëmarrjen e 10 mijë vetave etj. E pakta që mund të themi për këtë person është kjo: jo vetëm ideologjikisht që është i ulët, por edhe politikisht nuk i kupton zhvillimet në Iran, lëre si duhet t'i kuptojë një komunist, por as si Bani Sadri, për shembull, që është një element borgjez liberal.

Ky sekretar i përgjithshëm i kësaj partie, duke kujtuar se neve na pëlqejnë mendimet e tij prej matamori donkishotesk, kërkon të hiqet si majtist kur thotë se është për marrjen e pushtetit, por çështjen se si e kur merret pushteti dhe ç'duhet bërë për ta mbrojtur e për ta mbajtur këtë pushtet, ai e prek fare pak ose më mirë të themi s'i bie fare kësaj pune. Ky njeri gjoja analizon forcat politike në Iran, por analiza e tij nuk është e saktë dhe as marksiste. Ai nuk i përcakton qëndrimet e partisë së tij në lidhje të ngushtë me gjendjen ekzis-

tuese në Iran, por «përcakton» aleancat klasike dhe pikërisht në këto situata të zhvillimit të revolucionit iranian, të ndeshjes së klasave për problemet politike, ideologjike, ekonomike dhe ushtarake. Prandaj them se ky ose është një element i paqartë, ose nuk dëshiron që të pranonohet. Në mendimet e tij ka kontradikta dhe kjo rrjedh nga moskuptimi i karakterit të kryengritjes popullore në Iran. Ai ka mendimin se revolucioni antiimperialist iranian nuk është i tillë, shtetëzimet nuk janë shtetëzime, megjithëse pranon që atje janë shtetëzuar banka e ndërmarrje të mëdha kapitaliste. Këto ai i quan truke të borgjezisë në favor të imperializmit. Pastaj ai vazhdon të thotë se punëtorët janë të pakënaqur e bëjnë greva. Po aq më mirë që janë të pakënaqur, bile të bëjnë sa më shumë greva. Komunistët iranianë duhet t'i mbështetin e t'i përforcojnë veprimet e tyre, të futen në radhët e punëtorëve, të fshatarëve e të intelektualëve përparimtarë e t'i sqarojnë këta për misionin që duhet të kryejnë. Por mendoj se ata nuk i kuptojnë fare, ose nuk duan t'i kuptojnë këto çështje. Bile nuk kuptojnë as qëndrimet e Partisë sonë dhe arrijnë në të njëjtat mendime që shprehin armiqtë tanë kundër vijës së Partisë sonë.

Këta komunistë iranianë nuk janë në gjendje të kuptojnë se në ç'drejtime duhen mbështetur Khomeini, Bani Sadri etj., dhe në ç'pikëpamje duhen luftuar, kur dhe si duhen luftuar ata. Politikën e aleancave, duke ruajtur parimet dhe personalitetin e partisë, të cilat ai më shokë as i llogaritin fare, nuk dinë si ta bëjnë, sepse nuk e njohin gjendjen në vendin e tyre, mbasi nuk kanë jetuar pranë popullit, por kanë qenë të shkëputur prej tij. Ata janë kthyer nga emigracioni, ku ushqeheshin nga lloj-lloj «teorish» e platformash politike e subversive. Këta më shumë i preokupon ajo çka thonë komunistët marksistë-leninistë gjermanë, që, sipas nesh, kanë mendi-

me të drejta mbi lëvizjen në Iran, sesa ç'duhet të bëjnë vetë brenda vendit të tyre.

Me fjalë të tjera, ashtu si Qazim Koculët e Ali Këlcyrët që erdhën në Shqipëri me ushtritë italiane për të bërë «politikë patriotike», kështu janë kthyer në Iran edhe këta Qazim Koculë e Ali Këlcyrë iranianë. Sidoqoftë, ne duhet t'ua shpjegojmë me durim e kujdes, por edhe prerë, se pikëpamjet tona për kryengritjen popullore në vendin e tyre janë ato që kemi shprehur botërisht. Ne t'u themi në mënyrë të qetë se aty ku s'puqemi nuk puqemi dhe ata le të vendosin vetë në partinë e tyre, kurse ne qëndrojmë në vijën tonë. Qëndrimet tona për çështjen e Iranit t'i mbrojmë pa dorashka dhe me argumente t'ua hedhim poshtë përfytyrimet dhe imagjinatat e tyre të sëmura, sipas të cilave, shqiptarët mund që mbajnë një qëndrim të tillë ndaj qeverisë irانية për të dalë nga «izolimi» që na ka shkaktuar prishja me Kinën.

Me fjalë të tjera, këta komunistë mendojnë se qëndrimet tona janë të lidhura me nevojën për të dalë nga «izolimi» dhe për këtë bashkohemi ose mbrojmë politikën borgjeze kapitaliste të Ajatollah Khomeinit, të Bani Sadrit etj. Jo, atyre duhet t'ua bëjmë të qartë se ne nuk mbrojmë politikën e tyre, por mbrojmë revolucionin popullor iranian dhe mendojmë se komunistët iranianë në këtë revolucion në vendin e tyre duhet të mbështetin aspiratat e popullit dhe të kërkojnë që reformat, që duhet t'i kryejë ky revolucion me karakter demokratiko-borgjez, të realizohen hap pas hapi. Realizimi i tyre, natyrisht, nuk është aq i lehtë dhe në këto situata nuk mund të shkohet si në dasmë, me një lugë të zbrazët në brez, siç mendojnë këta komunistë, të cilët mjaftohen të thonë vetëm që janë për marrjen e pushtetit. Sigurisht, komunistët janë për marrjen e pushtetit, por puna është si duhet marrë ky pushtet. Për këtë duhet të kalojë shumë

ujë nën urat e lumenjve iranianë, duhet të derdhet shumë gjak, pse as feudalët, as Khomeini, as Bani Sadri dhe partitë e tyre nuk e lejojnë aq kollaj t'u merret pushteti nga duart. Prandaj komunistët iranianë duhet të reflektojnë shumë më thellë në këto probleme kaq të rëndësishme për ta.

Në fakt ata jo vetëm nuk i kuptojnë mirë këto probleme, por edhe partia e tyre nuk do të jetë ndonjë gjë e madhe, se dy vjet ka që është formuar, siç tha sekretari i përgjithshëm i saj. Megjithatë brenda radhëve të saj ka pasur përçarje, e cila u shkaktua gjoja nga mosmarrëveshjet e atyre që punonin brenda dhe këtyre që u kthyen nga emigracioni. Por që të dyja palët i kanë të turbullta parimet e marksizëm-leninizmit dhe nuk dihet çfarë kanë në kokë e në zemër. Lufta e tyre në të ardhmen do të na sqarojë më mirë nëse janë me të vërtetë marksistë-leninistë revolucionarë apo një grup llafazanësh në shërbim të revizionizmit modern dhe të fuqive të ndryshme kapitaliste.

E HËNË  
10 MARS 1980

## BISEDIME PËR FASADË

Kina i ndërpreu të ashtuquajturat bisedime me Vietnamin. Këto bisedime, natyrisht, zhvilloheshin sa për të kaluar kohën, ose më mirë me thënë që Kina të krijonte përshtypjen se pas «mësimit» që i dha Vietnamit duke e sulmuar, e ktheu gjendjen nga e nxehtë që ishte, në situatë «paqësore». Por, siç duket, delegatët kinezë u lodhën dhe Pekini vendosi t'u japë mundësi «të pushojnë» njëfarë kohe. Vietnamezët, nga ana e tyre, kanë vajtur në këto bisedime për t'i treguar Kinës dhe botës se ata kurdoherë, kur ngjasin konflikte të armatosura ose jo të armatosura, janë për bisedime, njëkohësisht janë për gjetjen e një zgjidhjeje të mundshme të çështjes kamboxhiane, kuptohet, në favor të tyre. Kështu që të dyja palët këto bisedime i përdorin për fasadë, i pari, i madhi, për të fshehur qëllimet e tij agresive ndaj Vietnamit dhe i dyti, i vogli, për të fshehur qëllimet e tij agresive ndaj Kamboxhias. Kështu as Vietnami s'heq dorë nga pushtimi i Kamboxhias, as Kina nuk heq dorë nga agresioni i saj ndaj Vietnamit.

Të dy, pra, janë hileqarë, por tani që i pari largohet nga tryeza, i dyti gjoja bën politikë dhe fajin për ndërprerjen e bisedimeve kërkon t'ia lërë në kurriz Kinës së Hua Kuo Fenit. Për këtë vietnamezët deklaruan publikisht nëpërmjet Ministrisë së tyre të Punëve të Jashtme se «janë për vazhdimin e bisedimeve me Kinën»

dhe thonë se «kjo bëri një gabim trashanik» që i ndërpreu ato; demaskojnë edhe arsyen e ndërprerjes së këtyre bisedimeve, domethënë kërkesën e kinezëve që Vietnamit të tërheqë trupat pushtuese nga Kamboxhia dhe «t'i lërë kamboxhianët të vendosin vetë për fatin e tyre». Kinezët pra, jo vetëm i quajnë vietnamezët agresorë, por, nga ana tjetër, lënë të kuptohet se e mbështetin të ashtuquajturën qeveri të Kieu Samfanit, ku me siguri rron dhe lufton edhe banda e vjetër kamboxhiane me Pol Potin, Jeng Sarin e të tjerë.

Për vietnamezët kjo do të thotë se Kina qëndron si shpata e Damokleut mbi kokën e Vietnamit derisa ky të heqë dorë nga pushtimi i Kamboxhias dhe t'i lërë vendin asaj, duke i krijuar mundësi të vërë dorë mbi Kamboxhian, që andej mbi Laosin dhe ta rrethojë Vietnamin. Pastaj e sulmon apo nuk e sulmon, është tjetër problem.

Lidhur me këtë ndodhi, Kieu Samfani mori valixhen dhe këto ditë po bën vizita në Kinë e në Kore. Në Kinë atë e pritën me salltanet. Hua Kuo Feni doli në aerodrom, kurse «më i vogli», por, në fakt, «më i madhi» në pozita, nuk doli. Ky shkurtabiq, që e ka emrin Ten Hsiao Pin, dhe që kohët e fundit është bërë i plotfuqishëm në Kinë, e priti Kieu Samfanin në rezidencën e tij. Pra, Hua Kuo Feni del në aerodrom, kurse Ten Hsiao Pini rri në shtëpi dhe i pret vizitorët «e shquar» në audiencë.

Natyrisht, sipas lajmeve, në fjalimet që mbajtën në aerodrom e në banquet, Hua Kuo Feni foli «për miqësinë e madhe e të sinqertë që Kina ushqen për Kamboxhian demokratike» dhe Kieu Samfani «për miqësinë e madhe që lidh Kamboxhian me Kinën dhe për ndihmën e madhe që kjo i jep Kamboxhias». Kieu Samfani tha se lufta e popullit kamboxhian kundër pushtuesve vietnamezë vazhdon dhe do të kurorëzohet me fitore.

Pas dy ditësh qëndrimi në Pekin, mysafiri nga Kamboxhia shkoi te miku tjetër i tij, Kim Ir Seni. Naty-

risht, ky nuk denjoi të dilte në aerodrom, por e priti në shtëpi, ku biseduan përzemërsisht. Ndërkohë, miku i tij i vjetër, Sihanuku, të cilit Kimi i ka ndërtuar edhe një pallat në Phenian, ka shkuar në Kanada prej nga flet kundër Kieu Samfanit, Pol Potit dhe të gjithë atyre që i mbrojnë këta.

Pra, shohim se si shpejt e shpejt ndërrojnë vend pozitave e mbajtura si nga kinezët, ashtu edhe nga koreanët. Hua Kuo Feni dhe Kim Ir Seni një herë mbështetin Pol Potin, një herë tjetër Sihanukun, tani Kieu Samfanin e kështu me radhë. Kjo është politika e ndërrimit të këmi-shëve, politikë që, natyrisht, ka edhe pasojat e saj të hidhura.

Kina jo vetëm që armatoset, por rreth Vietnamit ka grumbulluar ushtri dhe nuk qëndron pa e provokuar këtë herë pas here, derisa të përgatitë terrenin për të bërë edhe ndonjë skandal të ri që do të kushtojë edhe disa qindra mijë të tjerë të vrarë dhe do ta përhapë zjarrin në gjithë Azinë Juglindore.

Nëpërmjet Tajlandës Kina e ndihmon fuqimisht me armë, me ushqime e me veshje ushtrinë partizane të Kieu Samfanit, e cila është e organizuar në formë çetash të vogla, që e zhvillojnë luftën me taktikën partizane në xhungla dhe e shqetësojnë ushtrinë vietnameze. Kjo është e shtrënguar të zhvillojë një luftë me forca të mëdha, por ka vështirësi, sepse lufton në një vend të huaj, populli i të cilit nuk e do, e urren dhe ia saboton përpjekjet kolonialiste. Qeveria e Heng Samrinit, natyrisht, një qeveri kukull e vietnamezëve, nuk dëgjohet, ajo është qeveri e fasadës, bën ndonjë deklaratë dhe kaq, kurse populli kamboxhian vuan të zité e ullirit, në mjerim, uri e sëmundje dhe i hallakatur në të ashtuquajturat qytete e fshatra të djegura ose në xhungla, nëpër çadra.

Megjithëse sulmi i vietnamezëve ndaj Kamboxhias mund të ketë pasur edhe «arsye», si kundërpërgjigje e

agresionit të anës tjetër, të udhëhequr nga Pol Poti, prapëseprapë është një agresion dhe e ka vënë Vietnamin në pozita shumë të vështira, politike dhe ekonomike e me një perspektivë të errët për sa i përket vazhdimit të kësaj aventure.

Situata brenda në Vietnam është e turbullt. Atje, siç e dimë, u bënë ndryshime në udhëheqje dhe i plotfuqishëm është Le Zuani, pastaj Xhiapi dhe Fam Van Dongu, megjithëse ky, sipas të dhënave të agjencive të lajmeve, nuk e ka atë pozitë të fortë politike që kishte më parë. Kjo, thuhet, për arsye pleqërie ose sëmundeje, por duhet të jetë për qëndrime politike të kundërta lidhur me çka po ngjet tani në Vietnam, pavarësisht se edhe Fam Van Dongu është një nga arkitektët e këtyre ngjarjeve të paqarta, të lëkundshme dhe tragjike që po zhvillohen në Vietnam.

Vietnami i Jugut, i cili qysh pas çlirimit u bashkua me Vietnamin e Veriut dhe formuan një republikë të vetme me kryeqytet Hanoi, është, si të thuash, në të njëjtën gjendje që ka qenë më parë. Pas luftës, në Vietnamin e Jugut vietnamezët nuk mundën të vendosnin dot po atë organizim politik dhe ekonomik, po atë ndërtim organizativ, siç ekzistonin këto, natyrisht të dobësuar nga lufta, në Vietnamin e Veriut. Kështu që tani ata po detyrohen të lejojnë zhvillimin e tregtisë private, të mbyllin sytë përpara tregut të zi, tregut privat dhe nuk po i ndërtojnë kooperativat bujqësore. Me fjalë të tjera, elementët e borgjezisë dhe të reaksionit vazhdojnë të rrojnë, të punojnë e të shfrytëzojnë masat nën maskën e regjimit pseudosocialist të Veriut.

Turbullirat që ndodhën në Vietnamin e Jugut dhe në Vietnamin e Veriut, për sa u përket masave që u morën ndaj kinezëve të pasuruar nga lufta e që banonin në Vietnam, pas arratisjes me shumicë të shumë prej këtyre, gjë që shkaktoi skandal ndërkombëtar, duke e ulur

autoritetin e Vietnamit në sytë e popujve të botës, i detyroi vietnamezët, edhe pas goditjes që u bëri Kina, të marrin masa të brendshme më të rrepta, por njëkohësisht t'i lëshojnë terren zhvillimit të ekonomive private.

Me sa kuptohet, regjimi në Vietnam është në pozita të vështira politike, ekonomike e organizative. Aktualisht Vietnami nuk mund t'ua kushtojë kujdesin kryesor zhvillimit dhe ndërtimit të vendit, ekonomisë së shkatërruar nga kjo luftë kaq e gjatë. Me agresionin mbi Kamboxhian zgjatet më tepër gjendja e mjeruar për këtë popull trim dhe heroik. Vietnamit i duhet të mbajë një ushtri të madhe në këmbë, përveç faktit që kjo ushtri ndodhet në gjendje lufte dhe në goditje të vazhdueshme nga forcat partizane të Kieu Samfanit. Megjithëse nga Kamboxhia Vietnami tërheq artikuj ushqimorë, se gjë tjetër atje nuk ka, prapëseprapë kushtet e luftës nuk i sjellin asnjë fitim shtypësit dhe agresorit të ri në Indokinë.

Aleanca me Bashkimin Sovjetik mund t'i sjellë ndonjëfarë ndihme Vietnamit, por kjo ndihmë nuk është veçse me karakter ushtarak, e cila, edhe në qoftë se ekziston, është e paktë. Ushtria vietnameze është e armatosur me ato mjete që ka pasur gjatë kohës së luftës kundër amerikanëve dhe me ato armë e municione që u kapën kur u çlirua vendi. Pra, ndihma politike e Bashkimit Sovjetik nuk ka as atë efekt, as atë peshë që udhëheqësit e Vietnamit kanë menduar të nxjerrin nga nënshkrimi i traktatit të miqësisë dhe të bashkëpunimit me të, pavarësisht se udhëheqësit e futën Vietnamin edhe në KNER.

Rreziku dhe kërcënimi i një sulmi tjetër nga ana e Kinës ndaj Vietnamit vazhdojnë dhe do të vazhdojnë. Tani së fundi Huan Huaja, ministër i Jashtëm i Kinës, filloi një turne në Filipine, në Tajlandë, në Singapor e gjetkë, sigurisht për të forcuar «miqësinë» e këtyre shteteve me Kinën, por dhe për të shtrënguar darën kundër Vietnamit dhe synimeve hegjemoniste të Bashkimit So-

vjetik në pellgun e Lindjes së Largme e të Lindjes së Mesme.

Aleati i bindur dhe i sjellshëm i amerikanëve, Kina e Ten Hsiao Pinit dhe e Hua Kuo Fenit, njëkohësisht me lojën e vet, bën edhe lojën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në të gjithë pellgun rreth Lindjes së Largme dhe Azisë Juglindore, por si partner i dorës së dytë e të tretë. Këtë Kina e bën me qëllim që të krijojë një situatë të favorshme për imperializmin amerikan, japonez dhe për imperialistët e tjerë, që të konsiderohet prej tyre si një barrikadë kundër ekspansionit sovjetik dhe të merren kështu prej tyre kreditë aq shumë të dëshiruara nga ana e saj dhe aq shumë të nevojshme për ta bërë ekonominë kineze një ekonomi të fortë ushtarake dhe social-imperialiste. Për këtë gjë ne shohim që Kina, nga njëra anë, luan rolin si një sufifre<sup>1</sup> i Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe i kapitalizmit botëror në përgjithësi, dhe, nga ana tjetër, në mënyrë të heshtur dhe pa bujë, lidh kontrata ekonomike dhe ushtarake me këto shtete kapitaliste e imperialiste, duke ia shitur veten politikisht dhe ekonomikisht një shoqërie të re kapitalistësh që po ngrihet në Kinën e Mao Ce Dunit.

Vendimet që merren në Kinë kanë për qëllim demaskimin e plotë të figurës së Mao Ce Dunit. Këtë e bëjnë me dorashka, por konkretisht rehabilitimi i armikut kryesor të Mao Ce Dunit, ish-presidentit Liu Shao Çi, është kapaku që Teni i vuri luftës që po zhvillon kundër maocedunidesë dhe grupit që udhëhiqte më parë. Për fat të keq të Tenit ky grup është shumë i madh dhe influenca e Maos nuk është e vogël në Kinë, prandaj në rrugën për realizimin e këtyre qëllimeve të tij, si dhe në aleancat e tij të brendshme e të jashtme, ai nuk do të shkasë si në gjalpë, por do të hasë vështirësi.

<sup>1</sup> Nga frëngjishtja: Sous-fifre — vartës.

E DIEL  
16 MARS 1980

## POLITIKA E «MOSANGAZHIMIT» — NJË KËSHTJELLË E NDËRTUAR MBI RËRË

Politika e jashtme jugosllave është po aq e ççroditur dhe e lëkundshme, sa edhe ajo e brendshmeja. «Kali» i luftës së titistëve është politika e «mosangazhimit», mirëpo ky «kalë» po çalon nga të dyja këmbët dhe tash, me vdekjen e kavalierit aventurier plak, Titos, edhe ai do të ngordhë.

Zaten kjo politikë, në qoftë se mund ta quajmë kështu, ishte një fikSION, një kështjellë e ndërtuar mbi rërë, jo pa qëllime të caktuara. Ajo ishte një *modus vivendi* i sajuar nga kapitalizmi botëror që ky i fundit të ruante perandorinë e tij neokolonialiste duke gënjyer popujt se gjoja politika që ndiqnin udhëheqësit e këtyre vendeve «të paangazhuara», por që në fakt ishin satelitë të imperializmit amerikan dhe të fuqive të tjera kapitaliste, ishte një politikë «e pavarur e jashtë blloqeve».

Natyrisht, dy superfuqitë imperialiste, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Sovjetik, nuk mund t'i futnin vendet e zonave të tyre të influencës në blloqet ushtarake, siç janë NATO-ja dhe Traktati i Varshavës, sepse atëherë këto superfuqi do të rrezikoheshin orë e çast në konflikte ekonomike ose ushtarake, që nuk do të kishin më karakter lokal, sepse do të ktheheshin në zona influence edhe për anëtarët e tjerë të blloqeve dhe

do të nxitnin jo vetëm luftën lokale po e po, por edhe luftën botërore.

Këto vende «të paangazhuara», ose, siç pretendojnë titistët, që ndjekin një politikë «të paangazhuar», apo vendet e «botës së tretë», ose ato të zonave të influencës së njërës apo të tjetrit vend kapitalist të industrializuar, janë, si të thuash, shtete notuese, shtete që kanë lëkundje të vazhdueshme politike në ekonomi, pse politika e tyre është një apendiks në mëshirën e kirurgut të madh, i cili e operon ose nuk e operon, sipas koniunkturave që krijohen.

Të gjitha këto vende dhe shtetet e tyre janë të krimbura në borxhe, pra, ekonomia e tyre është një apendiks i sëmurë i kapitalit të madh botëror, i cili bën ligjin në këto vende, dikton politikën, mban ose rrëzon klikat që i udhëheqin ato, sipas nevojave dhe politikës së shoqërive të përbashkëta të kapitalit të madh financiar.

Popujt e këtyre vendeve vuajnë nga çdo pikëpamje, fuqitë e mëdha kapitaliste kanë ndërtuar në to një strukturë dhe një infrastrukturë të atillë që të mund të sigurojnë shtypjen dhe shfrytëzimin e popujve, të cilët me anën e fokuseve të një loje gjoja demokratike, parlamentare, i gënjejnë duke u krijuar përshtypjen se janë të lirë, të pavarur e sovranë.

Në Gjirokastrë populli thotë: «Dhentë e dhinë e Zeres, nami i Hasan Qeres». Kështu ngjet edhe me politikën e «të paangazhuarve». Kjo politikë **bëhet dhe financohet nga imperializmi amerikan, aprovohet në përgjithësi nga aleatët e vet dhe trumbetohet nga Titoja**. Më parë trumbetohej edhe nga Naseri, nga Nehruja, nga Nkvrume Nkruma e nga Sukarnoja, por, me vdekjen ose largimin e këtyre të fundit nga skena, mbeti vetëm një «kalë Troje», që gjoja ishte udhëheqësi i politikës së «të paangazhuarve». Ky ishte Titoja i Jugosllavisë. Në realitet, Titoja, gjatë gjithë veprimtarisë së tij, s'ka qenë tjetër

veçse një agjent i imperializmit amerikan, i cili e mbante në këmbë për qëllime të caktuara dhe Jugosllavia e tij shembull i një vendi «socialist», të pavarur nga Moska, një element «me rëndësi» në skakierën ndërkombëtare dhe një shembull për vendet e porsakrijuara pas Luftës së Dytë Botërore, që i kishin ndërruar padronët e dikurshëm dhe ishin futur nën influencën e kolonizatorëve të rinj, imperialistëve amerikanë, të dalë të fuqishëm nga lufta, për t'u treguar se ç'rrugë duhej të ndiqnin për të rrojtur me krodhat që do t'u jepte ky imperializëm.

Investimet amerikane, angleze, franceze, gjermane etj. në Jugosllavi kanë qenë shumë të mëdha dhe fryt-dhënëse për kapitalistët, si në fushën ekonomike e politike, ashtu edhe nga pikëpamja e forcimit të pozitave të tyre ushtarake. Për imperializmin amerikan dhe kapitalizmin botëror Jugosllavia ishte një bastion politik kundër Bashkimit Sovjetik, kundër vendeve të ish-demokracisë popullore dhe njëkohësisht një *glacis* ushtarak midis NATO-s dhe Traktatit të Varshavës. Them se ishte një bastion politik, mbasi ky shtet kapitalist, i krijuar gjatë periudhës së pasluftës, duke pretenduar se ndërtonte një socializëm specifik, do të shërbente si një nxitës dhe element subversiv në vendet satelite të Bashkimit Sovjetik, do të ishte një përçarës i «unitetit» të Bashkimit Sovjetik revizionist me satelitët e tij dhe me partitë e tjera revizioniste të Evropës Lindore dhe të Evropës Perëndimore.

Pra, Titoja, me politikën e tij «të paangazhuar», të sajuar nga imperializmi amerikan, do të arrinte tok me liderët e tjerë të kësaj politike, që i përmendëm më lart dhe që tash kanë vdekur, të krijonte një kope dhensh, pa kokë dhe pa këmbë, por me një tabelë ku të lexohej vende «të paangazhuara», me një politikë specifike, që gjoja i dallonte dhe i vinte në kundërshtim me politikën e blloqeve. Të gjitha këto vende, të ashtuquajtura të pa-

angazhuara, por që ishin nën influencën ekonomike e politike dhe nën mbrojtjen e imperializmit e të kapitalizmit, ushqenin iluzionin se gjoja në mbledhjet e tyre të herëpashershme manifestonin vullnetin e tyre «të madh» dhe kundërshtimin e politikës së fuqive të mëdha e të blloqeve.

Mirëpo në këtë lojë të politikës ndërkombëtare Bashkimi Sovjetik nuk mbeti pas Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kishte edhe ai zonat e tij të influencës që përbëheshin nga shtete gjoja të pavarura nga ai nëpër kontinente, ku jo vetëm politika e Bashkimit Sovjetik, por edhe investimet ekonomike që bënte ai, luanin një rol të rëndësishëm. Këto shtete lejoheshin të bënin pjesë «në botë» dhe të zhvillonin një politikë pseudo të paangazhuar. Ç'humbitnin? As Bashkimi Sovjetik nuk humbiste gjë, as satelitët e tij, për arsye se kjo «botë e paangazhuar» nuk merrte asnjë angazhim, secili prej këtyre shteteve, në raport me vendin prej nga varej, çdo klikë që sundonte në to, bënte atë politikë e cila i siguronte më shumë fitime dhe, kur gjente çastin më të volitshëm, mund të kalonte nga njëra varësi në tjetrën, pra, nga një zonë influence në një zonë tjetër. Natyrisht kjo bëhej me fërkime, gjë që u duk edhe në votimet e Kombeve të Bashkuara, ku më parë votat ishin ndarë sipas blloqeve, kurse më pas ato filluan të lëkundeshin sa andej-këndej. Pavarësisht se këto votime s'kishin asnjë rëndësi, loja luhej në prapaskenë në mes fuqive të mëdha. Në Kombet e Bashkuara makina e votës ishte e njëjlojtë me votimet që bëheshin në parlamentet e vendeve borgjezo-demokratike.

Mirëpo në këto vende «të paangazhuara» nuk ndihej vetëm influenza e blloqeve, siç pretendon titizmi, që thotë se s'mund të ketë «liri të plotë» përderisa ekzistojnë blloqet, por ndihej edhe influenza e pjesëtarëve të këtyre blloqeve veç e veç, të cilët brenda në bllok kishin

kontradikta edhe politike, edhe ekonomike dhe secili kërkonte të ruante e të shtonte zonën e influencës në kurrizin e aleatëve të tij dhe ato të NATO-s edhe në bllokun sovjetik. Kështu që politika e «të paangazhuarve» nuk i pengonte as Francën, as Anglinë, as Republikën Federale të Gjermanisë etj., të përhapeshin si vaji në lakra, mbasi i kishin forcuar pozitën e tyre politiko-ekonomike pas Luftës së Dytë Botërore e sidomos këto dekadat e fundit. Lidhur me zonat e influencës NATO-ja nuk vepronte si bllok ushtarak, por çdo anëtar i këtij blloku vepronte në zonat e veta si një fuqi e veçantë ekonomiko-politike.

Kontradiktat në gjirin e NATO-s, natyrisht manifestohen edhe jashtë saj. NATO-ja as interesat e anëtarëve të saj nuk i shikon në prizmin e një «uniteti» monolit. Kjo duket qartë në kundërshtimet që zhvillohen midis Republikës Federale të Gjermanisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, midis këtyre dhe Francës, midis Francës dhe Anglisë etj., bile arrihet deri atje sa Brzezinski kërkon që vendet anëtare të NATO-s të ndihmojnë politikën amerikane për ruajtjen e influencës ekonomiko-politiko-ushtarake të saj jo vetëm në zonën e Evropës, por në të gjitha anët e botës ku imperializmi amerikan ka investuar mjetet e tij ekonomike dhe ka përhapur forcat politike.

Politika amerikane ka pësuar disfatë në botë dhe kjo u reflektua edhe në të ashtuquajturën politikë të vendeve të paangazhuara. Kështu në Konferencën e Havanës u manifestuan kundërshtime midis vendeve pjesëmarrëse, aleate të të dyja blloqeve. Vendet prosovjetike, si Kuba, Vietnami, Somalia e të tjera mbështetnin politikën e Bashkimit Sovjetik, kurse grupi që gjoja ndjek politikën e «kalit» të Beogradit mbronte politikën amerikane nën maskën e politikës «së paangazhuar», politikës «jash-të blloqeve e në kundërshtim me blloqet».

E tërë kjo mbledhje, ashtu si edhe ato të mëparsh-

met, ishte një maskaradë dhe të tilla do të jenë edhe ato që do të zhvillohen në të ardhmen, për arsye se **çdo shtet kapitalist, i madh ose i vogël, që bën pjesë në botën e «të paangazhuarve»**, ndjek një politikë të jashtme të akorduar me diapazonin e atij që e financon, që e mbështet dhe që ka lidhur fatet e klikës së qeverisë me veten e tij.

Aktualisht, duke parë dobësinë e politikës amerikane në botë, Franca e Zhiskar d'Estënit dhe Gjermania e Bonit kanë filluar të manifestojnë me forcë politikën e tyre të ekspansionit ekonomik, politik e ushtarak dhe që të dy këto shtete, për të mos folur për Japoninë dhe për Anglinë, kanë zonat e tyre të influencës, kanë në varësinë e tyre shtete që quhen «të paangazhuara», të cilat bëjnë atë politikë që u diktohet nga ato. Kështu me teorinë e tyre të «të paangazhuarve» titistët mund të përallisin, duke kujtuar se gjoja kanë gjetur formulën e shumëdëshiruar për të ruajtur pushtetin e kapitalit amerikan dhe të shteteve të tjera kapitaliste të industrializuara, por kjo nuk pi më ujë as edhe si një fiksjon.

«Kali» i fundit i kësaj karroce të sajuar nga imperia- lizmi amerikan është duke vdekur dhe me të do të vdesë edhe kjo dada e tyre. Udhëheqja «kolegjiale» jugosllave nuk do të jetë më në gjendje ta mbajë ngritur këtë flamur të «mosangazhimit» dhe të gënjejë popujt, dhe në fakt asnjëherë nuk i ka gënjyer dot ata. Por edhe klikat vasale të kapitalizmit botëror, te Jugosllavia nuk shikoni veçse një *valé* të imperializmit amerikan dhe asgjë tjetër. Pas vdekjes së Titos zhduket edhe ky *valé*, zhduket edhe ky xhol që hynte në të katër anët si i dërguar i kapitalit botëror.

## SHËNIM

Erdhi Ramizi. Bisedova me të për librin «Eurokomunizmi»<sup>1</sup> që po shkruaj.

<sup>1</sup> Është fjala për librin «Eurokomunizmi është antikomunizëm».

**KISINGERI ZBULON SHUMË GJËRA PËR KINËN**

Gjithë këto ditë po bie shi dhe po fryn erë, kështu që s'bëj dot as shëtitje, por kohën s'e lë të më kalojë kot. Përveç punëve të tjera, kam në dorë dy vëllimet e trasha të kujtimeve të Kisingerit dhe po i lexoj, pse ka atje shumë çështje për Kinën, që nuk i dinim, por që ai na i zbulon. Zhvillimeve në Kinë u kemi rënë në kokë, pa i njohur faktet.

**TEZAT E PK TË GJERMANISË  
(MARKSISTE-LENINISTE)**

Para disa ditësh, Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Gjermanisë (marksiste-leniniste) i dërgoi Komitetit Qendror të Partisë sonë një letër si dhe një material me 43 apo me 44 teza. Objekti i këtyre tezave është: si duhet të ndërtohet një parti e vërtetë komuniste ose punëtore, marksiste-leniniste dhe ç'vijë duhet të ndjekë ajo.

Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Gjermanisë (marksiste-leniniste) kërkon, gjithashtu, që nga 7-12 prilli të vijnë në Shqipëri për bisedime kryetari i kësaj partie, Ernst Aust dhe anëtari i Byrosë Politike Host Koh. Natyrisht, ne me kënaqësi i thamë që të vijnë dhe të shkëmbejmë mendime lidhur me sa kërkojnë ata.

Duke na dërguar këtë letër e këto teza dhe duke na kërkuar mendimin tonë për to, Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Gjermanisë (marksiste-leniniste) në radhë të parë i bën një nder Komitetit Qendror të Partisë sonë.

Nga një vështrim i parë dhe i shpejtë që u bëra tezave që na ka dërguar kjo parti motër, duket se ato kanë të bëjnë me normat e njohura marksiste-leniniste që duhet të ketë dhe të plotësojë një parti komuniste e punëtore me të vërtetë marksiste-leniniste. Në përgjithësi, me ndonjë vërejtje të vogël parimore, ose me ndonjë formulim, si me thënë, më të mirë e më të saktë të këtyre te-

zave, unë mendoj se ne mund të jemi dakord, pavarësisht se Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Gjermanisë (marksiste-leniniste) ka përzier normat që duhet të udhëheqin partinë me udhëzime e me orientime që mund dhe duhet të jepen për të shpjeguar këto norma.

Siç dihet, Internacionalja Komuniste (Internacionalja e Tretë, e cila u shkëput nga Internacionalja e Dytë), caktoi 21 kushtet e famshme, të ndërtuara sipas tezave të paraqitura nga Lenini, më 25 korrik të vitit 1920, në Komisionin e Kongresit të 2-të mbi «Kushtet e pranimin në Internacionalen Komuniste». Këto kushte, që u aprovuan pastaj edhe nga vetë Kongresi i 2-të i Internacionales Komuniste, përcaktonin detyrimet që duhet të plotësonin partitë komuniste për të bërë pjesë në Komintern, për të qenë, pra, pjesëtare të Kominternit. Kur Lenini themeloi Partinë Socialdemokrate Ruse dhe kur u gjend përpara luftës fraksioniste të Danit e të mensevikëve të tjerë, ai përcaktoi karakteristikat që duhet të ketë partia që i nevojitet revolucionit proletar dhe shkroi në mes të tjerash veprën e tij të famshme «Ç'të bëjmë?».

Në tezat që na kanë dërguar, shokët gjermanë jo vetëm përcaktojnë normat parimore organizative mbi të cilat duhet të bazohet partia komuniste, marksiste-leniniste, pra normat e përgjithshme strategjike të një partie të tillë, por bashkojnë me to dhe përcaktojnë afërsisht edhe taktikat që duhet të kenë partitë marksiste-leniniste në situata e në etapa të ndryshme. Vetë shokët gjermanë, në letrën që na kanë dërguar, e thonë se cili është qëllimi për të cilin i kanë formuluar këto teza. Kështu ata thonë se këto çështje duhet t'i shtrojmë e t'i diskutojmë në bisedimet dypalëshe dhe shumëpalëshe me partitë komuniste dhe punëtoare, me qëllim që të përcaktohen, si me thënë, disa norma, disa piketa parimore për të gjitha partitë komuniste, marksiste-leniniste.

Mua më duket se është vështirë për ne që t'u diktojme partive marksiste-leniniste, qoftë edhe në mbledhje të përbashkëta, dypalëshe ose shumëpalëshe, si dhe qysh duhet të jetë partia marksiste-leniniste. Pse është vështirë? Është i vështirë një veprim i tillë se, duam apo s'duam ne, ky përmban në vetvete «tendencën e imponimit» nga ana e një ose e shumë partive të disa orientimeve, të cilat Kominterni në kohën e vet i pati dhënë për të bërë dallimin në mes partive komuniste dhe partive socialiste e socialdemokrate të Internacionales së Dytë.

Aktualisht ekziston një situatë pak a shumë analoge. Partitë e vjetra komuniste dhe punëtoare, siç janë Partia Komuniste hrushoviane e Bashkimit Sovjetik, partitë e vendeve të Evropës Lindore, e ashtuquajtura Lidhje e Komunistëve të Jugosllavisë, partitë eurokomuniste, Partia Komuniste e Kinës dhe gati të gjitha partitë e vjetra të vendeve kapitaliste, kanë tradhtuar marksizëm-leninizmin, kanë devijuar nga teoria jonë shkencore dhe janë kthyer në parti revizioniste. Mirëpo, pavarësisht se ekziston kjo situatë, sot nuk ekziston Kominterni dhe, sipas mendimit të Partisë sonë, nuk mund të formohet një Internacionale e re, e cila të ngarkohet me detyrën e udhëheqjes dhe të drejtimit të të gjitha partive të vërteta marksiste-leniniste në luftën e tyre kundër borgjezisë kapitaliste dhe kundër revizionizmit modern.

Në qoftë se konsiderohet se ekziston një situatë e tillë (dhe në fakt ajo ekziston) partitë e reja duhet të mbështeten fort si në çështjet politike, të organizimit dhe të luftës, ashtu edhe në çështjet ideologjike, në teorinë marksiste-leniniste. Kjo teori nuk mund të imponohet nga një ose nga pesë parti. Përkundrazi duhet të bëhen përpjekje luftarake që në çdo parti të formohen pikëpamje të drejta dhe shkencore.

Përmbajtja e tezave që na ka paraqitur tani Partia Komuniste e Gjermanisë (marksiste-leniniste) në të vërtetë është formuluar me kohë, shkencërisht dhe në mënyrë precize që në «Manifestin Komunist» të Marksit dhe të Engelsit. Po kështu statutet dhe programet e Partisë Bolshevike të Leninit përmbajnë formulime shumë ektakte për sa i përket çështjes se si duhet të jetë partia e klasës punëtore dhe cilat janë detyrimet e saj. Stalini në veprën e tij «Mbi bazat e leninizmit», më 1924, ka parashikuar në mënyrë të hollësishme gjashtë veçoritë që duhet të ketë partia e tipit leninist.

Edhe Partia jonë që në fillim ka përcaktuar në mënyrë shkencore normat marksiste-leniniste të organizimit të vet. Në programin e saj, i cili në vija kryesore pasqyrohet në Statutin e Partisë, ajo ka përcaktuar, gjithashtu, edhe orientimet e veta politiko-ideologjiko-luftarake. Çdo parti duhet ta bëjë këtë gjë, dhe jo vetëm kaq, por këto norma e parime nuk duhet të jenë mjete dekorative, por armë dhe mësim për të vepruar në mënyrë revolucionare në udhëheqjen e masave të gjera punonjëse në luftë dhe në revolucion për të drejtat e tyre, kundër borgjezisë dhe aparatit të saj shtypës e shfrytëzues.

Teoria jonë marksiste-leniniste, që është shkencë e jo dogmë, duhet të studiohet nga të gjithë marksistët, nga të gjitha partitë marksiste-leniniste. Bile këta duhet t'ua sqarojnë atë edhe masave punonjëse, veçanërisht klasës punëtore, që është mbështetja e tyre kryesore, nga ku kanë dalë dhe për të cilën luftojnë. Natyrisht çdo parti marksiste-leniniste këto parime i përcakton në programin e në statutin e saj dhe i zbaton si duhet në kushtet e vendit të vet. Kjo shihet në praktikën e përditshme luftarake, në orientimet që jepen si për probleme kapitale, ashtu edhe për probleme korrente që interesojnë klasën punëtore dhe punonjësit e tjerë, të cilët çdo ditë e çdo

orë luftojnë për të fituar terren drejt revolucionit. Kup-tohet se çdo parti vijën dhe qëndrimet e veta politike e luftarake i përhap nëpërmjet propagandës që bën dhe ak-sioneve konkrete. Për sa i përket çështjes përse është mbajtur ky apo ai qëndrim i caktuar ose përse është ndër-marrë ky apo ai veprim tjetër, midis partive motra mark-siste-leniniste ekziston bashkëpunimi vëllazëror dhe sho-qëror për të shkëmbyer eksperiencë dhe për t'i shpjeguar njëra-tjetrës çështje të vijës politike apo të veprimeve konkrete, jo pse janë të detyruara, por sepse janë parti marksiste-leniniste që i bashkon e njëjta ideologji dhe që luftojnë për një qëllim.

Kuptohet se në bisedime vëllazërore dypalëshe ose shumëpalëshe, mund dhe duhet të ketë edhe kritikë, edhe autokritikë. Këto duhet të bëhen ashtu siç përcakton teo-ria jonë marksiste-leniniste dhe që të dyja të shërbejnë për përmirësimin e punës e të luftës, për kalitjen e çdo partie dhe për përgatitjen e masave për revolucionin. Prandaj partitë motra marksiste-leniniste, në kontaktet që mund të kenë dhe duhet të kenë midis tyre, nuk mund t'i kërkojnë raporte njëra-tjetrës, ose të raportojnë në një qendër ashtu siç raportnin dikur partitë komuniste në Komintern. Kominterni ishte një formë tjetër organizimi dhe partitë e asaj kohe, që ishin pjesëtare të këtij organizimi ndërkombëtar, merrnin aty direktiva për punën e tyre. Në Komintern ato kishin seksionet e veta, prandaj ishin të detyruara të jepnin raporte mbi gjendjen në partitë e në vendet e tyre, të merrnin udhëzime nga Komiteti Ekzekutiv i Internacionales Komuniste. Aktualisht dhe për arsye që dihen, një gjë e tillë nuk mund të bëhet.

Në qoftë se mendohet që partitë marksiste-leniniste duhet të pranojnë ndonjë dokument të përbashkët si një manifest të ri, mua më duket se një gjë e tillë nuk është e udhës të bëhet. Po të bëhet kjo, do të dukej sikur mark-

sizëm-leninizmi është vjetruar dhe partive të reja marksiste-leniniste u duhet të kenë një manifest të ri..

Është e natyrshme se Partia Komuniste e Gjermanisë (marksiste-leniniste) qëkurse i ka hartuar këto teza i ka në themel të partisë së vet. Çdo parti marksiste-leniniste këto parime duhet t'i ketë në themelin e saj dhe t'i vërë në jetë. Është, gjithashtu, e domosdoshme dhe e nevojshme që partitë tona, në mbledhjet që mund të kenë me ndonjë ose me disa parti motra, t'i shtrojnë këto parime, me qëllim që t'i bëjnë shtyllën kurrizore të partive të tyre marksiste-leniniste. Por kjo gjë nuk duhet bërë, si me thënë, në një platformë manifesti, por në kuadrin e shkëmbimit të eksperiencës dhe të përforcimit të këtyre parimeve bazë dhe vendimtare. Kjo, aktualisht dhe në çdo kohë që të bëhet, është shumë e nevojshme. Në këtë kuptim jemi dakord me shokët e Partisë Komuniste të Gjermanisë (marksiste-leniniste).

Një gjë të tillë ne e bëjmë vazhdimisht duke vënë në dukje parimet që udhëheqin Partinë tonë, domethënë ideologjinë marksiste-leniniste dhe format organizative bazë mbi të cilat është ndërtuar Partia jonë. Po ashtu, natyrisht, ne, qëkurse u formua Partia jonë dhe filloi Luftën Nacionalçlirimtare, kemi përcaktuar edhe strategjinë tonë. Aktualisht në çdo Kongres të Partisë sonë ne përcaktojmë vijën e saj konkrete për çdo etapë, forcojmë unitetin e Partisë, e kalitim atë më tej nëpërmjet edukimit ideologjik e politik dhe e vëmë në pozita të shëndosha parimore, strategjike dhe taktike marksiste-leniniste edhe për sa i përket qëndrimit ndaj ngjarjeve ndërkombëtare, pra, të politikës botërore.

Tani në gjirin e lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare, në partitë komuniste e punëtore marksiste-leniniste, relativisht të reja, ka pikëpamje jo të qarta. Ka nga këto parti që e quajnë veten marksiste-leniniste,

por në të vërtetë ato nuk bazohen plotësisht në normat parimore që duhet të udhëheqin një parti të tillë, të tipit Lenin-Stalin. Ato çalojnë ende edhe nga ana organizative, nuk kanë një objektiv plotësisht të qartë marksist-leninist të punës dhe të luftës që duhet të bëjnë në vendet e tyre dhe në situata të ndryshme, nuk kanë, gjithashtu, një statut e një program që t'u vlejnjë, pak a shumë, për të ecur përpara dhe për të kalitur anëtarët e tyre.

Shohim se këto parti marksiste-leniniste në përgjithësi janë formuar pas vitit 1960, domethënë kur Partia jonë sulmoi haptazi revizionizmin hrushovian, kur Partia Komuniste e Kinës, pak a shumë, qëndroi në pozitë anti-hrushoviane. Por, siç e kemi analizuar, kur Partia Komuniste e Kinës pa se ishte e pamundur që të bashkëjetonte ideologjikisht dhe politikisht me Bashkimin Sovjetik hrushovian, ajo i forcoi pozitë e saj antisovjetike, por nga një platformë nacionaliste, shoviniste dhe imperialiste derisa, më në fund e më në bisht, në luftën e saj pseudorevolucionare ndryshoi plotësisht strategjinë dhe taktikën.

Këtu nuk synoj të bëj një analizë për partinë revizioniste kineze, sepse vijën dhe veprimet e saj kundërrevolucionare Partia jonë i ka analizuar me kohë. Por dua të theksoj se në vitet 60-të u formuan mjaft parti marksiste-leniniste, të cilat mbajtën një qëndrim konsekuent pro Partisë sonë dhe asaj të Kinës dhe hodhën bazat e një pune organizative, luftuan për të krijuar dhe për të zgjeruar radhët e tyre. Mirëpo në disa prej tyre (dhe kjo ishte e natyrshme), përderisa nuk u vendosën themeli të shëndosha marksiste-leniniste, që përbëjnë bazën e një partie të tipit Lenin-Stalin, përderisa nuk pati norma bolshevike në jetën e tyre të brendshme, doemos do të kishte çarje, fraksione dhe kuptime të ndryshme të politikës që duhej të ndiqej si në çështjet e brendshme, ashtu edhe në ato ndërkombëtare.

Kështu u pa se kur u acaruan situatat në mes Partisë sonë marksiste-leniniste të Punës dhe Partisë Komuniste të Kinës dhe kur në Kongresin e 7-të të Partisë sonë ne vumë qartë në dukje falsitetin e maocedunidesë, që kinezët donin ta impononin si marksizëm-leninizmin e kohës sonë, në mjaft nga këto parti u duk një çarje. Disa prej tyre mbajtën dhe mbajnë anën e maocedunidesë. Në ato rrethana u duk qartë se këto parti nuk ishin ndërtuar në baza të shëndosha marksiste-leniniste dhe qëndrimet e tyre të mëparshme ishin qëndrime koniunkturale, ashtu si të tanishmet, të lidhura me interesat e grupeve kryesore që kishin themeluar këto parti. Ato u bënë njësh për të mbështetur haptazi partinë revizioniste të Kinës, ose rryma të tjera politike në shërbim të kapitalit, të cilat kishin interes që këto parti të mos zhvilloheshin në drejtimin marksist-leninist, por, ose të braktisnin vijën e drejtë, ose të vazhdonin të mashtronin atë opinion që kishin mundur të krijonin me qëndrimet e tyre të mëparshme. Kështu ngjau, për shembull, me Partinë Komuniste të Francës (marksiste-leniniste), të Belgjikës, të Austrisë, me njëfarë Strobeli, i cili, deri në fund, ishte «antikinez», pastaj u bë prokinez. Në të vërtetë ky njeri nuk kishte dhe nuk ka parti, por hiqej e hiqet sikur ka një parti komuniste austriake, marksiste-leniniste. Kështu ka ndodhur edhe me partinë e Kilit, të Cejlonit dhe me disa parti të tjera të vendeve kapitaliste në kontinente të ndryshme.

Ka edhe parti të tjera si ajo e Italisë, e cila vitin e fundit devijoi nga pozitat e mëparshme, që i quante marksiste-leniniste. Në komunistët shqiptarë, i kemi ndihmuar udhëheqësit e kësaj partie që të forcoheshin, të organizonin punën e luftën e tyre, kemi pasur me ta bisedime të vazhdueshme dhe kemi shprehur haptazi pikëpamjet tona politike, ideologjike e organizative. Duhet thënë se ata nuk i kanë kundërshtuar pikëpamjet tona

marksiste-leniniste, bile tregoheshin shumë solidarë. Mirëpo del se, në fakt, ata nuk kishin qenë solidarë me ne, sepse erdhi një çast kur devijuan, duke nxjerrë një gazetë të re me emrin «Ottobre», e cila, nëpërmjet artikujve redaksionalë që botoi, në ata numra që dolën, mbronte idenë e një bashkekzistence me «grupet antiberlinguer» që vegjetonin në partinë revizioniste italiane. Kjo gazetë mbrojti edhe pikëpamjen se Partia Komuniste e Italisë (marksiste-leniniste) duhej të afrohej me Bashkimin Sovjetik, pse në Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik na paska jo vetëm revizionistë, por edhe «revolucionarë»!

Po të analizohen thellë këto veprime e qëndrime, del se ato e shndërrojnë partinë e tyre në një bisht e agjunkturë kapitalisto-revizioniste të borgjezisë italiane, amerikane e sovjetike. Fakt është se, në thelb, Partia Komuniste e Italisë (marksiste-leniniste) hyri në kontakte dhe në bashkëpunim me revizionistët italianë. Që në atë kohë, në mënyrë shoqërore ne u bëmë vërejtje, duke u thënë se kjo ishte një rrugë e gabuar. Në fillim ata gjoja i pranuan vërejtjet tona shoqërore, gjoja e dënuan gazetën «Ottobre», dhe në fakt ajo nuk doli më, por nuk morën më kontakt me ne, megjithëse Fosko Dinuçit i kërkua të bënim një takim në Tiranë dhe të shpjegoheshim për këtë çështje. Ftesën tonë ai nuk e refuzoi, por nuk erdhi këtu dhe akoma nuk po vjen.

Kemi, për shembull, një parti tjetër, atë të Greqisë, që quhet marksiste-leniniste, por as ajo nuk është në pozita marksiste-leniniste revolucionare. (Në Greqi dhe jashtë deri tash ka nja tri parti të tjera që e quajnë veten komuniste.) Me këtë parti, të quajtur marksiste-leniniste, që për ne s'ka qenë kurrë një parti serioze, ne shumë vonë vendosëm lidhje dhe u përpoqëm, duke shpjeguar qëndrimet tona për çdo çështje, ta ndihmonim sa të ishte e mundur që të mëkëmbej. Nga pamja e jashtme duket

sikur kjo parti nuk ka hyrë në kundërshtim me Partinë tonë, por në fakt ajo, për çështjen e qëndrimit ndaj maocedunidesë, është në kundërshtim me Partinë tonë. Kjo parti në mjetet e saj të propagandës thotë se me Partinë e Punës të Shqipërisë është dakord, dhe këtë e bën për të gënjyer anëtarët e vet, por thotë se vetëm në një çështje nuk është dakord dhe se për këtë do të shpjegohen, megjithëse në fakt s'kanë se për çfarë të shpjegohen. Aktualisht ata po përgatitin kongresin e tyre dhe, sipas të dhënave që kemi, në këtë kongres, kur të mbledhet, do të ngrenë lart maocedunidenë. Ç'janë këta të ashtuquajtur komunistë marksistë-leninistë? Ata s'bëjnë gjë tjetër veçse lojën e kinezëve, për t'u vetëquajtur marksistë-leninistë dhe për ta paraqitur maocedunidenë si ideologjinë që i udhëheq. Një parti e tillë nuk mund të quhet marksiste-leniniste.

Si këto parti që përmenda ka edhe të tjera. Elementë të lëkundshëm, deviatorë, që u krijojnë telashe partive marksiste-leniniste në luftën e tyre revolucionare, nuk përjashtohet mundësia që të dalin edhe në gjirin e partive që qëndrojnë në pozita të shëndosha marksiste-leniniste. Kjo është pjesë përbërëse e luftës klasore brenda radhëve të partisë, pjesë e luftës për forcimin e frymës revolucionare e të fitores mbi borgjezinë kapitaliste. Kjo gjë ka qenë dhe është e paevitueshme, por, në qoftë se partia është ngritur mbi baza të shëndosha dhe qëndron në pozita revolucionare marksiste-leniniste, në qoftë se ajo i zbaton parimet dhe normat e një partie të tipit Lenin-Stalin, në qoftë se mbështetet në klasën punëtore dhe në ideologjinë e saj, e përvetëson këtë ideologji dhe e bën një armë të efektshme për të zhvilluar luftën në krye të klasës punëtore e të masave të tjera punonjëse, ajo nuk ka frikë nga elementët përçarës e devianistë që mund të dalin, përkundrazi i spastron ata me guxim e vendosmëri, i hedh si skoriet jashtë radhëve të veta

dhe forcon bazën e saj, kalit anëtarët në luftë e në aksion.

Me fjalë të tjera parimet bazë, që në përgjithësi shokët e Partisë Komuniste të Gjermanisë (marksiste-leniniste) i kanë kthyer në teza, janë të domosdoshme për një parti marksiste-leniniste. Ato ne duhet t'i propagandojmë me çdo mjet e në çdo formë, në teori e në politikë. Këtë ne duhet ta bëjmë, sepse kjo është një nga detyrat tona internacionaliste. Fitorja e një partie në një vend të vetëm ose e disa partive në disa vende të ndryshme, varet pikërisht në atë nëse ajo ose ato qëndrojnë në pozita të shëndosha marksiste-leniniste, mbrojnë teorinë e Marksit, të Engelsit, të Leninit e të Stalinit dhe luftojnë me rreptësi kundër deviacioneve revizioniste moderne, socialdemokrate e socialiste të vjetra.

Prandaj, në përgjithësi, ne duhet t'i mirëpresim propozimet e shokëve gjermanë, t'i diskutojmë me ta dhe t'u themi atyre se nuk kemi kundërshtim, përkundrazi në takimet tona me partitë motra ne jemi për atë që t'i theksojmë këto gjëra. Por duhet të theksojmë edhe se vënia në jetë e këtyre parimeve nuk varet nga fjala jonë. Ajo varet nga vetë komunistët e çdo partie që është marksiste-leniniste, varet nga ajo nëse i pranon me të vërtetë këto parime dhe i zbaton në jetë, pse mund të ndodhë që parimet të pranohen me fjalë, por në jetë, në praktikë, të veprohet në të kundërtën. Natyrisht, në takimet që bëjmë me atë parti motër që lëkundet nga këto pozita, që mban qëndrime taktike të gabuara ose që në ndonjë çështje strategjia e saj ndryshon, ne do të përpiqemi të diskutojmë, të shprehim mendimin tonë kritik, siç mund të thotë dhe ajo mendimin e saj kritik për pikëpamjet tona. Kjo gjë lypset të bëhet dhe në çdo rast duhen përdorur bindja, argumentimi i shëndoshë marksist-leninist dhe jo dënimi i menjëhershëm i ndonjë partie që vërtet bën ndonjë gabim, por e njeh dhe e korrigjon atë. Në qoftë se një parti nuk e njeh gabimin e saj dhe vazhdon

ta thellojë, po të jetë se ajo ka rëndësi, ka krijuar një opinion rreth vetes dhe me devijimin e saj kërkon të molepsë me këtë opinion dhe të tjerët, atëherë edhe ne haptazi duhet ta kritikojmë dhe ta dënojmë atë. E gjithë kjo duhet bërë vetëm pasi të kemi konsumuar të gjitha përpjekjet për ta shpëtuar këtë parti, ashtu siç bëjmë edhe brenda radhëve të Partisë për të shëruar e për të shpëtuar shokët që gabojnë, të cilët përpiqemi t'i edukojmë dhe nuk i hedhim menjëherë jashtë Partisë, përveç rastit ekstrem, kur faji i tyre është i rëndë, kur këtë faj ata nuk e pranojnë dhe nuk duan të ndreqen. Kështu duhet vepruar në marrëdhëniet në mes partive marksiste-leniniste, kur ndonjëra prej tyre edhe mund të gabojë.

E HËNË  
31 MARS 1980

## SOT NË BOTË NUK MUND TË RUHET STATUKUOJA

Kur i hedhim një sy gjendjes ndërkombëtare, gjë që duhet ta bëjmë vazhdimisht, konstatojmë se kjo është shumë e turbullt. Imperializmi, socialimperializmi dhe kapitalizmi botëror po armatosen për t'u mbajtur në fuqi, për të mbajtur nën zap popujt e botës, për të rindarë zonat e influencës dhe për të goditur atë që do të dëmtonte statukuonë aktuale që është në favor të tyre.

Por mund të themi se aktualisht në botë nuk mund të ruhet statukuoja. **Imperializmi amerikan, socialimperializmi sovjetik, socialimperializmi kinez dhe të gjithë kapitalistët e botës janë në ethe, në lëvizje, në goditje me njëri-tjetrin**, qoftë duke përdorur satelitët e tyre, ashtu edhe hapur, duke zaptuar vende të ashtuquajtura të pavarura, siç ishte Afganistani ose ndonjë vend tjetër.

Interesat e mëdhenj të këtyre superfuqive po përqendrohen në Lindjen e Mesme, në kontinentin afrikan dhe në Azinë Juglindore. Në këto rajone u janë krijuar vështirësi të mëdha, qoftë sovjetikëve, aq më tepër tani me pushtimin e Afganistanit, qoftë amerikanëve, të cilëve u janë tronditur thellë bazat politiko-ekonomiko-ushtarake në Iran; në vështirësi të mëdha kanë ndeshur edhe synimet agresive kineze në Azinë Juglindore dhe në të katër anët e tjera të botës, ku ky imperializëm i verdhë ka tendencë të etshme zgjerimi. Por edhe kapitalizmi francez

ndodhet përpara një gjendjeje mjaft të vështirë në ish-kolonitë e tij të Afrikës, të cilat i ka kthyer në shtete gjoja të pavarura, por që në fakt janë zonë e tij e influencës.

**Zjarri i një lufte botërore akoma nuk është ndezur, por zjarre lokale kanë shpërthyer dhe këto krijojnë vatra, të cilat, sot ose nesër, kur kontradiktat të acarohen shumë, do të kthehen në një luftë botërore imperialiste.**

Në këtë shkrim nuk do të zgjatem në zhvillimin aktual të situatave në përgjithësi, por do të kufizohem vetëm në disa mendime rreth situatës shqetësuese që rrjedh nga agresiviteti fashist i Kinës.

Udhëheqja aktuale kineze, që erdhi pas vdekjes së Çu En Lait dhe të Mao Ce Dunit, pa as më të voglin skrupull, është një nga udhëheqjet më agresive të botës për paqen botërore. Qëndrimet e saj politike, të jashtme dhe të brendshme, janë flagrante, ajo kërcënon me luftë. Qëllimi i saj është sulmi mbi Bashkimin Sovjetik, për ta likuiduar këtë si një fuqi të madhe dhe për të zaptuar Siberinë e pasur deri në Uralet.

Përveç kësaj, Kina e sotme imperialiste synon në mënyrë të veçantë të pushtojë gjithë Azinë Juglindore, domethënë Vietnamin, Laosin, Kamboxhian, Tajlandën, Singaporin, Indonezinë, pse jo, edhe Filipinet. Me fjalë të tjera qëllimi i saj është që gjithë pellgu juglindor i Azisë të bëhet pjesë e perandorisë së re kineze. Por, përveç këtyre dy synimeve, **Kina e sotme ka në plan të saj hegjemonizmin botëror**, domethënë që, në një mënyrë ose në një tjetër, **të dominojë kontinentet, botën.** Ky është një plan i madh, i perealizueshëm, por, në kokën e agresorëve fashistë kinezë mund të realizohet. Ata janë nacionalistë të tërbuar, bile do të bëhen më keq se militaristët japonezë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ata kanë idenë e shtetit të madh që është një realitet në praktikë, pse në katër veta në botë një është kinez. Mirëpo kjo i

nxit ata, gjithashtu, ideologjikisht. Prandaj udhëheqësit revizionistë kinezë mendojnë se Kina mund ta pushtojë botën dhe tregjet e saj jo vetëm duke bërë luftëra grabitqare, që ata i quajnë «çlirimtare», por edhe në mënyrë paqësore kanë mundësi ta dominojnë botën, duke i krimbur shtetet e kontinentet edhe me njerëzit e vet. Dhe aktualisht udhëheqja kineze ka hyrë në veprim në këto drejtime. Ten Hsiao Pini gjatë një interviste u deklaroi gazetarëve japonezë se duhet të nënshkruhet një traktat ushtarak midis Kinës, Japonisë, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe vendeve të «botës së tretë» kundër socialimperializmit sovjetik, për ta shkatërruar Bashkimin Sovjetik. Sa është e vërtetë kjo thënie e Ten Hsiao Pinit, nuk e dimë, por janë agjencitë japoneze dhe të tjera ato që e japin këtë intervistë të tij. Pra, udhëheqja aktuale kineze me tendenca agresive predikon një aleancë globale ku, natyrisht, të dominojnë Kina dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës kundër socialimperializmit sovjetik. Një kjo.

Në dukje dhe aktualisht në këto situata një gjë e tillë ndoshta është e pamundur, por ideja dhe qëllimi u hodhën nga kinezët. Për t'ia arritur këtij qëllimi, natyrisht, udhëheqja aktuale kineze ka vënë të gjitha forcat për militarizimin e Kinës. Për të realizuar këtë qëllim, militarizimin e të gjithë ekonomisë, Kinës i vijonë në ndihmë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Japonia, Franca, Anglia dhe vende të tjera të industrializuara, siç është edhe Gjermania Federale e Bonit.

Të gjitha këto shtete imperialiste po investojnë kapitale të mëdha në Kinë, bëjnë investime në fushën e përgatitjeve ushtarake, për armatime të sofistikuar, investojnë për shfrytëzimin e pasurive të mëdha të nëntokës që ka Kina, sidomos të hekurit, të naftës dhe të mineraleve të tjera të çmueshme.

Siç kam thënë edhe në shkrimet e mëparshme, udhë-

heqja aktuale kineze e ka flakur tej edhe atë cipë të hollë pseudomarksiste me të cilën Mao Ce Duni, ky «La Fajet» i revolucionit kinez, kishte mbuluar fytyrën dhe veprimet e tij prej borgjezi demokrat. Aktualisht Ten Hsiao Pini dhe banda e tij që kanë ardhur në fuqi shkojnë më tej nga një demokraci borgjeze kapitaliste, po shkojnë në rrugën e fashistizimit të vendit, në përgatitjen e luftës. Për këtë qëllim sot në Kinë kanë sjellë në udhëheqje gjithë shtresën e pasur të qytetit dhe të fshatit e cila «ishite goditur» dhe «shpronësuar» nga revolucioni demokratiko-borgjez i së ashtuquajturës Parti Komuniste të Kinës.

Tani në Kinë, me dekrete e me shkop, po zhduket çdo ndjenjë lirie e demokracie, ndryshe Kina nuk mund «të modernizohet». Me «modernizimin» që predikojnë ata, duhet kuptuar fashistizimi dhe kthimi i ekonomisë kineze në një ekonomi luftarake imperialiste.

Format politiko-ideologjike që përdor aktualisht udhëheqja kineze, për të zhdukur çdo liri demokratike, janë të hapëta. Masat që merren atje për demoralizimin në shkallë të gjerë të popullit kinez po bëhen një jetë e re në Kinë, e cila ka përfshirë masa të shumta punonjësishe. Ky degjenerim që po përhapet atje, pasqyron një mënyrë jetese nga më të shtururat e kapitalizmit botëror në kalbëzim. Që nga pornografia e deri te banditizmi dhe kusaria po zhvillohen në shkallë të gjerë në Kinë.

Natyrisht, ky degjenerim, këto forma administrative të drejtimit të shtetit dhe të ekonomisë nuk realizohen pa përpjekje, pa vështirësi e pa kundërshtime. Por aktualisht konstatohet se rezistenca që u bëhet këtyre fashistëve po shtypet, gjë që e vështirëson situatën jo vetëm për Kinën, por edhe për botën.

**Kina ndjek shembullin e militarizmit japonez, i cili u bë jashtëzakonisht i rrezikshëm para Luftës së Dytë**

**Botërore dhe një nga faktorët më agresivë në këtë luftë.** Pra, këtë rrugë ndjek edhe Kina tani, vetëm se duhet të kemi parasysh që, duke arritur këtë militarizim, kjo rrezikshmëri e Kinës bëhet 10 apo 20 herë më e fortë dhe më e madhe se ajo e militarizmit japonez, për arsye të shovinizmit kinez, të frymëzimit fashist e të numrit të madh të popullsisë që ka. Popullsia e Kinës, siç e dimë, është aq e madhe, sa që Mao Ce Duni thoshte se nuk humbasim ndonjë gjë po të na vriten në luftë 300 milionë kinezë. Udhëheqja aktuale nuk e vlerëson fare jetën e njerëzve, prandaj, pasi ta armatosë këtë mizëri njerëzish, ajo do ta hedhë pa hezitim në luftën grabitqare imperialiste në çdo moment e mbi këdo dhe një veprim të tillë ajo e bën me bindjen se do të vendosë hegjemoninë e vet. Por, para se ta ndër marrë këtë veprim, aktualisht Kina popullsinë e saj e vë në balancën e të ashtuquajturit modernizim.

Udhëheqja e sotme kineze ka deklaruar se është e gatshme të vërë në dispozicion të imperializmit amerikan dhe të çdo kapitalizmi tjetër krahun e punës, kurse këta mjetet e punës, dhe, tok me ta, të ndërtojnë ku t'u leverdisë imperialistëve amerikanë e të tjerëve, të investojnë për të shfrytëzuar e për të skllavëruar popujt.

Pra tani, në këtë kohë paqeje relative, Kina i përdor njerëzit e saj si skllavë, ashtu siç janë përdorur afrikanët nga kolonizatorët portugezë, francezë, amerikanë e anglezë, që i kanë çuar në kolonitë e tyre për të ndërtuar dhe për të shfrytëzuar vende të ndryshme. **Tani si zezakët e dikurshëm afrikanë janë bërë të verdhët kinezë.**

Vënia e «skllavëve» kinezë në dispozicion të imperialistëve të ndryshëm nga ana e udhëheqjes aktuale të Kinës i siguron kësaj devizë, por, nga ana tjetër, gjithë kjo forcë krahu në mënyrë të heshtur, në formën e një emigracioni të madh, i shërben për të pushtuar ato vende

ku gjithë këta njerëz venë për të punuar. Me fjalë të tjera, duke lëshuar jashtë kufijve të saj me dhjetëra milionë «skllevër», Kina përgatitet për luftë. Kështu kinezët do të vënë krahë pune të lirë në dispozicion të amerikanëve, të francezëve, të gjermanëve, të anglezëve dhe kjo do të konsistojë në një emigracion të madh që do t'i shtohet emigracionit të vjetër kinez, afro 40-50 milionësh, duke krijuar në kontinente të ndryshme një forcë ushtarake për ta përdorur në momentet e duhura kundër asaj superfuqie që kërkon të mbajë pozitat e fituara më parë ose që përpiqet të depërtojë në zona të tjera të influencës. Mund ta quajmë këtë një plan të madh djallëzor kinez që ka mbështetjen e imperializmit amerikan dhe të kapitalit perëndimor evropian në përgjithësi, për të kundërshtuar pushtimin sovjetik në kontinentin afrikan, në Azinë Juglindore dhe në të gjitha vendet e tjera të botës.

Është fillimi i zbatimit të këtij plani pushtues fashist kinez. Por ky plan do të ndeshë patjetër në rezistencën e popujve. Aktualisht ne shohim se depërtimi politik dhe ekonomik kinez në vende të ndryshme të botës bëhet me vështirësi të mëdha. Kjo e ka arsyen në urrejtjen që kanë popujt për kolonizatorët e vjetër dhe të rinj, në dyshimin që u ngjallin fjalët e bukura të tyre, si dhe në mungesën e mjeteve financiare e teknike të Kinës aktuale.

«Ndhima» që u jep Kina vendeve të ndryshme, është shumë e paktë në raport me investimet e mëdha që bëjnë kolonizatorët e vjetër, që nga imperializmi amerikan deri tek ai anglez, që mban bishtin e kapitalizmit botëror. Sidoqoftë udhëheqja aktuale kineze di të përfitojë nga acarimi i kontradiktave amerikano-sovjetike dhe të bëhet dora e djathtë e imperializmit amerikan, për të qenë mish për top në momentet kur Uashingtoni të gjendet në vështirësi të mëdha dhe në kontradikta të pazgjidhshme me

socialimperializmin sovjetik. Pra, Kina, duke përgatitur dhe duke pritur momentin kur ajo të bëhet me të vërtetë vepruese pa ndihmën e imperializmit amerikan, po ua ofron veten, si mish për top, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe kapitalizmit botëror.

Ne shohim se kontradiktat në gjirin e fuqive të mëdha po shtohen e po thellohen dhe, plani kinez si dhe plani amerikan, nuk mund të ecin ashtu siç duan këto superfuqi, për arsye se edhe superfuqia tjetër, Bashkimi Sovjetik me aleatët e tij, edhe Evropa kapitaliste nga ana e saj, përpiqen të bëjnë një politikë të balancuar për të zgjatur jetën e tyre dhe shfrytëzimin mbi ata popuj, mbi të cilët kanë hedhur kthetrat. Kështu ndihma që fuqitë kapitaliste të Evropës do t'i japin Kinës, që ajo «të modernizohet», do të jetë e atillë që të mos rrezikojë pushtetin e vendosur mbi to nga ana e imperializmit amerikan, e militarizmit japonez dhe atij të Gjermanisë Perëndimore.

Kjo, natyrisht, është një ndihmë që kërkon, gjithashtu, edhe vigjilencë nga ana e tyre, por vigjilenca ka një kufi, se nxitja e kapitalit, nxitja për fitime të mëdha dhe për të likuiduar një kundërshtar aktual, mund të sjellë atë që Kina të bëhet një shtet militarist i rrezikshëm jo vetëm për Bashkimin Sovjetik, por edhe për imperializmin amerikan, atë japonez dhe për kapitalizmin evropian.

Prandaj këto eventualitete mund të sjellin edhe ndryshime në aleancat e kapitalistëve, ndryshime pozicionesh, që do të varen nga rrethanat e krijuara, si rezultat i zhvillimit kinez, sovjetik, amerikan, japonez etj., si dhe shtrirjen e kthetrave të njërit ose të tjetrit në shumë vende dhe në shumë pozita kyç, shtrirje kjo që do të shkaktojë ndryshime qëndrimesh në politikë dhe në aleanca.

Ja ç'po shohim ne aktualisht: të marrim marrëdhë-

niet kino-jugosllave dhe kino-rumune. Për një kohë u bë bujë e madhe që miqësia midis Kinës dhe këtyre dy vendeve ishte një ngjarje me rëndësi të madhe politike: një vend «socialist», siç ishte Kina, lidhi marrëdhënie të ngushta ekonomike, politike dhe partie me këto dy vende josocialiste, por të ashtuquajtura socialiste.

Jugosllavia, për t'iu kundërvënë Bashkimit Sovjetik dhe për t'u rreshtuar më fuqimisht përkrah Shteteve të Bashkuara të Amerikës, aleatit të saj, u afrua me Kinën dhe u duk që marrëdhëniet e tyre do të ecnin kurdoherë përpara, kurse Rumania, nga ana e saj, i kishte ngrohur këto marrëdhënie që më parë se Jugosllavia dhe dukej sikur ecte me një revan të madh e të papërmbajtur drejt një miqësie të përjetshme me Kinën, nga e cila mori ndihma e kredi dhe kësaj miqësie i dha ngjyrën e një kundërshtimi ndaj presionit sovjetik që i bëhej Rumanisë.

Por, siç thotë populli, u ftohën p... dhe aktualisht shohim që marrëdhëniet e Jugosllavisë me Kinën po fishken dhe po ftohen edhe marrëdhëniet me Rumaninë e, jo vetëm kaq, kinezët po i bëjnë presion ekonomik Rumanisë, e cila e tregoi fytyrën e saj të vërtetë që është një satelit agjenturor i Bashkimit Sovjetik e që me Kinën nuk e lidhin shumë gjëra.

Për ftohjen e marrëdhënieve, natyrisht, u mor si një pretekst çështja e Afganistanit, por preteksti i vërtetë është se këto vende nuk shohin t'u jepet ndonjë ndihmë konkrete nga Kina si ajo që kanë nga Bashkimi Sovjetik dhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Këto dy vende pseudosocialiste ndjekin koniunkturaturat dhe aktualisht këto janë për ftohjen e marrëdhënieve me Kinën, kështu që kjo në Evropë nuk ka baza të forta, kurse në Afrikë nuk ka fare. Atje Kina përpiqet të dërgojë skllëvër në shërbim të imperialistëve, të bëhet, si me thënë, «kubanezi» i imperializmit amerikan. Por të paktën kubanezët mbështe-

tin regjimet e Angolës, të Etiopisë etj. me armë; kurse Kina aktualisht nuk ka të atilla baza që ta bëjë këtë gjë, për arsye se edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës veprojnë në këto vende me forma të tjera, ndryshe nga ato të sovjetikëve.

## CILI DUHET TË JETË OBJEKTIVI I LIBRIT «EUROKOMUNIZËM APO EUROREVIZIONIZËM»

Libri me titull «Eurokomunizëm apo eurorevizionizëm», që jam duke shkruar, ka për objektiv demaskimin e deviacionit revizionist modern të një sërë partive të ashtuquajtura komuniste, në radhë të parë në Evropën Perëndimore dhe posaçërisht në Francë, në Itali, në Spanjë etj.

Tradhtia e këtyre partive, që e shpjegoj gjerë e gjatë në kapitujt e ndryshëm të këtij libri, konsiston në faktin që ato e hedhin poshtë teorinë e Marksit, të Engelsit, të Leninit dhe të Stalinit për revolucionin, për luftën e klasave, për diktaturën e proletariatit e për probleme të tjera që përbëjnë bazën themelore të doktrinës sonë shkencore.

Në libër do të dalë qartë se revizionizmi modern iu përshtat kohëve të pasluftës së Dytë Botërore, se variantet dhe korrentet e tij kanë të njëjtat baza dhe të njëjtën strategji, por ndryshojnë pak a shumë vetëm në taktika, se ato janë vazhdimi i teorive antimarksiste të partive të Internacionales së Dytë, të socialdemokracisë evropiane.

Duke filluar analizën e këtij deviacioni nga rruga e drejtë e marksizëm-leninizmit me brauderizmin në ish-Partinë Komuniste të SHBA-së, kam për qëllim të vërtetoj se teoritë në fjalë, ose më mirë rrymat e fuqishme revizioniste moderne, e kanë burimin te politika hegjemoniste e imperializmit amerikan.

Në shpjegimin e brauderizmit, të teorisë së renegatit Brauder dhe synimeve të tij, vërtetohet se deviacionet titiste, hrushoviane, maoiste dhe «eurokomuniste» ose më mirë eurorevizioniste e kanë burimin pikërisht në këtë politikë dhe në këtë korrent ideologjik të sajuar nga imperializmi amerikan, pas Luftës së Dytë Botërore.

Prandaj çështjen e titizmit, të hrushovizmit dhe të maoizmit nuk do ta shtroj në këtë libër si një çështje në vetvete, por ashtu siç kam shkruar edhe herët e tjera, do t'i trajtoj si deviacione të njohura, të lidhura dhe të varura nga strategjia botërore hegjemoniste e imperializmit amerikan në luftë kundër marksizëm-leninizmit, socializmit dhe veçanërisht kundër Bashkimit Sovjetik të kohës së Leninit e të Stalinit.

Pra, në shtjellimin e problemit, do të gjej pikat e përbashkëta me brauderizmin të titizmit, të revizionizmit hrushovian, të maoizmit e aleatëve të tyre. Për këtë qëllim do të nënvizoj çështjen se fill pas Luftës së Dytë Botërore imperializmi amerikan u gjend në pozita dominuese nga pikëpamja e fuqisë ekonomike dhe deri diku ushtarake për karshi Evropës dhe Azisë së rrënuar nga Lufta e Dytë Botërore. Në këtë periudhë kohe ekonomia amerikane e militarizuar ishte mjaft e fuqishme, Shtetet e Bashkuara të Amerikës synonin të vendosnin hegjemoninë e vet politiko-ekonomiko-ushtarake në të gjithë botën me qëllim që të rrethonin dhe të dobësonin Bashkimin Sovjetik, i cili doli fitimtar nga Lufta e Dytë Botërore dhe që me siguri shpejt do të mëkëmbej edhe nga ana ekonomike dhe do të ndihmonte për të konsoliduar shtetet e reja të demokracisë popullore që u krijuan në vendet e Evropës dhe të Azisë.

Pra, në këto situata, për të dominuar shtete dhe popuj dhe për t'i shfrytëzuar këto në interes të kapitalit të madh amerikan, Shtetet e Bashkuara të Amerikës duhej të zhvillonin luftën për shtrirjen e tyre me baza

ushtarake dhe me investime të mëdha ekonomike. Për këtë gjë u ndërtuan taktikat e luftës politiko-ideologjike, të luftës ekonomike, si dhe taktikat ushtarake. Këto të fundit ishin vazhdim i mëtejshëm i planeve të tyre që gjatë kohës së luftës, pra i atyre planeve që e kishin bërë ekonominë amerikane një fuqi të madhe për prodhimin e armëve moderne të sofistikuar, si edhe për zbulimin dhe prodhimin e bombës atomike, që ata e hodhën për herë të parë në Hiroshima dhe në Nagasaki.

Fill pas mbarimit të luftës, nën pretekstin e ndihmës me lekat dhe ushqimet e mbetura stok nga koha e luftës, imperialistët amerikano-anglezë, nëpërmjet UNRRA-s, tentuan të infiltronin në shumë vende të botës dhe veçanërisht në vendet ku populli erdhi në fuqi, domethënë në vendet e demokracisë popullore. Kështu ata synonin të përgatitnin një terren pak a shumë të përshtatshëm për veprime në një plan më të gjerë në të ardhmen. Duhet thënë se jugosllavët përfituan shumë nga dhuratat e UNRRA-s dhe u ushqyen shumë prej saj, por edhe UNRRA, nga ana e saj, mundi të infiltrohej dhe të krijonte agjenturat e veta në mekanizmat shtetërorë të pa-ndërtuar si duhej në shtetin jugosllav të porsaformuar.

Në vendin tonë, siç dihet, UNRRA u dëbua dhe nuk u pranua që oficerët anglezë, agjentë të Intelixhens Servisit, të vinin në Shqipëri dhe të ndanin ata vetë plaçkat dhe ushqimet e mbetura. Kështu dështoi taktika e UNRRA-s karshi vendit tonë.

Jo vetëm UNRRA, por është fakt se kanë zbarkuar në portet jugosllave edhe forca ushtarake angleze. Kur lexojmë kujtimet e Kardelit për takimet e tij me Stalinin (kujtime këto që janë shkruar për të denigruar Stalinin e madh dhe pikëpamjet e tij të qarta politike, ideologjike dhe organizative), bindemi për këtë të vërtetë. Aty, diku lexojmë që Stalini e pyet atë pse i kanë lejuar ata 3 mijë a 5 mijë anglezë në portet e tyre? Dhe Kardeli ia paska

kundërshtuar Stalinin këtë fakt, duke i thënë se nuk kanë zbarkuar veçse disa qindra. Titoja, në bisedimet e tij me Çerçillin, që u zhvilluan në kohën e luftës në Bari të Italisë më duket, ka rënë dakord jo vetëm që Anglia t'i priste ndihmat ndaj Drazha Mihajloviçit dhe qeverisë së mbretit Pjetër të Jugosllavisë, por ajo, në të njëjtën kohë, të shtonte ndihmat karshi Ushtrisë Nacionalçlirimtare Jugosllave, duke u marrë vesh patjetër edhe për zhvillimin e situatës së mëvonshme të pasluftës. Me fjalë të tjera, ai që në kohën e luftës ka qenë një deviator anti-marksist i maskuar, një agjent politik i borgjezisë kapitaliste angleze dhe më vonë i asaj amerikane.

Në Azi dhe veçanërisht në Kinë, ku, gjithashtu, ziente lufta nacionalçlirimtare kundër imperializmit japonez, amerikanët kishin si kalë lufte më tepër Çan Kai Shinë. Lobia e këtij të fundit ishte shumë e fortë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kurse lobia e Mao Ce Dunit ishte e dobët. Rrjedhimisht edhe ndihmat amerikane për Ushtrinë Nacionalçlirimtare Kineze nuk duhet të kenë qenë të konsiderueshme, por të pakta, pavarësisht se dokumentet aktuale që ka shpallur Departamenti Amerikan i Shtetit pohojnë që Mao Ce Duni dhe Çu En Lai janë përpjekur që interesimin e imperializmit amerikan në Lindjen e Largët e veçanërisht në Kinë, ta kthenin drejt luftës nacionalçlirimtare të udhëhequr nga Mao Ce Duni dhe të braktisej kështu Çan Kai Shia. Sido që të thuhet, është fakt se dëshirat e Maos, të Çusë dhe të miqve të tyre amerikanë, nuk çuan dot në favorin e Kinës «komuniste».

«Planit Marshall», gjoja ekonomik, nëpërmjet të cilit Shtetet e Bashkuara të Amerikës synonin të vendosnin hegjemoninë e tyre ekonomike në vende të ndryshme të Evropës së shkatërruar nga lufta, të Azisë, të Afrikës etj. i shërbente teoria e Brauderit, i cili predikonte se

vendet e botës dhe veçanërisht vendet e demokracisë popullore, që u krijuan gjatë luftës dhe pas luftës, si dhe Bashkimi Sovjetik duhej të zbutnin politikën e tyre marksiste-leniniste, dhe të pranonin ndihmën «altruiste» të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilat, sipas tij, kanë një ekonomi të madhe dhe disponojnë teprica të mëdha, që mund dhe duhet t'u shërbejnë të gjithë popujve. (!) Brauderi, sikurse dihet, ishte njëkohësisht likuidator i partisë, duke predikuar zëvendësimin e saj me një shoqatë gjoja demokratike, e cila duhej të mbështeste politikën «demokratike» të të dy partive të borgjezisë amerikane: asaj republikane dhe asaj demokrate, që sundojnë me radhë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Brauderizmi u bë strategjia e madhe e imperializmit amerikan. Taktika që përdori ky imperializëm nëpërmjet Brauderit pati një jehonë të madhe në Amerikën e Jugut, gjë që ndikoi shumë në vendosjen në vendet e ndryshme të Amerikës Latine të një thundre të hekurt politike, ekonomike dhe ushtarake të kapitalit amerikan. Amerika e Jugut u bë sfera e influencës së gjallë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Këtu politika e sundimit të SHBA-së pati reperkusionet e saj edhe për tronditjen e partive të vjetra komuniste, në gjirin e të cilave u shkakjuan përçarje që e kishin burimin në veprimtarinë e elementëve oportunistë, të cilët, të lodhur nga lufta revolucionare, u kapën pas degëve që lëshonte imperializmi amerikan për të shuar revoltat e popujve, revolucionin dhe për të krimbur partitë marksiste-leniniste, që ushqenin, edukonin dhe drejtonin popujt drejt revolucionit.

Në Evropë brauderizmi nuk pati atë sukses që pati në Amerikën e Jugut, megjithatë, kjo farë e imperializmit amerikan nuk mbeti pa u thithur nga ata elementë reformistë, antimarksistë dhe antileninistë të maskuar,

që pritin ose përgatitin momentet e përshtatshme për të devijuar haptazi nga ideologjia jonë shkencore.

Është fakt se sido që titizmi jugosllav anonte shpirtërisht, ideologjikisht dhe politikisht drejt Perëndimit, drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe merrte ndihma nga UNRRA, sido që merrte kontakte të shumta politike dhe realizonte kombinacione të fshehta me anglezët dhe me përfaqësues të tjerë të kapitalizmit botëror, prapë as ky nuk pranoi të merrte ndihmat e «Planit Marshall». Karshi këtij plani Jugosllavia qëndroi në të njëjtat pozita me ato të Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të demokracisë popullore.

Titizmi nuk e hoqi maskën që në fillim kundër marksizëm-leninizmit, kundër revolucionit, kundër socializmit, përkundrazi u përpoq të maskohej, duke vazhduar të përgatiste terrenin për shkëputjen e Jugosllavisë nga familja socialiste. Unë nuk do të hyj në hollësi për këtë çështje, pse do ta ngarkoja së tepërmi këtë libër me gjëra që janë të panevojshme të shënohen, por duhet të theksoj se, pas shkëputjes nga kampi i socializmit, Titoja dhe grupi i tij e lidhën Jugosllavinë me botën kapitaliste dhe i vunë për detyrë vetes që, në Jugosllavi, të transformonin çdo gjë në drejtim të shteteve kapitaliste perëndimore, duke filluar që nga politika, nga ideologjia, nga organizimi shtetëror, nga organizimi i ekonomisë dhe nga organizimi i ushtrisë, pra synonin ta transformonin Jugosllavinë sa më shpejt në një vend borgjez kapitalist.

Në këtë drejtim, pavarësisht se titistët nuk vepruan posaçërisht ashtu siç thoshte Brauderi, prapë duhet të vë në dukje pikat e ngjashme të brauderizmit me titizmin. Idetë e Brauderit ishin idetë e kapitalizmit amerikan, të cilat duhej të infiltroheshin në shtetet socialiste dhe në partitë komuniste të këtyre vendeve dhe të vendeve të tjera kapitaliste. Pra, Brauderi, siç kam shkruar, ishte një likuidator i partisë, por edhe Titoja ishte, gjithashtu,

një likuidator i vijës komuniste në partinë e tij, jo sepse i ndryshoi emrin kësaj partie, duke e quajtur Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë, por, sidomos, sepse i ndryshoi asaj qëllimet, funksionet, organizimin dhe rolin që luante dhe do të luante ajo parti në revolucion dhe në ndërtimin e socializmit. Titizmi ia hoqi shpirtin revolucionar Partisë Komuniste të Jugosllavisë dhe, *de facto*, arriti deri në atë shkallë sa ta likuidonte ndikimin e partisë dhe të ngrinte mbi të rolin e frontit. Kjo veprimtari nuk është gjë tjetër veçse likuidim i rolit të partisë, i atij roli pararojë për udhëheqjen e ndërtimit të socializmit, për zhdukjen përfundimisht të klasave shfrytëzuese dhe për kalimin nga socializmi në komunizëm, siç kanë përcaktuar Marks, Engelsi, Lenini dhe Stalini.

Pra në këtë çështje kardinale midis brauderizmit dhe titizmit ka një bashkësi politiko-ideologjike dhe organizative në lidhje me faktorin udhëheqës të revolucionit, të ndërtimit të socializmit dhe të komunizmit. Pra edhe titizmi, ashtu si brauderizmi, është likuidator dhe antimarksist-leninist. Derisa është antimarksist-leninist në platformën vendimtare të rolit pararojë të partisë së klasës punëtore në revolucion dhe në ndërtimin e socializmit, ai është i tillë në të gjitha platformat.

Pas kësaj vepre likuidatore në drejtim të partisë, ne jemi dëshmitarë të faktit që Jugosllavia titiste u ndal në fillimin e rrugës së reformave që kishte filluar. Me fjalë të tjera, Jugosllavia, pas shkëputjes nga Bashkimi Sovjetik edhe nga ne u përpëliti në një kaos veprimesh ekonomik-organizative dhe në një ngadalësim të zhvillimit industrial dhe sidomos të zhvillimit të ndërtimit të socializmit në fshat. Kooperativat bujqësore u ndalën së formuari që në fillim, mori hov prona private mbi tokën deri në atë shkallë, sa aktualisht në Jugosllavi, nga 10 milionë hektarë tokë e punueshme, 9 milionë janë në pronësi të privatëve dhe vetëm 1 milion hektarë

tokë është në pronësi të tipit të fermave shtetërore kapitaliste.

Ky transformim i fillimit në fushat ekonomike, politike dhe ideologjike, do të sillte, natyrisht, sikurse sollin, edhe transformimin e vazhdueshëm të organizimit shtetëror, të organizimit të ushtrisë, të organizimit të arsimit e të kulturës, derisa u arrit njëfarë stabilizimi në disa forma kaotike anarkosindikaliste, siç është vetadministrimi jugosllav dhe futja e ekonomisë jugosllave në ingranazhin e kapitalizmit botëror. Me fjalë të tjera, nëpërmjet shoqërive të përbashkëta, nëpërmjet kredive të panumërta që mori dhe vazhdon të marrë nga fuqitë imperialiste, ekonomia jugosllave hyri nën zgjedhën e imperializmit amerikan dhe të kapitalizmit botëror.

Pas një sërë peripecish, titistët përgatitën terrenin dhe arritën pikërisht në atë objektivi që predikonte Brauderi, në pranimin e ndihmave dhe të mbështetjes ekonomike e politike të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ja, pra, edhe një pikë e përbashkët e titizmit me brauderizmin.

Pse maoizmi dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk patën sukses që të binin në ujdi me njëri-tjetrin më 1948 ose më 1949? Unë mendoj se në atë kohë imperializmi amerikan nuk e ndiente veten aq të fuqishëm sa të përballonte nevojat për ndihmë që kishte gjithë bota. Prandaj ai nuk u aktivizua gjatë kohës së luftës edhe pas çlirimit të Kinës për ta ndihmuar këtë të fundit me ndihma ekonomike dhe për t'u infiltruar në të. Shtetet e Bashkuara të Amerikës në atë kohë kishin shpresa dhe mbështetnin Çan Kai Shinë, por ata mendonin se më parë duhej të ndihmonin ose të nënshtronin nga çdo pikëpamje Japoninë, ta bënin këtë një aleat të fuqishme dhe të bindur të tyre, të rindërtonin ekonominë japoneze dhe ta kthenin këtë vend në një bastion të madh kundër Bashkimit Sovjetik dhe, eventualisht, kundër Kinës së

Mao Ce Dunit. Ka mundësi që Shtetet e Bashkuara të Amerikës të mos jenë aktivizuar në Kinë gjatë luftës, pse s'ka dyshim që ata mbështetnin Çan Kai Shinë, kurse pas çlirimit të Kinës nuk donin të krijonin fërkime të pariparueshme me Bashkimin Sovjetik. SHBA e dinin që në kontinentin e Azisë ishin të dobët dhe mund të pësonin disfatë përpara Bashkimit Sovjetik në rast se zhvillonin edhe në Azi të njëjtën politikë aktive siç bënin në Evropë. SHBA me sa duket nuk ishin aq të fuqishme sa të përballonin me ndihma të gjitha anët e botës dhe t'i përgatitnin ato kundër Bashkimit Sovjetik, kundër sistemit të socializmit, prandaj preferonin të përgatitnin më shumë Evropën, ku shkatërrimet ishin të mëdha dhe ku socializmi ishte bërë i rrezikshëm për kapitalin botëror.

Mao Ce Duni, grupi i tij dhe regjimi i ashtuquajtur socialist që ata vendosën në Kinë, nuk ishte veçse një regjim demokratiko-borgjez. Tendencat e Maos, të Liu Shao Çisë, të Çu En Lait dhe të shumë udhëheqësve të tjerë kinezë ishin që ata të ndihmoheshin nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ata nuk kishin as besim, as shpresa se do t'i ndihmonte Bashkimi Sovjetik që Kina të bëhej një fuqi e madhe siç ëndërronin.

Përveç kësaj më duhet të vë në dukje se në pikëpamjet politiko-ideologjike të udhëheqjes së Partisë Komuniste të Kinës ekzistonin pika të përbashkëta referimi me brauderizmin, me titizmin dhe me socialdemokracinë. Komunizmi kinez ishte i shpëlarë.

Pas vdekjes së Maos dhe me ardhjen në fuqi të Hua Kuo Fenit e të Ten Hsiao Pinit, Kina ndryshoi kryekëput strategjinë e saj dhe e ktheu këtë drejt bashkëpunimit të përgjithshëm dhe të veçantë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me kapitalizmin botëror, të cilët filluan ta mbështetnin Kinën politikisht, ta ndikonin ideologjikisht që ajo të braktiste edhe ndonjëfarë hije të marksizëm-

-leninizmit në kokën dhe në zemrën e njerëzve dhe të bënin kështu transformime të thella politiko-organizative drejt sistemit kapitalist qoftë në fushën ekonomike, qoftë në organizimin shtetëror, qoftë në atë të partisë.

Këtu, pra, duhet të vë në dukje pikat e përbashkëta të maoizmit (që gjatë kohës së luftës, pas çlirimit dhe pas vdekjes së Maos me ardhjen në fuqi të grupit të ri të Hua Kuo Fenit) me brauderizmin, me titizmin dhe me hrushovizmin.

Hrushovizmi nuk ka ndryshim nga këto rryma të tjera të revizionizmit modern; ai është një revizionizëm me maskë dhe është bërë jashtëzakonisht i rrezikshëm për fatet e socializmit dhe të popujve, për dy arsye: së pari, pse në dukje ruan terminologjinë marksiste dhe, së dyti, pse është bërë sundues në një shtet që përbën një fuqi të madhe socialimperialiste.

Por hrushovizmi ka përsëri pika të përbashkëta me të gjitha rrymat antimarksiste të ngjyrave që përmendëm, siç është, për shembull, likuidimi i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Në atë vend nuk u bë ndërrimi i emrit, siç u bë në Jugosllavi. Jo, atje emri i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik mbeti ai që ishte, por edhe këtu partisë iu hoq thelbi dhe shpirti revolucionar, roli i vërtetë i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik u venit dhe ajo u bë parti gjoja e përshtatshme për situatat që u krijuan në Bashkimin Sovjetik pas ardhjes së hrushovianëve në fuqi dhe pas vdekjes së Stalinit. Pra iu «përshtat» situatave kur Bashkimi Sovjetik gjoja kishte përfunduar ndërtimin e socializmit dhe po «ndërtonte» komunizmin. Pra roli i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik u shndërrua dhe drejtimit të zhvillimit e forcimit të ideologjisë marksiste-leniniste në praktikë dhe në teori ia zuri vendin deformimi i teorisë marksiste-leniniste me maska të ndryshme, me frazeologji, me demagogji. Organizimi politik i partisë u kthye

në një organizëm edhe fizikisht shtypës, pa lëre ideologjikisht dhe politikisht që po e po.

Pika tjetër e përbashkët e hrushovizmit me titizmin dhe me brauderizmin është «bashkekzistenca paqësore» natyrisht në forma të ndryshme. Format e taktikat e titizmit në këtë drejtim janë të ndryshme nga ato të hrushovizmit, por thelbi i tyre është i njëjtë. Titizmi, hrushovizmi, maoizmi si dhe eurorevizionistët, të katër tok, kanë për qëllim të ruajnë sundimin e kapitalit ndërkombëtar në përgjithësi dhe të kapitalit të çdo vendi në veçanti. Ata punojnë që mundësisht këtë kapital ta shkombëtarizojnë me anë të bashkëpunimit të shumanshëm politik, por sidomos ekonomik, nëpërmjet shoqërive të përbashkëta, nëpërmjet kredive dhe «ndihmave». Edhe Bashkimi Sovjetik nuk u shpëton dot «ndihmave» amerikane dhe atyre perëndimore, ashtu sikurse nuk u shpëtojnë dot as titizmi dhe aktualisht as maoizmi.

Natyrisht qëllimi im është që këtu t'i vë mirë në dukje të gjitha këto çështje, por të mos futem në hollësi dhe të argumentoj se eurokomunizmi, titizmi, hrushovizmi, maoizmi, brauderizmi e të tjera rryma revizioniste moderne kanë një bazë dhe një burim ideologjik — ideologjinë borgjeze dhe një qëllim të vetëm, luftën kundër marksizëm-leninizmit, kundër socializmit, kundër lëvizjeve nacionalçlirimtare të popujve.

Unë nuk i kam vënë detyrë vetes që të bëj historikun e revizionizmit modern, por kam për qëllim që nga ngjarjet historike, nga zhvillimi dialektik i historisë së popujve e vendeve të ndryshme, të nxjerr konkluzione për çështjet kryesore të librit, se ajo që quajnë eurokomunizëm në të vërtetë është eurorevizionizëm.

Natyrisht eurorevizionizmin nuk do ta trajtoj kështu siç po trajtoj këto tri rryma, sidomos titizmin, hrushovizmin dhe maoizmin në lidhje me brauderizmin, por do të vë në dukje që eurokomunizmi është një zhvillim

i mëtejshëm antimarksist i përhapjes së teorive revizioniste në partitë komuniste të Evropës Perëndimore dhe të disa shteteve të tjera kapitaliste, ku komunistët nuk janë në fuqi. Do të shtjelloj që strategjia e partive eurokomuniste është e njëjlojtë, por çdo parti eurorevizioniste ka taktika të ndryshme dhe etapa të ndryshme zhvillimi jo vetëm të përgjithshme, por edhe të veçanta. Kurdoherë për trajtimin shkencor të eurorevizionizmit duhen mbajtur parasysh lidhjet e revizionizmit të partive të Evropës Perëndimore dhe të vendeve të tjera kapitaliste me titizmin, hrushovizmin, maoizmin dhe brauderizmin.

Këto lidhje, ky unitet në parimet dhe në qëllimet kryesore që bashkojnë revizionizmin modern në të gjitha shfaqjet e tij strategjike dhe taktike, duhet të duken si fije e bardhë në copë të zezë. Nuk duhet harruar se partitë eurokomuniste nuk janë në fuqi, por ato përpiqen të infiltrohen në pushtetin e borgjezisë dhe këtë e bëjnë pikërisht për ato qëllime që kanë edhe titistët, edhe hrushovianët, edhe maoistët etj., pra për të ruajtur kapitalizmin në forma të reja.

Ndryshimi i eurokomunistëve me rrymat që thamë, qëndron në atë që ndërsa dje titistët, hrushovianët, maoistët e morën fuqinë nën maskën e luftës për ndërtimin e socializmit dhe sot shkallmuan socializmin që nga themelet, bashkë me partitë dhe parimet marksiste-leniniste, partitë revizioniste të vendeve kapitaliste përpiqen të futen në shërbim të borgjezisë kapitaliste, të lozin lojën parlamentare dhe të bëhen bashkështypëse të proletariatit dhe të popullit me socialdemokracinë, me demokristianët dhe me partitë e tjera të kapitalit. Me fjalë të tjera, eurorevizionistët kanë «zbuluar» se s'kanë pse të bëjnë transformime të thella në strukturën e jetës shoqërore, administrative, organizative e funksionare të borgjezisë dhe të shtetit të saj.

Është për këtë arsye që Karriljoja me shokë thonë se nuk duhet të shkatërrohet pushteti borgjez, por të reformohet, kurse titistëve, hrushovianëve, maoistëve etj. që të bashkëpunonin me borgjezinë iu desh të shkatërronin sistemin socialist dhe të rikthenin sistemin kapitalist.

Kaq kam parasysh për rregullimin e plotësimin e kapitullit të parë të librit.

Tash të vijmë në kapitullin e fundit, që është shumë i rëndësishëm, për arsye se ky kapitull duhet të përmbajë konkluzionin dhe objektivin, pse unë e shkruaj këtë libër. Objektivi është jo vetëm trajtimi në mënyrë teorike i çështjes së revizionizmit modern dhe i shfaqjeve të ndryshme të tij, por edhe lufta që duhet t'i bëjnë këtij revizionizmi partitë marksiste-leniniste të vërteta e revolucionare, partitë e tipit Lenin-Stalin, proletariati botëror dhe popujt kësaj rryme të egër, të rrezikshme të kapitalit botëror. Ky duhet të jetë edhe konkluzioni i gjithë këtij libri.

Pra, nuk mjafton të shkruaj në libër që klasa punëtore me partitë marksiste-leniniste duhet të sabotojë influencën e partive revizioniste dhe të aristokracisë punëtore në sindikata, po ashtu nuk mjafton problemi tjetër i rëndësishëm që konsiston në demoralizimin e ushtrisë borgjeze, siç e kam trajtuar në kapitullin e fundit, por, përveç këtyre dy qëllimeve, ka edhe qëllime të tjera kryesore që duhet t'i pasqyroj në këtë libër pa u nisur nga mendimi se këto çështje njihen. Partia jonë i ka thënë vazhdimisht çështjet themelore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e marksizëm-leninizmit, por ne duhet të udhëhiqemi nga kërkesa e drejtë që në çdo libër ose artikull që shkruajmë për çështjet kryesore të luftës dhe të mjeteve të luftës sonë, të përmendim dhe të përcaktojmë qartë detyrat, pse ndryshe nuk mund t'i arrihet atij objektivi të madh që kërkojmë të arrijmë.

Në librin «Imperializmi dhe revolucioni» kam shkruar për çështje politiko-teorike të rëndësishme të kësaj faze, por nuk është e thënë që, pa përsëritur të njëjtat forma shtruarje të problemit, të mos përcaktojmë disa çështje të domosdoshme që duhet të ekzistojnë në këtë libër. Cilat janë këto çështje?

E para, është ajo që revizionizmi modern titist, hrushovian, eurokomunist, maoist, brauderian i likuiduan partitë e tyre, i zhveshën ato nga fryma marksiste-leniniste revolucionare, nga armët e tyre të mprehta, nga repartet e organizuara të klasës punëtore, të proletariatit dhe i kthyen në armë për shkatërrimin e revolucionit, për «shuarjen» e luftës së klasave, për «paqen» klasore.

Pra, duke marrë parasysh këtë problem kaq të madh, luftën që revizionistët modernë i bëjnë partisë, kësaj arme të mprehtë të proletariatit, pikërisht në kapitullin e fundit çështja kryesore është mbrojtja e qenies së partive marksiste-leniniste, të ndërtuara mbi bazën e mësimave të Marksit, të Leninit dhe të Stalinit dhe vërtetimi, në bazë të parimeve kryesore politiko-ideologjike dhe organizative të partisë, se pa një detashment të organizuar e pararojë të tillë nuk mund të shkohet në revolucionin e vërtetë, nuk mund të zhvillohet lufta nacionalçlirimtare, nuk mund të thellohet revolucioni demokratiko-borgjez, nuk mund të kalohet nga etapa e revolucionit demokratiko-borgjez në revolucionin proletar për të ndërtuar socializmin dhe më vonë komunizmin.

Në radhë të parë, mendoj të vë caqet, domethënë përkufizimet, parimet e vërteta marksiste-leniniste të partisë së proletariatit, pse pikërisht këto parime godasin, në radhë të parë, revizionistët modernë.

Problemi i dytë ka të bëjë me atë që revizionistët modernë kërkojnë të demoralizojnë klasën punëtore, proletariatin, ta përçajnë atë. Këtë ata e bëjnë sepse e dinë se proletariati është varrmihësi i kapitalizmit. Prandaj në

këtë kapitull më duhet ta bëj të qartë e të theksoj se partia marksiste-leniniste e tipit Lenin-Stalin nuk mund të ndërtohet dhe të rrojë jashtë klasës punëtore nga e cila ka dalë e për të cilën lufton dhe pa u udhëhequr nga ideologjia e saj marksiste-leniniste.

Në këtë çështje, domethënë në përcaktimin e rolit udhëheqës të partisë, të strategjisë dhe të taktikës së saj në etapat e ndryshme të revolucionit e në vende të ndryshme, ku lufta kundër kapitalizmit zhvillohet me intensitete të ndryshme, duke marrë parasysh forcën e kapitalit vendas dhe të atij ndërkombëtar, nga momentet nëpërmjet të cilave kalojnë dhe dobësitë që kanë, duhet të vë mirë në dukje fenomenet negative që aktualisht duken në partitë e reja marksiste-leniniste.

Partitë marksiste-leniniste dhe proletariati botëror e veçanërisht proletariati i çdo vendi të caktuar nuk duhet të nënvleftësojnë presionin e borgjezisë dhe të ideologjisë së saj, forcën shtypëse të kapitalizmit, të imperializmit e të socialimperializmit dhe të ideologjive mashtruese revizioniste. Në rast se partia nuk ndërtohet mbi bazën e parimeve të vërteta marksiste-leniniste dhe të një organizimi të fortë e me një disiplinë të hekurt proletare, këto presione e influenca negative e të dëmshme bëhen shumë të rrezikshme.

Sentimentalizmi, liberalizmi, tendenca për numër, për të dhënë përshtypjen se po shtohen radhët e partisë me anëtarë të rinj, pa zbatuar me rreptësi normat marksiste-leniniste, pranimet në parti jo vetëm shkaktojnë që influenca dhe presioni i borgjezisë ta godasin rëndë atë nga jashtë, por të infiltrojnë brenda dhe ta përçajjnë e ta likuidojnë partinë.

Në çështjen kapitale të ndërtimit e të zhvillimit të tyre, të shtimit ose pakësimit të radhëve të partisë, partitë e reja marksiste-leniniste medoemos duhet të nisen nga parimi i madh dhe gjithnjë aktual se në vendet ka-

pitaliste gjithçka në këtë drejtim bëhet nëpërmjet një lufte të ashpër me forcat e shtetit kapitalist dhe me ideologjitë e tij fashiste, socialdemokrate, revizioniste, reformiste.

Këto rreziqe nuk mund të konsiderohen akademike. Jo. Ato janë rreziqe reale, të cilat duhet të përballohen. Por atyre nuk mund t'u bëhet ballë, në rast se partia nuk ndërtohet mbi bazat e marksizëm-leninizmit. Ato nuk mund të përballohen në qoftë se në themel të programit të veprimit e të luftës së partisë nuk vihet nevoja e sakrificës për idealet e mëdha të kauzës së proletariatit e të komunizmit, dhe nëse këto sakrifica nuk pranohen me ndërgjegje dhe nuk bëhen pa lëkundje në çdo moment, në çdo situatë e në çdo rrethanë që do ta lypë interesin e madh të proletariatit dhe të popullit.

Në vendet kapitaliste, ekzistenca e shumë partive ka shkaktuar një botëkuptim të rrezikshëm në mendjet e njerëzve. Këto parti të borgjezisë janë parti për vota, janë në shërbim të kapitalit vendas dhe të atij botëror. Ky kapital i bashkuar sundon me ndihmën e aparatit të gjerë bankar, me atë të pushtetit shtetëror, sundon me forcën e organizuar të ushtrisë, të sigurimit e të organeve të tjera të dhunës. Partitë që janë të lidhura me kapitalin, me koncernet e shoqëritë e ndryshme shumëkombëshe, kanë për detyrë të lozin lojën e «demokracisë», për t'i çorientuar masat nga objektivi kryesor i luftës së tyre, domethënë nga përmbysja dhe zhdukja e zgjedhës së kapitalit dhe marrja e pushtetit shtetëror në dorë nga masat punonjëse, pra nga kryerja e revolucionit.

Jo pa qëllim partitë borgjeze zbatojnë orientimet e format aktuale organizative e politike, lejojnë të hyjë e të dalë në radhët e tyre kush të dojë e kur të dojë, të gjithë janë «të lirë» të llomotitin, të çirren, por askujt s'i lejohet të veprojnë. Çështjet që kanë të bëjnë me jetën e njerëzve «i rregullojnë» të tjerë. Anëtarët e partive të

ndryshme, pra, kanë vetëm «të drejtën» e llogjeve, të fjalimeve, të diskureve nëpër mitingje pa kapërcyer caqet e së ashtuquajturës liri të fjalës. Kalimi nga liria e fjalës në veprime konkrete klasifikohet e trajtohet si veprim anarkistësh, kriminelësh dhe terroristësh. Prandaj nëse një parti marksiste-leniniste nuk bën kujdes në pranimet në gjirin e saj, në qoftë se anëtarët e saj nuk futen në veprime e aksione konkrete, në luftë konkrete, ajo nuk do të jetë një parti e vërtetë marksiste-leniniste, por një parti marksiste-leniniste vetëm me emër. Një parti e tillë patjetër, në momente të caktuara, do të çahet në fraksione të ndryshme, do të ketë shumë vija, që do të bashkëjetojnë, sepse partia është kthyer në një parti liberale, oportuniste dhe revizioniste. Një parti e tillë as i nevojitet, as i përshtatet klasës punëtore.

Mjaft parti marksiste-leniniste thonë se janë dakord me Partinë e Punës të Shqipërisë, por theksojnë se për një çështje të vetme, për çështjen e Mao Ce Dunit e të maocedunidesë, «ne kemi mendimet tona». Në fakt ajo parti që thotë kështu nuk është dakord me Partinë e Punës të Shqipërisë në një çështje me rëndësi të madhe parimore megjithëse Partia e Punës e Shqipërisë, për sa i përket vijës së Partisë Komuniste të Kinës dhe maocedunidesë, ka bërë një analizë të thellë, kurse ajo parti që pretendon se në përgjithësi është dakord me Partinë e Punës të Shqipërisë, dhe nuk është dakord vetëm me çështjen e maocedunidesë, është një parti e re dhe as që i ka bërë një analizë kësaj çështjeje të rëndësishme, e cila në të vërtetë përbën një devijim revizionist. Natyrisht, për ne kjo parti përderisa nuk e sqaron këtë pozitë, nuk mund të jetë në pozitë marksiste-leniniste.

Ka, gjithashtu, edhe parti që dikur e kanë hequr veten si parti në pozita marksiste-leniniste, por në disa situata ato e kanë ndryshuar edhe strategjinë edhe taktikën e tyre, dhe duket qartë se në mos haptazi, në mënyrë

të tërthortë janë kthyer në prosovjetike. Në propagandën e tyre ata predikojnë se «në Bashkimin Sovjetik ndërtohet socializmi», se në Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik «ekzistojnë burokratë, por ekzistojnë edhe revolucionarë, marksistë-leninistë».

Në parti të tilla ekzistojnë edhe grupe që mbrojnë haptazi maocedunidenë dhe janë në kundërshtim me Partinë tonë. Për ne, këto parti e këto grupe s'janë marksiste-leniniste. Prandaj në çështjen kapitale të formimit të partisë, në pranimin e anëtarëve në radhët e saj, duhet të ecet me kritere të shëndosha politike, ideologjike, organizative, kritere të cilat na i mësojnë Marksi, Engelsi, Lenini dhe Stalini.

Në qoftë se në këto drejtime nuk ndiqet rruga e shëndoshë, marksiste-leniniste, edhe vetë partia kurrë nuk mund të jetë e shëndoshë. Partia marksiste-leniniste duhet të jetë parti e klasës punëtore, repart i organizuar i proletariatit, shtabi i tij madhor dhe, që të jetë e tillë, ajo duhet të edukohet me teorinë marksiste-leniniste. Pastaj këtë teori, duke e përvetësuar mirë, duhet ta përdorë si armë të fuqishme e të pazëvendësueshme në luftën klasore për triumfin e revolucionit, për vendosjen e diktaturës së proletariatit dhe për ndërtimin e socializmit.

Ajo parti marksiste-leniniste që duhet ta përvetësojë dhe ta zbatojë këtë teori, në qoftë se e përvetëson, por nuk e zbaton ose e zbaton gabim dhe vazhdon të mos e ndreqë gabimin që bën, ajo nuk do të ketë rrugë të drejtë, do të devijojë nga rruga e saj.

Partia marksiste-leniniste nuk lind e nuk krijohet ashtu kot. Përkundrazi ajo lind e krijohet si rezultat i disa faktorëve objektivë e subjektivë shumë të rëndësishëm. Partia marksiste-leniniste del nga gjiri i klasës, përfaqëson aspiratat e saj të larta, qëllimet e saj revolucionare dhe zbaton luftën e klasës. Jashtë klasës punëtore, jashtë objektivave të saj revolucionarë, jashtë

teorisë marksiste-leniniste, që është teoria e klasës punëtore, nuk mund të ketë kurrë parti marksiste-leniniste. Nuk mund të jetë parti marksiste-leniniste, parti e proletariatit, parti e klasës punëtore, një parti me shumë korrente dhe me shumë tendenca politike e prirje ideologjike. Një parti e tillë mund të jetë çdo gjë, por parti marksiste-leniniste ajo nuk mund të jetë.

Një çështje tjetër me rëndësi që duhet të sqarohet e të theksohet mirë në këtë libër, është ajo që: partia marksiste-leniniste është parti e veprimt, e aksionit dhe jo parti që qëndron në bisht të ngjarjeve e të lëvizjes së masave ose që futet në rrethin vicioz të partive të tjera revizioniste e reformiste. Një parti marksiste-leniniste revolucionare nuk mund të pajtohet as me reformizmin dhe as me anarkizmin e me terrorizmin. Ajo është kundër të gjitha këtyre rrymave kundërrivolucionare. Por ajo duhet të ketë, gjithashtu, parasysh e të mos harrojë kurrë se përgatit luftën revolucionare të klasës punëtore dhe të masave të tjera punonjëse, prandaj në çdo vend e në çdo rrethanë ndërtimin e saj organizativ dhe punën e vet duhet ta bëjë në mënyrë të tillë që të futet në gjirin e klasës punëtore, të luftojë tok me të, në ballë të saj dhe të krijojë rrethanat dhe mundësitë që klasa të kuptojë politikisht dhe ideologjikisht si rolin e vet të madh në luftën revolucionare, ashtu edhe rolin hegjemon të partisë së saj në revolucion. Në të njëjtën kohë duhet mbajtur parasysh se si pasojë e një pune të tillë, edhe partia marksiste-leniniste nuk mund t'i shpëtojë goditjeve të borgjezisë dhe të aparatit të saj shtypës.

Me këtë problem lidhen çështjet që unë kam shtruar për unitetin e klasës punëtore në çdo vend. Aktualisht uniteti nuk ekziston, ai është përçarë në shkallë kombëtare e ndërkombëtare nga partitë e tjera të kapitalit, të socialdemokracisë, të revizionistëve etj. Me këtë lidhet lufta që duhet të bëjnë partitë marksiste-leniniste tok me kla-

sën punëtore, të cilën duhet ta bëjnë të ndërgjegjshme, kundër ndikimit të socialdemokracisë, të revizionizmit, të reformizmit, të aristokracisë punëtore. Pra të luftohet për të transformuar edhe organizmat aktualë të klasës punëtore, një nga më të fuqishmet e të cilave janë sindikatat, në organizma revolucionarë. Çfarë duhet bërë që këto sindikata të kthehen në organizata me të vërtetë revolucionare e që të luftojnë për mbrojtjen e interesave të klasës punëtore? Që ato të bëhen të tilla duhet që marksistë-leninistët, komunistët e vërtetë të futen në to, të punojnë me to, të sqarojnë klasën, të organizojnë veprimet dhe luftën e saj, ta udhëheqin atë që të dalë në luftë politike, ideologjike dhe ekonomike kundër socialdemokracisë, revizionizmit dhe shtetit të borgjezisë. Në këtë mënyrë përgatitet revolucioni dhe shpallet kryengritja. Prandaj duhet pasur parasysh se është e pamundur që borgjezia të mos e godasë partinë marksiste-leniniste, është e pamundur që veprimet e partisë komuniste marksiste-leniniste që bien dhe janë në kundërshtim me platformën e partive të tjera socialdemokrate e reformiste që ka caktuar kapitali, të mos i quajnë si veprime anarkistësh dhe terroristësh.

Lenini e ka përcaktuar mirë luftën që partitë marksiste-leniniste duhet t'i bëjnë edhe djathtizmit, edhe majtizmit, edhe anarkizmit, edhe terrorizmit. Prandaj këto veprime komplekse të luftës që duhet të bëjnë partitë komuniste marksiste-leniniste në gjirin e klasës punëtore dhe të masave punonjëse kundër pushtetit të borgjezisë, janë ato që përcaktojnë në syrin e masave që ngrihen kundër pushtetit të borgjezisë, karakterin e vërtetë revolucionar të veprimeve e të aksioneve, pavarësisht nga goditjet dhe nga shtypja e ashpër e borgjezisë kapitaliste, shtypje që mund të çojë deri në goditje të armatosura, në vendosje të diktaturës fashiste dhe të ndërmarrjes së veprimeve gjakatare kundër klasës pu-

nëto dhe kundër komunistëve të vërtetë. Le të mos harrojmë se, siç tregon historia, nga këto goditje arrihet në luftë të vërtetë civile, në kryengritje të përgjithshme.

Partia komuniste marksiste-leniniste nuk duhet të trembet nga lufta revolucionare civile, sepse në këtë luftë çojnë shtypja dhe dhuna e egër borgjeze. Dihet se lufta civile nuk bëhet midis klasës punëtore dhe punonjësve të ndershëm, por ajo zhvillohet nga këta të fundit kundër organeve shtypëse fashiste të shtetit të borgjezisë kapitaliste. Kjo përbën periudhën e luftës revolucionare të proletariatit për marrjen e pushtetit me dhunë. Këtë luftë kapitalistët, borgjezët, revizionistët e kanë frikë dhe e cilësojnë luftë civile. Prandaj socialdemokracia dhe revizionistët modernë përpiqen që të mos e lejojnë klasën punëtore të fitojë ndërgjegjen e saj klasore, të zhvillohet, të kuptojë domethënien e problemeve ekonomike, politike dhe ideologjike në atë shkallë, sa të arrijë në atë pjekuri revolucionare që ndihmon në krijimin e kushteve objektive dhe subjektive të luftës për marrjen e pushtetit.

Çështja është që ta bëjmë të ndërgjegjshme klasën punëtore për rolin që ka ajo në marrjen e pushtetit dhe vendosjen e diktaturës së proletariatit, që klasën punëtore ta shkëputim nga influenca e borgjezisë dhe ta shpëtojmë nga pasojat e ligjeve shtypëse të saj, të socialdemokracisë, të revizionizmit, domethënë nga zinxhirët e kapitalizmit; çështja është që marksistët-leninistët të futen në bashkimet profesionale dhe të punojnë për krijimin e sindikatave revolucionare, të cilat kanë për qëllim luftën kundër aparatit shtypës të shtetit borgjez dhe përmbysjen e tij. Prandaj në gjithë këtë punë duhet të dalim në konkluzionin që partitë marksiste-leniniste, në krye të klasës punëtore, organizohen, edukohen, futen në veprime për të shembur nga themelet pushtetin e kapitalit dhe për të marrë pushtetin në duart e veta. Ky

është një konkluzion me rëndësi të madhe teorike dhe praktike.

Edhe çështja tjetër që unë kam shtruar disa herë, çështja e demoralizimit dhe e paralizimit të ushtrisë së borgjezisë, ka për qëllim që të krijojë ato rrethana e ato kushte në të cilat kjo armë e borgjezisë, përpara hovit revolucionar të masave, të gjendet e çorganizuar dhe e çarmatosur.

Pra dy çështjet kapitale: futja në sindikatat aktuale të borgjezuarra dhe shndërrimi i tyre në sindikata revolucionare, nga njëra anë, dhe demoralizimi e paralizimi i aparatit të ushtrisë dhe sabotimi i kësaj arme të borgjezisë, janë dy kushte për të shpejtuar revolucionin dhe për të evituar goditjen e përgjakshme që borgjezia kapitaliste kërkon t'i japë klasës punëtore dhe punonjësve që ngrihen në revolucion. Natyrisht (dhe këtë duhet ta shtojmë e ta theksojmë gjithashtu) këtë qëllim kanë edhe aleancat që duhet të bëjë partia marksiste-leniniste e klasës punëtore me njerëzit përparimtarë, me partitë përparimtare apo me fraksione të këtyre partive që janë për ecjen së bashku për disa probleme në periudha të ndryshme.

Çështja e aleancave, pra, është një problem tjetër që duhet të trajtoj në librin «Eurokomunizëm apo eurorevizionizëm» përveç problemit të partisë, problemit të sindikatave dhe problemit të ushtrisë. Ky është një problem me rëndësi të madhe, delikat dhe mjaft i mprehtë. Për këtë duhet të përcaktojmë mirë anët, shfaqjet e mira dhe të këqija që aktualisht ekzistojnë në masat në lëvizje, në kërkesat e në kundërshtimet e tyre, me fjalë të tjera në dialektikën e luftës së tyre, mbi zgjedhjen e drejtë të rrugëve për të arritur në aleanca të ndryshme. Pikërisht në kuptimin e shëndoshë të situatave që ekzistojnë në gjirin e masave, në gjirin e grupimeve të ndryshme politike qëndron pjekuria e partisë marksiste-leniniste që di

të kombinojë aleancat, duke ruajtur personalitetin e shëndoshë dhe të fortë të saj e, në të njëjtën kohë, duke shtuar ndikimin e vet në këto masa nëpërmjet këtyre aleancave me një politikë të drejtë, me një parashikim pak a shumë të saktë të ngjarjeve dhe të rezultateve. Vetëm kështu partia jo vetëm do të ruajë personalitetin e saj, por edhe do të shtojë influencën në masat që kërkon t'i grumbullojë dhe t'i hedhë në revolucion. Qëndrimi në vend, apatia, llafet e diskutimet boshe të një partie marksiste-leniniste janë vdekje për të. Që këtej del konkluzioni shumë i rëndësishëm se në rast se një parti marksiste-leniniste nuk është vazhdimisht në veprim, në lëvizje, në agjitacion, në propagandë, në qoftë se ajo nuk merr pjesë në manifestimet e ndryshme të klasës punëtore e të masave të tjera punonjëse, pavarësisht se ato janë nën presionin e partive reformiste, ajo nuk do të mund dot t'ia ndërrojë kursin që këto parti reformiste u japin lëvizjeve të masave.

E gjithë çështja është që partitë marksiste-leniniste të aftësohen për të qenë të zgjuara, të shpejta e të sakta në analiza dhe të drejta e të vendosura në marrjen e vendimeve. Për të përpunuar masat me ideologjinë dhe frymën e saj, natyrisht, partia duhet të përdorë shumë forma, shumë metoda pune, por më efikasat janë ato që zhvillohen brenda në gjirin e masave e sidomos kur këto masa janë në lëvizje, në aksion për të kërkuar e për të mbrojtur të drejtat e tyre ekonomike e ca më mirë ato politike.

Ne shohim se në rrugët e qyteteve e të fshatrave të vendeve kapitaliste zhvillohen mitingje e demonstrata. Natyrisht këto janë të organizuara nga partitë e borgjezisë, socialdemokrate dhe revizioniste, të cilat kanë disa arsye përse i nxjerrin masat në rrugë. Në radhë të parë këtu është fjala si ata nëpërmjet kësaj përcaktojnë qëllimet që i udhëheqin këto masa në kërkesat e tyre të

kufizuara, prandaj pikërisht këtu qëndron edhe aftësia dhe zgjuarsia e komunistëve që të marrin pjesë në këto lëvizje masash dhe gjatë veprimit t'i kthejnë ato në demonstrata dhe në përleshje politike me aparatën e dhunës të borgjezisë dhe të shërbëtorëve të saj. Pra propaganda dhe vija e drejtë e partisë nuk mund të bëjnë efekt vetëm me anën e shtypit të saj, që zakonisht është një gazetë me tirazh jashtëzakonisht të kufizuar. Efektin e vijës së drejtë të partisë duhet ta sigurojnë vetë komunistët, simpatizantët dhe njerëzit e frontit, të organizatave të rinisë, pikërisht gjatë veprimeve dhe aksioneve të klasës punëtore e të masave të tjera punonjëse, kur ato janë duke kërkuar disa të drejta. Pikërisht këto momente e këto kërkesa që për komunistët nuk janë të mjaftueshme, duhet të shfrytëzohen mirë dhe të kalohet më tej, të bëhet që klasa e masat punonjëse të mos mbeten në caqet e rivendikimeve që u kanë caktuar sindikatat borgjeze ose reformiste, por t'i tejkalojnë ato dhe të hidhen në veprime me karakter politik.

Një veprim i tillë revolucionar aktiv siguron dy objektiva të rëndësishëm: nga njëra anë, kalitjen e vet në aksione së bashku me masat dhe rritjen e autoritetit tek ato dhe, nga ana tjetër, do ta lejojë partinë që të shohë në veprim elementët më të përparuar, politikisht dhe ideologjikisht, të klasës punëtore, ata që do të jenë shtyllat e ardhshme të vendosura të partisë marksiste-leniniste. Nga ata ajo do të sigurojë gjak të ri për radhët e veta në vend që të grumbullojë andej-këndej dhe të pranojë qosheve disa elementë intelektualë të pakënaqur ose disa punonjës të papunë që kërkojnë drejtësi, që janë të revoltuar, por që nuk janë aq të fortë dhe nuk pranojnë një disiplinë të hekurt të një partie proletare marksiste-leniniste.

Një vijë e tillë luftarake e partive marksiste-leniniste do t'i çojë ata në pozitat e përgatitjes shkallë-shkallë të

kryengritjes e të revolucionit. Kryengritja dhe revolucionin duhen përgatitur, ata nuk vijnë vetë. Përgatitja më e mirë bëhet nëpërmjet aksioneve. Por partitë marksiste-leniniste duhet të kenë parasysh mirë se tok me aksionin duhet edhe teoria, e cila duhet të udhëheqë aksionin, pra nuk duhet nënvlerësuar teoria, sepse, siç na mësojnë mësuesit tanë të mëdhenj të marksizëm-leninizmit, Marksi, Engelsi, Lenini dhe Stalini, pa aksion nuk ka teori dhe pa teori nuk ka aksion.

Më duket se mjaft udhëheqës të disa partive marksiste-leniniste të reja kanë rënë në format e propagandës së rëndomtë të partive revizioniste nga ku janë shkëputur. Ata mendojnë se të tërë punën e partisë e përbëjnë diskutimet e vazhdueshme dhe kontestimet e paprincipita për një çështje ose për një tjetër. Në fakt po të shikojmë me kujdes veprimtarinë e partive revizioniste do të vëmë re se ajo konsiston vetëm në fjalime, në diskutime pa fund, në teorizime pa bukë. Asgjë nuk del nga një punë e tillë shterpë. Ato e përpunojnë masën nëpërmjet shtypit të tyre, të cilin, duhet pranuar, e kanë të madh. Vetë këto parti janë truste të mëdha kapitaliste dhe propagandën e tyre e bëjnë me rrogëtarë të posaçëm. Këta janë bërë mjeshtër të rafinuar për t'u predikuar masave punonjëse, nga tribunat e mitingjeve, çfarë duhet të bëjnë e çfarë nuk duhet të bëjnë. Demagogjia e tyre arrin në një shkallë që e trullon mendimin e shëndoshë të masës rreth qëllimit final dhe e bën atë të besojë se ajo që arrin nëpërmjet një greve të shkurtër, t'i duket se diçka ka arritur. Pikërisht kjo është një gënjeshtër e madhe, në dëm të klasës punëtore e të masave punonjëse dhe në favor të borgjezisë kapitaliste, sepse në të njëjtën kohë forca e kapitalit, mjetet e tij, institucionet dhe forcat e armatosura të borgjezisë bëjnë punën e tyre. Në fakt borgjezia pak shqetësohet nga fjalët, nga artikujt, nga diskuret e këtyre rrogëtarëve revizionistë edhe nga gre-

vat e shumta që bëhen nën udhëheqjen e partive të tyre.

Pra, në qoftë se partitë marksiste-leniniste ose disa udhëheqës adoptojnë stilin dhe metodën e punës të revizionistëve, ata nuk do të dalin dot nga veza, nuk do t'i zgjerojnë radhët e tyre, nuk do të ngrenë dhe nuk do të kalitin moralin dhe shpirtin luftarak të partisë së tyre, përkundrazi do të dobësojnë hovin revoltues revolucionar të anëtarëve të partisë dhe të masave që e ndjekin atë në veprimet e saj.

Organizimi i partisë në celula në vendet kapitaliste ka rëndësi jashtëzakonisht të madhe. Këto celula partie duhet të konsiderohen si bërthama luftarake, si bërthama të armatosura të partisë. Në situatat aktuale partitë marksiste-leniniste duhet të armatosen me ideologjinë marksiste-leniniste dhe me frymën e veprimit dhe të aksionit të përditshëm revolucionar, plot sakrificë dhe, në momente, periudha ose etapa të tjera, të armatosura edhe me armë, duhet të përgatiten për t'u përleshur me forcat e rendit borgjez kapitalist.

Në libër duhet të theksoj se mjaft parti të reja marksiste-leniniste nuk mendojnë si duhet se në veprime e në aksione kërkojnë sakrificë, se do të ketë njerëz që do të dëmtohen, do të vriten e do të burgosen dhe prandaj duhet punuar që rreth partisë të krijohet një masë e madhe njerëzish të devotshëm e revolucionarë të vendosur që ta dëgjojnë partinë dhe të hidhen tok me të në veprime revolucionare. Për këtë partitë duhet të krijojnë baza jo vetëm propagandistike legale, por edhe baza luftarake për momente të nxehta, të cilat duhet t'i parashikojnë. Një parti që nuk parashikon momente të nxehta goditjeje e përleshjeje me forcat e borgjezisë kapitaliste, ajo nuk është një parti e vërtetë revolucionare. Për të parimi teorik se pushteti nuk mund t'i rrëmbehet borgjezisë veçse me dhunë, domethënë me armë, duke luftuar dhe sakrifikuar, mbetet një frazë boshe, një slogan.

Kur themi që partia duhet të ekzistojë në ilegalitet e në të njëjtën kohë të punojë edhe në legalitet, të përfitojë edhe nga momentet e legalitetit, këtë duhet të kemi parasysh, se momentet e ashpra të luftës janë të paevitueshme, dhe në këto momente të ashpra lufte komunistët duhet të kenë krijuar forcat e tyre të goditjes, duhet të kenë krijuar prapavijat e tyre dhe t'i kenë armatosur ato me mjetet e nevojshme politike, ideologjike dhe materiale.

Natyrisht, të gjitha këto çështje dhe mendime të tjera që mund të lindin nga rishikimi i mëtejshëm i materialit që po përgatis, duhet të formohen në mënyrë të drejtë e parimore që përfundimet e nxjerra nga lufta e Partisë sonë dhe nga lufta e partive marksiste-leniniste të vendeve të tjera, nga eksperiencia e hidhur e tradhtisë së krerëve revizionistë dhe të partive të tyre, të mos paraqiten si direktiva që lëshon Partia jonë, por si konkluzione, si eksperiencë që ajo nxjerr nga ndodhitë dhe nga zhvillimi i ngjarjeve kombëtare dhe ndërkombëtare, nga përlëshjet e klasës punëtore dhe të punonjësve të tjerë me kapitalizmin botëror, me borgjezinë kapitaliste nacionale dhe me partitë e borgjezisë së vjetër dhe të re, socialdemokrate dhe revizioniste në vende të ndryshme.

Konkluzioni i librit duhet të jetë konciz, optimist. Duhet që lexuesi i këtij libri të kuptojë mirë e drejt atë çka thotë Partia jonë, ç'konkluzione nxjerr Partia jonë. Këto konkluzione të shërbejnë që t'ia shpërndajnë mjegullën nga koka atij që i lexon dhe t'i hapin horizonte lufte dhe përpjekjesh, horizonte organizimi të luftës me metoda revolucionare që i përshtaten periudhës në të cilën po kalojmë.

Konkluzioni i këtij libri, më duket mua, duhet të jetë një sintezë e qartë, e shkurtër, koncize, plot optimizëm revolucionar për të gjitha mendimet e shprehura dhe idetë e trajtuara në kapitujt e ndryshëm të tij. Pra të

jetë, si me thënë, një përmbledhje e shkurtër por e qartë që të rikapitulojë pa përsëritje vijat kryesore të qëndrimeve marksiste-leniniste revolucionare të partive të vërteta marksiste-leniniste dhe pikat, fushat ku duhet të godasë lufta jonë për të mobilizuar masat punëtore dhe të punonjësve të tjerë në një luftë nacionalçlirimtare kundër shtypjes së brendshme dhe të jashtme, për një luftë të ashpër kundër ideologjisë socialdemokrate dhe revizioniste të përfaqësuar nga partitë e ndryshme të kapitalit, për t'u hequr maskën pseudomarksistëve që në kohën aktuale, në kohën e revolucioneve proletare, për t'i zgjatur jetën kapitalizmit botëror, imperializmit dhe social-imperializmit në kalbëzim, deformojnë teorinë tonë shker-core, marksizëm-leninizmin e pavdekshëm, gjithnjë triumfues.

**E MËRKURË**  
**9 PRILL 1980\***

## **TË MBROJMË LUFTËN E DREJTË** **ANTIIMPERIALISTE TË POPULLIT IRANIAN**

Bisedova me shokun Ramiz për një artikull redaksional në mbrojtje të Iranit<sup>1</sup>. Në artikull të demaskojmë dhe të dënojmë masat shtrënguese që kanë marrë Shtetet e Bashkuara të Amerikës e që i shpalli me gojën e tij vetë Karteri, të dënojmë përgatitjet për agresion ushtarak që po bën imperializmi amerikan dhe të kërkojmë që të ngrihet opinioni botëror në mbrojtje të Iranit, të çahet koalicioni antiiranian që predikon Karteri. Të vëmë në dukje se fajtorët e vetëm të krizës iraniane janë imperializmi amerikan, agjenti i tij, shahu Pahlevi, komplotet e CIA-s dhe kontradiktat në mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik.

Objektivi i të dyja superfuqive është nafta. Këtë armë të fuqishme populli iranian duhet ta përdorë për të shpartalluar planet e imperializmit amerikan dhe ata që do të ndjekin Karterin në luftën kundër Iranit. Në artikull të demaskojmë edhe pseudombrojtjen sovjetike për Iranin. Të vëmë në dukje se Bashkimi Sovjetik me demagogji e acaron situatën dhe përgatit ndërhyrjen dhe me këtë kërkon të errësojë edhe krimin e vet kundër Af-

<sup>1</sup> «Populli iranian hedh poshtë me vendosmëri kërcënimet e reja të imperialistëve amerikanë». «Zëri i popullit», 13 prill 1980.

ganistanit. Nuk mund të hidhet poshtë teza e marrëveshjeve të fshehta midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik për të stabilizuar zonat e tyre të influencës në këtë rajon. Të theksojmë në artikull nevojën e forcimit të unitetit të popullit iranian përpara rrezikut të jashtëm, të theksojmë momentin nacional, që e kërkon këtë unitet për të dalë me sukses në luftën kundër imperialistëve amerikanë dhe socialimperialistëve sovjetikë. Të japim si shembull qëndrimin e vendit tonë kundër kërcënimeve, shantazheve e bllokadave të armiqve. Të gjitha i thyem dhe po i thyejmë, ecim përpara; pra dhe Irani do të fitojë.

E PREMTE

11 PRILL 1980

## MBI TEZAT E PK TË GJERMANISË (MARKSISTE—LENINISTE)

Sot në takimin me sekretarët e Komitetit Qendror, shoku Ramiz na informoi mbi bisedën që pati me kryetarin e Partisë Komuniste të Gjermanisë (marksiste-leniniste), shokun Ernst Aust dhe me anëtarin e Byrosë Politike të kësaj partie, shokun Horst Ditrih Koh.

Austi kishte folur kryesisht mbi materialin me teza që Partia Komuniste e Gjermanisë (marksiste-leniniste) na ka dërguar ca kohë përpara se të vinin këta të dy te ne, ku bëhet fjalë se si duhet të jetë një parti marksiste-leniniste, çfarë parimesh ideopolitike e organizative duhet të ketë, mbi taktikat dhe strategjinë e saj revolucionare etj.

Austi i kishte thënë Ramizit se ata, gjermanët, shohin se ka edhe parti, dhe këtu ai kishte bërë aluzion për Partinë Komuniste të Italisë (marksiste-leniniste) që i shkëlin parimet, prandaj çështja shtrohet se si mund të ndihmohen këto parti që të ecin drejt.

Ramizi, pa u futur në thelbin e paraqitjes së mendimit tonë, lidhur me tezat që kanë paraqitur shokët gjermanë, i kishte kujtuar Austit vështirësitë që dalin në terrenin praktik për kontrollin e zbatimit të këtyre parimeve.

Për të arritur atë që mendojnë shokët gjermanë, u vura në dukje shokëve sekretarë, situata nuk është e

favorshme, sepse ka shembuj negativë që tregojnë se në lëvizjen komuniste marksiste-leniniste ka elementë që nuk njohin as parimin e unitetit, as nevojën e konsultimeve reciproke për çështje të rëndësishme e të përbashkëta parimore. I tillë është rasti i Dinuçit, që nuk pranon të takohet e të shkëmbejë mendime me përfaqësuesit e partive tona ose rasti i ndonjë tjetri si ky që, përpara se të bëjë deklarata në gazetën e partisë së tij për çështjen e maocedunidesë e për të thënë se për këtë ose ndonjë çështje tjetër është në kundërshtim me Partinë e Punës të Shqipërisë, duhet, në parim, të vijë të bisedojë me ne, pavarësisht se mund të ndaheshim duke i thënë njëri-tjetrit: këtu ju keni mendimin tuaj, ne kemi mendimin tonë etj. Tani, u theksova shokëve, rëndësi ka çështja që çdo parti të përpiqet të afirmojë veten, të forcohet, të konsolidojë pozitat në vend dhe të mbrojë parimet.

Duke folur për detyrat që i dalin Partisë Komuniste të Gjermanisë (marksiste-leniniste), Austi i kishte shpjeguar Ramizit se për partinë e tyre aktualisht shtrohet çështja e afrimit të klasës punëtore, pavarësisht se është e inkuadruar në sindikatat reformiste apo është nën ndikimin e revizionistëve. Për shokët gjermanë, me sa shoh unë, çështja shtrohet ashtu si te ne gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, kur u përpoqëm të bashkëvepronim politikisht me Ballin Kombëtar dhe me Bazin e Canës. Pra vija e shokëve gjermanë në këtë drejtim është e drejtë, më duket mua, nuk ka oportunitizëm. Ata nuk ka pse të akuzohen se bashkëpunojnë me sindikatat e borgjezisë socialdemokrate apo edhe me ato revizioniste, pse bashkohen me ta për të realizuar një objektiv të përbashkët, siç është, për shembull, çështja e 7-orëshit, për arsye se, në të njëjtën kohë, marksistë-leninistët luftojnë për të realizuar objektiva të tjerë politikë edhe më të mëdhenj, për të cilët revizionistët dhe socialdemokratët nuk janë

e nuk do të jenë kurrë dakord. Shokët gjermanë nuk mund t'i akuzojë njeri as si përkrahës të Shmidit, mbasi ata kanë forcuar dozën e luftës kundër Bashkimit Kristian Social.

Ne, vura në dukje, nuk mund të afirmojmë bashkëjetesën me revizionistët dhe me shërbëtorët e tjerë të kapitalit, domethënë nuk mund të afirmojmë që me partinë revizioniste gjermane të bihet në marrëveshje dhe të thuhet se do të mbahen të njëjtat pozita taktike për çdo gjë.

Duke pasur parasysh informacionin që Austi i kishte dhënë shokut Ramiz për një numër problemesh të tjera, për sa i përket politikës së brendshme e të jashtme të Gjermanisë Perëndimore, si dhe të politikës e të qëndrimit të Partisë Komuniste të Gjermanisë (marksiste-leniniste) ndaj tyre, theksova se është një gjë shumë e mirë që shokët gjermanë na informojnë dhe kjo dëshmon se ata kanë respekt dhe besim te Partia jonë.

**E MARTË**  
**15 PRILL 1980**

### **BISEDË E PËRZEMËRT ME SHOKËT E PK TË GJERMANISË (MARKSISTE—LENINISTE)**

Sot paradite prita në aparatën e Komitetit Qendror kryetarin e Partisë Komuniste të Gjermanisë (marksiste-leniniste), shokun Ernst Aust dhe anëtarin e Byrosë Politike të kësaj partie, shokun Horst Ditrih Koh, me të cilët bëra një bisedë të gjatë e të përzemërt.

Shokëve gjermanë, pasi u urova mirëseardhjen, u shpreha gëzimin tonë të madh që ndodhen përsëri në Shqipëri dhe u thashë se shkëmbimi i mendimeve midis nesh i ndihmon partitë tona në luftën e përbashkët për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit, të socializmit e të çështjes së revolucionit proletar kundër imperializmit, socialimperializmit, revizionizmit të të gjitha ngjyrave dhe reaksionit botëror.

Pastaj u bëra të ditur se materialin me tezat që na kishin dërguar, e kemi studiuar me kujdes të madh në Sekretariatën e KQ të Partisë dhe e konsiderojmë si një dokument të rëndësishëm. U shpreha, gjithashtu, gëzimin se, për sa i përket diskutimit dhe shkëmbimit të mendimeve për vënien në themel të punës së çdo partie të parimeve bazë të ndërtimit ideopolitik e organizativ të një partie të vërtetë marksiste-leniniste, mendimi ynë përputhet me atë të tyre.

Pastaj i vura në dukje shokut Aust se informacioni që na dha ai për gjendjen aktuale në Gjermani dhe mbi

luftën e partisë së tyre, është interesant, me vlerë për ne dhe na ndihmon për të kuptuar më mirë gjendjen e atjeshme, si dhe përpjekjet dhe vështirësitë në të cilat ndesh partia e tyre.

Duke bërë fjalë për situatën ndërkombëtare, e cila po ndërlikohet vazhdimisht, për zonat e nxehta që janë krijuar, veçanërisht në Lindjen e Mesme e në Azinë Juglindore, ku ndeshen me njëra-tjetrën superfuqitë imperialiste, i fola edhe për gjendjen në Evropë, në Ballkan dhe për situatat e rënda e pikat e dobëta rreth vendit tonë. Këtu u ndala ca më gjatë e më me hollësi dhe u fola për mendimet dhe gjykimet që ka Partia jonë veçanërisht për gjendjen e brendshme në Jugosllavi, për politikën prej zigareje që ka ndjekur e ndjek klika titiste, për grindjet midis kombësive dhe klaneve të ndryshme që përbëjnë shtetin jugosllav, ato serbe, kroate, sllovene, si edhe për zhurmën dhe spekulimet që bëhen sot nga qarqe të ndryshme të botës rreth asaj çka mund të ndodhë në Jugosllavi pas vdekjes së Titos.

Ne, u thashë shokëve Aust e Koh, mendojmë se, në përgjithësi, të dyja superfuqitë imperialiste si dhe NATO-ja e Traktati i Varshavës, dëshirojnë që Jugosllavia të qëndrojë në gjendjen që është sot, pra të ruhet statukuojë, domethënë të vazhdojë të ekzistojë atje republika federative nën ato influenca që ekzistojnë aktualisht. Por është e natyrshme që këto influenca nuk mund të ruhen, sepse, qoftë Perëndimi, ashtu edhe Lindja do të përpiqen të vendosin në Jugosllavi hegjemoninë e tyre në kurriz të njëra-tjetrës dhe ky rivalitet, kjo kontraktë, patjetër që do t'i çojë kundërshtarët në përleshje. Sa kohë do të duhet të kalojë që kjo situatë e këto kontraktë të kthehen në përleshje të armatosur, këtë nuk e parashikojmë dot, dimë vetëm që do të ngjasë.

Për sa u përket mundësisë dhe zërave që janë përhapur për një ndërhyrje të socialimperialistëve sovjetikë

në Jugosllavi, u thashë se, sipas mendimit tonë, këta mund të bëjnë një sulm kundër këtij vendi vetëm kur ta kenë litarin në fyt, kur kontraktat ndër imperialiste të acarohen jashtëzakonisht shumë, kur rivalët për hegjemoni të kenë vendosur përfundimisht që çdo gjë ta zgjidhin me mjetet më të ashpra, me luftë.

Kështu, theksova, ne kemi arritur në konkluzionin se aktualisht Jugosllavia është një vend jo i qetë, një vend kapitalist plotësisht i varur nga fuqitë e huaja. Ky vend gjoja drejtohet nga vetë jugosllavët, por në të vërtetë është kapitali financiar i shoqërive të huaja shumëkombëshe që bën ligjin atje, është ky kapital që bën politikën e këtij vendi. Kjo është shumë e rrezikshme si për vetë popujt e Jugosllavisë, për ne, ashtu edhe për qetësinë dhe sigurimin në Ballkan e në Evropë. Për këto arsye Jugosllavia përbën një pikë të dobët në këtë rajon të botës. Për sa na takon neve, u thashë shokëve gjermanë, gjithçka po e ndjekim me shumë kujdes, kemi rritur e forcuar vigjilencën dhe kemi shtuar masat për mbrojtjen e vendit.

I shpjegova, midis të tjerave, edhe arsyet përse ne kemi deklaruar që, në rast se Jugosllavia do të sulmohet nga socialimperialistët sovjetikë apo nga kushdo tjetër dhe popujt e Jugosllavisë do të ngrihen në një luftë të drejtë kundër pushtuesve të huaj, populli shqiptar do të luftojë së toku me ta.

Atyre u fola edhe për disa probleme ekonomike të vendit tonë, për marrëdhëniet dhe tregtinë që bëjmë ne me fqinjët e me vendet e tjera, u fola shkurtimisht, gjithashtu, mbi problemin e dëmshpërblimeve që duhet të na paguajë Gjermania Perëndimore për shkak të shkatërrimeve që hordhitë naziste gjermane i sollën vendit tonë gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Me shokun Aust shkëmbyem mendime edhe për disa çështje aktuale të Gjermanisë Perëndimore, si për shem-

bull, mbi mundësinë ose jo të fitores së Shtrausit në zgjedhjet e ardhshme për kancelar, mbi pozitën e qeverisë së Shmidit ndaj presioneve amerikane, mbi mundësinë e ndërhyrjes së imperializmit amerikan në Iran etj.

E pyeta pastaj se cili ishte mendimi i tyre mbi qëndrimet që kemi shprehur ne për ngjarjet që po zhvillohen në Iran dhe shoku Aust m'u përgjigj se ato i quajnë të drejta, shumë të mira. Me këtë rast i bëra të qartë se në thelb ne nuk mbrojmë Khomeinin, po luftën e tij anti-imperialiste, kryengritjen antiimperialiste të popullit iranian.

Folëm pastaj mbi marrëdhëniet midis dy partive tonë, për çështjen e shokëve gjermanë që studiojnë pranë Shkollës së Partisë sonë «V. I. Lenin», për dërgimin nga Gjermania në vendin tonë të disa punëtorëve specialistë të industrisë metalurgjike, mekanike, të porteve detare etj. në grupe të vogla që njëkohësisht të mësojnë, të shohin e të pushojnë, por edhe të na ndihmojnë për zgjidhjen e disa çështjeve praktike e teknologjike, për vënien në shfrytëzim të plotë të objekteve të ndryshme që kemi ndërtuar, një pjesë të cilave revizionistët kinezë ose na i kanë dhënë me defekte, ose na i kanë sabotuar, ose nuk na kanë lënë fare dokumentacione për funksionimin e tyre.

Në fund dolëm në fotografi dhe pastaj u ndamë me shokët Aust e Koh, të cilëve u urova udhë të mbarë për në atdheun e tyre.

E DIEL  
27 PRILL 1980\*

## AKT BANDITESK I KARTERIT QË PËSOI DISFATË TË TURPSHME

Operacioni barbar amerikan me komando, i hedhur në Iran<sup>1</sup> për të shpëtuar bandën e spiunëve, që gjenden në çerdhen e spiunazhit në Teheran dhe që quhet ambasada amerikane, dështoi me turp të madh. Ky akt banditesk prej gangsterësh i mbuloi me një tjetër skandal turpi imperializmin amerikan dhe presidentin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Xhimi Karterin.

Ky, në një fjalim televiziv që mbajti dy ditë më parë, pohoi se operacioni kishte filluar të përgatitej që në muajin nëntor të vitit 1979 dhe se ishte vetë përgjegjës për ndalimin e këtij veprimi, për arsye se dështoi, se u përplasën, ose nuk ishin në gatishmëri aeroplanët dhe helikopterët. Karteri njoftoi se 8 oficerë, anëtarë të ekuipazheve të avionëve vdiqën, disa dhjetëra të tjerë u plagosën, kurse ata që mbetën, u tërhoqën dhe ngushëlloi familjet e të vrarëve, duke thënë rrofshin «heronjtë»! Këto tha Xhimi Karteri, që u mbulua me turp.

Ky veprim banditesk diskreditoi një nga fuqitë më të mëdha të botës me teknikën më të sofistikuar, fuqinë ushtarake amerikane, dhe tregoi dobësinë e kalbëzimin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Populli amerikan është i traumatizuar dhe Karteri, «ky Hamlet i Shtëpisë së

<sup>1</sup> Është fjala për operacionin ajror në Tabas.

Bardhë», siç e ka quajtur në një artikull të tij të fundit Andre Fonteni në gazetën «Lë Mond», që donte të tregojë një «luan», po izolohet deri edhe nga miqtë.

Ky akt barbar po denoncohet kudo në botë jo vetëm nga popujt, por edhe nga vetë aleatët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilët, ashtu siç lënë minjtë vaporin kur fillon të mbytet, gjejnë një mijë e një arsye të shkundin zgjedhën amerikane, duke akuzuar Karterin që nuk i lajmëroi. Kështu këta lajnë duart si Pons Pilati. Vetëm kryeministrja e Britanisë Theçer dhe Trudoja i Kanadasë mburrën «trimërinë» tragjike të Karterit. Në fakt, bota kapitaliste, e zhytur në një konfuzion të madh, në frikë dhe në dyshime për mbrojtjen amerikane dhe e shqetësuar në kulm nga kriza energjetike, veçanërisht nga pre- rja e naftës iraniane, po përpiqet të ngjijtë «kupa- t e thye- ra». Agresorët sovjetikë, nga ana e tyre, fërkojnë duart. Ata mendojnë se intervencioni dhe dështimi i operacionit amerikan do të mbulojnë agresionin e tyre në Afgani- stan. Por si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ashtu edhe Bashkimi Sovjetik janë që të dy imperialistë, janë agresorë. Veprimet e të dyja palëve janë agresione. Ai i sovje- tikëve u bë dhe po pëson disfata, ndërsa ky i amerikanë- ve dështoi porsa filloi, megjithëse mund të përsëritet pas një kohe. Imperialistët janë gangsterë, arrogantë, luf- tënxitës, ata nuk heqin dorë nga veprime të tilla bar- bare, prandaj ne duhet t'i luftojmë dhe t'i demaskojmë ata deri në fund.

Agresioni amerikan kundër Iranit, ashtu si ai sovje- tik kundër Afganistanit, ai kinez mbi Vietnamit, do të kenë kurdoherë rrjedhime në arenën ndërkombëtare. Ato janë shenja të qarta që i paraprijnë një lufte të re botë- rore imperialiste.

Prandaj ne duhet të jemi shumë vigjilentë, të for- cojmë ekonominë, të forcojmë mbrojtjen dhe unitetin, si dhe disiplinën proletare kudo në punët tona. Brenda ven-

dit ne duhet të jemi të fortë, por edhe në arenën ndër- kombëtare, me qëndrimet tona të drejta të përpiqemi që të zgjerojmë rrethin e miqve dhe të popujve në favor të vendit tonë socialist. Të sulmojmë, të sulmojmë dhe kur- doherë të sulmojmë armiqtë më të egër të popujve, im- perializmin amerikan, socialimperializmin sovjetik dhe atë kinez, revizionistët e ndryshëm dhe gjithë kapitaliz- min botëror.

Rekomandova të shkruhet një artikull për «Zërin e popullit»<sup>1</sup>, në të cilin, përveç të tjerave, të argumentoj- më falsitetin e argumentimeve amerikane dhe të miqve të tyre që japin lloj-lloj variantesh për disfatën katastro- fike të operacionit agresiv amerikan.

E para, të shkruhet se arsyet që dha Karteri janë të alambikuara dhe false. Ajo që thuhet se forcës agresive më të madhe të botës, me armatime nga më të sofistiku- arat, iu prish gjoja një helikopter, pastaj një i dytë, më tej një i tretë, një i pestë, ... asnjëri nuk e ha, çdo gjë në këtë drejtim thuhet vetëm për të shpëtuar fytyrën e autorëve të agresionit. Si është e mundur që një opera- cion i tillë, i përgatitur intensivisht për 100 ditë me ra- dhë, të pësojë Vaterlonë? Jo vetëm kaq, por pjesa e banditëve që shpëtoi u largua në panik, duke lënë në rërën e nxehtë të Iranit oficerët e vrarë amerikanë si ushqim për korbat, dhe avionët e djegur në fushën e Ta- basit. Karteri pohoi se gjoja për arsye defekti teknik urdhëroi ndalimin e operacionit, domethënë tërheqjen në panik të komandove. Vetëm dështimi, tërheqja në panik dhe katastrofa politike e Shteteve të Bashkuara të Ame- rikës qëndrojnë, gjithë të tjerat bien.

E dyta, as versioni tjetër, sipas të cilit gjoja sovje- tikët, me anë të satelitëve, ua ngatërruan amerikanëve

<sup>1</sup> «Poshtë agresioni fashist amerikan kundër Iranit!». «Zëri i popullit», 29 prill 1980.

ndërlidhjen, nuk qëndron. Një gjë e tillë mund të bëhet, por jo kundër amerikanëve që i njohin aq mirë si edhe sovjetikët këto mjete e mënyra, prandaj jo duhej, po me siguri amerikanët kishin marrë masa më parë kundër veprimeve eventuale të sovjetikëve. Avionët e morën të saktë urdhrin që të tërhiqeshin në panik, pse nuk ua prisshën edhe këtë urdhër sovjetikët? Prandaj edhe ky version është një filluskë sapuni që bie.

E treta, qëndron supozimi sipas të cilit sovjetikët, duke vëzhguar këto veprime të amerikanëve, i lanë këta të angazhoheshin në Tabas dhe menjëherë u dhanë ultimatum që brenda një kohe rekord, sigurisht vetëm prej pak orësh, të ndalonin operacionin e të largoheshin, ndryshe do të ndërhynin me trupat e tyre gjoja për të shpëtuar Iranin, me fjalë të tjera ta pushtonin këtë ashtu siç bënë me Afganistanin. Sovjetikët morën me këtë hakën e shuplakës që hëngrën hrushovianët 18 vjet më parë<sup>1</sup>. Atëherë revizionistët sovjetikë u mbuluan me turp, këtë herë u mbuluan me turp imperialistët amerikanë. Karteri, si Hrushovi dikur, u tërhoq me bisht në shalë, në panik. Bashkimi Sovjetik mundet që blofoi. Ai kishte mundësi edhe ta pushtonte Iranin, se trupat e logjistikën përkatëse i kishte si në kufi të Iranit, ashtu edhe në Afganistan.

Karteri nuk e kishte llogaritur faktorin sovjetik. Ai nuk ishte përgatitur për një ballafaqim në shkallë të gjerë, që do të çonte në një luftë botërore imperialiste. Ai kishte llogaritur që operacioni të kryhej me shpejtësi rrufeje, por s'e lanë socialimperialistët sovjetikë të ve-

1 Në nëntor të vitit 1962, në kohën e krizës së Karaibeve, revizionistët sovjetikë nën presionin dhe kërcënimet e imperialistëve amerikanë u detyruan të tërhiqnin raketat e tyre nga Kuba dhe të lejonin edhe kontrollin e tyre në det të hapët nga anijet amerikane të luftës.

pronte kështu. Ai e mbajti të fshehtë operacionin agresiv edhe nga senati, edhe nga bashkëpunëtorët e tij më të ngushtë, por edhe nga aleatët e NATO-s. Në qoftë se e pranojmë këtë version, Bashkimi Sovjetik ia diktoi planin dhe ia bëri gjëmën pa bërë zhurmë. Zhurmën e bëri vetë Karteri. Ai personalisht shpalli dështimin, panikun, mosbesimin që krijoi dështimi i operacionit dhe diskreditimin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që janë sot në rend të ditës. Karteri punoi vetë në favor të sovjetikëve, të cilët po flasin me të madhe për dështimin e agresionit amerikan, sepse ky mbuloi zhurmën rreth problemit afgan dhe gjithë poshtërsive të tjera të agresorëve sovjetikë.

E katërta, edhe një supozim tjetër. Amerikanët mund të kenë hedhur një grup të madh desantësh në Iran dhe ta kenë lënë këtë atje me detyrën që tani të shpërndahen dhe më vonë të grumbullohen tok me agjenturën që kanë brenda në këtë vend e në Teheran dhe së bashku të ndezin luftën civile. Mundet Karteri ka preferuar kështu një turp të madh të përkohshëm për të korrur më vonë në pragun e zgjedhjeve si president një fitore tjetër më të madhe. Ky veprim mund të konsiderohet si një taktikë mashtruese për një veprim tjetër më të madh në të ardhmen. Koha do të zbulojë versionin e vërtetë.

Iranianët duhet të jenë shumë vigjilentë. Popujt, gjithashtu, duhet të jenë shumë vigjilentë dhe të luftojnë kundër banditëve imperialistë amerikanë, sovjetikë, kinezë e të tjerë. Në këto situata të rrezikshme, kriza botërore po thellohet dhe me siguri do të ketë mosmarrëveshje në mes amerikanëve dhe aleatëve të tyre në NATO. Kinezët mund të bëjnë një kthesë prej 90 gradësh drejt sovjetikëve në të njëjtën kohë me kthesën prej 90 gradësh që kanë bërë drejt amerikanëve dhe të mbajnë kështu pozitat e titizmit. Kontradiktat në mes armiqve

janë një fitore për popujt, prandaj ato ne duhet t'i thellojmë, t'i demaskojmë dhe të përfitojmë e të ndihmojmë që popujt të fitojnë lirinë, pavarësinë e vërtetë, që popujt të shkatërrojnë përgatitjet për luftë që bëhen nga sovjetikët, amerikanët dhe kapitali botëror.

**E MËRKURË**  
**30 PRILL 1980**

### MBI SITUATËN NDËRKOMBËTARE

Pas pushtimit ushtarak të Afganistanit nga ana e socialimperializmit sovjetik dhe pas ndërhyrjes së komandove ushtarake të imperializmit amerikan në Iran, gjoja për të shpëtuar pengjet që mbahen në ambasadën amerikane në Teheran, gjendja ndërkombëtare po turbullohet e po acarohet nga dita në ditë, vazhdimisht. Ne po shohim se Bashkimi Sovjetik socialimperialist po vepron haptazi e në mënyrë brutale, me forca ushtarake e me diversion në Afganistan e në rajone të tjera të Lindjes së Mesme, në Afrikë e gjetiu.

Përpara kësaj politike ekspansioniste e agresioneve të socialimperializmit sovjetik, shohim, gjithashtu, se imperializmi amerikan është në dilemë, i duhet të veprojë edhe ai si socialimperializmi sovjetik, domethënë të ndërmarrë të njëjtët hapa agresivë. Por, kjo çështje shtrohet kështu kur si imperializmi amerikan, ashtu edhe socialimperializmi sovjetik janë mbërthyer nga një krizë e madhe ekonomiko-politike.

Natyrisht Shtetet e Bashkuara të Amerikës i kanë zgjeruar zonat e tyre të influencës, por tash atyre u duhet t'i mbajnë ato të pacenuara, bile t'i forcojnë. Mirëpo aktualisht ato nuk janë në gjendje si më parë. Siç e dimë, pas Luftës së Dytë Botërore, imperializmi amerikan korri një fitore të madhe mbi kundërshtarët ose «aleatët» e vet dhe arriti të bëhej «lidershipi» i ka-

pitalizmit botëror. Forca ekonomike e Shteteve të Bashkuara u rrit shumë dhe u shtri duke pushtuar tregun e frangut francez, të sterlinës angleze, të juanit japonez, të markës gjermane dhe arriti që të ushtronte mbi vendet që përfaqësojnë këto tregje ligjet e veta ekonomike, politike dhe ushtarake. Kështu shoqëritë dhe monopolet e mëdha amerikane infiltruan dhe u instaluan kudo në vendet kapitaliste, në Gjermaninë Perëndimore, në Francë, në Angli dhe në ish-kolonitë e tyre, në Japoni e gjetkë dhe, nëpërmjet Traktatit të NATO-s, u bënë «mburoja» e gjithë botës kapitaliste. Si rrjedhim, kjo shtrirje i dha mundësinë industrisë ushtarake amerikane të punonte me ritme të larta për të sofistikuar armatimet dhe për t'i zhvilluar ato në një shkallë aq të madhe sa që Shtetet e Bashkuara të Amerikës arritën në gjendje t'i lidhnin mirë pas qerres së tyre të gjithë pjesëtarët e NATO-s dhe të bëheshin furnitorët kryesorë të armëve në botë. Kjo, natyrisht, nuk mund të vazhdonte tërë jetën. Kështu erdhi një kohë që pjesëtarëve të NATO-s, të cilët ndaj Shteteve të Bashkuara kishin detyrime dhe në «sofrën e përbashkët» kishin çanakun më të vogël, iu hap edhe atyre oreksi dhe organizuan e forcuan potencialin e vet ekonomik brenda dhe jashtë vendeve të tyre, u fuqizuan, gjithashtu, ushtarakisht dhe i hynë punës për të krijuar një organizëm të ri reaksionar, Tregun e Përbashkët Evropian.

Me kalimin e kohës, Tregu i Përbashkët Evropian, nga ana e organizimit, e ndarjes së roleve, e kontributeve ekonomike dhe e njëfarë stabiliteti ose marrëveshjeje rreth shkëmbimit reciprok të mallrave që prodhoheshin pak a shumë të planëzuara e të njëfarë stabiliteti monetar kundrejt monedhave të tjera, erdhi duke u forcuar. Tendencat e këtij grupimi synonin të balanconin, ose më mirë të themi të kundërshtonin, sa të ishte e mundur, diktatin amerikan në çështjet ekonomike në Evropë, të

frenonin ekspansionin amerikan në tregjet e vendeve anëtare të Tregut të Përbashkët Evropian, të konkurronin tregun amerikan dhe të zgjeronin tregjet e zonat e influencës së tyre, si në tërësi, ashtu edhe veç e veç për çdo shtet anëtar të këtij Tregu.

I gjithë ky organizim politik e ekonomik bëhej jashtë dëshirave e pushtetit ekonomik amerikan. Bile, dhe kjo është e qartë, një organizim i tillë plot kontradikta nuk u pëlqente Shteteve të Bashkuara të Amerikës edhe nga pikëpamja politike, prandaj ato u përpoqën që ta pengonin krijimin e këtij bashkimi të ri.

Në këtë drejtim e në këtë proces ne shohim që të shtohen kontradiktat në mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe «Evropës së Bashkuar» në Tregun e Përbashkët Evropian, ku secili shtet më vete, po edhe si grup, kanë qëllimet e objektivat e tyre të veçantë, si ndaj njëri-tjetrit, ashtu edhe kundrejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Këta të fundit veprojnë kundër Tregut të Përbashkët Evropian si nga jashtë, edhe nga brenda. Siç tregojnë ngjarjet, kartën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për të dobësuar Tregun e Përbashkët Evropian dhe synimet e tij nga brenda e luan Anglia. Në fakt, mbledhja e kryeministrave të vendeve anëtare të Tregut të Përbashkët Evropian, që u mbajt këto ditët e fundit në Luksemburg, pësoi fiasko pikërisht për shkak të kundërshtimit të Anglisë për të kontribuar me shumën që i caktohej nga partnerët e tjerë të Tregut të Përbashkët Evropian.

Përveç kësaj, nga njëfarë ujdje, për të mos thënë bashkëpunim të ngushtë që ekzistonte në mes Francës dhe Gjermanisë Perëndimore, aktualisht në mes tyre po shohim njëfarë ftohjeje dhe në disa çështje duket qartë se Republika Federale e Gjermanisë mban më tepër anën e amerikanëve. Dihet se Republika Federale e Gjermanisë është anëtarja më e fuqishme ekonomike, mundet

edhe ushtarake e «Evropës së Bashkuar». Ja, për shembull, është Boni ai që në krizën e madhe botërore, dhe veçanërisht në krizën e dollarit, ndihmoi disi monedhën amerikane, kurse Franca ka filluar të tregohet më e paruar ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Franca e Zhiskarit është, si me thënë, fëmija më xanaxare e Tregut të Përbashkët Evropian. Ne nuk mund të themi se ajo nuk ka influencë në këtë treg. Por mosmarrëveshjet dhe kontradiktat e «Evropës së Bashkuar», të Tregut të Përbashkët Evropian, nuk konsistojnë vetëm në fushën e marrëdhënieve, si grup me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Aktualisht çdonjëri prej shteteve që përbëjnë Tregun e Përbashkët Evropian ka filluar në shkallë të gjerë të rikrijojë e të forcojë zonat e veta të influencës. Bile Franca, nga ana e saj, po aktivizohet gjërisht edhe me dërgim ushtarësh e komandosh në Afrikë e, veçanërisht, në vendet frankofone. Këto vende Franca i mban nën drejtimin dhe pushtetin ekonomik e ushtarak të saj jo vetëm me anë të financimit dhe të investimeve, por atje ka, gjithashtu, një bazë kulturore, një shtresë intelektualësh në udhëheqjet e këtyre vendeve. Kështu këto lidhen me Francën jo vetëm ekonomikisht e ushtarakisht, por edhe nga ana kulturore e shpirtërore.

Nga ana e saj, Gjermania Perëndimore, që ka një potencial të madh ekonomik dhe ushtarak, livadhis poshtë e lart me grushtin plot marka nëpërmjet shitjes së fabrikave e të teknologjisë kudo ku gjen treg, dhe tregje ajo gjen boll, pse të gjitha vendet e ashtuquajtura të paan-gazhuara nderin duart e tyre nga të katër anët dhe marrin nga të gjithë.

Edhe Italia investon, por nuk ka fuqinë e dy vendeve që përmenda më lart, as atë të Anglisë, e cila përpiqet, gjithashtu, të rimëkëmbë zonën e saj të influencës në botë, megjithëse kurdoherë ka qenë dhe vazhdon të jetë

një partnere treçerek luajale ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Kanadasë.

Për sa i përket anës ushtarake, vendet e «Evropës së Bashkuar», që bëjnë pjesë në NATO, me përjashtim të Francës, e cila është pjesëtare e NATO-s, por ushtarakisht nuk është angazhuar në të dhe ka armët e veta bërthamore që nuk i kanë të tjerët, e ruajnë aleancën me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe, nën ombrellën e kësaj aleance, e cila ka të çara, por që i mbron nga shiu, nga breshëri dhe nga rrufeja sovjetike, punojnë si për fuqizimin në përgjithësi të saj, ashtu edhe të çdo anëtari veç e veç.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës e shikojnë lojën e dyfishtë të Tregut të Përbashkët Evropian dhe të pjesëtarëve të NATO-s në këto situata dhe kjo lojë e dyfishtë nuk u leverdis, prandaj kërkojnë që vendet që bëjnë pjesë në NATO t'i binden Uashingtonit, ose, më mirë të themi, të njohin udhëheqjen amerikane, qoftë në NATO, domethënë në fushën ushtarake, qoftë në Tregun e Përbashkët Evropian, domethënë në fushën ekonomike. Me fjalë të tjera, vendet e «Evropës së Bashkuar», duhet të bëjnë një politikë të tillë ekonomike, që të mos dëmtojë interesat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, përkundrazi ata të jenë një shtojcë e tyre dhe, në tregjet ku po futen e po zhvillohen, të kenë parasysh edhe interesat amerikanë. Kjo edhe për arsye se Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë potencial material dhe teknologjik më të përparuar, gjë që gjoja influencon edhe në «mbrojtjen» e Perëndimit nga forca goditëse e socialimperializmit sovjetik. Mirëpo ligji i xhunglës në botën e kapitalit vepron pa marrë parasysh dëshirat e njërës apo të tjetrës palë, kontradiktat thellohen. Kështu ne mund të mendojmë dhe të themi se Tregu i Përbashkët Evropian reaksionar kapitalist, si një forcë ekonomike, politike dhe ushtarake brenda NATO-s, ka filluar të dalë në skenë, në mënyrë

jo aq të varur dhe jo aq të bindur përballë «lidershipit» amerikan.

Aktualisht, shohim se si përpara imperializmit amerikan, ashtu edhe përpara Bashkimit Sovjetik socialimperialist po ngrihet lëvizja popullore nacionalçlirimtare. Ne shohim, gjithashtu, se edhe përpara «Evropës së Bashkuar» po fuqizohen lëvizja dhe lufta nacionalçlirimtare e popujve për liri, për demokraci, për sovranitet.

Në këto momente, në botë përkrah njëri-tjetrit qëndrojnë imperializmi amerikan, socialimperializmi sovjetik, imperializmi i ri kinez dhe «Evropa e Bashkuar». Kontradiktat dhe krizat në mes këtyre blloqeve kapitalisto-imperialisto-revizioniste po thellohen. Kriza e dollarit, e frangut, e markës, e rublës dhe e të gjitha monehave të tjera të vendeve kapitaliste, shkaktohet nga kriza e madhe politike dhe ekonomike që ka mbuluar këto vende.

Përballë imperializmit të vjetër, tani shohim që socialimperializmi sovjetik po bëhet çdo ditë e më tepër agresiv dhe po ndërhyt me armë në vende të ndryshme të botës, në tregje e në zona influence që i pretendojnë imperializmi amerikan dhe kapitalizmi botëror. Prandaj ky invadim ndesh jo vetëm në kundërshtimin e popujve që bien viktimë e agresioneve sovjetike, por edhe në kundërshtimin e imperializmit amerikan dhe të «Evropës së Bashkuar».

Ç'është e vërteta sot për sot imperializmi amerikan gjendet në pozita të vështira e të dobëta përballë akteve invaduese të socialimperializmit sovjetik. Kjo edhe për arsye se ai është në kontradikta me partnerët e tij të «Evropës së Bashkuar». Kjo e fundit nuk pranon politikën aventureske dhe luftënxitëse të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, nuk pranon që t'u bindet verbërisht veprimeve të planëzuara në Uashington dhe veçanërisht veprimeve kundër Iranit dhe vendeve të Lindjes së Mesme. Pikë-

risht për këto dy rastet e fundit, qeveria amerikane i ka qortuar aleatët e vet të «Evropës së Bashkuar» e të tjerë, që nuk e mbështetin, duke u thënë hapur se ne, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, do t'ju ndihmojmë ju në rast të një sulmi nga sovjetikët, edhe ju duhet të na ndihmoni ne në mbrojtjen e zonave tona të influencës neokolonialiste në botë.

Ne konstatojmë se fuqitë perëndimore vetëm me fjalë i mbështetin veprimet agresive dhe të çmendura të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Në realitet, në thelb, ata janë tërhequr dhe i kanë lënë amerikanët në baltë. Konkretisht këtë e pamë në mosmbështetjen e marrëveshjeve të Kemp Dejvidit, që u arritën midis Izraelit dhe Egjiptit nën patronazhin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e shohim në mospranimin e kërkesave për masa ekonomike e politike kundër Iranit, në mospranimin e kërkesave të qeverisë amerikane për të bojkotuar lojërat olimpikë që duhet të zhvillohen sivjet në Moskë etj. Në këto situata ne shohim se si pikërisht Franca jo vetëm forcon pozitat e saj në Afrikë, por, duke lënë hapur të kuptohet se nuk është dakord me politikën amerikane në Gjirin Persik e në Lindjen e Mesme, kohët e fundit dërgoi atje vetë presidentin D'Estën për vizitë zyrtare. Me fjalë të tjera, Franca po tregon qëndrim të hapët kryengritës ndaj statukuosë së mëparshme kur politika prej «lidershipi» e amerikanëve bënte ligjin në këto vende dhe kudo tjetër në botë.

Në të njëjtën kohë ne shohim se Tregu i Përbashkët Evropian, domethënë të nëntët e «Evropës së Bashkuar», me ndonjë dallim në qëndrimet e tyre, nuk dëshirojnë t'i acarojnë punët me Bashkimin Sovjetik. Edhe këtu shquhet Franca, e cila, në përpjekjet për uljen e tensionit me Bashkimin Sovjetik dhe për vazhdimin e dialogut me të, dallohet më tepër nga partnerët e saj të «Evropës së Bashkuar». Në këtë rrugë, me një intensitet më të vogël,

po ecën edhe kancelari Shmid i Gjermanisë Perëndimore, kurse Anglia tregohet po aq intransigjente sa edhe vetë Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Këto konsideracione tregojnë se Shtetet e Bashkuara ndodhen jo vetëm përballë fuqisë tjetër imperialiste, Bashkimit Sovjetik, por edhe përballë mosmarrëveshjeve dhe kontradiktave që shtohen me partnerët e saj të «Evropës së Bashkuar», gjë që i vë në pozita të vështira dhe i pengon të konfrontohen me Bashkimin Sovjetik.

Imperializmi amerikan dhe kapitalizmi botëror kanë investuar me miliarda dollarë në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera të ish-demokracisë popullore me shpresë jo vetëm të siguronin fitime të mëdha ekonomike, të cilat, në fakt i kanë siguruar, por edhe që t'u impononin Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të Traktatit të Varshavës pikëpamjet dhe politikën e tyre të dobësimit të politikës hegjemoniste e të agresionit sovjetik dhe të forcimit të hegjemonisë amerikane.

Por edhe Bashkimi Sovjetik, në radhë të parë, ka ditur të marrë kredi, teknologji moderne perëndimore dhe amerikane për të fuqizuar industrinë e për të modernizuar teknologjinë e vet, për të përmirësuar industrinë e prodhimit të armëve, t'i shtojë këto dhe fuqinë e tyre të zjarrit, pra të fuqizojë ushtrinë e tij agresive. Si rezultat sot Bashkimi Sovjetik gjendet në pozita të forta ushtarake dhe me një ekonomi të militarizuar.

Bashkimi Sovjetik, pavarësisht se ka kontradikta me aleatët e tij të Traktatit të Varshavës, pavarësisht se i ka lejuar këta të marrin teknologjinë perëndimore nëpërmjet kredive të panumërta, i mban në zap dhe të pushuar. Në rast të një konflagracioni botëror ose të një konfrontimi me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pjesëtarët e Traktatit të Varshavës, nën kamxhikun sovjetik do të ecin së toku me të, kurse NATO-ja nuk do të ecë aq kompakte nën kamxhikun amerikan. Megjithatë,

dhe derisa të arrihet në një konfrontim, aktualisht «Evropa e Bashkuar» po i hedh disa vicka imperializmit amerikan.

Në përfundim mund të dalim në këtë konkluzion: **sot Bashkimi Sovjetik socialimperialist vepron pa pyetur kërkkënd dhe në veprimet e tij agresive gjen përpara kundërshtarë të dobët, ndërsa imperializmi amerikan përpigjet të vërë në zap aleatët e vet të NATO-s duke u bërë kërcënime ushtarake dhe presione ekonomike, por nuk është në gjendje të veprojë aq lirisht siç vepron Bashkimi Sovjetik me aleatët e tij të nënshtruar.** Këtu është thundra e Akilit amerikan, pse qëllimet, dëshirat dhe veprimet e veçuara të imperializmit amerikan janë në kulm agresive dhe çojnë drejt një lufte botërore imperialiste, ndryshe ai nuk mund të fitojë dhe të lejojë një situatë të tillë që i sjell vdekjen. Përpara vdekjes ai do të ndeshet, në mos sot nesër me socialimperializmin sovjetik, dashkan apo nuk dashkan aleatët e tyre të NATO-s e të Traktatit të Varshavës. **Aleatët e NATO-s ose ata të Traktatit të Varshavës po përpëliten në një politikë të balancimit në pragun e luftës botërore, por kjo nuk do t'i shpëtojë nga një rrezik eventual që mund të shkaktohet nga imperializmi amerikan dhe socialimperializmi sovjetik.**

Shtetet e Bashkuara të Amerikës kërkojnë, pra, që t'i kenë aleatët evropianë nën një zap më të fortë, dhe, nga ana tjetër, përpigjen dhe do të përpigjen që, bashkë me klikën e Ten Hsiao Pinit, të konsolidojnë dhe të kompensojnë dobësimin që u vjen nga Evropa Perëndimore me aleancën kino-japoneze. Po ta shohim zhvillimin e ardhshëm në këtë prizëm, për strategjinë imperialiste rëndësi të madhe merr aleanca amerikano-kineze, për arsye se Kina është një partnere më e dobët se partnerët e «Evropës së Bashkuar», Kina është e etshme për armatime e për teknologji për të realizuar «katër modernizimet» dhe

për më tepër është në armiqësi me Bashkimin Sovjetik. Pra për Shtetet e Bashkuara të Amerikës, **për strategjinë amerikane, guri më i mirë e më i favorshëm në gjendjen aktuale të tabelës së shahut, është Kina** dhe tok me këtë edhe Japonia, sido që kjo e fundit është me potencial ekonomik dhe ushtarak shumë më të madh e më të përparuar se Kina e Ten Hsiao Pinit.

Në këto ujëra, në këtë gjendje, në këtë politikë të çoroditur vërtitet aktualisht administrata e kalbur e Xhimi Karterit.

Neve na bie detyra që këto situata t'i shfrytëzojmë. Me aq sa mundim ne, komunistët shqiptarë, në unitet të plotë me popujt që luftojnë dhe me komunistët në botë që udhëheqin lëvizjet çlirimtare, duhet të luftojmë me të gjitha forcat dhe me të gjitha mjetet që të godasim pa mëshirë dhe të demaskojmë katërcipërisht qëllimet, veprimet dhe komplotet agresive, politikën pseudodemokratike, pseudosocialiste, fashiste të të gjitha shteteve imperialiste që përpëlitën në vorbullën e kapitalizmit botëror që po jep shpirt. Luftën ne duhet ta pengojmë duke luftuar kundër tyre, të jemi vigjilentë, por vigjilentë jo në apati dhe duke qëndruar duarkryq, por në veprim, në aksion e në luftë për të shfrytëzuar çdo të çarë. Marksistë-leninistët e vërtetë, forcat revolucionare, popujt liri-dashës duhet ta kuptojnë se, pavarësisht se situatat janë shumë të rrezikshme, ato njëkohësisht janë edhe shumë të favorshme për popujt, për revolucionin.

## VDIQ TITOJA

Sot agjencia jugosllave e lajmeve Tanjug njoftoi vdekjen e Titos.

Titoja ishte një armik i tërbuar dhe nga më të rrezikshmit të komunizmit. Ai ishte një renegat me patentë antimarksiste e antileniniste, ishte një agjent i hibridizuar i kapitalizmit botëror, ishte dhe luftoi deri në fund kundër shoqërisë socialiste. Titoja jetoi dhe sundoi si mbret i Jugosllavisë, e bëri këtë çifligun e fuqive imperialiste e veçanërisht të imperializmit amerikan. Ai ishte një shovinist dhe megaloman pa fre, armik i egër e agresiv ndaj popullit shqiptar dhe Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë. Titoja e urrente në kulm Partinë e Punës të Shqipërisë. Ai i shtrydhi, i mashtroi shqiptarët që jetojnë në tokat e veta në Jugosllavi. Armiqësia e tij kundër Stalinit të madh dhe kundër marksizëm-leninizmit i shërbeu kapitalizmit botëror, i cili e pompoi këtë renegat dhe e ngriti si një «personalitet ndërkombëtar» për të mashtruar popujt dhe për të luftuar komunizmin, revolucionin dhe luftërat nacionalçlirimtare të popujve.

Popujve të Jugosllavisë vdekja e tij do t'u lërë pas mjerimin ekonomik dhe politik, përçarjen dhe grindjet në mes mozaikut të popujve që formojnë atë që quhet Federata Jugosllave. Sistemi i vetadministrimit do të

shkrijë si bora në ujë dhe politika «botërore» e «mosangazhimit» do të pëlcasë si një flluskë sapuni.

Partia jonë me kohë e me guxim ia çori maskën këtij renegati. Jeta, faktet vërtetuan drejtësinë e luftës marksiste-leniniste të Stalinit dhe të Partisë sonë kundër Tito tradhtarit, Tito agentit të kapitalizmit botëror.

E MËRKURË

7 MAJ 1980

## NJË CEREMONI MASKARADË

Po shoh në televizionin jugosllav ceremoninë ose, më ekzakt, ceremonitë e varrimit të Titos. Me të vërtetë diçka skandaloze, një organizim superpompoz, varrim i një njeriu «superbotëror»! As në histori, as në filma kinematografikë, bile fikzioni, nuk mund të shikosh një gjë të tillë! As në kohën e monarkive nuk bëhej një maskaradë e tillë, pa le në kohët kontemporane. Çdo gjë e organizuar në fill e për pe, çdo veprim, çdo hap, i cilitdo, i organizuar me ekzaktësi, me kronometër, me lule, me flamurë, me dekorata nga të gjitha vendet e botës, me udhëtimet e tij nëpër botë të telekronikuara me mjeshtëri, me paramendim, me delegacione të panumërta që nga Brezhnjevi dhe deri te djalli me të birin! Vetëm, në gjithë këtë ceremoni, nuk treguan se ai e shiti Jugosllavinë të të huajt, se e ka mbytur në borxhe, nuk treguan që në Jugosllavi ka mbi një milion të papunë dhe të mërguar, nuk treguan inflacionin që ka arritur 30 për qind, nuk treguan ngritjen e çmimeve e fatkeqësi të tjera të panumërta. Pikërisht për të mbuluar këtë mjerim, organizuan këtë farë varrimi!

Por shpejt sytë do të na shohin gjëra të tjera. Shpejt gjithë bota do të shohë atë të vërtetë të madhe që ka thënë dhe e ka mbrojtur Partia jonë e Punës: falimentimin e gënjeshtres dhe të tradhtisë titiste.

E SHITUNË  
10 MAJ 1980

## MBRETËRIMI I MONARKUT TITO MORI FUND

Zhdukja e palavdishme, e orkestruar me aq mjesh-tëri e hosanara, e monarkut Tito u mbyll. Për ironi, me himnin e internacionales. Derisa e mbuloi guri i varrit titistët nuk munguan të gënjenin, të bënin demagogji.

Borgjezia është e poshtër, është dinake, është e pa-turpshme.

Për të varrosur këtë aventurier, që e quanin Josip Broz, në Beograd shkuan derri e dosa. Vetëm Shqipëria socialiste nuk dërgoi asnjëri, pse është një republikë e lavdishme socialiste, armike e betuar e borgjezisë kapita-liste e revizioniste.

Titoja ishte dhe vdiq armik i betuar i marksizëm-leninizmit, i socializmit dhe i komunizmit. Ne, komu-nistët shqiptarë, e luftuam atë pa mëshirë sa ishte gjallë dhe luftën kundër titizmit, një nga variantet e revizioniz-mit modern, do ta vazhdojmë deri në fund.

Siç e thanë apostujt që la pas Titoja, në meshat e veta, kur i kënduan *De profundis*-in «kryetarit» të tyre, orientimi i politikës jugosllave është: 1) «vëllazërim-bashkim», 2) «vetadministrim», 3) «mosangazhim». Pra «ati, biri dhe shpirti i shenjtë». Amin!

1. Bashkim-vëllazërimi është pjellë e Klemansoit<sup>1</sup> në Traktatin e Versajës; pra një shtet me arna të grabitura

1 Zhorzh Klemanso — negociator i Francës në Traktatin e Versajës midis Francës e aleatëve të saj dhe Gjermanisë.

poshtë e lart e të qepura me makinë imperialiste, mbi të cilin vendosën një monarki dhe një mbret, që shtypte popujt e ndryshëm dhe që ndiqte politikën e padronit francez. Këtë mbret kukull e vuri në fron Parisi dhe e vrau Marseja pa pasur kohë dhe kokë që të këndohej dhe Marsejeza.

Këtë formulë «Bashkim-vëllazërim», pas Luftës së Dytë Botërore, e adoptoi një mbret tjetër, që hiqej si komunist, por që, nën këtë petk, fshihej një mbret i ri, këtë herë jo serb dhe jo i quajtur Karagjorgj, por kroat e që kishte emrin Josip Broz Tito.

Ky «Bashkim-vëllazërim» nga monarki u transfor-mua në republikë federative. U quajt edhe socialiste, për të gënjyer masat dhe popujt që luftuan për çlirimin e për unitetin e tyre deri në shkëputje. Por kush i linte popujt e Jugosllavisë të vetëvendosnin deri edhe në shkëputje? Sa për vetëvendosje atyre u dhanë vetadministrimin.

2. Vetadministrimi ishte maska pseudomarksiste që fshihte sistemin kapitalist që po ndërtohej, për të tjetër-suar në një formë të re mbretërinë e Karagjorgjëve. U ndërrua forma, u ndërrua dhe padroni. Karagjorgjët ki-shin një padron kryesor dhe nuk e fshihnin, Francën. Ti-toja kishte një padron tjetër kryesor: Shtetet e Bashkua-rra të Amerikës, por edhe një sërë vendesh të tjera kapi-taliste, dhe ia donte puna që të hiqej «i barabartë midis të barabartëve». Titoja hiqej «i paangazhuar», sepse kështu ia donte puna atij, ua donte puna edhe padronëve të tij.

3. «Mosangazhimi» është e kundërta e angazhimit. Ti-toja donte të gënjente me një «mos» të vogël dhe të hi-qej «i pavarur» kur litarin e kishte në grykë e kur lita-rin ua hodhi në grykë popujve të Jugosllavisë. Por mbre-ti Tito rrojti si mbret me proverbin «pas meje le të bëhet kiameti».

Sot kapitalizmi botëror bën pyetjen: «Ç'do të bëhet

pas Titos?». Ne, komunistët shqiptarë, themi se atë që do të ndodhë «pas Titos» e kemi parashikuar përpara «pas Titos». Ne jemi dialekticienë, pse jemi marksistë-leninistë. «Dielli duket që kur lind», thotë populli ynë dhe ne e pamë dhe e luftuam titizmin që kurse lindi dhe derisa përfundoi i kredhur në tradhti, në pabesi, në intriga, në vrasje e në gjenocide, në gënjeshtër, në shërbim të kapitalizmit botëror me atë amerikan në krye, në akrobacia politike të ndyra që i sillnin mjete për qejfet e zbavitjet mbretit Tito dhe kurtizanëve të tij, kurse popujve të Jugosllavisë përçarjen, zgjedhën dhe mjerimin politik e ekonomik.

«Pompoziteti i varrimit» të mbretit e ka bishtin prapa, si dardhë. Ja, kjo do të jetë «pas Titoja», që i ha merak mbretërit, presidentët dhe kryeministrat me kancelaritë e tyre, që morën pjesë në varrimin e këtij politikani aventurier, të këtij mbreti mufliz të falimentuar, të korruptuar shpirtërisht, politikisht, materialisht. Dhe për këtë parvenu ishin plotësisht në dijeni mbretërit dhe presidentët se ç'është e ndotur dilte nga ai arkivol i mbuluar me dekorata për shërbime të larta që i kishte sjellë kapitalizmi botëror. Ata u larguan të habitur nga luksi i madh i varrimit, nga uniformat e shkëlqyera, nga veturat, flamurët, protokollat, fjalimet e kurdisura me mjeshteri gjatë katër muajve të Golgotasë së profetit Simonik. Mbretërit dhe presidentët e borgjezisë dhe të revizionizmit e paguan edhe këtë luks të varrimit. «U mbyll për bukuri» Titoja në varr dhe kapitalizmi botëror «mbolli erën, po korri furtunën». Tash bën pyetjen: «Ç'do të ngjashë pas Titos?». Çdo gjë do të shkatërrohet, se e shkatërruar ishte, çdo gjë do të falimentojë, se e falimentuar ishte, çdo gjë do të demaskohet, se bluf ishte, kala e ndërtuar mbi rërë ishte. Jo «do ta sulmojë Bashkimi Sovjetik», jo «s'e lë Amerika», jo «vajti Brezhnjevi në varrim», jo «s'vajti Karteri», jo po «Karteri s'vajti sot, po do të

vejë nesër», jo «kush do ta drejtojë lëvizjen e «të paangazhuarve» Kastroja, Indira Gandhi, presidenti i Algjerisë» etj., etj. Të gjitha këto po thuhën. Ne komunistët shqiptarë themi «të paangazhuarit» janë të angazhuar dhe këta do të udhëhiqen siç kanë qenë të udhëhequr deri më sot, nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe nga Bashkimi Sovjetik. Vetëm lufta e popujve mund ta ndryshojë dhe duhet ta ndryshojë këtë situatë.

Kështu edhe në Jugosllavi, vetëm lufta e ashpër parimore marksiste-leniniste, lufta e klasave, varrosja një herë e përgjithmonë bashkë me Titon e titizmit, e sistemit të vetadministrimit nga ana e popujve të Jugosllavisë, do ta shpëtojë popullin jugosllav, do ta bëjë atë të pavarur, të lirë, sovran. Vetëm ndërtimi i vërtetë i socializmit në rrugën e marksizëm-leninizmit do të mund t'i sigurojë Jugosllavisë pavarësinë e sovranitetin. Tjetër rrugë, veç asaj kapitaliste, të skllavërimit, të vartësisë, të degjenerimit, të shtypjes dhe të neokolonializmit, nuk ka.

## TË DEMASKOJMË QËNDRIMIN ANTISHQIPTAR TË ANGLISË

I dhashë shokut Ramiz disa ide për të përgatitur një artikull<sup>1</sup> kundër Anglisë për çështjen e arit që na ka grabitur. Këtë ar, siç dihet, më parë e patën grabitur nazistët gjermanë, nga të cilët pastaj e grabitën anglezët e që Konferenca tripalëshe e Parisit, e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e Francës dhe e Anglisë, ia akordoi pjesën e vet Shqipërisë. Anglia padrejtësisht e ka bllokuar arin tonë. Për të na e kthyer atë të cinguar invokon incidentin e Korfuzit, shkaktarët e të cilit nuk jemi ne, kërkon dëmshpërblime për dëmet e pësuarra dhe vë si konditë edhe marrëdhëniet diplomatike. T'i demaskojmë.

<sup>1</sup> «Ari i grabitur nga Anglia duhet t'i kthehet Shqipërisë». «Zëri i popullit», 24 maj 1980.

## TRASHËGIMIA E TITOS

Titoja nuk kishte besim në unitetin e kombësive të ndryshme që përbëjnë Jugosllavinë dhe kjo e kishte bërë bindjet e tij antimarksiste. Ai dhe grupi i tij ishin nacionalistë-shovinistë. Parulla «**bashkim-vllazërim**» mbështetej në një ideologji që ndan dhe nuk bashkon. Ajo «**bashkon**» vetëm për të dominuar klani më i fortë e për të shfrytëzuar më të dobët.

Analiza e drejtë e gjendjes brenda në Jugosllavi nuk të lejon të mendosh se Titoja me «autoritetin» e tij e kishte realizuar «bashkim-vllazërimin» në Federatë. Është e vërtetë të thuhet se Federata u ruajt dhe u krijua shtesa borgjeze titiste e federatistëve, por jo uniteti i republikave dhe i krahinave autonome, si dhe i kombësive të ndryshme që përbëjnë Federatën.

Titoja ishte një politikan dhe etatist borgjez i zgjuar që diti të fshihej për të manovruar nën sloganet pseudo-marksiste, të ruante për një kohë pushtetin e centralizuar të Federatës, por njëherësh të bënte edhe kthesën e decentralizimit brenda saj, pse dolën në dritë ndjenjat nacionale dhe shoviniste për dominim dhe për hegjemoni. **Në garë për dominim u vunë serbët, kroatët e sllovenët.** Titoja, në fakt, nuk mundi t'i dozonte dhe t'i frenonte dot këto lakmi. Ai anoi nga klani kroato-slloven, por duke vepruar në mënyrë të atillë që të kishte rolin e një arbitri «të pagabuar dhe të drejtë» dhe të jepte përshtyp-

jen e një udhëheqësi «të urtë, të zgjuar» dhe «marksist» të sprovuar. Kështu në këtë frymë ai goditi nacionalizmin serb të Rankoviçit, më pas atë të Nikeziçit dhe të Koça Popoviçit. Më vonë, më 1976-1977, ai goditi grupin e ushtarakëve serbë të Jovanoviçit, Shumonjës e të tjerëve, sikurse pati goditur edhe më 1971 grupin e nacionalistëve kroatë, me Tripallon në krye.

Përse flasin këto spastrime? **Këto flasin për rivalitetet që ekzistojnë dhe nuk mund të mos ekzistojnë në një shtet kapitalist.**

Zhvillimi jo i barabartë ekonomik në republikat dhe në krahinat autonome, brenda Federatës Jugosllave, nxiti shovinizmin, nacionalizmin dhe hegjemonizmin, pra e vuri Jugosllavinë titiste në një rrugëkryq: ose të vazhdonin grindjet dhe lufta për hegjemoni në mes klaneve serbe dhe kroato-sllovene për Malin e Zi, Maqedoninë, Bosnjën, Hercegovinën (krahina autonome e Kosovës qëndronte kurdoherë një krahinë e shtypur dhe e shfrytëzuar), ose të shtypeshin. **U ruajtën kështu republikat, krahinat autonome dhe Federata, por u vendos decentralizimi i ekonomisë, u vendos sistemi pseudosocialist i vetadministrimit.**

U mendua se me këto veprime u gjet zgjidhja e luftës së klaneve për hegjemoni dhe njëkohësisht u hap rruga e zhvillimit më të shpejtë në formë të pabarabartë të kapitalizmit në republika, po ashtu edhe pasurimi i shtresave të ndryshme të borgjezisë së re dhe të individëve në veçanti. **Titoja dhe klani i tij kroato-slloven, babai i këtij manovrimi favorizuan jo vetëm zhvillimin e pabarabartë të republikave e të krahinave, por forcuan Kroacinë dhe Sllloveninë me investime të jashtme dhe vendosën *de facto*, në mos *de jure*, hegjemoninë e këtij klani.**

Pra rivalitetet në mes kombeve dhe kombësive, në mes republikave dhe krahinave në Federatën Jugosllave,

jo vetëm nuk u zhdukën, por u acaruan dhe do të shkojnë duke u acaruar.

Është e qartë se klani i Titos mbante fort në duart e veta ushtrinë dhe sigurimin e shtetit, që përbënin të vetmen shtyllë të mbajtjes në fuqi të klanit titist federalist në këtë formacion të sajuar. Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë s'kishte asnjë funksion udhëheqës, por as edhe edukues, pse as në teori, as edhe në praktikë s'kishte se çfarë të edukonte, çfarë shoqërie të predikonte dhe me ç'ideale ta frymëzonte individin.

Vetadministrimi, në fakt, nuk ishte veçse një parodi administrimi, punëtorët s'kishin «votë në kapitull», ata ishin për formë, pse në bashkëpunim me shoqëritë shumëkombëshe dhe me kapitalin financiar të huaj që kishte ndarë zonat e influencës dhe të shfrytëzimit në Jugosllavinë federale, atje vendoste borgjezia e re. Dhe ky manipulim i madh bëhej nga klani i Titos dhe ligjërohej nga disa forume në shkallë krahine, republike dhe federate, që u përngjitnin dhomave të korporatave musoliniane.

Ky kaos kapitalist, ky regjim anarkist, kjo formë «korporative» musoliniane ta zëmë se mund të ecte sa ishte Titoja gjallë, po pas tij ç'do të bëhej? Krerët e klanit titist do të haheshin me njëri-tjetrin si qentë dhe si ujquit.

Thuhet se Titoja gjoja parashikoi edhe si duhej drejtuar pas vdekjes së tij dhe krijoi «udhëheqjen kolegjiale». **Po ç'ishte dhe ç'zgjidhte kjo udhëheqje kolegjiale?** Pas Titos nuk do të kishte më një president, po shumë presidentë në një presidencë. Kjo presidencë përbëhet nga një i zgjedhur për çdo republikë dhe krahinë autonome për 5 vjet dhe cilido nga këta me rotacion do të ishte «Çeërmën»<sup>1</sup> i kësaj presidencie për një vit.

Çdo gjë «u rregullua», por nuk u zgjidh dhe nuk do

1 Nga anglishtja: Chairman — kryetar.

të zgjidhet asgjë! Ç'do të ngjasë? Klani kroato-slloven i Titos do të sundojë atje, hëpërhë jo shumë në evidencë, dhe, në fakt, ky do të jetë grupi i Bakariç-Dolancit. Të tjerët federalistë, por marioneta, derisa të bëhet kohezioni i grupit rival serbo-malazez-maqedonas, dhe ky ashtu si edhe i pari federalist, në qoftë se bëhet hegjemon, ose separatist, në rast se thellohen grindjet.

**Pra, pas Titos, nuk mund të ketë stabilitet veçse të përkohshëm.** Situata e sotme eviton dominimin e klanit serb. Po deri kur? Aktualisht ekziston sistemi i pushtetit kolegjal i dy presidencave, ajo e republikës dhe ajo e Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë. Të tërë, 31 veta, janë të paefektshëm në marrje vendimesh, të tërë do të kalojnë në krye me rotacione dhe ky rotacion është i tillë që në një kohë do të sjellë atje nga çdo klan njerëz me autoritet ose pa autoritet, gjë që do të krijojë paqëndrueshmëri, rivalitet dhe do të çojë në krijimin e domoshëm të një personaliteti të vetëm, që do ta ndërrojë këtë «kala» (formë pushteti) të ndërtuar mbi rërë.

Klani kroato-slloven tani dominon, por, gjatë kohëve që do të vijë, do të diferencohet e do të afirmohet edhe klani serb (Miniç, Lubiç, Vidiç, Markoviç, Stamboliç e të tjerë). Tani këta punojnë të krijojnë situata të favorshme për klanin e tyre dhe do të përpiqen të godasin në fushën ekonomike, si dhe të fitojnë edhe pozita dominuese politike. Klani serb është më i gjallë, më dinamik dhe ka pozita më të gjera në kuadrin e mesëm. Udhëheqja aktuale dëshiron që të jetë federaliste, pse ia do interesi, por kjo nuk do të varet shumë dhe kurdoherë nga vullneti i saj. Zhvillimi kapitalist në forma të reja dhe influenca e kapitalit të huaj financiar do të luajnë atje një nga rolet vendimtare në të ardhmen.

Tani për tani nuk ngrihet problemi i ndërhyrjes së Bashkimit Sovjetik në Jugosllavi. Çështja qëndron në formën që do të marrë në këtë vend pushteti kapitalist.

Mendoj se tendenca e ruajtjes së Federatës do të vazhdojë, por njëkohësisht do të ketë edhe luftë për hegjemoni në mes serbëve dhe kroato-sllovenëve. Ky rivalitet do të kalojë në formën e centralizimit të pushtetit, në të cilin do të dominojë klani më i fuqishëm ekonomik që do të ketë mbështetjen e ushtrisë.

**Aktualisht do të dominojë klani kapitalist që mbështetet në kapitalin perëndimor.** Kjo nuk do të thotë se klani serb është prosovjetik. E kaluara pansllave nuk do të luajë atë rol që dëshirojnë t'i japin nga Moska. Reakcioni serb është properëndimor, kozmopolit, mund të them edhe antirus. Megjithatë kjo nuk do të thotë mungesë simpatie ndaj rusëve, por do të shërbejë si një koniunkturë politike e jashtme në luftën e klaneve.

Kapitali sovjetik mund të influencojë më shumë në Serbi, por mundet edhe në Kroaci, pa harruar Maqedoninë nëpërmjet bullgarëve. Në këtë vështrim nuk do të mbetet pas as kapitali amerikan, as ai perëndimor. Do të ketë luftë klanesh të brendshme, luftë në mes shtresave të ndryshme të kapitalistëve në republikat, luftë në mes monopoleve të ndryshme perëndimore, të këtyre me monopolet sovjetike dhe evropianolindore, si dhe luftë klase në mes proletariatit dhe borgjezisë së shitur jugosllave.

Diversion të armatosur nga ana e sovjeta-bullgarëve mund të ketë, por, sidomos në këto situata, në qoftë se do të ketë, këto do të jenë aventura dhe çdo orvatje nga ana e tyre do të shtypet shpejt. Të ashtuquajturit informbyroistë, si dhe rankoviçistët e ustashët janë të dobët dhe të pafuqishëm. Orvatjet jashtë klaneve proserbe apo prokroato-sllovene për separatizëm e për thirrje ndihme nga sovjetikët nuk do kenë as më të voglin sukses.

Në këto situata shqiptarët që jetojnë në Jugosllavi duhet të forcojnë unitetin e tyre kombëtar dhe ta afirmojnë atë në të drejtat kushtetuese. Të drejtat e fituara

duhet të përpiqen që t'i ruajnë, t'i forcojnë dhe t'i zgjerojnë. Ata duhet të jenë vigjilentë ndaj serbëve, por edhe në aleancat me kombësitë e tjera kërkohet që të jenë të matur, as liberalë e shpresues të verbër dhe as sektarë e difidentë përpara çdo situatë të favorshme koniunkturale në favor të tyre. Ata duhet të dinë të përfitojnë në çdo rast, të jenë gjakftohtë dhe të përgatitin me durim të ardhmen e tyre më të mirë e më të lirë. Çdo aventurë në këtë drejtim do të shtypet. Prandaj as aventura nuk duhet të bëjnë shqiptarët në Jugosllavi, po as të lejojnë që të shtypen ose t'u shkelen të drejtat. Vetëvendosjen e tyre do ta sjellin rrethanat, objektive dhe subjektive, do ta sjellë revolucioni brenda në Jugosllavi.

E DIEL

8 QERSHOR 1980

## NJË LIBËR QË DËSHMON PËR GABIMET POLITIKO- -IDEOLOGJIKE E USHTARAKE TË TITOS

Jam duke lexuar një libër të renegatit Milovan Gjilasi, të botuar kohët e fundit me titullin «La guerre dans la guerre».

Është e qartë se Gjilasi me këtë libër nuk ka ndër mend të mohojë luftën e popujve të Jugosllavisë, por me ç'shkruan e argumenton, ai vë në dukje se lufta partizane jugosllave dhe veçanërisht udhëheqja e Titos dhe e grupit të tij (Gjilasi veten e tij s'e përjashton, por e tregon më të dobëtin), ka qenë plot gabime politiko-ideologjike dhe ushtarake. Strategjia dhe taktikat e Titos në luftime, siç shkruan ai, kanë qenë me tërë kuptimin e fjalës defektoze, të pamatura. Jugosllavët kanë vrarë e prerë fshatarë pa asnjë dallim. Titoja dhe shokët e tij kanë djegur fshatra të tëra, njëlloj siç vepronin njerëzit e Drazhës, çetnikët dhe ustashët e Paveliçit. Lufta kryesore e Titos, sipas Gjilasi, ka qenë më shumë një luftë civile dhe më pak kundër pushtuesve. Gjilasi në librin e tij tregon për grindjet në grupin e Titos, manovrimet dhe tërheqjet e panumërta e me humbje të mëdha përpara goditjeve të armikut. Gjilasi evidencon kompromiset e Titos me gjermanët për të pushuar luftimet dhe thotë se për këto bisedime me gjermanët ai kishte dërguar vetë Gjilasin, Popoviçin, Rankoviçin dhe një tjetër, të tërë

anëtarë të Byrosë Politike të KQ të Partisë Komuniste të Jugosllavisë. Deri këtu kishte arritur shkarja e tradhtia. Këtë veprim ata ia fshehën Stalin.

Gjilasi flet për puthjen e plotë të Titos me anglezët dhe për antisovjetizmin e vjetër të grupit titist. Titistët e kishin qendrën e tyre në Bari, ku vinte Titoja, nën mbrojtjen e anglezëve. Ishulli i Visit, rezidencë e Titos, mbrohej, gjithashtu, nga luftanije angleze.

Gjilasi vë në dukje lustrën e madhe, ekzagjerimin që u bëhej luftimeve dhe të vrarëve. Ai thotë se në shifrën prej një milion e njëqindmijë të vrarë që jepen, përfshihen të gjithë: partizanë, ustashë, çetnikë, viktima në kampe e kudo, të vrarë e të djegur nga gjermanët, nga italianët, nga ustashët, nga çetnikët e Drazhës e të mbretit dhe nga partizanët e Titos.

Ç'nuk thotë Gjilasi në këtë libër të tij! Dhe të gjitha ato janë të vërteta. Popujt e Jugosllavisë kanë luftuar. Kjo për mua nuk ka dyshim, por Titoja dhe grupi i tij kanë blouar, kanë gënjyer, janë hequr për çka nuk ishin. Edhe lufta jonë ka qenë një luftë e ashpër kundër pushtuesve, por vija politike, ideologjike, ushtarake e Partisë sonë, ka qenë në çdo moment e drejtë, e qartë dhe pa gabime e devijime.

Sukseset e Partisë në luftë, në organizim, në strategji dhe në taktikat e luftimit kanë qenë të vërteta, të sakta. Ato nuk janë shtrembëruar kurrë. Lufta jonë ishte pa dallavere, pa kompromise politike dhe ushtarake me armiqtë pushtues dhe kuislingët. Është e qartë pse titistët donin ta nënvleftësonin, ta përçmonin dhe ta denigronin Luftën tonë Nacionalçlirimtare. Është i qartë qëllimi i Titos dhe i të dërguarve të tij, që donin të rrëzonin udhëheqjen tonë të Partisë e të Luftës Nacionalçlirimtare. Asnjë fjalë nuk thotë tradhtari Gjilasi për gjithë atë luftë heroike që bënë partizanët tanë për çliri-

min e popujve të Jugosllavisë. Por historia do të zbulojë më tej qelbësirën e Titos dhe do të bëjë të shkëlqejë lufta e Partisë Komuniste të Shqipërisë dhe e popullit tonë.

**E ENJTE**  
**12 QERSHOR 1980**

## **PËRSËRI MBI ÇËSHTJEN E DËMSHPËRBLIMEVE GJERMANE**

Sot i tërhoqa vëmendjen përsëri Mehmet Shehut për ngathtësinë me të cilën po ndiqet çështja e dëmshpërblimeve të luftës që i kërkojmë Bonit. Ministri i Punëve të Jashtme, Nesti Nase, po na e ngadalëson këtë çështje dhe nuk tregon as iniciativë, as gjallëri. Boni, nëpërmjet një gazete gjermane, po bën tërthorazi propozimet e veta, kurse ne 10 herë ia kemi kërkuar Nesti Nases variantet tona dhe ai po fle.

Porosita të përcaktojnë procedurën tonë menjëherë.

**E MARTË**  
**24 QERSHOR 1980**

## **XHIMI KARTERI ZBULON «AMERIKËN»**

Agjencia jugosllave e lajmeve Tanjug me entuziazëm shkruan se presidenti amerikan Xhimi Karter, duke iu përgjigjur pyetjeve të gazetës «Politika» lidhur me vizitën e tij në Beograd, ka thënë se «është shumë i mallëngjyer që po vjen në Jugosllavi».

As Kristofor Kolombi kur zbriti në El Salvador, nuk i shkroi kështu mbretit të Spanjës.

Ustai i Jugosllavisë në intervistën dhënë gazetës «Politika» deklaroi: «Ne i përmbahemi politikës sonë ndaj Jugosllavisë dhe nga ajo nuk heqim dorë». Perspektivë e shkëlqyer për popujt e Jugosllavisë! Jugosllavët mund të mburren se kanë një mik për kokë... për t'ua rrjepur lëkurën.

Përpara botës dhe veçanërisht popujve të Jugosllavisë Karteri pohoi se Titoja e ka futur Jugosllavinë nën diktatin dhe drejtimin amerikan «prej më shumë se 30 vjet më parë, që kur në postin më të lartë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës ndodhej presidenti Truman». Karteri, pra, me vetë gojën e tij e bëri të qartë, dhe shtypi jugosllav e shkruan të zezën mbi të bardhë, se qenia e Titos «komunist» qenkësh një profkë dhe drejtësia e vendimit të Stalinit kur e demaskoi këtë renegat, është e evidente.

Karteri, duke i bërë elozhe Titos, zbuloi në dritën e diellit tradhtinë e udhëheqësit renegat jugosllav ndaj marksizëm-leninizmit.

Karteri më poshtë thotë: «Kam shumë dëshirë të takohem me udhëheqësit e rinj të Jugosllavisë» dhe nuk mungoi të shtonte se vinte nga Konferenca e Venecias, ku «të mëdhenjtë» e imperializmit botëror diskutuan për «hallet e tyre» dhe si t'ua hedhin ato në kurriz popujve të botës. Ai tha se do t'ua transmetonte me këtë rast jugosllavëve pikëpamjet «se si vendet e zhvilluara perëndimore e shikojnë procesin e mëtejshëm të inflacionit e të papunësisë, problemin e energjetikës dhe të tregtisë». «Për këtë arsye, shton ai, vizita ime te ju do të jetë interesante». Në këtë mënyrë Karteri «do të flasë për litar në shtëpinë e të varurit». Në deklaratën që bëri në aeroportin e Beogradit, Titon, që u hodhi litarin në grykë popujve të Jugosllavisë, Karteri e cilësoi kështu: «Titoja ka qenë kolos, një nga njerëzit më të mëdhenj të shekullit të 20-të. Ai ka qenë një nga pak burrat e shtetit, për të cilin me siguri mund të thuhet se e ka brumosur bota e sotme (e kapitalit, shënimi im) dhe një nga njerëzit e paktë, të cilët botën e kanë orientuar drejt një jete të mirë».

Kështu për «Dikin», një eklavazhist, mbret i kiki-rikut, «bota» që çeli Titoja «për një jetë më të mirë», është Jugosllavia që po jeton në bankrutën më të madhe politike, ideologjike, ekonomike dhe morale.

Të gjitha epitetet superlative ia ngjiti Karteri Titos, epitete që i lanë pa mend udhëheqësit e rinj jugosllavë, të cilët edhe donin që Karteri të thoshte një fjalë të mirë për Titon, por jo aq sa ta ngrinte në qiell dhe që mburrjet e tij ta demaskonin. Karteri tha për Titon jo vetëm se ishte kolos etj., etj. por se «ishte njeri me guxim të jashtëzakonshëm fizik, moral dhe politik. Ai, gjithashtu, ka qenë njeri i fantazisë dhe një nga njerëzit e rrallë me vizion praktik, të atyre lloj vizioneve, në të cilat shikohet jo vetëm se si mund të bëhet bota më e mirë, por, gjithashtu, se si ne armët më moderne që

disponojmë mund t'i përdorim për të ndërtuar një botë më të mirë». Kjo kështu tekstualisht!! Një poemë!!

Tito — «moral» për imoralitet në tradhti, «moral» për imoralitet për të ngrënë ryshfete dhe për të marrë çeqe, «fisnik» për të jetuar në luksin përrallor të mbretërve, «fisnik» në shërbim të kapitalizmit amerikan, «fisnik» në tradhtinë e marksizëm-leninizmit, duke gënjyer botën se gjoja ishte marksist. Karteri ia vuri kapakun edhe «të paangazhuarit», udhëheqësit të ndritur të çarmatimit, duke pohuar se Titoja i konsideronte armët moderne «që disponojmë» (Amerika e Karterit, shënimi im) se «do t'i përdorim për të ndërtuar një botë më të mirë». Rroftë bomba atomike!; rroftë bomba me hidrogjen!; rroftë bomba me neutron! dhe pastaj «dalim komunistët shqip-tarë» dhe na konsiderojnë «ne», domethënë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimin Sovjetik revizionist, revizionistët kinezë dhe renegatin Tito si «armiqtë e njerëzimit», kurse këta, sipas Titos, «luftojnë për një botë të mirë!».

Sipas Karterit, «kontributi i presidentit Tito për zhvillimin e Jugosllavisë së fuqishme, të pavarur dhe të paangazhuar ka qenë shumë i madh. . .» dhe këtë e transmeton Tanjugu, që çdo ditë shkruan se Jugosllavia vuan në mjerim ekonomik dhe rron me lëmshë.

Kjo është të tallesh me njerëzit që të dëgjojnë. Por, nga ana tjetër, këta njerëz që dëgjojnë këto dokrra të Karterit, e marrin vesh kuptimin e vërtetë të fjalëve të tij: «Titoja ka merita të mëdha, sepse e bëri Jugosllavinë një neokoloni të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të kapitalit botëror, se jemi ne Shtetet e Bashkuara që i mbajmë frymën gjallë Jugosllavisë, e cila është jo e pavarur, por e varur bile nga këmbët e nga koka prej nesh, Shteteve të Bashkuara të Amerikës»!

Karteri mbuloi me lavde Titon duke pohuar se ka qenë arkitekti i lidhjeve në mes Shteteve të Bashkuara

të Amerikës dhe Jugosllavisë dhe se «këto lidhje janë fort të qëndrueshme». Karteri shkoi deri atje sa të thoshte se Titoja i ka dhënë edhe këshilla, bile se kanë shkëmbyer në mes tyre edhe «letra personale»! Ky zbulim u dogji jugosllavëve, pse nesër, kur të zbulohet «Kartergejti» sekretet e këtyre letrave do të dalin në shesh.

Asnjë mendim i shprehur nga Karteri për Jugosllavinë nuk do koment. Pse të lodhesh të demaskosh titizmin! Lexo intervistën e Karterit dhënë gazetës «Politika», si dhe deklaratën që bëri në aeroport, kur mbërriti në Beograd, dhe nxirr vetë konkluzionet. «Ne, tha ai në aeroport, jemi të gatshëm të punojmë ngushtë me ju për sigurimin e zhvillimit të Jugosllavisë së pavarur, sepse e dimë se pavarësia juaj nuk është krijuar nga asnjë fuqi e jashtme, por nga trimëria dhe vetëmohimi i popujve të Jugosllavisë»; më poshtë vazhdon: «Jugosllavia vazhdon politikën e mosangazhimit autentik». Ua dha Karteri titistëve diplomën e Shtëpisë së Bardhë!

Për Partinë e Punës të Shqipërisë kurdoherë ka qenë e qartë se politika e «mosangazhimit» ka qenë dhe mbetet një politikë në interes të imperializmit amerikan dhe Titoja punonte për këtë politikë në shërbim të imperializmit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Tash, në këtë politikë false të paangazhuar, të një «bote të tretë» të perënduar që në lindje, u fut pyka sovjetike, Kastre.

Karteri, në intervistën me gazetën «Politika», duke folur për politikën e «mosangazhimit», pohon me gojë e tij se «kjo është një nga temat për të cilën presidenti Tito dhe unë kemi diskutuar hollësisht. Ne jemi thëllësisht të interesuar që të ruhet integriteti dhe ndikimi aktiv i lëvizjes së mosangazhimit». Titoja, pra, për këtë politikë ka marrë bekimin e Uashingtonit, dhe tok me të, edhe çeqet.

Kreu i imperializmit amerikan u tha jugosllavëve se nga gjendja e vështirë ekonomike në të cilën përpë-

litet Jugosllavia do të dilet nëpërmjet Bankës Rajonale, Bankës Botërore, Fondit Monetar Ndërkombëtar etj. Viçi i artë! Nënshtrimi ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës! Amerika, lidhshipi i popujve të botës!

Mbi varrin e Titos, ku u përkul dhe të cilin Karteri e përshkroi si «shumë të përshtatshëm», ai i këshilloi udhëheqësit e rinj të Jugosllavisë të «ndjekin me besnikëri rrugën e Titos», që është rruga e besnikërisë ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës. «Amerika do të jetë me ju», u tha Karteri pasardhësve të Titos, në rast se ju «qëndroni ndershmërisht të pavarur» (ndaj sovjetikëve, kuptohet). *A bon entendeur salut* e përfundoi *De profundis*-in e tij Karteri në «Shtëpinë e luleve»<sup>1</sup> të Beogradit të skllavëruar.

1 Vendi ku është vendosur varri i Titos.

**E MARTË**  
**1 KORRIK 1980**

## **HELMUT SHMIDI NË MOSKË**

Bashkimi Sovjetik po luan kartën e përçarjes së përndimorëve, ndërsa Gjermania Federale luan atë të pavarësisë dhe të presioneve kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Këto kohët e fundit, duke gjykuar nga zhvillimi i ngjarjeve në botë, politika e presidentit amerikan Karter ka pësuar disa disfata të njëpasnjëshme. Karteri dhe administrata e tij kanë mbajtur qëndrime të lëkundshme në shumë probleme kyç ndërkombëtare. Kjo për shkak të mosmarrëveshjeve e të përplasjeve midis trusteve dhe koncerneve shumëkombëshe amerikane, që luftojnë si brenda në senat, ashtu edhe në gjirin e qeverisë, sepse interesat e tyre të mëdhenj, brenda në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe jashtë tyre, kërcënohen nga dara e rrezikshme e krizës së madhe ekonomike botërore dhe nga kundërshtimi dhe lufta çlirimtare e popujve.

Imperializmi amerikan, duke vendosur marrëdhëniet me Kinën, mendoi se korri një sukses të madh në arenën ndërkombëtare dhe si rezultat i dobësoi pozitat e Bashkimit Sovjetik. Por kjo, pavarësisht se ishte një humbje për Bashkimin Sovjetik, nuk është kështu, sepse «Kina e humbur» për Bashkimin Sovjetik, është si «fitorja e Pirros» për Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Kina në gjendjen aktuale nuk përbën një rrezik imediat kërcënues për Bashkimin Sovjetik. Ajo nuk është, gjithashtu, as e gatshme të luajë fort e bindur kartën e

Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kina synon të forcohet për të hyrë në aventura të mëdha, drejtimet e të cilave aktualisht nuk mund të përcaktohen në mënyrë të qartë. Në stadin e sotëm të stabilizimit dhe të mëkëmbjes së ekonomisë së saj kapitaliste, Kina u afrohet të gjitha atyre shteteve që i japin kredi, teknologji dhe armatime moderne. Pra, duhet të jetë e qartë se Kina, më parë se për çdo gjë, si fuqi e madhe imperialiste, lufton për veten e saj.

Aleancat e sotme mund dhe do të pësojnë ndryshime në të ardhmen dhe këto do të jenë koniunkturale dhe do të zhvillohen sipas ngritjes dhe uljes së potencialit ekonomik-politiko-ushtarak të njëjës apo tjetrës super-fuqi.

Kriza e madhe ekonomike që ka mbërthyer Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe botën kapitalisto-revizioniste, nuk u përballua dhe nuk mund të përballohet dot nga Shtetet e Bashkuara, si lidërsip i botës kapitaliste. Përkundrazi, ato e humbën potencialin ekonomik dhe ndikimin politik, humbën besimin te partnerët dhe te vasalet e tyre.

Perandoria e imperializmit amerikan është e madhe, por edhe vështirësitë që iu krijuan janë të panumërta. Prandaj ajo nuk mund t'u përgjigjej më si duhej me format dhe metodat e mëparshme politike, nuk siguronte më ato mjete «bindëse» për të kënaqur, me kulaç ose me kërbac, shtetet ose popujt që shtypte dhe shfrytëzonte me lehtësi.

Ndërhyrjet e armatosura të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në vende të ndryshme dhe disfatat ushtarake që pësuan, të cilat sollën edhe disfatat politike, e bënë imperializmin amerikan të maste shtatë herë për të prerë një herë.

Trashëgimitë e politikës agresive të Foster Dallesit, aventurat e çmendura të Xhon Kenedit, të Lindon Xhon-

sonit e të Riçard Niksonit rënduan shumë në kurrizin e Karterit, aq sa e thyen në mes. Bota filloi të ndryshonte, popujt filluan të zgjoheshin dhe të lëviznin drejt revoltës kundër tiranisë së brendshme e të jashtme, duke realizuar forcën e vet e duke zbuluar pikat e dobëta të armiqve të tyre. Perandorinë amerikane që po tronditej, e kapën ethet e kalit. Kërkonte rrugëdalje nga qorrso-kaku ku ishte futur, por s'gjente dot. Orientimet strategjike dhe veprimet taktike të Karterit, për të penguar ecjen përpara të revolucionit ishin inkohere, të lëkundshme, më të shumtat e herës krejt të çoroditura, ishin, pra, veprime të ndërmarra «jo nga malli, por nga halli». Shtetet e Bashkuara mendonin se ekonomia e tyre jo vetëm do të ishte e qëndrueshme, por do të vazhdonte si ngahera të bënte kohën e mirë ose kohën e keqe mbi gjithë ekonominë kapitaliste botërore. Por kjo nuk ngjau. Në të vërtetë ekonomia kapitaliste u zhyt në një krizë të madhe të superprodhimit dhe, në të njëjtën kohë, edhe të ngadalësimit të prodhimit, por në mënyrë të veçantë dhe katastrofike në këtë krizë u zhyt ekonomia amerikane, e cila, me rënien e dollarit, me inflacionin, me papunësinë, jo vetëm tregoi dobësitë e saj, por krijoi edhe mosbesim e pakënaqësi tek aleatët e vet, të cilëve u jepte kredi për t'i rrjepur, bëri të qartë te kushdo se vartësia nga politika dhe ekonomia amerikane sjell fatkeqësi të pariparueshme mbi vende dhe mbi popuj të ndryshëm.

Aventura e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Iran, braktisja e aleatit të tij, e shahut Muhamed Reza Pahlevi, mbajtja peng prej një kohe shumë të gjatë nga iranianët e të gjithë personelit diplomatik spiun të ambasadës amerikane në Teheran, tregoi, gjithashtu, qartë dobësinë dhe falimentimin e politikës amerikane, pa-fuqishmërinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për t'u bërë ballë kundërshtimit dhe luftës së popujve. Sateli-

tët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës u trembën, sepse e panë se «aleati i madh» i lë në baltë. Kjo i huton ata dhe i nxit të kërkojnë e të sigurojnë mbështetje të tjera. Këndeje rrjedh pasiguria, kaosi dhe konfuzioni në botën kapitaliste, ku në rend të ditës janë frika, dyshimi, divergjencat, mospajtimi me qëndrimet ose «pajtimi» sa për të ruajtur aparenat, gjë që shprehet edhe në veprimet dhe qëndrimet e diskorduara në mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe aleatëve të tyre të Evropës Perëndimore, sidomos Francës dhe Gjermanisë Perëndimore.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës ishin bërë fuqia më e madhe e armatosur në botë, por as Bashkimi socialimperialist Sovjetik s'mbetej prapa. Shtetet e Bashkuara të Amerikës ishin bërë tregtari më i madh i armëve në botë, por as Bashkimi Sovjetik s'mbetej prapa. Shtetet e Bashkuara të Amerikës me një ekonomi të fortë jepnin kredi e investonin në tregjet e botës dhe luftonin të zgjeronin dominimin dhe sferat e tyre të influencës. Bashkimi Sovjetik, nga ana e tij, merr kredi nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, lejon investimet e tyre dhe të fuqive të tjera perëndimore në Bashkimin Sovjetik, jep edhe vetë kredi, shtrydh «aleatët» e tij dhe i mban nën çizmen e vet të hekurt dhe nuk neglizhon; përkundrazi, ndërhyt me brutalitet dhe me ushtri për të pushtuar vende e popuj, për të zgjeruar tregjet e veta dhe zonat e influencës në vende strategjike kyç për hegjemoninë botërore.

Dobësia dhe vështirësitë, në të cilat po përpëliten Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kanë bërë që sovjetikët të shtojnë arrogancën e tyre. Këto jo vetëm organizojnë dhe nxitin kudo subversionin, por ndërhyjnë edhe me armë, siç ngjau në Afganistan, në Angola, në Etiopi e gjetkë. Aleatët evropianë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në NATO, përpara kësaj situatë krize

të madhe ekonomike dhe politike, duan të ruajnë edhe mbështetjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, por edhe me sovjetikët duan ta vazhdojnë «detantën». Kështu Franca dhe Gjermania Federale, duke mos pranuar plotësisht masat represive të presidentit Karter ndaj Bashkimit Sovjetik, bëjnë avanca në drejtim të tij. Ky i fundit, nga ana e vet, kërkon t'i përçajë, prandaj edhe u buzëqesh, edhe i kërcënon. Kështu bëjnë edhe Franca dhe Gjermania Federale, që i buzëqeshin Bashkimit Sovjetik. Të dyja palët gjoja nuk lëvizin nga «parimet» e tyre dhe «përkëdhelin edhe lakrën edhe dhinë», ose rrinë edhe i thonë «kikirikut» (Karterit) se për shumë probleme dhe për shumë taktika kemi pikëpamje jo të barabarta dhe jo të njëjta.

Aktualisht vëmendja e të gjithë ujqve imperialistë është përqendruar sidomos në Lindjen e Mesme, pse kjo për ta do të thotë naftë. Por strategjia e vendosur nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe fuqitë e tjera përendimore për Lindjen e Mesme, ku konflikti arabo-izraelit përbënte preludin e nxehtë të zhvillimeve të mëvonshme në këtë rajon, u prish nga ngjarjet në Iran. Pra, megjithëse deri tani interesat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës e të Bashkimit Sovjetik në Lindjen e Mesme përplaseshin shumë rëndë, rreziku i një konflikti të nxehtë nuk i kalonte kufijtë e një lufte midis shteteve arabe dhe Izraelit. Kështu Shtetet e Bashkuara të Amerikës kishin mundur të mënjanonin përkohësisht zjarrin në rajonet naftëmbajtëse të Iranit dhe të Gjirit Persik.

Sadati, ky aleat i vjetër i Hitlerit, ishte mik i sovjetikëve. Më vonë ndërroi flamur dhe u bë aleat i amerikanëve. Në Kemp Dejvid ai u pajtua me Izraelin, duke u armiqësuar me të gjitha shtetet e tjera arabe. E gjithë kjo rrëmujë shkaktoi rrëmuja të tjera. Sovjetikët kërkuan dhe gjetën baza të tjera detare e ajrore në Jemenin e Jugut, në Libi, në Algjeri etj. Kryengritja popullore

në Iran, që çoi në rrëzimin e shahut dhe që lëkundi fort interesat e amerikanëve, bëri që sovjetikët të përfitonin nga gjendja, të pushtonin *manu militari* Afganistanin. Siç dihet, socialimperialistët sovjetikë, pavarësisht nga puçi ushtarak në pallatin presidencial në Kabul, nuk e kishin nën zap Afganistanin. Përveç kësaj ata e pushtuan atë për të përballuar edhe eventualitetin e ndërhyrjes ushtarake amerikane në Iran. Imperialistët i njohin qëllimet grabitqare të shoqi-shoqit.

Në kohën e Musadekut dhe të «Tudehut» amerikanët, duke ndërhyrë për të rikthyer shahun në fuqi, i vunë bërnylat Anglisë dhe rezervuan për vete pjesën e luanit në përvetësimin e naftës iraniane. Tani, kësaj radhe imperializmi sovjetik mori masa për t'u gjendur afër Iranit, përpara se të realizohej ndërhyrja e mundshme e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Nga ana tjetër, gomarllëqet e Karterit bënë që, për të mos humbur naftën, aleatët e tij përendimorë të dalin nga radha. Kjo i çoi ata në mosmarrëveshje me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe mbajtën qëndrime, në thelb, kontradiktore me Uashingtonin në sanksionet kundër Iranit, në sanksionet kundër Bashkimit Sovjetik për çështjen e Afganistanit dhe për problemin palestinez.

Zhiskar d'Estëni dhe Shmidi e mbajtën hapur portën për bisedime me sovjetikët dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pas kthimit të Shmidit nga Moska, nga zori deklaruan se e aprovonin qëndrimin e tij në bisedimet me Brezhnjevën. E tillë është situata në NATO, të tilla janë marrëdhëniet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës me «aleatët» e tyre, marrëdhëniet e tyre me Bashkimin Sovjetik. Në këtë situatë vazhdon kriza e madhe, po thellohen kontradiktat ndër imperialiste, pakënaqësia dhe zemërimi i popujve shtohen dhe manifestohen kudo me violencë e me forma të ndryshme. Kjo i bën aleancat ushtarake të NATO-s e të Traktatit të Varshavës, pava-

rësisht se nga pamja e jashtme duken si solide, të plasariten. Brenda tyre ziejnë kontradiktat, kundërshtimet, grindjet, mosmarrëveshjet.

Imperializmi amerikan, socialimperializmi sovjetik, Kina dhe kapitalizmi botëror janë në krizë të madhe, ndërsa popujt janë në revoltë, në kryengritje, në revolucion. Popujt duhet të forcojnë e të shtojnë goditjet kundër armiqve të tyre të brendshëm e të jashtëm. Në Poloni, për shembull, sidomos në portet e Balltikut, ka filluar një lëvizje greviste e punëtorëve kundër masave shtrenguese ekonomike që ka marrë qeveria e Gierekut dhe e Babjushit. Por unë mendoj se këto greva të punëtorëve të Gdanskut, Gdinas etj., pavarësisht se janë greva punëtorësh, frymëzohen nga reaksioni, domethënë manovrohen nga qarqet reaksionare perëndimore dhe nga kisha katolike, e cila gëzon liri veprimi dhe është bërë shtet brenda shtetit polak.

Është e vërtetë se këto greva punëtorësh, që bëhen për rivendikime ekonomike e që mund të kthehen edhe në greva politike, janë kundër revizionistëve polakë, por në realitet duket se janë frymëzuar nga kapitali botëror i mbështetur nga Vatikani. Kjo, natyrisht, i bën pozitativ e revizionistëve sovjetikë të lëkundshme në përgjithësi, i dobëson ato në Poloni dhe edhe në gjirin e kampit revizionist, sepse nuk duhet përjashtuar rrezikun që edhe në vende të tjera të këtij kampi të mos shpërthejnë greva të tilla si në Poloni. Megjithatë, hëpërhë, nuk mund të prononcohem mbi këtë çështje, për arsye se në zhvillimin e këtyre grevave dhe orientimin që do të marrin ato si në Poloni, ashtu edhe në të gjithë kampin revizionist, duhet t'i ndjekim me kujdesin më të madh. Do të shohim po ashtu qëndrimet që do të mbajë Bashkimi Sovjetik, në rast se acarohet situata në Poloni. Sidoqoftë unë mendoj se me siguri Bashkimi Sovjetik në fillim do të heshtë, nuk do të bëjë zë, do të vëzhgojë me

vigilencë të madhe. Vetëm kur ta shikojë se rrezikohen pozitativ e tij në kamp, se rrezikohet ushtria sovjetike në Gjermaninë Lindore, në Çekoslovaki e gjetkë, atëherë ka mundësi që Bashkimi Sovjetik të ndërhyjë, dhe jo më parë. Bashkimi Sovjetik ndodhet në vështirësi të mëdha, pse në duar i rëndon edhe çështja afgane.

Ne, shqiptarët, në këto situata të vështira në Evropë dhe në botë, duhet të jemi shumë vigilentë.

E MARTË  
1 KORRIK 1980

## THELLOHET KRIZA E MADHE EKONOMIKE BOTËRORE

Kriza e madhe ekonomike botërore që ka mbërthyer për gryke veçanërisht dy superfuqitë imperialiste, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Sovjetik, si dhe vendet e industrializuara, Japoninë, Gjermaninë Federale, Francën, Anglinë, Kanadanë, Italinë, Kinën maoste, Jugosllavinë titiste, vendet anëtare të KNER-it etj., po thellohet çdo ditë e më shumë. Ajo është me konsekuenca të rënda për të gjitha shtetet që varen nga kapitali ndërkombëtar.

Kjo krizë e madhe ekonomike është **krizë e superprodhimit, e bumit<sup>1</sup> industrial, por, në të njëjtën kohë, ajo ka shkaktuar një krizë të thellë në prodhim.** Në fakt kudo në vendet kapitaliste e revizioniste ajo ka çuar në rritjen e papunësisë, të inflacionit, në ngritjen e çmimeve etj. Kjo do të thotë se aktualisht prodhimi është ulur dhe ka filluar lufta për evadimin e mallrave stoqe. Mirëpo borgjezia kapitaliste, evadimin e këtyre mallrave stoqe nuk e bën duke ulur çmimet, por duke hedhur në rrugë punëtorët, pra duke ngadalësuar prodhimin. Meqenëse industria kapitaliste nuk punon më me rendimentin e mëparshëm, lind edhe kriza e lëndëve të para. Kjo krizë, gjithashtu, është shumë e rëndë. E gjithë kjo çështje

1 Nga anglishtja — lulëzim i rrëmbyeshëm dhe i përkohshëm.

shoqërohet me luftën ndërimperialiste kolosale për tregje. Kjo luftë herë e hapur dhe herë subversive, nga ana e saj shoqërohet me një shtim të panjohur e të pakrahueshëm deri tash të buxheteve ushtarake dhe të armatimeve konvencionale, të sofistikuara e atomiko-bërthamore.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Sovjetik, Kina e fuqi të tjera imperialiste janë bërë nxitëset më të tërbuara të një lufte të re imperialiste botërore. Politika e tyre hegjemoniste, etja për të ruajtur statukuonë imperialiste ekzistuese, nga njëra anë, dhe për rindarjen e sferave të influencës, nga ana tjetër, ka thelluar e ka ashpërsuar kontradiktat midis vetë fuqive të mëdha dhe midis tyre e partnerëve të tyre në krimet ndaj popujve të tjerë, në shfrytëzimin e tyre dhe kështu ka krijuar konflikte të reja.

Marrëdhëniet ekonomike, politike dhe ushtarake në grupimet e ndryshme imperialiste e revizioniste janë tronditur. Pjesëtarët e këtyre grupimeve po përpiqen të shkaktojnë, të gjejnë e të shfrytëzojnë të çara të ndryshme dhe kështu të formulojnë arsye për të mos iu përmbytur angazhimeve, traktateve dhe marrëveshjeve që ekzistojnë midis tyre.

Aktualisht lufta e popujve të shtypur e të shfrytëzuar nga kapitali botëror në krizë, ka marrë proporcione dhe forma të larmishme, të papara ndonjëherë. Pikërisht këtu e ka burimin e vërtetë kriza e madhe ekonomike botërore që ka mbuluar botën kapitaliste e revizioniste. Në dukje konfliktet e armatosura, ato në lëmin e marrëdhënieve ekonomiko-financiare, kriza e madhe e energjetikës e të tjera, duken se janë vetëm midis shteteve kapitaliste, por në të vërtetë këto konflikte kanë një prejardhje më të thellë, që e gërryen shtetin borgjez kapitalist, i cili përpiqet të mbrohet, të mbahet gjallë, të shërojë plagët e shumta etj. **Forca që e gërryen shtetin borgjez**

**kapitalist, është lufta në të gjitha format e në të gjitha shkallët që bëjnë popujt kudo në botë.** Klasa punëtore dhe të gjithë të shfrytëzuarit, në një mënyrë ose në një tjetër, me më pak ose me më shumë intensitet, shohin dhe luftojnë kundër të gjitha formave të regjimit kapitalist, vendas ose ndërkombëtar që i shfrytëzon, i varfëron dhe i shtyp ekonomikisht e moralisht. Ekzistojnë, pra, pakënaqësi e madhe dhe revoltë në gjirin e popujve të botës.

Sot gati kudo në vendet kapitaliste zhvillohen greva me pjesëmarrjen e miliona vetave, ka goditje të ashpra me të ashtuquajturat forca të rendit, ka revolta të armatosura, puçe ushtarake, ka terrorizëm dhe anarkizëm të organizuar nga qeveritë borgjeze kapitaliste në fuqi, ka kontrabandë kolosale, vjedhje të organizuara në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare, ka një zhvillim të pakufishëm e të llahtarshëm të korrupsionit politik, moral dhe fizik. Kështu po i përgatitet rruga fashizmit për të ardhur në fuqi.

Ne sot jetojmë në periudhën e kalbëzimit të kapitalizmit, të dobësisht, të dezagregimit dhe të falimentimit të plotë të këtij sistemi, të kësaj shoqërie të degjeneruar. Rrugëdalje tjetër nga ky kaos, nga ky llum, nuk ka përveç revolucionit, spastrimit të qelbit, marrjes në dorë të pushtetit shtetëror nga klasa punëtore, e cila ka për mision të vendosë diktaturën e proletarietit. Ajo që ka thënë Lenini lidhur me këtë proces, po vërtetohet dhe do të realizohet patjetër.

Imperializmi amerikan dhe kreu i tij, presidenti Karter, gjenden përpara vështirësish të mëdha në politikë, në ekonomi, në aleancat dhe në kolonitë. Imperializmi amerikan nuk e di ku e ka kokën, nuk di si t'u bëjë ballë rreziqeve që i janë turrur e që shtohen çdo ditë. Kështu ai ndodhet i mbërthyer nga një darë, nga e cila përpiqet të dalë duke zbatuar një politikë të çmendur

kërcënimesh, shantazhesh, presionesh ekonomike, politike, ndërhyrjesh ushtarake të hapëta dhe subversive deri edhe në çështjet sportive etj.

Për të mos u larguar nga ngjarjet e kohës duhet thënë se lufta e dy-tre vjetëve të fundit e popullit iranian kundër shahut dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, është një grusht i rëndë kundër imperializmit amerikan. **Kriza e Iranit është kriza e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.** Popujt e botës i njihnin edhe më përpara politikën barbare amerikane dhe metodat e sundimit të tij të egër e grabitqar, por në Iran i panë këto akoma më qartë. Masha e imperialistëve amerikanë në Iran ishte shahu dhe klika e tij, vrasëse e popullit. Për disa dekada me radhë ligjin në Iran e bënë kusarët në aleancë me kusarët, vrasësit dhe gjakpirësit e popullit iranian, të jashtëm dhe të brendshëm, në ujdi të plotë me njëri-tjetrin, qeveria dhe administrata e shahut nën drejtimin e Uashingtonit nëpërmjet ambasadës amerikane në Teheran.

Por më në fund populli iranian u ngrit në revolucion dhe fshiu me fshesë të hekurt nga faqja e dheut shahun dhe regjimin e tij mesjetar, zuri dhe burgosi të gjithë spiunët e ambasadës amerikane, që vepronin nën petkun e diplomatëve. Që prej 9 muajsh të ashtuquajturit diplomatë të një fuqie të madhe, e cila bën ligjin në botë, ndodhen në burg «*O tempora! O mores!*». Kjo nuk mund të ngjiste në kohët e mëparshme, por ja ngjau tash dhe, përveç amerikanëve, vazhdon t'u ngjasë edhe të tjerëve në vende të tjera.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës pësuan një disfatë të madhe politike, disfatë të cilën nuk janë në gjendje ta riparojnë, jo vetëm me rrugë diplomatike e me shantazhe ekonomike, por as edhe me ndërhyrje ushtarake, siç tentuan dhe dështuan me komandon ajrore të prillit në Tabas. Në Iran Shtetet e Bashkuara të Amerikës humbën një burim naftë e energjetike nga më të rëndësishmit,

humbën fitime kolosale, humbën besimin tek «aleatët» arabë të Gjirit Persik, u lëkund kompromisi amerikano-egjiptiano-izraelit i Kemp Dejvidit, lindën zizanies<sup>1</sup>, mosmarrëveshje të hapëta dhe të nënujshme me partnerët e NATO-s.

Bashkimi Sovjetik në këto situata mpreh dhëmbët dhe kafshon. Ai pushtoi Afganistanin, nxit oreksin e Vietnamit, fut pyka në NATO etj. Në të njëjtën kohë po thellohen kontradiktat midis Bashkimit Sovjetik e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Traktati i Varshavës duket «monolit», kurse në gjirin e NATO-s, «Evropa e Bashkuar» dhe Tregu i Përbashkët Evropian po japin shenja plasaritjeje. Plasaritja është po aq e madhe edhe në gjirin e KNER-it e të Traktatit të Varshavës, por këtu ushtria sovjetike ua ka zënë mirë frymën «aleatëve» të Bashkimit Sovjetik, kurse Shtetet e Bashkuara të Amerikës po e humbasin ndikimin e tyre të mëparshëm mbi «aleatët» e tyre, sidomos mbi Francën dhe Gjermaninë Federale, që kanë nxjerrë dhëmbët dhe po mprehin thonjtë e vet. «Mete, o Mete, gjithkush për vete», thotë populli ynë. Shtetet e Bashkuara të Amerikës duan që në fitime të jenë të parat, të jenë lubia e madhe, kurse në fatkeqësi copat e thyera prej tyre t'i paguajnë «aleatët», domethënë të bëhen pjesëtarë të fatkeqësive dhe të disfatave që pësojnë ato.

Por edhe ligji i xhunglës vepron; varur të të shohë kapitalisti, në ndihmë nuk të vjen.

Franca e Dë Golit dhe e D'Estënit, duke qenë në NATO, nuk është në NATO. Ajo qëroi nga toka franceze bazat e NATO-s, domethënë bazat amerikane, forcoi ushtrinë e saj në mënyrë të pavarur, ndërtoi bombën atomike e me hidrogjen dhe tash së fundi edhe atë me neutron

1 Frëngjisht — grindje.

dhe nuk i nënshtrohet diktatit amerikan në këtë çështje. Politika aktuale franceze niset nga parimi «më mirë të përgatitem të mbrohem më parë vetë, sesa të pres pas akshamit të më mbrojnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës». Kjo përbën një të çarë midis Francës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Muajt e fundit Shtetet e Bashkuara dhe Karteri bënë çmos që veçanërisht Franca dhe Gjermania Federale të bashkoheshin në të gjitha veprimet e tyre kundër Iranit.

Parisi dhe Boni parimisht dënuan mbajtjen peng të diplomatëve amerikanë nga Irani, por nuk ranë dakord me masat e tjera shtrënguese ekonomike që rekomandonin Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pra i lanë në baltë ato. Kjo është një e çarë tjetër midis Shteteve të Bashkuara dhe Francës e Gjermanisë Federale. Shtetet e Bashkuara të Amerikës dënuan pushtimin e Afganistanit nga Bashkimi Sovjetik. Këtë pushtim e dënoi edhe Kina, edhe NATO-ja. E dënuam edhe ne, por jo nga pozitë dhe nga qëllimet e tyre. Ata për këtë çështje nesër do të bien në ujdi me sovjetikët, kurse ne kurrë nuk do ta bëjmë një gjë të tillë.

Presidenti amerikan, si sanksion kundër Bashkimit Sovjetik për çështjen e Afganistanit, shpalli bojkotimin e lojërave olimpikë që do të zhvillohen këto ditë në Moskë, dhe kërkoi që edhe gjithë të tjerët t'i bojkotonin këto, por një shumicë shtetesh, midis tyre edhe Franca, bile edhe aleatja e bindur e tyre, Italia e Kosigës, që dërgoi në Moskë një ekip atletësh gjoja jozyrta, përsëri e lanë në baltë.

Franca shkoi më tej. Presidenti Zhiskar d'Estën, pa pyetur fare Shtetet e Bashkuara të Amerikës, u takua me Brezhnëvin në Varshavë. Zhiskari bëri vizitë zyrtare edhe në disa vende të Lindjes së Mesme, ku në fjalime publike vuri në dyshim kompromisin amerikano-egjiptiano-izraelit të Kemp Dejvidit dhe paraqiti disa

formulime kauçuk të tjera mbi të drejtat e popullit palestinez. Edhe kjo është një e çarë tjetër midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Francës.

Edhe pas këtyre disfatave Karteri propozoi që, për «mbrojtjen» e Evropës së NATO-s, të vendosen në Evropë nga ana e Shteteve të Bashkuara një lloj i ri raketash bërthamore, raketat «Pershing-2» dhe «Kruiz».

Ky propozim imponues i Karterit nuk u pranua as nga Zhiskari dhe as nga kancelari gjerman Shmid. Përse? Me sa duket nga frika se, po t'i vendosin Shtetet e Bashkuara të Amerikës raketat e tyre të reja në Evropë, një gjë të tillë do ta bëjë edhe Bashkimi Sovjetik, duke vendosur në vendet e Traktatit të Varshavës raketat e tij të reja bërthamore «SS-20». Prandaj Shmidi tash së afërmi do të shkojë në Moskë ku, siç flitet, do t'u kërkojë sovjetikëve një moratorium prej tre vjetësh lidhur me çështjen e vendosjes së raketave të reja në Evropë. Karteri u zemërua dhe i shkroi Shmidit që të mos shkonte në Moskë e të mos bisedonte për çështjen e vendosjes së raketave të reja. Por edhe Shmidi nuk u tund dhe iu përgjigj letrës së Karterit negativisht. Bile, lidhur me këtë letër, Shmidi i ka deklaruar gazetës amerikane «Uashington post» tekstualisht kështu: «E kam pasur zakon për 20 vjet që të shpreh mendimet e mia pa pyetur njeri tjetër», domethënë edhe tani nuk kam ndër mend të pyes Karterin. E gjithë kjo çështje flet për «unitet» midis Francës dhe Gjermanisë Federale dhe për të çara midis tyre dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

«Evropa e Bashkuar», në vetvete nuk është më e bashkuar. Grindjet, rivalitetet, interesat e kundërt të çdo shteti, të këtij farë Komuniteti Evropian po shtohen saqë vënë në rrezik vetë ekzistencën e tij. Anglia, aleatja më besnike e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, nuk dëgjon të paguajë kuotën që i është caktuar nga Tregu i Përbashkët Evropian. Natyrisht, kjo nuk u pëlqen as Bo-

nit, as Parisit. Franca është dakord që Greqia të rifutet në strukturat ushtarake të NATO-s dhe në Tregun e Përbashkët Evropian, por është kundër pranimin në to të Spanjës dhe të Portugalisë. Zhiskari e di se futja e shteteve iberike në vathën e perëndimorëve do t'i sjellë vështirësi për shitjen e prodhimeve bujqësore franceze. Nga ana tjetër, Gadishulli Iberik, që është një bazë e vërtetë ushtarake amerikane, duke u pranuar në NATO, krijon një aleat të ri të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Evropë, përkrah Anglisë. Sa për Italinë demokristiane ajo është një çizme e vërtetë amerikane në Mesdhe. Borgjezia italiane, që po e çon vendin drejt një fashizmi të ri, nuk di kujt t'ia prishë dhe kujt t'ia ndreqë më parë. Shtetet e Bashkuara të Amerikës e mbajnë gjallë, por ajo ndodhet edhe në «Evropën e Bashkuar» dhe në Tregun e Përbashkët Evropian. Italia është bërë vendi i mbledhjeve të kompromiseve dhe të kontradiktave.

Në mbledhjen e kryetarëve të shteteve dhe të qeverive të vendeve kryesore të industrializuara të botës, që u mbajt aty nga fundi i qershorit në Venecia, u shpalosën kontradiktat midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe vendeve të industrializuara evropiane dhe, italiani Kosiga, presidenti i turnit i Komunitetit Evropian, lexoi çarçafin e komunikatës së mbledhjes së ujqve në «xhungël». Në mes të kësaj mbledhjeje ujqish, që bëhej në një manastir të një ishulli të Lagunës së Venedikut, mbërriti nga Bashkimi Sovjetik një «meteorit i vogël» diplomatik për Zhiskarin. Moska njoftonte se po tërhiqte një divizion ushtarësh dhe 100 tanke nga Afganistani, duke lënë atje, në mos më shumë, nja 10 divizione të tjera. E hodhi kështu edhe Moska një gur në kënetë, rrathët koncentrikë të të cilit nuk mbajtën shumë. Ajo ishte një manovër diplomatike, por pa jetë të gjatë. Kosiga i kërkoi Moskës që të largonte nga Afganistani edhe trupat e tjera, por ajo zbuloi bateritë dhe

dhëmbët e saj prej egërsire, duke iu përgjigjur se jo vetëm që nuk do të tërhiqte më trupa nga Afganistani, por, po të qe nevoja, mund të dërgonte atje trupa të tjera.

Socialimperializmi sovjetik po sulmon me arrogancë stanin kundërshtar që gjendet në vështirësi. Ariu sovjetik mendon të përdorë pykat Zhiskar dhe Shmid, por sa dhe deri kur, kjo mbetet për të parë. Është e vërtetë se shpata sovjetike është më e gjatë, por dhe të tjerët thikat i mbajnë zhveshur. **Në këtë kazan të madh, në këtë zjarr të madh ku zien dhe digjet kapitalizmi botëror, po shtohen, po ngjiten, po shtrihen në sasi e në cilësi edhe luftërat nacionalçlirimtare, faktorët objektivë e subjektivë. Popujt e botës janë në lëvizje.** Proletariati botëror, pavarësisht se po manipulohet nga ideologjitë e ndryshme në shërbim të kapitalit, po lufton dhe po udhëheq luftën e klasave.

Duke e parë në tërësi e me syrin e marksizëm-leninizmit gjendjen, vihet re se në çdo skaj të botës po zhvillohet lufta e klasave, në format klasike e joklasike. Kudo popujt janë në ankth, në një shqetësim të jashtëzakonshëm. Pakënaqësia dhe zemërimi kundër fuqive shtypëse, kombëtare e të huaja, po shtohen, po ngjiten, po specifikohen dhe po materializohen. Luftërat e armatosura nacionalçlirimtare të popujve, pavarësisht se kush i udhëheq ato, gjaku i popujve që luftojnë për lirinë dhe pavarësinë e tyre, pasqyrojnë urrejtjen dhe zemërimin kundër shtypjes kapitaliste, vendase e të huaj, bëjnë që popujt në luftë të dallojnë qëndrimet antipopullore të individëve ose të grupeve, të bëjnë aleanca me forcat më progresive dhe më revolucionare. Në çdo lëvizje, në çdo demonstratë apo grevë, në çdo manifestim publik, politik ose ekonomik, është e pamundur të mos protestohet kundër efekteve shkatërruese të krizave të rënda dhe të mos u vihet gishti shkaktarëve të shfrytëzimit e të shtypjes

së popujve, forcave që kërkojnë shkatërrimin e njerëzimit.

Në vendet kapitaliste dhe revizioniste, me një parti pseudokomuniste, me dy ose më shumë parti pseudo-demokratike, pavarësisht se bëhen përpjekje për t'ia hedhur fajin njëra-tjetrës, pavarësisht se shtetet borgjeze të veçuara ose në grupe përpiqen t'ia hedhin fajin njëri-tjetrit, asgjë nuk ndryshon; shtypja e popujve vazhdon, por vazhdojnë të rriten edhe zemërimi e revolta e tyre. Ky zemërim e kjo revoltë po godasin, në forma të ndryshme dhe me intensitet të ndryshëm, borgjezinë kapitaliste e revizioniste.

**Popujt e shohin se po i kërcënon lufta grabitqare imperialiste. Ata e kuptojnë kush e përgatit këtë luftë, kush i paguan harxhet e saj dhe kush fiton nga luftërat grabitqare.** Dy fenomene vihen re në këtë situatë: ka disa popuj që i tremben akoma luftës imperialiste; ka edhe popuj të tjerë që e luftojnë atë. Por, në analizë të fundit të gjithë, me forma të ndryshme, po futen në luftën e rezistencës aktive, në fazat e para të luftës nacionalçlirimtare, në sabotimin dhe në ndalimin e luftës imperialiste dhe më në fund po kapërcejnë stadin e frikës dhe po hidhen në revolucion. Lëvizjet dhe kundërshtimet që ndodhin në botë nuk duhen gjykuar vetëm nga këndi i vështrimit të qeverive borgjeze dhe të partive të tyre që i udhëheqin dhe i manipulojnë popujt, por duhet parë thelbi i problemit, i rezistencës dhe i drejtimit themelor që marrin kërkesat politike apo ekonomike të popujve, të cilat i detyrojnë udhëheqjet borgjeze kapitaliste ose të marrin masa shtypëse drakoniane kundër këtyre lëvizjeve, ose, për të ristabilizuar gjendjen e tyre të tronditur, të lëkunden sa andej-këndej dhe të mbështeten herë te njëra e herë te tjetra superfuqi.

Marksistë-leninistët duhet të përvetësojnë materializmin historik dhe ta zbatojnë atë në praktikë. Zhvi-

llimin e botës dhe çdo ndryshim t'i shohin në prizmin e marksizëm-leninizmit. Nuk mund të quhet marksist, por antimarksist, ai që mbron pushtimin e Afganistanit nga ana e socialimperialistëve sovjetikë dhe e konsideron atë një veprim të drejtë dhe të domosdoshëm. Nuk mund të quhen marksistë, por antimarksistë, ata të vetëquajtur marksistë-leninistë që përpiqen «të argumentojnë» se nuk duhen quajtur patriotë populli afgan dhe elementët e borgjezisë së mesme, bile edhe të lartë që luftojnë kundër pushtuesve sovjetikë. Ai që mendon dhe vepron kështu, nuk ka kuptuar asgjë nga mësimet e marksizëm-leninizmit mbi aleancat, mbi frontet dhe luftërat nacionalçlirimtare. Po ashtu nuk mund të quhet mendim dhe veprim marksist-leninist, ai i disa shokëve «komunistë» jashtë, që nuk shohin anët progresive dhe antiimperialiste të popujve arabë, të popullit iranian ose të botës myslimane. Të nënvleftësosh dhe të mos shfrytëzosh këto momente revolucionare, antiimperialiste dhe të tregohesh shumë «ortodoks» për të kërkuar që këta popuj në revolucion të braktisin, me sot me nesër, besimin në fenë e tyre, në doket e në zakonet që rrjedhin prej saj, kjo tregon të paktën papjekuri ideologjike marksiste-leniniste.

As Ajatollah Khomeini me pikëpamjet e tij fetare islamike, as Ajatollahët e tjerë, as Bani Sadri e Gotbza-dehu, me pikëpamjet e tyre shtetërore borgjeze ekonomike e ideologjike nuk janë aleatët tanë të natyrshëm. Por, aktualisht, në luftën për rrëzimin e monarkisë feudale të Pahlevëve dhe në qëndrimet e tyre kundër imperializmit amerikan e socialimperializmit sovjetik, ata janë aleatët tanë. Ne duhet t'i mbështetim dhe t'i ndihmojmë të ecin në këtë rrugë. Rruga e tyre aktuale i lejon komunistët të futen në masat, të punojnë për edukimin e drejtë të tyre, të thellojnë botëkuptimet e tyre strategjike dhe taktike, të mbështeten te populli revolucionar dhe, në radhë të parë, te klasa punëtore dhe të

dinë të shfrytëzojnë çdo situatë të favorshme për revolucionin.

Kështu duhet të kuptohet dhe të zbatohet procesi i zhvillimit të popujve. Në rast se ndjenjat e popujve, cilatdo qofshin ato, konfondonen dhe identifikohen me ato të grupeve borgjezo-kapitaliste që janë në fuqi në një vend të caktuar, ky është një gabim i rëndë. Populli i Egjiptit, për shembull, nuk është dhe nuk duhet të identifikohet me Sadatin dhe klikën e tij, që dje ishte në shërbim të sovjetikëve, sot është vënë në shërbim të amerikanëve; as populli libian nuk mund të identifikohet me Kadafin, as ai i Sirisë me Asadin, e kështu me radhë me të gjithë popujt, shtetet e kombet e tjera.

Komunistët marksistë-leninistë duhet të dinë të bëjnë analiza të drejta, të përcaktojnë strategji dhe taktika të drejta, të bëjnë aleanca të favorshme e të drejta, të ndër marrin veprime revolucionare të drejta e jo aventura dhe të gjitha këto duhet të shikohen nën prizmin e teorisë marksiste-leniniste, pse vetëm kështu i shërbehet çlirimit të popujve nga kapitalizmi dhe bëhet revolucioni.

Luftërat nacionalçlirimtare janë luftëra të drejta. Ato shpërthejnë kur ekzistojnë dhe pihen faktorët objektivë dhe subjektivë. Këta faktorë duhet t'i krijojnë vetë marksistë-leninistët. Në luftërat e drejta marksistë-leninistët nuk duhet të rrinë asnjëherë duarkryq dhe të mos marrin pjesë qoftë si parti ose si grupe, akoma të paorganizuara si parti, qoftë si luftëtarë individualë. Kurrë ata nuk duhet të ndahen nga masat që luftojnë për çlirim shoqëror e kombëtar, por, duke luftuar në gjirin e tyre, të afirmojnë edhe bindjet komuniste, të organizohen, të vënë klasën punëtore në udhëheqje. Edhe në qoftë se nuk janë të organizuar, ata duhet të dalin në pararojë të masave, me luftë, me sakrificë për të bërë që lufta nacionalçlirimtare të ecë drejt objektivave minimalë dhe pastaj edhe drejt atyre maksimalë.

-078 **Kushtet për shpërthimin e luftërave nacionalçlirimtare nuk përfaqësojnë vullnetin e njërit apo të tjetrit personalitet. Janë situatat objektive e subjektive ato që i krijojnë këto kushte, që bëjnë të shpërthejnë luftërat nacionalçlirimtare, që janë një formë e lartë e luftës së klasave.** Ajo klasë që del në krye dhe udhëheq luftën nacionalçlirimtare, është më progresivja, faktori vendimtar. Klasa punëtore është klasa më progresive nga progresivet. Ajo duhet të marrë drejtimin e luftës çlirimtare. Edhe në rast se në fillim të luftës, ajo nuk i ka afirmuar pozitrat e saj udhëheqëse, duhet të qëndrojë në ballë të luftës dhe të sakrifikave, pse vetëm kështu ajo mund të marrë drejtimin politiko-ushtarak dhe të sigurojë objektivat e luftës nacionalçlirimtare, të realizojë dëshirat e klasës.

Në situatën e zhvillimit të sotëm botëror, partitë marksiste-leniniste, klasa punëtore e aleatët e mundshëm të saj, shtresat e gjera të fshatarësisë, të inteligjencies përparimtare duhet jo vetëm të shohin qartë rrezikun e një lufte të re botërore imperialiste, por edhe të organizohen e të afirmojnë me një mijë forma vullnetin e tyre për ta ndaluar këtë luftë shkatërrimtare, të demaskojnë demagogjinë dhe falsitetin e parullave demokratike të kapitalit skllavërues, t'u shpëtojnë zinxhirëve frenues të partive të ndryshme pseudodemokratike dhe pseudopullore të krijuara nga borgjezia.

Çdo situatë që krijohet, në çdo vend e në gjirin e çdo populli, në çfarëdo kohe duhet të studiohet me kujdes e në bazë të parimeve të marksizëm-leninizmit, të nxirren konkluzione e të dilet me veprime progresive unitare e revolucionare. Asgjë nuk duhet t'i shpëtojë syrit revolucionar të njerëzve që luftojnë për çështjen e madhe të popullit të vet dhe të të gjithë popujve. Marksistë-leninistët këto zhvillime duhet t'i shfrytëzojnë. Kjo është një luftë e përditshme që duhet bërë, pse

kështu orteku i madh i revolucionit do të shtypë armiqtë e popujve dhe do të sjellë lirinë, përparimin, shoqërinë socialiste dhe atë komuniste më vonë.

Prandaj në këtë krizë të madhe ekonomike botërore, komunistët marksistë-leninistë, kudo që janë, duhet të përcaktojnë qartë vijën dhe qëndrimet e tyre dhe këtë vijë të dinë ta vënë në jetë. Vetëm një parti komuniste e vërtetë marksiste-leniniste në këto situata mjaft të komplikuar, ku përplasen interesat e klasave të cilat nuk janë të prera me thikë, por të ndërlikuara e të ndërvarura, mund të shohë qartë ku janë avantazhet dhe ku dezavantazhet, ku dhe cilët janë miqtë dhe armiqtë, me kë duhet të bashkohet, kundër kujt duhet të luftojë e si duhet të luftojë dhe kush t'i çojë përpara etj.

## SHËNIM

U kisha dërguar shokëve të Byrosë Politike, përpara botimit, veprën time të re «Hrushovianët» që ta lexonin dhe të më bënin ndonjë vërejtje po të kishin. Ata e lexuan, ma kthyen dhe më thonë se e kanë gjetur të gjithë të mirë dhe shumë të dobishme. Nuk kishin vërejtje veçse disa fjalë, ndonjë korrigjim shprehjeje ose ndonjë përcaktim më të plotë nga kujtimet. I lexova me kujdes ato. Disa i pranova, disa të pakta i lashë jashtë, pse m'u dukën të panevojshme. Kështu lashë mënjanë një «Hyrje» që kishte bërë Mehmet Shehu pa e ngarkuar njeri. Si duket donte të vinte emrin e tij, të jepte «vizën» për këtë vepër, duke pasur me mendjemadhësi edhe vulën në këto kujtime, duke kurdisur ngjarje e fakte që s'kanë ndodhur ashtu. Tani vepra «Hrushovianët» është gati për shtyp dhe për përkthim në gjuhë të huaj.

## PRESIONEVE NE U PËRGJIGJEMI ZJARR PËR ZJARR

Sandro Pertini, president i Republikës së Italisë, e provokoi ambasadorin tonë të ri, Pirro Bitën, kur ky i paraqiti letrat kredenciale. Në thelb ai i tha: «Zoti Enver Hoxha, president i Republikës, në librin e tij «Eurokomunizmi» atakon popullin italian dhe unë protestoj për këtë» etj.

Ambasadori ynë iu përgjigj drejt duke i thënë se «Shoku Enver Hoxha nuk ka sulmuar popullin italian, por eurokomunistët. Ju kanë keqinformuar, zoti president» etj.

Është fakt, pra, se politika jonë dhe realiteti që demaskon libri «Eurokomunizmi është antikomunizëm» u ka djegur demokristianëve, socialistëve, revizionistëve italianë dhe terroristëve të tjerë fashistë. Nuk është e vërtetë që ne me këtë vepër sulmojmë popullin italian, por këta banditë duan të identifikohen me popullin italian dhe me proletariatin e tij. Ata kërkojnë të na bëjnë presion e të na kërcënojnë në tregtinë që bëjmë me ta. Pipinot s'kanë vënë kurrë mend. Por «gjetën xhami ku të falen»! Ua tregojmë ne atyre ku e kanë kufirin dhe sa u vlejnjë protestat.

Sot i thashë Ramizit në telefon që ta studiojnë çështjen me ministrin e Punëve të Jashtme. I propozova dy variante për qëndrimin që duhet të mbajmë ne:

1. Të kthehet sa më parë ambasadori ynë nga Roma gjoja për konsultime ose për pushime. Kjo, që italianët ta kuptojnë se ne u përgjigjemi presioneve të tyre zjarr për zjarr. Ambasadori ynë quhet i akredituar dhe ne e kthejmë atë kur të na bëhet mbarë. Ambasada jonë të vazhdojë punën si më parë, por me shumë kujdes, se ata do të vazhdojnë provokacionet, mund t'i bëjnë ato edhe më të hapëta e më të bujshme. Duhet ta kemi parasysh se prapa italianëve qëndrojnë amerikanët, Vatikani, NATO-ja e të tjerë.

2. Ambasadori të qëndrojë në Romë, të mos kërkojë takim as me ministrin e Punëve të Jashtme të tyre, pa lëre me kryeministrin (në qoftë se e lejojnë rregullat diplomatike) dhe në qoftë se Kolomboja<sup>1</sup> e njofton se e pret, ambasadori ynë të vejë, të qëndrojë i ftohtë dhe i rezervuar. Në rast se edhe ky e provokon, atëherë t'i përgjigjet edhe më mirë nga ç'iu përgjigj Pertinit. Në këtë rast, jemi të detyruar të veprojmë si në variantin e parë.

I thashë Ramizit se unë jam për variantin e parë. I thashë, gjithashtu, që ambasadorit italian në Tiranë shokët tanë t'i qëndrojnë akull, ndërsa ministri ynë i Punëve të Jashtme të mos e presë më, siç e ka pritur dhe ai ka provokuar duke protestuar në emër të qeverisë italiane po për këtë problem.

Ministria jonë e Tregtisë së Jashtme të vazhdojë punën e saj me italianët mbi bazën më jep të të jap, por të jetë e zgjuar, vigjilente, dhe të mos e flejë mendjen, pse fashistët italianë e të tjerë mund t'i shtrijnë presionet edhe në marrëdhëniet tregtare.

1 Në atë kohë ministër i Punëve të Jashtme të Italisë.

POGRADEC, E PREMTE

25 KORRIK 1980

## BISEDË ME SHOKUN AMAZONAS

Sot erdhi në Pogradec për t'u takuar me mua shoku Zhoao Amazonas, Sekretar i Parë i KQ të Partisë Komuniste të Brazilit. Ai ishte tok me të shoqen. Vinte në Shqipëri nga Parisi, ku çdo shtatë-tetë muaj duhet të bëjë disa kura shumë të domosdoshme për shëndetin e tij.

Në Pogradec shoku Amazonas shoqërohej nga shoku Ramiz Alia, me të cilin ka biseduar gjerë e gjatë për problemet aktuale të politikës ndërkombëtare dhe të gjendjes në lëvizjen komuniste ndërkombëtare.

I pritëm miqtë tok me Nexhmijen në shtëpinë ku pushojmë. Zhvilluam me këtë rast bisedime shumë të përzemërta, të çiltra e shoqërore.

Shoku Amazonas më vuri në dijeni mbi gjendjen në partinë e tyre. Më tha se Partia Komuniste e Brazilit po rritet dhe po kalitet. Më tha se kur u kthyen në Brazil me Arrudën, u zbulua në parti një fraksion që kishte në krye djalin e Pedro Pomarit. Ky fraksion notonte në ujërat e eurokomunistëve dhe luftonte çdo direktivë të partisë. Amazonasi më tha se fraksionistët i demaskuan, i këshilluan për herë të fundit dhe në kongresin e ardhshëm të partisë do t'i likuidojnë krejtësisht, pse ka akoma 4 veta në KQ prej 12 vetash dhe kanë në dorë akoma një komitet rajoni në Sao Paulo dhe një celulë në Bahia.

Amazonasi, si kurdoherë me një pjekuri të madhe dhe me një hov rinor revolucionar, ishte shumë optimist për luftën e partisë, ishte, gjithashtu, i ndërgjegjshëm për vështirësitë e mëdha që hasin dhe do të hasin nga lufta e egër që u bën qeveria e gjeneralëve, nga terrori që ushtron ajo dhe nga shtypja e shfrytëzimi që ushtrojnë më shumë se kurrë shoqëritë shumëkombëshe. Ai me këtë rast vuri në dukje rëndësinë e dy librave tanë «Imperializmi dhe revolucioni» dhe «Eurokomunizmi është antikomunizëm», libra, tha ai, që ndihmojnë shumë lëvizjen komuniste botërore. Ndenjëm së toku afro gjashtë orë me biseda të ndryshme dhe hëngrëm drekën në Volorekë, buzë ujit. Ata mbetën shumë të kënaqur.

Unë nga ana ime fola për përgatitjet që po bëjmë për hartimin e planit të ri pesëvjeçar, për objektivat që dëshirojmë të arrijmë me Plenumin e 8-të të KQ të Partisë<sup>1</sup> që mbajtëm këto kohët e fundit etj. Fola dhe për zhvillimin e kulturës, për historikun e fshatrave dhe për muzetë e ndryshëm që janë ngritur anembanë vendit dhe rolin e madh që luajnë ata.

Në mënyrë të veçantë theksova mendimin tim për rëndësinë e madhe që duhet t'i kushtohet rinisë në vendet kapitaliste, pse borgjezia atje me të gjitha forcat dhe mjetet e mëdha që ka në dispozicion, po punon për ta korruptuar atë shpirtërisht dhe fizikisht. Ajo synon ta arrijë këtë me anë të drogave, televizionit, kinemasë dhe literaturës degjeneruese e dekadente. Duhet të mbrohet rinia, duhet të luftohet që ajo të organizohet, të edukohet dhe të hidhet në luftëra klasore. Ky rol vendimtar dhe historik u takon ideologjisë sonë dhe partive komuniste e punëtore marksiste-leniniste. Duke ruajtur parimet klasore, të udhëheqjes së revolucionit, duhet të kemi pa-

<sup>1</sup> Ky Plenum diskutoi e mori vendime për probleme të shkencës e të teknikës.

rasysh se klasa punëtore duhet të qëndrojë në ballë. Por edhe klasa punëtore nuk i shpëton darës së kapitalit dhe kur punëtori kalon të 40-45 vjetët, nuk e ka atë hov dhe atë frymë luftarake që ka rinia punëtore në veçanti dhe e gjithë rinia në përgjithësi. Në këtë drejtim, i thashë Amazonasit, duhet të shikojmë edhe çështjen e të papunëve, që fabrikantët i hedhin në rrugë e i lënë në mjerim dhe në uri. Më duket, i thashë, se nuk është ai preokupacion i duhur me këta miliona të papunë, që «s'kanë ç'humbasin veç zinxhirëve» dhe që janë nga më të gatshmit të përleshën me armiqtë e klasës. Amazonasi ishte dakord me mendimin tim.

E SHTUNË  
2 GUSHT 1980

## PËRGJIGJE E MERITUAR PRESIDENTIT TË ITALISË

Muajin e kaluar Sandro Pertini, president i Republikës së Italisë, bëri një protestë «energjike» para ambasadorit tonë në Romë, pikërisht kur ky i paraqiti letrat kredenciale dhe i transmetoi të falat e shokut Haxhi Lleshi.

Presidenti italian protestoi duke thënë se «zoti Enver Hoxha në librin e tij «Eurokomunizmi është anti-komunizëm», sulmon popullin italian» dhe se ai «e ka për detyrë ta mbrojë atë» etj. . . Protesta e zotit Pertini ishte pa baza, arrogante, dhe kishte për qëllim të ushtronte presion ndaj nesh. Në këtë farë proteste nuk kishte as takt dhe as diplomaci, pse e bënte presidenti i republikës dhe pasi ambasadori italian në Tiranë, kur doli libri në fjalë, erdhi në ministrinë tonë dhe protestoi në emër të qeverisë së tij. Që atëherë protesta iu hodh poshtë ambasadorit italian, duke i treguar me fakte se në libër nuk sulmohet aspak populli italian.

Ambasadori ynë në Romë, pas protestës nervoze të presidentit italian, me diplomaci e me gjakftohtësi i tha zotit Pertini, se e kanë keqinformuar, se shoku Enver Hoxha në librin e tij asnjëherë dhe asgjëkundi nuk sulmon popullin italian, por shpreh pikëpamjet e tij ideologjike etj. Presidenti italian iu përgjigj se atij «nuk i interesojnë sulmet kundër eurokomunizmit» etj. Pas kësaj ne e thirrëm ambasadorin tonë në Tiranë për «pu-

shime». Siç duket qeveria italiane «u alarmua» dhe ndodhi që po në atë avion që udhëtonte ambasadori ynë për t'u kthyer në Tiranë, ishte edhe ambasadori italian në Shqipëri, që kishte shkuar për «pushime» në Itali. Ky i fundit bëri sikur u çudit kur e pa atë aty dhe e pyeti: «Do të rriini shumë në Tiranë?». Ambasadori ynë iu përgjigj: «Varet nga klima»!

Kthimin e ambasadorit tonë ne e bëmë për t'u thënë italianëve se presionet e tyre nuk shkojnë te ne dhe ishte një përgjigje e denjë që iu dha Sandro Pertinit. Por nuk u mjaftuam me kaq. Pritëm një javë dhe thirrëm në Ministrinë tonë të Punëve të Jashtme ambasadorin italian, të cilit iu dha një notë verbale nga shoku Haxhi Lleshi<sup>1</sup> për Sandro Pertinin. Në këtë notë, në thelb, presidentit italian i thuhej se «shoku Enver Hoxha në librin e tij «Eurokomunizmi është antikomunizëm» asgjëkundi nuk sulmon popullin italian. Atë ne nuk e sulmuam dhe ditëm të bënim dallimin e duhur edhe kur na sulmuan ushtritë fashiste të Musolinit, na dogjën vendin dhe na vranë popullin tonë. Ju kujtojmë, i thuhej Pertinit në këtë notë, se ishte shoku Enver, që, si Komandant i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare, pas kapitullimit të Musolinit, u bëri thirrje ushtrisë së mundur të Musolinit, të mos dorëzohej te gjermanët dhe populli ynë i pranoi e i strehoi ushtarët italianë në shtëpitë e veta në male dhe me mijëra ia dorëzoi të gjallë Italisë» etj.

Në notën tonë verbale Haxhi Lleshi, duke e hedhur poshtë si pa baza protestën e Pertinit, theksonte se ne shqiptarët dëshirojmë të kemi marrëdhënie të fqinjësisë së mirë, në bazë të parimeve të njohura, dhe askush nuk mund të pengojë Partinë tonë të demaskojë regjimet borgjeze dhe politikën reaksionare të partive të tyre.

1 Në atë kohë Kryetar i Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSSH.

Ambasadori italian e dëgjoi notën tonë dhe nuk tha veçse: «Mos ia vini re zotit Pertini, se është plak dhe është ca nervoz». Kjo ishte një përgjigje sa për të «justifikuar» gafën kolosale diplomatike. Italianët patën frikë se mos ne e hiqnim fare ambasadorin tonë, edhe pse pikërisht për atë provokuan ata.

Ne nuk e tërhoqëm ambasadorin tonë, por e thirrëm në Tiranë, ku do të rrijë disa kohë. Ne do të vëzhgojmë reagimin e italianëve dhe do të veprojmë sipas situatave.

Sandro Pertini nuk mungoi që pas notës sonë verbale, t'i dërgonte ambasadorit tonë në Romë një letër autografe, ku i përsëriste protestën që i bëri me gojë në Kuirinale<sup>1</sup>.

Ai, pra, e uli polemikën në rangun e ambasadorit, dhe në rast se ambasadori ynë i përgjigjej, ai ta deklaronte këtë «person të padëshiruar». Ne nuk i dhamë asnjë përgjigje.

Në letrën e Pertinit shënoheshin edhe faqet e librit «Eurokomunizmi është antikomunizëm» (191-193), ku gjoja «sulmohej populli italian». Në faqet në fjalë, përkundrazi, unë sintetizoj ato që për 35 vjet me radhë, 24 orë në 24 orë, shtypi, radioja, televizioni, literatura italiane dhe realiteti, e kanë shprehur me bujë. Jemi ne, pra, si internacionalistë, që mbrojmë popullin italian nga gjithë ai llum që është ngritur në fqinjët tanë të përtej Adriatikut.

Sandro Pertini, që mbeti duke bërë telegrame ngushëllimi dhe duke marrë pjesë në varrime të njerëzve që vrasin terroristët fashistë, në vend që t'i dënojë e t'i luftojë këta, proteston kundër nesh që themi të vërtetën.

<sup>1</sup> Selia e Presidencës së Republikës së Italisë.

## NGJARJET DHE NDODHITË NË ITALI VËRTETOJNË DREJTËSINË E TEZAVE TONA

Pardje bisedova me shokun Manush Myftiu, i cili erdhi për të më bërë vizitë.

Në atë kohë sapo kisha marrë një letër nga Mehmet Shehu, i cili, çuditërisht, më propozonte që «ambasadori ynë në Itali t'i përgjigjej letrës së Sandro Pertinit, me qëllim që fjalën e fundit ta kemi ne». «E shumta që mund të bëjë Pertini, shtonte ai, është që të mos e pranojë letrën».

I thashë Manushit t'u thotë shokëve se duhet të qëndrojnë në propozimin e parë që më bënë. Të mjaftohemi me përgjigjen e Haxhi Lleshit. Letra e Pertinit drejtuar ambasadorit tonë për mendimin tim është një provokacion i përsëritur. Po t'i përgjigjet ky me letër, mund t'i japim armë Pertinit që të kërkojë largimin e tij nga Italia. Si rrjedhim edhe ne do të kërkojmë largimin e ambasadorit italian etj., etj.

Unë mendoj, i thashë Manushit, se nuk duhet të ecim në këtë rrugë. Ne me dinjitet dhe në mënyrë diplomatike iu përgjigjëm Pertinit.

Unë mendoj, i thashë Manushit, se shokët mund të botojnë një artikull në «Zërin e popullit», ku duke dënuar atentatin e rëndë të terroristëve në stacionin hekurudhor të Bolonjës, të vënë në dukje vërtetësinë e vlerë-

simeve dhe të parashikimeve që bëhen në librin «Euro-komunizmi është antikomunizëm».

Natyrisht, në artikull nuk do të përmenden as partitë, as qeveria italiane, por duhet theksuar çështja që në libër nuk sulmohet populli italian, përkundrazi, ndihmohet dhe i hapen sytë për humnerën ku po e shtyn borgjezia dhe sistemi i saj. Të theksohet se Shqipëria qëndron vigjilente, pse dy herë me radhë në një periudhë të shkurtër është sulmuar nga ushtritë agresive të borgjezisë dhe të fashizmit italian. I thashë Manushit se mund të merret edhe ndonjë citat nga libri «Eurokomunizmi është antikomunizëm» pikërisht nga faqet që përmend Pertini në letër-protestën që i drejton ambasadorit tonë. Kështu tërthorazi marrin përgjigjen italianët dhe me fakte e ndodhi në vetë vendin e tyre, ne vërtetojmë drejtësinë e tezave tona<sup>1</sup>.

1 «Një akt i ri terrorist i forcave fashiste në Itali». «Zëri i popullit», 8 gusht 1980.

## JUGOSLLAVIA PO FALIMENTON

Jugosllavia titiste si strukturë dhe si superstrukturë po falimenton. Ekonomia jugosllave është në kalbëzim, sistemi i vetadministrimit ka dështuar dhe është bërë një pengesë e pakapërcyeshme për ecjen përpara. Po ngrihen pa pushim çmimet, inflacioni ka arritur kulmin, papunësia po shtohet dhe, tok me të gjitha këto të këqija, po shumëfishohet pakënaqësia e popujve jugosllavë.

Udhëheqja aktuale jugosllave në punën e saj ndjek dy drejtime të varura nga njëra-tjetra. Duke dashur të japë përshtypjen se është homogjene e në unitet, kërkon të duket sikur vazhdon të bëjë po atë politikë të madhe botërore që bënte Jugosllavia në kohën e «papës» së falimentuar revizionist, Titos. Këtë përshtypje ajo don ta japë duke harxhuar shuma të mëdha dollarësh nëpërmjet delegacioneve të panumërta që dërgohen nga të katër anët e botës. Qëllimi i udhëtimit të këtyre delegacioneve është që të propagandojnë se gjoja Jugosllavia e pas Titos, është po ajo e kohës së Titos, dhe se politika «e paangazhuar» e Jugosllavisë vazhdon të jetë një faktor i qëndrueshëm. Nëpërmjet kësaj, domethënë duke u përpjekur të mbajnë në këmbë pseudopolitikën e «të paangazhuarve», emisarët jugosllavë kërkojnë të ndihmojnë çështjen tjetër me rëndësi të madhe për Jugosllavinë, realizimin e kërkesës për kredi e borxhe të reja nga

Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe nga të gjitha shtetet e tjera kapitaliste.

Ekonomia jugosllave ka arritur në një shkallë të atillë që pa kredi e borxhe të reja nuk mund të qëndrojë në këmbë, bile do të pësojë një falimentim katastrofal. Për të evituar këtë katastrofë, udhëheqja aktuale jugosllave, si ai prifti që shëtit në kishë, pas meshës, me një dhisk për të mbledhur pesë kacidhe nga besimtarët, kërkon kredi e borxhe sa andej-këtej. Por, për t'i shpëtuar krizës së madhe që e kërcënon, asaj i duhen jo më pesë kacidhe, por disa miliardë dollarë të tjerë borxh, përveç miliardëve që ka deri tani. Kështu që borxhi i jashtëm i Jugosllavisë, sipas lajmeve të agjencive që kam lexuar, ka arritur në 22 miliardë dollarë. Mirëpo vendet kapitaliste nuk janë as të verbër, as budallenj që t'i japin këto kredi e këto borxhe kaq të mëdha një shteti të falimentuar e mufliz, një udhëheqjeje kapitaliste pa perspektiva, një sistemi që nuk u jep asnjë garanci të shëndoshë për kaptalet që ata mund të investojnë në Republikën Federative Socialiste të Jugosllavisë.

Prandaj, pavarësisht nga boja që pasardhësit e Titos përpiqen t'i japin regjimit të tij të falimentuar, kriza në Jugosllavi po thellohet dhe kontradiktat brenda, sidomos midis dy klaneve kroato-slllovene dhe klanit serb, po shtohen. Të parët janë për ruajtjen e sistemit të vetadministrimit, kurse klani tjetër, ai serb, kërkon që Federata të marrë kompetenca më të mëdha nga ato që ka aktualisht. Në qoftë se Federata merr kompetenca më të mëdha, kjo do të thotë që sistemi i vetadministrimit të shkatërrohet dhe të zëvendësohet me një sistem të centralizuar. Kroatët dhe slllovenët, nga ana tjetër, të cilët kanë pasur mbështetjen e Titos, nuk duan të kontribuojnë në ndihmat që u duhen dhënë republikave të prapambetura të Jugosllavisë. Kështu këto kontradikta do të

zhvillohen dhe nuk ka se si të mos arrihet në shkatërrimin e sistemit të kalbur të vetadministrimit, që ne e kemi demaskuar me kohë dhe që u sjell kaq fatkeqësi popujve të Jugosllavisë.

E ENJTE  
14 GUSHT 1980

## FRANCA DHE GJERMANIA FEDERALE NUK I NËNSHTROHEN DIKTATIT TË KARTERIT

Kam shkruar edhe më parë për mosmarrëveshjet që kanë lindur midis «Evropës së Bashkuar», veçanërisht Francës e Gjermanisë Federale dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Këto mosmarrëveshje janë manifestuar në mënyrë më të hapët këto kohët e fundit, që kur presidenti amerikan, Karter, kërkoi t'u impononte shteteve të «Evropës së Bashkuar» diktatin e tij në lidhje me disa probleme e ngjarje politike ndërkombëtare.

Konstatojmë se aktualisht mosmarrëveshjet midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Francës e Gjermanisë Federale, sidomos pas takimit të Zhiskar d'Estënit me Brezhnjevin në Varshavë dhe takimit të Shmidit me Brezhnjevin në Moskë, po bëhen më të theksuara e më të thella. Pas këtyre bisedimeve Zhiskari, në vazhdim të takimeve tradicionale për shkëmbim mendimesh bilaterale që kishin vendosur që në kohën e tyre Dë Goli me Adenauerin, bëri një vizitë miqësore zyrtare në Gjermaninë Federale. Bisedimet që ai zhvilloi me këtë rast me kancelarin Shmid përfunduan në përgjithësi me një mirëkuptim politik dhe ekonomik në mes Francës e Gjermanisë, dy shtetet më kryesore të «Evropës së Bashkuar».

Takimet dhe bisedimet e presidentit francez Zhiskar d'Estën me kancelarin gjerman Shmid treguan një unitet

më të thellë e më të qëndrueshëm se më parë midis këtyre dy republikave evropiane dhe një qëndrim më të fortë, pa u vënë haptazi në kundërshtim me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ne shohim se aktualisht kancelari gjerman Shmid po bën deklaratat, në të cilat thekson qëllimin e tij për të vazhduar më tej bisedimet gjermanoperëndimore me Bashkimin Sovjetik, domethënë për të vazhduar «Ost-politikën» që inauguroi Vili Brandi, ish-kryetar i Partisë Socialdemokrate Gjermane, e cila tash është në fuqi në Bon.

Pas takimeve me Brezhnjevin, kancelari i Bonit ka deklaruar se do të takohet së afërmi edhe me Gierekun e Polonisë dhe me Honekerin e Gjermanisë Lindore, dy shtete këto që, pas Bashkimit Sovjetik, janë nga më të fuqishmet në Traktatin e Varshavës. Bisedimet e Shmidit me të dy këta udhëheqës revizionistë lindorë, sipas mendimit tim, do të kenë për qëllim «ndihmën» që Gjermania e Bonit, pra, kapitali gjermanoperëndimor, do t'u japë këtyre dy vendeve që gjenden në vështirësi të mëdha ekonomike dhe politike. Natyrisht kjo ndihmë e Gjermanisë Federale është në favor të fuqive perëndimore dhe në disfavor të sovjetikëve. Socialimperialistët sovjetikë janë të detyruar ta gëlltitin këtë situatë, pse gjendja brenda vendit të tyre dhe ajo në gjirin e Traktatit të Varshavës nuk është e lulëzuar.

Gjermania Lindore e sidomos Polonia janë të mbërthyera në një krizë të rëndë ekonomike, gjë që i bën t'ua kenë shumë nevojën kredive të panumërta që kanë marrë e që dëshirojnë të marrin nga Gjermania e Bonit. Aktualisht në Poloni po zhvillohen greva të mëdha dhe të përditshme të punëtorëve, të cilët protestojnë për mungesën e mishit dhe të artikujve të tjerë ushqimorë dhe kërkojnë ngritjen e rrogave. Punëtorët, me grevat e tyre, e kanë vënë në vështirësi të jashtëzakonshme edhe politikisht qeverinë e Gierekut. Këto greva, naty-

risht, u shkaktojnë vështirësi edhe Bashkimit Sovjetik, po dhe gjithë kampit revizionist.

Bashkimi Sovjetik jo vetëm që nuk i furnizon «aleatët» e tij me lëndët e para të nevojshme, sidomos me naftë, energji elektrike, gaz e materiale të tjera, por u imponon atyre edhe armatime të reja moderne, të cilat ua shet me çmime të larta, ashtu siç bën edhe për materialet e tjera që ka kontraktuar me këto shtete. Prandaj qoftë Polonia, qoftë Gjermania Lindore, apo vendet e tjera vasale të Evropës Lindore, me kohë janë futur në borxhe kolosale jo vetëm ndaj socialimperializmit sovjetik, por edhe ndaj imperializmit amerikan e veçanërisht imperializmit gjermanoperëndimor.

Republika Federale e Gjermanisë është bërë sot një shtet i fuqishëm ekonomik, që, së bashku me Francën, sfidojnë, deri diku, edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kjo sfidë e tyre qëndron në mospranimin e politikës së Karterit për sa u përket sanksioneve politike dhe ekonomike kundër Iranit, në mospranimin e marrëveshjeve të Kemp Dejvidit për Lindjen e Mesme, në mospranimin e vendosjes në vendet e tyre të raketave «Pershing-2» dhe «Kruiz», sipas qejfit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës etj.

Këto çështje, pra, kanë krijuar fërkime midis Francës e Gjermanisë Federale me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, natyrisht, përpiqen të mos i lënë «aleatët» e vet në NATO të shkojnë në shumë larg, sidomos në bisedimet me socialimperialistët sovjetikë. Kështu, përveç presioneve të tërthorta e të drejtpërdrejta, Uashingtoni ka vënë Italinë e falimentuar që të kundërshtojë kursin e politikës së Parisit e të Bonit për bisedime me Bashkimin Sovjetik.

Në një artikull që ministri i Jashtëm italian, Emilio Kolombo, botoi para disa ditësh në gazetën «Republika», kritikonte Francën dhe Republikën Federale të Gjermanisë,

për politikën e veçuar që bëjnë brenda «Evropës së Bashkuar», në drejtim të Bashkimit Sovjetik. Ai i kritikonte Parisin dhe Bonin se gjoja flasin në emër të «Evropës së Bashkuar», pa marrë më parë pëlqimin e pjesëtarëve të tjerë të këtij komuniteti. Përveç të tjerave Kolomboja thotë se, kur flitet për «Evropën e Bashkuar» dhe për politikën e saj, duhet kuptuar se ajo është e lidhur ngushtë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Kolomboja theksonte se «mirëkuptimi franko-gjerman» është i nevojshëm për Evropën Perëndimore dhe shtonte se për këtë «Italia nuk është xheloze». «Por, vazhdonte ai, në rast se anëtarët e tjerë të Komunitetit Evropian vihen përpara fakteve të kryera dhe bëhen përpjekje për të vendosur vetë për vijat e përgjithshme të politikës evropiane, atëherë ne nuk jemi dakord». Pastaj ai vinte në dukje se midis Francës dhe Republikës Federale të Gjermanisë nuk ekziston unitet i plotë mendimesh dhe se ka «divergjenca në lidhje me mbrojtjen e përbashkët». Me këtë frazë të fundit ai kërkon të bëjë të njohur botërisht se ka kontradikta midis Francës dhe Italisë.

Këtu, e tërë çështja qëndron në atë që Italia mbështet plotësisht Shtetet e Bashkuara të Amerikës në veprimet e tyre. Këtë ajo e bën pse ua ka atyre nevojën më shumë se Franca dhe Gjermania Perëndimore; Italia është një shtet i falimentuar ku mbretëron kaosi dhe ku fashizmi vepron haptas.

Megjithëkëtë ditët e fundit Shmidi e ritheksoi edhe një herë politikën e tij drejt zbutjes me Bashkimin Sovjetik dhe me vendet e tjera të Traktatit të Varshavës. Duket qartë, pra, se Boni dhe Parisi dëshirojnë jo vetëm të mos i presin urat me Bashkimin Sovjetik, po përkundrazi t'i zbutin gjakrat, pse ata e dinë se një acarim në mes Bashkimit Sovjetik dhe vendeve kapitaliste të Evropës Perëndimore do të rezultojë me një gjak-

derdhje katastrofike për Evropën, dhe se nga kjo Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si kurdoherë, do të kenë përfitime të mëdha. Këtyre pasojave kërkojnë t'u shpëtojnë Franca dhe Gjermania Federale.

Shmidi dha shpresa, gjithashtu, se politika e Bonit drejt Lindjes, do të ketë efekte pozitive edhe për konferencën e ardhshme të Madridit mbi «sigurimin dhe bashkëpunimin evropian». Në këtë mbledhje Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që do të marrin pjesë, edhe pse nuk janë vend evropian, do të kërkojnë të ngrihet çështja e pushtimit të Afganistanit nga ushtria sovjetike, kurse Bashkimi Sovjetik e kundërshton një gjë të tillë. Prandaj Helmut Shmidi dhe Zhiskar d'Estëni do të përpiqen që të gjejnë një *modus vivendi* për këtë çështje, domethënë të mos e prishin me asnjërin, as me Bashkimin Sovjetik, as me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si të thuash do të përpiqen që edhe «mishi të piqet, por edhe helli të mos digjet». Kështu, ata duan të paraqiten deri diku si të paangazhuar në veprimet e shpejtuara të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilat kanë pasur edhe karakter elektoral. Siç dihet, Karteri këto veprime i ndërmoi edhe sepse i ranë mbi kokë shkëmbinj të mëdhenj që e tronditën prestigjin e tij si president, dhe i duhej patjetër t'u tregonte opinionit botëror dhe atij amerikan se ishte një president «i fortë», por në të vërtetë u duk se ishte një makaronë.

Pra Franca dhe Gjermania Federale mendojnë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kur të kenë një president të ri, ka mundësi që ai të jetë përsëri Karteri, do të ndjekin një politikë tjetër, më elastike ndaj Bashkimit Sovjetik dhe natyrisht edhe ndaj partnerëve dhe aleatëve të vet, veçanërisht ndaj Francës dhe Gjermanisë Federale.

Në këto situata Boni dhe Parisi janë në gjendje t'i bëjnë dhe po i bëjnë edhe ata shantazhe Uashing-

tonit dhe kështu forcojnë pozitat e tyre. Është e kuptueshme që këto dy vende, të cilat janë fuqizuar ekonomikisht dhe politikisht, bëjnë si me thënë ligjin në NATO derisa arrijnë të kundërshtojnë, në mënyrën e tyre, edhe planet amerikane dhe kërkojnë të ruhet statuskuoja nga e cila ata kanë përfitime. Gjermania Federale dhe Franca e shtrojnë çështjen kështu: A duhet ne ta lëmë këtë rrugë, ta braktisim këtë politikë drejt Lindjes dhe të futemi në konflikte të përgjakshme me Bashkimin Sovjetik, kur gjatë gjithë kësaj kohe kemi investuar shuma të mëdha në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera të Evropës Lindore, dhe, nga ana tjetër, kjo politikë ka sjellë mosmarrëveshje të rënda në gjirin e vendeve të Traktatit të Varshavës?

Kriza e madhe ekonomike botërore ka prekur thellë edhe Bashkimin Sovjetik dhe vendet e tjera të Traktatit të Varshavës. Nga kjo krizë e përgjithshme e kapitalizmit janë prekur edhe Gjermania Federale dhe Franca, por mund të thuhet se këto janë superiore ndaj vendeve të Evropës Lindore, të inkuadruara në Traktatin e Varshavës. Këtu e kam fjalën për anën ekonomike, pse ushtarakisht në një konflikt të mundshëm evropian Bashkimi Sovjetik dhe ato, janë më të forta nga Franca, nga Gjermania Federale dhe nga NATO-ja, në rast se nuk ndërhyjnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Pra me këtë politikë, Franca dhe Gjermania Federale u thonë edhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, edhe aleates së tyre, Kinës, në qoftë se ju dëshironi një konflikt me Bashkimin Sovjetik, bëjeni atë në Lindjen e Largme, në Siberi dhe jo në Evropë, jo në Lindjen e Afërt e të Mesme ku gjenden pusët e naftës, të cilat furnizojnë me energji edhe Evropën. Këtu ndeshen në kundërshtim të madh politika hegjemoniste e imperialiste e Shteteve të Bashkuara të Amerikës me politikën tjetër kapitaliste dhe kolonialiste të Francës, të Gjermanisë Fe-

derale dhe deri diku edhe të Anglisë, e cila nuk e ngre zërin siç po e ngrenë dy partnerët e tjerë evropianë. Anglia ka kohë që është shushatur, është bërë një aleate, si me thënë, e bindur, e heshtur, e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

E HËNË

1 SHTATOR 1980

## **ÇFARË FSHIHET PRAPA GREVAVE TË PUNËTORËVE TË PORTEVE POLAKE TË BALLTIKUT?**

Sikurse kam shkruar edhe më përpara në Ditarin tim Politik, që nga fillimi i muajit korrik në Poloni, sidomos në qytetet-porte të Balltikut, Gdansk, Gdunia, Shçecin etj., filloi një lëvizje greviste e dokerëve dhe e punëtorëve të sektorëve të tjerë. Këto greva morën përpjesëtime të mëdha gjatë 15-ditëshit të dytë të gushtit.

Që në fillim, zhvillimi i ngjarjeve lidhur me këto greva, tregoi se ato, edhe pse bëheshin nga punëtorë kundër vështirësive ekonomike në të cilat kanë ndeshur, frymëzoheshin e manipuloheshin nga jashtë dhe nga kisha e plotfuqishme katolike polake. Në thelb, pra, ato ishin reaksionare, me karakter kundërrevolucionar dhe drejt-heshin kundër pushtetit antipopullor aktual në Poloni.

Duke i ndjekur dita-ditës këto ngjarje, që u zhvilluan dy muajt e fundit në Poloni, mund të dalim me disa konkluzione të cilat mund të jenë, por edhe mund të mos jenë plotësisht ekzakte.

Ishte e natyrshme se grevat në Gdansk, Gdunia dhe në Shçecin do të çonin në disa zhvillime e rezultate. Në radhë të parë, ato i shkaktuan vështirësi të reja udhëheqjes revizioniste polake dhe, në të njëjtën kohë, bënë që të acaroheshin edhe situata politike në të gjithë vendin. Përveç kësaj, ashtu siç parashikohej, përpara situatave kri-

tike që u krijuan, presioneve të brendshme e të jashtme, qeveria polake u detyrua të nënshkruante më 31 gusht, në Gdansk, një marrëveshje kapitulluese me komitetin e grevistëve dhe të bënte disa lëshime e të pranonte, midis të tjerave, që në portet e Gdanskut, Gdinas e të Shçëçinit të ngriheshin «sindikatat e pavarura vetadministruese» dhe punëtorët të kishin të drejtën e grevës e të zgjedhjeve me votë të fshehtë. Ky rezultat, natyrisht, u arrit jashtë dëshirës së partisë dhe të qeverisë kundër-revolucionare polake, po ashtu edhe jashtë dëshirës së revizionistëve sovjetikë.

Ngritja e këtyre sindikatave të reja «të pavarura vetadministruese» është një sulm i ri i borgjezisë, i reaksionit ndërkombëtar dhe i revizionistëve modernë kundër teorisë leniniste për sindikatat e klasës punëtore si rripa transmissioni për të lidhur partinë me klasën e saj, si bashkim vullnetar i klasës punëtore për të mbrojtur pushtetin e saj, diktaturën e proletariatit, si shkolla të komunizmit. Ato janë krejtësisht në kundërshtim me atë që thoshte V. I. Lenini se

*«Bashkimet profesionale duhet të jenë bashkëpunëtorët më të afërta dhe të domosdoshme të pushtetit shtetëror, i cili drejtohet në gjithë punën e tij politike dhe ekonomike nga pararoja e ndërgjegjshme e klasës punëtore — Partia Komuniste»<sup>1</sup>.*

Tash ngritja e këtyre sindikatave të reja në Poloni do të thotë që në këtë vend, si fillim në tri qytetet e përmendura, sepse influenca e tyre mund të hapet si vaji në lakra në të gjithë vendin, por mund dhe të likuidohet në forma të ndryshme dhe nëpërmjet masave të marra

kohë pas kohe, do të ekzistojnë dy lloje sindikatash: «Sindikatat e pavarura vetadministruese» dhe sindikatat e drejtuara nga Partia Punëtore e Bashkuar e Polonisë. Sa për formë, në marrëveshjen që u nënshkrua në Gdansk, midis të deleguarve të qeverisë dhe atyre të komitetit të grevave, thuhet se këto «sindikata të pavarura vetadministruese» njohin drejtimin e partisë. Por, sipas njoftimeve të agjencive të lajmeve, shumë grevistë nuk kanë qenë dakord me udhëheqjen e tyre për këtë çështje. Ata dëshironin që këto sindikata të ishin krejtësisht të pavarura, në mënyrë që të mund t'u imponoheshin partisë dhe shtetit polak jo vetëm në çështjen e caktimit të çmimeve të artikujve ushqimorë e industrialë, por edhe në çështje të tjera të përgjithshme. Por kjo, siç duket, deri në njëfarë shkalle, nuk u arrit dhe udhëheqësi i këtyre grevave, Les Valesa, u tha punëtorëve se për tash duhet të kënaqemi me këto që arritëm, dhe, përpara zëvendëskryeministrit polak, Jegielski, që në emër të qeverisë nënshkroi marrëveshjen, theksoi se qeveria polake duhet t'i zbatojë kushtet e marrëveshjes, ndryshe grevat do të rifillojnë. Me një fjalë, të ashtuquajturit grevistë i bëjnë kërcënime qeverisë polake.

Këto janë faktet që ne njohim deri tani. Por unë mendoj se e gjithë kjo e ashtuquajtur grevë e punëtorëve të porteve të Balltikut nuk është shkaktuar vetëm nga mungesa e ushqimeve e sidomos e mishit ose e rritjes së çmimeve të tyre në treg, përkundrazi ajo ka karakter politik. Grevat nuk ishin spontane, por të organizuara. Ato ishin të organizuara nga jashtë, nga vendet kapitalisto-imperialiste dhe nga brenda, nga reaksioni polak, nga kisha dhe nga vetë klika e Gierekut.

Le t'i shpjegojmë dhe le t'i mbështetim në fakte këtë analizë e këto konkluzione.

Është e natyrshme që këto greva të jenë pasojë e vetë vijës revizioniste të së ashtuquajturës Parti Punëtore e

<sup>1</sup> V. I. Lenin. Veprat, vëll. 33, f. 202-203.

Bashkuar e Polonisë dhe e nënshtrimit të gjithanshëm të këtij vendi ndaj Bashkimit Sovjetik revizionist. Polonia, si pjesëtare e Traktatit të Varshavës dhe e KNER-it, është ushtarakisht e pushtuar, ekonomikisht e shfrytëzuar dhe politikisht e varur nga Bashkimi Sovjetik. Përveç kësaj, populli polak në përgjithësi ka qenë kurdoherë antirus. Reaksioni dhe kisha katolike vazhdimisht kanë përdorur të gjitha mjetet propagandistike dhe kanë shfrytëzuar vështirësitë ekonomike e politike për të thelluar urrejtjen ndaj Bashkimit Sovjetik, për të thelluar kontradiktat me të.

Nga ana tjetër, sistemi pseudosocialist në Poloni ka qenë kurdoherë në pozita më të avancuara kapitaliste sesa ai i vendeve të tjera të ashtuquajtura vende të demokracisë popullore. Në Poloni nuk u formuan dhe as ekzistojnë kooperativat bujqësore socialiste. Ekzistojnë disa ferma shtetërore, por në përgjithësi atje lulëzon prona private. Panët e sotëm polakë, natyrisht me emra të tjerë, posedojnë parcela të gjera tokash që i punojnë me punëtorë krahu, me argatë.

Në fshatin polak, pra, mbretëron sistemi bujqësor kapitalist, që ushqehet e përforcohet me ndjenja fetare antisocialiste e antisovjetike nga propaganda kapitaliste perëndimore dhe nga Vatikani nëpërmjet kishës polake, që kanë rrugë të hapët veprimi. Një gjendje e njëjtë është edhe në qytetet polake, pra edhe në fabrikat. Kisha katolike pas çlirimit, me përjashtim të një periudhe në kohën e Boleslav Bjerutit, ka luajtur dhe luan rol shumë të rëndësishëm kundërrevolucionar. Ajo ka ruajtur, ka forcuar dhe ka zhvilluar pozitat e saj ideologjike reaksionare dhe vazhdon të ndikojë thellë politikisht mbi fshatarësinë e mbi klasën punëtore, për të mos folur mbi inteligjencien polake, e cila ruan dhe zhvillon idealizmin dhe ideologji të tjera reaksionare. Këtë rol të rëndësishëm kishës katolike ia kanë dhënë Gomulka, Giereku dhe, me

dashje e pa dashje, atë e kanë toleruar edhe revizionistët sovjetikë. Është e qartë, pra, se kisha ka gisht dhe influencë edhe në grevat që po bëhen në Poloni.

Udhëheqja revizioniste polake, si ajo e partisë, ashtu edhe ajo shtetërore, në dukje, paraqitet sikur është në aleancë me revizionistët sovjetikë, por, në të vërtetë, është antisovjetike. Vetëm pozita gjeografike dhe qenia e Polonisë në Traktatin e Varshavës dhe në KNER, e detyrojnë atë të japë përshtypjen se është në unitet me sovjetikët. Edhe revizionistët sovjetikë e njohin këtë situatë, por ata nuk mund të lejojnë kurrë që Polonia t'u dalë nga dora. Përse? Sepse po ngjau një gjë e tillë, atëherë rrezikohen rrugët e hegjemonizmit sovjetik mbi të gjitha vendet e tjera të kampit revizionist, sepse Polonia është anëtarja kryesore dhe më luftarake, pas Bashkimit Sovjetik, në Traktatin e Varshavës dhe në rast se humbet Poloninë, Bashkimi Sovjetik nga pikëpamja ushtarake ka humbur Gjermaninë Lindore, Çekoslovakinë, Hungarinë për të mos përmendur Rumaninë dhe Bullgarinë. Me fjalë të tjera një gjë e tillë do të çonte në destabilizimin e strategjisë së vetë Traktatit të Varshavës në Evropë dhe kuptohet se në këtë rast socialimperialistët sovjetikë në asnjë mënyrë nuk mund të rrinin me duar lidhur.

Natyrisht edhe Polonia, si vetë Bashkimi Sovjetik, ka marrëdhënie ekonomike e politike shumë të zhvilluara me vendet kapitaliste perëndimore e edhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Këto marrëdhënie kanë ardhur duke u trashur. Në lëmin ekonomik, Polonia ka marrë kredi të mëdha nga vendet kapitaliste. Sipas lajmeve të ditëve të fundit, këto kredi arrijnë në 20 miliardë dollarë. Natyrisht, kjo e ka futur Poloninë në vështirësi të mëdha ekonomike. Asaj i duhet të përballojë detyrimet ndaj borxhlinjve, domethënë jo vetëm të kthejë këstet e kredive që ka marrë, por të paguajë edhe kamatat,

prandaj ka qenë e detyruar të shtojë eksportet. Por, për shlyerjen e plotë të kredive, Polonia duhet të sakrifikojë dy vjet me radhë të gjithë eksportin e vet, gjë që praktikisht është e pamundur.

Këto vitet e fundit zhvillimi ekonomik në Poloni ka rënë, dhe përveç kësaj përmytjet e sivjetme e kanë detyruar atë që të importojë miliona tonë drithë. Polonisë, pra, i mungon drithi për popullsinë dhe foragjeret për bagëtinë. Kjo gjë ka sjellë vështirësi e mungesa në treg, sidomos për mish, megjithëse Polonia është një nga vendet kryesore për eksportimin e mishit të dërrit, *bacon* që i thonë në Angli e gjetkë; janë shtuar tregu i zi dhe spekulimet, si rezultat është rritur pakënaqësia e masave të popullit dhe e punëtorëve. Vështirësitë janë shtuar akoma më shumë, sepse «aleatët» e Polonisë, me Bashkimin Sovjetik në krye, që e furnizojnë me shumë lëndë të parë, i kanë ngritur çmimet e mallrave dhe nuk ia livrojnë ato në kohën e duhur dhe në sasinë që kanë vendosur t'ia japin. Kjo tregon se marrëdhëniet në KNER janë vështirësuar me kohë dhe jo vetëm me Poloninë, por me të gjithë pjesëtarët e kësaj organizate ekonomike pseudosocialiste.

Për ta përmirësuar situatën në të cilën ndodhej, udhëheqja polake para 5-6 muajve ndryshoi kryeministrin, hoqi Jarosheviçin dhe vuri në vend të tij një tjetër, njëfarë Babjush, për të cilin atëherë u tha se gjoja do ta përmirësonte situatën ekonomike të Polonisë. Kjo ishte një përrallë, pse nuk ishte një person ai që e shkaktoi gjendjen aktuale të vështirë ekonomike, por ishte dhe është vetë vija revizioniste, kapitaliste e partisë dhe e shtetit polak. Babjushi dhe Giereku menduan se, duke ngritur çmimet e mishit dhe të artikujve të tjerë të nevojës së përditshme të popullit, do të mundnin të rregullonin situatën pa ndonjë kokëçarje të madhe. Por në

fakt nuk arritën as të kalonin vështirësitë e brendshme ekonomike dhe as të likuidonin detyrimet ndaj «aleatëve» e «dashamirësve» kapitalistë perëndimorë.

Pra, në këto situata të brendshme në Poloni filluan grevat e punëtorëve të porteve të Balltikut. Por grevat në qytetet e Balltikut dhe në përgjithësi çështjen polake ne duhet t'i shohim në kuadrin e strategjisë globale imperia- listo-revizioniste, në zhvillimet e politikës aktuale të të dyja superfuqive imperialiste. Kështu, para se të arrihej në grevat në Poloni, midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe shteteve të Evropës Perëndimore, e në veçanti me Francën dhe me Republikën Federale të Gjermanisë, ka pasur kontradikta të thella për disa çështje, si për Iranin, për lojërat olimpike që do të zhvilloheshin në Moskë, për vendosjen e raketave «Pershing-2» dhe «Kruiz» në territorin e shteteve anëtare të NATO-s dhe të raketave «SS-20» nga Bashkimi Sovjetik në territorin e vendeve anëtare të Traktatit të Varshavës, për çështjen e marrëveshjeve të Kemp Dejvidit midis Izraelit dhe Egjiptit, me fjalë të tjera për çështjen e Palestinës, të të drejtave të popullit palestinez etj.

Në këto mosmarrëveshje presidenti amerikan Karter mbajti një qëndrim gati arrogant dhe imponues kundrejt Francës dhe Gjermanisë Federale. Në të njëjtën kohë jo vetëm Franca, por edhe Gjermania nuk iu nënshtruan kërcënimeve dhe shantazheve amerikane. Përkundrazi, ato vazhduan politikën e tyre të «detantës» me Lindjen. Në këtë kuadër presidenti i Republikës Franceze, Zhiskar d'Estëni, shkoi në Varshavë dhe atje, duke pasur si «përkthyes» Gierekun, Sekretarin e Parë të Partisë së Bashkuar Punëtoresh të Polonisë, u takua kokë më kokë me Brezhnjevën.

Nga ana e tij edhe kancelari i Gjermanisë Federale, Shmid, shkoi në Moskë ku bisedoi me Brezhnjevën. Pas

takimeve me të, Shmidi deklaroi se i kishte kërkuar Bashkimit Sovjetik një moratorium prej 3 vjetësh për të diskutuar çështjen e vendosjes ose jo të raketave të reja në Evropë, qoftë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, qoftë nga Bashkimi Sovjetik. Përveç takimit me Brezhnëvin, Shmidi kishte planifikuar gjatë muajit gusht takime e bisedime në Poloni me Gierekun dhe në Gjermaninë Lindore me Honekerin.

Gjatë muajit korrik u bë edhe takimi midis Zhiskar d'Estënit dhe Shmidit në Gjermaninë Perëndimore. Sipas komunikatës që u botua pas bisedimeve të tyre, doli se ata kishin rënë dakord që qeveritë e të dy vendeve, në kundërshtim me dëshirat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të vazhdonin politikën e «detantës» dhe të bashkëpunimit me Bashkimin Sovjetik dhe me vendet e tjera të Evropës Lindore, domethënë me shtetet anëtare të Traktatit të Varshavës.

Dihet se edhe vendet e Evropës Lindore, pjesëtare të Traktatit të Varshavës dhe vetë Bashkimi Sovjetik kanë interesa të mëdhenj ekonomikë në bashkëpunimin me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, veçanërisht me Francën dhe me Gjermaninë Federale. Këto dy shtete perëndimore kapitaliste, shumë të zhvilluara, kanë investuar miliarda dollarë, u kanë dhënë miliarda kredi këtyre vendeve. Ato janë shumë të interesuara që nga këto kredi jo vetëm të nxjerrin, dhe nxjerrin fitime të mëdha, por, nëpërmjet tyre, synojnë të minojnë akoma më shumë influencën sovjetike në vendet e Evropës Lindore.

Me fjalë të tjera, nëpërmjet kredive e investimeve të shumta dhe politikës së «detantës» ato, nga njëra anë, përpiqen të largojnë nga Evropa rrezikun e një lufte bërthamore ose me armë konvencionale dhe ta shtyjnë atë në Azi, nga ana tjetër, të arrijnë të rritin influencën e vet mbi vendet satelite të Bashkimit Sovjetik, të dobësojnë, pra, lidhjet e tyre të shumanshme me Moskën. Ky

është objektivi i madh i këtyre dy shteteve më të fuqishme të Evropës Perëndimore.

Natyrisht, në këtë çështje e në këtë drejtim interes kanë edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Bile këto duan të jenë promotori i një politike ose i një shantazhi të tillë, kurse dy aleatët e tyre evropianë, Franca dhe Gjermania, për interesat e vet imediatë dhe të ardhshëm dëshirojnë të veprojnë si të pavarur. Bashkimi Sovjetik, nga ana e tij, gjendet në vështirësi politike dhe ekonomike, bile edhe ushtarake pas invadimit *manu militari* të Afganistanit. Kështu që në këto situata edhe Bashkimit Sovjetik i intereson të ruhet «detanta» dhe bashkëpunimi me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe në rast se këto vazhdojnë të kërcënojnë, atëherë, të paktën i intereson të çajë frontin e NATO-s duke bërë një politikë të «detantës» me Francën e me Gjermaninë Federale.

Këtë politikë të Bashkimit Sovjetik e ndjekin edhe satelitët e tij, vendet e tjera të Evropës Lindore. Bashkimi Sovjetik në asnjë mënyrë nuk dëshiron që këto vende satelite t'i dalin nga dora, por e ka të pamundur t'i ndalojë ato të futen në borxhe te Gjermania Federale, te Franca, te Shtetet e Bashkuara të Amerikës e te vende të tjera kapitaliste perëndimore.

Këto, sipas mendimit tim, janë caqet dhe objektivat politikë të synimeve dhe të dëshirave që kanë dy superfuqitë imperialiste në Evropë edhe në botë.

Pikërisht në këto situata e në këto ndërlikime politike ndërkombëtare, krahas vështirësive të brendshme të Polonisë, filluan grevat në qytetet bregdetare të Balltikut. Këto greva, siç e kam shkruar edhe në analizat e tjera që u kam bërë, janë reaksionare, kundërrevolucionare, udhëhiqen nga kapitalistë polakë dhe drejtohen kundër kapitalistëve të tjerë polakë që quhen revizionistë e që janë në fuqi. Këto greva kanë karakter antisovjetik dhe properëndimor. Grevistët janë në shërbim të reak-

sionit e të kapitalit të brendshëm polak dhe të kishës katolike.

Dy supozime mund të bëhen rreth faktit që këto greva shpërthyen nën influencën e forcave reaksionare të brendshme e të jashtme, por jo në një kohë aq të përshtatshme për to për të arritur rezultatet që dëshiroheshin. E para, mundet që ato shpërthyen pa llogaritur mirë momentet dhe predispozicionin e reaksionit kapitalist perëndimor. E dyta, ka mundësi që edhe ky i fundit dëshironte të arrihej në njëfarë kundërrevolucionari kundër kundërrevolucionarëve në fuqi në Poloni, por pa i kapërcyer caqet, domethënë të zhvillohej një kundërrevolucion i frenuar.

Me fjalë të tjera ka shumë mundësi që Franca dhe Gjermania Federale, nëpërmjet këtyre grevave, dëshirojnë të ushtronin presion ndaj Bashkimit Sovjetik, por jo ndaj Gierekut dhe klikës së tij, pra të mos shkohej aq larg, sa të viheshin në rrezik pozitativ e kësaj klike polake, përndryshe e gjithë politika e tyre e «detantës» drejt Lindjes do të komprometohej. Ata e dinin se, po të shkohej shumë larg në këtë çështje (dhe kjo kishte mundësi të ndodhte, pse kushtet për një grusht kundërrevolucionar kundër një grupi po aq kundërrevolucionar, por që është në fuqi në Poloni, janë përgatitur prej kohësh), do të shkaktonte ndërhyrjen e armatosur të Bashkimit Sovjetik.

Pra, mund të themi pa asnjë dyshim se Perëndimi ka pasur gisht në këtë lëvizje kundërrevolucionare polake, dhe nuk mungoi t'i hidhte benzinë zjarrit, por aq sa për t'i dhënë shtytjen e parë, shijen e parë të kundërshtimit sidomos nga klasa punëtore ndaj shtypjes sovjetike, dhe kjo në një formë të moderuar dhe jo të ashpër. Unë mendoj se për këtë orientim edhe klike e Gierekut ka pasur dijeni, e ka dashur një veprim të tillë për t'u treguar «më e pavarur» nga Moska. Giereku është prope-

rëndimor. Unë jam i bindur për këtë. Edhe shtetet kapitaliste perëndimore, duke përfshirë edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duan një udhëheqje polake me Gierekun, Babjushin ose një shokun e tyre në krye. Por në njëfarë shkalle, vendet kapitaliste evropiane sidomos, duan që edhe «mishi të piqet, edhe helli të mos digjet». Ato duan, pra, që punëtorët dhe populli polak të fitojnë gjoja të drejta demokratike, më shumë se ç'kanë aktualisht, që do të thotë se regjimi autoritar revizionist polak duhet të zbutet, të bëjë hapa të rinj drejt liberalizmit, por, në të njëjtën kohë, të mos kalohen caqet.

Po Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë apo s'kanë gisht në këtë mes? Mund të kenë, mund edhe të mos kenë. Mospasja është relative, pse Shteteve të Bashkuara të Amerikës u intereson një situatë që ta zemërojë, ta acarojë Bashkimin Sovjetik dhe ky acarim të ndikojë në marrëdhëniet e Moskës me aleatët e saj të Evropës Perëndimore, kështu që Karteri të mund të realizojë pastaj planet e tij hegjemoniste në Evropë, të dobësojë atë farë kundërshtimi që i bëhet nga ana e Francës dhe e Gjermanisë Federale. Por mund të mendohet edhe kështu: kontradiktat e Francës dhe të Gjermanisë Federale me Shtetet e Bashkuara të Amerikës ishin një lojë diplomatike në shkallë të gjerë për të arritur në grevat në Poloni, ose për të shkuar edhe më tej.

Unë mendoj se ky version nuk mund t'u leverdiste Francës dhe Gjermanisë Federale. Kjo u duk qartë edhe në qëndrimin që mbajti shtypi perëndimor, i cili vuri në dukje me të madhe grevat e punëtorëve të porteve polake të Balltikut, por, nga ana e tyre, qeveria franceze, ajo gjermane, qeveria angleze, bile edhe qeveria amerikane u treguan shumë të rezervuara. Jo vetëm kaq, por punëtorëve të Gdinas, të Gdanskut e të Shçëçinit ato u këshillorin kërkesa të matura. Deri edhe papa i Vatikanit, dhe si rrjedhim edhe kisha katolike polake me Vishin

në krye, u thoshin punëtorëve se ishin dakord me kërkesat e tyre, por haptazi u bënë thirrje që çdo gjë të zhvillohej në «qetësi», në «rregull», të merren «parasysht» kushtet e Polonisë, të shtetit polak etj., etj.

Me fjalë të tjera Perëndimi pati frikë nga një ndërhyrje ushtarake e Bashkimit Sovjetik, gjë që bëri të arrihet në Gdansk atë çka thashë në fillim të këtij shkrimi, në ndalimin e grevave me nënshkrimin e marrëveshjes midis përfaqësuesve të qeverisë dhe përfaqësuesve të komitetit të grevistëve. Sot për sot një ndërhyrje e armatosur nga ana e Bashkimit Sovjetik në Poloni nuk u leverdis as Gjermanisë Perëndimore, as Francës, as Anglisë dhe as Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Sidoqoftë frymëzimi i grevave në portet e Balltikut ishte frymëzim perëndimor, por njëkohësisht i frenuar dhe prudent, që të mos ndodhte ajo që ngjau me Çekoslovakinë dhe me Dubçekun, i cili mendoi se mund të shkonte drejt caqeve që ëndërronte kapitalizmi pa u rrezikuar nga Bashkimi Sovjetik.

Për sa i përket Gierekut dhe klikës së tij, edhe ai u frikësua se mos grevistët kapërcenin kufijtë, gjë që do të shkaktonte ndërhyrjen e Bashkimit Sovjetik dhe kështu e tërë klika e plani i saj të viheshin në rrezik. Pra klika e Gierekut, e cila sipas mendimit tim ka gisht në këto greva, synonte që nëpërmjet tyre t'u thoshte popullit dhe punëtorëve polakë: jepuni të kuptojnë sovjetikëve kundërshtimin tuaj për varësinë nga Moska, por me kujdes dhe maturi. Në të njëjtën kohë, për t'u treguar punëtorëve se regjimi gjoja socialist në Poloni ka falimentuar, përpara kombit polak, përpara grevistëve, ai bëri autokritikë «të hapët», skandaloze, në Komitetin Qendror, duke pohuar se në Poloni, sidomos gjatë gjithë këtyre viteve të fundit, janë bërë gabime të mëdha politike dhe ekonomike, furnizimet nuk janë bërë në rregull, janë shkelur të drejtat e shtetasve e janë vërtetuar një sërë

gabimesh të tjera, të cilat kanë shkaktuar pakënaqësi të mëdha te punëtorët e te populli.

Pas kësaj autokritike, klika e Gierekut premtoi se do t'i rishikonte kërkesat e grevistëve, disa prej tyre do t'i aprovonte, por nën drejtimin e Partisë Punëtore të Bashkuar të Polonisë dhe brenda kushtetutës e ligjeve të shtetit polak. Për gjithçka Giereku fajin ia ngarkoi kryeministrit të ri, Babjush, i cili nuk kishte veçse pak muaj që kishte ardhur në fuqi pas rrëzimit të Jarosheviçit. Tok me të u shkarkuan dhe një numër ministrash të tjerë dhe në vend të tyre u sollën disa njerëz që ishin përjashtuar nga Byroja Politike, nga KQ i partisë dhe nga kabineti i ministrave në kohën kur ra Jarosheviçi. Kështu Babjushi dhe të tjerët u bënë «koka e turkut», ndërsa faji nuk qëndronte te Babjushi. Faje ai kishte sa të duash, por ato e kanë burimin dhe shkakun te klika e Gierekut, që është reaksionare, kapitaliste. Prandaj, në qoftë se dikush duhej të largohej nga udhëheqja e partisë dhe e shtetit në Poloni, ky, në radhë të parë, duhej të ishte vetë Giereku me gjithë klikën e tij.

Për sa i përket Bashkimit Sovjetik socialimperialist, gjatë gjithë këtyre trazirave ai heshti, por veshët i mban te ngritur, ruante si macja miun dhe, pa lëvizur asnjë regjiment, sepse këto i kishte brenda në Poloni, armët i mbante gati për rrezikun që mund t'i turrej. Revizionistët sovjetikë patjetër mbanin lidhje me Gierekun dhe me klikën e tij, e me siguri nuk ishin dakord, përkundrazi ishin në kundërshtim të hapët me çka po ndodhte në Poloni dhe me klikën e Gierekut, me autokritikën e tij dhe me vendimet që po përgatiteshin të merreshin. Kur u nënshkrua marrëveshja në Gdansk, atëherë Moska në shtypin e saj relatoi shkurtimisht ngjarjet dhe zuri në gojë diçka nga fjalimi i Gierekut. Ky ishte qëndrimi që mbajti Bashkimi Sovjetik gjatë zhvillimit të këtyre grevave dhe ky qëndrim i trembi Shtetet e Bash-

kuara të Amerikës, Francën, Gjermaninë Federale, bile edhe vetë Gierkun dhe kishën katolike polake.

Aktualisht ne vëmë re se si Franca, ashtu edhe Republika Federale e Gjermanisë e edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nëpërmjet zëdhënësve të tyre zyrtarë kryesorë po i bëjnë elozhe Gierkut për mënyrën e zgjidhjes së krizës. Kështu Brzezinski, këshilltar i presidentit Karter për problemet e sigurimit, Ponjatovski, ish-ministër i Brendshëm i qeverisë franceze, e quajtnë Gierkun «njeri të pjekur», «me eksperiencë të madhe», «patriot të flaktë» që diti të zgjidhë më së miri mosmarrëveshjet e punëtorëve në grevë me qeverinë dhe me Partinë Punëtore të Bashkuar të Polonisë. Por fakt është se fuqitë perëndimore, tash për tash, dëshirojnë të qëndrohet deri këtu, të thellohen fitoret që korrën grevistët e porteve të Balltikut dhe të përhapen ato në të gjitha qendrat punëtore të Polonisë. Ato duan që të ashtuquajturat sindikata të pavarura vetadministruese të konsolidohen dhe të kthehen në një parti politike në opozitë me të ashtuquajturën Parti Komuniste të Polonisë.

Shtypi i këtyre vendeve shkruan haptazi se «fitorja e arritur nga punëtorët polakë është një fitore historike», pse kjo ngjau në një vend gjoja komunist e socialist, ku regjimi komunist ka falimentuar dhe ku nuk ekziston pluralizmi i partive. Pra kapitalizmi botëror, të ashtuquajturat sindikata të pavarura vetadministruese, që lindën nga kompromisi i klikës së Gierkut me grevistët kundërrevolucionarë të porteve të Balltikut, i konsideron si një parti të ardhshme politike, që ka fituar që tash pavarësinë ndaj Partisë Punëtore të Bashkuar të Polonisë.

Marrëveshja prej 21 pikash që u nënshkrua në Gdansk midis përfaqësuesve të komitetit të grevistëve dhe përfaqësuesve të qeverisë, është një disfatë e turp-

shme për revizionistët polakë, për sistemin pseudosocialist të ekonomisë në Poloni, është rezultat i zhvillimit që në fillim të ekonomisë private, sidomos në fshat, si edhe i masave të çala që janë marrë në industri. Në të njëjtën kohë e për analogji, ajo është një disfatë e turpshme edhe për Bashkimin Sovjetik dhe për vendet e tjera revizioniste.

Ç'janë këto 21 pika? Ato janë kërkesat ekonomike e politike, njëfarë platforme ideologjiko-politike e programit minimal të forcave kundërrevolucionare aktuale në Poloni, që komiteti i grevistëve ia kishte paraqitur qeverisë polake si kusht për pushimin e grevës. E para nga këto kërkesa ishte krijimi i «sindikatave të pavarura vetadministruese» jashtë, dhe në opozitë me sindikatat ekzistuese në Poloni. Kështu, në bazë të kësaj kërkesë, u aprovua themelimi i të ashtuquajturave bashkime profesionale të lira, si grupe krejt të pavarura dhe kjo gjoja në bazë të Konventës 87 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, të cilën Polonia e ka nënshkruar, por nuk e ka zbatuar. Në këtë çështje grevistët gjoja pranojnë edhe rolin drejtues të partisë, por është e qartë, atë e pranojnë përkohësisht dhe siç thuhet në marrëveshje, «në shkëmbim të garancive se edhe nga ana e partisë nuk do të ketë ndërhyrje në çështjet e bashkimeve profesionale». Një nga pikat e tjera thotë se punëtorëve «u garantohet e drejta për grevë» dhe grevistët e përkrahësit e tyre sigurohen që gjatë ose pas grevës «të mos keqtrajtohen». Kjo do të thotë që elementi reaksionar që frymëzon grevën dhe grevistët, u thotë këtyre të fundit se kur të dëshirojnë mund të rrinë pa punë dhe të kërkojnë nga shteti çfarë t'u dojë zemra. Në qoftë se nuk u jepet, atëherë ashtu si në vendet kapitaliste ku sundon prona private, ata të vazhdojnë grevën. Kjo klauzolë e marrëveshjes vë, pra, në pah se edhe në Poloni në fuqi është prona private ose prona shtetërore kapitaliste.

Një nga të 21 pikat e marrëveshjes u njeh grevistëve «lirinë e fjalës dhe të shtypit», «ndalon ndjekjen e botuesve të pavarur» dhe siguron mundësinë që në shtyp «të shkruajnë të gjitha sektet fetare». Pra këto «sindikata të lira», që marrin të njëjtat forma dhe të njëjtat «të drejta të sindikatave» në shtetin kapitalist, do të kenë shtypin e tyre dhe ky shtyp do të përdoret edhe nga sektet fetare, kuptohet në radhë të parë nga kisha katolike. Marrëveshja parashikon edhe heqjen e censurës, me përjashtim të rasteve kur gjoja preken sigurimi i shtetit dhe çështjet ushtarake. Për të tjerat s'ka as kufizim, as censurë.

Një pikë tjetër e marrëveshjes e detyron qeverinë polake «të rivendosen në punë ose të rifillojnë studimet të gjithë ata që janë pushuar, që janë përjashtuar nga universiteti ose janë burgosur për arsye të pjesëmarrjes në demonstrata dhe në greva që në vitin 1970 edhe në vitin 1976, ose për pikëpamjet e tyre politike». Pra, këta grevistë reaksionarë, arritën të kërkojnë nga qeveria e tyre reaksionare lirimin e të gjithë të burgosurve politikë. Jo vetëm kaq, por udhëheqja e këtyre sindikatave që sapo u krijuan i ka dërguar që tash qeverisë një listë me emra personash të dënuar dhe kërkon lirimin e tyre. Qeveria pranoi dhe ata do të lirohen brenda 24 orëve.

Grevistët kërkojnë nga qeveria që ajo të shpallë në shtypin e saj zyrtar krijimin e komitetit të grevistëve, kërkesat e tyre, domethënë të 21 pikat, në mënyrë që ato të merren vesh nga të gjithë punëtorët e Polonisë dhe kuptohet që edhe këta të nxiten të ndjekin rrugën e tyre. Këto sindikata kërkojnë nga qeveria e tyre reaksionare që të botojnë në shtyp «informata të plota mbi gjendjen ekonomike dhe shoqërore të vendit» dhe «t'u krijojë mundësi të gjitha grupeve të marrin pjesë në diskutimin mbi një program reformash kombëtare» të reja.

Në këto kërkesa, të cilat me nënshkrimin e marrë-

veshjes u kthyen në vendime, flitet, gjithashtu, për çështjen e marrjes së masave «për shtimin e rrogave», për «pagesën e grevistëve» që përfaqësojnë «kolonën e grevës», të rrogave për «periudhën e grevës» mbi mesataren e pagës së tre muajve. Pra grevistët kërkuar rritjen e rrogave, siguruan aprovimin e qeverisë për shtimin e tyre, kërkuar dhe u vendos që «të ruhet furnizimi i plotë i tregut të brendshëm dhe të eksportohen vetëm prodhimet shtesë». Qeveria u premtoi atyre t'u japë më shumë mish, «duke e importuar atë nga jashtë». U vendos «të ndalohet shitja e mishit dhe shitja e produkteve të vendit për valutë», «të hiqen privilegjet për anëtarët e partisë, forcat e sigurimit dhe të policisë». «Qeveria, thuhet në marrëveshje, theksoi se privilegje të tilla nuk ka» (edhe pse në fakt ka). Grevistët e pranuan deklaratën e qeverisë, por «deklaruan se do të bëjnë kontrolle» për t'u siguruar. Grevistët kërkuar «uljen e moshës së pensionit në 55 vjeç për burra dhe 50 vjeç për gra, ose mbas 25-30 vjet pune përkatësisht». U arrit në marrëveshje për çështjen e parë, ndërsa vendimi për çështjen e dytë u shty. Pastaj në marrëveshje radhiten pikat që flasin për përmirësime në fushën e pensioneve, në shërbimin shëndetësor, në rritjen e numrit të çerdheve, për lejë të paguar lindjeje për 3 vjet, shkurtimi i kohës që pritet për strehim, rritja e fondeve për shërbimet zyrtare, më shumë të shtuna të lira e të tjera, e të tjera.

Të gjitha këto koncesione, dhe çështjet për të cilat ato u bënë, flasin për gjendjen e kalbëzuar të regjimit aktual revizionist polak dhe për transformimin akoma më rrënjësor, më radikal, të Polonisë në një vend kapitalist. Siç shihet, ky transformim i një të ashtuquajturit vend socialist, që s'është socialist, u kërkuar dhe u arrit nga «klasa punëtore». Pikërisht për këtë arsye, borgjezia dhe shtetet kapitaliste, krerët e tyre që nga Karteri deri

te Regani, e quajjnë një «fitore historike», një fazë të re të ndërtimit të një «socializmi real», që në të vërtetë do të thotë transformimi i një vendi nga revizionist e pseudosocialist, në një vend plotësisht kapitalist.

Në qoftë se klika e Gierekut, e cila nënshkroi këtë kapitullim me elementë kapitalistë që paraqiten nën maskën e klasës punëtore, mbetet në fuqi, atëherë duhet të arrijmë në konkluzionin që influenca e Bashkimit Sovjetik në Poloni dhe nënshtrimi ndaj tij, ka arritur në një shkallë mjaft interesante. Në rast se klika e Gierekut rrëzohet dhe në fuqi vjen një udhëheqje prosovjetike, dhe këto të ashtuquajtura fitore që u arritën në Gdansk, në Gdania e në Shçecin gërryhen e më në fund zhduken, atëherë mund të arrijmë në konkluzionin tjetër se çizmjja sovjetike vazhdon të sundojë fort në Poloni. Sidoqoftë, qëndron apo nuk qëndron klika e Gierekut në fuqi, këndeje duhen nxjerrë dy konkluzione:

E para, regjimi pseudosocialist, sistemi revizionistokapitalist, qoftë ai i formës sovjetike, apo ai i formës aktuale polake, qoftë ai i vendeve të tjera që quhen vende të «demokracisë popullore», të cilat ndjekin rrugën e revizionizmit sovjetik, ose sistemi vetadministrues i titizimit jugosllav, tregojnë falimentimin e revizionizmit modern.

E dyta, të gjitha format e emërtimit e ndryshme që ata kanë adoptuar i çojnë vendet e tyre respektive drejt një sistemi të plotë kapitalist.

Një konkluzion tjetër, që del nga zhvillimi i grevave të punëtorëve të porteve të Balltikut, është roli i madh udhëheqës që ka partia komuniste marksiste-leniniste në krye të klasës punëtore. Kur një parti e tillë nuk ekziston, atëherë klasa punëtore manipulohet me lehtësi nga revizionistët modernë, nga borgjezia kapitaliste e brendshme dhe e jashtme. Një manipulim i tillë e çon klasën punëtore në disfatë të vërtetë, në rrugë që janë kundër

interesave të saj jetikë e në favor të interesave të borgjezisë kapitaliste, duke e gënjyer me gjoja fitoren e disa të drejtave fiktive. Por këto «fitore» nuk e lëkundin dot pushtetin e kapitalit, të kapitalistëve e të revizionistëve, ashtu siç nuk mund ta lëkundin pushtetin e borgjezisë në vendet kapitaliste grevat ekonomike, «liria» e fjalës, diskutimet «demokratike» e të tjera, e të tjera.

Një klasë punëtore revolucionare, që udhëhiqet nga një parti komuniste marksiste-leniniste e vërtetë revolucionare, duhet të luftojë seriozisht për të drejtat e veta politike dhe ekonomike. Ajo nuk mund t'i fitojë të drejtat e saj të vërteta me rrugën reformiste të bisedimeve.

Cilat janë të drejtat e vërteta për të cilat duhet të luftojë klasa punëtore? Në radhë të parë e mbi të gjitha është çështja e marrjes së pushtetit në duart e veta. Vetëm kur të ketë marrë në dorë dhe të ketë çrrënjësuar aparatit diktatorial të pushtetit të borgjezisë, pra, kur të ketë vendosur diktaturën e proletariatit, klasa punëtore mund të sigurojë me të vërtetë të drejtat që i takojnë për administrimin e gjithanshëm politik, ekonomik e kulturor të vendit në interes të vet e të masave punonjëse.

Çfarë do të ngjasë në Poloni në rast se revizionistët sovjetikë nuk arrijnë ta përmbysin situatën që u krijua? Do të krijohen për ta vështirësi të tjera më të mëdha dhe jo vetëm në Poloni, por edhe në vendet e tjera të Traktatit të Varshavës, në radhë të parë në Hungari, në Republikën Demokratike Gjermane, në Çekosllovakia, pastaj në Rumani e më në fund në Bullgari.

Këtij eventualiteti me siguri sovjetikët do t'i dalin përpara. Për këtë arsye Evropa Perëndimore, dhe ka mundësi që edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të solidarizohen me polakët për ta mbështetur kursin e tyre të ri, i cili është në interes të borgjezisë kapitaliste botërore

dhe në disavantazh të Bashkimit Sovjetik dhe të forca-  
ve revizioniste, aleate të tij.

Prandaj ne duhet të jemi vigjilentë dhe të ndjekim  
me kujdesin më të madh zhvillimin e ngjarjeve.

Në përfundim, krijimin e «sindikatave të pavarura  
vetadministruese» në Poloni ne duhet ta gjykojmë si një  
trampolinë për të kaluar nga një sistem anarkosindikalist  
të strukturave dhe të superstrukturave të vendeve revi-  
zioniste, në një sistem të plotë kapitalist. Ajo çka ndodhi  
në Poloni, ka ngjasim me atë çka ka ndodhur më përpara  
në Jugosllavi, vepër e grupit tradhtar të Titos. Por, Ju-  
gosllavia, që kaloi nga faza e një regjimi pseudosocialist  
pas lufte, u shkëput definitivisht nga kampi i socializmit  
dhe, pas disa peripecive, kaloi në sistemin e vetadminis-  
trimit. Në Jugosllavi roli i partisë u zhduk. U zhduk edhe  
roli i bashkimeve profesionale. Centralizmi shtetëror dhe  
demokratik u zhdukën dhe ia lanë vendin decentralizimit  
ekonomik, duke ruajtur gjoja një centralizëm politik dhe  
një administrim të përbashkët federativ.

Aktualisht në Jugosllavi vetadministrimit, në forma  
të ndryshme, po i vihen kushtëzime. Përse? Sepse si sis-  
tem anarkist që është, ai nuk mund ta përballojë krizën  
e madhe ekonomike që ka mbuluar Jugosllavinë dhe ven-  
det kapitaliste që e ndihmojnë atë. Kapitalistët perëndi-  
morë dhe imperializmi amerikan me investimet, kreditë  
e borxhet që japin kërkojnë të sigurojnë fitime nga Ju-  
gosllavia. Për një kohë, deri në kapërcimin e stadi të  
shkëputjes plotësisht nga sistemi gjoja socialist, këtyre  
qëllimeve të tyre u shërbeu sistemi i vetadministrimit.  
Tash, ky s'vlen më dhe qëllimet e borgjezisë kapitaliste  
botërore synojnë që t'i sigurojnë Jugosllavisë një sistem  
tjetër, atë të centralizmit burokratik.

Kurse në Poloni, revizionizmi polak, ashtu si në Ba-  
shkimin Sovjetik e në vendet e tjera anëtare të Traktatit  
të Varshavës, ruan format e vjetra të strukturës dhe të

superstrukturës, domethënë atje ruhet ende centralizmi  
në ekonomi e në pushtet; Partia Punëtore e Bashkuar e  
Polonisë është në udhëheqje; bashkimet profesionale lu-  
ajnë rolin e rripit transmetues të politikës së partisë  
revizioniste në klasën punëtore etj., etj. Borgjezisë kapita-  
liste perëndimore i duhet të gjejë një rrugëdalje për ta  
dobësuar më tej këtë sistem shtetëror që ata e dinë se është  
pseudosocialist e nën influencën e plotë të Bashkimit  
Sovjetik. Pra, kapitalizmi perëndimor dhe imperializmi  
amerikan, për të dobësuar sistemet kapitalisto-revizioniste  
në vendet aleate të Bashkimit Sovjetik, duhet të veprojnë,  
por, natyrisht, me prurë, sepse një ndërhyrje e tyre  
e hapët mund të shkaktojë ngjarje si në Hungari, në Çe-  
koslllovakë, në Afganistan, nga të cilat, siç duket, ata kanë  
nxjerrë mësim.

Pra, që të infiltrohen më mirë në këto vende, ata, do-  
methënë perëndimorët, duhet të përpiqen jo vetëm të rea-  
lizojnë aty degjenerimin e shoqërisë dhe të investojnë  
kapitalet e tyre, të cilat u sjellin fitime e njëkohësisht  
gërryejnë edhe potencialin politik, ekonomik dhe ushtarak  
të Bashkimit Sovjetik në këto vende, por nuk lënë në ha-  
rresë dhe punojnë edhe për degjenerimin e vetë sistemit  
aktual në fuqi në to. Dhe mjeti më i mirë për degjene-  
rimin e sistemit të vendeve revizioniste, është vetadmini-  
strimi, që u zbatua në Jugosllavi, po zbatohet në Kinë,  
e predikojnë eurokomunistët, partia revizioniste franceze,  
ajo italiane etj., dhe tash duhet ta zbatojnë edhe vendet  
e Traktatit të Varshavës.

Borgjezia kapitaliste botërore ka menduar, dhe s'ka  
menduar keq, se aktualisht nuk mund të tentonte për një  
përpjekje të tillë në Hungari, në Republikën Demokratike  
Gjermane ose në Rumani, prandaj gjeti Poloninë. Përse?  
Për arsye se në Poloni sistemi aktual revizionist në fuqi  
është dobësuar, kisha katolike është forcë dominuese dhe  
këtë forcë dhe rolin e rëndësishëm që ka asaj ia kanë

dhënë Gomulka, Giereku. Me dashje ose pa dashje atë e kanë toleruar edhe revizionistët sovjetikë. Kështu, borgjezia kapitaliste botërore ka në Poloni mbështetjen e kishës katolike, që përbën një forcë të madhe brenda vetë sistemit polak, ku e ashtuquajtura parti është e krimbur dhe kërkon rrugëdalje për të likuiduar elementët që përpiqen ta mbajnë në këmbë sistemin aktual.

Borgjezia kapitaliste botërore mbështetet, gjithashtu, në antisovjetizmin e madh të polakëve, si dhe në faktin se klika e Gierekut, pavarësisht nga ana formale, nuk u bindet plotësisht revizionistëve sovjetikë. Antisovjetizmi i Gierekut dhe i klikës së tij qëndron në nxitjen e rivendikimeve të fshehta për pavarësi nga revizionistët sovjetikë.

Në këto situata, ata që qëndrojnë prapa grevave në portet e Balltikut, të cilave përpiqen t'u japin karakter «të lirë vetadministrues», synojnë të krijojnë një opozitë ndaj Partisë Punëtore të Bashkuar të Polonisë dhe pastaj, sistemin vetadministrues ta zbatojnë dalngadalë edhe në ekonomi, ashtu siç u bë në Jugosllavi. Duhet të kemi, gjithashtu, parasysh faktin se këta «punëtorë grevistë», të frymëzuar nga borgjezia kapitaliste dhe nga kisha katolike, do të zhvillojnë aktivitetet në fshatin polak dhe «sindikatat e pavarura vetadministruese» do të përpiqen të grumbullojnë nën drejtimin e tyre të gjitha ndërmarrjet e vogla ose punishtet që ekzistojnë atje «për t'i vetadministruar» ekonomikisht dhe politikisht. Organizatat e reja sindikale do të zgjerojnë patjetër aktivitetin e tyre politik dhe si rrjedhim edhe ekonomik. Në ndërmarrjet shtetërore ku do të infiltrohet «e drejta» e grevës dhe të gjitha «të drejtat» e tjera, që figurojnë në 21 pikat që përmenda më lart, puna do të arrijë deri në atë shkallë saqë vendimet e tyre, nëpërmjet grevash, t'u imponohen qeverisë dhe Partisë Punëtore të Bashkuar të Polonisë.

Kështu mendojnë borgjezia kapitaliste përëndimore

dhe ata që udhëhoqën grevat e punëtorëve të porteve të Balltikut, me të cilët indirekt është ndërlikuar edhe grupi i Gierekut, që hedh gurin dhe fsheh dorën për të fituar terren në rrugë reformiste dhe për të evituar ndërhyrjet e Bashkimit Sovjetik në punët e brendshme të Polonisë. A do t'ia arrijnë ata këtij qëllimi? Kjo është një pikëpyetje. Mendimin tim unë e shpreha më lart dhe e përsëris se do të jetë shumë azardoze, siç thotë francezi, e guximshme që t'i çojnë gjërat më larg. Është e vështirë që revizionistët sovjetikë dhe vendet e tjera të Traktatit të Varshavës, ose klikat që sundojnë në këto vende, të lejojnë që të realizohen plotësisht qëllimet e borgjezisë përëndimore dhe të reaksionit polak. Bashkimi Sovjetik është i vendosur të ruajë pushtetin e vet në të gjitha vendet e KNER-it dhe të Traktatit të Varshavës, domethënë të ruajë të paprekur si pushtetin politik, format etatiste, strukturat e superstrukturat pseudosocialiste, ashtu edhe sistemin aktual ekonomik dhe atë ushtarak. Për këtë qëllim revizionistët sovjetikë krijuan të ashtuquajturën teori të «sovrانيتit të kufizuar».

Unë mendoj se kompromisi i arritur midis grevistëve dhe qeverisë polake është vetëm një *modus vivendi*. Bashkimi Sovjetik socialimperialist nuk do të lejojë që në klanin e tij revizionist të rritet një klan tjetër ultrarevizionist. Dhe është e qartë se Bashkimi Sovjetik, pavarësisht se ndodhet në vështirësi të mëdha ekonomike, politike dhe ushtarake brenda në Bashkimin Sovjetik dhe në gjirin e Traktatit të Varshavës, prapëseprapë ka aq forca, bile këto i ka të përqendruara në vendet vasale të Evropës Lindore, sa të mos lejojë që një veprimtari e tillë kërcënuese të përhapet e të bëhet e rrezikshme për të dhe për klikat në shërbim të tij që janë në fuqi në këto vende.

Në të gjitha këto çështje rëndësi të veçantë ka që klasa punëtore ndërkombëtare të mos gabohet dhe grevën në portet polake të Balltikut ta konsiderojë veprim-

tari revolucionare. Në asnjë mënyrë ajo nuk duhet vlerësuar si veprimtari revolucionare. Ajo ka frymëzim kundërrevolucionar, është drejtuar kundër një udhëheqjeje po aq kundërrevolucionare. Ajo kërkon të shpëtojë Poloninë nga thonjtë e socialimperialistëve sovjetikë, por duke e shndërruar atë në një vegël të kapitalizmit botëror.

Vetë klasa punëtore polake duhet ta kuptojë këtë. Të kuptojë se rruga e vërtetë e shpëtimit kërkon që klasa punëtore polake, nën udhëheqjen e një partie me të vërtetë marksiste-leniniste e të frymëzuar nga marksizëm-leninizmi, të ngrejë popullin polak në këmbë dhe ta udhëheqë në fushën e betejës për të rrëzuar klikat e brendshme kapitalisto-revizioniste, për të hequr qafe zgjedhën e Bashkimit Sovjetik revizionist, për të shkundur zgjedhën e kapitalizmit botëror dhe për të likuiduar influencën shkatërruese të kishës katolike. Klasa punëtore dhe populli polak duhet ta kuptojnë se antisovjetizmi i tyre aktual nuk bazohet në ideologjinë marksiste-leniniste, por është një antisovjetizëm i frymëzuar nga idetë shoviniste të borgjezisë polake.

Për sa u përket njerëzve tanë, nëpërmjet shtypit dhe mjeteve të tjera të propagandës, duhet t'i analizojnë e t'i kuptojnë drejt rrethanat në të cilat ndodhin këto ngjarje, t'i analizojnë e t'i kuptojnë ato nën dritën e marksizëm-leninizmit dhe të mos gabohen nga ajo se gjoja ata që ngritën krye ishin punëtorë dhe këta punëtorë ishin kundër klikës së Gierekut dhe kundër Bashkimit Sovjetik. Jo. Këta punëtorë, me ndërgjegje ose jo, nuk ecnin në rrugën e revolucionit, por në atë kapitaliste. Ata ishin kundër Gierekut, por jo për rrëzimin e tij, ishin kundër Bashkimit Sovjetik, por jo për shpëputjen me violencë nga çizma socialimperialiste sovjetike, nuk janë për ecjen në rrugën revolucionare, për kthesën vendimtare në ndërtimin e vërtetë të socializmit në Poloni. Borgjezia kapitaliste perëndimore dhe reaksioni botëror mund t'i përdor-

rin këta për të dobësuar kundërshtarët e tyre dhe për të forcuar pozitat e veta. Për të krijuar vështirësi dhe turbullira të reja, që edhe tani nuk janë të pakta, për të forcuar pozitat e veta dhe për të dobësuar ato të kundërshtarëve të saj, borgjezia kapitaliste botërore dhe veçanërisht borgjezia kapitaliste evropiane dhe ajo amerikane do të vazhdojnë me këto rrugë e me këto mënyra jo vetëm në Poloni, por edhe në Gjermaninë Lindore, edhe në vendet e tjera të ashtuquajtura të demokracisë popullore, edhe brenda në Bashkimin Sovjetik. Ja, në fakt, tash që grevat në portet polake mbaruan dhe, siç thuhet, sot rifilloi puna, borgjezia kapitaliste gjermanoperëndimore, Boni, filloi të nxjerrë përsëri në plan të parë çështjen e takimit dhe të bisedimeve të lëna mënjanë, me Honekerin, bile edhe me Gierekun. Në shtyp flitet, gjithashtu, se Gjermania Perëndimore i ka caktuar Polonisë një kredi të re prej 500 milionë markash «për ta ndihmuar» që të kalojë vështirësitë që ka. Po kështu edhe Franca. Po u bëhet thirrje të gjitha vendeve kapitaliste të zhvilluara që «ta ndihmojnë» Poloninë në këto situata. Pra, po vazhdon të hidhet helmi i lyer me një cipë të hollë sheqeri për të përforcuar pozitat e lëkundura të Gierekut për ta inkurajuar reaksionin polak dhe kishën katolike që të vazhdojnë punën e tyre gërryese kundër komunizmit, të shtohen mëria dhe armiqësia kundër Bashkimit Sovjetik etj. Nga ana e tij edhe Bashkimi Sovjetik, patjetër, punon për të krijuar një ekip të ri në favor të tij dhe, kur ta ketë krijuar atë, atëherë do t'ia ngrejë këmbët Gierekut dhe do ta zëvendësojë me një Gierek prosovjetik më të sigurt.

Sidoqoftë, me sa duket, tani për tani, Giereku e shpëtoi lëkurën e vet, po ashtu shpëtoi edhe nga ndërhyrja sovjetike. Megjithatë gjendja e turbullt në Poloni nuk ka marrë fund. Ajo po zhvillohet e do të zhvillohet. Mendoj se Bashkimi Sovjetik do t'ia shtrëngojë rripat Polonisë.

### LETËR NGA POL MILIEZI

Profesor Pol Miliezi, mjek me famë e pjesëmarrës në rezistencën franceze më dërgoi një letër shumë të ngrohtë nga Parisi ku sapo është kthyer nga një qëndrim i shkurtër në vendin tonë. Më falënderon për pritjen e ngrohtë e miqësore që i është bërë këtu.

Do t'i bëj një përgjigje që ta falënderoj për ndjenjat shumë dashamirëse dhe të sinqerta që shpreh për vendin tonë, si dhe për përkrahjen që i jep Shqipërisë socialiste, si kryetar i shquar i Shoqatës së Miqësisë Francë-Shqipëri.

Ta falënderoj, po ashtu, për kujdesin e madh që tregojnë për shokët dhe veçanërisht për kujdesin aq të madh, aq humanitar që tregoi personalisht vetë ai për shokun tonë të dashur, Hysni Kapon etj., etj.

### SHËNIM

Profesor Miliezit i dërgova sot një kopje të librit tim «Hrushovianët» në gjuhën frëngjishte me dedikasin që vijon:

«A mon ami le professeur Paul Milliez, avec mes profonds sentiments d'amitié et mes meilleurs souvenirs.  
En hommage»<sup>1</sup>

Enver Hoxha

30 septembre 1980

<sup>1</sup> «Mikut tim profesor Pol Miliezit, me ndjenjat e mia më të thella miqësore dhe me kujtimin tim më të mirë.

Në shenjë nderimi»

Enver Hoxha

30 shtator 1980

## SHËNIM

I dërgova Robert Eskarpit një kopje të librit tim «Hrushovianët» në gjuhën frëngjishte me dedikasin që vijon:

«A. M. Robert Escarpit, ami sincère de l'Albanie Socialiste, homme de grande culture, auteur de renom et essayiste qui, comme Montaigne en son temps, a bien connu et apprécié le caractère noble et fière du montagnard albanais.

En hommage de l'auteur»<sup>1</sup>

*Enver Hoxha*

30 septembre 1980

1 «Z. Robert Eskarpit, mikut të sinqertë të Shqipërisë socialiste, njeri me kulturë të gjerë, autor me emër dhe eseist, i cili, ashtu si Montenji në kohën e tij, e ka njohur dhe e ka çmuar më së miri karakterin bujar dhe krenar të malësorit shqiptar.

Në shenjë nderimi nga autori».

*Enver Hoxha*

30 shtator 1980

## PËRVOJA E MADHE E PARTISË ËSHTË ARMA MË E FUQISHME NË DUART E POPULLIT E TË KOMUNISTËVE

Besoj se libri «Hrushovianët» do t'u vlejë njerëzve tanë dhe sidomos rinisë që nuk i ka jetuar ngjarjet për të cilat flitet aty.

Duke lexuar këtë libër, njerëzit mund të gjykojnë se momentet nëpër të cilat kemi kaluar, kanë qenë shumë të ngatërruara, shumë të vështira dhe delikate. Vetëm një parti marksiste-leniniste si jona mund t'i kapërcente ato vështirësi, siç edhe i kapërceu me sukses. Pjekuria, guximi, vija e drejtë marksiste-leniniste e saj, kompaktësia dhe uniteti i radhëve të saj e bënë Partinë tonë të përballonte në çdo pikëpamje luftën e madhe kundër fujive të mëdha.

Besoj se njerëzit, dhe në radhë të parë komunistët, do t'i kenë parasysh këto beteja të Partisë sonë të lavdishme, do të mësojnë nga strategjia dhe taktikat e saj, pse lufta vazhdon dhe do të vazhdojë. Eksperienca e madhe e Partisë është arma më e fuqishme në duart e popullit dhe të komunistëve shqiptarë.

**GJYQI I TË GJALLËVE E I TË VDEKURVE,  
GJYQI I MAO CE DUNIT**

Në Pekin ka filluar gjyqi i «bandës së të katërve», që është bërë «banda e të dhjetëve», pa përmendur të panurmërtit e tjerë që quhen «pasuesit e bandës së të katërve» dhe që gjykohen në mënyrë ekstensive nëpër provinca. Ky është **gjyqi i të gjallëve dhe i të vdekurve, por mbi të gjitha është gjyqi i Mao Ce Dunit.**

Pjesëtarët e «bandës së të katërve» gjykohen kryesisht si banditë e vrasës të qindra mijë njerëzve dhe jo si kundërshtarë politikë të grupit të Liu Shao Çisë e të Ten Hsiao Pinit me kompani. Gjykimi i të akuzuarve si njerëz politikë do ta çonte larg bandën e Tenit, pse do t'i hapej ose duhej t'i hapej tërë peta lakrorit, që do të thotë të dilte në dritë e vërteta mbi Kinën e ashtuquajtur socialiste, ku, në realitet, socializëm nuk po ndërtohet dhe të shpjegohej politika e Mao Ce Dunit, e Liu Shao Çisë, e Çu En Lait, e Tenit dhe e një numri të madh rrymash politike që përplaseshin atje.

Si e arsyetojnë këtë gjyq, që për fat të keq s'është veçse një komedi tragjike për popullin kinez, njerëzit e bandës së Tenit tani që kanë marrë plotësisht në duar frenat e shtetit? Le t'ia lëmë fjalën agjencisë kineze të lajmeve HSINHUA. Kjo thotë se juristi Çen Jou Ju, zëvendëskryetar i Akademisë së Shkencave Shoqërore të Kinës, iu përgjigj pyetjes së mëposhtme: «Cilat janë arsytet li-

gjore që gjykata e posaçme pranë gjykatës së lartë popullore ka përdorur kodin penal të Republikës Popullore të Kinës në procesin gjyqësor kundër klikave kundërrevolucionare të Lin Biaos dhe të Çian Çinit, në vend të neve për dënimin e kundërrevolucionarëve dhe të dekretëve në fuqi, kur ata kanë kryer krime kundërrevolucionare, për të cilat akuzohen?».

Ja edhe përgjigjja tekstuale: «Lidhur me çështjen e zbatimit të ligjit, neni nëntë i kodit penal të Kinës përcakton se, në qoftë se një akt i kryer pas themelimit të Republikës Popullore të Kinës dhe para hyrjes në fuqi të ligjit të tanishëm nuk konsiderohet krim sipas ligjeve, dekretëve dhe politikave të asaj kohe, atëherë si bazë do të shërbejnë këto ligje, dekrete dhe politika. Në qoftë se akti konsiderohet krim sipas atyre ligjeve, dekretëve dhe politikave e gjithashtu edhe sipas nenit të tetë të kapitullit të katërt të dispozitave të përgjithshme të ligjit të tanishëm, për këtë krim do të zbatohen ato ligje, dekrete dhe politika, por, në qoftë se akti nuk konsiderohet krim, ose në qoftë se dënimi për krim është më i lehtë sipas ligjit të tanishëm, atëherë duhet të zbatohet ligji i tanishëm. Në përputhje me këtë nen, rrethanat e mëposhtme duhet të shqyrtohen, duke pasur parasysh zbatimin si më parë të këtij ligji. Në qoftë se një akt i kryer, pas themelimit të Republikës Popullore të Kinës dhe para hyrjes në fuqi të ligjit të tanishëm, nuk konsiderohet krim sipas ligjeve, dekretëve dhe politikave të atëhershme, por konsiderohet krim sipas kodit penal, ligjet, dekretet dhe politika e mëparshme akoma do të jenë në fuqi, ndërsa kodi penal nuk do të zbatohet si më parë. Në qoftë se akti konsiderohet krim, sipas atyre ligjeve, dekretëve dhe politikave dhe gjithashtu sipas kodit penal dhe duhet të bëhet objekt ndjekjeje, ato ligje, dekrete dhe politika do të mbeten gjithashtu në fuqi për sa i përket veprimtarisë kriminale, ndërsa kodi penal nuk do të zbatohet si më parë.

Në qoftë se akti konsiderohet krim, sipas ligjeve, dekretëve dhe politikave që ishin atëherë në fuqi, ose është objekt i dënimit të rëndë, por nuk është krim ose është një krim që parashikon një dënim më të lehtë sipas kodit penal, atëherë ligji i tanishëm ka fuqi prapavepruese» etj., etj.

Jashtëzakonisht «e qartë», s'ka ku vete «më qartë dhe në mënyrë më të kuptueshme»! Më tërë kuptimin e fjalës ky është një lesh arapi, një kinezëri e vërtetë tipike për të mos kuptuar asgjëkafshë.

Udhëheqja kineze s'ka gjetur rrugë më të errët për të gjykuar një çështje kaq të madhe, të ndërlikuar dhe të pazgjydhshme në rrethanat aktuale nëpër të cilat po kalon Kina.

Duke ndjekur seancat e para të gjyqit e duke lexuar pretencën e prokurorit të përgjithshëm në gjyqin e «bandës së të katërve», del qartë se ky gjyq synon vetëm të vërtetojë në mënyrë krejt të thjeshtë se të dhjetë personat që gjenden në bankën e të akuzuarve si dhe ata që kanë vdekur, me përjashtim të Mao Ce Dunit, i cili nuk përmendet asgjëkundi, «kanë komplotuar për të vrarë Mao Ce Dunin» (këtë komplot e ka organizuar banda e Lin Biaos, në të cilin implikohen oficerë që nga shefi i shtabit të përgjithshëm deri te komandanti i flotës ajrore); se «banda e të katërve», domethënë Çian Çini dhe tre të tjerët, «kanë komplotuar kundër Ten Hsiao Pinit dhe Çu En Lait me shokë», se kanë shkuar te Mao Ce Duni dhe e «kanë informuar» atë se Çu En Lai, megjithëse i sëmurë në krevat nga kanceri, po pret ditë e natë njerëz si Ten Hsiao Pinin, Jeh Çien Jinin, Li Hsien Nienin, se ata «po komplotojnë kundër pushtetit në Kinë dhe, si rezultat, është krijuar një situatë sikundërqë u krijua në Lushan».

Në vitin 1970, në Lushan Lin Biaoja «paska bërë përpjekje që Komiteti Qendror të vendoste përsëri postin e

kryetarit të shtetit, që u hoq pas shkarkimit të presidentit Liu Shao Çi, tre vjet më parë, pse donte të bëhej vetë kryetar i Republikës Popullore të Kinës, të merrte pushtetin». Në Lushan Mao Ce Duni e paskësh kundërshtuar mendimin e Lin Biaos, se gjoja ai e kishte kuptuar qëllimin e tij, por nuk kishte munguar që ta ngrinte në qiell dhe ta bënte Linin shokun e tij kryesor të armëve.

Pra, njerëzit e «bandës së të katërve», me Çian Çinin në krye, vanë komplotuan me Mao Ce Dunin, i cili gjoja i tha Van Hun Venit të dërguar nga banda, «që të mos merreshin me këto gjëra dhe të mos u besonin shumë mendimeve të Çian Çinit». Mirëpo Van Hun Veni, natyrisht, nuk ia tha «bandës së të katërve» mendimin e Mao Ce Dunit. Këta pra «komplotuan». Përveç kësaj, këta akuzohen për të gjitha krimet e Revolucionit të madh Kulturor, për persekutimin e kuadrove, domethënë të shokëve të Ten Hsiao Pinit dhe të Liu Shao Çisë, si dhe për vrasjen e qindra mijë vetave.

Ky është thelbi dhe tërësia e pretencës së prokurorit. Në këtë pretencë prej tri ose katër faqesh gazete nuk mund të gjesh asnjë fjalë për qëllimet politike, organizative, ekonomike dhe ideologjike të të akuzuarve. Nuk flitet, gjithashtu, cilat ishin pikëpamjet e grupit të Liu Shao Çisë, të Ten Hsiao Pinit, të Çu En Lait, të Çu Desë etj., që u luftuan nga Revolucioni i madh Kulturor. Mbi të gjitha nuk thuhet asgjë për pikëpamjet politike të Mao Ce Dunit mbi këto probleme të mëdha që kanë preokupuar Kinën, që nga viti 1956 dhe derisa «timonieri i madh» mbylli sytë. Asgjë. Domethënë çështjeve politike, çështjeve organizative, atyre ekonomike, apo ideologjike u është vënë kapaku në këtë gjyq dhe pjesëtarët e «bandës së të katërve» akuzohen vetëm se janë «kriminelë, vrasës e komplotistë». Gjithë aktakuza përbëhet nga thashetheme, filani porositi filanin të vejë t'i thotë filanit kështu ose ashtu dhe ai iu përgjigj kështu, tjetri shkoi i

kallzoi këtë, ky vajti i tha atij. Pra një *galimatias*<sup>1</sup> i tillë qesharak përbën aktakuzën e prokurorit të përgjithshëm të Kinës kundër «bandës së të katërve».

Gjyqi filloi me ushtarakët, mbasi gjykimin e të akuzuarve e kanë ndarë në dy pjesë, në gjykimin e ushtarakëve më parë, pastaj dhe në gjykimin e Çian Çinit, të Jao Ven Juanit dhe dy të tjerëve. Shumë për t'u tallur e për të qeshur është gjyqi i ushtarakëve. Të lexosh pyetjet e gjykatësit dhe përgjigjet e të akuzuarve, mund të nxjerrësh konkluzionin se udhëheqësit revizionistë të Pekinit po tallen me popullin kinez e në të njëjtën kohë bëhen edhe lodra e botës. Kryesuesi i seancës gjyqësore i bën, për shembull, pyetjen ish-komandantit të Flotës Ajrore të Kinës Vu Fa Hsien: «Je ti që e emërove djalin e Lin Biaos si zëvendës drejtor të Zyrës së Përgjithshme dhe zëvendës shef të Drejtorisë Operative të Komandës së Forcave Ajrore?».

Dhe i akuzuari përgjigjet:

— Po, unë jam.

— Po pse e emërove?

— Se mora urdhër nga Lin Biaoja. — Dhe pas kësaj përgjigjeje lexohet urdhri i emërimit të djalit të Lin Biaos.

— Si ia komunikove këtë urdhër? — vazhdon gjykatësi.

— Ia komunikova duke qenë prezent filani dhe filani. — Atëherë kryesuesi i seancës gjyqësore thërret personat që iu përmend emri, të cilët deponojnë se ndodheshin atje kur komandanti i aviacionit emëroi djalin e Lin Biaos dhe i porositi që urdhrat të zbatoheshin.

«U vërtetua kjo», thotë me kënaqësi kryesuesi i seancës gjyqësore. — Pastaj, vazhdoi ai, djali i Lin Biaos (që u vra tok me babanë kur «u arratis» në Mongoli) bëri

<sup>1</sup> Frëngjisht — fjalim i shkruar në mënyrë të ngatërruar dhe konfuze.

një mbledhje me filanin, me filanin dhe me filanin, ku shtroi çështjen që të formohej një komandë e përbashkët e aviacionit dhe e flotës.

— Je në dijeni? — e pyet përsëri kryesuesi i seancës gjyqësore ish-komandantin e flotës ajrore.

— Po.

— Po pse e bëri këtë djali i Lin Biaos?

— E bëri se mori shembullin e filan admiralit japonez që kishte bërë një organizim të tillë. — Kryesuesi i seancës gjyqësore me seriozitetin më të madh, thotë përsëri, «ja, u vërtetua edhe kjo».

Atëherë bëhet një tiradë, ku vihet në dukje që djali i Lin Biaos gjoja kishte bërë disa mbledhje dhe kishte kërkuar të viheshin nën kontroll radarët, pajisje e mjete të tjera ushtarake dhe të gjitha këto për arsye se do të përgatitej komploti, ose ky komplot ishte duke u përgatitur për të vrrarë Mao Ce Dunin dhe tërë këta njerëz mbanin lidhje me Lin Biaon. (S'duhet harruar se Lin Biaoja ishte ministër i Mbrojtjes i Kinës në atë kohë dhe, mbi Çu En Lain, ai komandonte jo vetëm aviacionin, por tërë forcat e armatosura, pra edhe marinën, këmbësorinë etj.)

Kështu gjoja kishin vendosur, por s'ka kush e vërteton këtë gjë, vetëm se të akuzuarit e pohojnë, ata thonë se «ashtu është, do të bëhej komplot për të vrrarë Mao Ce Dunin» dhe «kishin vendosur që këtë ta hidhnin në erë» kur të kalonte treni nga ajo ose nga kjo rrugë. Mirëpo Mao Ce Duni në kundërshtim me oraret e rregullta të trenit «nuk qëndroi në Shangaï, nuk doli fare nga treni dhe u largua drejt e në Pekin». Kështu dështoi i famshmi komplot dhe Çu En Lai nga Pekini dha urdhër që avioni special numër kaq apo aq, që ishte në dispozicion të Lin Biaos, të kthehej në Pekin. Mirëpo Lin Biaoja pasi kishte parë dhe kuptuar se komploti u zbulua, u bashkua me gruan dhe me djalin, hipi në po

këtë avion, por harroi të merrte një pilot të dytë që i duhej, si dhe specialistin e radarëve dhe në këto kushte u nis për në Mongoli, ku u vra.

Gjithë kjo histori u zhvillua në gjyq gati kështu, me këto fjalë që thashë më lart, vetëm nuk përmenda dot emrat, se nuk i mbaj mend. Dhe tërë kjo që thashë, formon aktakuzën kundër oficerëve dhe komplotit. Me të vërtetë për të qeshur!

Nga «banda e të katërve» kanë nxjerrë përpara trupit gjyqes vetëm Van Hun Venin dhe Jao Ven Juanin, të cilët i kanë pyetur nëse kanë bërë komplot.

— Po, — janë përgjigjur këta, — kemi bërë komplot.

— Po si e keni bërë këtë komplot?

— Ja, shkuam te Mao Ce Duni dhe i thamë se Çu En Lai me Ten Hsiao Pinin, me Li Hsien Nienin dhe me Jeh Çien Jinin po komplotojnë dhe po krijohet një situatë si në Lushan.

— Ky është komplot, — thotë gjykatësi, dhe çështja u sqarua.

— Po kush ju shtyu ju t'ia thoshit Maos këto? — pyeti ai përsëri.

— Ne na shtyu Çian Çini, — u përgjigjën këta.

Me fjalë të tjera këta u zbrazën, megjithatë do të shohim çfarë do të thonë tjetër dhe si do të arsyetohet gjithë kjo ngjarje e zhvilluar prej kaq vitesh, me Mao Ce Dunin në krye.

Gjyqi është një parodi e vërtetë. Si është e mundur që personalitete të tilla, që kanë luajtur një rol të madh në Revolucionin Kulturor, të mos kenë pasur qëllime politike dhe të mos jenë frymëzuar nga disa parime të caktuara në veprimet e tyre?! Vetëm në një gjyq kinez, organizuar nga një klikë pa parime mund të ndodhë një gjë e tillë. Në fakt, ky është një problem i madh, politik dhe ideologjik, për të cilin sa kam mundur të gjykoja e si kam gjykuar, kam shkruar në Ditarin tim.

Shumica e mendimeve të mia vërtetohen, por, ashtu si po zhvillohen ngjarjet në Kinë, është e zorshme të arrish të vërtetosh e të krahasosh konkluzionet që kam nxjerrë, pse, çështjet sa kohë që kalon dhe nga mënyra si shtjellohen, bëhen akoma më të errëta, më të pakuptueshme. Dhe është e natyrshme të bëhen më të errëta, mbasi grupi udhëheqës që ka ardhur në krye të Kinës, është pikërisht një grup puçist kapitalist, që kërkon të marrë revanshin kundër kundërshtarëve të mëparshëm të tij, të vendosë një regjim kapitalist sipas dëshirave të veta dhe ta fshehtë këtë politikë, nën maskën e një pseudoregjimi socialist dhe pushtetin ushtarako-fashist ta quajë diktaturë të proletariatit.

Është për këto arsye që as në këtë gjyq, as në fjalimet e udhëheqësve revizionistë kinezë, duke filluar që nga Ten Hsiao Pini, Hua Kuo Feni e të tjerë, nuk përcaktohet qartë vija e tyre politike dhe ideologjike. Kjo jo vetëm se është në natyrën e kinezit të jetë konfuz në mendime dhe në veprime, por edhe pse njerëzit që kanë drejtuar e vazhdojnë të drejtojnë Kinën, kanë pikëpamje idealiste konfuciane me më pak parime se idetë e Konfucit.

Ku po shkon tani Kina? Jam i bindur se këta që janë sot në fuqi, as vetë nuk dinë ku po shkojnë. Ata nuk kanë përcaktuar akoma rrugën dhe mënyrën e ecjes së tyre. Qëllimi aktual i njerëzve që sundojnë në këtë vend, është ai i mëparshmi, domethënë në radhë të parë të mbajnë në duar fuqinë që morën, domethënë një grup të dominojë mbi të tjerët. Aktualisht është grupi i Ten Hsiao Pinit ai që bën të gjitha përpjekjet të marrë në duar të gjitha kyçet e vendit. Këtu qëndron objektivi kryesor i këtij grupi dhe jo si të zhvillohet, me ç'politikë të zhvillohet, me ç'forma të zhvillohet Kina. Çdo gjë si më parë, edhe tani, atje ecën në mënyrë të çoroditur.

Është e vërtetë se njerëzit e grupit të Ten Hsiao Pinit, që janë pasardhësit e grupit të Çu En Lait, kanë

deklaruar se orientimi politik-ekonomik i Kinës janë «katër modernizimet». Këto «katër modernizime» janë katër formula që njeriu mendon se kanë njëfarë përmbajtjeje, por kjo është diçka e mjegullt, që vërtet synon ndërtimin e njëfarë ekonomie dhe forcimin e pushtetit ushtarak etj., por qëllimi i tyre kryesor është që ta bëjnë Kinën një vend kapitalist.

Po çfarë vendi kapitalist, në ç'mënyrë do të ecë Kina në rrugën kapitaliste? Pikërisht këtu qëndron ajo që thashë më parë që vetë kinezët nuk e dinë. Ata nuk e kanë përcaktuar këtë rrugë, ecin në mjegull, duke huazuar sa nga njëri nga tjetri. Por në thelb qëllimi i organizimit dhe vetë organizimi shtetëror i sundimtarëve të tanishëm të Pekinit, mbetet organizimi arkajk i perandorive të vjetra të Kinës, natyrisht me forma të reja. Mbeten po ashtu objektivat e perandorive të vjetra kineze në struktura pak a shumë të reja, të cilat çojnë vetëm në vendosjen e një dinastie të re të veshur me petka gjoja moderne, por me qëllime e politikë të vjetër. Atje ekzistojnë grupe të atilla të fuqishme perandorake, si me thënë, që luftojnë njëri me tjetrin në mënyrë të paparimë, që përpiqen kush e kush të marrë fuqinë në dorë dhe të imponojë pikëpamjet e tij që nuk janë emancipacioni i dëshirave, i qëllimeve dhe i aspiratave të popullit. Përkundrazi, ato janë aspiratat e një grupi që merr fuqinë dhe që kërkon ta ruajë këtë fuqi me forma, me metoda dhe me një politikë të tij, që ka, pra, për qëllim të ruajë pushtetin që ka vendosur. Çështja qëndron pikërisht te marrja dhe te ruajtja e pushtetit. Kjo është kryesorja, pastaj këtë pushtet ta përdorë për qëllimet e «perandorit» dhe të «oborrtarëve» të tij, të cilët nuk kanë më emrin as të perandorit, as të oborrtarëve, por atë të kryetarit të partisë, të kryeministrit, të ministrave e emërtime të tjera moderne.

Kur thellohesh në situatën e Kinës, në zhvillimin e

saj, në institucionet dhe në politikën që ka ndjekur ajo pas çlirimit, del në pah se në këtë vend revolucion i demokratiko-borgjez nuk ka ndjekur rrugën e revolucioneve demokratiko-borgjeze që janë zhvilluar në vendet e tjera. Kjo lëvizje ose ky revolucion ka mbetur në strukturën dhe sidomos në shpirtin e në politikën e Perandorisë së Mesit. Me fjalë të tjera, jo vetëm mbeturinat e pushtetit të vjetër perandorak, por edhe idetë e tij as janë zhdukur, as nuk janë zhvilluar në ato forma dhe me atë intensitet që kërkon një revolucion demokratiko-borgjez.

Kam shkruar për Sun Jat Senin, por, po ta analizojmë një çikë më mirë situatën e historisë së Kinës të fundit të shekullit të 19-të dhe të fillimit të shekullit të 20-të, mund të dalim në konkluzionin se ai kishte filluar rrugën drejt një revolucion demokratiko-borgjez, i cili mbeti në mes të rrugës. E ashtuquajtura Parti Komuniste e Kinës, që u formua, që kur ishte gjallë Sun Jat Seni dhe që u forcua më vonë gjatë gjithë kohës së luftës, nuk e gjeti rrugën e vërtetë të një zhvillimi me etapa e të shkëputjes nga pikëpamjet perandorake të së kaluarës dhe formave të saj në mos tipike, të deformatuara. Megjithatë ajo krijoi më vonë një pushtet që mori disa forma shumë më të avancuara, bile mund të themi disa forma të një shteti socialist, që ishin në realitet vetëm forma, sepse brendia e tyre mbeti në botëkuptimet borgjeze të pleksura me pikëpamjet e «zotërve të tokave», të «zotërve të luftës» dhe të kompradorëve. Një gjë të tillë e quajten në Kinë revolucion popullor, më vonë bile edhe revolucion proletar, por që, në fakt, nuk ishte i tillë.

Pas çlirimit, natyrisht, në qoftë se Partia Komuniste do ta kishte të qartë programin e saj, minimal dhe maksimal, aktualisht nuk do të ndodhej në këto situata që karakterizova. Në Kinë e luftës nacionalçlirimtare dhe të periudhës pas çlirimit e më vonë ka ekzistuar një kaos

në politikë, në ideologji e në organizim. Ky kaos nuk lejoi që Kina të kanalizohet e të futej në binarë, qoftë edhe të një revolucioni të thellë demokratiko-borgjez.

Po të marrim të studiojmë në hollësi Revolucionin Demokratiko-Borgjez të Francës, do të shohim se në këtë revolucion kanë ekzistuar parti të ndryshme, që kishin qëllimet e programet e veta dhe që luftuan kundër njëra-tjetrës për të vënë cilado prej tyre në jetë pikëpamjet politike dhe format organizative që kishte përcaktuar ose që do të zhvilloheshin e do të marrin forma të reja. Në pragun e Revolucionit Demokratiko-Borgjez të Francës shohim se ekzistonin grupe ose fraksione politike që u quajtën parti të ndryshme, siç ishin ato që donin t'i hiqnin mbretit pushtetin absolut, por që ishin në fakt për ruajtjen e privilegjeve të aristokracisë. Pikërisht ishte ky grup mjaft i fuqishëm që e filloi Revolucionin Demokratiko-Borgjez. Pra ishte vetë aristokracia ajo që e filloi këtë revolucion për të kufizuar të drejtat absolute të monarkut të vendosur që në kohën e Luigjit të 13-të nga Rishëliëja dhe Mazarini dhe atij të 14-të, por njëkohësisht për të ruajtur privilegjet e saj. Dhe, që t'ia arrinte këtij qëllimi, aristokracia franceze e mbështeti thirrjen e asamblesë së përgjithshme që të merreshin vendime të tilla. Por më 4 gusht u fshinë të gjitha privilegjet e aristokracisë dhe të priftërinjve madhorë. Kështu që në gjirin e vetë partizanëve të monarkisë u dukën ndarje të përcaktuara mirë. Krahas aristokratëve kishte grupe të cilat donin që mbreti të mbante ato pozita që kishte më parë, ekzistonin monarkistët që kërkonin një mbretëri konstitucionale, ekzistonin, gjithashtu, edhe disa grupe të tjera dhe revolucioni pati kështu një zhvillim të mëtejshëm. Pra vetëm në gjirin e ruajalistëve u krijua partia që mbështeste Tuilerinë, ajo që mbështeste princët në emigracion në Goblencë, ajo që kishte në krye dukën e Bretenilit, të tjerët mbështetnin kundërrevolucionin, gru-

pin e kontit Dantreg. Të gjitha këto grupe kishin qëllime të caktuara, për të ruajtur monarkinë. Ato kishin po ashtu edhe një politikë të jashtme të caktuar, një pjesë e tyre mbështetej në Vjenë, një pjesë tjetër te mbreti i Prusisë, disa te mbreti i Suedisë dhe më në fund një pjesë mbështetej te mbreti i Spanjës. Këto ishin grupet, si me thënë, mbretërore që kishin objektiva të caktuar, siç thashë më lart.

Nga ana tjetër, ekzistonin partitë më të avancuara të borgjezisë, të aristokracisë së robës, siç i thoshin, por që kishin origjinë borgjeze, dhe të borgjezisë revolucionare. Të tërë këta ishin grupuar në parti, të cilat luajtën një rol të madh në Revolucionin Demokratiko-Borgjez të Francës dhe zhvilluan një luftë të ashpër klasash, një luftë të madhe intrigash e organizimi, që kishin politika të ndryshme dhe bënë aleanca të ndryshme në mes tyre për të arritur qëllimet që kishin. Në mes këtyre partive ato që kanë luajtur një rol të madh dhe që janë dalluar në këtë revolucion janë Fëjantët, partizanët e monarkisë konstitucionale, La Fajeti, Petioni, duka i Orleanit, janë Zhironidët, njerëzit e Maresë, të Montanjës, jakobinët me Robespierin e me klubet e tyre, Dantonistët e të tjerë e të tjerë, derisa Revolucioni Demokratiko-Borgjez kaloi në faza të ndryshme dhe arriti në direktoriat dhe në Perandorinë e parë të Napoleon Bonapartit e kështu me radhë.

Pra, në qoftë se mund të gjejmë disa nuanca të përafërta të revolucionit demokratiko-borgjez kinez me atë të Francës, ne nuk e shohim qartë evolucionin e këtij «revolucioni». Është e vërtetë se me çlirimin e Kinës u tha se u vendos «demokracia e re», se u vendosën të drejtat e njeriut, u zhdukën pamjet dhe pikëpamjet e Perandorisë së Mesit, u zhdukën mbretërit e luftës, u zhdukën feudalizmi, kompradorët etj. Të gjitha këto u thanë dhe si forca vepruese nuk paraqiteshin me atë akuitet në

skënë, por në brendi ato vepronin dhe krijonin një kaos të madh në politikë, në organizim, në ideologji. E ashtuquajtura Parti Komuniste e Kinës, Komiteti i saj Qendror, me Mao Ce Dunin në krye, nuk arritën, ose nuk deshën që revolucioni demokratiko-borgjez, etapa e parë tranzitore e revolucionit proletar, të zhvillohej në mënyrë konsekuente.

Format organizative të «demokracisë së re» të pasqirimit në Kinë nuk i përgjigjeshin realitetit objektiv të ndarjes të këtij gati kontinenti me popullsi e zakone të ndryshme, me gjuhë të ndryshme, me një prapambetje të madhe kulturore, ekonomike dhe politike. Gjatë gjithë periudhës pas çlirimit në Kinë nga ana e partisë dhe e udhëheqjes së saj nuk shohim një përpjekje për të ndjekur një politikë të qartë ekonomike, ushtarake dhe administrative. Natyrisht, flitej atje për një zhvillim të ri, për një «demokraci të re», për një organizim të ri, për një përparim kulturor, për një ekonomi të re, por në të gjitha planet mbizotëronin formula dhe parulla, të cilat përvetësoheshin nga masat në ato forma dhe me ato qëllime të traditës së vjetër imperiale.

Populli kinez luftoi po me ato forma dhe gjatë luftës tek ai nuk u kristalizuan si duhet orientimet e mëdha politike, ideologjike dhe ekonomike. Idetë e reja që udhëhiqnin luftën kundër okupatorëve dhe Çan Kai Shisë nuk e kishin atë qartësi që duhej dhe që kishte krijuar vetë lufta e popullit kundër armikut të jashtëm dhe atij të brendshëm.

Për një kohë të gjatë armiku i brendshëm u konfondua, u zhvilluan edhe aleanca që duhej të zhvilloheshin, po nuk u ruajt personaliteti i partisë dhe, kur flasim për këtë personalitet, nuk kam parasysh personalitetin e udhëheqjes së saj, por personalitetin e ideologjisë së partisë, të parimeve politike, ideologjike dhe organizative të saj. Këto nuk u ruajtën, se nuk ekzistonin të përcaktuara si

duhet dhe qartë. Ato nuk ishin përcaktuar, se nuk përcaktoheshin nga vetë udhëheqja e atëhershme, qoftë pse kjo nuk i donte parimet e vërteta të një partie komuniste, se nuk i kishte kuptuar ato parime, ose kishte adoptuar vetëm formën e jashtme të tyre, por në fakt kishte ruajtur të gjitha pikëpamjet e vjetra që zhvilloheshin në gjirin e Perandorisë së Mesit. Në këtë gjendje po të ishin përcaktuar qartë parimet e vërteta që udhëheqin një parti komuniste, natyrisht brenda radhëve të Partisë Komuniste të Kinës do të kishte fraksione, përpjekje bile edhe luftë civile, por në fund të fundit do të triumfonte revolucioni i vërtetë i udhëhequr nga parimet e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit.

Fraksione pati në Partinë Komuniste të Kinës, por ato nuk u luftuan në bazë të parimeve të shëndosha. Pa qenë parti të ndryshme, brenda në parti fraksionet u përngjitnin si me thënë atyre të kohës së Revolucionit Demokratiko-Borgjez në Francë, ishin të atilla që synonin të merrnin fuqinë dhe të vendosnin pushtetin e klanit që përfaqësonin. Kështu që, nën mbulesën e një demokracie të re, u krijuan klane të forta, që maskoheshin me emrin e komunizmit, të socializmit, të Partisë Komuniste të Kinës, por që në realitet asnjëra nuk u besonte parimeve të vërteta marksiste-leniniste.

Teoria e «lulëzimit të 100 luleve dhe e konkurrimit të 100 shkollave» ishte teoria e Mao Ce Dunit dhe e të gjitha grupeve të tjera rivale të tij që punonin dhe organizoheshin nën rrogos për të marrë pushtetin. Ajo ishte një realitet i rivaliteteve të maskuara me gjoja liberalizimin e shtetit të ri që po ndërtohej, ose më mirë me thënë të jepte përshtypjen se demokracia e re ishte një demokraci e vërtetë që u jepte liri fjale e mendimi të gjithë njerëzve dhe grupeve e partive pa përjashtim. Të gjithë mund të shfaqnin atje mendimet e tyre politike, mund të mbillnin farën e tyre kudo dhe kurdoherë, por

realiteti nuk qëndronte ashtu. Kjo krijonte idenë e një-rëzve gjoja të lirë që kanë të drejtën të shfaqin dhe të mbrojnë çdo pikëpamje, por klanet më të forta e përdorin, nga ana tjetër, këtë si një mashë për të forcuar pushtetin e tyre. Kur ky pushtet rrezikohej, atëherë kjo formulë binte dhe e zëvendësonin një sërë formulash të tjera, sloganesh politike, që dilnin nga një qendër, nga një kokë dhe kjo ishte koka e Mao Ce Dunit.

Mao Ce Duni ishte një ëndërrues, po njëkohësisht një perandor dhe despot në pikëpamjet e tij. Ai nuk kishte pikëpamje të qarta të një revolucionari demokrat-borgjez, të një «revolucionari» si aristokratët e Revolucionit Demokratiko-Borgjez të Francës, pa lëre të një revolucionari proletar. Pikëpamjet e tij ishin të pajisura me idetë e theksuara perandorake, konfuciane, mistike, të shartuara këto me ide të reja të zhvillimit botëror të papërtypura e të papranueshme, të paasimiluara prej tij. Këtej del konkluzioni se nga ky person i gjithëfuqishëm nuk u bënë përpjekje për të gjetur një vijë të përshtatshme politiko-organizativo-ekonomiko-ushtarake për Kinën e re, prandaj Mao Ce Duni e çoi vendin, siç thotë francezi, *à la dérive*, nga të frynte era, mjaft që ai të ishte në krye dhe që në fakt tërë kohën qëndroi në krye. Të gjithë duhej t'i bindeshin atij në forma gjoja të reja, moderne dhe të zbatonin idetë e tij «gjeniale», po që në realitet nuk çonin në ndërtimin e një Kine më moderne, më të përparuar, më të organizuar, më të kulturuar. Njerëzit që kishte ai rreth e rrotull vetes ishin ose kundërshtarë ose oborrtarë.

Mao Ce Duni, duke ndjekur qëllimin e tij kryesor që të dominonte me format dhe në mendimet që kishte krijuar në kokën e vet, lejonte oborrtarët t'i thurnin himne e ditirambe të panumërta. Po ashtu ai, deri në njëfarë kufiri, nuk i pengonte kundërshtarët e tij të vepronin, ndërsa, kur e kapërcenin këtë kufi, atëherë me ve-

prime perandorake ai merrte masa, masa ushtarake, gjyqësore, bënte demaskimin politik dhe ideologjik të kundërshtarëve, më në fund i dënonte ata edhe me pushkatim. E tillë ishte kjo farë demokracie në Kinë, që solli më në fund këtë kaos dhe s'kishte dalje tjetër. Në Kinë luftohej anarkia me anarki dhe kaosi me kaos.

Aktualisht regjimi i Ten Hsiao Pinit nuk është gjë tjetër veçse një kopje e regjimit të Mao Ce Dunit, por më i djathtë ose, më mirë të themi, një regjim fashist, mbasi pushteti i Mao Ce Dunit, sido që karakterizohej nga të gjitha ato që thashë më lart, prapëseprapë kishte një element demokratik. Kurse regjimi aktual jo.

«Banda e të katërve» që po gjykohet tani është banda e oborrtarëve të Mao Ce Dunit, te të cilët ai u mbështet për një kohë të gjatë për të zhvilluar në popull pikëpamjet e tij. Është Mao Ce Duni ai që urdhëroi rrëzimin dhe shkatërrimin e grupit të Liu Shao Çisë e të Ten Hsiao Pinit me shokë dhe këtë e bëri në kohën kur e pa se rrezikohej pushteti i tij, kur pa se hrushovianët nuk e mbështetën në aspiratat e tij hegjemoniste për të dominuar në botën komuniste dhe në botë në përgjithësi; Mao Ce Duni është ai që ngriti hunveibinët në Revolucionin Kulturor dhe në krye të këtij revolucioni, është e kuptueshme, u vunë njerëz besnikë të tij, elementë të rinj, se Maoja nuk mund të mbështetej më në brezin e vjetër, që ishte i hallakatur në mendime, në politikë dhe i hutuar nga një propagandë e çoroditur. Prandaj ai u mbështet, sikundër bëri, në rininë, e cila ishte pompuar me kultin e «timonierit të madh».

Në fakt, «banda e të katërve» përbëhej nga ata oborrtarë të «perandorit» që zbatuan direktivat e tij. Oborrtar i Maos ishte edhe Lin Biaoja, ishin edhe shefat e ushtrisë kineze, të cilët është fakt se morën pjesë aktive në Revolucionin Kulturor dhe mbështetën orientimet e Maos, sipas të cilit duhej «të shkatërroheshin shtabet», që do

të thotë grupi i kryesuar nga Liu-Teni. Në këtë mes Çu En Lai, person i grupit të Tenit, kryeministri «i mirë», pikërisht si Konfuci i perandorit, diti të manovronte dhe manovroi, në dukje duke e mbështetur Revolucionin Kulturor, por duke punuar me synimin që, pasi të kalonte vala e tij, të rimerrte pozitat e vërteta të një udhëheqësi dhe të nxirrte mbi ujë klanin e tij.

Kështu gjyqi i sotëm që po zhvillohet në mënyrë kaq qesharake, sikur të mos kishte ekzistuar asnjë lidhje në mes Maos dhe «bandës së të katërve», në mes kësaj bande dhe Hua Kuo Fenit, vërteton atë që kam thënë më lart, luftën për pushtet. Në fakt, «banda e të katërve» akuzohet se ka komplotuar në mënyrë të thjeshtë. Asnjë konsideratë politike, ekonomike, ideologjike nuk figuron në akuzat që i bëhen kësaj bande, ajo akuzohet në mënyrë të thjeshtë se ata që bënin pjesë në të, kanë vajtur te Mao Ce Duni dhe i kanë kallzuar se «Çu En Lai, Ten Hsiao Pini, Jeh Çien Jini dhe Li Hsien Nieni mblidheshin çdo natë në spital për të organizuar marrjen e pushtetit». Grupi i Tenit vetëm këtë përpiqet të vërë në dukje pa asnjë konsideratë politike, duke përjashtuar nga ky «komplot» Mao Ce Dunin dhe Hua Kuo Fenin. Duhet të jesh naiv që të mos mendosh se Çu En Lai në spitalin ku dergjej nuk komplotonte (të përdor edhe unë termin e tyre — komplot) me Ten Hsiao Pinin, Jeh Çien Jinin dhe Li Hsien Nienin për të marrë pushtetin pas vdekjes si domos të Çu En Lait, vdekje që ishte e sigurt, që edhe ai vetë e dinte se do të mbaronte nga kanceri. Pra grupi i Tenit dhe i Çusë komplotonte nga njëra anë, kurse «banda e të katërve» nga ana tjetër. Ai grup që fitoi çoi përpara gjyqit grupin tjetër.

Por nga vetë gjyqi del se «banda e të katërve» nuk ka bërë përveçse «veprime logjike». Brenda formave «banda» e kishte për detyrë t'i drejtohej Mao Ce Dunit atje ku ndodhej për pushime dhe t'i shfaqte mendimin e

vet se ç'po ngjiste në spitalin e Pekinit. Kjo është e vetmja akuzë «e rëndë» që ngrihet kundër «bandës së të katërve». Të tjerat, siç janë vrasja e qindra mijë njerëzve, janë sfumatura, që nuk e thonë haptazi, por që me to autorët e akuzave duan të thonë se Revolucioni i madh Kulturor, i udhëhequr nga Mao Ce Duni, shkaktoi viktima. Por, për të mos e thënë këtë, për të forcuar dozën e këtij farë komploti të të katërve, i shtojnë edhe këto krime, të cilat nuk i vënë në evidencë të madhe, po vënë në dukje vetëm atë që këta kanë komplotuar kundër Çu En Lait dhe Ten Hsiao Pinit, pra, që nuk kanë lejuar të vinte në krye një klan i ri, të ngrihej një perandori e re, por të mbetej në fuqi perandoria e Mao Ce Dunit dhe e oborrtarëve të tij. Kjo u përngjet si dy pika uji klaneve ose partive të aristokracisë, të ruajalistëve, të monarkistëve gjatë Revolucionit Demokratiko-Borgjez të Francës. Në Kinë ishte lufta e klaneve të mandarinëve.

Pas vdekjes së Çu En Lait, Ten Hsiao Pini dhe grupi i tij ishte i sigurt se do t'ia zinte atij vendin, por kjo nuk ngjau. Pse nuk ngjau? Se nuk kishte dashur Mao Ce Duni që Teni të zinte vendin e Çusë, domethënë të bëhej kryeministër e kryetar partie. Kjo lë të kuptohet që komploti i Çusë dhe i Tenit, tok me Jeh Çien Jinin nuk pati sukses dhe arsytet e këtij mossuksesit duhen kërkuar te Maoja dhe te pikëpamjet e tij që kanë qenë kurdoherë konfuze, që vendoste ata që donte dhe në atë që Maoja nuk dëshironte të kishte në krah të tij një element ambicioz që e kishte provuar me kohë në qëllimet dhe në veprimet e tij, gjatë gjithë kohës kur Teni ishte bashkëpunëtor i ngushtë i Liu Shao Çisë.

Sigurisht Mao Ce Duni ka marrë po ashtu mendimet e pjesës më të madhe të byrosë politike, në qoftë se mund të themi se ka ekzistuar tek ai një fije ideje për konsultime dhe nëse ekzistonte në parti një byro politike në format dhe në idenë që i kuptojmë ne, marksistë-leninis-

tët, që nuk e dëshironte ardhjen e Tenit në postin e kryeministrit. Është, pra, Mao Ce Duni ai që nuk e lejoi Tenin të zinte vendin e Çu En Lait, por emëroi, e theksoj, emëroi Hua Kuo Fenin në këtë post dhe i tha këtij se «tani që je ti në krye të partisë dhe të pushtetit, jam i qetë». Kjo ka qenë në praktikën dhe në mënyrën e drejtimit të Mao Ce Dunit që nuk pyeste kurrë si për gjërat e vogla, ashtu edhe për gjërat e mëdha. Pra «komplotin», në qoftë se kishte komplot, e organizoi Maoja, dhe ai duhet gjykuar në radhë të parë. Po të bëhet kështu, atëherë, duhen vënë në dukje mendimet e Maos dhe të Tenit. Por këtë s'e do oportuniteti politik aktual në Kinë.

Pra faktet historike tregojnë se kryesori i komplotit, në qoftë se ekziston një komplot, nuk janë as «banda e të katërve», as banda e Lin Biaos, por është vetë Mao Ce Duni, i cili vepronte sipas mendjes, dëshirës dhe aspiratave të tij. Është ai që e hodhi matanë Ten Hsiao Pinin dhe vuri në krye Hua Kuo Fenin. Ky pati mbëshetjen e Mao Ce Dunit dhe të «bandës së të katërve».

Ten Hsiao Pini, natyrisht, pati deziluzione të mëdha dhe me grupin e tij organizoi rezistencën nën hundën e Maos, të Hua Kuo Fenit e të «bandës së të katërve», i nxori njerëzit në Tien An Men dhe, siç dihet, kundër tij u morën masa.

Pas vdekjes së Maos, Ten Hsiao Pini u lidh me aleancë me Hua Kuo Fenin dhe së toku përgatitën një komplot që rezultoi në arrestimin e menjëhershëm të «bandës së të katërve» dhe të zhvillimit të situatave të mëvonshme në Kinë. Vetë gjyqi që po zhvillohet aktualisht kundër «bandës së të katërve» vërteton katërcipërisht këto mendime që Teni me Çunë kanë komplotuar për të marrë pushtetin pas vdekjes së Çusë, për ta ruajtur këtë pushtet po kështu edhe pas vdekjes së Maos. Ai vërteton, gjithashtu, se ata kërkonin të merrnin masa

që të likuidonin kundërshtarët e tyre, domethënë pasuesit e Maos dhe vetë këtë «si ideolog, mendimtar dhe udhëheqës» dhe të ngrinin në pushtet klanin e Ten Hsiao Pinit, domethënë gjithë borgjezinë e madhe kompradore, latifondistët, industrialistët fashistë. Më vonë me siguri do të bëhet edhe gjyqi i Hua Kuo Fenit ose i Ten Hsiao Pinit. Kjo varet nga ajo se cili klan do të fitojë.

Të çudit mendimi kaq përbuzës i kësaj klike të re fashiste perandorake kur në gjyqin politik, siç është ky që po bën, nuk nxjerr në dukje pikëpamjet politike, ideologjike, ekonomike dhe ushtarake të grupit të rrëzuar, me të cilat të vërtetojë se ky grup, që po gjykohet tani, ka pasur një politikë të tillë që bie në kundërshtim me politikën «e vërtetë» të udhëheqjes aktuale të Kinës. Pra, të ekspozohet njëkohësisht edhe politika aktuale e Kinës që populli të shohë mirë se cila ka qenë politika e Mao Ce Dunit, e «bandës së të katërve» dhe cila është politika e bandës së Ten Hsiao Pinit dhe e Hua Kuo Fenit. Kjo gjë nuk bëhet. Po pse nuk bëhet? Për arsye se dalin në shesh gjithë kalbëzimi politiko-ideologjiko-ekonomik dhe aspiratat për hegjemoni botërore të Perandorisë së re të Mesit, me perandor Mao Ce Dunin, me perandor Liu Shao Çinë, Ten Hsiao Pinin, Lin Biaon, Çu En Lain e gjithë të tjerët me radhë. Domethënë kush e ka fuqinë, kush e pati fuqinë, ose kush do ta marrë fuqinë në të ardhmen.

Kjo nuk duhet të dalë dhe nuk e nxjerrin, prandaj ky gjyq, në vend që të demaskojë «katërshen», demaskon vetë grupin e Tenit. Por ky grup është i atillë që s'ka asnjë konsideratë, as më të voglin respekt për popullin kinez dhe për opinionin publik botëror. Ai mendon vetëm të bëjë punën e tij, të vendosë pushtetin e tij, ta forcojë këtë pushtet, të likuidojë kundërshtarët e vet politikë dhe ta çojë Kinën në rrugën e hegjemonizmit botëror, të një kapitalizmi special, të cilit, mendoj,

nuk i duket akoma ai evolucion që do të marrë me kohë.

Politika e jashtme e Kinës nuk mund të bëjë përjashtime nga anarkia dhe çoroditja, nga konfuzioni në të cilin ka qenë edhe në kohën e Mao Ce Dunit, dhe në kohën e Perandorisë së Mesit. Duket sikur grupi i Tenit është proamerikan dhe në fakt ai e kërkon mbështetjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Bile me pikëpamjet e një fashisti si Hitleri, ai ka pretendime të tilla që Uashingtoni ta ndihmojë Kinën deri atje sa mund të vijë koha që të bëhet e rrezikshme për vetë Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në politikën reaksionare dhe proamerikane të Ten Hsiao Pinit vepron dinakëria kineze. Këtë dinakëri e pabesi borgjeze, ai e mbështjell në fjalën e dhënë dhe në aleanca.

Kina në politikën e saj të jashtme, nuk ka parime, nuk ka suplesën e një vendi kapitalist bile as të një vendi kapitalist të pazhvilluar, por ka aspirata të mëdha për hegjemonizëm. Te Kina aktuale kapitaliste nuk shikon drejtime, pak a shumë stabël, në gjetjen dhe në vendosjen e aleancave me shtetet imperialiste dhe kapitaliste. Ajo është kudo, pa qenë gjëkund, kërkon të dominojë gjithë këtë botë me pesë para në xhep, kërkon ndihma nga të tjerët, por edhe të tjerët dëshirojnë ta kenë atë ashtu siç e kishin në kohën e perandorëve të Mesit, me fjalë të tjera, një koloni që ta zhveshin dhe politika e saj të drejtohet prej tyre. Prandaj këtu ka një rivalitet të madh midis shteteve imperialiste të organizuara e të fuqishme politikisht, ekonomikisht dhe ushtarakisht me një shtet tjetër borgjez kapitalist të prapambetur, të pafornuar, me një ekonomi të dobët, me një ushtri të dobët, siç është Kina, por që ka aspirata «kolosale» për hegjemonizëm botëror.

Ne shohim tani që shtetet imperialiste dhe bota kapitaliste, në përgjithësi, nuk janë aq entuziaste për regjimin aktual të drejtuar nga grupi i Ten Hsiao Pinit, se

nuk shohin që të realizohen ato ëndrra ekstravagante të muajve të parë ose të vitit të parë të ardhjes së tij në fuqi. Përkundrazi, shohim një indiferentizëm relativ, një mosbesim të kujdesshëm nga ana e fuqive imperialiste ndaj Kinës, se edhe sloganet e lëshuara nga Ten Hsiao Pini ishin monstruoze. Politikës borgjezo-kapitaliste dhe imperialiste nuk i leverdiste të afishohej me një partner të tillë, të çakërdisur në politikë dhe të varfër në ekonomi e ushtri, të etshëm për të marrë dhe për të mos u dhënë gjë atyre. Kjo nuk lejohet në ligjet e kapitalizmit. Por megalomania kineze, anarkia dhe kaosi në mendjen e udhëheqësve kinezë, që është si një fill i bardhë që i përshkon, nuk i lejon ata të stabilizojnë një gjendje, si me thënë, të përshtatshme për ta dhe kjo me siguri do ta futë Kinën në aventura të reja, të jashtme dhe të brendshme.

Aventurat e brendshme nuk kanë mbaruar dhe nuk mund të mbarojnë në Kinë: Ose edhe grupi i Hua Kuo Fenit do të dalë në gjyq dhe do të akuzohet për rrëzimin e Tenit, për bashkëpunim me «bandën e të katërve», ose do të mëkëmbet dhe do t'i bëjë varrin klanit të Tenit. Pra do të kalojë një kohë mjaft e gjatë, them mjaft e gjatë, në rast se gjithë këto pësime nuk bëhen mësim, për arsye se grupet e fuqishme që ekzistojnë në Kinë dhe që mbulohen me demagogji dhe me formula, do të luftojnë njëri-tjetrin në kaos.

Hua Kuo Fenit dhe Mao Ce Dunit, siç po duket, do t'u bëhet gjyqi në njëfarë mbledhjeje të kongresit të Partisë Komuniste të Kinës, gjoja në forumin e lartë të partisë, i përbërë krejtësisht nga elementët fashisto-borgjezë të grupit të Tenit, ku do të demaskohen Mao Ce Duni njëkohësisht edhe Hua Kuo Feni. Mao Ce Dunit do t'i mbetet vetëm emri, do t'i mbetet vetëm ndonjë formulim sa për të gënjyer masat e popullit, kurse Hua Kuo Feni do të gjejë vendin e tij. E gjithë

kjo do të ngjasë, mendoj unë, në rast se gjatë kësaj kohe nuk do të ndodhë diçka tjetër që t'i vërë dru në rrota Ten Hsiao Pinit. Por, në këto situata dhe në këtë gjendje në të cilën ndodhet populli kinez, kjo, hëpërhë, do të jetë e zorshme. Kjo jo se populli kinez nuk i kupton këto manovrime të poshtra që po bëhen në kurrizin e tij, por a do të jetë në gjendje të organizojë një rezistencë të vërtetë me një ideologji të vërtetë revolucionare për të luftuar anarkinë, kaosin në politikë, në ideologji dhe në organizim? Do të jetë ai në gjendje të vërë në krye çështjet politike, çështjet ideologjike të frymëzuara nga marksizëm-leninizmi dhe kjo të mbështetet nga klasa punëtore dhe nga levat e një partie të vërtetë marksiste-leniniste në mes të të cilave edhe ushtria?

Në qoftë se populli, proletariati, komunistët e vërtetë kinezë arrijnë të bëjnë që të ndryshojë botëkuptimi aktual i klaneve, i «zotërve të luftës» në ushtri, atëherë do të ketë sukses një revolucion i vërtetë demokratiko-borgjez e më vonë edhe proletar. Vetëm me një parti komuniste marksiste-leniniste të vërtetë në krye, mund të organizohet dhe të fitojë revolucionin proletar në Kinë.

NËNTOR 1980

## NGJARJET NË POLONI DHE PASOJAT E TYRE TË BRENDSHME E TË JASHTME

Gjendja në Poloni po vështirësohet dita me ditë. Organizatat sindikale reaksionare janë bërë një element me rëndësi ekonomiko-politik dhe vazhdimisht ato po fitojnë terren mbi pushtetin pseudosocialist polak. Pushteti aktual në Poloni vetëm emrin ka si pushtet i një vendi socialist ose si diktaturë e proletariatit. Në të vërtetë ai është një pushtet borgjez, kapitalist në esencë, pavarësisht nga format dhe emërtimet që përdor.

Partia polake, e cila e quan veten komuniste, është një parti borgjeze, me strukturë të atillë që mbështet tekat e një klike të tërë burokratësh të rinj kapitalistë që bashkëpunojnë me kapitalistët e vjetër, veçanërisht me ata të fshatit, si edhe me kishën e fuqishme katolike të Polonisë.

Kisha katolike polake, «bija e madhe e Vatikanit», ka ruajtur dhe ka shumëfishuar aq shumë forcën e saj «bindëse» dhe pushtetin shpirtëror, sa që ka influencuar vazhdimisht, këto kohët e fundit akoma më shumë në pushtetin laik. Kisha katolike romane e Polonisë ka pasur vazhdimisht mbështetjen e autoriteteve pseudokomuniste polake. Ajo i ka pasë të hapura rregullisht jo vetëm famullitë, katedralet e kishat, por ka fituar, gjithashtu, të drejtën të zhvillojë katekizmin në shkolla dhe predikimin në ushtri. Tani kisha katolike polake është frymëzuesja kryesore e «sindikave të lira — Solidarnost», të

cilat po veprojnë haptazi për të transformuar pushtetin kapitalisto-revizionist që ekziston në Poloni dhe për të ndërtuar një pushtet kapitalist pa asnjë maskë.

Situata që është krijuar i ka nxjerrë telashe borgjezisë së re polake për arsye se po lëkunden pozitat e saj të fituara nën maskën e një shteti socialist. Po vihen në pikëpyetje privilegjet e stabilizuara gjatë disa dekadave, të cilat do të ndahen me njerëz të tjerë më të vendosur, më të organizuar e më të lidhur me reaksionin e jashtëm kapitalist. Me fjalë të tjera një borgjezi tjetër e re kërkon një *modus vivendi* të ri, në një formë më të theksuar kapitaliste, për të ndjekur një politikë të brendshme dhe të jashtme të lirë nga çdo varësi e revizionistëve sovjetikë dhe e së ashtuquajturës bashkësi socialiste.

E keqja më e madhe, në situatën e krijuar, bie mbi popullin polak, i cili, si një popull trim, nuk mundi të gjente dot rrugën e vërtetë të ndërtimit socialist dhe të vendoste diktaturën e proletariatit. Klasa punëtore në Poloni nuk u udhëhoq nga teoria marksiste-leniniste e nuk u edukua me këtë teori. Ajo nuk zhvilloi një veprimtari revolucionare këmbëngulëse si gjatë luftës, ashtu edhe pas çlirimit për të vendosur norma të vërteta demokratike në jetën e vendit. Këtë ajo nuk mund ta bënte duke pasur në udhëheqje të ashtuquajturën Parti Komuniste të Polonisë, që nuk ishte veçse shartimi i një sërë partish borgjeze demokratike me një parti komuniste, për të cilën ishte marrë vendim të likuidohej që në kohën e Kominternit, për arsye të devijimeve të theksuara nga marksizmi. Pra, proletariati polak nuk mundi të zhdukte mbeturinat e thella idealiste, fetare e mistike në popull. Jeta politike e Polonisë, edhe pas çlirimit vazhdoi me ndjenja të theksuara të një nacionalizmi të shfrenuar.

Internacionalizmi proletar në Poloni nuk kishte vend. Borgjezia vendase e kisha katolike ushqenin atje seriozisht dhe sistematikisht ndjenjat antisovjetike. Kështu

që aktualisht, pas grevave të Dancigut dhe pas «fitoreve» të njëpasnjëshme të arritura nga «sindikatat e lira — Solidarnosti», brenda në Poloni është krijuar një situatë shumë e vështirë dhe jo vetëm për autoritetet e vendit por edhe për Bashkimin Sovjetik dhe për vendet e tjera «të bashkësisë socialiste».

Siç kam thënë edhe në një shkrim tjetër, situata e krijuar tani në Poloni është vepër e menduar mirë nga reaksioni dhe nga feja. Për t'ia arritur kësaj situatë, që transformimet kapitaliste të bëheshin nën drejtimin e elementëve reaksionarë në gjirin e klasës punëtore, është punuar me kohë në rrugën antisocialiste. Veprimtaria antisocialiste në Poloni është e vjetër. Ajo është ushqyer nga brenda e nga jashtë dhe është ndihmuar nga vetë udhëheqja revizioniste e partisë polake si dhe nga transformimet regresive, kapitaliste e fashiste, të ndodhura në Bashkimin Sovjetik pas marrjes së fuqisë nga hrushovianët, po ashtu edhe nga gjithë politika hegjemoniste e Bashkimit Sovjetik mbi të ashtuquajturën bashkësi socialiste. Të tëra këto rrethana kanë ndikuar për të krijuar këtë situatë në Poloni.

Natyrisht për krijimin e kësaj situatë kanë ndihmuar fuqimisht edhe borgjezia kapitaliste e Evropës dhe e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, nëpërmjet financimit me kredi të Polonisë, ashtu si edhe të vendeve të tjera «të bashkësisë socialiste». Tash këto vende, me Bashkimin Sovjetik në krye, janë pleksur me shoqëri shumëkombëshe dhe nëpërmjet kredive kolosale që arrijnë deri në 80 miliardë dollarë, janë varur nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe nga vendet e zhvilluara kapitaliste evropiane.

Bashkimi Sovjetik kudo në vendet e ashtuquajtura socialiste të Lindjes ka shkaktuar një frymë mbytëse. Këtë e ka bërë me Traktatin e Varshavës, me repartet ushtarake që ka vendosur në të gjitha vendet e ashtu-

quajtura aleate të tij, me përdorimin e KNER-it në format që ka dashur vetë, për të lehtësuar shfrytëzimin ekonomik të «aleatëve», të cilëve u ka caktuar drejtimet e zhvillimit të njëanshëm të ekonomisë së tyre, nëpërmjet «ndarjes së punës» në industri, në bujqësi etj., si dhe me pikëpamjet politike të veçanta të diktuar nga Moskë për qëndrime të caktuara në favorin e hegjemonizmit sovjetik.

Pavarësisht nga pamja e jashtme dhe nga qëndrimet e udhëheqësve të këtyre vendeve, asnjë popull, asnjë parti bile asnjë udhëheqje, në këto vende nuk e do Bashkimin Sovjetik revizionist, shtypës dhe skllavërues. Të gjithë manovrojnë, veprojnë dhe kërkojnë të gjejnë vrima nga të cilat të mund të shpëtojnë. Sa mund të shpëtojnë nga kjo zgjedhë, është çështje tjetër. Polonia e gjeti një rrugë, të ndryshme nga ato që ndoqën Dubçeku, Nagi ose Kadari. Në kundërrevolucionin hungarez, reaksioni i jashtëm e hoqi maskën. Dubçeku mendoi se e gënjeu Moskën dhe filloi të bënte «reforma» gjoja në favor të socializmit, por, kur u mbush kupa, Moskë futi tanket në Çekosllovakë. Rruga e ndjekur nga Polonia, pra, ndryshon si nga forma, ashtu edhe nga përmbajtja. Këtu është klasa punëtore e manipuluar që ka dalë në skenë «për të kërkuar liri e pavarësi» nga Partia Komuniste e Polonisë, Partia Punëtore e Bashkuar e Polonisë.

Ç'mund të ngjasë në këtë situatë? Natyrisht kjo situatë që po zhvillohet në Poloni, Bashkimit Sovjetik nuk i pëlqen, ndërsa të tjerëve, «aleatëve» të tij, në dukje as atyre nuk u pëlqen, por në thelb mund t'u leverdisë për të lehtësuar barrën e sovjetikëve mbi ta. Veçse Bashkimi Sovjetik, në fakt, humbet perandorinë, kurse udhëheqjet revizioniste në vendet e «bashkësisë socialiste», humbasin privilegjet e fituara, ashtu siç i humbi Gierku. Në rast se infeksioni nga ngjarjet në Poloni do të jetë më i madh, ka mundësi të shkaktojë turbullira të

gjera dhe të pallogaritshme për klikat revizioniste në fuqi, në radhë të parë për sundimin e Bashkimit Sovjetik. Prandaj ky do të përpiqet të kufizojë ngjarjet në Poloni dhe, duke u përpjekur ta realizojë këtë gjë, do të luftojë për ta hedhur në erë situatën negative që është krijuar atje për të, duke përdorur agjenturën e vet. Sa do të arrijë agjentura sovjetike t'i vërë shkopinë në rrota kësaj karroce, që po ecën revan drejt kapitalizmit, kjo varet nga shtrirja e lëvizjes së të ashtuquajturave sindikata të lira, nga forca e tyre organizative dhe nga ndjenjat që do të ngjallë veprimtaria e tyre te populli polak.

Por mund të thuhet se udhëheqja revizioniste polake, sado prosovjetike që të hiqet, në vetvete është antisovjetike, antiruse dhe masat që mund të marrë imediatisht, ose për një kohë relativisht më të gjatë, nuk do të kenë efektin që shpreson Moskë. Kjo e fundit, nga ana e saj, në të njëjtën kohë, në kuadrin e Traktatit të Varshavës e të KNER-it do të përpiqet të bëjë presion mbi Poloninë nëpërmjet satelitëve të vet. Në fakt këtë punë ajo e ka filluar nëpërmjet Gjermanisë Lindore e Çekosllovakisë, kurse Hungaria flet pak, Bullgaria, gjithashtu, flet ca më pak, ndërsa Rumania nuk flet fare.

Pra, për të shuar atë që po ngjet në Poloni, në pararojë janë aktualisht Gjermania Lindore dhe Çekosllovakia. Në këtë çështje Moskë vazhdon taktikën e vjetër duke ngarkuar udhëheqësit e këtyre dy vendeve të shkruajnë sidomos artikuj kërcënues kundër elementëve reaksionarë në Poloni dhe i riboton këta në faqen e parë të «Pravdës». Por Kremli, natyrisht, nuk mbetet vetëm me ribotimin e artikujve të të tjerëve. Ai po merr edhe masa, akoma të padukshme, nën rrogëz, por të egra, kundër kësaj situatë që po bëhet e rrezikshme për të.

Megjithëkëtë tani për tani në Poloni nuk shohim të bëhet ndonjë ndryshim në favor të Moskës. Përkundrazi, udhëheqja polake u ka dhënë të drejtë sindikatave «Soli-

darnost», të veprojnë, bile të hedhin hapa përpara në rivendikime politike, të kërkojnë të spastrojnë partinë nga elementët «antisocialistë», «spekulatorë» etj. Udhëheqja aktuale e partisë dhe e shtetit polak u mban avazin këtyre rivendikimeve të «Solidarnost». Nën presionin e këtyre rivendikimeve për së shpejti ajo do të bëjë edhe një mbledhje të Komitetit Qendror të Partisë Punëtore të Bashkuar të Polonisë, ku do të merren vendime gjoja për të forcuar situatën e krijuar. Këto vendime nuk duket të jenë në disfavorin e situatës së krijuar. Pra, gjendja në Poloni nuk po ecën në favorin e Bashkimit Sovjetik.

Në rast se Bashkimi Sovjetik i shkreh të gjithë këta fishekë dhe prapë nuk ia arrin qëllimit që ka caktuar, atëherë i mbetet një rrugë tjetër, ajo e ndërhyrjes ushtarake, siç bëri në Hungari, në Çekoslovakia dhe vitin e kaluar në Afganistan.

Ndërhyrja me armë në Poloni nga Bashkimi Sovjetik, e bashkërenduar kjo me Çekoslovakinë dhe me Gjermaninë Lindore, do të shkaktojë për të gjithë kampin revizionist, me Bashkimin Sovjetik në krye, një turbullirë të jashtëzakonshme, një situatë shumë të ngarkuar me ngjarje të rënda për të. Po ngjau kjo, Bashkimi Sovjetik revizionist dhe vendet e tjera aleate të tij do të pësojnë humbje të mëdha politike, ekonomike dhe ushtarake, për arsye se populli dhe ushtria polake, mendojmë ne, nuk do të pranojnë një ndërhyrje të huaj, qoftë edhe me emrin e Traktatit të Varshavës, pa iu përgjigjur asaj me armë.

Karakterit i vetë proletariatit, i popullit dhe i ushtrisë polake, nuk është si ai i atyre të Çekoslovakisë, ku tanket sovjetike ndërhyjnë pa hasur në rezistencë. Në këtë rast, në mes Polonisë, nga njëra anë, dhe Bashkimit Sovjetik e vendeve të tjera të Traktatit të Varshavës, nga ana tjetër, do të ketë luftë, e cila nuk mund të ndalet lehtë,

shpejt dhe pa pasoja të rënda, jo vetëm për Poloninë, jo vetëm për vendet e tjera ish-socialiste, por dhe për vetë Bashkimin Sovjetik revizionist. Brenda në Bashkimin Sovjetik do të lindin probleme e situata që mendoj se do të jenë revolucionare. Popullit sovjetik do t'i hapen disi sytë. Ai do të shohë më mirë se udhëheqja aktuale e vendit është një udhëheqje kapitaliste, revizioniste, imperialiste dhe «aleancat» që predikon ajo me shtete dhe popuj të tjerë miq, nuk janë veçse hallka shtypjeje, skllavëruese dhe mjete dominimi nga ana e saj.

Nga ana tjetër, Bashkimi Sovjetik do të ketë një humbje të re të jashtëzakonshme politike në arenën ndërkombëtare. Kjo jo vetëm se aktualisht ai është demaskuar si një shtet agresiv imperialist, ashtu siç është, por duke ndërhyrë në Poloni, pra edhe në kurriz të «aleatëve» të tij, provon se mund të ngjasë ca më keq kundër popujve të tjerë.

Mendoj se hëpërhë ndërhyrja me armë e Bashkimit Sovjetik në Poloni nuk do të bëhet shkak për një luftë të re botërore, por kjo ndërhyrje do t'i acarojë situatat në një shkallë të tillë që do të sjellë me të vërtetë gjendjen në prag të një lufte të re botërore.

NATO-ja dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës do ta konsiderojnë patjetër ndërhyrjen e Bashkimit Sovjetik, ashtu siç është, një ndërhyrje agresive, që paralajmëron një sulm edhe kundër vendeve të tjera kapitaliste, duke kaluar mbi trupin e të gjithë disidentëve të hapët ose të fshehtë në vendet e të ashtuquajturave demokraci popullore, që aktualisht ndodhen nën thundrën sovjetike dhe konsiderohen si një *glacis* në luftën e ardhshme në mes dy blloqeve, të NATO-s dhe Traktatit të Varshavës.

Por, edhe nëse ndërhyrja e armatosur sovjetike në Poloni mund të mos shërbejë si një shkëndijë për luftën e madhe botërore, vendet e Evropës Perëndimore dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të mbajnë anën e

Polonisë. Kështu Bashkimi Sovjetik dhe vendet e tjera të ish-demokracisë popullore nuk do të kenë më atë ndihmë ekonomike, ato kredi të shumta prej miliarda dollarësh si ato që kanë marrë deri tani nga Perëndimi. Kjo do të bëjë që këto vende të hasin në vështirësi të jashtëzakonshme për zhvillimin e ekonomisë së vet, të tregtisë së jashtme. Do të krijohet në to një konfuzion ekonomik dhe një amulli e tmerrshme që do të frenojë zhvillimin e tyre, gjë që do të dobësojë gjendjen ekonomike të popujve të këtyre shteteve, do të shtojë zemërimin e tyre dhe do të kërcënojë udhëheqjet aktuale.

Kjo është diçka konkrete, që nuk do të kufizohet vetëm në fushën propagandistike, por do të shfaqet konkretisht në jetën e këtyre shteteve të Evropës dhe në botë.

Pra çështja e Polonisë në këto situata nuk do të mbetet një episod si në rastin e Çekosllovakisë, pavarësisht se edhe ai ishte i rrezikshëm dhe për të u bë shumë zhurmë. Por me kohë plaga çekosllovake u cikatrizua. Pas pushtimit të Çekosllovakisë, kanë kaluar shumë vjet, megjithëkëtë Perëndimi përsëri i vazhdoi ndihmat dhe infiltrimin e tij ekonomiko-politik për degjenerimin e vendeve anëtare të Traktatit të Varshavës dhe një nga fitoret e këtij infiltrimi është pikërisht Polonia. Prandaj ndërhyrja në Poloni do të shkaktojë një reaksion të madh nga ana e perëndimorëve dhe një dëm të madh për Bashkimin Sovjetik revizionist e për vendet e tjera revizioniste të Evropës Lindore.

Pra, marrja e një vendimi të tillë nga Bashkimi Sovjetik, kur ai ta shikojë se kupa u mbush dhe do të jetë përpara rrezikut që të humbasë dominimin e vet jo vetëm në Poloni, por rrjedhimisht edhe në vendet e tjera ish-socialiste ku ngjarjet në Poloni do të kenë reperi-kusione, do të jetë katastrofike për të. Prandaj mendoj se revizionistët sovjetikë dhe aleatët e tyre do të maten shumë për ta marrë këtë vendim, se nuk është i lehtë.

Ai është me konsekuenca të rënda për ta. Fundi i fundit kjo për perëndimorët është e leverdishme se Bashkimi Sovjetik, duke qenë në luftë me popullin afgan, duke u futur në luftë edhe me Poloninë, duke kërcënuar fërthorazi popujt e tjerë aleatë të tij, do të dobësohet, jo vetëm politikisht dhe ekonomikisht, ca më shumë nga sa është sot, por edhe ushtarakisht. Pavarësisht se ushtria sovjetike është e armatosur, duke u futur në luftë edhe me ish-aleatët e tij, me ata aleatë që janë propaganduar në popull si besnikë të Bashkimit Sovjetik, morali i saj do të bjerë shumë. Kjo do të bëjë që edhe mentaliteti i ushtarit sovjetik të ndryshojë, gjë që do të jetë një humbje për kampin revizionist dhe fitore për imperializmin amerikan dhe kapitalizmin e Evropës Perëndimore.

Nga ana tjetër, mund të themi se veprime të tilla agresive të sovjetikëve do të kenë po ashtu anën pozitive revolucionare në gjirin e popujve, ku po ndodhin këto ngjarje të tmerrshme invadimi dhe skllavërimi. Ndjenja revolucionare, aktualisht e topitur, do të ngrihet edhe në vetë Bashkimin Sovjetik, ku mund të ndodhin transformime jorrënjësore siç na i do zemra, por sidoqoftë mund të arrihet në disa ndryshime progresive që do të shkaktojë lufta imperialiste, e cila ua ngre lart ndërgjegjen revolucionarëve për ta kundërshtuar këtë luftë të padrejtë. Kjo do të jetë e keqja më e madhe për Bashkimin Sovjetik revizionist.

Në të njëjtën kohë duhet pasur parasysh se ndërhyrja me armë në Poloni nga ana e Moskës nuk mund të realizohet vetëm me Gjermaninë Lindore ose edhe me Çekosllovakinë. Në qoftë se do të ngjasë, kjo do të bëhet nën emrin dhe nën petkun e Traktatit të Varshavës, gjoja për të «mbrojtur socializmin» në Poloni, i cili rrezikohet nga elementët reaksionarë, të brendshëm dhe të jashtëm.

Mund të mendohet edhe një version tjetër. Revizionistët sovjetikë, po t'i shikojnë punët pisk, mund të bëjnë

lëshime, po në ç'drejtim dhe sa? Lëshimet mund të bëhen për shkak të zhvillimit të situatave në disfavorin e tyre, duke u dhënë ngjarjeve në Poloni ngjyrën e një transformimi gjoja të vetëdijshëm të klasës punëtore dhe të Partisë Komuniste Polake. Me fjalë të tjera, të lihet Polonia të zhvillohet politikisht dhe organizativisht në «një formë të re», gjoja socialiste vetadministruese dhe të qëndrojë në Traktatin e Varshavës; regjimi polak i zhvilluar në rrugën e «sindikave të lira» të marrë formën e një «regjimi socialist» si ai i Jugosllavisë ose që t'i përngjasë atij, brenda kuadrit të Traktatit të Varshavës dhe të KNER-it.

Në rast se një Poloni e tillë do t'i shtyjë marrëdhëniet e saj shtetërore, politike dhe ushtarake, jashtë kuadrit të Traktatit të Varshavës, atëherë Bashkimi Sovjetik do të ndërhyjë me armë. Por, në qoftë se Bashkimi Sovjetik do të pranojë të bëjë lëshime të tilla, atëherë kjo do të sjellë shpërthimin zinxhir të zhvillimeve të reja në të gjithë kampin revizionist të ashtuquajtur bashkësi socialiste. Kjo do të thotë se shembullin polak do ta ndjekin edhe klasa punëtore e Gjermanisë Lindore, ajo e Çekosllovakisë, e Hungarisë po e po, e Rumanisë, më në fund edhe e Bullgarisë. Atëherë do të krijohet një situatë krejt e ndryshme në marrëdhëniet në mes Bashkimit Sovjetik dhe aleatëve të tij. Në qoftë se ky transformim do të bëhet nga zori, në qoftë se do të bëhen lëshime të tilla për të zgjedhur rrugën më pak të keqe nga rruga më e rrezikshme, siç është ajo e ndërhyrjes së armatosur, ky transformim mund t'i afrohet strukturës organizative, politike dhe ushtarake të NATO-s dhe të Tregut të Përbashkët Evropian.

Pra, vendet e Traktatit të Varshavës, ashtu si vendet e NATO-s, do të ruajnë potencialin e tyre ushtarak brenda lidhjeve të Traktatit të Varshavës për të mbrojtur kufijtë e tyre dhe kufijtë e përbashkët kundër një in-

vadimi nga forcat e NATO-s. Në një situatë të tillë, në qoftë se do të krijohet, atëherë mund të ketë transformime edhe në pozicionet luftarake të ushtrive që aktualisht janë vendosur te njëri-tjetri, dhe sidomos të ushtrisë sovjetike jashtë kufijve të saj kombëtarë. Në rast se gjendja merr një evolucion të tillë, në strategjinë ushtarake të Traktatit të Varshavës dhe në NATO duhet të bëhen ndryshime të tilla dhe të merren vesh në mes tyre që të tërhiqen nga të dy këto blloqe si forcat ushtarake të Shteteve të Bashkuara të Amerikës ashtu edhe ato të Bashkimit Sovjetik. Me fjalë të tjera Bashkimi Sovjetik të tërheqë trupat që ka vendosur në vendet e aleatëve të tij, dhe ushtritë amerikane të largohen nga Belgjika, nga Gjermania Perëndimore, nga Italia dhe nga vendet e tjera anëtare të NATO-s.

Kjo, natyrisht, nuk bëhet as në një ditë, as në një vit, se është një çështje mjaft e ndërlikuar politike, në radhë të parë, po edhe nga ana strategjike, nga ana ushtarake, se, me largimin e ushtrive nga çdo vend, flasim të ushtrive të huaja që janë vendosur në vende të ndryshme, duhet të largohen ose të transferohen edhe bazat ushtarake që janë krijuar në këto vende, ose të mbeten në pronësi e nën komandën e shtetit pjesëtar të cilitdo kamp.

Në këtë situatë shtetet do t'i ruajnë aleancat ushtarake nga të dyja anët, do të ruajnë, gjithashtu, marrëdhëniet ekonomiko-tregtare që kanë vendosur njëri në KNER, tjetri në Tregun e Përbashkët Evropian.

Natyrisht, në qoftë se Bashkimi Sovjetik, në pamundësi të bëjë ndryshe, do të bëjë ndryshime të tilla, atëherë marrëdhëniet aktuale ekonomike duhet medoemos të ndryshojnë në disfavorin e tij dhe të marrin një formë të tillë organizative, ekonomike dhe politike ku do të shikohet më shumë interesi nacional sesa interesi i komunitetit. Kështu ngjet edhe në NATO, ku ka edhe

koordinime, po ka edhe kontradikta të mëdha midis shteteve pjesëmarrëse. Një gjë e tillë vetvetiu do të ngjasë edhe në KNER.

Por a do ta lejojë Bashkimi Sovjetik një situatë të tillë? Domethënë ka mundësi të realizohet një shthurje e tillë në dëm të revizionizmit sovjetik? Mua më duket se kjo nuk mund të ngjasë, se Bashkimi Sovjetik nuk do të lejojë që punët të shkojnë në këtë rrugë. Agresiviteti i tij, fryma e tij dominuese dhe imperialiste, nuk mund ta lejojë të zhvillohet një situatë e tillë. Ai do të preferojë ndërhyrjen ushtarake nën maskën e Traktatit të Varshavës.

Si konkluzion: aktualisht Bashkimi Sovjetik do të luftojë me dorën e polakëve, për të ndaluar shkëputjen dhe do të përdorë çdo presion të mundshëm dhe të imagjinueshëm. Fisheku i fundit do të jetë ndërhyrja me ushtri.

E ENJTE  
4 DHJETOR 1980

## VERSIONI MONGOL I BRËZIMIT TË AVIONIT KINEZ TË LIN BIAOS

Në Ditarin Politik kam dhënë versionin që jepnin kinezët për arratisjen dhe vrasjen e Lin Biaos në Mongoli me aeroplan. Këtë çështje edhe e kam komentuar.

Tani në Pekin po zhvillohet farsa gjyqësore kundër «katërshes» dhe kjo ngjarje po tirret nga prokurori në formë parodie të pabesueshme.

Çfarë ishte ai, version sovjetik apo mongol, ne nuk e kemi ditur, kemi lexuar vetëm një komunikim lakonik.

Këto ditë sekretari i parë i ambasadës mongole në Kinë i tha një diplomatit tonë në Pekin: «Largimi i Lin Biaos për në Mongoli dhe për në Bashkimin Sovjetik është i pabesueshëm. Siç dihet, atëherë një aeroplan kinez është rrëzuar në Mongoli. Ky aeroplan që u fut në mesnatë në territorin mongol, kaloi mbi një aeroport të madh 60 km larg kryeqytetit tonë, u diktua dhe u gjuajt nga ana jonë, por u rrëzua në një distancë prej 10 km nga kufiri kinez. Kështu, pra, aeroplani kishte mundësi të ulej në këtë aeroport. Me të rënë aeroplani ekspertët tanë shkuan dhe e panë. Gjetën nëntë kufoma 80-90 për qind të djegur dhe nuk mund të dallohej njeri. Midis tyre dukej të ishte një grua, bile u gjend dhe një vërtetim pune me emrin e djalit të Lin Biaos, Lin Li Kuo. Mendoj se në aeroplan nuk është e mundur të ketë qenë vetë Lin Biaoja, por i gjithë tregimi është ndërtuar mbi bazën e

kësaj ndodhie. Mundet në aeroplan të ketë pasur përleshje me armë, sepse janë gjetur shenja plumbash. Të nesërmen e asaj dite u njoftua ambasada kineze në Ulan-Bator, e cila dërgoi njerëzit e vet për të parë mbeturinat e aeroplanit. Më vonë, kinezët na kërkuan të falura për shkeljen e territorit mongol pse «avioni kishte humbur drejtimin».

Sekretari i parë i ambasadës mongole ka shtuar: «Aktakuza për grupin e Lin Biaos bën bashkëpunëtor dhe Bashkimin Sovjetik. Kjo gjë bëhet me qëllim që t'i shërbejë propagandës antisovjetike kineze, brenda dhe jashtë vendit në favor të marrëdhënieve të tyre me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vendet e tjera të Perëndimit. Sovjetikët duket sikur po përgatiten që po ta shohin të nevojshme, ta demaskojnë këtë gjë».

Siç e kam komentuar edhe më parë këtë ngjarje, kurdoherë vihet pyetja: «Në rast se Lin Biaoja ishte i lidhur me sovjetikët, pse aeroplani i tij nuk u ul në stepat e Mongolisë dhe ca më mirë në një aerodrom të madh afër Ulan-Batorit, siç thotë diplomati mongol?».

Dy versione mbeten për ta shpjeguar këtë pyetje:

1. Lin Biaoja dhe familja e tij, të vrarë më parë, janë futur në një aeroplan piëge dhe janë nisur për në Mongoli, ku u rrëzua nga artileria kundërajrore dhe u dogj.

2. Aeroplani i Lin Biaos, i minuar, u nis jo për Mongoli, por për ndonjë drejtim tjetër të Kinës, dhe aviatori (njeri i Çusë) e futi në Mongoli. Lin Biaoja mund që e ka diktuar djallëzinë dhe ka urdhëruar pilotin të kthehej, ai s'është kthyer (ose, po të marrim parasysh versionin se në avion u gjendën shenja plumbash, siç thotë diplomati mongol, janë qëlluar midis tyre) dhe në ajër aeroplani është qëlluar nga artileria kundërajrore, u rrëzua dhe u dogj.

Zgjidh e merr cilin version të duash. Katërcipërisht kinezëri!

E PREMTE  
5 DHJETOR 1980

## SHËNIM

Sot më erdhi Ramizi në shtëpi. Më foli për një bisedë që ambasadori ynë në Beograd, Sokrat Plaka, ka pasur me Fadil Hoxhën.

## SHËNIM

Bisedova sot me shokët për krizën botërore financiare dhe energjetike (kriza e naftës), si dhe për rolin e OPEK-ut<sup>1</sup>.

1981

<sup>1</sup> Organizata e Vendeve Eksportuese të Naftës.

**E PREMTE**  
**2 JANAR 1981\***

## **POPULLI AFGAN NUK NËNSHTROHET**

Patriotët afganë e pritën me demonstrata të mëdha dhe me armë përvjetorin e pushtimit të vendit të tyre nga ushtria socialimperialiste sovjetike. Në disa rajone, sipas mundësive e kushteve rrethanore, pushtuesit u sulmuan e u goditën me armë e me gurë.

Nga sa kam lexuar në axhanset e lajmeve, këto ditë në një lagje qendrore të Kabulit, ndodhi një shpërthim i fuqishëm në një objekt të rëndësishëm të sovjetikëve. Shumë ndërtesa të tjera qeveritare janë goditur me gurë, ndërsa ushtarët sovjetikë kanë përdorur armët e zjarrit kundër demonstruesve, studentë, punëtorë e qytetarë të thjeshtë. Ka pasur të plagosur e shumë të arrestuar.

Afganët janë popull i varfër, por krenar e me tradita trimërie. Prandaj atë nuk mund ta nënshtrojnë as forca numerike e madhe e pushtuesve, as armët moderne, as terrori i tyre i egër. Aksionet e tanishme janë akoma të vogla, por në të ardhmen ato do të rriten e do të kthehen në beteja të ashpra e dërrmuese kundër hordhive të socialimperialistëve sovjetikë deri në dëbimin e tyre të plotë nga toka e Afganistanit.

Shtypja e të huajit nuk e shuan, por e ndez më fort urrejtjen e popujve. Këtë ne shqiptarët e kemi provuar mbi vetë kurrizin tonë derisa arritëm fitoren përfundimtare mbi pushtuesit nazifashistë e shërbëtorët e tyre vendas.

## MAOS IU PRISH QETËSIA E VARRIT

Lajmet që vijnë nga Pekini nuk i tregojnë të mira bathët për presidentin Hua Kuo Fen. Duket se rivali i tij, Ten Hsiao Pini, ia ngriti këmbët dhe e bëri «reaktiv», siç thoshte Mao Ce Duni kur përkrahësit e Revolucionit Kulturor i vinin ndonjërit «kapelen». Siç po duken punët, tash edhe Huasë ia kanë vënë «kapelen». Ka ndonjë muaj që nuk po i del emri gjëkund dhe s'i duket fytyra në asnjë manifestim.

Në pritjen e djeshme të vitit të ri «evropian», që u zhvillua në Pekin, në sallën e madhe të Asamblesë së Madhe Kombëtare, ishin të gjithë kuadrot kryesorë, me Tenin në krye, vetëm Hua Kuo Feni mungonte në «apel». Ky është një truk i njohur kinez: mbledhja ishte bërë për të pirë një çaj dhe me këtë rast të konfirmonin, pa e shpallur zyrtarisht, se Hua Kuo Fenit ia kanë kënduar *De profundis*-in në liturgjinë budiste. Kështu Mao Ce Duni, duke zgjedhur Hua Kuo Fenin si zëvendës të tij, «nuk fjeti gjatë i qetë», Teni i vogël ia prishi qetësinë e varrit Maos, si dhe karrierën mikut të Titos dhe të Çausheikut.

Gjyqi i «të katërve», i «të dhjetëve» ose i «të dymbëdhjetëve», duke futur në të edhe Maon e Huanë, mori fund tok me fundin e vitit 1980. Maoja u sulmua dhe u rrëzua nga piedestali i lartë ku ishte ngritur, ra në baltë dhe u bë helaq. Huaja shkriu si kripa në ujë, për

Çian Çinin prokurori kërkoi dënimin me vdekje, por nuk dihet kur do të vendosë gjykata, pse kalendari kinez është i panjohur. Në këtë rrëmuje të re vetëm zëri i Çian Çinit u ngrit për t'u thënë gjyqtarëve: «Ju jeni fashistë, revizionistë, njerëz të Guomindanit».

E PREMTE  
9 JANAR 1981

## MAOCEDUNIDEJA — NJË FËMIJË I DËSHTUAR, ME SHUMË BABALLARË

Bota pret vendimin e gjykatës së posaçme të Pekinit kundër «bandës së të katërve».

Gjykimi i «bandës së kriminelëve dhe vrasësve» mori fund me «sukses të madh» ... për të qeshur! Prokurori vetëm për Çian Çinin, gruan e Maos, kërkoi dënimin me vdekje, për gjithë të tjerët kërkoi dënime të ndryshme me burgim. Por vendimi i gjykatës s'po duket akoma në horizont: mund të jepet nesër, siç mund të jepet edhe pas dy vjetësh! E këtillë është «drejtësia» kineze, e këtillë është «procedura penale» kineze, unike në botë. Çdo gjë origjinale, i dënuari me vdekje mund të dergjjet me vite të tëra në birucë, dhe jeta e tij të jetë në *suspens* orë e çast, sa herë hapet dera e birucës!

Por «gjyqi i bandës së të katërve», siç u quajt ai, kaloi nga salla e gjyqit në atë të byrosë politike dhe të Komitetit Qendror. Kjo se tani duheshin gjykuar edhe të vdekurit, Mao Ce Duni me Çu En Lain, edhe të gjallët, Jeh Çien Jini, Hua Kuo Feni dhe grupi i tyre.

Sigurisht gjyqi i dytë nuk mund të shkiste si në gjalpë, siç u organizua nga Teni dhe grupi i tij «gjyqi i bandës së të katërve» dhe njëkohësisht i të dhjetëve.

Grindjet dhe rivalitetet në udhëheqjen kineze janë të mëdha. Në këto rivalitete nuk implikohen vetëm disa persona, por grupe të tëra milionëshe, politika të ndrysh-

me në periudha të ndryshme, rrezikohen interesa për pushtet të formave të ndryshme, ambicie të formuluar ose të paformuluara. Në këtë luftë kaotike dhe joparimore për dominim implikohen, në radhë të parë, grupe të shumta ushtarakësh, ata që duan dhe aprovojnë Maon dhe ata që e dënojnë, grupi i Jeh Çien Jinit, që është dakord në disa çështje me Hua Kuo Fenin kundër Tenit, grupet e Huasë pro Maos e kundër Tenit, grupet e Tenit kundër Maos, Jehut, Huasë e pro Liu Shao Çisë, gjoja pro Çu En Lait dhe grupet e të rinjve, që, sapo të stabilizohen, do të krijojnë pushtetin e tyre. «Njëqind lulet e njëqind shkollat» e Maos kanë qenë pak. S'i kishte parashikuar mirë. Vetëm një gjë ai e kishte parashikuar drejt, atë se idetë e tij do t'i përdornin si të djathtët, ashtu edhe të majtët. Me fjalë të tjera, në Pekin qentë do të grihen me njëri-tjetrin, populli kinez do të vuajë.

Në Kinë zor se do të ketë stabilitet, arbitraritet po, pse gjithnjë në pushtet një grup do të ngrihet dhe do të rrëzohet tjetri, pastaj ky i fundit do të komplotojë përsëri për të rrëzuar të parin, derisa populli kinez të bëhet i ndërgjegjshëm për realitetin e hidhur që e ka pllakosur dhe t'i japë fund «rrëmujës» së predikuar nga Mao Ce Duni.

Aktualisht Teni dhe grupi i tij janë në radhën e parë të skenës. Teni duket se po bën ligjin, pret e përcjell, mban fjalime, bën aluzione, kërcënon, por kaosi vazhdon. Kina po diskreditohet brenda e jashtë. Ekonomia është përtokë, brenda ka dhe uri, thuhet se fajin e ka «banda», por edhe Hua Kuo Feni me gjoja planin e tij ekonomik të majtë. Të tëra do t'i dëgjojmë, «kur lind djalë, baba është Teni, kur lind çupë e bëri Feni».

Hua Kuo Feni që kur vazhdonte gjyqi, u fut në errësirë, nuk dilte më në pjacë, kështu lihej të kuptohej hapur nga Teni, se Feni dha dorëheqjen, u shkarkua nga funksionet etj. Kinezët, për të përgatitur opinionin e

brendshëm dhe atë të jashtëm, përdorin një taktikë të njohur: vënë të flasin «miqtë» dhe armiqtë e tyre. Dhe bota gati e hëngri: «Hua Kuo Feni u likuidua». Po ja, përsëri papritur, tash së fundi, Feni doli si xhol, me tituj e dekorata, doli në pjacë dhe Jehu.

Ç'ngjau?

Lufta vazhdon me të përpjetat e të tatëpjetat e veta.

Feni për Tenin është «mace e zezë». Ai ka qenë i Maos, Mao e vuri atë aty ku është, ai bashkëpunoi me «bandën» kundër Tenit. Feni ishte personi që shtypi demonstratën e Tien An Menit. Feni është pro Japonisë dhe «Evropës së Bashkuar». Teni është pro Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe për pushtimin e Azisë Juglindore. Teni është fashist i egër, Feni është fendë moderator.

Kush do të fitojë?

Me ta në krye as Kina, as revolucioni dhe as paqja e vërtetë. Këta udhëheqës do të jenë masha të imperializmit botëror dhe përfaqësues të hegjemonizmit kinez.

Të tërë këta vazhdojnë të ngrenë flamurin e Maos. Maocedunideja është e të gjithëve. Feni është integralisht për të. Teni ka nuanca: Mao ka të mira, ka dhe gabime, për të mos thënë se s'vlen më. Për Tenin maocedunideja ka baba Maon, Liun, Çunë dhe Tenin. Pra, një fëmijë i dështuar, me shumë baballarë. Çdo gjë kineze vazhdon të jetë eklektike.

E SHTUNË  
10 JANAR 1981\*

## KISINGERI PËRSËRI NË LINDJEN E MESME

Prej disa ditësh në Lindjen e Mesme po vërtitet një nga armiqtë më të egër të popullit palestinez e të popujve të tjerë arabë, përkrahësi i lindur i çifutërisë ndërkombëtare, famëkeqi Henri Kissinger. Kësaj radhe ai nuk ka ardhur me funksione shtetërore, por si i dërguar i posaçëm i presidentit Regan për të hetuar, për të tatuar e për të komplotuar kundër popujve arabë e, mbi të gjitha, për të siguruar interesat e monopoleve amerikane të naftës e të prodhimit të armëve.

Kudo që ka shkuar, në Arabinë Saudite apo në Izrael, në Oman apo gjetiu, jo pa qëllim ai ka mburrur Kemp Dejvidin dhe traktatin e paqes Izrael-Egjypt, për përfundimin e të cilit krenohet se ka derdhur edhe ai «djerse». Kudo ka bërë thirrje për «mirëkuptim rajonal», me një fjalë për të pushuar luftën kundër agresorëve izraelitë, për të pranuar si fakt të kryer pushtimin nga Izraeli të tokave arabe, të Cisjordanisë, rripit të Gazës, Golanit e të disa pjesëve të Sinait — atë që quhet shteti i Izraelit me kufij të sigurt etj.

Hapur e me arrogancë, jo një herë, ai ka kërcënuar me «vendosmërinë e qeverisë amerikane për një ndërhyrje më të madhe ushtarake në Mesdhe e në Gjirin Persik».

Ky është Henri Kissingeri, strategu dhe formuluesi i politikës antiarabe të Kenedit, Xhonsonit, Niksonit, Karterit dhe tash të Reganit.

E HËNË  
19 JANAR 1981

## Ç'PO NDODH NË KINË?!

Edhe të dua të mos shkruaj më për Kinën e sotme, pse rrezikoj të bëj përsëritje, prapë s'më rrihet pa shënuar disa ngjarje (them disa, pse është e vështirë t'i shënoosh të gjitha). Këto ngjarje janë shkruar me të zezë mbi të bardhë nga vetë gazeta «Zhenminzhibao» dhe janë transmetuar nga agjencia HSINHUA. Partia Komuniste e Kinës, Komiteti i saj Qendror ose, më mirë të themi, grupi i Ten Hsiao Pinit këshillon anëtarët e partisë, kudo ku janë, që të përkrahin pa përjashtim e pa rezerva të gjithë ata që Revolucioni Kulturor i ka pasë demaskuar si reaksionarë, borgjezë, kapitalistë dhe t'i futin në punët që kanë pasur më parë. I thuhet partisë se këta njerëz janë «shumë të vlefshëm», se kanë «eksperiencë», prandaj duhet të hiqen nga drejtimet që kishin «uzurpuar» elementët që ngriti Revolucioni Kulturor e që janë njerëz pa eksperiencë e të vendosen ata. Agjencia HSINHUA thotë se 80 për qind e këtyre «xhevahirëve» nuk janë sistemuar akoma në vendet që u përkasin, prandaj bën thirrje: «shpejtohuni»... se mund të bëhet vonë!

E qartë. Me një dekret të mëparshëm kapitalistëve iu kthyen pasuritë e luajtshme e të paluajtshme, tani po i integrojnë në masë në pushtet dhe në udhëheqjen e organizmave të tij.

Ky është xhevahiri i parë.

Një tjetër xhevahir: Shtypi kinez shkruan se «ngjyra

e kuqe nuk është ngjyra e proletariatit». Është gabim, «metafizike» të pretendosh për një gjë të tillë! Po ashtu «e bardha» nuk mund të përfaqësojë «kapitalistët dhe borgjezinë».

Kështu me «një të goditur» në «Zhenminzhibao», kinëzët likuiduan edhe këtë çështje «shumë të diskutueshme» e që kishte «ngatërruar» kot mendjet e njerëzve dhe të klasave. Sipas tyre tani «të gjithë jemi vëllezër», nuk ka më klasa, nuk ka flamurë, nuk ka ngjyra me dy kup-time, ashtu sikundër nuk ka rëndësi nëse «macja është e zezë apo e bardhë, mjafton që ajo të zërë minj». Mirëpo hajde mbushu mendjen proletariatit dhe borgjezisë.

Kështu siç ka filluar, një mëngjes Teni do të propozojë ngjyrën e verdhë si ngjyrë universale. «Një për të gjithë e të gjithë për një», edhe me revizionistët sovjetikë, por me Kinën e amshueme në krye.

Xhevahiri i tretë, i shkruar me të zezë mbi të bardhë nga vetë shtypi kinez: Revolucioni Kulturor solli shkatërrimin e Kinës, vrau me qindra mijë, në mos me miliona kuadro, shkatërroi ekonominë, kulturën, la pas zhvillimin e Kinës! Kriminelët fajtorë për këtë ishin «katërshja», fajtor ishte Maoja. Ky ishte zëri i fortë i Tenit, ndërsa Feni i mbante ison, por me zë të ngjirur. Në gjyq Çian Çini i quajti të gjithë tradhtarë, agjentë të Guomindanit. E dënuan me vdekje. Çian Çini iu përgjigj këtij dënimi: «Do të jem e lumtur të më pritet koka në Tien An Men, përpara 15 mijë vetave, pse ju do të keni prerë kokën e Mao Ce Dunit». «Unë, tha ajo, zbatoja urdhrat dhe vendimet e Maos». Dhe këtu ajo fliste drejt.

Në kulisat e sallës së gjyqit, që ishte një maskaradë dhe që «në vend që të vinte vetulla nxori sytë», filluan ethet dhe dridhmat. Teni zbuti tonin: «Mao kishte ca gabime, por kishte shumë të mira. Revolucioni Kulturor kishte anët e këqija, por edhe anët pozitive». Feni u ringjall, iu ul ca temperatura, doli nga krevati në skenë.

Por, prapa skenës vazhdon lufta. Secila palë kërkon të fitojë kohë deri në kongres, që thuhet se do të bëhet, por asnjeri nuk e di se kur do të bëhet. As ata që do ta bëjnë atë nuk e dinë, pse kongresi duhet t'i vërë kurorën njëerës palë dhe tjetrën ta futë në gropë.

**E ENJTE**  
**22 JANAR 1981\***

## **GRUSHT I RËNDË ARROGANCËS AMERIKANE**

Agjencitë e lajmeve njoftuan përsëri për një ngjarje të re e me efekte të rënda për autoritetin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në arenën ndërkombëtare. Qeveria iraniane liroi 52 pengjet që populli e revolucionarët e Teheranit i kapën në ambasadën amerikane më 4 nëntor 1979. Është fjala për diplomatë të rangjeve të ndryshme, teknikë e nëpunës të tjerë, si dhe për rojat e marinës ushtarake të Shteteve të Bashkuara që ishin ngarkuar të mbronin ambasadën e tyre në Teheran. Ata u mbajtën të burgosur dhe u morën në pyetje për 444 ditë, pavarësisht nga presionet e shumta politiko-ekonomike, si dhe nga shantazhet e kërcënimet për ndërhyrje ushtarake të bëra nga qeveria e Uashingtonit.

Personeli i ambasadës amerikane në Teheran u kap për arsye se, në kundërshtim dhe duke marrë nëpër këmbë ligjet dhe konventat e ndryshme ndërkombëtare, ishte marrë me veprimtari të paligjshme e me ndërhyrje në punët e brendshme të popullit iranian. Vetë ambasada ishte kthyer në një fole të rrezikshme spiunazhi e subversioni e agjentëve të CIA-s. Në vitin 1953 ajo organizoi dhe realizoi, me ndihmën e përkrahësve të shahut, puçin ushtarak që rrëzoi qeverinë e Musadekut dhe sabotoi luftën e popullit iranian kundër shahut e kundër imperialistëve amerikanë.

Në këtë fole spiunësh të regjur të CIA-s, iranianët

kapën një numër të madh dokumentesh komprometuese për veprimtarinë sabotuese e komplotuese të imperializmit amerikan jo vetëm në Iran, por edhe në vende të tjera të pellgut naftëmbajtës të Lindjes së Mesme.

Kapja dhe mbajtja për një kohë të gjatë në arrest e diplomatëve-spiunë amerikanë nga populli iranian ishte një grusht i rëndë kundër prepotencës dhe arrogancës politiko-ekonomike e ushtarake të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ajo pati jehonë shumë të madhe në botë. Shtetet e Bashkuara të Amerikës u tërbuan dhe bënë çdo përpjekje për të dalë nga gjendja e turpshme në të cilën u vunë, me sa më pak dhimbje, por nuk ia arritën dot. Më në fund u detyruan të pranonin kushtet e rënda, por të drejta të caktuara nga mexhlisi (parlamenti) iranian për lëshimin e pengjeve dhe konkretisht: zhblokimi i pasurive iraniane të depozituara në Shtetet e Bashkuara të Amerikës; vënia në dispozicion të Iranit të të gjitha pasurive që i përkasin Iranit; njohja e faktit se pasuritë e ish-shahut dhe të afërmve të tij i përkasin popullit iranian etj.

Përveç kësaj, në komunikatën e botuar nga qeveria iraniane për lirim të pengjeve, denoncoheshin edhe një herë me vendosmëri të gjitha ndërhyrjet politike e ushtarake të imperialistëve amerikanë, si dhe kërcënimet e bujshme të presidentit Regan.

Lëshimi i pengjeve amerikane pasi qeveria e Shteteve të Bashkuara u detyrua të pranonte kushtet e caktuara nga mexhlisi iranian, përbën një fitore tjetër të popullit iranian në revolucionin e tij kundër monarkisë feudale të Pahlevëve dhe imperializmit. Dëshmon se ai është një popull trim, i vendosur e i gatshëm t'u japë goditje të tjera imperialistëve amerikanë e gjithë imperialistëve të tjerë që do të përpiqen ta pengojnë në rrugën e tij për një Iran me të vërtetë të lirë e të pavarur.

Ky akt i qeverisë e i popullit iranian meriton të për-

shëndetet dhe ne do ta përshëndetim me anë të shtypit si një shembull i mirë që tregon se asnjë fuqi imperialiste apo socialimperialiste, sado e madhe dhe sado e armatosur që të jetë, nuk mund t'i imponohet e të mposhtë vullnetin e popujve për liri e për pavarësi.

E HËNË  
26 JANAR 1981

## ALEANCAT MUND TË BËHEN VETËM NËN UDHËHEQJEN E PARTISË MARKSISTE-LENINISTE

Lexova letrën e shokëve gjermanë për një artikull që ka shkruar «Zëri i popullit»<sup>1</sup> në lidhje me grevat në Poloni, të udhëhequra nga organizata «Solidarnost». Ata janë dakord me artikullin, por kanë edhe disa vërejtje.

Çështjen e drejtimit politik reaksionar të «Solidarnostit» e vënë në radhë të dytë, si çështje të parë nxjerrin në pah anën ekonomike. E quajnë të kapërcyer ose të dorës së dytë e të tretë që të bëhet thirrje për «formimin e Partisë Komuniste Poloneze (marksiste-leniniste) dhe për revolucion», por thonë se partive tona duhet «t'u bëjmë të njohur si e me kë të bëjnë aleancë». Harrojnë shokët gjermanë se që të flasësh për aleancë, ashtu siç na mëson leninizmi, duhet më parë të formohet partia, e cila do të udhëheqë, do të bëjë aleanca dhe do të kalojë etapat revolucionare. Këtë gjë bëri edhe reaksioni polak, kisha dhe reaksioni i jashtëm me «Solidarnostin» dhe jo më të mos bëjnë revolucionarët marksistë-leninistë polakë. Populli dhe klasa punëtore medoemos duhet të bëjnë greva kundër reaksionit në fuqi ose që përpiqet të ndërrojë kuajt e pushtetit kapitalist. Kjo është çështje

<sup>1</sup> «Vetëm rruga revolucionare mund t'i sjellë fitore klasës punëtore polake». «Zëri i popullit», 7 shtator 1980.

më vete, çështja se kush i udhëheq e kush duhet t'i udhëheqë është tjetër.

Grevat e lëvizjet revolucionare ne duhet t'i mbësh-tetim, por ato nuk zhvillohen kudo njëlloj, pse kanë orientime të ndryshme ku politike dhe ku ekonomike, sidomos kur nuk ekziston një parti marksiste-leniniste që t'i udhëheqë. Elementët e ndërgjegjshëm të klasës punëtore, që nuk janë të organizuar në parti, duhet të udhëhiqen nga marksizëm-leninizmi dhe ne, partitë marksiste-leniniste, duhet të japim mendime të drejta dhe shembullin marksist-leninist revolucionar në veprimet tona.

Shokët gjermanë nuk i analizojnë në mënyrë korrekte ngjarjet në Poloni dhe në vendet e tjera kapitaliste dhe revizioniste. Për vete ata kanë vepruar drejt, duke formuar partinë dhe sindikatat e tyre, por harrojnë se edhe në këtë rast taktikat e luftës së tyre ndryshojnë në të dy Gjermanitë. Është ekzistenca e partisë së tyre ajo që i bën të jenë në gjendje të bëjnë analiza më të drejta dhe të caktojnë aleancat në luftë kundër reaksionit.

Po kush do ta bëjë këtë në Poloni?

Shokët gjermanë duhet të kenë parasysh se luftën, revolucionin do ta bëjë populli polak me klasën e vet punëtore dhe nën udhëheqjen e një partie marksiste-leniniste. Ne jemi faktori ndihmës i jashtëm.

Kam përshtypjen se shokët gjermanë **duan të hiqen si faktor** që duhet të udhëheqë dhe që duhet t'i thotë klasës punëtore polake ç'duhet të bëjë dhe pa pasur partinë e saj.

Këto mendime ia thashë edhe shokut Ramiz.

E SHTUNË  
31 JANAR 1981

## ÇFARË PASQYROI GJYQI I «TË KATËRVE» NË PEKIN?

Sot bisedova me shokun Ramiz për çështjen e artikullit<sup>1</sup> mbi gjyqin e Pekinit kundër «bandës së të katërve». I dhashë me këtë rast mendimet e mia nga shënimet që vazhdoj të mbaj mbi zhvillimin e ngjarjeve në Kinë.

— Në Pekin, në fakt, zhvilloheshin dy gjyqe, një i hapët kundër «katërshes» e grupit ushtarak dhe një i brendshëm kundër Maos, Çusë, Jehut dhe Huasë<sup>2</sup>.

Gjyqi i hapët mund të ecte sipas orkestrimit të Tenit, por ai që zhvillohej me «porta të mbyllura» ishte shumë i vështirë, pse përfaqësonte rivalitetet midis klivave e grupeve të mëdha kundërshtarë në gjirin e udhëheqjes aktuale kineze.

Në këto rivalitete nuk implikoheshin vetëm disa persona, por grupe të tëra milionëshe, politika të ndryshme në periudha të ndryshme, rrezikoheshin interesa të veçantë për pushtet, ambicie të formuluar ose jo të shumë grupeve në luftë kaotike dhe joparimore për dominim, grupe të shumta ushtarakësh «zotër modernë të luftës», grupe që duan dhe aprovojnë Maon, si dhe ata që e

1 «Shprehje e re e luftës së egër për pushtet midis klaneve revizioniste në Kinë». «Zëri popullit», 3 shkurt 1981.

2 Mao Ce Dun, Çu En Lai, Jeh Çien Jin, Hua Kuo Fen.

dënojnë atë. Grupi i Jehut është në akord për disa probleme me Huanë dhe kundër Tenit; grupet e Huasë janë pro Maos dhe kundër Tenit; grupi i Tenit është kundër Maos, Jehut e Huasë dhe pro Liut, gjoja pro Çusë. Më në fund është grupi i më të rinjve, që i shtyn Teni përpara, por që përpiqen të stabilizohen për të krijuar pushtetin e tyre.

«Njëqind lulet dhe njëqind shkollat» e Mao Ce Dunit janë në lulëzim, në zhvillim dhe në luftë. Maoja vetëm një gjë kishte parashikuar drejt, se idetë e tij eklektike do të përdroreshin edhe nga të djathtët, edhe nga të majtët.

Huaja për Tenin, siç kam shkruar, ka qenë dhe është «macja e zezë». Teni përdori taktikat e njohura kineze duke nxitur njërin dhe tjetrin të thonë se «Huaja u likuidua», se ai «dha dorëheqjen». Kështu përgatitej opinionioni, tatohej pulsi si jashtë, ashtu edhe brenda.

Hua Kuo Feni hiqej e hiqet i moderuar, maoist integral, ndërsa Teni është hapur reaksionar, fashist, hakmarrës, antimaoist. Huaja ishte dhe është për miqësi me Japoninë dhe me «Evropën e Bashkuar», Teni ishte dhe është proamerikan, luftënxitës dhe për pushtimin e vendeve të Azisë Juglindore.

Kush do të fitojë? E përsëris: me ta në pushtet as Kina, as revolucioni dhe as paqja e vërtetë. Këta udhëheqës që përfaqësojnë hegjemonizmin kinez, do të jenë masha të imperializmit botëror.

Kina, që është gati një kontinent, që nga çlirimi i saj e deri sot nuk ka gjetur asnjë stabilitet dhe as ka mundur të ndërtojë një strukturë politiko-ekonomike dhe shtetërore-organizative të qëndrueshme, të çfarëdo natyre të ishte ajo.

Në fillim u adoptua slogani i «një demokracie të re», që më vonë u pagëzua «socializëm» deri edhe «diktaturë e proletariatit». Por, në realitet, struktura e shtetit të ri

kinez ishte dhe mbeti një strukturë feudo-borgjeze. Në praktikë nuk u bënë përpjekje për t'i rinuar këto struktura, pse mungonte qartësia politike dhe ideologjike që t'i udhëhiqte këto transformime. Udhëheqësit kinezë në gjithë këtë periudhë, edhe sot vazhdon e njëjta gjë, jo vetëm që s'kanë qenë dhe s'janë marksistë-leninistë, por edhe synimet e tyre për zhvillimin e vendit dhe të ekonomisë së Kinës në rrugën borgjezo-kapitaliste, ishin dhe janë të paqarta. Luftohej me formula, me citate, tatohe-shin terrenet, sistemet, asgjëkundi nuk përqendroheshin e, në të njëjtën kohë, përpiqeshin të tregoheshin për atë që nuk ishin. Kina rronte e rron nga një ditë në tjetrën.

Në këtë mjegull, në këtë paqartësi politiko-ideologjike, zhvilloheshin rivalitetet e grupeve të ndryshme, që luftonin për pushtet, për sundim. Secili grup ose individ kishte rrugën e tij të paqartë, të papërcaktuar, por te të gjithë sundonte ndjenja e hakmarrjes, e rrëzimit të njërit nga tjetri. Kjo rrugë vazhdon edhe sot. Edhe grupi i Mao Ce Dunit e i Çu En Lait notonte fort në këto ujëra. Megjithëkëtë, ai ishte grupi më pozitiv që u përpoq dhe bëri diçka të çalë, por bëri për Kinën. Grupi i Liu Shao Çisë ishte më reaksionari dhe aktualisht grupi i Tenit kaloi në feudo-fashizëm, në ultrareaksion.

Aktualisht Teni me grupin e tij duket se është në lozhat e para, pret e përcjell, mban fjalime dhe kërcënon. Rezultatet: Kina po diskreditohet, si brenda, ashtu edhe jashtë. Të gjithë dyshojnë tek ajo. Ekonomia e saj, e mëkëmbur nga Maoja dhe nga Çu En Lai, është përtokë. Udhëheqja e tanishme gënjen duke ia hedhur fajin për këtë «katërshes».

Kina aktuale ndodhet në rrugëkryqe. Ajo rron në kaos, në anarki, në pasiguri. Çdo hap i udhëheqësve të saj aktualë është jo vetëm pragmatist, por edhe koniunktural në vetvete si për situatën e brendshme, ashtu edhe

për atë të jashtme. Kjo është një politikë pa parime, anakronike, feudale, prepotente. Ajo s'gënjen kërrkënd kur hiqet si «demokratike», pa le «socialiste».

Kina, në qoftë se mund të përdorim një figurë, i përngjet një shtëpie të madhe të vjetër, pa themele të shëndosha, e ndërtaur pa plan dhe pa struktura. Çdo tërmet politik që bie i rrëzon pjesë të tëra të mëdha. Ndërtuesit që vijnë për ta meremetuar, janë akoma më të këqij dhe i vënë fare kazmën.

Megalomania e «shtetit të madh» kinez nuk peshon në politikën aktuale botërore për të triumfuar, dhe idetë e Tenit dhe të Fenit nuk kanë mundësi të triumfojnë. Imperializmi dhe hegjemonizmi, qoftë ai amerikan, sovjetik, kinez, fuqitë e tjera kapitaliste të zhvilluara, urrehen dhe luftohen nga popujt e botës.

Është shekulli i krizave të mëdha të botës kapitalisto-revizioniste, është shekulli i luftërave çlirimtare dhe i revolucioneve.

Armiqtë e saj të jashtëm kërkojnë ta grabitin Kinën, duke bërë investime me shumë fitime për ta. Tek ata mbretëron dyshimi dhe mosbesimi ndaj Kinës. Kina as vetë nuk e di ku e ka kokën e ku i ka këmbët. Për armiqtë e popullit kinez kaosi është i dëshirueshëm. As Amerika, as borgjezia reaksionare tashmë s'ia kanë frikën Kinës. Bashkimi Sovjetik ka më shumë frikë Les Valesën sesa Ten Hsiao Pinin.

Këtë situatë pasqyroi e vërtetoi gjyqi i Pekinit. Grupi i Tenit dhe i Huasë dënuan gjoja si «kriminelë të thjeshtë dhe komplotistë» «katërshen» dhe grupin e ushtarakeve, por në realitet ata dënuan të gjithë politikën dhe sistemin ekonomik-shtetëror të Kinës që nga çlirimi e deri më sot.

Dhe kush janë këta që e dënuan këtë sistem?

Janë vetë ata që e kishin ndërtaur dhe që synojnë

ta meremetojnë me mënyra monstruoze dhe në drejtime akoma më katastrofike për Kinën.

Në Kinë nuk do të ketë stabilitet, as politik, as ekonomik. Arbitraritet dhe dhunë po, vazhdimisht. Do të ngrihet në pushtet një grup dhe do të rrëzohet tjetri. Ky i fundit do të komplotojë për të rrëzuar të parin derisa populli kinez të bëhet i ndërgjegjshëm dhe t'i japë fund «rrëmujës» së predikuar nga vetë Mao Ce Duni.

Vjetërsirat kapitaliste po mbulojnë Kinën. Por këto i ka dënuar historia. Kina e rinisë revolucionare nuk mund të mposhtet nga llumi që është ngritur për t'ia varrosur edhe ato fitore që ka pasë arritur deri tani populli kinez.

Marksistë-leninistët dhe gjithë njerëzit përparimtarë në botë kanë shpresë dhe dëshirojnë që Kina revolucionare të çajë me gjoks kaosin e madh ku e kanë futur armiqtë e saj të brendshëm dhe të jashtëm.

E SHTUNË  
7 SHKURT 1981

## MBI KARAKTERIN E GREVAVE TË KLASËS PUNËTORE NË POLONI

### Teza për artikull<sup>1</sup>

I dërgova shokut Ramiz tezat e mëposhtme për përgatitjen e një artikulli që duhet të botojmë, ku të sqarojmë karakterin e grevave të klasës punëtore në Poloni:

1. **Mungesa e partisë komuniste (marksiste-leniniste) është dhe mbetet handikapi<sup>2</sup> më i madh i klasës punëtore luftarake polake.**

2. Revolucioni dhe çdo përmbyesje pozitive progresiste në një popull dhe në një klasë punëtore të shtypur nuk mund të kryhen, po nuk u udhëhoqën nga një parti komuniste marksiste revolucionare leniniste.

3. **Klasa pa një parti komuniste (marksiste-leniniste) zor se gjen rrugën e saj drejt revolucionit, ajo do të ndodhet kurdoherë e përçarë dhe si të fillë do ta manipulojnë partitë e borgjezisë kapitaliste dhe revizioniste për interesat e tyre.**

4. Një klasë punëtore e përçarë politikisht dhe në mungesë të një partie komuniste (marksiste-leniniste) do të bëhet loja e partive të ndryshme, e reaksionit dhe e reformistëve.

1 «Poloninë mund ta shpëtojë vetëm klasa e saj punëtore».  
«Zëri i popullit», 13 shkurt 1981.

2 Nga anglishtja — pengesë.

5. «Lëvizja punëtorë» e «solidaritetit» është reaktionare. Kjo lëvizje udhëhiqet nga kisha katolike polake dhe nga Vatikani (klani i Les Valesës), nga «Klubi i inteligjencies katolike», nga KOR-i, grup i reaksionit kapitalist botëror, nga reaksioni i brendshëm dhe nga organizata «Konfederata e Polonisë së pavarur».

Të gjitha këto e të tjera grupime formojnë gjoja një sindikatë të pavarur dhe apolitike me emrin «Solidarnost». Këto korrente të ndryshme politike reaksionare manipulojnë klasën punëtorë polake.

6. Në mes tyre ekziston aleanca kundër Partisë Punëtorë të Bashkuar të Polonisë në fuqi, parti revizioniste-reaksionare e përçarë brenda saj në grupe anti-sovjetike, prosovjetike, shoviniste, reformiste, klerikale. PPB e Polonisë është plotësisht antimarksiste-leniniste.

7. «Solidarnosti» kërkon të vijë në pushtet dhe ta orientojë Poloninë drejt Perëndimit, ta nxjerrë atë nga Traktati i Varshavës. Kjo është strategjia. Kisha dhe Perëndimi zbatojnë taktikën, sipas së cilës edhe «mishi të piqet, edhe helli të mos digjet».

Mirëpo brenda «Solidarnostit» janë edhe «ultrat» që duan të djegin etapat e «Ost-politikës» gjermane, sidomos të politikës franceze të «detantës së fuqive perëndimore evropiane me Bashkimin Sovjetik». Ultrat janë për taktikën: deri edhe në ndërhyrjen sovjetike dhe konflagracionin me armë. Ultrat bëjnë politikën amerikane, që synon konfliktin e armatosur brenda në Poloni dhe dobësimin e shkatërrimin e taktikës së «Ost-politikës» franko-gjermane për t'i dobësuar këto dhe për t'i kthyer në pozitë të bindurve, duke i kërcënuar me rrezikun e imperializmit sovjetik.

8. Kisha katolike polake është e plotfuqishme, është pushteti shpirtëror dhe ideologjik që dominon katërcipërisht në jetën e popullit polak. Në Poloni drejton Vatikani edhe në «çështjen temporale», por këtë të kamu-

fluar dhe nëpërmjet «panëve të rinj» që janë në pushtet. Me «Solidarnostin» ai lufton të marrë plotësisht edhe drejtimin e shtetit.

Vatikani — kisha polake dhe Evropa Perëndimore predikojnë: «Hidh një hap dhe konsolidoje, pastaj hidh hapin tjetër», «evito ndërhyrjen sovjetike», «21 pikat përdori si platformë gjoja ekonomike për të gënjyer klasën dhe ndërroji me veprime politike», duke i gërryer themelet e sistemit revizionist aktual, themelet e pseudopartisë komuniste polake (prosovjetike — antisovjetike — antiruse — shoviniste etj.), «nga qyteti kalo në fshat me «Solidarnostin fshatar», grumbullo politikisht panët e tokave, që kurrë nuk lejuan kolektivizimin dhe janë baza kryesore e kishës polake dhe e traditave shoviniste.

9. Kjo është strategjia dhe këto janë taktikat e reaksionit të brendshëm polak dhe atij ndërkombëtar. Këta janë objektivat e kundërrevolucionit, brenda në një gjendje e nën një pushtet kundërrevolucionar.

10. Pushteti aktual revizionist polak është në suspens. Reaksioni kishtar manipulon bazën, klasën. Pushteti aktual detyrohet t'u lëshojë reaksionit dhe kishës dhe këtë ta pranojë si arbitër në konflikt. Por pushteti revizionist polak duhet «t'i bëjë qejfin edhe dhisë, edhe lakrës», duhet të ketë kujdes në ekzigjencat rigorozë të «aleatit» sovjetik. Panët në fuqi duan, gjithashtu, të ruajnë privilegjet.

11. Sovjetikët dhe aleatët e tyre të Traktatit të Varshavës janë tepër në hall; rrezikohet aleanca, rrezikohet hegjemonia sovjetike në vendet e Lindjes, rrezikohen rrugët vitale të ushtrisë sovjetike, rrezikohet strategjia e sulmit, rrezikohen marrëdhëniet tregtare Lindje-Perëndim, rrezikohet marrja e miliarda dollarëve që Bashkimi Sovjetik dhe satelitët e tij kanë marrë dhe marrin nga imperializmi amerikan dhe nga Evropa Perëndimore e zhvilluar.

12. Prandaj klani sovjetik propagandon kundër, mbron klanin e tij polak brenda Polonisë, bën presion, kërcënon, ka në gatishmëri forcat e sulmit, pranon diçka për sy e për faqe, por edhe ky klan lufton ta shpartallojë diversionin me diversion dhe, po s'mundi e kur të rrezikohet çdo gjë e të venitet çdo shpresë e tij, i mbeten vetëm dy rrugë: ose «të ndërhyjë me armë» dhe të «stabilizojë gjendjen», ose të pranojë disfatën totale, domethënë shkatërrimin e Traktatit të Varshavës dhe të KNER-it.

**Sovjeti nuk mund të pranojë disfatën totale.**

13. Populli polak dhe klasa punëtore polake, në goftë se nuk i kuptojnë këto situata të ndërlikuara, ku i kanë futur korrentet e ndryshme reaksionare kapitalisto-klerikale revizioniste, do të bien «nga shiu në breshër».

14. Polonia e revolucionit as nuk ka vdekur, as nuk do të vdesë, ajo ka humbur orientimin, atë e kanë futur dhe po e futin në rrugë të rrezikshme. Polonia duhet të gjejë rrugën e vërtetë, rrugën e revolucionit proletar, të udhëhequr nga ideologjia marksiste-leniniste.

15. Partia jonë, nëpërmjet organit të saj, ka dhënë mendimet e veta për ngjarjet e zhvilluara në Poloni. Ajo ka dënuar regjimin e Gomulkës, të Gierekut dhe aktualisht të Kanas, ka dënuar dhe demaskuar revizionistët sovjetikë dhe satelitët e tyre, regjimet dhe synimet që ata kanë, ka dënuar dhe demaskuar imperializmin amerikan, shtetet neokolonialiste dhe synimet e tyre, ka mbështetur fuqimisht lëvizjen çlirimtare të popujve dhe revolucionet përparimtare, revolucionet proletare.

16. Partia jonë vazhdimisht ka përkrahur rivendikimet ekonomike dhe politike të klasës punëtore të çdo vendi kapitalisto-revizionist. Çdo lëvizje Partia jonë e ka parë dhe do ta shohë me syrin klasor, në prizmin e marksizëm-leninizmit, në prizmin politik.

Partia jonë nuk gënjehet nga sloganet dhe parullat, por shikon me kujdes kujt i shërbejnë orientimet, ç'rrugë merr rivendikimi, greva ose kryengritja.

**Partia jonë, duke qenë për grevat politike, ekonomike, për kryengritjet popullore, për revolucionin, nuk mbështet në to as aleancat reaksionare dhe as tendencat kundërrevolucionare, përkundrazi ajo mbështet frymën revolucionare, aleancat progresiste dhe revolucionare.** Çdo lëvizje nuk është revolucionare, por kur në to marrin pjesë populli dhe klasa, diçka ka pozitive, nga e cila duhet të kapesht për ta kthyer të tërën në pozitive, në interes të popullit, të klasës dhe të revolucionit.

**17. Këtë rrugë ka ndjekur dhe do të ndjekë Partia jonë në çështjen e Polonisë, të grevave dhe të rivendikimeve të klasës punëtore polake.**

Qëndrimet e Partisë sonë kanë qenë konsekuente marksiste-leniniste në çdo fazë të grevave, në çdo etapë të tyre. Ajo ka parë orientimet politike të grevave, sido që bëheshin përpjekje nga reaksioni polak të fshiheshin synimet e vërteta politike, të cilat mbuloheshin gjoja me rivendikime thjesht ekonomike. Les Valesa, njeriu i Vatikanit dhe i primatit polak, bërtiste, kush të donte ta dëgjonte dhe ta besonte se ai «nuk ishte njeri politik, s'bënte politikë», se «Solidarnosti nuk ishte një parti politike».

Shumë u gënjen, vetë klasa punëtore e Polonisë po mashtrohet.

Partia jonë, mund të themi, dhe mendimet e saj janë të shprehura dhe të shkruara me të zezë mbi të bardhë, nuk u mashtrua nga demagogjia, as nga strategjia dhe taktikat e reaksionit polak dhe atij botëror.

18. Ka rrugëdalje për popullin dhe për klasën punëtore polake nga kjo gjendje katastrofike ku është dhe ku duan ta futin dhe cila është kjo rrugë?

**Kjo është rruga e revolucionit që na mëson Lenini,**

duke zbatuar strategjinë e tij të revolucionit dhe taktikat revolucionare të vërteta në bazë të situatave që krijohen në çdo vend.

Klasa punëtore polake tregoi edhe një herë vitalitetin e madh të saj. Ajo rrëzoi Gomulkën, ajo rrëzoi Gierekun, ajo mund dhe duhet të dërrmojë edhe Kanian e shokët e tij, ajo duhet të dërrmojë kishën, Les Valesën, influencën e Vatikanit, zgjedhën e revizionistëve sovjetikë dhe të kapitalizmit botëror, me atë amerikan në krye.

**Klasa punëtore kaq revolucionare polake duhet të krijojë nga gjiri i saj një parti të re të vërtetë komuniste marksiste-leniniste dhe kjo, si të krijohet, duhet të japë prova dhe të kalitet në luftën klasore për revolucionin.**

19. Disa mund të thonë se Partia e Punës e Shqipërisë «nuk është realiste, është anakronike, kërkon shumë».

Por kështu mund të mendojnë armiqtë e marksizëm-leninizmit, armiqtë e revolucionit, kurse revolucionarët e mbështetin Partinë e Punës të Shqipërisë, pse ajo u qëndron besnike leninizmit dhe revolucionit.

E MARTË  
24 SHKURT 1981\*

## VEPRIME TERRORISTE TË USHTRISË SOVJETIKE NË AFGANISTAN

Agjencitë e lajmeve herë pas here flasin për luftën e guximshme të patriotëve afganë kundër ushtrisë sovjetike të pushtimit në Afganistan, si dhe për veprime të tyre të shpeshta në zonat fshatare, sidomos rreth e përqark Kabulit. Po ato flasin, gjithashtu, edhe për raprezaljet e egra e barbare të sovjetikëve kundër popullit afgan. Të ashpra janë masat e raprezaljes sidomos në zonat fshatare ku ka rezistencë dhe populli mbështet luftëtarët e lirisë. Njësitë e ushtrisë sovjetike godasin pa pushim me artileri, me aeroplanë e helikopterë zona të tëra pa dallim. Flitet për mijëra të vrarë midis popullsisë së pambrojtur.

Këto ditë ushtria sovjetike e pushtimit ka goditur me artileri edhe qytetin e Kandaharit duke përfshirë edhe një shkollë teknike. Në qendër të qytetit tani patrollojnë autoblanda e mjete të tjera të rënda ushtarake.

Këto veprime pirateske të sovjetikëve agjencitë e lajmeve me të drejtë i quajnë raprezalje nga më të ashprat që nga dhjetori i vitit 1979.

## TE DEMASKOJME MANOVRAT SHKOMBËTARIZUESE TË JUGOSLLAVËVE KUNDËR POPULLSISË SHQIPTARE

Bisedova sot në telefon me shokun Ramiz dhe i dërgova edhe tezat për një artikull<sup>1</sup> kundër metodave shkombëtarizuese që zbatojnë shovinistët jugosllavë ndaj shqiptarëve. Një nga këto metoda të poshtra është regjistrimi i shqiptarëve si «myslimanë», domethënë «besimin — fenë» e konsiderojnë si «kombësi». Me këtë mënyrë, shovinistët titistë duan të fshehin numrin e popullsisë shqiptare që jeton në trojet e veta në Jugosllavi e që rritet çdo vit.

Në artikull ne nuk duhet ta përmendim këtë manovër shkombëtarizuese të jugosllavëve, por ata do ta kuptojnë për kë bëhet fjalë. Ne duhet ta trajtojmë problemin historikisht, duke treguar si e kanë përdorur armiqtë e popullit tonë një gjë të tillë për të na përçarë dhe për të na zhdukur si komb, por «besimi — feja» as formon dhe as zhduk kombësinë.

Si konkluzion në artikull duhet të thuhet se këto manovra djallëzore nuk kanë pasur dhe nuk mund të kenë sukses. Historia i ka dënuar zbatuesit e tyre, ajo nuk kthehet prapa dhe nuk përsëritet.

<sup>1</sup> «Forca e patriotizmit shqiptar». «Bashkimi», 23 mars 1981.

## SHËNIME

Më bëri vizitë shoku Ramiz dhe me këtë rast më foli për përfundimet e bisedimeve me shokun Aust të Partisë Komuniste të Gjermanisë (marksiste-leniniste). Çdo gjë ka shkuar mirë. Austi kishte ngelur shumë i kënaqur nga bisedimet dhe nga vizitat që bëri nëpër vendin tonë.

Ramizi foli edhe për bisedat që ka pasur me disa shokë të Partisë Komuniste të Spanjës (marksiste-leniniste), të kryesuar nga Raul Marko.

Morali i spanjollëve, më tha Ramizi, kishte rënë për shkak të fraksionit serioz që u ka ndodhur në udhëheqje si dhe për krizën «ekonomike» që po kalonte partia e tyre. Nga biseda e druajtur dhe nga disa shprehje të tyre, tha Ramizi, dukeshin sikur të ishin fajtorë ndaj Partisë sonë, pse duhet t'u jenë bërë kritika për qëndrimin tonë jo të favorshëm ndaj tezës së tyre për të formuar një «internacionale» dhe, me sa duket, kanë frikë se mos fraksionistët e partisë së tyre na bëjnë ndonjë letër edhe neve për «ç'ka ngjarë».

E këshillova Ramizin t'i inkurajojë shokët spanjollë dhe të jetë i kujdesshëm me ta.

E HËNË  
16 MARS 1981

## SHËNIME PËR ARTIKULLIN MBI KONGRESIN E 26-TË TË PK TË BS<sup>1</sup>

Konkluzionet të jenë direkte që të tregojnë qëndrimin luftarak dhe parimor marksist-leninist të Partisë sonë ndaj këtij kongresi renegatësh të marksizëm-leninizmit, të kësaj partie revizioniste, antimarksiste dhe kundër këtij shteti pseudosocialist, revizionist dhe imperialist.

Të gjitha sistemet borgjeze kapitaliste, revizioniste, antisocialiste, kudo ku janë dhe nën çdo formë që paraqiten, janë në krizë të plotë, të përgjithshme, të thellë dhe në të gjitha veprimet e jetës së tyre.

Çdo zgjidhje, përveç revolucionit, është e përkohshme. Revolucioni i armatosur i popujve kundër zgjedhës së kapitalit, i jep fund kësaj shoqërie borgjezo-kapitaliste të korruptuar deri në palcë.

Demagogjia, gënjeshtria dhe shantazhi kundër popujve predominojnë kudo në politikën e fuqive të mëdha imperialiste, borgjeze e revizioniste. Ngarjet e përditshme vërtetojnë se superfuqitë bëjnë ligjin mbi të tjerët, se multinacionalët dominojnë në ekonominë botërore.

Shtetet borgjeze, kapitaliste e revizioniste janë mby-

<sup>1</sup> «Kongresi i revizionistëve sovjetikë — kongres i demagogjisë sociale e pacifiste». «Zëri i popullit», 18 mars 1981.

tur në borxhe deri në fyt. Më të pasurit sundojnë dhe mbajnë të lidhur me zinxhirët e tyre më të varfrit. Shtetet dhe popujt e botës, të mbytur në borxhe dhe në pamundësi për të dalë nga ato, po i nënshtrohen gjithnjë e më shumë diktatit dhe arbitraritetit të fuqive të mëdha imperialiste, po humbasin pavarësinë morale, politike, sovranitetin e tyre kombëtar dhe po hedhin vallen me litar në grykë në vorbullën e krizës së madhe botërore.

Jeta e masave punonjëse në vendet kapitaliste e revizioniste po bëhet gjithnjë e më e shtrenjtë. Çmimet e mallrave të konsumit të gjerë po rriten nga dita në ditë dhe asnjë shenjë nuk po duket se kur ata do ta ndalin vrapin. Papunësia dhe inflacioni po rriten në mënyrë të papërmbajtur. Borxheve të vjetra u shtohen borxhet e reja, zinxhirët e neokolonializmit trashen. Ata që sundojnë vendin dhe popullin, borxhet që marrin, i përdorin për të blerë armë, nën pretekstin për të balancuar gjoja fuqinë ushtarake të superfuqive dhe për të dhënë përshtypjen se vendet e vogla janë të pavarura e armatosen për të ruajtur gjoja independencën e tyre.

Koha vërtetoi se «bota e tretë», «bota e paangazhuar» dhe të tjera përralla të këtij lloji kanë qenë sfumatura demagogjike dhe thjesht mashtrim. Çarmatimi, premtimet për paqe e siguri të Helsinkit, «të drejtat e njeriut», pelegrinazhet e papës polak e të tjera, të gjitha këto janë gënjeshtria dhe opium për popujt që vuajnë nën thundrën e shtypjes imperialiste. Njëkohësisht ato janë një etiketë për klikat sunduese borgjeze, të lyera me çdo ngjyrë, për të ruajtur fuqinë e tyre mbi popujt dhe për ta vënë këtë fuqi në shërbim të fuqisë më të madhe që paguan më shumë.

Ata që zbatojnë prej dekadash këtë politikë të mbrapshtë e skllavëruese e cilësojnë atë të zgjuar, të zhdërvjellët. Shtypi kapitalist botëror merret gjerësisht

me ta, i reklamon e i shndërron në engjëj të paqes dhe shpëtimtarë të botës. Një ingranazh i tmerrshëm intri-gash, komplotesh e gënjeshtresh është vendosur në shka-llë botërore, për të bërë të bardhën të zezë dhe të zezën të bardhë.

Grevat e revoltat e punëtorëve po devijohen e mani-pulohen nga oportunistët e reaksioni. Fuqitë imperialiste dhe neokolonialiste përpiqen t'i largojnë luftërat nacio-nalçlirimtare nga qëllimet e vërteta të tyre dhe t'i kthej-në në luftëra lokale për interesat e vet, duke nxitur e përgatitur kështu luftë botërore.

Ata edhe duan të rindajnë botën, edhe kanë frikë nga lufta atomike, edhe armatosin veten dhe të tjerët. Të gjitha këto përgatitje e veprime shoqërohen me shan-tazhe e kërcënime pa dallim ndaj aleatëve dhe joaleatëve, me frikën e luftës, me allishverishe të qelbura, me ko-rupsione dhe degjenerim.

Bota duhet të ndryshojë, imperializmi sovjeta-ame-rikan duhet të përmbysset, kapitalizmi botëror dhe sho-qëria e tij duhet të shkatërrohen dhe të zëvendësohen me shoqërinë e re socialiste të vërtetë që është pjellë vetëm e një revolucioni të papërkulur, që me sakrificat dhe me luftë do të shpërthejë në çdo vend ku janë pjekur, ose duhet të bëhet çdo gjë që të piqen kushtet. Ky është shpëtimi i njerëzimit. Shumë veta këtë mund ta quajnë utopi, por Marksi dhe Lenini nuk janë uto-pistë.

E MARTË  
24 MARS 1981

## SHËNIM

Sipas agjencisë HSINHUA, ish-presidenti amerikan Ford, me detyrën e të ngarkuarit të posaçëm të presi-dentit Regan, arriti dje në Pekin për një vizitë 6-ditëshe në Kinë. Me këtë rast Fordi ka sjellë edhe një mesazh personal të Reganit për Ten Hsiao Pinin.

Po forcohen e po zgjerohen lidhjet e miqësisë ame-rikano-kineze, po vihet mirë në funksionim «ura e mi-qësisë Pekin—San-Francisko».

## ATENTAT KUNDËR REGANIT

Agjencitë e lajmeve njoftojnë sot me bujë të madhe për një atentat që është bërë në Uashington kundër presidentit Regan. Regani, zëdhënësi dhe dy agjentë të sigurimit të tij qenkan plagosur. Atentatori është zënë.

Zhurme e madhe. Mos po përsëritet historia e presidentit Kenedi? Cilat monopole e forca të brendshme të interesuara ndodhen pas këtij atentati? Të presim e të shikojmë!

## DEMONSTRATA TË FUQISHME POLITIKE NË KOSOVË

Nga njoftimet që japin agjencitë e huaja të lajmeve, mësojmë se në Kosovë shpërthyen sot demonstrata të fuqishme veçanërisht nga studentët shqiptarë të Universitetit të Prishtinës. Siç thonë këto agjenci, gjatë përlëshjeve me policinë pati një ose dy të vrarë. Të plagosurit nga studentët dhe nga policia janë shumë. Thuhet, gjithashtu, se u arrestuan me dhjetëra studentë dhe se ata po torturohen.

Demonstrata janë bërë dy herë gjatë dhjetëditorit të fundit të muajit mars dhe të dy herët ato janë shpërndarë me dhunë. Herën e parë udhëheqja jugosllave nuk bëri fjalë, herën e dytë shpërtheu kundër demonstruesve me akuza shpifarake e me epitete nga më të ndryshmet, si dhe me dhunë rankoviçiane, si qëmoti.

Thuhet se studentët janë ankuar kundër gjendjes së mjeruar ushqimore në mensat e konvikteve të universitetit, si dhe të lënies pas dore të ekonomisë së Kosovës. Por, siç po duken punët, demonstrata ka marrë karakter politik. Në fakt, siç thuhet, studentët thërritnin: «Duam liri», «Duam Kosova të bëhet republikë».

## ACAROHET GJENDJA NË KOSOVË

Në Kosovë po acarohet gjendja. Rriten përlëshjet e studentëve me policinë. Është shpallur gjendja e shtet-rrethimit.

PËRLESHJE TË REJA E TË FUQISHME  
NË QYTETET E KOSOVËS

Siç bëjnë të ditur agjencitë e lajmeve, në Prishtinë e në Podujevë, dje dhe sot, studentët, me të cilët janë bashkuar edhe punëtorë, shpërthyen në demonstrata dhe përlëshje të tjera, më të furishme se të parat. Situata është bërë shumë e nderë. Autoritetet jugosllave Prishtinën e kanë rrethuar me tanke. Në Kosovë kanë ardhur nga Beogradi forca të mëdha policie dhe të milicisë serbe.

Është shpallur gjendja e shtetrrrethimit, është ndaluar qarkullimi me grupe dhe filluan llogjet e lakenjve titistë, që nga Fadil Hoxha, Xhavit Nimani, Asllan Fazllija e të tjerë. Ç'nuk thanë ata kundër demonstruesve, përdorën të gjitha fjalët që përmban fjalori titist, bënë akuzat më të ndyra: «Nacionalistë shqiptarë», «irredentistë», «informbyroistë», «agjentë të imperializmit», «ballistë» etj.

Pas të sharave dhe akuzave kundër studentëve shqiptarë, hosanara për Titon, për titizmin, për vetad-ministrimin dhe për «fitoret e Kosovës». Pas hosanarave për titizmin, premtime mashtruese «do të bëjmë këtë», «do të bëjmë atë», «ka vështirësi, po fajin e ka kriza botërore» etj. Më në fund arrestimet e shumta dhe kërcënime për raprezalje akoma më të mëdha.

Është e qartë, kosovarët janë të shtypur, të mje-

ruar, janë gjakosur nga serbomëdhenjtë dhe nga titizmi. Tani, siç duket, kanë gënjatur se u mbush kupa dhe se ishte momenti i volitshëm që të kërkonin të drejtat që u janë mohuar. Sa dëgjojmë e mësojmë nga informacionet e agjencive të huaja të lajmeve, radiot e televizioni i huaj, pse ne nuk kemi fare gisht në këtë punë, në këtë çështje ka pasur organizim të dobët, por edhe elementë të huaj që kanë manipuluar. Nuk ekskludohet edhe agjentura e jashtme, por, në analizë të fundit, mendoj se këtyre, në këto momente, nuk u intereson edhe aq turbullira, sidomos në Jugosllavi.

Arsyet e vërteta duhen kërkuar e gjetur në faktorin e brendshëm, në vetadministrimin që dështoi, në borxhet e mëdha, në ngritjen e çmimeve, në inflacionin, në papunësinë, në mjerimin e masave, si dhe në problemet nacionale që janë zgjidhur në mënyrën më shoviniste nga titizmi. Të gjitha këto të këqija rëndojnë më shumë në kurriz të shqiptarëve që jetojnë në trojet e veta në Jugosllavi. Nuk mund të përjashtohet edhe manipulimi i agjunkturës serbomadhe kundër vetë sistemit, i separatistëve kroatë etj., që gjetën terrenin e Kosovës si hallkën më të dobët të Federatës Jugosllave.

Sidoqoftë, kjo që ngjau në Kosovë ishte një grusht i rëndë për titistët që duan t'i japin botës përshtypjen se «në Jugosllavi çdo gjë është zgjidhur drejt» — çështja nacionale, socializmi, demokracia, stabiliteti etj., etj.

Gjithë sistemi i tyre mban erë...

**E SHTUNË  
4 PRILL 1981**

## **TITISTËT SILLEN EGËR ME DEMONSTRUESIT KOSOVARË**

Dje në mëngjes, më 3 prill, u kthyem nga Vlora me Nexhmijen dhe me fëmijët.

Ngjarjet në Kosovë më kanë preokupuar e më kanë shqetësuar shumë, pse titistët e poshtër jugosllavë, sipas lajmeve të agjencive, kanë sulmuar me mjetet më të egra popullin dhe studentët që në mënyrë paqësore kërkonin përmirësimin e konditave të tyre të jetesës dhe statusin e republikës për Kosovën në kuadrin e Federatës Jugosllave.

## BYROJA POLITIKE DISKUTON MBI NGJARJET NË KOSOVË

Thirra mbledhjen e Byrosë Politike, ku diskutuam mbi ngjarjet e ditëve të fundit në Kosovë dhe masat që duhet të marrim ne. Të gjithë shokët ishin plotësisht dakord me propozimin që bëra për të shkruar një artikull<sup>1</sup> të rreptë kundër dhunës së serbomëdhenjve jugosllavë ndaj popullit e studentëve kosovarë, si dhe me tezat që kisha përgatitur për të.

Vendosëm që artikulli të botohet sa më parë. I dhashë Ramizit disa teza.

<sup>1</sup> «Pse u përdor dhuna policore dhe tanket kundër shqiptarëve në Kosovë?». «Zëri i popullit», 8 prill 1981.

## ÇFARË POHON E ÇFARË MOHON ZOTI DRAGOSAVAC

### Shënime<sup>1</sup>

Zoti Dushan Dragosavac, ju, në fjalimin tuaj, që mbajtët më datën 3 prill, drejt thoni në një vend:

«Përvoja ka treguar se vazhdimisht kemi pasur dëme kur i kemi lënë pas dore momentet që paraqiteshin për ne si historike».

Kjo këshillë «e vlefshme» që jepni ju, nuk është me vend vetëm për udhëheqjen e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, por është një kujtesë edhe për Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë, nuk është një rekomandim vetëm për popullin serb, por edhe për popullin shqiptar që jeton në trojet e veta në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë.

Por ne dëshirojmë të theksojmë, me këtë rast, se ju asgjë nuk keni lënë në harresë dhe historinë nuk keni dashur ta shikoni ashtu si duhej shikuar, që e kaluara e hidhur të mos përsëritej.

Zoti Dushan Dragosavac, po në këtë fjalim ju thoni edhe këto:

<sup>1</sup> Këto shënime autori i ka përfshirë në artikullin «Pse u përdor dhuna policore dhe tanket kundër shqiptarëve në Kosovë?». «Zëri i popullit», 8 prill 1981.

«Ne kemi zgjidhur në mënyrën më të mirë të mundshme çështjen e kombësive të republikave kombëtare dhe, në kuadrin e Republikës Socialiste të Serbisë, çështjen e krahinave autonome».

Ky pohim juaji tregon se, edhe pas Luftës Nacionalçlirimtare të popujve të Jugosllavisë, historia e vjetër nuk u harrua; Kosova mbeti «një krahinë autonome» e Republikës Socialiste të Serbisë dhe popullsia shqiptare kompakte, si nga kombësia, ashtu edhe nga territori, u nda në mes tri republikave të Federatës Jugosllave. Pse u bë kjo kështu, ju bie ta shpjegoni ideologjikisht, politikisht, gjeografikisht dhe ekonomikisht. Po të bëhej një analizë e tillë, atëherë mund të gjykohej se sa vlerë kanë afirmimet tuaja kur thoni:

«Ne kemi zgjidhur në mënyrën më të mirë të mundshme çështjet e kombësive dhe të republikave kombëtare».

Zoti Dragosavac, në vazhdim të pikëpamjeve tuaja, se gjoja i keni zgjidhur drejt çështjet e kombësive, ju në fjalimin tuaj vazhdoni të thoni edhe këto:

«Megjithatë, do të ishte iluzion të mendohej se këtë e kemi zgjidhur në mënyrë të qëndrueshme dhe të përsosur dhe se nuk do të ketë probleme ndërnacionale».

Qartë, ju pohoni se «nuk e keni zgjidhur në mënyrë të qëndrueshme dhe të përsosur» këtë problem kaq të koklavitur të kombësive. Atëherë duhet të dilet me konkluzionin se nga popujt që përbëjnë Jugosllavinë duhet të bëhen përpjekje që këto probleme të përsosen. Pra, u përket popujve të Jugosllavisë që t'i zgjidhin e t'i përsosin këto demokratikisht, brenda kuadrit të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.

Konkretisht: popullsia dërrmuese shqiptare që jeton në Kosovë dhe në republika të tjera të Jugosllavisë, kërkoi brenda normave, por edhe në rrugë, që krahina e

Kosovës të çlirohet nga tutela e Republikës Socialiste të Serbisë, ajo kërkoi t'i njihet statusi i një republike brenda Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.

Ç'krim bëri populli i Kosovës me këtë kërkesë, ashtu siç e cilësuan udhëheqja e Federatës Socialiste të Jugosllavisë dhe disa udhëheqës kryesorë të krahinës së Kosovës? Ne gjykojmë se ajo s'bëri asnjë krim. Përkundrazi, konstatojmë se këto kërkesa të ligjshme janë nënvlerësuar, janë quajtur armiqësore dhe u arrit në demonstratat që u zhvilluan.

Asnjëherë populli shqiptar i Kosovës nuk është lejuar të shprehet lirisht dhe në mënyrë demokratike mbi statusin që duhej të kishte, brenda ligjeve dhe kushtetutës jugosllave, krahina ku ai banon. Persona të tjerë kanë vendosur për këtë dhe, pas shumë kërkesave paqësore, kur ai kërkoi me zë të lartë që të dëgjonin popujt vëllezër të Jugosllavisë se Kosova kërkonte statusin e një republike brenda kuadrit të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, ata që bënë veshin e shurdhër, s'ngurruan të sulmonin me tanke dhe të qëllonin mbi shqiptarët. Jo vetëm kaq, por studentët trima kosovarë i akuzuan se gjoja vepruan si gangsterët e Çikagos dhe vunë përpara kalamanët e vegjël. Këto zakone të ndyra mund të jenë cilësi të të tjerëve, por kurrë të shqiptarëve që kanë luftuar dhe luftojnë me pallën sheshit. Një thënie e tillë e shtypit jugosllav vërteton qartë të kundërtën, se demonstratat ishin popullore dhe paqësore. Ajo, po ashtu, të lë të kuptosh se, po të mos ishin turma nxënësish, policia serbe do t'i kishte grirë me mitraloza. Këto nuk harrohen kollaj dhe nuk tregojnë forcën, por dobësinë, nuk tregojnë pjekurinë, por hutimin.

Duhet gjykuar çështjet me objektivitet dhe me drejtësi dhe jo të arrihet derisa të shtyhen gjithë popujt e Jugosllavisë, me të gjitha udhëheqjet e çdo rangu në

krye, të sulmojnë, të shajnë, të rrahin, të vrasin, të gjytojne dhe të burgosin lulen më të bukur dhe trimë, rininë shqiptare të Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare.

Nuk është as në nderin dhe as në interesin e Jugosllavisë që të derdhen mbi Kosovë gjysma e policisë serbe dhe e milicisë së Beogradit, të armatosura deri në dhëmbë, të rrethojnë qytetet e Kosovës me tanke, të mbulojnë qiejt me avionë dhe të mbushin aerodromet me parashutistë.

Jo, kjo s'duhej të ngjiste. Ne e dënojmë rëndë këtë dhunë të pashembullt në Kosovë. Shkaktarët e vërtetë të situatave duhet të gjenden, por këta nuk janë në Kosovë, as në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë, siç nuk mungohet të bëhen aluzione dhe nënkuptime. Ata duhet të kërkohen e të gjenden më thellë, më lart, në arsyet subjektive dhe objektive.

Të kërkosh të frikësosh një popull me epitete monstruoze dhe me tanke, siç po veprohet me shqiptarët që jetojnë në trojet e veta në Jugosllavi, nuk mund t'i arrihet kurrë qëllimit. Me shqiptarët e Kosovës, të Maqedonisë, të Malit të Zi dhe me ata që kanë shkuar në emigracion nga mjerimi dhe papunësia, duhet biseduar shtruar, me qetësi, me arsye e jo me paragjykime të këqija, dhe të kenë të gjitha të drejtat dhe barazi të plota brenda kushtetutës së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.

Çdo propozim, çdo kërkesë, çdo pretendim i drejtë i shqiptarëve, që jetojnë në Jugosllavi, por që nuk u pëlqejnë dhe u prishin rehatinë udhëheqjes federale dhe asaj krahinore, kualifikohen pa hezitim «armiqësore, shoviniste shqiptare, irredentiste» etj. Çdo gjë, çdo protestë kundër padrejtësive që u janë bërë dhe po u bëhen shqiptarëve që jetojnë në tokat e veta në Jugosllavi,

dhe ato s'janë as të pakta dhe as të vogla, futen në këto kanale ofenduese.

Ç'do të thotë në gojën e jugosllavëve epiteti armiqësor «nacionalistë»? Fjala nacionalist vjen nga fjala nacion, që do të thotë komb, kombësi. Çdo diksioner, i vogël ose i madh, e shpjegon qartë këtë nocion. Fjalën nacion-nacionalitet, që do të thotë komb-kombësi, jugosllavët e mbajnë në gojë e në letër, të shkruar të zezë mbi të bardhë.

Kur një kombi përpiqesh t'ia mohosh kombësinë, sovranitetin dhe të gjitha atributet që rrjedhin prej tyre, atëherë fjalët që lëshon janë vetëm demagogji dhe shkaktojnë e krijojnë fërkime që mund të çojnë edhe në konfrontime të padëshirueshme e të rrezikshme.

Në qoftë se një populli përpiqesh t'ia shtypësh dhe t'ia zhdukësh traditat dhe aspiratat nacionale, atëherë do të hasësh patjetër në një reaksion vetëmbrojtës.

Vetëm marksizëm-leninizmi dhe socializmi shkencor, sipas teorisë së Marksit, Leninit dhe Stalinit, i zgjidh drejt këto probleme.

Në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe posaçërisht në Republikën Socialiste të Bosnjë-Hercegovinës e në Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës dhe kudo ku jetojnë shqiptarët, është shkuar deri atje sa të krijohet një «kombësi myslimane». «Kombësia myslimane» është një specifike e Jugosllavisë, por, për çudi në Jugosllavi nuk ka «kombësi kristiane ortodokse» dhe as «kombësi katolike romane»! Për këtë s'duhën shpjegime, ajo shpjegohet lehtë.

Është e qartë pse Dobrivoje Vidiçi, kryetar i Republikës Socialiste të Serbisë dhe anëtar i Kryesisë së Komitetit Qendror të Lidhjes Komuniste të Serbisë, pasi hodhi vrerin dhe mërinë më të madhe mbi Kosovën, foli

«veçanërisht mbi marrëdhëniet e barazisë së plotë në marrjen e vendimeve mbi të gjitha çështjet me rëndësi shoqërore në kuadrin e Republikës Socialiste të Serbisë, në të cilën krahinat socialiste autonome kanë pavarësi të plotë të garantuar dhe të përcaktuar në dokumentet kushtetuese të Republikës Socialiste të Serbisë dhe të Krahinës Socialiste Autonome». (Autonomi «e plotë» nën tutelë.)

Është kuptimplotë se çdo veprim i shqiptarëve të Kosovës, brenda kushtetutës dhe ligjeve të Federatës, por që nuk i vjen pas qejfit udhëheqjes, cilësohet menjëherë «shoviniste shqiptare» dhe, për t'i futur në burgje e në kampe përqendrimi, njerëzit cilësohen fare lehtë si «irredentistë». Të akuzosh për irredentizëm një popull dhe një komb të tërë, prej më shumë se 2 milionë banorësh, siç është pjesa e kombit shqiptar që jeton në trojet e veta në Jugosllavi, duhet të mos kesh qenë e të mos jesh vetë irredentist dhe të kesh zhdukur të gjitha shkaqet dhe burimet e kësaj doktrine, shkaqe që janë pjellë e imperialistëve dhe e feudo-borgjezisë së vjetër ballkanike. Në qoftë se pas luftës nacionalçlirimtare është zbatuar parimi i vetëvendosjes së popujve, atëherë pse duhet të ketë irredentizëm?

Më parë se të flitet për të ashtuquajturin irredentizëm, duhet të shpjegohet prapambetja ekonomiko-kulturore, inflacioni, papunësia në masë dhe emigracioni i detyruar i shqiptarëve, një nga emigracionet më të mëdha të Jugosllavisë në vendet e huaja. Ky problem i madh nuk zgjidhet drejt dhe nuk shpjegohet vetëm me «krizën botërore», siç duan ta shpjegojnë disa udhëheqës jugosllavë, gjoja teoricienë të Federatës Socialiste Jugosllave dhe të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës.

Për sa i përket shovinizmit, karakteri i shqiptarit dhe historia e tij në shekuj tregojnë të kundërtën e asaj për të cilën ju akuzoni shqiptarët e Jugosllavisë, pse shqiptari asnjëherë s'ka shtypur dhe s'ka shfrytëzuar asnjë popull. Kurrë ai nuk ka sulmuar dhe copëtuar tokat e popujve të tjerë. E kundërta ka ngjarë ndaj tyre. Prandaj shovinizmin kërkojeni se do ta gjeni gjetiu dhe jo te shqiptarët e Kosovës dhe as tek ata të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë që përbëjnë një popull. Shovinizmin kërkojeni pikërisht tek ata udhëheqës jugosllavë që urdhëruan sulmin me tanke e me policë serbë dhe vranë, gjakosën, torturuan dhe burgosën studentë, punëtorë dhe fshatarë shqiptarë, nipërit dhe mbesat e heronjve të popullit tonë, Isa Boletinit, Bajram Currit, Abdyl dhe Naim Frashërit, Sulejman Vokshit, Ymer Prizrenit, Azem e Shote Galicës, Çerçiz Topullit e Selam Salarisë, vëllezërve dhe bashkëluftëtarëve të Hajdar Dushit, Hysni Kapos, Miladin Popoviçit, Emin Durakut dhe mijërave partizanë heroikë shqiptarë, malazez dhe maqedonas që luftuan së toku si vëllezër dhe derdhën gjakun e tyre në Jugosllavi për lirinë, pavarësinë dhe vetëvendosjen e popujve të Jugosllavisë. Këto akte brutale dhe të përgjakshme përbëjnë shovinizmin më të egër.

Mos vallë ju dëshironi që shqiptari të mos jetë patriot? Jo, kjo s'do të ngjasë kurrë! Shqiptari kurdoherë është mbrojtur me heroizëm dhe i ka mundur armiqtë e tij, pse gjithnjë ka qenë në të drejtën e vet. Shqiptari kudo që jeton, punon dhe lufton, tregon kurdoherë pjekuri dhe durim. Historia shekullore e shqiptarëve dhe ajo e kohës së Luftës Nacionalçlirimtare kanë vërtetuar se populli ynë ka derdhur gjakun e bijve dhe bijave të tij për t'u ardhur në ndihmë edhe popujve vëllezër fqinjë. Këtë shpirt të lartë sakrifice dhe internacionaliste ju e quani shoviniste. Gjënë më të vogël që mund të themi,

kjo është paturpësi dhe asnjëri të mos harrojë se vërtet populli shqiptar është i durueshëm, por ama kur i shkelen të drejtat dhe kur zemërohet shqiptari, merr zjarr e flakë edhe stralli.

Për këto probleme ne mendojmë se udhëheqja jugosllave duhet të jetë shumë e matur, të tregohet e pjekur, gjakftohtë dhe t'i studiojë e t'i zgjidhë drejt problemet e saj të brendshme dhe jo t'u japë mësim me bollëk të tjerëve «për moderacion, për zgjidhje paqësore, për të drejtat e njeriut dhe të popujve» e të tjera.

Ne mendojmë se duhen ulur gjakrat, nga udhëheqësit jugosllavë në radhë të parë, dhe çështjet e shqiptarëve që jetojnë në trojet e tyre në Jugosllavi të studiohen me gjakftohtësi, me urtësi e drejtësi. Po u veprua ndryshe, nuk shërohet plaga, përkundrazi, do të thellohet hendeku. Ne nuk duam të ngjasë kjo dhe jemi gati të ndihmojmë me të gjitha forcat tona të pastra e fisnike, të zemrës dhe të mendjes, për të ruajtur miqësinë me popujt vëllezër të Jugosllavisë, për të ruajtur marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë që janë vendosur dhe të ndihmojmë si edhe më parë vëllezërit tanë shqiptarë në çështjet tregtare dhe të shkëmbimeve kulturore, siç i bëjmë edhe me popujt e tjerë të Jugosllavisë, malazez, maqedonas etj., në bazë të marrëveshjeve të vendosura bashkërisht në mes Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.

Këtë e do interesi i të dy shteteve tona, e do miqësia, fqinjësia e mirë, pa ndërhyrë në asnjë moment në punët e brendshme të njëri-tjetrit.

Në rast se ne shfaqim mendimet tona për çka ngjau në Kosovë, kjo nuk do të thotë se jemi ne shkaktarët apo nxitësit e atyre ngjarjeve që po ndodhin atje. Ne

e kemi thënë dhe po e themi se do të interesohemi për vëllezërit tanë shqiptarë që jetojnë në trojet e tyre në Jugosllavi, do t'i mbrojmë ata, siç i kemi mbrojtur, kur u bëhen padrejtësi dhe ligësi. Ashtu siç ka të drejtë Jugosllavia dhe çdo shtet tjetër të mbrojë dhe të kërkojë të drejtat për pakicat e veta nacionale, këtë të drejtë e kemi edhe ne. Traktati i Londrës, Traktati i Versajës dhe çdo traktat tjetër imperialist nuk kalon më mbi kurrizin e popullit shqiptar. Këtë ta kenë të qartë të gjithë, miq dhe armiq, shtete të vogla e të mëdha, imperialistë dhe revizionistë, shokë e vëllezër komunistë dhe njerëz përparimtarë, si dhe antikomunistët e pseudosocialistët.

E SHTUNË  
11 PRILL 1981

## SHQIPTARI NUK E KA DURUAR KURRË ROBËRINË

Armiqësia e serbëve është viserale<sup>1</sup> kundër shqiptarëve në përgjithësi dhe, veçanërisht, kundër shqiptarëve që banojnë në tokat e veta në Jugosllavinë e ish-kralëve serbë, të kralit Tito dhe të shovinistëve të tjerë që sundojnë atje pas tij.

Shqiptarët që banojnë në Jugosllavinë e krijuar nga traktatet antishqiptare të Londrës e të Versajës, kanë qenë dhe janë vazhdimisht të persektuar, nuk kanë liri. Asnjëherë ata nuk kanë vetëvendosur për fatin e tyre, bile as edhe pas luftës nacionalçlirimtare, pavarësisht se ç'pretendojnë titistët. Kufijtë e Jugosllavisë «së re» u vendosën në Bihaç, në mos gabohem, në mbledhjen e parë ose të dytë të AVNOJ-t dhe asnjë shqiptar nuk mori pjesë në këtë të ashtuquajtur mbledhje konstitucionale. Këta «kufij të rinj» ishin po ata të vjetrit, që i vendosi si deshi Klemansoi në Versajë. Pra, «vetëvendosja» e popujve të Jugosllavisë është një gënjeshtëri, pse pas çlirimit asnjë referendum nuk u bë, askush nuk u pyet. Çdo gjë ishte vendosur veçanërisht në dëm të interesave të shqiptarëve nga pseudomarksistët titistë, që nuk ishin veçse shovinistë dhe nacionalistë të tërbuar. Bile Kosova u caktua një krahinë e thjeshtë e Serbisë dhe u quajt Kosmet. Vonë, me një amendament në

<sup>1</sup> Nga frëngjishtja — e thellë dhe e paarsyeshme.

kushtetutën e RSFJ, ajo u quajt «Krahinë Autonome e RS të Serbisë».

Tokat shqiptare dhe shqiptarët etnikë në Jugosllavi u bënë, me tërë kuptimin e fjalës, plaçkë tregu: një pjesë u quajt «Krahina Autonome e Kosovës», një pjesë iu ngjiti Maqedonisë, e cila ndryshe as nuk do të kishte kuptim të quhej «RS e Maqedonisë», ndaj së cilës bullgarët kanë pretendime, ku banojnë edhe turq dhe grekë të ashtuquajtur maqedonas të Egjeut dhe pjesa e tretë e tokave shqiptare iu bashkua RS të Malit të Zi, që pa shqiptarët nuk ka as 400 mijë veta.

Kështu e ujdishën Federatën e tyre titistët jugosllavë. Stane Dolanci në një intervistë që u dha gazetarëve të huaj dhe atyre jugosllavë në Beograd në lidhje me ngjarjet në Kosovë<sup>1</sup>, dënoi, si një qen i tërbuar shovinist, shqiptarët e Kosovës, sulmoi kërkesat e drejta të kosovarëve që krahina e tyre të bëhet republikë duke thënë midis të tjerave se «Kosova nuk do të bëhet kurrë republikë», pse një gjë e tillë nuk është në interesin e Serbisë, se, po të shpallet ajo republikë, «shkatërrohet Federata» etj.

Nuk ka vërtetim më të mirë se ky për atë që Federata Jugosllave qëndron në këmbë mbi bazën e përdorimit si «monedhë tregu» të tokave shqiptare dhe të shqiptarëve. Me fjalë të tjera copëtimi i shqiptarëve mban «në këmbë» Federatën, kurse shpallja e Kosovës republikë «plagos Serbinë», bën inekzistuese RS të Maqedonisë dhe varfëron Malin e Zi. Sipas Dolancit, pra, Serbia e ka pushtuar Kosovën. Dolanci mendon se po të bëhet Kosova republikë do të ngjallen dëshirat e kroatëve, me «kombësi myslimane» etj., për hegjemoni në Bosnjë dhe Hercegovinë. Prandaj, sipas tij, më mirë të

<sup>1</sup> Anëtar i Kryesisë së KQ të LKJ. Intervistë e dhënë më 6 prill 1981, në Beograd.

këqijat le të vazhdojnë të bien mbi kurrizin e shqiptarëve.

Dolanci gënjeu në këtë intervistë kur, për të fshehur të vërtetën, tha se në Kosovë u vranë 11<sup>1</sup> veta. Sipas të dhënave të tjera deri tani janë vranë: në Prishtinë 150-200 veta, në Ferizaj 13, në Prizren 3 veta. Shumë të vranë ka në Lipjan, Obiliq (nxënës shkolle të mesme), Podujevë etj. Të plagosur ka boll, janë mbushur spitalet. Edhe burgjet po ashtu. Masakër, gjenocid i vërtetë ndaj shqiptarëve nga policia dhe ushtria serbe. Por kjo nuk do të kalojë lehtë, siç mendojnë armiqtë jugosllavë, vrasësit e vëllezërve tanë kosovarë.

Këtë problem jetik ne do ta studiojmë thellë dhe do të nxjerrim edhe pasojat.

Sido që ne nuk kemi gisht në këto demonstrata, ne do t'i mbrojmë vëllezërit tanë kosovarë deri në fund, në të drejtat e tyre dhe tonat të përbashkëta. Shqiptari nuk e duron robërinë, ai e di dhe e ka provuar se liria fitohet me gjak dhe me luftë.

Lavdi studentëve, punëtorëve, rinisë dhe gjithë popullit shqiptar që jetojnë në trojet e veta në Jugosllavinë titiste, që i treguan grushtin e hekurt armikut. Le të dridhen titistët, «dy duart për një kokë» i kanë edhe shqiptarët. Ata kanë qenë shumë të durueshëm, shumë të sjellshëm. Ne derdhëm edhe gjakun tonë për çlirim e popujve të Jugosllavisë, kurse këta të na vënë pushkën!? Jo. Ky është kulmi i armiqësisë, i egërsisë, i shovinizmit serbo-titist.

1 9 demonstrues dhe 2 «anëtarë të sigurimit».

## PALESTINEZËT KUNDËRSHTOJNË TERRORIN IZRAELIT

Prej disa ditësh po lexojmë lajme të shumta rreth demonstratave të popullit palestinez kundër dhunës dhe terrorit që izraelitët ushtrojnë mbi të në tokat arabe të pushtuara, si dhe në qendrat e banuara palestineze në Libanin e Jugut. Kudo, sidomos në Cisjordani, rezistenca e forcave palestineze është e madhe.

Ndërkaq flitet për një desantim në masë të disa njësisive të posaçme izraelite, që mbështeten edhe nga qitje të artilerisë së rëndë, në disa pika të rajonit veriperëndimor të Bejrutit, Nabatjeh, Tir etj. Po zhvillohen luftime. Ka të vranë e të plagosur. Izraelitët kanë pësuar dëme të mëdha.

Krahas veprimeve ushtarake, izraelitët vazhdojnë edhe shpronësimin e tokave e të pronave të familjeve palestineze për të ngritur në to fshatra të reja çifutësh.

Këto veprime çnjerëzore, ky terror i egër kundër palestinezëve ma shtojnë dhimbjen që ndiej këto ditë për vëllezërit kosovarë, të cilët i janë nënshtuar një terrori të egër nga ana e serbomëdhenjve titistë. Njëlloj si çifutët racistë të Tel-Avivit edhe titistët serbomëdhenj ushtrojnë dhunën e terrorin e paligjshëm dhe antinjëror kundër shqiptarëve të Kosovës vetëm sepse këta kërkojnë të drejtat e tyre politike e ekonomike në bazë e brenda kushtetutës së vetë Jugosllavisë. Por si izraelitët, ashtu edhe serbomëdhenjtë me këto veprime i bëjnë dëm vetëm vetes së tyre.

**E PREMTE**  
**17 PRILL 1981**

## **ARSYET E VËRTETA TË GJENDJES DHE TË NGJARJEVE TË KOHËVE TË FUNDIT NË JUGOSLLAVINË TITISTE**

**Panoramë<sup>1</sup>**

Stane Dolanci me kombësi sllovene, ku niveli i jetesës është nga më të lartët në Jugosllavi, në intervistën që u dha gazetarëve të huaj dhe atyre jugosllavë në Beograd në lidhje me ngjarjet në Kosovë, mund të themi se nuk e përmendi fare gjendjen e rëndë ekonomike të kësaj krahine. Ai jo vetëm duhej ta kishte përmendur këtë, por edhe duhej të kishte analizuar për ç'arsye Sllovenia, Kroacia dhe Serbia kanë një nivel aq të lartë, kurse Kosova aq të ulët.

A është toka e Sllovenisë, e Kroacisë ose e Serbisë më pjellore se ajo e Kosovës? Po nëntoka e Kosovës nuk është vallë më e pasur se çdo nëntokë tjetër e cilëndo republikë jugosllave?

A nuk e di zoti Dolanci se çështjet ekonomike luajnë rolin vendimtar në ekzistencën e shteteve dhe të popujve? A nuk determinojnë këto çështje në politikën e mirë apo të keqe të brendshme dhe të jashtme të një

<sup>1</sup> Këtë material autori e ka përdorur në artikullin me titull «Kush e nxit armiqësinë midis popujve të Jugosllavisë?». («Zëri i popullit», 23 prill 1981.)

vendi? Pse nuk u mor mundimi të shpjegoheshin këto probleme kapitale?

Është lehtë të shpjegohen këto çështje primordiale me sharje politike dhe ideologjike, se «shqiptarët u treguan kundërrevolucionarë, shovinistë, irredentistë».

Këto të dytat nuk i shpjegojnë të parat, ndërsa të parat mund të shkaktojnë edhe të dytat.

Si mundet në një vend si Jugosllavia, ku predikohet «barazia në të drejta politike dhe ekonomike», «bashkim-vëllazërimi», në realitet të ekzistojë diskriminimi dhe pabarazia në këto të drejta bazë? Si mundet që një republikë apo krahinë të trajtohet si «djali i nënës» dhe krahina tjetër si i «njerkes», që të ketë një vëlla që ha me lugë të artë, kurse tjetri me një lugë të vogël prej druri? Kjo nuk tregon as «bashkim», as «vëllazërim».

«Në të mira dhe në vështirësi të gjendemi të një-llojtë». Kjo ishte dhe është parulla e revizionistëve jugosllavë. Por kështu nuk ngjet as në Jugosllavinë e Titos, dhe nuk ngjet as në atë pas Titos.

Kujt i bie faji për këtë gjendje reale? Artikullit të «Zërit të popullit»<sup>1</sup> që shprehu mendimin e vet si gjithë shtypi botëror, i cili dënoi udhëheqjen jugosllave për represionin barbar të ushtruar kundër shqiptarëve të Kosovës?!

Shqipëria socialiste dhe gazeta «Zëri i popullit», edhe më parë se të tjerët, kanë të drejtën të thonë fjalën e tyre për vrasjet dhe torturat e egra që u bënë nga UDB-ja dhe ushtria serbe kundër shqiptarëve të Koso-

<sup>1</sup> «Pse u përdor dhuna policore dhe tanket kundër shqiptarëve në Kosovë?», Shih: «Zëri i popullit», 8 prill 1981.

vës. Dhe nuk është hera e parë që bëhet një gjë e tillë. Historia nuk harrohet, ajo është e shkruar. *Scripta manent.*

Klithmat, të gërthiturat, epitetet, fshehja e së vërtetës nga personalitete «të mëdha» të Federatës dhe të republikave, histerizmat e shtypit serb, kroat, slloven etj., që arrijnë deri në akuza të përbindshme, sipas të cilave «Shqipëria socialiste ka gisht në demonstratat e Kosovës», se «Shqipëria socialiste u bashkua me reaksionin kroato-slloveno-shqiptar në emigracion», se «Shqipëria bashkohet me ato shtete që duan shpartallimin e Federatës Jugosllave» etj., etj., janë shpifje rrugaçësh. Sa të shumta dhe aq me zë të lartë të jenë këto britma, aq më mirë njerëzimi kupton se bëhen përpjekje të pashpresa që të mbulohet e vërteta. *Verba volant. Asgjë s'do të mbetet nga këto, se asgjë nuk është e vërtetë.*

Zoti Dolanci, në intervistën në fjalë, tha se «në demonstratat në Kosovë u vranë 11 veta». Një shërbëtor i tij shqiptar nga udhëheqja e Kosovës tha nëntë. Me sa duket për këtë çështje ata nuk patën kohë të merreshin vesh dhe të binin dakord. **Megjithatë, të gjithë gënijn opinionin botëror dhe atë jugosllav.** Shtypi i huaj flet për qindra të vrarë, qindra të humbur, të plagosur e të arrestuar në Kosovë. Këto i di mirë vetëm populli i Kosovës, pse gjaku i tij u derdh — pse u derdh dhe kush e bëri këtë gjëmë. **Ata, pra, nuk ishin as 9, as 11 veta, por me qindra të vrarë dhe, duke u thënë gazetarëve të huaj se kjo që ngjau ishte vepër e një grushti «shovinistësh», u mendua se u dhanë arsytet dhe u lanë duart.**

**Por e vërteta do të çajë muret e shtetrrethimit dhe të censurës jugosllave, që është vendosur në Kosovë dhe bota do të shohë ç'masakra masive u bënë atje nga ush-**

**tria dhe policia serbe, do të shohë mashtrimet që u bënë dhe do të njohë fytyrën e vërtetë të atij «socializmi vetadministrues» me fytyrë gjoja njerëzore dhe që «po i zgjidh problemet e jashtme botërore me aq mjeshtëri akrobatike dhe ato të brendshmet me aq drejtësi dhe tejpamësi shembullore — me tanke». Po i del kallaji kësaj gënjeshtre.**

Dolanci po ashtu tha se «i njohim cilët janë organizatorët. Ata janë në Shtutgart, në Bruksel dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës». Ai tha, po ashtu, se gjoja në demonstratë ishte një numër i vogël të gënjerish.

Kur zoti Dolanci i njihte organizatorët se ishin në Shtutgart e gjetkë nëpër Evropë, përse nuk i neutralizoi? Në rast se në demonstratë mori pjesë një numër i vogël njerëzish, atëherë pse u dërguan atje ushtria, milicia e Beogradit, tanket dhe avionët?

Vallë për «një kokërr ulli priset dasma», ajo «dasmë», për të cilën që tash «nga të katër skutat e Jugosllavisë vërshojnë si lumi i Danubit, Savës dhe Dravës telegramet plot indinjatë e zemërim kundër «shovinistëve dhe irredentistëve shqiptarë», dhe plot himne ditirambike për «unitetin e kombeve dhe të kombësive të Jugosllavisë»?

Kush e ndjell dhe e forcon armiqësinë në mes popujve të Jugosllavisë? Kjo fushatë e tërbuar që ka ngritur udhëheqja e Jugosllavisë, apo artikulli i natyrshëm, i drejtë dhe i matur i «Zërit të popullit», që vetë Dolanci gjatë konferencës së tij të shtypit, kur një gazetar i huaj e pyeti: «A ka gisht Shqipëria?», u përgjigj jo dhe shtoi se nga «Shqipëria nuk ka ardhur ndonjë protestë».

**Kjo vërteton se «fajtori» priste një protestë. Por Qeveria Shqiptare nuk bëri protestë zyrtare.**

A mos donte vallë udhëheqja jugosllave që shtypi shqiptar të heshtte për këtë tragjedi që ajo shkaktoi në Kosovë, kur gjithë shtypi botëror ka javë të tëra që po flet dhe dënon egërsinë e treguar?

Jo, zotërinj udhëheqës jugosllavë. Jini realistë, ruani gjakftohtësinë! Ç'po bëni ju për demonstruesit dhe grevistët e «Solidarnostit» në Poloni, ku deri tash kundër tyre nuk është hedhur as edhe një pushkë nga qeveria polake? Ju po flisni, ju po shkruani. Ju paskeni vetëm të drejtë të flisni e të shkruani dhe, kur ne botuam një artikull të drejtë për problemin e madh të Kosovës, ju u hodhët përpjetë, **por çfarë të hedhuri, saqë Radioja e Zagrebit arriti të kërcënojë dhe ekzistencën e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë!**

Zagrebi harron se Shqipëria di të mbrohet edhe pa Zagrebin. Duhet ta dijë ai se Jugosllavia, qoftë dhe ajo e Titos, në asnjë kohë nuk e ka ndihmuar çlirimin e Shqipërisë. Kurse Ushtria Nacionalçlirimtare Shqiptare e ka ndihmuar me gjak të derdhur çlirimin e popujve të Jugosllavisë dhe ne prapë do ta bëjmë këtë vepër sublime kur të rrezikohet Jugosllavia! **Ne s'i kemi fjalë këto, por vepra, kurse ju flisni dokrra dhe bëni kërcënime rrugaçësh.**

A harruat ju, zotërinj udhëheqës jugosllavë, si luftuat në Konferencën e Parisit për Triesten, Pulën, Fiumen etj.? Të drejtë kishit. Ne nuk ju quajtëm as «shovinistë, as irredentistë». Por kur nuk ishit të tillë, pse nuk ju shkoi ndër mend që ekzistonte një popullatë shqiptare, e treta në Jugosllavi nga madhësia, e cila duhej të bashkohej me Shqipërinë, aleaten tuaj socialiste në Luftën Nacionalçlirimtare? Ju heshtët. Pse heshtët, kur na qenkeni kaq parimorë? Ju as statusin e krahinës

autonome nuk ia dhatë Kosovës deri në vitin 1968. Pse presidenti Tito nuk e realizoi atë që më tha mua në bisedimet zyrtare që patëm në vitin 1946 se «Kosova dhe viset e tjera të banuara nga shqiptarët i përkasin Shqipërisë dhe do t'jua kthejmë, por jo tash, se reaksioni serbomadhi nuk do ta pranonte një gjë të tillë».

Zoti Dolanci e shfaqti më hapur mendimin e tij «Kosova nuk do të bëhet kurrë republikë... pse këtë nuk e lejon Serbia».

**«Po të bëhet Kosova republikë në kuadrin e Federatës, tha Dolanci, atëherë u shkatërrua Federata».** Me fjalë të tjera, kjo do të thotë që viset e Shqipërisë janë bërë plaçkë tregu dhe njëkohësisht janë «kyçi i murit» që mban Federatën në këmbë. I çuditshëm mendim!

**Këtë nuk e themi ne, e tha Dolanci. «Republikën e Kosovës» brenda Federatës Jugosllave nuk e kërkuam ne, e kërkoi populli i Kosovës.**

Rivendikime territoriale nga ana e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë nuk janë bërë. Nuk mund të gjesh një kërkesë të tillë në asnjë dokument, por dokumente për të mbrojtur të drejtat e vëllezërve kosovarë dhe të shqiptarëve që banojnë në tokat e veta në republikat e tjera të Jugosllavisë, të drejta që ua njeh kushtetuta dhe që u janë shkelur dhe po u shkelen, do të gjesh boll, në të kaluarën dhe në të sotmen. Dhe varet nga politika e qeverisë jugosllave ndaj shqiptarëve nëse do të ketë ose jo në të ardhmen.

Jugosllavët kanë protestuar edhe për tabelat e dyqaneve, «përse nuk shkruhen në serbisht» kur është fjala për ndonjë vend ku ekziston një minoritet i tyre! Këtë bëri tani së fundi, në mes të tjerave, zoti Gjuranoviç në Austri në lidhje me minoritetin e vogël sloven

që ndodhet në Karinti. Ne nuk e akuzuam atë as si «kundërrevolucionar, as si irredentist, as si shovinist».

**Si mundet populli shqiptar të mos interesohet jo për tabelat e dyqaneve në Kosovë, por për vetë gjuhën shqipe, për shkollat, liritë dhe të drejtat e tyre, si të mos interesohet ai për vrasjet në masë, për burgosjet e torturat që u bëhen shqiptarëve në Jugosllavi? Për qeverinë jugosllave qenka normale që jugosllavët mbrojnë minoritetet e tyre jashtë republikës dhe që popullata ku jetojnë këto minoritete as grihet nga plumbat e mitralozave, as shtypet nga tanket, kurse për Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë qenka «shovinizëm, irredentizëm, kundërrevolucionare». Nga vjen, ku e ka vallë burimin kjo «alergji» e madhe antishqiptare e jugosllavëve?!**

**Gabohet udhëheqja jugosllave se gënjen njeri, e si domos opinionin botëror, se Shqipëria socialiste kërkon ose bën lojën e atyre që duan minimin e Federatës.**

Federatën e ka minuar vetë titizmi, kjo rrymë armiqësore e marksizëm-leninizmit, e ka minuar sistemi antisocialist i vetadministrimit, e kanë minuar borxhet e mëdha që kanë mbuluar popullin dhe kanë shkaktuar inflacionin, papunësinë e madhe, ngritjen e çmimeve, pabarazinë e zhvillimit, varfërinë.

**Kush thellohet në këto probleme kyç, do të dalë menjëherë në përfundimin se Shqipëria socialiste nuk është për minimin e Federatës, siç e shprehu Dolanci.**

Dolanci gabohet rëndë kur mendon të frenojë lakmitë serbe për hegjemoni përballë hegjemonisë kroato-slllovene, duke prerë me thikë se «Kosova nuk do të bëhet kurrë republikë». Haraç i këtij antagonizmi nuk duhet të bëhet Kosova.

Jugosllavët hiqen «politikanë të zgjuar», por tregohen jo vetëm naivë, por edhe të hutuar. Plaga dhe përçarja nuk qëndron në demonstratat e Prishtinës. Ato duhen kërkuar në udhëheqjen jugosllave, në shovinizmat e mëdhenj e të vjetër që ka krijuar sistemi i vjetër jugosllav dhe ai i riu i tyre antisocialist. Nuk mbahet shtëpia me miell hua. Këndej vjen ajo përçarje, e keqe të cilën ne nuk ia duam aspak popujve vëllezër të Jugosllavisë.

Politika pa parime e udhëheqjes jugosllave nuk të nxjerr në asnjë rrugë të drejtë.

Ne jemi zotër në shtëpinë tonë dhe bëjmë politikën që e gjejmë më të mirë e më të drejtë. Populli ynë na shikon, na gjykon, e mbron këtë politikë ose e dënon, në qoftë se është e gabuar. Por faktet, jeta, puna tregojnë se populli shqiptar e mbështet me të gjitha forcat vijën e drejtë të Partisë dhe të pushtetit të tij.

Revizionistët jugosllavë ne na quajnë stalinistë, dogmatistë, informbyroistë e me të tjera epitete. Malet tona më të larta! Jemi stalinistë, marksistë-leninistë.

Edhe popujt e Jugosllavisë bëjnë politikën e tyre. Udhëheqësit jugosllavë, po ashtu, bëjnë politikën e tyre. Dhe ne kemi të drejtë të gjykojmë e të dënojmë ideologjinë e tyre, të gjykojmë politikën e tyre. Por ne nuk mund të lëmë pa u thënë popujve të Jugosllavisë dhe gjithë atyre udhëheqësve jugosllavë që arsyetojnë se «Është populli shqiptar që jeton në Jugosllavi ai që mund të prishë stabilitetin dhe ekuilibrin e Federatës, pse kërkon t'i njihet statusi i republikës brenda Federatës», se nuk duhet të sillen keq ndaj shqiptarëve që jetojnë në Jugosllavi. Shqiptarët janë luftëtarë trima që kanë të drejtë të luftojnë për lirinë e tyre dhe për atë të popujve vëllezër jugosllavë, në rast se këta sulmohen nga revizionistët agresorë sovjetiko-bullgarë. Janë këta të

fundit dhe të tjerë si këta që rrezikojnë Jugosllavinë. Nga shqiptarët as i ka ardhur, as do t'i vijë ndonjë e keqe Jugosllavisë.

**Prandaj udhëheqja jugosllave të tregohet shumë gjakftohtë dhe shumë e drejtë ndaj shqiptarëve. T'u vërë fre akteve barbare kundër tyre, të dënojë rreptë ata që dhanë urdhra dhe qëlluan mbi masat e shqiptarëve, të stabilizojë gjendjen shpirtërore, politike dhe të ndalojë kasnecët serbo-kroato-slovenë dhe lakenjtë e tyre shqiptarë në Kosovë që të shpifin dhe të sulmojnë Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe popullin shqiptar.**

Në qoftë se vazhdohet kështu, siç po veprohet nga ju, asgjë e mirë nuk do të dalë. Ata udhëheqës shqiptarë në Kosovë, që sulmuan popullin, le t'i gjykojë ky vetë.

Populli shqiptar, që jeton në trojet e veta në Jugosllavi, di të dallojë shërbëtorët nga djemtë dhe bijtë e tij të ndershëm dhe janë të kota përpjekjet që bëhen për t'i komprometuar, duke i detyruar të flasin e të dërgojnë telegrame për konsum, të përgatitura në oficinat e UDB-së, që përgjojnë deri nëpër shtëpi e nëpër familje. «Liri» dhe «demokraci» e bukur «vetadministruese»!

**Ne duam që çdo gjë të normalizohet dhe i themi kasnecit ustash të Radio Zagrebit që «është e vërtetë se historia do të gjykojë se kush ka të drejtë», ju apo ne, shqiptarët.**

Sa për frikë s'janë shqiptarët që e njohin atë dhe nuk gjen në historinë e tyre barbarizma si të ustashëve, të vjetër e të rinj.

Në Beograd kanë filluar të dalin libra me tituj bombastikë, që bien erë megalomani dhe shovinizëm të

**pafrënuar me hapësira panballkanike, si «Lufta për Ballkanin» e Svetozar Vukmanoviç Tempos, «Aspekte të çështjes maqedonase» dhe një libër «Mbi realitetin në Ballkan» i Lllazar Kolishevskit. Në Bullgarinë revizioniste, koloni e vërtetë e revizionistëve sovjetikë, po shkruhen artikuj të gjatë, bëhen festime e mbahen fjalime «për Bullgarinë e madhe të Shën Stefanit» që i çon kufijtë e saj deri në Shqipëri!**

**Këta njerëz asgjë s'kanë mësuar dhe asgjë s'kanë harruar nga historia! Vetëm shqiptarët, që janë bërë preja e tyre, na qenkan «kundërrevolucionarë, shovinistë dhe irredentistë».**

Po le të lëmë të flasë me gojën e tij zoti Kolishevski, ish-kryetar i Presidencës së Jugosllavisë, në librin në fjalë. Ai shkruan pikërisht (sipas agjencisë Tanjug nga Beogradi, më 15 prill 1981):

**«Është fakt se ne ekzistojmë, se Republika Socialiste e Maqedonisë dhe kombi maqedonas po zhvillohen dhe riafirmohen vazhdimisht dhe se ndjenja që ushqen çdo maqedonas, se është një pjesë e kombit të tij, po bëhet gjithnjë e më e fortë pavarësisht se ku jeton. Ky është një proces që askush nuk mund ta ndalë».** (Nënvizuar prej meje.)

Si t'i cilësojmë këto mendime, zotërinj Dolanc, Dragosavac, Vidiç e të tjerë, që akuzoni shqiptarët e Kosovës dhe Shqipërinë socialiste si «shoviniste, kundërrevolucionare dhe irredentiste»?

**«Ky proces i zhvillimit dhe i afirmimit, që askush nuk mund ta ndalojë» na qenka një e drejtë vetëm për popullin maqedonas të Maqedonisë (ku jetojnë në tokat e tyre më tepër se 400 mijë shqiptarë)? Po në Kosovë dhe në vise të tjera të Jugosllavisë, ku jetojnë më tepër se 1 800 000 shqiptarë, a nuk zhvillohet ky proces? A nuk është një fakt se edhe atje ekziston një komb, që nuk kërkon veçse të drejtën të shpallet republikë brenda**

**Federatës? Atëherë ky proces, «të cilin nuk mund ta ndalë askush për maqedonasit», pse ndalohet për shqiptarët?**

I akordoni të paktën me njëri-tjetrin mendimet, por jo në kurriz veçanërisht të popullit shqiptar që jeton në Jugosllavi!

Shumë flasin udhëheqësit jugosllavë për luftën nacionalçlirimtare «që krijoi unitetin e Federatës», por të mos harrojnë se edhe populli shqiptar nuk luftoi më pak për çlirimin dhe unitetin e kombit të tij. Bile ai derdhi gjakun e bijve të tij edhe për çlirimin e popujve të Jugosllavisë. Këtë jo vetëm që nuk e pohoni me plot gojën, por na akuzoni si «shovinistë dhe irredentistë», që s'kemi qenë dhe as do të jemi kurrë! Shqiptari historikisht ka vendosur dhe vendos vetë për fatet e tij. Të tjerë janë përzier dhe janë borxhlinj ndaj shqiptarëve. Shqiptarët s'i kanë borxh kurrkujt, as borxhe morale, as borxhe politike, as borxhe materiale.

Sistemin tonë të vërtetë socialist, të ndërtuar në bazat e marksizëm-leninizmit, nuk keni pushuar kurrë, s'e keni mbyllur gojën kurrë së sulmuari me epitete përçmuese si «stalinist», «etatist-burokreatik» e të tjera si këto. Një pseudoteori të tërë keni ndërtuar ju për këtë mision. Ju e mbroni dhe e propagandoni «sistemin tuaj vetadministrues» si një «nga format më të përsosura të socializmit» dhe, për të mbrojtur njërin, sulmoni tjetrin. Bile sistemin tuaj e reklamoni me të madhe ku të mundni dhe te kushdo që e ha. Kjo është puna juaj.

Por është edhe puna jonë të mbrojmë teorinë marksiste-leniniste, socializmin shkencor dhe ndërtimin e socializmit me sukses në Shqipëri në bazë të mësimeve të Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit. Ne luftojmë dhe do të luftojmë pa u lëkundur kundër kapitalizmit botë-

ror, kundër imperializmit dhe revizionizmit modern, qoftë ky sovjetik, kinez, jugosllav apo eurokomunist, si dhe kundër çfarëdo reformizmi, që predikon shuarjen e luftës së klasave, që shtyp revolucionin, që degjeneron klasën punëtore, unitetin e saj luftarak dhe gënjen e mban nën zgjedhën e kapitalit popujt e botës që luftojnë për çlirim nga çfarëdo zgjedhe.

Ne jemi dhe luftojmë ideologjikisht kundër «vet-administrimit» tuaj, i cili është për ne një sistem kapitalist, pseudosocialist, kundërrevolucionar. Këtë e bëjmë dhe do ta bëjmë pa lëkundje.

Është e qartë se ideologjikisht dhe politikisht ne as puqemi, as nuk do të puqemi kurrë. Këtë të vërtetë e dimë edhe ne, e dini mirë edhe ju. Këtë e di gjithë bota.

Por, pavarësisht se ideologjikisht dhe politikisht nuk pajtohemi kurrë, ne mendojmë dhe kemi konstatuar që edhe ju keni ardhur në mendimin tonë ose keni arritur në një mendim të përbashkët që konsiston në këtë: Në mes dy shteteve tona fqinje, për hir të fqinjësisë së mirë në mes dy vendeve dhe për stabilitetin e paqen në rajonin e Ballkanit, duhet të zhvillohen marrëdhënie tregtare dhe kulturore.

Duhet të pohojmë se nga të dyja palët në këtë rrugë është gjendur mirëkuptim. Tregtia në mes nesh, në interesin jo vetëm tonin, siç dëshiron ta cilësojë borgjezia kapitaliste botërore, por edhe në interesin tuaj, është zhvilluar dhe po zhvillohet. Ana e marrëdhënieve kulturore dhe veçanërisht tonat me Kosovën, me Maqedoninë dhe me Malin e Zi, kanë ecur mirë, me sukses, me asnjë incident dhe në një mirëkuptim që jep fryte. As nga ana jonë, as nga ana jugosllave nuk është hasur në asnjë pengesë serioze. Këtë, si edhe marrëdhëniet treg-

tare ne i konsiderojmë si gjëra të mira që duhet të vazhdohen dhe të mos ndërpriten. As shenja më e vogël e «shovinizmit shqiptar, e irredentizmit shqiptar», siç po pretendohet tani nga udhëheqja jugosllave dhe shtypi i saj, nuk është shfaqur dhe nuk mund të shfaqej nga asnjë prej nënshtetasve tanë që kanë vizituar Kosovën, që nga ministrja jonë e Arsimit dhe e Kulturës, deri te profesorët dhe turistit më i thjeshtë shqiptar. Ne mund të themi se edhe nga shtetasit jugosllavë e njëjta gjë ka ndodhur, nuk është parë asnjë shfaqje e tillë që ta prishtë këtë rrjedhë.

Si miq të ambasadës jugosllave në Tiranë ne kemi pritur kryeministrin e Malit të Zi, kryeministrin e Maqedonisë dhe i kemi pritur me bujarinë tradicionale shqiptare. Ata kanë shkuar ku kanë dashur, kanë parë vendin dhe kanë biseduar me njerëzit. Të dyja palët e kemi gjetur normale këtë praktikë. Anormale ne kemi gjetur vetëm atë që kryeministri i Kosovës nuk gjeti një herë kohë të vizitonte Shqipërinë. Ne nuk e dimë përse s'e ka bërë këtë, siç e bënë edhe dy kryeministrat fqinjë jugosllavë. Këtë mund ta dijë vetëm Federata, udhëheqja e Republikës Federative të Serbisë dhe udhëheqja e krahinës së Kosovës. Neve nuk na intereson arsyeja, vetëm konstatojmë, pse po të kishte ardhur, do ta pritnim edhe atë si dy të parët.

Çka është e drejtë ne e mbrojmë dhe e pohojmë, çka është e padrejtë, e denoncojmë dhe e dënojmë.

Ne kemi afirmuar dhe afirmojmë se në këtë dekadë të fundit arsimit dhe kultura shqiptare në Kosovë (më pak në Maqedoni e në Mal të Zi) kanë marrë një hov të lavdërueshëm. Hapja e shkollave shqipe, e Universitetit të rëndësishëm të Prishtinës, unifikimi i gjuhës shqipe, zhvillimi i këngëve, i valleve, i folklorit shqiptar, muzika e përpunuar, literatura shqipe etj., bre-

nda caqeve të Federatës dhe përkrah kulturës së popujve të tjerë të Jugosllavisë, kanë marrë një hov që nuk ishte parë kohë më parë dhe arsyet dihen dhe nuk duam të zgjatemi këtu. Pra, ne e shohim dhe e barazojmë të kaluarën me aktualitetin, i shohim ndryshimet pozitive të bëra në këto fusha. Një zhvillim të tillë ata që e pengonin dje, nuk e pengojnë dot sot dhe është në kundërshtim me kushtetutën e Federatës dhe me interesin e Jugosllavisë që të ndalohet e të pengohet.

Por një gjë të tillë ne nuk kemi si ta pohojmë për zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe të viseve të tjera ku banojnë shqiptarë. Diferencat ekonomike dhe të nivelit të jetesës në mes Krahinës Autonome të Kosovës dhe republikave të tjera të Jugosllavisë janë kolosale. Këto diferenca nuk shpjegohen dot, siç bëjnë udhëheqësit jugosllavë, me arsyen e «krizës botërore». Diferencat në nivelin e jetesës në mes republikave dhe krahinave duhet të kërkohen edhe në arsye të tjera shumë të mëdha dhe të vjetra, politike, ideologjike dhe ekonomike.

Për zhvillimin e ulët të ekonomisë në Kosovë flet edhe numri i madh i emigrantëve ekonomikë. Emigracioni ekonomik i shqiptarëve që jetojnë në Jugosllavi numërohet me qindra mijë. Vetëm në Turqi kanë emigruar rreth 250 000 veta, përveç dhjetëra e dhjetëra mijëve në vende të tjera të Evropës, Amerikës, Australisë, Afrikës. Kudo gjen emigrantë shqiptarë të larguar nga Jugosllavia «socialiste vetadministruese» dhe asnjë emigrant ekonomik nuk është larguar nga «Shqipëria staliniste, etatiste-burokratike». Rinia e Kosovës s'gjen punë, ajo vuan për bukë në Jugosllavinë e Titos dhe të pas Titos. Këtyre problemeve u duhen gjetur arsyet, t'u bëhet diagnoza dhe të shërohet sëmundja sa më parë dhe sa më drejt.

Të flasësh kundër Republikës Popullore Socialiste të

Shqipërisë dhe popullit të saj për gjoja faje të paqena, ky problem nuk zgjidhet me tanke e me terror policesk rankoviçian.

S'gënjen dot njeri shtypi jugosllav kur thotë se «Shqipëria socialiste i thotë këto se ka smirë për përparimin ekonomik të Kosovës». Kjo është qesharake.

Cilat janë arsytet që bëhen këto barazime të paqena në mes Kosovës dhe Shqipërisë socialiste dhe nuk bëhen barazime të qena në mes krahinës së Kosovës dhe pjesëve të tjera të Jugosllavisë? Ka një arsye politike që tenton të bindë dikë dhe të fshehtë realitetin, si në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë, si në Krahinën Autonome të Kosovës dhe në republikat socialiste të federuara të Jugosllavisë.

Për sa u përket «të drejtave politike», ndryshime statusi nga krahina në republikë etj., as kanë qenë dhe as janë preokupime për Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë. Këto janë çështje të brendshme të popujve të Jugosllavisë, janë çështje të vetë popullit shqiptar që jeton në trojet e veta në Jugosllavi, i cili, në bazë të ligjeve në fuqi, që rrjedhin nga kushtetuta e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, ka të drejtë t'i kërkojë. Jo vetëm që askush në Federatë s'ka të drejtë t'ua ndalojë shqiptarëve që jetojnë në Jugosllavi këto kërkesa, por ca më pak t'i sulmojë ata, t'i plagosë, t'i vrasë dhe t'i burgosë. Për këtë të vërtetë që themi, jugosllavët na akuzojnë se ndërhyjmë në punët e brendshme të tyre. Ne nuk kemi ndërhyrë dhe nuk ndërhyjmë në këto punë të brendshme të tyre, të cilat mendojmë se zgjidhen drejt vetëm me vetëvendosje, në mirëkuptim, me bisedime të sinqerta dhe me gjakftohtësi nga të gjitha palët.

Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë as më të voglën ndërhyrje nuk bëri në Kosovë, as tanke, as

helikopterë, as policë nuk dërgoi, as shtoi kufitarët, as bateri topash nuk nxori në kufijtë e saj dhe as protestë zyrtare nuk bëri, por një artikull të drejtë, të matur dhe të argumentuar politikisht, ideologjikisht e historikisht, dhe të tillë e cilësoi gjithë shtypi botëror, shkroi për tragjedinë që u shkaktua në Kosovë.

Përgjegjësi për çka ngjau në Kosovë nuk ka Shqipëria, përgjegjës janë ata që përdorën dhunën dhe jo gjakftohtësinë dhe arsyen.

Shqipëria socialiste e ka deklaruar se, në qoftë se ndonjë fuqi e huaj agresore prek kufijtë e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, atëherë ajo dhe populli shqiptar do të ngrihen dhe do të luftojnë përkrah popujve të Jugosllavisë. Çka themi është e qartë dhe premtimet që bëjmë i mbajmë, i themi ne ustashit që foli nga Radio Zagrebi. Asgjë s'i bashkon shqiptarët me ustashët, me çetnikë e ballistë, përkundrazi shqiptarët, kudo që janë, luftojnë kundër tyre, pse ata kanë qenë dhe janë armiq të popujve tanë, janë mercenarë dhe gjakatarë në shërbim të imperializmit amerikan, të socialimperializmit sovjetik etj., që punojnë me çdo mjet të hedhin në erë Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë.

Që kur shkruam artikullin në «Zërin e popullit» e deri tani ne kemi ruajtur gjakftohtësinë, kurse udhëheqja jugosllave dhe deri fletushka më e fundit jugosllave kanë vjellë vrer e kanë bërë sulme kundër Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë. E gjithë kjo fushatë e tërbuar u kthye kundër tyre.

Zotërinjtë zyrtarë jugosllavë na akuzuan ne për «nacionalistë, shovinistë» etj. Gati sa s'na akuzuan dhe për «pansllavistë». Të gjitha këto ideologji, e të tjera si këto,

janë teori antimarksiste, teori të borgjezisë. Shovinizmi është një nga tiparet e saj dhe s'ka të bëjë aspak me patriotizmin dhe me marksizëm-leninizmin.

Mund ta bësh revolucionin, siç flasin për të e teorizojnë përditë udhëheqësit jugosllavë, por mund edhe ta devijosh e ta tradhtosh atë. Revizionizmi modern, i çdo ngjyre dhe nën çdo maskë që të fshihet, është pjellë e borgjezisë kapitaliste që lufton revolucionin, që e deformon dhe e mbyt atë në gjak. Borgjezia çan e sundon, revizionizmi modern, po ashtu, nuk i bashkon popujt, por i përçan. Ç'po ngjet në Bashkimin Sovjetik revizionist? Atje u bë Revolucioni i madh proletar, atje u vendos dhe u konsolidua socializmi, u themelua BRSS, që do të thotë «Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike», dhe çështjet nacionale u zgjidhën drejt nga Lenini dhe Stalini.

Hrushovizmi dhe revizionizmi modern e devijuan veprën e madhe të revolucionit. Ata vendosën kapitalizmin. Shovinizmi rusomadh dominon atje egërsisht, por njëkohësisht kanë ngritur veshët dhe shovinizmi ukrainas, ai gjeorgjian, azerbajxhanas etj. Mbi to dominon pansllavizmi dhe Bashkimi Sovjetik nga një vend socialist u kthye në një vend socialimperialist agresiv dhe luftënxitës. Teoria e Brezhnjev-it e «sovranitetit të kufizuar» i ka zënë nga gryka të gjitha vendet e Traktatit të Varshavës, pjesëtare të KNER-it dhe të «Bashkësisë socialiste», që forca e armëve sovjetike i bën të qeshin verdhë për të mos qarë dhe lebetitur.

Kjo është një histori e tmerrshme për popujt që duan të rrojnë të lirë dhe të ndërtojnë socializmin, aq sa është e tmerrshme edhe forma e Shteteve të Bashkuara të Amerikës që shfrytëzon jo vetëm popujt e ndryshëm që jetojnë në Amerikë, por edhe popujt të tjerë të botës. Prandaj, zotërinj teoricienë të «Borbës», ka «shkallë» në shovinizëm dhe lloje të ndryshme, pavarë-

sisht nga forma dhe nga madhësia e tyre, pavarësisht nga maskat dhe nga fjalët pompoze. Nacionalizmi, shovinizmi dhe pansllavizmi janë të dënueshëm nga çdo anë që të vijnë, pavarësisht se ata që i kultivojnë këta janë të mëdhenj a të vegjël, por nacionalizmi dhe shovinizmi më i madh është më i rrezikshëm. Këtë të mos e harrojmë. Të gjitha këto të këqija duhen luftuar, duhen shkukur nga rrënjët, por kjo nuk mund të bëhet kurrë veçse nga pozitat e marksizëm-leninizmit. Tjetër rrugë s'ka.

Po e përsëritim edhe një herë, se për 10-15 veta të ashtuquajtur nga udhëheqja jugosllave si «reaksonarë, shovinistë e irredentistë» nuk mund të dërgoheshin aq shumë ushtri, milici, udbashë, tanke dhe avionë në Kosovë, as të vriteshin e të plagoseshin me armë zjarri aq njerëz dhe të vendosej shtetërrëthimi në të gjithë krahinën e Kosovës.

Ju keni frikë të tregoni të vërtetën dhe kjo është keq për ju, se populli i Kosovës e di këtë gjë, mbasi ka marrë pjesë vetë në demonstratë.

Me dhjetë-pesëmbëdhjetë veta, që ju i konsideroni «kundërrevolucionarë» etj., nuk është e lehtë të gënjeni një popull trim e të pjekur, siç është populli shqiptar që jeton në pjesë të ndryshme të Jugosllavisë, as të gënjeni punëtorët, fshatarët, studentët dhe inteligjencien e zgjuar, heroike dhe të ndërgjegjshme për jetën dhe fatin e kombit të tyre.

Në goftë se udhëheqja e Beogradit nuk i sheh problemet në rrënjë dhe t'i zgjidhë ato drejt e me guxim, me siguri që do t'i nxjerrë shumë telashe vetes.

Shohim me keqardhje se, kur ne ju themi të vërtetën, ju vjen shumë hidhur. Pse vallë? Mos doni që ne

t'ju mburrim për ato akte të mbrapshta që bëtë në Kosovë? Apo kishit dëshirë që ne të heshtnim? Pse nuk shpifëm ne edhe një vit më parë, apo edhe një muaj më parë se të ngjisnin turbullirat në Kosovë?

Udhëheqësit jugosllavë pretendojnë se këto turbullira ngjanë se «zbutën vigjilencën». As gënjeni dot njeri me këtë, pse pakënaqësia në viset ku banojnë shqiptarë është e madhe dhe e dukshme, prandaj ato turbullira nuk ngjanë për arsyet që ju përpiqeni t'i vini në dukje, por për ato që kërkonin t'i fshihni.

Nëpër fjalime të panumërta të udhëheqësve jugosllavë dhe të shtypit të tyre po bëhen kërcënime të hapëta kundër shqiptarëve të Jugosllavisë për të ardhmen. Mos ndiqni këtë rrugë të rrezikshme!

Ju, po të doni, vazhdoni t'i merrni për keq të vërtetat tona, akuzonani, po t'u vijë për mbarë, për ndërhyrje në punët tuaja të brendshme nga ana jonë, por kjo nuk e ndryshon aspak situatën e sëmurë në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë. Sëmundja kronike që ekziston te ju nuk vjen nga të drejtat e ligjshme që kërkojnë shqiptarët që banojnë në Jugosllavi brenda ligjeve të kushtetutës së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, por nga padrejtësitë dhe dobësi të tjera të thella në Federatë dhe jashtë kufijve të Krahinës Autonome të Kosovës.

Ne shkruajmë jo për të ngjallur polemikën dhe për t'i hedhur benzinë zjarrit, por dëshirojmë të shprehim dëshirën dhe gatishmërinë tonë për zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, pse kjo është në interesin e të dyja palëve.

Faktori shqiptar në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë (këtë e poëhojmë në mënyrë objektive dhe jo me frymë partizane, ose «shqiptaromadhe», «shoviniste», «irredentiste», siç pretendojnë udhëheqësit jugosllavë për ne) ka qenë faktori më i përbuzur politikisht, ekonomikisht dhe nga ana kulturoro-arsimore, por faktori më i durueshëm, më i zgjuar dhe më realist në kaosin politiko-ekonomik ku ishte zhytur Jugosllavia e pasluftës së Dytë Botërore, kaos që veçanërisht shqiptarëve u rëndonte tmerrësisht në shpinë.

Asnjë politikan jugosllav nuk ia vuri veshin këtij faktori kaq të rëndësishëm. Pse? Elementi shqiptar, në skakierën e politikanëve jugosllavë, ishte një pion që mund ta lëviznin si të donin dhe me të të bënin çfarë të donin. Këtë e vërteton gjithë situata e pasluftës në Jugosllavi.

S'ka si mohohet se në Luftën Nacionalçlirimtare të popujve të Jugosllavisë, edhe popullsia shqiptare që jeton në trojet e veta në Jugosllavi luftoi heroikisht i vëllazëruar me ta dhe për një të ardhme më të mirë. Gjatë luftës u përcaktuan nga AVNOJ kufijtë e Jugosllavisë dhe këta u riafirmuan pas luftime. Në këtë «bashkim-vëllazërim», në këtë «Jugosllavi socialiste», në këtë federatë të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, ç'të drejta iu njohën shqiptarëve? Asnjë. Ata u copëtuan, Kosova mbeti pjesë e pandarë e Serbisë, shqiptarëve s'iu dhanë as shkolla shqipe, as të drejta politike, as status, kurse zhvillimit ekonomik të tyre nuk iu vu fare veshi. Shqiptarët edhe pas luftës vazhduan të rronin në mjerim edhe politik, edhe ekonomik. Politika e ndjekur nga Tito-Kardeli dhe Rankoviçi (dhe faktet janë të njohura) ka qenë jo vetëm e gabuar karshi shqiptarëve, por edhe e egër e shfarosëse. Shqiptarët duruan, por

nuk u përkulën dhe nuk ngritën krye, as bënë demonstrata kundër Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.

Është e vërtetë se popujt e Jugosllavisë bënë revolucionin. Por pas luftës revolucionari i tyre në brendinë e vet ruante grindjet dhe dasitë e vjetra, ruante të maskuara, të fshehura, si qymyri i ndezur nën hi, rivalitetet në mes serbëve, kroatëve, sllovenëve, pavarësisht se popujt atje luftuan kundër çetnikëve serbë dhe ustashëve kroatë dhe këta i mundën fizikisht. Nuk u spastrua sistematikisht ideologjia dhe fryma e tyre që do të manifestoheshin, siç u manifestua më vonë, në forma të ndryshme, por me përmbajtje gati të njëjtë, e mbuluar këtë herë me petkun e «socializmit», të «bashkim-vëllazërimit» e «të drejtave të barabarta» të popujve që formonin Jugosllavinë.

Lufta heroike e popujve të Jugosllavisë s'kishte si të mos ngjallte një krenari të ligjshme, por s'mungoi që kjo të kthehej nga udhëheqja jugosllave në një megalomani dhe «shovinizëm» masiv jugosllav, për të vënë në dukje se gati vetëm ata luftuan, vetëm ata sakrifikuan, vetëm në sajë të atyre luftuan e morën shembull edhe popujt e tjerë. E gjithë kjo u transformua në një «ndjenjë superioriteti» që nuk mbante fare erën e marksizëm-leninizmit.

Filloi dhe vazhdoi të degjeneronte kështu revolucionin jugosllav.

Krimbi ishte brenda në «mollën e kuqe», ai gërryente revolucionin dhe, për ta arsyetuar këtë, ia hodhën fajin Stalinit, Bashkimit Sovjetik, sistemit të tij të vërtetë leninist dhe ideologjisë që e kishte udhëhequr dhe ndërtuar këtë sistem, marksizëm-leninizmit.

Politika e Tito-Kardel-Rankoviç-Gjilasit e arriti çarjen dhe njihet se kujt ia hodhën fajin. Por as Stalini, as Bashkimi Sovjetik nuk e ngritën dorën kundër Jugosllavisë, as tanke, as ushtri dhe as pushkë hodhën kundër jugosllavëve.

Titoja dhe shokët e tij u bënë nga borgjezia ndërkombëtare heronjtë e ditës antistaliniane dhe antisovjetike. U dhjetëfishua megalomania e tyre dhe iu vu punës për të ndryshuar sistemin shtetëror dhe për të vërtetuar se në këtë drejtim bazë duhej të ndryshonin nga sistemi i Bashkimit Sovjetik. U ndërtua një interpretim gjoja i ri, i përshtatshëm me situatat, i teorisë së Marksit, që të shpjegonte «sistemin e vetadministrimit», që të devijonte sistemin socialist në një sistem të kamufluar kapitalist, që të krijonte një «politikë gjeniale botërore të vendeve të paangazhuara» dhe t'u përgatiste ligjërisht shtratin e ngrohtë kapitaleve të huaja të borgjezisë botërore dhe mënyrës së jetesës, të mendimit dhe të veprimit të saj.

Të gjitha këto janë të njohura. Partia e Punës e Shqipërisë i dënoi dhe i demaskoi të gjitha këto devijime antimarksiste dhe kundërrevolucionare, për interes të popullit shqiptar, të popujve të Jugosllavisë dhe të revolucionit.

Rrjedha e kësaj lufte të ashpër politiko-ideologjike në mes dy shteteve tona fqinje dy partitë tona i bëri armike. Në shqiptarët në fillim na quajtën dhe na akuzuan me të madhe se bënë lojën e jugosllavëve, pastaj të sovjetikëve e më vonë të kinezëve. Si u demaskuan të gjitha këto nga vetë jeta dhe lufta heroike marksiste-leniniste e Partisë së Punës të Shqipërisë dhe e shtetit shqiptar, thanë se do të vdisnim, do të shembeshim, do

t'i ndernim dorën dhe do të viheshim nën zgjedhën e kapitalizmit botëror. Asnjë nga këto s'ngjau dhe s'do të ngjasë. Borgjezia dhe kapitalizmi botëror, revizionizmi modern dhe reformizmi nuk mund ta kuptojnë këtë fenomen shqiptar, i cili për ne është i qartë, se i qëndrojmë besnikë revolucionit proletar dhe teorisë marksiste-leniniste.

Ç'situata krijoi kundërrevolucionin në Jugosllavinë e «socializmit vetadministrues»? Sistemi ndryshoi dhe ky ndryshim ngjalli rivalitetet dhe hegjemonizmat e vjetër, hegjemonizmi serb, nga njëra anë, dhe ai kroato-slloven, nga ana tjetër. Janë këta të dy minuesit e socializmit në Jugosllavi e të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe jo «shovinizmi» shqiptar. Ky i fundit përdoret si cipë për të mbuluar shovinizmin serbomadh dhe atë kroato-sllovenomadh.

Lufta për hegjemoni dhe për pushtet në mes këtyre dy klaneve po zhvillohet e egër. Klani kroato-slloven dominon mbi atë serb. Titoja hiqej si moderator, por ai ishte përkrahës i hegjemonizmit kroato-slloven.

Grupi Ranković (veçanërisht vrasës i shqiptarëve) — Gjilas, Nikezić-Popović e Vukmanović u likuiduan prej klanit Tito-Kardel-Bakariç-Dolancit.

Klani i Titos rrojti në luks të madh, ai mori pjesën e luanit nga të ardhurat e Jugosllavisë dhe hëngri sa deshi nga borxhet e imperializmit amerikan dhe të shteteve të tjera kapitaliste.

Është e kuptueshme se klanit serb një gjendje e tillë nuk i leverdis dhe lufton të rifitojë supremacinë e vërtetë në mos barazinë në politikë, ekonomi etj.

Rreth këtyre dy klaneve rivale vërtiten republikat e tjera të varfra. Të gjitha me qëndrimet e tyre parti-

zane, kush më shumë e kush më pak, i hedhin benzinë këtij zjarri të madh që ekziston në këtë Republikë Socialiste Federative të Jugosllavisë të pastabilizuar kurrë.

I vetmi faktor pozitiv dhe i paanshëm në këtë Federatë është faktori shqiptar, i cili, duke qenë ekonomikisht më i varfri, më i durueshmi dhe politikisht më i lëni pas dore në një sistem «socialist vetadministrues», brenda kushtetutës, kërkoi «statusin e republikës në kuadrin e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë».

Është kjo kërkesë një faktor përçarës i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë apo janë rivalitetet e mëdha serbo-kroato-sllovene? Është më se e evidente se janë këto të dytat.

Cilat janë arsyet që u bënë demonstratat në Kosovë ne e shfaqëm hapur mendimin dhe qëndrojmë pa u lëkundur në mendimet tona.

Udhëheqja dhe shtypi jugosllav bënë fajtor popullin shqiptar të Kosovës, pastaj akuzuan Partinë e Punës të Shqipërisë dhe Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe me to ustashët, çetnikët dhe ballistët në Evropë dhe në Amerikë dhe, për të mbyllur ciklin, na futin të tërë në një thes, duke menduar me mendjelehtësi se e zgjidhën enigmën, ia vunë përpara opinionit botëror në një pjatë që ta hante. Po s'e ha kush këtë çorbë që gatuan jugosllavët.

Arsyet e vërteta fshihen, prandaj janë mbarsur me shumë rreziqe për popujt e Jugosllavisë dhe për popujt e Ballkanit. Ne nuk i fshehim mendimet tona.

Shkaqet e turbullirave që ngjanë, dhe mund të ngjasin të tjera, duhen gjetur e duhen shikuar realisht dhe

duhen mënjënjë me gjakftohtësi brenda në Jugosllavi dhe jo vetëm në Kosovë, por sidomos në republikat e tjera të Jugosllavisë. Ne, shkurtimisht, më lart i thamë këto dhe e vumë në dukje këtë gjendje.

Po faktorët e jashtëm, i pyesim udhëheqësit jugosllavë, kanë gisht në dobësimin e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe në krijimin e rivaliteteve? «Politikanët» jugosllavë jo pa qëllim nuk e gërvishtin këtë plagë të madhe.

Në këto situata krize ndërkombëtare jo vetëm ekonomike, por edhe politike, në këto rivalitete agresive luftënxitëse në mes imperializmit amerikan dhe revizionizmit sovjetik, a kanë gisht këta të fundit në dobësimin e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, në nxitjen e shovinizmit serbomadh dhe të atij kroato-slllovenomadh? Për ne këta janë, bile kryesorët. Në qoftë se ka ndonjë politikan të zgjuar dhe realist jugosllav këtë gjendje e sheh, por e fsheh.

Pse fshihet kjo situatë e rrezikshme? Fshihet se Jugosllavia e Titos nuk është «e pavarur», por e varur nga këto fuqi të mëdha. Teoria e Titos e vendeve «të paangazhuara» ishte boshe, ishte një falsitet. Këtë e tregoi dhe e tregon jeta. Jugosllavia nuk rron dot pa borxhe, ajo punon dhe nuk ia del dot të paguajë as vetëm përqindjet e miliarda dollarëve kredi.

Po me këtë vartësi ekonomike s'ka asnjë dyshim që gërshetohen dhe interesat politikë, hegjemonistë dhe strategjikë të të dyja superfuqive.

Klanet kroato-slllovene kanë mbështetjen e jashtme të një imperializmi, klani serb të një tjetri. Nëpërmjet tyre të dyja fuqitë e mëdha kërkojnë të fitojnë pozita të forta në Jugosllavi.

Pasqyra e Polonisë i përngjet asaj jugosllave me karakteristikat e tyre të veçanta.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës me njerëzit e tyre janë në ofensivë, veçanërisht në Evropë, gjë që na intereson më shumë në këtë problem.

Revizionizmi sovjetik dhe satelitët e tij, veçanërisht bullgarët, po ashtu janë në ofensivë.

Duhet shpëtuar popujt e Jugosllavisë, popujt tanë vëllezër jugosllavë, zotërinj të revistës «NIN», nga këta armiq të tërbuar të hapët dhe të fshehtë të tyre. Dhe po jua përsëritim edhe një herë, për të njëqindën herë, se Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë dhe populli shqiptar që jeton në trojet e veta në Jugosllavi nuk janë as armiq të popujve jugosllavë dhe as të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë. Ju, zotërinj politikë jugosllavë, po të doni mos na dëgjoni, po të doni vazhdoni të shpifni, po ne jemi të bindur se populli jugosllav do ta dëgjojë dhe do t'i arsyetojë mendimin dhe ndjenjat tona, ndjenjat vëllazërore të shqiptarëve.

## SHËNIM

I dhashë shokut Ramiz teza të reja, të zgjeruara, ose më mirë të them një artikull të ri<sup>1</sup>, kundër revizionistëve shovinistë jugosllavë për zhvillimin e mëtejshëm të ngjarjeve në Kosovë dhe për demaskimin e propagandës së tyre shpifëse kundër vendit tonë.

---

1 «Kush e nxit armiqësinë midis popujve të Jugosllavisë?», «Zëri i popullit», 23 prill 1981.

## KUSH E NXIT ARMIQËSINË MIDIS POPUJVE TË JUGOSLLAVISË?

I dërguam gazetës «Zëri i popullit» artikullin me titull «Kush e nxit armiqësinë midis popujve të Jugosllavisë?» për ta botuar në numrin e saj të nesërm. Në këtë artikull, i dyti që po botojmë brenda pak ditësh, theksojmë se nuk kemi për qëllim të ngjallim polemikën, as t'i hedhim benzinë zjarrit, por jemi të detyruar t'i japim përgjigje fushatës antishqiptare që ka shpërthyer aktualisht në Jugosllavi dhe të shprehim edhe një herë hapur mendimet tona mbi ngjarjet në Kosovë.

E DIEL  
26 PRILL 1981

## UDHËHEQJA JUGOSLLAVE KA HUMBUR KREJTËSISHT TORUAN

Udhëheqja jugosllave është marrosur, ka humbur krejtësisht toruan si dhe busullën e drejtimit. Kërkesat e drejta e të ligjshme të kosovarëve e tronditën aq shumë Jugosllavinë titiste, saqë menjëherë u dukën paqëndrueshmëria, kontradiktat, konfuzioni dhe rivalitetet që ekzistojnë në këtë vend të ashtuquajtur demokratik, në udhëheqjen e saj qendrore, në republikat dhe në komunat. Jugosllavia e Versajës, ajo e kralëve, Jugosllavia titiste, është një shtet artificial, me mballoma shumë mëngjyreshe të qepura me pe të bardhë.

Lufta nacionalçlirimtare nuk solli në këtë shtet asnjë ndryshim, vetëm që u çlirua nga pushtimi dhe Jugosllavisë iu dha një kushtetutë republikane, së cilës më vonë iu shtua emërtimi federative-popullore e pastaj edhe socialiste.

Brenda pak dekadave titizmi e ktheu Jugosllavinë në një vend kapitalist, me një përmbajtje e emërtim të ri «thelbësor» të «socializmit vetadministrues». Në këtë vend rivalitetet midis shovinizmave të ndryshëm janë të mëdha, të gjalla dhe sa vijnë e po forcohen. Rivaliteti më i madh e më gërryes, burimi kryesor i një rreziku të madh që zien, të cilin përpiqen ta mbulojnë me tym, është veçanërisht ai në mes serbëve dhe kroato-sllavenëve. Ky rivalitet dominues serbo-kroato-sllovenë nxit

dhe rivalitetet e tjera në Jugosllavinë prej shumë popujsh e kombësish, të unifikuara artificialisht.

Titoja zëvendësoi kralin serb Karagjorgjeviç. Ashtu si ky, Titoja u mbështet te të huajt, por me një ndryshim, Karagjorgjeviçi lidhte aleanca, ndërsa Titoja u lidh me të huajt «pa aleanca», por me zinxhirë më të rëndë politikë-ekonomikë dhe me mënyrën e jetesës. Titoja, si një monark i vogël, po, që hiqej si monark i madh, fantazoi me organizimin shtetëror, me politikën e brendshme dhe të jashtme. Nga centralizimi ai kaloi në decentralizim, nga administrimi kaloi në «vetadministrim». Parulla e tij ishte oburra hani, oburra pasurohuni, oburra shfrytëzoni dhe rripni popullin individualisht e kolektivisht si republikë. Kështu më i madhi hëngri edhe pjesën e më të voglit. Titizmi nga parulla-fasadë «bashkim-vëllazërim», kaloi në diferencime, në diskriminime, në mosbesim, në rivalitete ekonomike, politike midis republikave, popujve e kombeve që përbëjnë Jugosllavinë.

Cili qe rezultati?

Kroato-sllovenët u pasuruan më shumë se serbët, Bosnjë-Hercegovina, Maqedonia dhe Mali i Zi mbetën vëllezër të mjeruar, Kosova dhe shqiptarët mbetën në diell, kripë dhe në fund të shkallës.

Mbreti Tito sa rroi manovroi: ndihmo njërin, godit tjetrin, njërit i premtonte parajsën, tjetrit i bënte varrin e kështu me radhë. Kur ky mbret vdiq, përsëri u brohorit «rroftë mbreti», veç kësaj radhe nuk kishte më një mbret me një kokë, por një «mbret» me shumë kokë dhe me një «mbretëri» të krimbur, të përçarë, muflize, të mbytur në borxhe dhe që rron me ekspediente<sup>1</sup>. Asnjë frymëzim, asnjë ideal nuk ka që t'i nxitë popujt e

<sup>1</sup> Nga frëngjishtja — masa që të shpëtojnë përkohësisht nga hallet, nga vështirësitë.

Jugosllavisë. Socializmi është fals, «bashkim-vëllazërimi» është fals, «vetadministrimi» është, gjithashtu, fals, patriotizmi është kthyer në nacionalizëm e shovinizëm dhe demokracia në terrorizëm e në fashizëm, politika e «mos-angazhimit» është në të vërtetë politika e «angazhimit». Ky i famshëm shtet është, pra, në një bankrutë totale politike-ideologjike-ekonomike-morale dhe ushtarake.

Dhe më e bukura nga të gjitha, mendimi më «gjenial», më «i mprehtë», më «i zgjuar» dhe më «origjinali» i udhëheqjes jugosllave është se këtë katastrofë «e shkaktuan» shqiptarët që jetojnë në trojet e veta në Jugosllavi, shqiptarët e Kosovës, ose një grusht organizatorësh «shovinistë-nacionalistë-irredentistë shqiptarë». Ky është faktori i brendshëm. Faktori i jashtëm është Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë, Partia e Punës e Shqipërisë, gazeta «Zëri i popullit», janë marrëdhëniet kulturore të Shqipërisë me Kosovën!

Kështu, çdo gjë u shpjegua, u gjend «kali i Trojës» dhe oburra ta shkatërrojmë atë, u gjend fajtori dhe oburra të luftojmë atë. Tani kori serbomadhi jugosllav kundër shqiptarëve, kundër kosovarëve, kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë është aq i madh, aq i zhurmshëm sa që është bërë qesharak dhe asnjëri, me tërë kuptimin e fjalës, nuk u beson atyre që thonë jugosllavët.

Po si mund të shpjegohet kjo histeri, kjo marrëzi, kjo verbëri politike e jugosllavëve?

Ata e dinë se Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë nuk është për minimin e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, se Shqipëria socialiste nuk ka shfaqur kurrë pretendime territoriale, se Shqipëria socialiste është me vendosmëri të madhe kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik që janë agresorë të mundshëm ndaj dy vendeve tona. Ata e dinë, gjithashtu, se shqiptarët që jetojnë në Jugosllavi

nuk mund të mos luftojnë krah për krah me Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe me Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë kur Jugosllavia të sulmohet. Të gjitha këto udhëheqja jugosllave i di. Ajo e di që ne nuk kemi gisht në ato që ngjanë në Kosovë, se ajo që ngjau atje ishte rezultat i zemërimit të shqiptarëve të shkaktuar nga vetë jugosllavët, ata e dinë se kërkesa e kosovarëve për republikë ishte e ligjshme.

Atëherë pse kjo marrëzi?

E qartë. Kontradiktat, që theksova në fillim, po ziejnë, kazani është në vlim, një «supapë» plasi në Kosovë, do të pëlcasin edhe të tjerat, derisa kapaku i kazanit të hidhet në erë. Udhëheqja jugosllave do ta fshehtë këtë situatë, do të fitojë kohë, po rregullohen hesapet me thikë në dhëmbë, por ndërkohë thotë: Të godasim fort shqiptarët, që të mund të godasim më vonë edhe të tjerët. Diktatura ushtarake që po përgatitet, ka gjetur një «kokë turku», shqiptarët. Por harrojnë titistët se kjo kokë shqiptari u ka qëndruar rrebesheve dhe kurdoherë ka fituar.

## A BON ENTENDEUR SALUT<sup>1</sup>

Bisedova me Ramizin lidhur me një artikull<sup>2</sup> që duhet të botohet në gazetën «Zëri i popullit» për deputetin irlandez Bobi Sands, nga Ulsteri, i cili vdiq në burg duke bërë për 66 ditë grevë urie kundër kolonizatorëve anglezë. Ramizit i dhashë edhe tezat që kisha përgatitur.

Ky artikull u vete si gant edhe titistëve për çështjen e Kosovës. Le ta lexojnë kuptimin e tij të vërtetë nëpër rreshta.

«A bon entendeur salut».

1 Frëngjisht, proverb — kush e kupton le të nxjerrë përfitim.  
2 «Zgjedhë dhe shfrytëzim i egër kolonial mbi popullin irlandez». «Zëri i popullit», 7 maj 1981.

## CILI DUHET TË JETË QËLLIMI I KAPITULLIT TË FUNDIT TË LIBRIT PËR MISIONET E HUAJA NË SHQIPËRI<sup>1</sup>

Rilexova kapitullin e fundit të librit për misionet anglo-amerikane në vendin tonë. Mendoj ta ripunoj. Ka shumë biseda me oficerë e funksionarë të ndryshëm të UNRRA-s dhe të ML<sup>2</sup>-së, zgjatet muhabeti me disa «agjentë», për disa lecka, gjë që e ul nivelin e librit.

Problemi i UNRRA-s duhet të mbetet në këtë kapitull, po jo në formën që është tani dhe as t'i jepet kaq rëndësi. UNRRA ishte një mjet sabotimi dhe presioni kundër vendit tonë. Çështja e armiqësisë anglo-amerikane nuk qëndron këtu.

**Pra gjithë kapitulli duhet rindërtuar. Ky është një kapitull konkluziv, prandaj ai që lexon librin, duhet të ketë ide të plota rreth problemit dhe nuk duhet supozuar sikur lexuesi i di të gjitha ngjarjet për luftën tonë. Natyrisht histori të gjatë këtu nuk do të bëjmë, por problemi që na intereson, duhet vënë në kuadrin e situatës.**

Ç'duhet të kem parasysh në ripunimin e këtij kapitulli:

1 Është fjala për librin e shokut Enver Hoxha: «Rreziku anglo-amerikan për Shqipërinë».

2-ML — Military Liaison — Ndërlidhja Ushtarake.

Libri fillon me «pak histori», duhet të mbyllet po me pak histori në kushtet e menjëhershme të pasçlirimit, duke trajtuar shkurt, po qartë:

1. Fitoren e madhe të popullit, lirinë dhe pavarësinë që u fituan me luftë dhe me sakrificë.

2. Numrin e të vrarëve, djegien e vendit, shkatërrimin dhe grabitjen e gjithë pasurisë së popullit.

3. Shkatërrimin nga themelet të pushtetit të vjetër dhe ngritjen e pushtetit të ri të këshillave nacionalçlirimtarë.

4. Frontin Nacionalçlirimtar (me shumë rëndësi në këtë kapitull), si dhe pretendimet angleze, që thoshin se s'ka opozitë, s'ka parti të tjera.

5. Kongresin e Përmetit (me shumë rëndësi për ne dhe me shumë pasoja për anglo-amerikanët), për formimin e Qeverisë së përkohshme, anulimin e të gjitha marrëveshjeve të Zogut, mospranimin e futjes së Zogut në Shqipëri, për çështjen se regjimin do ta vendoste vetë populli me zgjedhje të lira, demokratike, për Kush-tetutën, republikën etj.

6. Entuziazmin e madh të popullit dhe fillimin e rindërtimit të vendit.

- a. Reformat e mëdha ekonomike.
- b. Tatimet e jashtëzakonshme të luftës mbi spekulatorët.
- c. Gjykimin e tradhtarëve dhe të kuislingëve.
- d. Klemencën e plotë ndaj atyre që ishin gënjyer etj.

#### **Ky është kuadri i brendshëm.**

Brenda këtij kuadri vijnë edhe çështjet e jashtme.

1. Kërkesat për njohjen e pushtetit popullor dhe të Qeverisë së përkohshme. Njohja e Shqipërisë së re nga Jugosllavia dhe Bashkimi Sovjetik. Këtë duhej ta kishin bërë edhe aleatët e luftës, Anglia me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. (Ata s'e bënë, dhanë arsytet etj.

Këtu të futen ato arsye që dalin në libër, me pretendimet e tyre dhe me kundërshtimet tona.)

2. Njohja e vendit tonë si shtet ndërluftues. Çështja e Konferencës së Paqes. Çështja e reparacioneve.

**Kushtetuta — Republika — Qeveria e parë e Republikës Popullore — Qeveri konstitucionale.**

Anglo-amerikanët duhet ta njihnin atë, po nuk e njohën (dhe këtu të vëmë psenë).

Këtu duhet të numërohen qartë, kronologjikisht, sabotimet e anglo-amerikanëve, faktet, qëllimi dhe rezultati.

**ML-UNRRA** (por jo të gjitha muhabetet). Bisedat e mia me një ose dy nga drejtuesit kryesorë të këtyre misionëve dhe jo të mbajmë të gjitha bisedat me ta. Kjo nuk është serioze.

**Organizimi i «opozitës» dhe i agjunkturës nga ana e misionëve anglo-amerikane.** Qëllimet dhe rezultatet.

**Sabotimi i ekonomisë dhe i tharjes së kënetës së Maliqit.**

**Organizimi dhe hedhja e diversantëve me avionë për të mbështetur organizimin armiqësor brenda vendit.** Dështimi.

**Përpjekjet tona që qeveritë angleze dhe amerikane të vendosnin marrëdhënie të rregullta diplomatike me Republikën Popullore të Shqipërisë dhe relatat miqësore në mes popujve tanë.** Çdo përpjekje dashamirëse nga ana jonë u përbuz, u hodh poshtë nga ana e tyre. Ata donin ta kishin Shqipërinë e re në zarin e tyre, po këtë s'e arritën dot dhe, me vullnetin e tyre, u larguan. Ata janë fajtorët, ata janë përgjegjës që nuk ekzistojnë marrëdhënie diplomatike në mes vendeve tona.

**Incidenti i kanalit të Korfuzit i kurdisur nga anglezët.** Me këtë incident lidhet çështja e arit shqiptar që duhet shpjeguar mirë, i cili duhet të na kthehet i tëri në ar puro me kamatat që rrjedhin nga kjo dhe pa

asnjë kusht. Të konsiderohet çështja e arit grabitje dhe shkelje e të drejtave e vendimeve ndërkombëtare. (Këtu të flitet, si në të kaluar, edhe për reparacionet jashtëzakonisht të vogla që na u dhanë nga Italia, si dhe për reparacionet, për dëmet e mëdha që na shkaktoi Rajhu hitlerian, për të cilat nuk na u dha asnjë grosh, në rast se këtë problem nuk e kam trajtuar në Konferencën e Paqes në Paris, nuk më kujtohet).

Mbyllja e këtij libri, pra kapitulli i tij i fundit, ka rëndësi të madhe për Partinë dhe për popullin tonë dhe duhet të ketë si qëllim forcimin e ndjenjës së ndërgjegjshme për domosdoshmërinë e vigjilencës jo vetëm kundër anglo-amerikanëve, por edhe kundër të gjithë reaksionit botëror.

E MARTË

5 MAJ 1981

## SHTOJCË PËR BISEDËN ME GJENERALIN DEJVIS NË FSHATIN OKSHTUN TË DIBRËS<sup>1</sup>

Kur gjenerali anglez shfaqti gëzimin dhe habinë që nga bora dhe acari ndodhet në një ambient të ngrohtë dhe aq bujar të fshatarit shqiptar, i fola për Bajronin, për vargjet e tij të bukura e plot ndjenja etj.

— Bajroni, — i thashë gjeneralit, — e ka dashur sinqerisht popullin shqiptar, i ka kënduar atij me ndjenja të pastra, duke shprehur simpati për të. (Këtu të shkruhen citatet e Bajronit mbi Shqipërinë, të cilat i ka grumbulluar Nexhmija.)

Gjenerali anglez, në atë dhomë të ngrohtë dibrane, tha:

— Ato që Bajroni ka shkruar për ju shqiptarët, unë po i shoh në realitet dhe në kohë të vështira që po kalon bota.

— Zoti gjeneral, — i thashë, — ambienti kaq bujar i të zotit të shtëpisë më kujtoka leximet e mia mbi jetën e Bajronit. Në një ambient të tillë lëngonte në shtratin e vdekjes poeti i madh anglez, që kishte vajtur në Greqi të luftonte për lirinë e popullit grek. Kur rreth e rrotull Mesollongjit luftonin arvanitasit e kapedanëve trima shqiptarë, Marko Boçarit, Kollokotronit e të tjerë,

<sup>1</sup> Libri «Rreziku anglo-amerikan për Shqipërinë».

poetit, në dhomën ku dergjej, i shërbenin dhe bënin rojë shqiptarë, suljotë.

— Më prekën fjalët tuaja, zoti Hoxha, — u përgjigj gjenerali anglez.

Kështu në atë natë dimri të ftohtë, në atë shtëpi dibrane, ne harruam për disa çaste vështirësitë e mëdha të luftës, duke biseduar për letërsinë, për pöezi e poetë, për mësimë të historisë.

*If you can keep your head when all about you  
Are losing theirs...  
...you'll be a Man, my son!*

«Po s'e humbe gjakftohtësinë kur  
të gjithë rreth teje e humbasin,  
atëherë je burrë, biri im!».

R. Kipling

E MERKURË

6 MAJ 1981

## SHËNIME

Lidhur me librin për anglo-amerikanët në Shqipëri, i thashë Nexhmijes:

1. S'ka asgjë për të hequr «mbi perandorinë angleze».

2. Atje ku është biseda me gjeneralin Dejvis duhet të shtohet paragrafi: «... ne e çmojmë shumë luftën e popullit anglez. Anglia është i vetmi shtet i madh i Evropës Perëndimore që i rezistoi me trimëri dhe me sakrificë të mëdha Hitlerit. Ajo nuk u përkul, diti të tërhiqej, por edhe të sulmonte. Këtë fakt nuk e kemi mohuar dhe nuk e mohojmë kurrë».

Pastaj të vihet falënderimi që më bën gjenerali, por jo vetëm *thank you*, por më gjatë duke vënë edhe ndonjë fjalë të mirë për luftën dhe për popullin tonë nga ato që më ka thënë ai.

Atje ku flas për njohjen e literaturës angleze dhe citohen emra autorësh, të shtohen dhe Shekspiri e Miltoni.

## SI T'I ÇMINOJMË E SI T'I SHPARTALLOJMË AKUZAT ANTISHQIPTARE TË TITISTËVE LIDHUR ME NGJARJET NË KOSOVË

I thashë sot Ramizit të jepte porosi që të mos më dërgohen më përkthimet e kopyrave të gazetave të huaja. Këtë kërkesë e bëra, se më është e pamundur të filloj të lexoj unë ç'kanë shkruar, që nga prilli, të gjitha gazetat e botës për ngjarjet në Kosovë etj. Por materiale të tilla, mendoj, është e nevojshme të mbahen në gatishmëri, në arkivat tanë, për t'i përdorur kur të na duhen.

Pastaj Ramizit i thashë që të punojmë për përgatitjen e shpejtë të një artikulli<sup>1</sup> mbi ngjarjet e zhvilluara në Kosovë gjatë muajve mars-prill 1981.

Ç'kërkova?

Të më grumbullojnë e të më dërgojnë të gjitha materialet e mbledhjes së Lidhjes së Komunistëve në Kosovë, të Komitetit Qendror të Lidhjes së Serbisë dhe të mbledhjes së Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë që bënë mbrëmë. Këtu nuk kam parasysh fjalimet e plota që janë mbajtur në këto mbledhje, por të më dërgohen vetëm ato pjesë ku ngrihen çështje që na atakojnë ne. Pra, nuk më duhen as ato

<sup>1</sup> Është fjala për artikullin: «Kërkesa për t'i njohur Kosovës statusin e republikës është e drejtë». «Zëri i popullit», 17 maj 1981.

çështje me të cilat revizionistët jugosllavë të të gjitha niveleve shpjegojnë demonstratat, fajet e udhëheqësve kryesorë etj., se tani ato nuk na shërbejnë për gjë. Prandaj mendoj se kjo punë mund të bëhet shpejt. Në këto materiale duhet të na nxirret konkretisht që filani tha kështu, ai tjetri deklaroi kështu etj. Kjo është ana teknike e punës që duhet kryer, anë teknike, por e nevojshme që të mund të kemi të qarta akuzat që bëjnë jugosllavët kundër nesh.

Ne, sigurisht, do të presim edhe ç'do të japë Tanjugu, por në qoftë se nuk gabohem, se nuk e di serbishten, dëgjova diçka që ka thënë Milosh Miniçi, anëtar i Kryesisë së Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë dhe që përbën një provokacion të rrezikshëm në adresë të vendit tonë.

Në diskutimin që bëri në mbledhjen e Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, përveç të tjerave, Milosh Miniçi foli edhe për rolin e Shqipërisë në ngjarjet e Kosovës. Ai pak a shumë tha kështu: «Udhëheqja shqiptare, nëpërmjet veprimtarisë së organeve të saj të informacionit dhe të diplomacisë, duke përfshirë ambasadën e saj në Beograd, zbuloi vetëgëzimin dhe ndërlikimin e saj të plotë në ngjarjet që u zhvilluan në Kosovë».

Nga këto pohime të zotit Miniçi mund të dalim në disa konkluzione:

Thëniet e tij janë pa baza, janë gënjeshtër, të sajuara dhe kanë për qëllim të arsyetojnë kauzën e tyre të humbur. Por, përveç kësaj, duket qartë se nervat e këtij ish-ambasadori janë dobësuar aq shumë, sa nuk e kontrollon dot më veten. Kjo mungesë gjakftohtësie, përveç të tjerave, tregon se zoti Miniçi ka vënë nën vëzhgim të shërbimit të sigurimit jugosllav të gjitha organet e informacionit dhe të diplomacisë të Republikës

Popullore Socialiste të Shqipërisë, kudo që janë në botë, në mënyrë të veçantë ambasadën e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë në Beograd.

Mendoj se këto pohime nuk janë të qeverisë së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, pse atëherë çështja do të ishte serioze, por janë mendimet e një personi të ashtuquajtur politikani. Por ky ish-diplomat duhet të dijë se, kur një person, një grup personash ose një ambasadë e tërë e një vendi tjetër vepron në mënyrë subversive dhe në kundërshtim me rregullat e njohura në vendin ku është akredituar, qeveria e këtij vendi kërkon largimin e këtij apo të atyre personave ose mbylljen e krejt përfaqësisë. Një gjë e tillë ndaj ambasadës sonë as është kërkuar, as është bërë nga qeveria jugosllave, pse nuk ka pasur arsye. Po kështu edhe nga Qeveria Shqiptare nuk është kërkuar dhe as që është bërë një gjë e tillë, qoftë edhe ndaj një funksionari të ambasadës jugosllave në Tiranë, pse nuk ka pasur arsye. Prandaj, të afirmosh gjëra të tilla, sikurse bëri Milosh Miniçi, do të thotë të provokosh, ose të paktën të kërkojë të dobësohen marrëdhëniet diplomatike dhe shtetërore në mes Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.

Ne i themi zotit Miniç se Qeveria Shqiptare i ka nervat e fortë dhe nuk do të bjerë në këtë provokacion, por do të vazhdojë si kurdoherë të zhvillojë dhe të ruajë marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë, marrëdhënie diplomatike, marrëdhënie tregtare dhe marrëdhënie kulturore me Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë mbi bazën e parimit të mosndërhyrjes në punët e brendshme të njëri-tjetrit dhe pa konfunduar asnjëherë çështjen se këto marrëdhënie i pengojnë kundërshtimet ideologjike që ekzistojnë në mes dy partive tona. Këtë qëndrim Partia e Punës e Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë e kanë afirmuar në

çdo kohë dhe qartë. Ato e afirmojnë atë edhe tani dhe deklarojnë se do të luftojnë që marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë, marrëdhëniet tregtare dhe ato kulturore të ecin në këtë rrugë, në interesin e të dy vendeve dhe të popujve tanë.

Deklarata e bërë nga ana e zotit Miniç përbën një problem për ne, prandaj duhet diskutuar qëndrimi që duhet mbajtur. Gjatë bisedës Ramizi më tha se kjo deklaratë e Miniçit dhe deklaratat e bëra nga udhëheqës të tjerë jugosllavë kërkojnë reagim nga ana jonë. Drejt e tha ai, por unë nuk jam i mendimit të bëjmë as protestë publike zyrtare nga ana e Qeverisë sonë, as ndonjë deklaratë nga ana e ATSH-së. Kjo e dyta mund të ishte një variant për të shprehur publikisht pikëpamjen tonë.

Megjithatë si mbrëmë, ashtu edhe sot, unë e kam menduar një çikë më thellë këtë çështje. Së pari, qëndrimi i mbajtur nga ana e udhëheqësve titistë të çdo niveli, nuk mund të mbetet pa një përgjigje nga ana jonë. Por, para se ta bëjmë këtë, përpara se të përgjigjemi, ne duhet të analizojmë përse veprojnë kështu udhëheqësit jugosllavë. Këtë veprim të tyre, që shoqërohet me gjithfarë akuzash kundër vendit tonë, unë e konsideroj një provokacion, të cilin ata e bëjnë që ne të biem në të dhe jo vetëm të largojmë ambasadorin tonë nga Jugosllavia, duke bërë këtë t'u japim atyre të drejtë për të gjitha ato që kanë deklaruar kundër nesh, por të shkojmë edhe më tej, të tërheqim ambasadën tonë nga Beogradi, sepse edhe Miniçi nuk tha ambasadori shqiptar, po ambasada shqiptare. Ky është një provokacion i madh, veç ata duan që pasojën që sjell ai, të mos e bëjnë vetë, por nxitin ta bëjmë ne. Kjo që bëjnë ata është e dënueshme. Bile ne e kemi dënuar, prandaj në këtë provokacion të tyre nuk biem. Pra, pas asaj që kjo çështje nuk duhet lënë pa përgjigje, është edhe e dyta që ne s'duhet të biem në provokacionin e tyre,

përkundraz, të punojmë që këtë ngjarje ta kthejmë kundër tyre.

Sigurisht në planin ndërkombëtar titistët jugosllavë kanë dështuar, ata janë demaskuar keq, se kudo në botë flitet që asnjë nga akuzat e tyre kundër Shqipërisë nuk qëndron.

Qëllimi i tyre, gjithashtu, është që, sa të jetë e mundur, të presin të gjitha marrëdhëniet me vendin tonë, ose të paktën t'i zvogëlojnë shumë këto marrëdhënie dhe atëherë do të përpiqen të gjejnë «arsyet» dhe «argumentet» për të thënë që shqiptarët i prenë marrëdhëniet shtetërore, gjë që do të thotë se nuk ka më lidhje në mes dy vendeve. Kjo pastaj do t'u shërbejë për të thënë se në qoftë se ata, domethënë ne shqiptarët, do të ndërhyjnë edhe në të ardhmen në çështjet tona të brendshme, domethënë të Jugosllavisë, kjo do të thotë se te ne (në Jugosllavi) kanë agjenturën e tyre, pra, se ndërhyjnë nëpërmjet kanaleve të tjera, prandaj janë në dijeni se çfarë bëhet në Kosovë, në Maqedoni dhe në Mal të Zi. Kjo është e papranueshme nga ana jonë.

Tani si duhet bërë kjo punë, sepse këtë deklaratë e bëri një person si Milosh Miniçi, i cili nuk ka funksione qeveritare në Jugosllavi dhe marrëdhëniet në mes shteteve tona janë në kompetencat e Presidencës së Federatës së tyre dhe të qeverisë jugosllave. Në qoftë se Presidenca e Jugosllavisë dhe qeveria jugosllave, do të themi në artikull, pranon akuzën e një personi, cilido qoftë dhe me çfarëdo pozite që të jetë, atëherë edhe Qeveria Shqiptare dhe Presidiumi i Kuvendit Popullor i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë do të vendosin në bazë të akuzës dhe të kërkesave që bëhen. Me fjalë të tjera, udhëheqësve jugosllavë u themi bëjeni po të doni, po akuzën tuaj ne e hedhim poshtë. Natyrisht, të gjitha ato që do të themi e që do të shkruajmë, do t'i formulojmë me terma diplomatikë, siç i kemi bërë edhe

herë të tjera, që opinioni të na japë të drejtë. Pra, me arsye të plota ne e hedhim poshtë akuzën e Miniçit, se është shpifje dhe se asnjëherë ambasadat tona, në asnjë vend, nuk merren me veprimtari të tilla etj., etj.

E këtillë mendoj unë të jetë përgjigjja jonë. Që të bëhet një protestë nga ana e Qeverisë, nuk është e kohës, sepse në këtë drejtim as nga qeveria jugosllave, as nga Presidenca e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë nuk është bërë akoma gjë. As Lllazar Koliševski nuk ka thënë një gjë të tillë kur ka folur, po titistët e bëjnë me shejtanllëk këtë provokacion.

Pra, nga ana qeveritare ne nuk mund të bëjmë protestë. Mendova një herë që ministri ynë i Punëve të Jashtme të thërriste ambasadorin jugosllav dhe t'i thoshte që Milosh Miniçi, me këtë apo atë funksion, ka deklaruar një gjë të tillë. Ne duam të dimë: Është ky edhe mendimi i qeverisë suaj apo jo? Por edhe këtë hap unë mendoj ta mënjanojmë, për arsye se ka mundësi dhe probabiliteti është që jugosllavët ta pranojnë këtë se me këtë marrim përsipër thënien që ambasada jonë në Beograd bën spiunazh. Atëherë ne duhet ta heqim ambasadën tonë nga Beogradi dhe të gjendemi në një situatë të padëshirueshme, pra të biem kështu në provokacionin e tyre, pavarësisht se ua lëmë atyre fajin. Mirëpo ne nuk kemi interes për një gjë të tillë. Atëherë ç'na mbetet të bëjmë? Mua më duket se në këto rrethana na mbetet të përgatitim një artikull.

Tani, ç'përmbajtje duhet të ketë ky artikull? Ky artikull, kurdoherë me gjakftohtësi nga ana jonë, duhet të ketë përmbajtjen që thamë më lart dhe, pasi të mbarojnë të gjitha këto, të sqarojmë edhe se si qëndron çështja e kërkesës së kosovarëve për «republikë të Kosovës».

Ne do të theksojmë se me këtë artikull nuk kemi ndër mend të rikthehemi në ngjarjet e Kosovës, kush i

shkaktoi ato, ku e kanë burimin dhe si duheshin zgjidhur. Këto çështje i kemi trajtuar në dy artikujt tanë të mëparshëm të «Zërit të popullit», të datave 8<sup>1</sup> dhe 23<sup>2</sup> prill të këtij viti, prandaj nuk e shohim të nevojshme të zgjatemi, por me këtë rast dëshirojmë të vëmë në dukje histerinë e paparë kurrë të të gjitha organeve dhe organizatave të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë jo vetëm kundër shqiptarëve të Kosovës, por veçanërisht kundër Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe Partisë së Punës të Shqipërisë, kundër politikës së tyre ndaj Jugosllavisë dhe politikës së tyre ndërkombëtare në përgjithësi. Dhe të përcaktojmë këtu akuzat që na bëjnë.

Cilat janë akuzat që bëhen nga ana e tyre në drejtim të Shqipërisë dhe që ne i kemi nxjerrë? Prej tyre, pa u zgjatur në hollësi, ne duhet të nxjerrim esencën, të polemizojmë me argumente të qarta, të kuptueshme dhe të bazuara. Në mes të gjitha të tjerave duhet të vëmë në dukje edhe diçka që tha njëri prej tyre, që nuk e kuptova se ç'ishte, po e përsëritën më pas edhe shumë të tjerë një ide, sipas së cilës Jugosllavia mbron Shqipërinë. Ne duhet t'u përgjigjemi se deri në njëfarë shkalle është e drejtë kjo ide, pse interesat për mbrojtjen e republikave tona janë të përafërta në drejtimin që, në qoftë se Jugosllavia sulmohet nga superfuqitë agresive, cilado qoftë kjo, dhe në qoftë se ajo e kundërshton agresionin, Shqipëria, sikurse e ka deklaruar botërisht, do të jetë krah për krah me Jugosllavinë. Dhe këtu puqen interesat e mbrojtjes së njëra-tjetres.

Në qoftë se nga ana e tyre vihet çështja që Jugo-

1 «Pse u përdor dhuna policore dhe tanket kundër shqiptarëve në Kosovë?».

2 «Kush e nxit armiqësinë midis popujve të Jugosllavisë?».

slavia mbron Shqipërinë, ne të themi të kundërtën, se është Shqipëria ajo që mbron Jugosllavinë dhe ta shpje-gojmë këtë.

Në rast se Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë do të bënte një politikë të brendshme dhe të jashtme si ajo e Jugosllavisë, të vihet në dukje në artikull, kjo do të ishte një rrezik i madh për vetë Shqipërinë, për Jugosllavinë, për Ballkanin dhe për të gjithë Evropën. Pastaj i kuptojnë vetë ata të gjitha këto gjëra e bashkë me ta i kupton gjithë bota. Prandaj, të shtohet në artikull, Shqipëria për njerëzit politikanë të zgjuar bën një politikë shumë të drejtë, konsekuente e të palëkundshme, politikë që bëhet një faktor i tillë paqeje.

Kjo politikë është në vazhden e historisë shekullore të Shqipërisë për të gjithë ata që e duan dhe që e njohin historinë e vendit tonë, pa qenë nevoja të përmendet shprehimisht që Skënderbeu ka mbrojtur edhe Evropën. (Këtë të mos e themi ne, por idenë ta shprehim me mënyrën që thashë.)

Ne, të theksojmë në artikull, e kritikojmë dhe do të vazhdojmë ta kritikojmë politikën e brendshme dhe të jashtme të Jugosllavisë Federative, pse ajo është e mbarsur me rreziqe për atë vetë dhe për të gjitha vendet që u përmendën dhe ky qëndrim nuk mund të konsiderohet sikur Shqipëria kërkon të minojë Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë. Përkundrazi, e bën se kërkon ta mbrojë këtë Federatë, pse me këtë politikë të vetën Shqipëria mbron popullin shqiptar, mbron njëkohësisht popujt e Jugosllavisë, vendet e Ballkanit dhe Evropën. Ata që nuk e kuptojnë këtë politikë të drejtë, mund t'u vënë shqiptarëve çfarëdo epiteti denigrues, si «megalomanë» etj., etj., por realiteti kështu është.

Në artikull të vëmë në dukje se Shqipëria socialiste nuk lëviz dhe nuk ka për të lëvizur kurrë nga rruga që ka vendosur të ndjekë. Që të lëvizë ajo nga kjo rru-

gë, duhet të kalohet mbi trupat e shqiptarëve nga forcat e agresorëve, por edhe atëherë agresorët prapë do të humbasin.

Çështjen e Miniçit ne duhet ta shpjegojmë siç thamë: Njëfarë Milosh Miniçi, pavarësisht se çfarë funksioni ka, ruan të drejtën e vet të flasë edhe përçart në Komitetin Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, por Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë nuk bie në provokacionin e tij, pse lidhjet e saj shtetërore dhe miqësore me popujt vëllezër të Jugosllavisë nuk i ka farkëtuar ai. Ato i kanë farkëtuar popujt e të dy vendeve tona, duke luftuar e duke derdhur gjak krah për krah njëri-tjetrit. Me atë që bëri Milosh Miniçi kërkon që ne të presim marrëdhëniet diplomatike me Jugosllavinë për të na bërë fajtorë ne për ato që kanë ngjarë, por ne nuk shkelim në atë dhogë të kalbur. Në qoftë se qeveria jugosllave dhe Presidenca e republikës e kërkojnë një gjë të tillë, atëherë problemi vihet ndryshe. Ne e kemi thënë, dhe me këtë rast mendojmë se është me vend të përsëritet edhe një herë, se ne dëshirojmë të kemi marrëdhënie diplomatike, marrëdhënie tregtare e marrëdhënie kulturore me Federatën, veçanërisht me Kosovën dhe këtë, veçanërisht me Kosovën, e themi hapur.

Në këtë pjesë të artikullit mund të vëmë në dukje që marrëdhëniet tona kulturore si Federatës Jugosllave, ashtu edhe Krahinës Autonome të Kosovës, nuk ua ka imponuar Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë. Ato janë vendosur me marrëveshje të përbashkëta në mes palëve, prandaj është absurde të thuhet e kundërta. Si profesorët tanë, ashtu edhe çdo manifestim yni kombëtar, nuk e ka prekur në asnjë rast politikën e brendshme të Jugosllavisë, nuk ka ndërhyrje nga ana jonë në punët e brendshme të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë. Njerëzit tanë që kanë shkuar dhe shkojnë

atje në asnjë rast nuk kanë shprehur qëndrimet ideologjike të hapëta të Partisë së Punës të Shqipërisë që ajo i ka dhe do të vazhdojë t'i ketë kurdoherë kundër ideologjisë antimarksiste që udhëheq Jugosllavinë. Përkundrazi, programet e këtyre manifestimeve janë zhvilluar normalisht. Shfaqjet kulturore janë bërë me akord të përbashkët dhe askush nuk ka në dorë ndonjë dokument që të vërtetojë të kundërtën e këtyre realiteteve.

Mund të ketë edhe ndonjë gjë tjetër që ne mund ta gjejkojmë të nevojshme t'u përgjigjemi revizionistëve jugosllavë me këtë artikull.

Tani të vijmë tek ajo se si qëndron çështja e republikës së Kosovës.

Në fjalimin e tij, të themi në artikull, zoti Miniç thotë: «Politika e Shqipërisë ka dalë hapur në mbrojtje të kërkesës për një republikë të parashtruar gjatë trazirave në krahinën e Kosovës dhe se, duke vepruar kështu, ajo ka kryer një akt brutal të ndërhyrjes në punët e brendshme të Jugosllavisë».

Po edhe në këtë çështje zoti Miniç bën një shtrembërim flagrant dhe shumë të rrezikshëm për marrëdhëniet midis dy vendeve tona.

Në artikujt e mëparshëm ne kemi thënë dhe përsëri po e themi që çështja e republikës së Kosovës është një çështje e popujve të Jugosllavisë dhe e vetë popullit të Kosovës dhe se ne asnjëherë nuk kemi dalë hapur në mbrojtje të kërkesave për një republikë të parashtruar gjatë trazirave që u vërtetuan në muajt mars-prill në Kosovë. Në artikullin tonë kemi theksuar se statusin e republikës së federuar të Kosovës nuk e kemi kërkuar ne, atë e ka kërkuar vetë populli i Kosovës. Ne vetëm kemi afirmuar se është një e drejtë e popullit shqiptar, që jeton në trojet e veta në Jugosllavi të kërkojë atë që ai mendon se është e drejta e tij brenda ligjeve të Federatës dhe kemi shtuar se për mendimin tonë kjo

nuk përbën aspak një krim. Për ta vërtetuar atë që është shkruar në gazetën «Zëri i popullit», e zezë mbi të bardhë, këtë herë jemi të detyruar të përdorim dokumente zyrtare të udhëheqësve kryesorë të Jugosllavisë së Titos, si të Moshe Pijades e të tjerëve që në kohën e luftës e deri vonë.

Këtu në parantezë të shënohen citatet dhe të bëhet komenti i tyre, duke filluar nga çështjet parimore të zgjidhjes së problemit të kombësive nga ana e Titos, citate të Titos nga mbledhjet e AVNOJ-t pastaj të përdoret citati i Moshe Pijades mbi republikën e Kosovës dhe të Metohisë.

Si rezultat i këtyre citateve që ne do të rreshtojmë, do të nxjerrim konkluzionet e mëposhtme, sipas të cilave populli i Kosovës, që ka marrë pjesë në luftën kundër gjermanëve me 50 mijë nga bijtë e vet dhe sipas fjalëve të Titos, që cituam më lart, ai ka të drejtë të kërkojë në çdo kohë të drejtën e tij. Pra nuk mund të mohohet e të mos zbatohet një e drejtë e tillë, që udhëheqësit dhe forumet e larta të partisë dhe ato shtetërore jugosllave e kanë njohur në kohën e Luftës Nacionalçlirimtare.

Pse të akuzohet atëherë Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë dhe Partia e Punës e Shqipërisë që ndërhyjnë në punët e brendshme të Jugosllavisë, kur ato në fakt nuk kanë ndërhyrë, kur vetë Moshe Pijade, shoku më i ngushtë, bashkëluftëtari i Josip Broz Titos dhe anëtar i shquar i byrosë politike të Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë ka dhënë mendimin e tij me citatin që përmendëm më lart? Mos vallë Moshe Pijade ka dashur t'i japë një grusht Federatës Jugosllave apo të minojë Jugosllavinë? Ca më pak nuk ka se si të jetë kështu, siç pretendon zoti Miniç, kur akuzohen pa të drejtë Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë dhe Partia e Punës e Shqipërisë

që nuk e kanë bërë këtë kërkesë, nuk ia kanë dhënë këtë grusht serioz Federatës Jugosllave dhe nuk kanë kryer asnjë akt brutal të ndërhyrjes në punët e brendshme të Jugosllavisë.

Këto dokumente që gjenden në arkivat e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë janë të drejta dhe nuk mund të fshihen. Por a janë zbatuar? Jo, ato nuk janë zbatuar plotësisht.

Pas kësaj, në parantezë, duhet të vëmë citatet se si që gjatë luftës populli i Kosovës dhe i Metohisë, i cili përfaqësohej nga Fronti Nacionalçlirimtar Shqiptar i Kosovës e Metohisë, nën udhëheqjen e Partisë Komuniste të Jugosllavisë të Krahinës së Kosovës e Metohisë, bëri mbledhjen e tij të parë në Bujan, ku mori një vendim (dhe këtu ky të citohet), i cili, duke u konsideruar si një vendim i përfaqësuesve të popullit të Kosovës në luftën kundër okupatorëve më 1944, u paraqit në Beograd, po pikërisht atje ai u hodh poshtë.

Pastaj të vihet letra e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë dërguar Komitetit Qarkor të Kosovë-Metohisë, ku i shpjegon se vendimi që kishte marrë mbledhja e Bujanit nuk ishte plotësisht i drejtë dhe të jepen arsyet që thuhet pse nuk është i drejtë (arsyet që shkruhen në letër).

Të vihen më tej citatet e Miladin Popoviçit dhe të thuhet se në arkivat e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë ndodhen dorëshkrimet e tij dhe një nga këto dokumente ndodhet edhe në arkivat e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë.

Pas Çlirimit ose në prag të Çlirimit, Miladin Popoviçi u vra në Prishtinë nga një agjent i UDB-së ose i OZNA-s, sikurse quhej në atë kohë. Pas kësaj ngjarjeje shkoi në Kosovë ushtria, shqiptarëve atje iu mblodhën armët dhe me ta u mbushën kampet e përqendrimit.

Më poshtë të vihet citati i Dushan Mugoshës, i cili

shkoi në Beograd dhe «në emër të popullit të Kosovës» kërkoi që krahina e Kosovës t'i aneksohej Serbisë. Ky është dokumenti i parë ku Dushani thotë, në fakt, se nuk e ka marrë pëlqimin e popullit të Kosovës për arsye të shtetrrrethimit ushtarak, por do ta marrë më vonë. Pra ai nuk çoi atje zërin e popullit të Kosovës, por zërin e një shovinisti serb. Më vonë, pas tre muajve vjen dokumenti tjetër që paraqiti Dushani në mbledhje, ku pretendon se e kishte marrë pëlqimin e popullit të Kosovës, që ky të bashkohej me Serbinë, duke mbetur një provincë e saj. Këtu të vëmë në dukje organizimin e gënjeshtres rreth të ashtuquajturit vullnet të popullit të Kosovës dhe të «vetëvendosjes».

Në bazë të të gjitha këtyre ngjarjeve duhen shpjeguar demonstratat paqësore të Kosovës, të cilat u kthyen më pas në demonstrata politike. Të gjitha këto ngjarje, që janë të dokumentuara, zotërinjtë e Beogradit i fshehin, prandaj të mos përpiqen aspak të thonë që shkartarët ose organizatorët e tyre janë «reaksonarë», «irredentistë», «nacionalistë», «shovinistë». Por të gjithë këta që vumë në dukje më sipër çfarë janë? Dhe përse nuk u bë kjo analizë në Komitetin Qendror të Lidhjes? Ç'hyjnë këtu akuzat kundër Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe Partisë së Punës të Shqipërisë që s'ka ngritur kurrë çështje territoriale.

Pasi të themi të gjitha këto, të dalim me konkluzionin: Ne mendojmë se udhëheqja jugosllave ka humbur gjakftohtësinë, gjë që s'është aspak as në interesin e vetë Jugosllavisë, as në interesin e marrëdhënies të saj me Shqipërinë, as në të mirën e sigurimit ballkanik dhe të Evropës, për të cilin udhëheqja jugosllave, që është një nga protagonistet «më të shquara» të lëvizjes së Helsinkit, bën shumë zhurmë.

Me këtë rast ne mund të shprehim edhe një herë idenë që Shqipëria socialiste ka deklaruar dhe është e

vendosur që, në rast se sulmohet Jugosllavia nga një fuqi imperialiste agresive, ajo do të gjendet krah për krah me të. Të theksohet se udhëheqja jugosllave duhet të kuptojë se shqiptarët, qofshin këta të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, qofshin këta të Krahinës Autonome të Kosovës ose të republikës së Kosovës, si edhe ata të Maqedonisë dhe të Malit të Zi, do të jenë medoemos krah për krah me popujt e Jugosllavisë për të mbrojtur kufijtë e Federatës. Të themi se shqiptarët e Jugosllavisë nuk mund të jenë as kundër popujve të Jugosllavisë, ca më tepër kundër vëllezërve të tyre shqiptarë, me të cilët do të luftojnë në një llogore. Këtë gjë nuk dëshiron ta kuptojë udhëheqja jugosllave, po llogjika e kësaj politike të drejtë të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë është kjo dhe s'mund të jetë tjetër. Udhëheqësit jugosllavë, të cilëve nuk u pëlqen kjo situatë dhe kanë qëllime të tjera nga ana e tyre, mund të mendojnë të kundërtën. Po ata bëjnë gabim, prandaj do t'i dënojnë popujt jugosllavë.

I vështruar ky problem në këtë prizëm ne themi se shqiptarët e Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare të Jugosllavisë përbëjnë një faktor stabilizues në çfarëdo statusi shtetëror që mund të jenë në Jugosllavi.

Udhëheqja jugosllave, duhet thënë në artikull, do të jetë mirë të bëjë çmos që popullin shqiptar të Kosovës dhe të viseve të tjera në Jugosllavi, për të mirën e vendit, ta bëjë mik në rrugë të drejtë dhe jo armik. Edhe ne, vëllezërit e tyre në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë, luftojmë që të jemi miq me popujt vëllezër të Jugosllavisë, prandaj u themi edhe atyre që të jenë miq me këta.

Të përdoret pastaj edhe ajo që ka thënë Titoja, kur i ngrita çështjen e Kosovës dhe të viseve të tjera të banuara nga shqiptarë në Jugosllavi, se «tani nuk është koha për të ngritur kufijtë shtetërorë» dhe më pas vazh-

doi të thoshte se «ato janë territore që i përkasin Shqipërisë», ndërsa më vonë u ka thënë kosovarëve se, «duke qëndruar në Jugosllavi, ata do të jenë njësoj sikur të ishin në Shqipëri».

Me këtë Titoja nuk mohon çështjen që Kosova dhe viset e tjera në Jugosllavi të banuara nga shqiptarë nuk mund të jenë në Shqipëri, po atëherë ishte një situatë e tillë që këtë gjë «e pengonte shovinizmi serb, prandaj nuk mund të realizohej kjo e drejtë». Bile Titoja u thotë edhe këtë shqiptarëve që «ju jeni një faktor me rëndësi për të forcuar Federatën Jugosllave».

Mua më duket se në këtë kontekst ne i japim një përgjigje tjetër plotësuese dhe dërrmuese udhëheqjes jugosllave. Me argumentet që kemi artikulli duhet të bëhet i fortë dhe akoma më i qetë nga dy të parët.

Me Ramizin rashë dakord që artikullin ta botojmë nga fundi i javës tjetër.

**E PREMTE**

**8 MAJ 1981**

## **NJË LIBËR QË HEDH DRITE MBI REZISTENCËN E POPULLIT GREK GJATË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE**

Ditët e fundit, shkrimtari grek në mërgim në Suedi, Kostis Papakongos më dërgoi librin e tij në greqisht, «Kapedan Aris», një kontribut i rëndësishëm i patriotëve e i revolucionarëve grekë, që ndihmon për të hedhur dritë rreth së vërtetës mbi lëvizjen e rezistencës dhe mbi luftën e popullit heroik të Greqisë gjatë Luftës së Dytë Botërore kundër pushtuesve nazifashistë italo-gjermanë dhe forcave të brendshme reaksionare.

Kapedan Arisin, pavarësisht se nuk e pata takuar ndonjëherë, e kam njohur dhe kam vlerësuar veprën e tij revolucionare, besnikërinë që ushqente ndaj popullit grek dhe komunizmit dhe kam dënuar me zemërim e me indinjatë ata që u përpoqën ta njollosnin këtë luftëtar të shquar të rezistencës greke.

Kostis Papakongosit i dërgova një letër falënderimi.

E SHTUNË  
9 MAJ 1981

## SI T'I ÇMINOJMË E SI T'I SHPARTALLOJMË AKUZAT ANTISHQIPTARE TË TITISTËVE LIDHUR ME NGJARJET NË KOSOVË

### Mendime (vazhdim)

E kemi ndier, e ndiejmë dhe do ta ndiejmë si detyrë të përhershme të mbrojmë marksizëm-leninizmin. Kemi luftuar dhe do të luftojmë kundër teorive e pikëpamjeve revizioniste, oportuniste, reformiste, të çfarëdo ngjyre qofshin këto. Kjo është një e drejtë jona, ashtu sikurse kanë të drejtë të na luftojnë, dhe në këtë drejtim nuk lënë gjë pa bërë, të gjithë antimarksistët dhe partitë e ndryshme të borgjezisë.

Ne kemi plotësisht të drejtë të mbrojmë sistemin tonë të diktaturës së proletariatit. Të tjerët kanë të drejtë të mbrojnë sistemet e tyre. Këtë rrjedh lufta ideologjike e natyrshme dhe e pashmangshme.

Ju pretendoni se këtë luftë nuk e bëni kundër nesh. Kjo as ka qenë, as është e vërtetë. Ne e bëjmë dhe e deklarojmë, kurse ju e bëni dhe e fshihni.

Ju pretendoni se një luftë e tillë ideologjike dobëson marrëdhëniet shtetërore, tregtare, kulturore. Ne themi dhe konstatojmë se këto nuk janë dobësuar, por përkundrazi janë forcuar dhe jo vetëm për vullnetin tuaj, por edhe tonin. As ju, as ne nuk i kemi bërë koncesione ideologjike njëri-tjetrit, por jemi marrë vesh në ato gjë-

ra që e kërkon interesi i përbashkët dhe s'jemi marrë vesh në ato çështje për të cilat nuk mund të pajtohemi kurrë.

Marrëdhëniet shtetërore në bazë të parimeve të njohura të fqinjësisë së mirë kanë ecur përpara. Ne dëshirojmë që edhe në të ardhmen të vazhdojë kështu. Në goftë se ju nuk do të dëshironi, askush nuk do t'ju pengojë të veproni ndryshe. Ne do të përpiqemi të gjejmë me ju një *modus vivendi* pa shkelur parimet.

Ju pretendoni se «keni ulur vigjilencën» kundër të ashtuquajturave veprime armiqësore të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë kundër Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë. Kjo nuk është e vërtetë, pse luftën ideologjike e keni bërë hapur.

Ju pretendoni se keni qenë «zemërgjerë» për hir të vazhdimit të marrëdhënieve të mira në mes dy vendeve. Kjo, gjithashtu, nuk është e vërtetë: ju nuk vuani nga zemërgjerësia dhe as nga mungesa e luftës ideologjike kundër doktrinës sonë bazë, marksizëm-leninizmit, dhe regjimit tonë të diktaturës së proletariatit. Pse e fshihni këtë gjë?

Por, me gjithë këtë realitet, realiteti tjetër i vazhdimit të fqinjësisë së mirë dhe të marrëdhënieve shtetërore vazhdon dhe ne dëshirojmë që të vazhdojë e të përparojë. Këto kohët e fundit ju jepni përshtypjen se këto marrëdhënie doni t'i kufizoni. Për këtë merreni ju përgjegjësinë.

Fushatën antishqiptare pa baza dhe të gabuar që keni ngritur tash së fundi, por që nuk është as e re, as e dobët, ju doni ta forconi dhe do ta ngrini në një shkallë më të lartë. Bëjeni, ne nuk jemi kundër. Ju bëni tuajën, ne do të bëjmë tonën.

Ju pretendoni në mënyrë hipokrite se nuk keni vënë në korent opinionin jugosllav dhe rininë tuaj për

«mjerimin që mbretëron në Shqipëri, për mungesën e lirive dhe të drejtave të popullit shqiptar, për prishjen e kishave e të xhamive, për mbylljen e dyerve të Shqipërisë hordhive turistike prej hunësh, për mbylljen e portave tona flotës luftarake sovjetike dhe për kampet e shumta politike e për të burgosurit» etj. Ne, nga ana jonë, do të flasim edhe më shumë nga sa kemi folur për «parajsën jugosllave». Ne kemi folur për këtë «parajsë dhe begati ekonomike, shpirtërore dhe ideologjike» të Jugosllavisë, por do të freskojmë kujtesën e popullit dhe të rinisë sonë për të gjitha ato të këqija që ka parë në kurriz populli shqiptar nga ju, si para luftës, ashtu edhe pas Luftës Nacionalçlirimtare. Kjo është në logjikën e gjërave të luftës që dëshironi të krijoni.

Ju keni pretenduar pa të drejtë, dhe faktet historike vërtetojnë të kundërtën, se Jugosllavia ka pasë mbrojtur Shqipërinë. Aktualisht në plenumin e Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, që u mbajt vetëm për të goditur Kosovën dhe për të sulmuar Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë, në mes të tjerave u dëgjuan shumë zëra «të autorizuar» se «Jugosllavia Federative është mbrojtësja e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë». Kjo është një thënie «paternaliste» dhe e njëanshme, pse u harrua dhe jo pa qëllim e nga pozitë megalomane të një shteti më të madh, se edhe Shqipëria socialiste është një mbrojtëse e fortë e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.

Ne e kundërshtojmë politikën aktuale të jashtme dhe të brendshme të Jugosllavisë, pse e gjykojmë me plot rreze për vetë Jugosllavinë, për Shqipërinë, për Ballkanin dhe për Evropën, pavarësisht nga rrethanat dhe fjalët bombastike, por thellësisht të gabuara të vetadministrimit, politikës «së pavarur» dhe asaj të «të paangazhuarve».

Çdo qeveri dhe çdo njeri që kupton nga politika dhe që i ndjek situatat që zhvillohen në botë, sheh se sa i gabuar dhe i mbarsur me rreze është ky kurs i politikës jugosllave. Kjo politikë është e ekspozuar në Jugosllavi në lakmitë dhe në agresionet e mundshme të imperializmit amerikan dhe të socialimperializmit sovjetik. Ky kërcënim është pjella e rrezikshme e kësaj politike dritëshkurtër që shkakton instabilitetin brenda në Jugosllavi.

Udhëheqësit jugosllavë jo vetëm që e predikojnë, por edhe e rekomandojnë te të tjerët sistemin e tyre vetadministrues si «formën dhe sistemin më të përsosur» socialist. Udhëheqësit jugosllavë e predikojnë politikën e tyre të jashtme sikur ajo do të shkatërrojë e do të çarmatosë fuqitë imperialiste agresive dhe do të sjellë paqen dhe begatinë në botë. Kjo politikë jo vetëm që është naive, por është një mashtrim, të cilin e demaskojnë ngjarjet botërore çdo ditë.

Jugosllavia e vlerëson si një meritë të madhe të saj faktin që është e mbytur në borxhe. Këtë e quan «pavarësi ekonomike». Ajo quan ruajtje e mbrojtje të pavarësisë së saj dhe të «mosangazhimit», kur shoqërive shumëkombëshe imperialiste dhe sovjetike u është siguruar me ligj 50 për qind e fitimeve nga ndërmarrjet e përbashkëta ekonomike jugosllave. Ajo quan «të zgjuar, të hapur, të çiltër» hyrjen e turistëve të huaj dhe përhapjen e emigracionit ekonomik jugosllav në të gjitha vendet kapitaliste të botës; quan «gjest mirësjelljeje» që lejon luftanijet sovjetike të ankorohen, të riparohen e të furnizohen në portet jugosllave; quan të paevitueshme dhe gati «normale» krizën e madhe ekonomike që ka pllakosur Jugosllavinë, rritjen e madhe të inflacionit, shtrenjtësinë e jetesës së masave punonjëse. Sipas udhëheqjes jugosllave, të gjitha këto nuk kanë të bëjnë as

me vetadministrimin, as me «politikën e pavarur», as me atë të «mosangazhimit». Këto janë dy çështje që nuk influencojnë njëra mbi tjetrën, e para nuk është konsekuenca e së dytës, thonë «teoricienët» jugosllavë.

Fajin e kanë shqiptarët që jetojnë në Jugosllavi dhe Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë, që «i nxit» ata me «politikën e saj etatiste-burokratike-staliniste, nacionaliste, irredentiste».

Jo, zotërinj udhëheqës jugosllavë, mos kini frikë nga e vërteta, jini pak realistë, se nuk është ashtu siç pretendoni ju.

Juve jua ka ënda që ne të ndjekim rrugën tuaj. Kurrë s'do të bëhet kjo. Ne mund të rrojmë të varfër, por duam të rrojmë të lirë dhe të ndërtojmë mirëqenien tonë që çdo ditë rritet. Këtë e bëjmë me forcat tona. Ne nuk i kemi borxh kurrkujt, ne nuk e shesim vendin te kapitalet e huaja të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të Bashkimit Sovjetik etj. Ne s'jemi të mbyllur në vetevete, po bëjmë tregti të ndershme e me leverdi reciproke. Fakt është që me ju po e shtojmë tregtinë çdo vit. Ne jemi një faktor i rëndësishëm stabiliteti në Ballkan.

Le të merret pak me mend nga kushdo qoftë, se ç'do të ngjiste, në rast se Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë u hapte dyert kapitaleve sovjetike, amerikane dhe të vendeve të tjera kapitaliste, ç'do të ngjiste në rast se Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë u hapte anijeve sovjetike të luftës portet e Sarandës, Vlorës, Durrësit, Shëngjinit, siç bën Jugosllavia? Është e sigurt se po të bëhej kjo, do të rrezikohej jo vetëm Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë, por Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë, Republika e Greqisë, gjithë Ballkani dhe tërë Evropa.

Këtë s'e kemi bërë kurrë dhe as do ta lejojmë kurrë. Sovjetikët dhe kushdo tjetër as me dylbi s'do t'i shikojnë portet tona dhe kush do të orvatet të guxojë të bëjë një gjë të tillë, duhet të kalojë më parë mbi trupat tanë.

Populli shqiptar e ka shpëtuar një herë Evropën, rilexoni për këtë luftërat e Skënderbeut. Ai është i përgatitur dhe i vendosur ta shpëtojë përsëri, po ta lypë nevoja.

Bota kapitaliste dhe imperialiste i ka bërë shumë të këqija popullit shqiptar në çdo kohë. Edhe tani ajo përipiqet ta deformojë të vërtetën mbi Shqipërinë, ajo i ka grabitur pasuritë e saj dhe nuk dëshiron t'ia kthejë, ajo me hekur e me zjarr e ka vrarë popullin tonë dhe e ka djegur Shqipërinë dhe tani refuzon ose heziton t'i paguajë dëmet e luftës, kur të gjithë të tjerëve ua ka dhënë. Dhe kjo ngjet pse ne, një popull i vogël, duam të rrojmë të lirë, të pavarur, sovranë në vendin tonë dhe askujt s'i kemi bërë keq, veçse të mira kanë parë nga populli shqiptar.

Askush dhe asnjë forcë nuk mund të na mposhtë në të drejtat tona të ligjshme.

Zotërinj udhëheqës kryesorë jugosllavë, lini për një çast pasionet e sëmura dhe mendoni me gjakftohtësi: kjo politikë e shtetit shqiptar e rrezikon, apo e mbron Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë?

Ne kemi deklaruar dhe deklarojmë zyrtarisht dhe botërisht se, po të sulmohet Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë, ne shqiptarët e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë do të luftojmë tok me popujt e Jugosllavisë. Kjo e mbron apo e minon Federatën Jugosllave?

A mendoni ju se në këtë moment suprem, kur populli shqiptar i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, i bashkuar me popujt e Jugosllavisë, do të luftojë krah për krah, sikurse ka vepruar edhe në Luftën e Dytë Botërore, kundër një armiku ose armiqve agresorë dhe invadorë të të dy vendeve tona, populli shqiptar që jeton në trojet e veta në Jugosllavi do të na kthejë pushkën dhe do të bëhet kundër nesh duke marrë anën e sovjeta-bullgarëve ose të ndonjë agresori tjetër?

Pse, zotërinj udhëheqës jugosllavë, shtrembëroni deklaratat tona dhe përpiqeni të na vini në gojën tonë gjëra që nuk i kemi thënë? Ne kemi deklaruar dhe deklarojmë se as kemi shfaqur dhe as shfaqim kërkesa territoriale. Pse na akuzoni për shovinistë, për nxitës të irredentizmit, për nacionalistë? Duke na i bërë neve këto akuza pa vend, pa baza dhe të paqena, ju, sigurisht, dëshironi të fshihni diçka të rëndë dhe të padrejtë tuajën.

Ne nuk kemi asnjë interes të dobësohet Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë, përkundrazi, dëshirojmë që ajo të forcohet, por jo në kurrizin e shqiptarëve të Kosovës dhe të kësaj ose asaj republike. Dobësimi i Federatës i pëlqen Bashkimit Sovjetik revizionist-agresor dhe udhëheqjes revizioniste bullgare. Këtë të vërtetë ne e themi hapur, ndërsa ju keni frikë ta thoni. Për më shumë ju keni ngritur boritë se Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë dëshiron minimin e Federatës Jugosllave, po u bini borive se janë populli dhe rinia heroike shqiptare e Kosovës, ata që kërkojnë statusin e republikës, na qenkan kundërrevolucionarë dhe kërkojnë shkatërrimin e Federatës.

Ju e keni gjakosur rëndë tri herë popullin martir shqiptar që jeton në trojet e veta në Jugosllavi dhe që

me 50 mijë veta luftoi krah për krah me vëllezërit jugosllavë dhe me popullin vëlla shqiptar që dërgoi brigadat sulmuese çlirimtare të tij në Jugosllavi kundër pushtuesve nazifashistë, ballistë, çetnikë dhe ustashë. Me gjithë këtë luftë, ju me Rankoviçin e gjakosët në vitin 1945, në vitin 1966 dhe përsëri më 1981 e mbuluat me gjak.

A mund të ecet më kështu, zotërinj udhëheqës jugosllavë? A i thonë kësaj «zgjidhje e drejtë e çështjes nacionale», siç po e trumbetoni çdo ditë këtë slogan? A do ta duroni ju një terror të tillë me popullin tuaj, a do të ishit ju aq gjakftohtë dhe aq të durueshëm, siç janë treguar kosovarët përpara këtyre ngjarjeve mizore? A nuk ka të drejtë të rrojë e qetë dhe e lirë popullsia shqiptare që jeton në trojet e veta në Jugosllavi? A nuk ka të drejtë ajo që të mos i hyjë udbashi në shtëpinë e tij dhe të burgosë, të torturojë e të dhunojë trimat e trimëreshat e saj?

Shqiptarët e Jugosllavisë duhet t'i kenë të gjitha të drejtat dhe Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë do t'i mbrojë ata kur t'u shkelen këto dhe sidomos kur mbyten me gjak, siç ngjau kohët e fundit në të gjithë Kosovën.

Këto të vërteta që ne afirmojmë dhe këto të drejta që mbrojmë botërisht, ju i quani «ndërhyrje në punët e brendshme të Jugosllavisë», i quani «organizim subversiv të Tiranës» etj. Jo, zotërinj, nuk është kështu dhe nuk ju beson njeri. Populli shqiptar që jeton në Jugosllavi është i zgjuar vetë dhe di çfarë bën, s'ka nevojë as ta mësojmë dhe as ta nxitim ne, shqiptarët e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë. Ai është trim dhe i besës, di të kërkojë çka i takon, siç di të mbrohet vetë. I çmoni drejt, zotërinj udhëheqës jugosllavë, virtytet e larta të kësaj pjese të kombit shqiptar që jeton në trojet e veta në Jugosllavi, mos e bëni ar-

mik, se nuk është mirë as për ju, as për ata, në qoftë se u shkelni të drejtat që u takojnë.

Marrëdhëniet arsimore, kulturore e shkencore që Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë ka zhvilluar, në radhë të parë me Kosovën, por më pak edhe me Republikën Socialiste të Maqedonisë dhe me atë të Malit të Zi (dhe me këto të fundit më pak jo se ka munguar vullneti ynë), për mendimin tonë kanë qenë shumë normale, shumë frytdhënëse, shumë të dobishme dhe korrekte për të dyja palët. Këto marrëdhënie janë zhvilluar me pëlqimin e të dyja palëve dhe me marrëveshje në mes dy qeverive tona.

Besojmë se qeveria e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë u ka dhënë pëlqimin si Krahinës Autonome të Kosovës, ashtu edhe të dyja republikave të federuara ku jetojnë shqiptarë. Por kjo është një çështje që nuk na përket neve. Të dyja palëve na përket fakti që këto marrëdhënie ecnin në rrugën e drejtë, ato nuk kishin karakter politik, as nxitnin nacionalizmin, shovinizmin dhe irredentizmin. Bashkëpunimi shkencor dhe kulturor ka qenë vëllazëror, i çiltër, i sinqertë nga të gjitha palët. Asnjë reklamim të mungesës së korrektesës, të shkeljes së ligjeve të njëres ose të tjetrës republikë nga njerëzit në vajtjet dhe ardhjet në vendet tona, nuk u bë dhe asnjë incident, qoftë edhe i vogël, nuk ngjau.

Ne kemi bindjen e plotë se këto marrëdhënie, siç keni qejf ta përsëritni shpeshherë, shërbyen si urë për forcimin e marrëdhënieve të popullit shqiptar me popujt e Jugosllavisë. Dhe në fakt këto marrëdhënie shkuan duke u forcuar.

Turbullirat që ngjanë në Kosovë, nuk erdhën për fajin tonë, as të nxitjes e ndërhyrjes më të vogël nga ne dhe as të marrëdhënieve ekonomike, tregtare e kul-

turore në mes Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe Krahinës Autonome të Kosovës, të cilat udhëheqja e Federatës Jugosllave i konsideroi si «ndërhyrje në punët e brendshme të Jugosllavisë, si nxitje të shovinizmit shqiptaromadhi, si rivendikime territoriale, si irredentiste». Ajo këto marrëdhënie që po zhvillohen prej kohësh në dritën e diellit dhe jo në skuta, i cilësoi si frymëzim bazal të nacionalizmit shqiptar, i importuar nga Tirana, nga shkencëtarët, nga profesorët, nga akademikët, këngëtarët dhe valltarët tanë. Ky mendim shpifës dhe armiqësor asnjëherë nuk u shfaq si kritikë ose si vërejtje nga ana jugosllave.

Përkundrazi, duam të theksojmë se disa udhëheqës nga më kryesorët të udhëheqjes shqiptare në Federatë dhe në Kosovë, që u treguan nga më të egrit kundër demonstruesve në Kosovë, njerëzit tanë të artit dhe të kulturës që shkonin në Kosovë, vazhdimisht i kanë marrë si shembull dhe i kanë lavdëruar e falënderuar publikisht për mirësjelljet e tyre.

Kjo ngritje e shpatave dhe e mburojave kundër nesh nga ana e udhëheqjes jugosllave u bë sigurisht për të mbuluar diçka të tmerrshme, të llahtarshme dhe të dënueshme që ngjau në rrugët e qyteteve dhe të fshatrave të Kosovës, ku u derdh gjak i shumtë i popullit.

Sa u vranë dhe si u vranë? Kjo mbahet e fshehtë, por populli shqiptar i Kosovës i di djemtë dhe vajzat e tij që janë vranë, janë torturuar dhe janë zhdukur e burgosur. Sa më shumë të fshihet e vërteta, aq më e rrezikshme bëhet. Gjaku nuk bëhet ujë! Mos e harroni!

Udhëheqja jugosllave këtë tragjedi ia veshi «nacionalizmit», «shovinizmit shqiptar» dhe «irredentizmit», ia veshi ndërhyrjes dhe nxitjes nga ana e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe Partisë së Punës të Shqipërisë. Por kjo nuk qëndron. Kjo mund të gënjejë

disa dhe jo për një kohë të gjatë. E vërteta e plotë do të dalë në shesh dhe kjo e vërtetë do të jetë e tmerrshme për ta.

Udhëheqja jugosllave harron se kombi shqiptar është një, pavarësisht se një pjesë rron në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe pjesa tjetër në tri pjesë të Jugosllavisë Federative. Ai ka historinë, kulturën, gjuhën e tij të njëjtë, ai ka heronjtë e tij, poetët, piktorët, muzikantët etj. të përbashkët. Ky është thesari i tij i madh që ai e ruan, e kultivon dhe e zhvillon. Këto janë tiparet kryesore të një kombi.

A mendojnë jugosllavët se këto tipare të kombësisë shqiptare duhet të shuhen, duhet të cilësohen si shenjat dhe dukuritë e një «nacionalizmi romantik të perënduar, të sëmurë dhe të një shovinizmi të dënueshëm»?

Për njerëzit e Shqipërisë socialiste që kanë shkuar në Jugosllavi dhe për shqiptarët që jetojnë atje dhe që kanë ardhur në Shqipëri, që kanë shkëmbyer mendime me njëri-tjetrin për pasurimin e gjuhës shqipe, për gjenezën e popullit shqiptar, për historinë e të parëve tanë, për shkencat ekzakte, për shkencat shoqërore dhe natyrore, a mund të konsiderohen këto si nxitje të shovinizmit dhe të irredentizmit shqiptar? A mund të konsiderohen vallet dhe këngët tona popullore që janë shfaqur në Jugosllavi si nxitje të shovinizmit dhe të irredentizmit? Ky është thesari ynë, i gjithë shqiptarëve, i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë në veçanti. Planet dhe programet tona jua kemi paraqitur dhe i keni aprovuar. Ato i ka pëlqyer shumë publiku, i ka duartrokitur. Të bukurën dhe të shëndoshën të gjithë e duan.

Ansamblet tona artistike kanë shkuar kudo. Ato janë pritur dhe janë duartrokitur me një simpati dhe entuziazëm të madh nga populli grek dhe udhëheqësit e

tij, nga artdashësit dhe shtypi i këtij vendi. Po e njëjta gjë, vallet dhe këngët tona popullore i kanë pëlqyer shumë populli turk dhe udhëheqësit e tij të çdo rangu. Kështu ka ngjarë në Francë, në Itali, në Algjeri, në Tunizi, në vendet nordike e kudo. Asnjë s'na ka akuzuar as për nacionalizëm, as për shovinizëm. Ata kanë respektuar ndjenjat tona dhe ne kemi respektuar të tyre.

Pyesim: Pse ky qëndrim i udhëheqësve jugosllavë? Çfarë i shqetëson ata në realitet në kokën dhe në ndjenjat e tyre? Pse nuk e kanë ndërgjegjen të qetë? A mos mendojnë ata se kanë shkuar shumë njerëz ose grupe njerëzish nga ana jonë në Jugosllavi? Statistikat tregojnë të kundërtën dhe ne gëzohemi.

Apo mos duan të gjejnë një arsye pa bazë që këto marrëdhënie t'i ngushtojnë, t'i zvogëlojnë vajtje-ardhjet dhe shkëmbimet në shkencat, në kulturë, në arte?

Ata, po të duan, e kanë të drejtën e tyre ta bëjnë një gjë të tillë. Ne dyert nuk i sforcojmë. Ne do t'i kemi dyert të hapëta për të gjithë miqtë e sinqertë, cilëtdo qofshin këta dhe veçanërisht për vëllezërit tanë shqiptarë që jetojnë në Jugosllavi. Kjo do të shërbejë që ata të shohin «skëterrën shqiptare», sikurse thonë udhëheqësit kryesorë të Krahinës Autonome të Kosovës dhe të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe ta barazojnë atë me «parajsën jugosllave», sikurse themi ne.

Por mendimin tonë ne po e themi: në rast se jugosllavët i marrin këto masa nacionaliste e shoviniste, do të jetë gabim i madh nga ana e tyre. Shqiptarët e Jugosllavisë dhe gjithë populli shqiptar do t'i dënojnë ata dhe kanë të drejtë të thonë se jugosllavët kanë frikë nga zhvillimi i kulturës shqiptare dhe s'kanë frikë nga kultura dekadente!

Po u themi sinqerisht jugosllavëve, që masa të tilla nuk do ta qetësojnë opinionin shqiptar në Kosovë dhe në viset e tjera të Jugosllavisë dhe opinionin i shëndoshë

jugosllav e ai botëror do ta dënojnë, gjithashtu, këtë veprim.

Edhe një herë e kemi për detyrë t'u themi udhëheqjes jugosllave dhe shqiptare në Kosovë dhe në vise të tjera, të ruajnë gjakftohtësinë në mendime dhe në veprime. Udhëheqja jugosllave të shikojë me drejtësinë më rigorozë nevojat e shqiptarëve të Jugosllavisë, të mos i trajtojë keq dhe të mos diskriminojë popullsinë shqiptare, të shikojë me seriozitet dhe me objektivitet kërkesat e ligjshme të kosovarëve, të mos prekë dhe të mos trajtojë keq rininë heroike shqiptare, veçanërisht rininë studenteske, mësuesit, profesorët dhe gjithë inteligjencien patriotike të Kosovës dhe të të gjithë shqiptarëve në viset e tjera të Jugosllavisë, të mos i konsiderojë Universitetin e Prishtinës dhe shkollat fillore e të mesme shqiptare si çerdhe armiqsh, kundërrevolucionarësh, shovinistësh etj., të mos e sakatosë Universitetin e Prishtinës, me pretekstin se ka superprodhim të të shkolluarve dhe t'i hallakatë studentët shqiptarë në të gjitha universitetet e Jugosllavisë, pse asnjëri nuk gënjehet përse bëhet kjo. Shqiptari nuk e harron «vendin ku ka lënë dhe ku e ka nderë». Asnjëherë nuk mund të ketë superprodhim të shkolluarish, në qoftë se shtohet prodhimi në Kosovën e pasur dhe të varfër njëkohësisht.

Këtu duhen marrë masa serioze, të mos fshihet ky realitet i hidhur, pa ju lejojmë të bërtitni sa të doni se në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë «populli s'ka të hajë, s'ka liri».

Këto gabime të mëdha mos i bëni, po i ndreqni. Nuk duam t'ju japim mend dhe as të ndërhyjmë në punët e brendshme tuajat, por po jua themi për të mirën e përbashkët të të dy vendeve tona, se shumë i kenë acaruar çështjet me kosovarët e me shqiptarët e viseve të

tjera në Jugosllavi dhe me emigracionin ekonomik shqiptar jashtë Jugosllavisë. Ju po krijoni dasi të këta të fundit. S'janë «agjencitë tona diplomatike» jashtë, zoti Miniç, që e bëjnë këtë dasi, por jeni ju.

E theksojmë edhe një herë, dhe për këtë kemi bindjen e plotë, se Kosova nuk mund të jetë kurrë për minimin e Federatës, në rast se kjo e studion dhe e zgjidh me drejtësi këtë çështje të madhe që vetë shqiptarët kosovarë e kanë hedhur në tryezë, që vetë Titoja, Moshe Pijade, Miladin Popoviçi kanë folur për këto çështje nga ana teorike dhe praktike.

Kosova duhet të qetësohet, po atë nuk e qetëson heqja e Mahmut Bakallit dhe sjellja në krye e një Mahmut Çakalli. Kosova do të qetësohet, po të hiqet shtettrrethimi, të tërhiqet ushtria dhe policia ndëshkuese serbe, të normalizohet gjendja, të lirohen të burgosurit e pafajshëm që kanë mbushur burgjet, t'u kthehen familjeve të vrarët e tyre në demonstrata, se kjo është një çështje e shenjtë dhe humanitare. Studioni me vëmendje dhe me drejtësi kërkesën e popullit të Kosovës për republikë, zgjidhni drejt problemet ekonomike të saj. Vetëm kështu do të qetësohet Kosova, vetëm kështu do të jetë një mike e republikave të tjera të Jugosllavisë dhe brenda Federatës.

E ndiejmë për detyrë t'ju themi këto të vërteta si miq. Ju, po të doni, i hidhni poshtë, na ngjitni çfarëdo epiteti që t'ju vijë për dore. Ne duam vëllazërimin me popujt e Jugosllavisë. Bota e përparuar le të na gjykojë si ne, ashtu edhe ju.

Zoti Stane Dolanci, në intervistën që u dha gazetarëve të huaj mbi ngjarjet në Kosovë, tha në mes të tjerave se «Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë nuk ka gisht në këto ngjarje». Zoti Dolanci është një nga udhëheqësit më kryesorë, në mos kryesori, në Komi-

tetin Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë dhe atë që afirmoi e kishte të bazuar, të faktuar.

Kush e fryu gënjeshtren? Kush e shtrembëroi të vërtetën? Kujt i interesonte që të akuzohej Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë se gjoja kishte gisht në trazirat e Kosovës? Këtë le ta zbulojë udhëheqja jugosllave, zoti Miniç dhe zoti Vidiç, por ajo që u kurdis ishte një vepër monstruoze, ishte një furtunë mërie që hapi një hendek të tillë, sa që çdo jugosllav i papjekur politikisht, emrin «shqiptar» do ta barazojë me «armik të popujve të Jugosllavisë». Këta që shkaktuan këtë hendek janë përgjegjës përpara popujve të tyre, duke përfshirë këtu edhe popullin shqiptar që jeton në Jugosllavi. Ata janë përgjegjës përpara historisë.

I gjithë Komiteti Qendror i Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë pa të drejtë i dënoi njëzëri ngjarjet në Kosovë, dënoi kosovarët, dënoi shqiptarët e Jugosllavisë, dënoi Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë si nxitëse të këtyre turbullirave. Ky është një fakt që do të mbetet në ngjarjet jugosllave.

Por ne dimë të bëjmë edhe dallime në mes të atyre që morën fjalën në forumin e lartë të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë. Ne konstatuam se udhëheqësit kryesorë të Republikës Socialiste fqinje të Malit të Zi, të Maqedonisë, por edhe të Kroacisë e të Sllovenisë, megjithëse i dënuan ngjarjet, u treguan më gjakftohtë, më të përmbajtur, më tejpamës për situatat që do të zhvillohen më vonë në mes shqiptarëve dhe jugosllavëve, në mes Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Nuk mund të bëjmë të njëjtin vlerësim për udhëheqësit kryesorë të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, siç janë zotërinjtë Miniç, Vidiç, Stamboliç. Fjalimet e tyre karakterizohen nga një egërsi e shfrenuar, nga

një dell shovinist serbomadhi i paparë ndonjëherë kundër popullit shqiptar që jeton në Jugosllavi dhe kundër Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Për sa u përket atyre «udhëheqësve shqiptarë» që morën fjalën në këtë forum të lartë të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, ose jashtë këtij forumi, fjalimet e tyre, gjithashtu, u karakterizuan nga një histeri aq e madhe, sa edhe servile e shërbyese, ndaj zotërinjve të tyre, Vidiç, Miniç, Stamboliç e të tjerë. Kuptohet se këta njerëz nuk mund ta qetësojnë Kosovën. Këta «udhëheqës» fantoshë i urren populli i Kosovës dhe, në qoftë se njerëzit me mendje të kthjellët në udhëheqjen e Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë dëshirojnë të shërojnë progresivisht, por me sukses, plagën e madhe që u hap në Kosovë, këta farë udhëheqësish duhet të hidhen në shportën e plehrave. Me manovra, me kombinacione, me fokuse nuk shërohet plaga. Vëllazërimi vendoset me zemër të hapët, me çiltërsi, me sinqeritet, me njerëz të rinj që i do dhe ka besim populli shqiptar i Kosovës, që të mundin e duhet të mbushin hendekun e madh që u krijua jo për fajin e popullit shqiptar kosovar.

Kosova kërkon statusin e republikës brenda Federatës Jugosllave. Ky status përfaqëson vullnetin e një populli të madh që kërkon me të drejtë «statusin e sovranitetit» dhe jo atë të «pakicës kombëtare», që padrejtësisht i ka pasë qenë caktuar e që serbomadhi dhe armiku i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, Milovan Gjilasi, në shkrimet e tij të fundit, ka zbuluar arsyet e kësaj padrejtësie, që asnjëherë udhëheqja aktuale jugosllave nuk i ka përgënjeshtuar.

Krahina Autonome e Kosovës duhet të bëhet republikë, se ajo e meriton, ajo duhet të shkëputet nga «tutela» e Republikës Socialiste të Serbisë. Shovinizmi serbomadhi tri herë në historinë e pasluftës së Dytë Botërore e ka gjakosur rëndë Kosovën dhe ka krijuar një

situatë aq të rëndë, saqë me ekspedientë zor të shërohet.

A dëshironi ju, zotërinj udhëheqës jugosllavë, që kjo sëmundje të gangrenizohet? Ju mendojeni vetë, por ne nuk e duam një gjë të tillë. Kjo sëmundje duhet shëruar menjëherë, drejt dhe me kurajë.

Popujt e Jugosllavisë dhe populli shqiptar duan miqësi me njëri-tjetrin, por miqësia duhet të vendoset në baza të shëndosha.

Në të gjitha mbledhjet e forumeve të larta shtetërore dhe partie të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë u ngritën zëra që thoshin: «Duhet të rishikohen marrëdhëniet me Shqipërinë» etj., etj. Dy herë brenda tridhjetë vjetëve e keni thyer kupën me Shqipërinë socialiste.

Mos mendoni ju të na frikësoni? Mos ju shkon ndër mend juve se Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë merr frymë në sajën tuaj? Ju gaboheni! Juve ju janë errur sytë nga megalomania jugosllavomadhe.

Ne e kemi mendjen të ftohtë dhe zemrën të zjarrtë. Ne bëjmë edhe me restriksionet në marrëdhëniet në mes dy vendeve tona që ju mendoni të bëni. Tymi do të ecë drejt në oxhakun tonë, edhe sikur ju t'i pritni fare këto marrëdhënie.

Ne, nga ana jonë, nuk e duam në asnjë mënyrë një gjë të tillë, se s'jemi ne që i krijuam situatat e vështira në Kosovë dhe në tërë Jugosllavinë, të cilat i krijuat vetë. Ky është një pretekst që ju e ngrini artificialisht për të mbuluar ngjarjet e shëmtuara.

Edhe një herë bëni kujdes! Jini gjakftohtë! Fajet tuaja mos i ktheni në konflikt me Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë, se ky është në interes të armiqve tanë.

Serbi Petër Stamboliç foli si një serbomadhi i pa-

korrigjueshëm. Ai diti t'i mbrojë interesat serbë në kurriz të shqiptarëve dhe ndër të tjera tha se «përpyekja për pastërtinë etnike objektivisht çon në nacionalizëm». Këtë përpyekje ai e cilësoi fashiste.

E pyesim zotin Stamboliç: Populli serb nuk është një etni? A nuk e konsideron ai popullin shqiptar një etni? Pa dyshim që këta dy popuj janë dy etni.

Në qoftë se zoti Stamboliç nuk e konsideron popullin serb një «etni të pastër», pse tok me të rrojnë edhe shqiptarë, malazez, boshnjakë, turq, po ashtu edhe populli shqiptar nuk është një «etni e pastër», pse në Kosovë, ku shumica dërrmuese është e kombësisë shqiptare, rron tok me të edhe një minoritet serb, malazez e turk.

Në këto rrethana të njëllojta zoti Stamboliç po bën një fokus: «Etnia shqiptare është nacionaliste, fashiste», kurse «Serbia nuk është e tillë».

Pse zoti Stamboliç nuk e thotë më hapur se etnia më e madhe duhet të sundojë mbi të voglën, se e para duhet të jetë sovraane në kushtetutë dhe e dyta jo, se kështu i vjen për mirë etnisë më të madhe që do të shfrytëzojë më të voglën?

Në vazhdim, ky teoricien serbomadhi, që ndjek po atë vijë ultrareaksionare të akademikut famëkeq Çubrilloviq, duke dalë në tezën se «etnia e pastër» të çon në fashizëm, në nacionalizëm, në praktikë do të thotë se «etnia shqiptare duhet të shpartallohet, të humbasë ti-paret e kombit të vet, të degjenerohet, pse na është bërë ferrë në këmbë».

Për zotin Stamboliç vetëm etnia serbe mund të rrojë në miqësi me popujt e tjerë që ai i konsideron të dorës së tretë e të katërt, kurse etnia shqiptare sovraane në Kosovë nuk mund të rrojë në miqësi me minoritetet e Kosovës, si serbë, malazez dhe turq.

«Janë tronditur seriozisht marrëdhëniet midis shqip-

tarëve, serbëve dhe turqve» pohon zoti Stamboliç. Kjo është e vërtetë, por këto marrëdhënie janë tronditur vetëm ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve dhe jo në mes shqiptarëve, malazezve dhe turqve.

Pse janë tronditur marrëdhëniet ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve? Lexo fabulën e La Fontenit «Ujku dhe qengji» dhe do t'i gjesh arsyet, zoti Stamboliç.

Nga mbledhja e Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë sulmet kundër Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe Partisë së Punës të Shqipërisë kaluan në mbledhjen e Komitetit Qendror të Republikës Socialiste të Serbisë, këtë herë me një virulencë të pashoqe. Disa anëtarë me frymë të tërbuar serbomadhe dhe fashiste arritën deri atje sa të thonë «ta shkatërrojmë regjimin stalinist të Shqipërisë».

«Delenda Kartago» bërtiste në «senatin serb» një Katon i ri. Mirëpo Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë nuk është Kartagjena dhe nuk ka lindur akoma një Skipion serbomadh që ta shkatërrojë Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Çdo gjë e kemi fituar me gjak, bërtiste ky Katon i ri. Po Shqipëria me se i ka fituar liritë? Pa gjak? Bile ne i themi se i ka fituar vetëm me gjakun e saj, bile këtë gjak e kemi derdhur edhe për lirinë e popujve jugosllavë dhe për këtë as kemi qenë dhe as do të jemi kurrë pishman. Përsëri do ta derdhim, po të jetë nevoja.

Katonët e rinj të Serbisë na akuzojnë ne shqiptarët se e urrejmë popullin serb. Kjo është një shpifje monstruoze. Ne e kemi dashur dhe e duam popullin serb, ne urrejmë vetëm shovinizmin serb, shovinizmin shqiptar dhe çdo shovinizëm tjetër, pse ne jemi marksistë-leninistë, jemi internacionalistë.

Shovinistët serbë, për të maskuar shovinizmin serbomadh, po na vënë përballë ne shqiptarëve titullin

shqiptaromadh. Këtë parullë e krijoi Italia fashiste e Musolinit dhe janë të njohura qëllimet ekspansioniste-agresive të tij dhe të ballistëve, siç janë të njohura edhe ato të çetnikëve serbë. Së toku luftuam me heroizëm dhe i mundëm armiqtë e përbashkët.

Paslufta duhej të rregullonte marrëdhëniet në mes miqve dhe aleatëve shqiptaro-jugosllavë. Ne detyrën tonë internacionaliste e bëmë. Bashkë me partizanët jugosllavë luftuam për çlirimin e Jugosllavisë. Ju detyrën që duhej të bënit, për zgjidhjen në rrugë të drejtë të Kosovës, s'e bëtë. Sikurse thamë më sipër, ju folët në parim, por në praktikë zbatuat të kundërtën dhe vazhdoni të bëni demagogji.

Popullin shqiptar nuk e polli as Roma e Cezarëve, as sllavët e Stefan Dushanit, as sulltanët e Osmanëve dhe as Italia fashiste e Musolinit. Populli shqiptar ka historinë e tij shumëshekullore, plot me luftëra për liri, për ekzistencë. Dëshën dhe vepruan armiqtë e tij ta zhduknin atë, po nuk mundën. Populli shqiptar luftoi dhe rrojti në shekuj dhe qëndroi një etni kompakte, pavarësisht se e përçanë dhe e copëtuan. Kush e mohon këtë realitet, jo vetëm që shkakton të qeshura në botë, por tregon edhe ndjenjat e tij të egra shoviniste.

Shqiptarët e Shqipërisë së vogël prej gati tre milionë banorësh ose të «Shqipërisë së madhe» (apelacion që e ka përdorur pushtuesi italian, dhe tani po e përdorni edhe ju për të na akuzuar ne si shovinistë) prej më tepër se pesë milionë, janë të gjithë shqiptarë. Kësaj nuk kenë ç'i bëni zotërinj shovinistë serbë. Ekzistojnë dy Gjermani, një e Lindjes dhe një e Perëndimit, ashtu siç ekzistojnë dy Kore, një e Veriut dhe një e Jugut. Por askush nuk dyshon se ekziston një popull e një komb gjerman i vetëm, ashtu siç ekziston edhe një

popull e një komb i vetëm korean. Shqiptarët janë një etni, një popull, quaje Shqipëri të vogël ose Shqipëri të madhe. Këta shqiptarë të kësaj Shqipërie të vogël ose të madhe, që përbëjnë një popull kompakt dhe që ka të gjitha tiparet e një kombi të vërtetë, as kanë zaptuar tokat e të tjerëve, as kanë shkelur të drejtat e kurrkujt. Ata vetëm të drejtat e veta kanë kërkuar, i kanë mbrojtur dhe do t'i mbrojnë. Këtë ju e gjeni të jashtënatyrshme, e quani «shqiptaromadhe», «nacionaliste», deri edhe «fashiste». Kur Kosova kërkon statusin e republikës brenda Federatës për të cilën kanë luftuar 50 mijë partizanë dhe ka bërë sakrifica, ju guxoni ta quani këtë një kërkesë kundërrevolucionare, nacionalizëm shqiptar e plot epitete të tilla.

Ju bini në kundërshtim të hapët me parimet e shpallura dhe me ç'kanë thënë udhëheqësit tuaj kryesorë, të cilëve ju u këndoni ditë e natë himne. Ju bini në kundërshtim me parimet e së drejtës ndërkombëtare, me parimet e fqinjësisë së mirë, prandaj ju nuk mund ta keni në anën tuaj opinionin e shëndoshë dhe të arsyeshëm botëror.

Për mbrojtjen e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë nga një sulm agresiv imperialisto-revizionist duhet të përpiqemi të gjithë, por me të tilla veprime që bëni, ju nuk e forconi pozitën e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, përkundrazi, e dobësoni atë.

E MARTË  
12 MAJ 1981

## INTRIGANTËT TITISTË, SHPIFËS E GËNJESHTARË TË NJOHUR

Në një intervistë që dha ministri i Brendshëm i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, Franjo Hërlejiç, akuzoi ambasadën tonë në Beograd dhe të gjitha përfaqësitë tona diplomatike në botë, se kanë «organizuar e nxitur ngjarjet në Kosovë». Natyrisht gjithçka pretendoi Hërlejiçi dhe kolegët e tij janë krejt gënjeshtër dhe shpifje. Ato kanë për qëllim të fshehin të vërtetën rreth gjendjes në Jugosllavi, si dhe krimet e egra që jugosllavët bëjnë në Kosovë dhe në viset e tjera ku banojnë shqiptarë.

Këtij serbomadhi do t'ia bëjmë kurrizin më të butë se barkun. Intrigantët titistë janë të njohur si shpifës, si gënjeshtarë.

## PËRSËRI MBLLEDHJE E BYROSË POLITIKE PËR NGJARJET NË KOSOVË

Sot pasdreke thirra një mbledhje të jashtëzakonshme të Byrosë Politike, ku paraqita artikullin e tretë<sup>1</sup> mbi ngjarjet e fundit në Kosovë. Shokët, pasi u lexua artikulli, ishin plotësisht dakord me të dhe e aprovuan njëzëri.

## KËRKËSA PËR T'I NJOHUR KOSOVËS STATUSIN E REPUBLIKËS ËSHTË E DREJTË

Lexova edhe një herë artikullin me titull «Kërkesa për t'i njohur Kosovës statusin e republikës është e drejtë». Në këtë artikull ne analizojmë politikisht dhe historikisht qëndrimin reaksionar dhe pa asnjë bazë të udhëheqësve të ndryshëm jugosllavë ndaj ngjarjeve në Kosovë dhe kërkesës së drejtë të kosovarëve për shpalljen e Kosovës republikë. Në fakt edhe pse këto ditë për këtë çështje ata kanë folur vazhdimisht, asnjëri prej tyre nuk ka shpjeguar pse Kosova nuk mund të jetë republikë.

Artikulli do të botohet nesër.

<sup>1</sup> «Kërkesa për t'i njohur Kosovës statusin e republikës është e drejtë». «Zëri i popullit», 17 maj 1981.

E ENJTE  
21 MAJ 1981

## VEPRIM SHOVINIST DHE OBSKURANTIST I SERBOMËDHENJVE NDAJ LIDHJEVE KULTURORE ME KOSOVËN

Bisedova me Ramizin që një grup nga profesorët tanë, që kanë mbajtur leksione në Universitetin e Prishtinës<sup>1</sup> dhe një grup nga shokët e Televizionit Shqiptar të shkruajnë nga një artikull të veçantë ku të hedhin poshtë akuzat e serbomëdhenjve jugosllavë kundër punës që kanë bërë ata në Kosovë.

Profesorët dhe pedagogët tanë të vënë në dukje se të gjitha leksionet e tyre kanë pasur karakter e përmbajtje shkencore. Mbajtja e ligjëratave, e kumtesave dhe e referateve të tilla ka qenë shumë e nevojshme dhe praktikë pune në mes institucioneve shkencore e jo më në mes Shqipërisë dhe Kosovës. Të flasim për sukseset e arsimit dhe të kulturës në Kosovë, për zotësinë, zgjuarsinë dhe horizontin kulturor të studentëve dhe pedagogëve kosovarë, gjë që është vënë re edhe në simpoziumet dhe në diskutimet akademike që janë bërë në Shqipëri, në Kosovë dhe gjetkë, ku janë dalluar dije-tarët kosovarë.

Me fjalë të tjera, profesorët tanë të thonë se puna që kanë bërë në Kosovë ka pasur vetëm karakter shken-

<sup>1</sup> «Zëri i shkencës dhe era e shovinizmit». «Zëri i popullit», 26 maj 1981.

cor dhe jo politik. Jugosllavët e quajnë atë «nacionaliste», mirë le të lejojnë atëherë «shkencëtarët» sovjetikë, amerikanë dhe anglezë që të mbajnë leksione «jonacionaliste». Veprimtarinë tonë dhe vlerën e saj e kanë gjykuar studentët dhe pedagogët kosovarë. Kjo është kënaqësia jonë. Vetëm theksojmë, se vendimi që po merr qeveria jugosllave në këtë çështje, duke i këputur brutalisht këto lidhje, është një veprim që nuk ndodh asgjëkundi në botën e qytetëruar. Është e qartë se kjo bëhet për të lënë në errësirë rininë kosovare. Kjo është një tentativë e kotë shovinizmi dhe obskurantizmi.

Shokët e televizionit, po ashtu, të mbrojnë punën e mirë që kanë bërë përfaqësuesit e tyre në Kosovë dhe të kosovarëve te ne. Asnjë qëllim të mbrapshtë, asnjë paramendim «subversiv» nuk ka pasur në këtë punë. Ka pasur vetëm dëshirë për zhvillim kulturor shqiptar nga të dyja anët, një konfirmim të madh të patriotizmit, të këngëve, të valleve, të folklorit tonë të përbashkët. U kemi kënduar popullit tonë, heronjve tanë të përbashkët, kemi shfaqur ndjenjat tona të përbashkëta dhe asnjëherë nuk kemi fyer ndjenjat e popujve të Jugosllavisë. Këtë zhvillim, këtë bashkëpunim, të aprovuar edhe nga qeveria jugosllave, ata e quajnë nxitje për «nacionalizëm, shovinizëm, irredentizëm». S'mund të thuhet më qartë se kaq se Serbia nuk do që Kosova të zhvillojë arsimin dhe kulturën e vet, por do që ta serbizojë atë me historitë e Milanëve, Dushanëve, të Brankoviçëve dhe të harrojë Skënderbeun, trimat e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Bajram Currin, Isa Boletinin e të tjerë. Për shovinistët serbë t'i këndosh historisë së këtyre është krim, është «romantizëm i sëmurë», është «të kujtosh fantazmat».

Të gjitha këto shpifje absurde të hidhen poshtë nga njerëzit e televizionit tonë, të fliten fjalë të mira

për këngëtarët e valltarët e talentuar kosovarë, të cilët duhet ta vazhdojnë dhe ta zhvillojnë traditën, siç po bëjmë edhe ne.

Të theksohet se Televizioni Shqiptar nuk do t'i prishë protokollet e nënshkruara, por do t'i vazhdojë dhe do t'i zgjerojë më shumë programet e vendosura.

Një ofensivë të këfillë të bëjnë edhe njerëzit tanë të shquar të gjinive të ndryshme të letërsisë, të artit, të kulturës, të teatrit. Të mbahet ngritur vazhdimisht kjo çështje, jo vetëm si polemikë, po në platformën e lartë të artit dhe të kulturës.

Kjo punë të bëhet veç asaj që leksionet e referatet që pedagogët e profesorët tanë do të mbanin në Universitetin e Prishtinës, të jepen, siç kam rekomanduar, me anë të emisioneve të posaçme të Radiotelevizionit Shqiptar.

**E PREMTE**

**22 MAJ 1981**

## **DUHET TË PUNOJMË QË OPINIONI PUBLIK NDËRKOMBËTAR TË JETË NË FAVOR TË ÇËSHTJES SË KOSOVES**

Po vëmë re se Kë d'Orseja<sup>1</sup> në përgjithësi nuk po tregohet dashamirëse ndaj çështjes sonë dhe aktualisht nuk po mban qëndrim të paanshëm. Përkundrazi, ajo po favorizon Jugosllavinë. Kjo nuk është në interesin tonë. Por në Francë ne kemi miq si Robert Eskarpiti, që flasin me simpati të madhe e publikisht për Shqipërinë. Dihet se personalitete të tilla me rëndësi si Robert Eskarpiti, ashtu edhe shkrimtarë, publicistë, profesorë të njohur kanë edhe rrethin e tyre. Prandaj Ministria jonë e Punëve të Jashtme, në radhë të parë, duhet të mendojë se si duhet punuar me këto personalitete miq në favor të çështjes sonë.

Tani që në fuqi në Francë erdhi Miterani, me siguri do të bëhen ndryshime të mëdha edhe në qeveri.

Ministër i Punëve të Jashtme të Francës, për shebull, mund të bëhet Zhoberi, i cili, me sa di unë, kur ka qenë një herë në këtë post, në kohën e Pjer Mesmerit, ndiqte një politikë me nuanca antiamerikane dhe pikërisht për këtë arsye dha dorëheqjen dhe iku. Pra, kam përshtypjen se atëherë Zhoberi u tërhoq, pse nuk ishte për një politikë shumë të afishuar proameri-

<sup>1</sup> Selia e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Francës.

kane, por për një pavarësi politike më të theksuar të Francës nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Ja në këtë drejtim e për këtë çështje Ministria jonë e Punëve të Jashtme duhet t'i japë të dhëna ambasadorit tonë në Paris, ta udhëzojë atë si duhet të bisedohet e çfarë të bisedohet, çfarë lidhjesh duhet të mbajë me personalitete të ndryshme. Këtu nuk është fjala për receta të gatshme e të shkruara, për të dhënë një darkë apo drekë, por si duhet e çfarë duhet t'u shpjegohet këtyre njerëzve për problemet dhe qëndrimet politike të Qeverisë Shqiptare për çështje të përgjithshme të politikës e të ngjarjeve ndërkombëtare apo të çështjeve konkrete të politikës sonë të jashtme. Domethënë këta persona t'i shohin e t'i kuptojnë qëndrimet dhe veprimet tona politike ashtu siç janë, të drejta, të arsyeshme e parimore e jo rrjedhime të një politike pasionesh, siç duan ta paraqesin disa.

Ja, për shembull, të marrim ngjarjet në Kosovë. Për to duhet t'u flitet jo thjesht sa për t'i informuar e për t'i bindur për drejtësinë e qëndrimeve që kemi marrë ne, por, duke pasur parasysh rrethin dhe mundësitë e njërës a tjetrit për të influencuar mbi të tjerët në favorin tonë, t'ua ekspozojmë qëndrimet tona politike dhe ky ekspozim që do t'u bëhet, të ketë frymën e një bashkëbisedimi si në mes kolegësh e miqsh.

Kjo punë ka rëndësi të madhe për ne. Ne nuk duhet të lëmë që përhapja dhe jehona e qëndrimeve tona politike të mbetet vetëm në duart e opinionit gazetaresk, të këtij apo të atij gazetari, të kësaj apo të asaj rryme, por duhet ta përpunojmë këtë opinion dhe t'ia forcojmë bindjen rreth drejtësisë së politikës sonë. Ne, pra, duhet të kemi parasysh një gjë: opinionin jashtë nuk krijohet pa orientime. Janë gënjeshtër ato që thuhet se shtypi atje është i lirë e demokratik. Në demokracinë borgjeze ai është i lirë e demokratik deri në njëfarë shkalle, se në

thelb ai orientohet e manipulohet nga dikush dhe jo nga dikush në përgjithësi, por nga dikush në kuptimin konkret. Në demokracinë borgjeze ekzistojnë interesat e grupeve financiare e monopoliste. Këtyre interesave u konfirmohen e u nënshtrohen si shtypi, ashtu edhe politika e përgjithshme e qeverive borgjeze dhe si rezultat opinionin gazetaresk i konformohet e i shërben politikës së përgjithshme të qeverisë së vendit të vet. Këtë nuk duhet ta harrojmë.

Prandaj në këtë drejtim duhet të punojmë e të punojmë seriozisht dhe jo të ecim, siç thotë francezi, *à la lettre* dhe *à la dérive*<sup>1</sup>, të themi fjalën tonë, pa le të dalë ku të dalë, më tej nuk na duhet gjë! Jo kështu. Ne jo vetëm duhet ta themi fjalën tonë, por duhet edhe të punojmë që ajo të zërë vend në opinionin publik, ta përpunojmë atë që të na kuptojë drejt e të na mbështetë.

Aktualisht janë ngjarjet në Kosovë dhe lidhur me to çështja e vetë Jugosllavisë. Ne kemi ndjekur dhe duhet të ndjekim me vëmendje të veçantë jehonën, përshtypjet që krijojnë ato në qarqet gazetareske në botë e sidomos në Evropë. Duke u nisur nga fakti se këto qarqe përfaqësojnë opinionin e qeverive të vendeve të tyre, në atë formë që theksova më lart, ne duhet të bëjmë dallimin cila gazetë, cili shtyp është treguar më në favorin tonë, të çështjes sonë të drejtë, domethënë të çështjes së drejtë të popullit të Kosovës dhe të pikëpamjeve që kemi shprehur ne në mbështetje të vëllezërve tanë kosovarë e të kërkesave të tyre.

Ne duhet të bëjmë, gjithashtu, një analizë edhe të qëndrimeve që kanë mbajtur kancelaritë e ndryshme, domethënë të përcaktojmë e të njohim cilët ambasadorë të vendeve të botës, sidomos të vendeve të Evropës e në mënyrë të veçantë të atyre vendeve që kanë ose që

1 Frëngjisht — këtu: në mënyrë shabllone; pa drejtim.

mund të kenë influencë mbi qeverinë jugosllave, janë treguar pro nesh, kundër veprimeve të jugosllavëve dhe i kanë dënuar ato. Këtu të mos harrojmë se ka edhe nga ata që janë treguar asnjans.

Deri tani kemi parë se disa gazeta kanë shkruar më realisht në favor të çështjes së popullit të Kosovës dhe të qëndrimit tonë. Të tilla janë disa gazeta e gazetare të Republikës Federale të Gjermanisë, pra gjermanoperëndimorët, pastaj vijnë austriakët. Me Gjermaninë Perëndimore ne nuk kemi as lidhje diplomatike, ndërsa me Austrinë marrëdhëniet janë të mira. Austriakët mbajnë këtë qëndrim, sepse kanë kontradikta për çështje pakicash me jugosllavët, kurse gjermanoperëndimorët nuk kanë. Prandaj ne duhet të gjykojmë pse Gjermania Perëndimore mban qëndrim më realist ndaj shqiptarëve të Kosovës dhe ndaj Shqipërisë, e cila e ka kritikuar kurdoherë dhe është në mosmarrëveshje me të.

Pra, unë mendoj se për çështjen e Kosovës ne duhet t'i interesojmë ata që janë të interesuar, pavarësisht nga ç'arsye nisen, që ajo të zgjidhet në mënyrë të favorshme, domethënë ne duhet t'u japim atyre disa sinjale që të punohet në drejtimin që na intereson neve.

Unë kam arritur në këtë mendim dhe them se duhet menduar e gjetur rasti, momenti dhe forma e përshtatshme, se si duhet paraqitur e si duhet vepruar me këtë çështje. Ndoshta duhet të presim edhe ca, ashtu siç bëmë edhe me dy artikujt e parë<sup>1</sup>, që artikulli ynë i fundit<sup>2</sup> të bëjë punën e vet, të shikojmë reagimin e opinionit botëror, a do të jetë ai pro apo kundër nesh, do të jetë

1 a. «Pse u përdor dhuna policore dhe tanket kundër shqiptarëve në Kosovë?». «Zëri i popullit», 8 prill 1981.

b. «Kush e nxit armiqësinë midis popujve të Jugosllavisë?». «Zëri i popullit», 23 prill 1981.

2. «Kërkesa për t'i njohur Kosovës statusin e republikës është e drejtë». «Zëri i popullit», 17 maj 1981.

i ftohtë, i vakët apo i nxehtë. Të presim edhe reagimin jugosllav. Mbasandaj mund të arrijmë në një konkluzion.

Atë çka thashë për Republikën Federale të Gjermanisë, për shembull, e thashë në bazë të reagimeve që patën atje dy artikujt e parë. Tani të shikojmë çfarë reagimesh të tjera do të ketë pas artikullit të fundit. Por mbrëmë lexova një artikull që ishte shumë i mirë dhe më duket se ishte shkruar në një mënyrë të tillë, që të linte të kuptoje sikur autori i shkrimit shtronte mendimet e veta dhe nuk e kishte lexuar artikullin tonë. Por unë krijova bindjen se ai e ka lexuar atë dhe se me qëllime të caktuara nuk e përmend. Kjo është një manovër diplomatike. Ne, pra, duhet t'i kuptojmë këto gjëra dhe jo të ecim kuturu.

Kështu, pasi të kemi arritur në konkluzione të sakta për këto qëndrime të favorshme, duhet të gjejmë cili nga ambasadorët tanë ka, për shembull, lidhje me gjermanoperëndimorët. Me ta kanë lidhje të gjithë, por veçanërisht lidhje më konkrete, më duket, ka ambasadori ynë në Vjenë ku, siç dihet, trajtohet edhe çështja e dëmshpërblimeve. Ne në artikullin tonë të fundit, duke u shprehur se ka vetëm një popull e një komb gjerman, qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë i dhamë një sinjal të butë dhe pamë se kjo u vu në dukje menjëherë atje. Domethënë në Gjermaninë Perëndimore krijuam, siç po duket, një atmosferë dashamirëse ndaj vendit tonë, që mund të ketë edhe pasoja politike jo vetëm në mbrojtjen e çështjes sonë aktuale kundrejt jugosllavëve, por edhe për çështjen e dëmshpërblimeve.

Atëherë, ashtu siç thotë francezi *decemment*<sup>1</sup>, ambasadori ynë, në një takim të rastit që mund të ketë me ambasadorin gjerman, ia hap këtë çështje pa pasion, por duke i thënë afërsisht: Kemi konstatuar se shtypi juaj

1 Frëngjisht — me korrektësi.

ka shkruar me dashamirësi për çështjen e Kosovës dhe për qëndrimin tonë lidhur me të, dhe, megjithëse nuk kemi relata aq të mira me ju, këtë gjë e kemi çmuar si një gjykim realist të shtypit të Gjermanisë Perëndimore. Mund të mos jetë kështu, të vazhdojë ambasadori ynë, por unë kam arritur në përfundimin se, pavarësisht nga mosmarrëveshjet që kemi midis nesh, rreth kësaj çështjeje edhe qeveria e Bonit mendon realisht dhe shikon se veprimet e jugosllavëve janë shumë të gabuara dhe këtë e bën jo për hatrin tonë, por për interesin e përgjithshëm të paqes në Evropë. Ne, nga ana jonë, mendimet rreth këtyre ngjarjeve dhe qëndrimit të jugosllavëve i kemi shprehur deri tani në tre artikuj. Dhe të vazhdojë: Pavarësisht nga mosmarrëveshjet, marrëdhëniet dhe bisedimet midis nesh kanë qenë kurdoherë miqësore, prandaj ju flas hapur dhe, nëse ju dëshironi, zoti ambasador, mund t'ju jap artikullin tonë të fundit. Por, do t'ju lutem, e lexoni me kujdes të madh dhe arsyetoni realisht rreth qëllimeve të vërteta të Qeverisë sonë. Aty ne mbrojmë vëllezërit tanë kosovarë që janë në shumicë, mbrojmë Federatën Jugosllave, mbrojmë edhe paqen në Evropë. Udhëheqja jugosllave nuk dëshiron ta shikojë këtë çështje kështu. Në artikull ne japim edhe mënyrat dhe rrugët se si duhet të zgjidhet kërkesa e popullit të Kosovës dhe kush duhet ta zgjidhë atë. Kosova nuk mund të qetësohet, ashtu siç mendojnë qeveritarët jugosllavë. Përkundrazi, në rast se nuk merren disa masa, ajo do të bëhet një gangrenë e rrezikshme. Haptazi themi ne se udhëheqja serbe nuk dëshiron ta gjejë rrugën e drejtë të zgjidhjes dhe kjo do t'i shkaktojë dëme të mëdha vetë Federatës Jugosllave, gjë të cilën ne nuk e duam. Prandaj këtu duhet të ndërhyjë dikush tjetër. Lexojeni artikullin tonë dhe do të shikoni se ne aty bëjmë diferencime. Për shembull, ne e kuptuam zotin Dolanc, kur foli herën e parë dhe me të drejtë tha se ne nuk kishim

marrë pjesë në ngjarjet e Kosovës. Ai ishte i sigurt për atë që tha atëherë. Në të njëjtën kohë edhe neve na jepte të kuptonim se duhej të mos flisnim. Ne, të vazhdojë të thotë ambasadori ynë, e kuptuam këtë dhe nuk folëm. Por Dolancin nuk e kuptuan shokët e tij. Ata filluan sulmet e ashpra e të vazhdueshme kundër nesh, prandaj u detyruam t'u përgjigjeshim atyre.

Pas gjithë këtyre gjërave që ngjanë, në artikullin e fundit ne përsëri themi se dimë të gjykojmë me gjakftohtësi e të bëjmë diferencime dhe këto diferencime po i bëjmë. Ne mendojmë se për ngjarjet aktuale dhe për kërkesën e drejtë të popullit të Kosovës dikush duhet të reflektojë me gjakftohtësi, që ato të zgjidhen drejt, popullit të Kosovës t'i jepen të drejtat që kërkon dhe kjo në rrugë të drejtë. Udhëheqja e Serbisë këtë gjë nuk dëshiron ta bëjë. Si rezultat punët do të acarohen.

Kështu ambasadorit gjerman ne nuk i themi drejt-përsëdrejti të ndërhyjë qeveria e Bonit, as dikush tjetër. Unë, t'i thotë ambasadori ynë, flas me ju si koleg, sepse, siç ju thashë, konstatoj se Gjermania Perëndimore i shikon drejt këto probleme. Ne mendojmë se çështja duhet të zgjidhet ashtu siç e kërkojnë kosovarët. Ne deklarojmë haptazi se të drejtat e kosovarëve, që dikush ua mohon dhe i shtyp, do t'i mbrojmë. Me sharje, me slogane dhe me demonstrim të forcës, me mbylljen e universitetit, me gjyqe false, që dihet pse bëhen, nga cilët e për ç'qëllime bëhen, kjo çështje nuk zgjidhet. Por në Jugosllavi duhet të ketë njerëz, të cilët kanë autoritet dhe këtë autoritet ata duhet ta përdorin për të mirën e Federatës së Jugosllavisë. Këtë e kemi thënë sinqerisht dhe ne as nuk flasim, as nuk jemi me dy faqe. Ne e themi të vërtetën haptazi, ja, kështu siç po flas tani me ju, edhe pse, siç ju thashë që në fillim, nuk kemi marrëdhënie aq të mira me ju, por e bëj sepse për këto probleme nga ana juaj shoh një logjikë të drejtë e në

interes të paqes në Evropë. Ne ndjekim, gjithashtu, me vëmendje edhe qëndrimin që mban kancelari Shmid në lidhje me politikën e përgjithshme në mes Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Pse ta fshehim këtë. Prandaj po jua themi, dhe ju duhet ta dini, që ne jemi në rrugë të drejtë dhe nuk ka kush të na lëkundë nga kjo rrugë. Ne nuk kemi frikë nga askush, pra as nga jugosllavët. Kur shprehemi se nuk duam që Federata të priset, këtë nuk e duan as kosovarët dhe, besojmë, nuk e doni as ju.

Ambasadori gjerman mund t'i thotë ambasadorit tonë: Pse m'i thua këto gjëra mua?

— Jua them, — t'i përgjigjet ambasadori ynë, — për të sqaruar pozitën tonë dhe, e përsëris, ia them një ambasadori, me të cilin kam pasur bisedime për probleme që ende nuk po zgjidhen, megjithëse ne kemi të drejtë për to, pse shoh që shtypi juaj këtë çështje e shikon me dashamirësi.

— Po ç'mund të bëj unë? — ndoshta do t'i thotë përsëri gjermani.

— Nuk e di, — t'i përgjigjet shoku ynë. — Unë vetëm si përfaqësues i Shqipërisë po ju them disa çështje, po jua ritheksoj ato, se për të thënë ato i ka thënë e i ka shtruar mirë artikulli i gazetës sonë.

Në këtë mënyrë, ne ndërmarrim një veprim diplomatik që kjo çështje të zgjidhet në favorin tonë, domethënë në favorin e Kosovës, që është në të drejtën e saj. Duke vepruar kështu, ne nuk qëndrojmë vetëm me artikujt që kemi botuar dhe me mendimin se këta artikuj i mbështetin gjoja të gjithë pa përjashtim, i mbështet gjoja gjithë shtypi botëror. Por ne dallojmë cili shtyp është më në favorin tonë, mbasi e dimë se jo i gjithë shtypi botëror, pa përjashtim, është në favorin tonë. Ka edhe gazeta që nuk janë në favorin tonë, por që në këtë rast arrijnë në konkluzionin se qëndrimi ynë është i

drejtë. Pra, armiku ynë thotë se ju keni të drejtë dhe ky armik ka influencë të madhe në Jugosllavi, i ka dhënë asaj kredi e para, ka pranuar 700 deri në 800 mijë punëtorë, shumica e të cilëve shqiptarë, që punojnë e jetojnë në Gjermani. Prandaj ne nuk duhet të presim shumë gjatë e të shohim çfarë do të thonë ata e çfarë të themi ne, që artikulli të bëjë punën e vet, të bëjnë punën e tyre edhe jugosllavët e të tjerët dhe pastaj të veprojmë kështu apo ashtu. Jo.

Unë them se kjo punë përbën një objektiv të veçantë të diplomacisë sonë në drejtim të Republikës Federale të Gjermanisë. Një hap të tillë mund ta bëjmë edhe me Turqinë, por turqit nuk pinë shumë ujë në Jugosllavi, nuk kanë influencë atje.

Franca nuk flet. Shtypi i këtij vendi thotë se ka urdhër nga qeveria që të jetë «i paanshëm»!

Greqia edhe flet, edhe nuk flet në favorin tonë. Në Greqi ata që flasin, bile që kanë edhe influencë, e bëjnë këtë sepse nuk duan që Jugosllavia të priset. Edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës flitet pro nesh, por ne nuk u drejtohem këtyre. Shteteve të Bashkuara të Amerikës mund t'u thotë kancelari gjerman Shmid se ç'po bëhet në Jugosllavi me Kosovën e kosovarët e t'u shprehë mendimin se kjo nuk është e drejtë.

Me qeverinë austriake jemi një çikë më afër, mund ta bëjmë këtë hap, por me një formë tjetër, sepse austriakët nuk kanë influencën e gjermanoperëndimorëve në Jugosllavi dhe, përveç kësaj, kanë edhe problemin e pakicës kombëtare me Jugosllavinë.

Po vij përsëri te çështja që një nga ambasadorët tanë duhet të bisedojë, të marrë kontakt me një nga ambasadorët e Republikës Federale të Gjermanisë. Por plani i këtij bisedimi duhet të hartohet me mend, pse këtë ve-

prim e konsideroj si një përpjekje diplomatike që ka për qëllim të dobësojë shovinizmin serb. Ne zgjedhim pikërisht Gjermaninë Perëndimore si një vend që ka mundësi të influencojë mbi udhëheqjen jugosllave, po sa e qysh do të influencojë, këtë nuk mund ta dimë. Qëllimi ynë, që synon në vendosjen e stabilitetit paqësor në Evropë, është që Republikën Federale të Gjermanisë, e cila ka interesa ekonomike në Jugosllavi dhe është kundër sovjetikëve, ta interesojmë që, lidhur me këto ngjarje, të ushtrojë influencën e vet mbi këtë vend. Po në ç'drejtim të influencojë? Që Kosova të bëhet republikë? Askurrë të mos na shkojë në mendje që të bëhet kjo nga ana e Gjermanisë Perëndimore. Megjithatë mund të na shkojë në mendje që kjo t'u thotë udhëheqësve jugosllavë të ulin gjakrat në Kosovë, të mos i acarojnë, gjithashtu, marrëdhëniet me Shqipërinë. Kjo gjë do të jetë pozitive për ne dhe një dobësim i pozitave të shovinistëve serbë.

Ne mendojmë që, në rast se ndërhyr në këtë çështje Republika Federale e Gjermanisë, ajo do ta bëjë këtë në ato qarqe ku ka mundësi të dëgjohet më shumë fjala e saj, domethënë te sllovenët e te kroatët dhe jo te serbët. Pra presioni i saj mbi serbët, në qoftë se mund të bëhet, do të bëhet tërthorazi, domethënë do të ushtrohet nga ana e sllovenëve dhe e kroatëve.

Po çështja varet edhe nga vetë kosovarët. Në qoftë se këta do ta vazhdojnë kërkesën e tyre në forma të ndryshme, por të vazhdueshme për republikën, atëherë përveç presionit nga ne, pse ne do t'u përgjigjemi masave që mund të marrin serbët kundër kosovarëve, presioni që do të bëhet kundër jugosllavëve nga opinioni ndërkombëtar dhe veçanërisht, në qoftë se ia arrijmë, edhe nga ana e Gjermanisë Perëndimore, kjo do t'i detyrojë udhëheqësit e tjerë, nga pjesët e ndryshme të Jugosllavisë, të kërkojnë ta marrin këtë çështje në shqyrtim.

Po ç'të marrin në shqyrtim? Që ta bëjnë Kosovën republikë? Jo, kjo do të jetë pika e fundit, por që ta bëjnë Kosovën një element më të rëndësishëm, shumë më të rëndësishëm, njëqind herë më të rëndësishëm se ç'është tani që është nën vartësinë e Serbisë. Edhe pas shqyrtimit të kësaj çështjeje, Kosova mund të mbetet prapë nën Serbinë, por ekonomikisht ajo do të ndihmohet më shumë, çështja kombëtare dhe ajo arsimore në Kosovë do të shikohen më drejt e kështu do të vijë gradualisht me radhë gjithë çështjet e tjera.

Prandaj, ky problem nga Ministria e Punëve të Jashtme duhet të mendohet që tani, pastaj e caktojmë ne se kur duhet bërë kjo përcapje. Por ky hap duhet të bëhet në një mënyrë të atillë që ambasadori gjerman të kuptojë përse ia themi ne. Gjithashtu t'i lëmë atij të kuptojë që këtë ia themi pa asnjë qëllim, megjithëse ai do të kuptojë që ne synojmë diçka, prandaj ia ngremë këtë çështje. Këtu rëndësi të madhe ka fakti diplomatik i paraqitjes së këtij problemi.

Përveç kësaj të përgatiten shkrime nga profesorët e pedagogët tanë për të hedhur poshtë akuzat që bëjnë jugosllavët. Edhe Radiotelevizioni ynë të hedhë poshtë akuzat që i ka bërë Radiotelevizioni i Prishtinës. Këto të jenë, me fjalë të tjera, përgjigje të një niveli të lartë shkencor dhe duhet të bëhen, bile sa më parë. Ne do t'i ndjekim me kujdes këto, që të shikojmë reagimin që do të shkaktojnë edhe këto përcapje, siç do të ndjekim reaksionin e artikullit të tretë të «Zërit të popullit», që po e ndjekim çdo ditë dhe që do ta shohim akoma më mirë në ditët e ardhshme.

Shohim tani që propaganda serbe i ka ulur pendët. Atje u fol një herë vetëm para katër ditësh, po edhe ajo që u bë ishte diçka e paargumentuar, kashtë dhe tani sa vete kjo «kashtë» po bëhet «hi», për arsye se propaganda serbe nuk ka baza ku të na atakojë.

Prandaj mendoj që ne të gjejmë një moment tjetër të rëndësishëm, të përdorim në këtë çështje një armë që na e japin sovjetët-bullgarët. Kur për ngjarjet në Kosovë ka folur gjithë bota, deri edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe radioja «Zëri i Amerikës», që janë armiqtë tanë, bile kanë folur në mënyrë asnjëse, sovjeti dhe bullgari nuk folën. Duke përfituar nga ky qëndrim i sovjetët-bullgarëve, ne do t'u drejtohem edhe atyre me një artikull të fortë ku do të vëmë në dukje se përse ata nuk folën për këto ngjarje të rëndësishme që ndodhën në Kosovë dhe do t'u themi se ju nuk folët për disa arsye: se ju dëshironi që midis popujve të Jugosllavisë dhe atij të Shqipërisë të zhvillohen grindje, nga të cilat të përfitoni për vete, por gaboheni. Ne do të diskutojmë me njëri-tjetrin, do t'i gjejmë punët vetë me njëri-tjetrin, ndërsa kundër jush do të jemi të bashkuar, prandaj ju nuk do të fitoni gjë nga një qëndrim i tillë. Arsyeja tjetër e këtij qëndrimi është që ju dëshironi të grindemi ne, me qëllim që të dobësohet situata si në Jugosllavi, ashtu edhe në Shqipëri, me synimin që, në momentin që juve do t'ju duket i përshtatshëm, të mund të na sulmoni dhe të na gjeni të dobësuar. Por edhe në këtë çështje gaboheni, se këtij qëllimi nuk do t'ia arrini, sepse ne do të jemi të fortë. Një arsye e tretë është se ju brenda në Jugosllavi keni elementët tuaj që veprojnë në drejtimet që thamë më lart. Se kush janë këta, kjo s'na përket ne shqiptarëve t'i zbulojmë, kjo i përket qeverisë jugosllave të gjejë cilët janë ata që punojnë nën rrogë në favorin tuaj për t'ia arritur qëllimet që thamë më lart. Kurse te ne, në Shqipëri, ju nuk keni asnjë bazë mbështetjeje, pse çdo gjë pro jush ne me kohë e kemi likuiduar.

Një artikull i tillë, i përgatitur dhe i botuar në momentin e duhur, mendoj se do të shërbejë shumë për t'i dhënë të kuptojnë si opinionit botëror, edhe jugosllavëve,

që shqiptarët janë të vendosur t'i rezistojnë një sulmi kundër Shqipërisë dhe Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe të dy këto vende, në një eventualitet të tillë, do të ndodhen së toku<sup>1</sup>.

Ofensiva e fundit që do të bëjmë, në rast se me festimet e Traktatit të Shën-Stefanit bullgarët do t'i çojnë kufijtë e tyre deri në Shqipëri, atëherë ne përnjëherë duhet të marrim vendim të prishim edhe Traktatin që kemi me Bullgarinë dhe ky do të ishte kulmi. Në qoftë se bullgarët nuk do të flasin për kufijtë e Shqipërisë, edhe ne nuk do të flasim. Traktati Bullgaro-Shqiptar ka vdekur për ne, le të tremben prej tij shovinistët serbë po të duan, në qoftë se ngacmojnë shqiptarët, ne e kemi shkëlmuar përgjithmonë Traktatin me Bullgarinë, ashtu siç kemi shkëlmuar 13 vjet përpara edhe Traktatin e Varshavës.

1 «Ngjarjet e Kosovës dhe bashkëpunimi i fshehtë sovjetë-serbomadh», «Zëri i popullit», 5 qershor 1981.

## PROVOKACION I AMBASADËS JUGOSLLAVE

Sot në mbrëmje ambasada jugosllave në Tiranë bëri një provokacion. Ambasadori njoftoi se në orën 21<sup>17</sup> në tarracën e kuzhinës së ambasadës ndodhën dy plasje bombe.

Ai kërkoi që në vendin e ngjarjes të shkonin përfaqësues nga Ministria jonë e Jashtme dhe lejuan që të marrin pjesë edhe ekspertë nga tanët, për hetime. Hetimet filluan dhe do të vazhdojnë edhe nesër, ditën.

## DO TË PËRBALLOJMË ME SUKSES PROVOKACIONET E ARMIQVE REVIZIONISTË

Hetimet e ekspertëve tanë rreth plasjes që ndodhi dje mbrëma në ambasadën jugosllave vazhdojnë. Ato bëhen në praninë e personelit të diplomatëve dhe teknikëve të vetë ambasadës jugosllave.

Konstatimet e para vërtetojnë se shpërthimi nuk duhet të jetë shkaktuar nga bomba, siç pretendon ambasadori jugosllav, por nga dy «llokume» dinamiti, plasja e të cilave kishte shkaktuar gërvishtjen e asfaltit të çatisë 1 cm, dhe rënien e një cope të vogël të suvasë së kuzhinës. Kuzhina është brenda oborrit 14 metra larg murit rrethues të ambasadës, 2 m i lartë. Nga të dyja anët e godinës së ambasadës qëndrojnë roja policë, të cilët nuk kanë parë asnjë lëvizje në rrugë, veç kanë dëgjuar plasjen. Pra, ekspertiza, e cila vazhdon punën, vërteton se nuk është fjala për plasje bombash.

Ne besojmë se objektet që plasën janë vënë nga vetë jugosllavët për të na akuzuar ne se, përderisa «sulmojmë ambasadën e tyre këtu në Tiranë», jemi shkaktarët edhe të gjithçkaje që po ndodh në Kosovë.

Të qarta janë qëllimet e tyre armiqësore. Ambasadori jugosllav, sot, më 24 maj, protestoi në Ministrinë tonë të Punëve të Jashtme. Zëvendësministri ynë ia hodhi poshtë protestën si shumë të nxituar përderisa ekspertiza që kanë kërkuar vetë ata vazhdon punën.

Jugosllavëve do t'ua hedhim poshtë protestën edhe sikur një për qind të vërtetohet mundësia e hedhjes së objekteve plasëse nga jashtë, pasi edhe ai që mund ta ketë bërë këtë, nuk mund të jetë tjetër veçse një agjent i jugosllavëve, i sovjetikëve ose i bullgarëve. Çdo provokacion të tyre ne do ta përballojmë me sukses. Këto punë të ndyra kanë bërë kundër Shqipërisë tërë jetën këta armiq të egër të vendit e të popullit tonë.

E MËRKURË  
27 MAJ 1981\*

## VRASËSI I PALESTINEZËVE NË MOSKË

Mbreti Hysein i Jordanisë ndodhet për vizitë zyrtare në Moskë i pritur me të gjitha nderimet që i përkasin si monark e si mik i vjetër i socialimperialistëve sovjetikë, por edhe si blerës i armëve të tyre. Hyseini është takuar me Brezhnjevën për të shkëmbyer mendime rreth një «konference ndërkombëtare që do të zgjidhë problemin e Lindjes së Mesme».

Hyseini, vrasësi i palestinezëve, pritet nga Brezhnjevi, «mik» i palestinezëve, për të zgjidhur problemet e Lindjes së Mesme, në qendrën e të cilave është populli palestinez!

Ja deri ku e ka kufirin «miqësia» e socialimperialistëve sovjetikë për popullin palestinez e për popujt e tjerë arabë! Për ta problem është tregtia e armëve dhe jo miqësia e vërtetë me popujt. Këtë popujt arabë e, në mënyrë të veçantë, populli i shumëvujtur dhe heroik palestinez nuk duhet ta harrojnë në asnjë mënyrë e për asnjë çast.

## PËRGJIGJE PROTESTAVE TË REVIZIONISTËVE JUGOSLLAVË<sup>1</sup>

(Shënime për përgjigjen që duhet t'i japë një përfaqësues i Ministrisë sonë të Punëve të Jashtme ambasadorit jugosllav në përgjigje të protestës jugosllave të datës 27.5.1981, bërë në Beograd ambasadorit tonë Sokrat Plaka.)

1. Ne hedhim poshtë me indinjatë protestat tuaja të ripërsëritura e pa baza.

2. Ne asnjëherë nuk kemi sulmuar dhe as do të sulmojmë ambasadën jugosllave në Tiranë. Çdo gjë në këtë drejtim është shpifje dhe trillim nga ana juaj dhe bëhet me qëllime të paracaktuara që nuk na trembin aspak.

3. Ne jua dhamë përgjigjen tonë për çka ju ngjau në aneksin e ambasadës suaj dhe nuk lëvizim asnjë presje nga deklarata jonë, pse është e hetuar, e kontrolluar dhe e faktuar.

4. Për sa i përket Konventës së Vjenës s'kemi nevojë të na e përmendë kush, se e njohim dhe e zbatojmë me përpikëri, e kemi zbatuar dhe do ta zbatojmë edhe ndaj ambasadës jugosllave në Tiranë, ashtu kërkojmë ta zbatoni dhe ju ndaj ambasadës së Shqipërisë në Beograd.

<sup>1</sup> Shih: «Zëri i popullit», 29 maj 1981.

5. Ne pranojmë të vijmë ekspertët tuaj, po të dëshironi, që të hetojnë për veten e tyre ngjarjen në vend, me kusht që në këtë ekspertizë që do të bëni për veten tuaj, duhet të asistojnë dhe ekspertët tanë që u thirrën nga ambasada juaj, si edhe ambasadori juaj në Tiranë tok me këshilltarin, që asistuan kur u bë ekspertiza jonë. Nga ana jonë ekspertiza është e plotë, e fotografuar dhe e filmuar.

6. Artikujt e «Zërit të popullit» janë tre, mund të bëhen edhe 33. Kjo çështje është në kompetencën e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe jo tonën. Ne theksojmë për të njëmijtën herë se as kemi ndërhyrë dhe as do të ndërhyjmë në punët e brendshme të Jugosllavisë. Ne do të mbrojmë kurdoherë të drejtat e vëllezërve tanë shqiptarë, kur këto shkelen kaq brutalisht, derisa mbyten edhe me gjak.

7. Për sa u përket përrallave të Hanit të Hotit dhe një tullumbaceje të lëshuar në qiellin e Tiranës ditën e Një Majit dhe që gjoja mbërriti në qiellin e Strugës, as që dua t'i zë në gojë, pse janë shumë qesharake.

**E SHTUNË**  
**30 MAJ 1981**

## **T'U DALIM PËRPARA VËSHTIRËSIVE QË JUGOSLLAVËT PO NA NXJERRIN NË TREGTI**

Duke marrë parasysh acarimin e marrëdhënieve me Jugosllavinë, shovinistët jugosllavë do të na qitin një mijë pengesa si në tregtinë që bëjmë me ta, ashtu edhe në mallrat tona tranzit që kalojnë nëpërmjet Jugosllavisë për në Austri e për në Evropën Qendrore. Që tani ata po na krijojnë një mijë pengesa artificiale me transportin automobilistik. Patatet verore që çojmë nëpërmjet Jugosllavisë po na prishen në Mal të Zi.

Për këto arsye u rekomandova shokëve të Qeverisë që të parashikojnë e të marrin sa më parë masat e nevojshme, si për shembull:

1. Të bisedohet me italianët për vendosjen e tragetit Durrës-Bari, gjë që e kanë propozuar vetë ata.

2. Të merret sa më parë vendimi për të ndërtuar linjën e tensionit të lartë Elbasan—Kapshticë, me qëllim që t'i shesim Greqisë energji elektrike. Grekët lusin për këtë.

3. Të parashikohet hapja e Kakavijës. Hapja e kësaj pike të kufirit ka kuptim të rëndësishëm politik dhe ekonomik.

Vendosja e tragetit me Italinë, shitja e energjisë elektrike Greqisë dhe hapja e Kakavijës, do t'u tregojnë shovinistëve jugosllavë se presionet dhe shantazhet e tyre në tregti nuk pinë ujë te ne. Ata do të dëmtohen

edhe në këtë fushë dhe nuk do të kenë më mundësi të propagandojnë rreth «favoreve» që na bëjnë duke na e «blerë energjinë elektrike, kromin» etj., artikuj këto kaq të kërkuar që ne i shesim jo ditën, por edhe natën, siç i thonë fjalës.

U rekomandova shokëve që kështu të veprojnë tregtia jonë e jashtme edhe me prodhimet bujqësore.

Me hapjen e Kakavijës, Janina, Preveza, Arta dhe gjithë Epiri i Jugut, mund t'i blejnë prodhimet tona, se u venë më të lira.

E DIEL  
31 MAJ 1981

## MBI NGJARJEN E AMBASADËS JUGOSLLAVE NË TIRANË<sup>1</sup>

### Përgjigje gazetës «Politika» të Beogradit Shënime-Teza

1. Në datën 26 maj 1981 ju botuat një artikull plot me trillime, shpifje e shtrembërime të paturpshme mbi çka ju ngjau në ambasadën jugosllave në Tiranë. Asgjë politike nuk kishte në atë artikull, përveç një botimi tipik të sigurimit të shtetit jugosllav (UDB-së). Pra «Politika» pasqyronte në të politikën e kryepolicit serb Hërljeviç.

2. Ministria jonë e Punëve të Jashtme ju ka deklaruar zyrtarisht se Konventën e Vjenës ne e zbatojmë etj., etj., kurse ju në shtypin tuaj shkruani krejt të kundërtën.

Ne themi se as e kemi sulmuar dhe as do ta sulmojmë kurrë ambasadën jugosllave. Në artikull shkruhet krejt e kundërta.

Ne themi se do ta mbrojmë ambasadën jugosllave, ashtu siç kërkojmë që të mbronë dhe ju tonën në Beograd. (Për këto argumente të citohen pjesë nga Tanjugu dhe «Politika».)

<sup>1</sup> «Mbi ngjarjen e ambasadës jugosllave në Tiranë» — Përgjigje gazetës «Politika» të Beogradit — «Zëri i popullit», 3 qershor 1981.

Ne ju paraqitëm raportin zyrtar të ekspertëve tanë të kërkuar nga ambasada juaj. (Të vihet në dukje si e hedh poshtë «Politika» këtë dokument, akoma pa dërguar pala jugosllave ekspertët e vet që ne i lejuam të vijnë.)

3. Gjithë kjo intrigë tragjike në ambasadën jugosllave në Tiranë duam të theksojmë se u kurdis dhe u krye në mungesën e titullarit të Sekretariatit të Shtetit të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, zotit Verhovec. Dikush tjetër i lëvizi fijet.

Është e qartë dhe e njohur se kryepolici jugosllav Hërljeviç ishte i pari që akuzoi publikisht ambasadën shqiptare në Beograd, si dhe ambasadat tona në vendet e tjera të botës dhe më në fund akuzoi Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë sikur ajo nxiti turbullirat në Kosovë.

Opinionin botëror dhe kancelaritë e botës nuk e hëngrën këtë gënjeshtër të madhe të jugosllavëve. Kjo tragjedi e tmerrshme e Kosovës, shkaqet e vërteta të së cilës i analizoi cilido dhe nxori cilët ishin shkaktarët e kësaj gjëme që ka emrin gjenocid, e diskreditoi keqas Jugosllavinë e Titos dhe vuri në dukje rrezikshmërinë e saj.

Ministria e Punëve të Brendshme të Jugosllavisë implikoi në këtë komplot të madh gati gjithë udhëheqjen jugosllave dhe çështjen e bëri ndërnacionale për gjithë Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë. Këtë komplot serb kundër Kosovës, kundër Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe kundër Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë asnjë udhëheqës jugosllav nuk u tregua i guximshëm ta dënonte përveç rinisë dhe inteligjencies së Kosovës, të cilat përnjëherë u burgosën.

Në këtë komplot shumë të rrezikshëm për të ardhmen e Federatës Jugosllave kosovarët dhe Republika

Popullore Socialiste e Shqipërisë jo vetëm mbrojtën të drejtat e tyre, por ishin të vetmit që mbrojtën edhe unitetin e Federatës Jugosllave. Kurse sulmi serbomadn ndoqi dy objektiva: gjenocidin në Kosovë dhe sulmin kundër Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë. Me një të goditur ai donte të vriste dy zogj, por vrau veten dhe plaga do të ketë konsekuenca të rënda.

Politika famëkeqe plot bujë dhe falsitet u demaskua. Çirakët s'e ndoqën dot ustanë që u vdiq dhe vazhdojnë t'i këndojnë himne të padëgjua kurrë në botë për një person që e solli Jugosllavinë në buzë të greminës. Kultet e pompuara me zor marrin fund shpejt dhe me lehtësi. Dhe ata që ishin të gënjyer nga parullat e politikës titiste «botërore dhe të brendshme» u zhgënjyen. «Madhështia» jugosllave, që rronte në ëndërrime se ishte bërë «kërthiza» e botës, u bë pluhur e hi.

4. Megjithatë ne kemi menduar dhe mendojmë se duhet shpëtuar Jugosllavia. Por këtë vepër të madhe nuk mund ta bëjnë as UDB-ja dhe as njerëz si Hërljeviçi, Stamboliçi, Rankoviçi dhe Vukmanoviçi.

«Zëri i popullit», organ i Komitetit Qendror të PPSH, shkroi tre artikuj bazë, ku fliste të vërtetën dhe bënte thirrje për moderacion, për gjakftohtësi, për meditime, që të uleshin gjakrat dhe të vendosej qetësia në Kosovë, të rishikoheshin me drejtësi dhe me objektivitetet kërkesat e shqiptarëve.

Organi i Komitetit Qendror të PPSH theksonte shqip dhe botërisht se «Shqipëria nuk kishte ndërhyrë dhe nuk do të ndërhynte në punët e brendshme të Jugosllavisë», se «nuk kishte bërë kurrë rivendikime territoriale», se «populli shqiptar nuk ishte për minimin e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe se do të luftonte krah për krah me popujt e Jugosllavisë, në qoftë se këta atakoheshin, nga kushdo qoftë».

U duk që ne thoshim gjëra të vërteta dhe jetike,

por në shkretëtirë. Gjithë udhëheqja jugosllave e të tëra rangjeve dhe e të tëra llojeve dhe diplomacia jugosllave gjykonin dhe flisnin me kokën dhe me gjuhën e policisë sekrete jugosllave nën drejtimin e dukshëm të serbo-mëdhenjve.

Ne ruajtëm gjakftohtësinë përpara korit të turpshëm anembanë Jugosllavisë që çirrej kundër shqiptarëve: «Eureka!», e gjetëm fajtorin! Por kori ishte fals dhe opinionin botëror, deri dhe ato shtete që s'na e duan të mirën, na dhanë hak neve dhe jo jugosllavëve. Vetëm armiqtë e betuar të popujve, revizionistët sovjetikë, heshtën, kur gjithë bota fliste. Pse heshtën ata, do të kthehemi një herë tjetër dhe do të zbulojmë fijet e komplotit ruso-serbomadn.

Përpara kësaj disfate të bujshme, kryepolici Hërljeviç organizoi me njerëzit e tij, në mungesë të sekretarit të shtetit për Punët e Jashtme të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë Verhovec dhe pa dijeninë e ambasadorit jugosllav në Tiranë, Komatina, ngjarjen në ambasadën jugosllave në vendin tonë, për «të lyer pak me flori» bakrin e tij, të cilit i doli kallaji.

Ekspertët tanë, tok me nëpunës të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, të thirrur nga ambasadori jugosllav, vajtën në vend dhe, në praninë e gjithë personelit të ambasadës jugosllave, bënë imtësisht ekspertizën, të cilën Ministria jonë e Punëve të Jashtme ia dorëzoi zotit Komatina.

Kjo përgjigje dhe kjo ekspertizë nuk u pëlqeu jugosllavëve. Ata kërkuan të vinin në Tiranë ekspertët e tyre, që ne i lejuam. Por kanë kaluar kaq ditë dhe ata s'po duken. Në vend të tyre u duk artikulli në fjalë i gazetës së Beogradit «Politika».

Ne i themi gazetës «Politika», organ i UDB-së, në përgjigjen tonë ekskludohej kategorikisht që lëndët plasëse, dy llokume TNT speciale dhe me djegie speciale,

që s'ka Shqipëria, të ishin hedhur nga jashtë. Ne, për politesë, nuk deklaram se ato janë vendosur nga brenda. Jugosllavët s'deshën të reflektonin në deklaratën tonë. Atëherë, meqenëse ju kërkonin të na e hidhni fajin neve për të gënjer opinionin botëror, ne po ju themi se në ambasadën jugosllave në Tiranë gjenden dy veta dhe një e tretë me origjinë ruse që i kanë bërë këto gjëra. Emrat i gjeni vetë. Theksojmë, gjithashtu, se çdo gjë që ka lidhje me ngjarjen e 23 majit në ambasadën jugosllave është e dokumentuar, e fotografuar dhe e filmuar.

Ne i themi, po ashtu, gazetës «Politika» se faktet e përditshme tregojnë se fryma e Helsinkit ishte një filluskë sapuni. Këto fakte i dhanë të drejtë Shqipërisë socialiste. Po ashtu me fakte do t'i tregojmë botës se Shqipëria socialiste nuk është një rrezik për Evropën, siç pretendoni ju, kasnecë të Beogradit, por është Jugosllavia titiste një rrezik për Ballkanin, për Evropën dhe për botën.

E HËNË  
1 QERSHOR 1981

## MBI BASHKËPUNIMIN E FSHEHTË SOVJETO-SERBOMADH

### Teza për artikull<sup>1</sup>

1. Për ngjarjet tragjike të Kosovës, të shkaktuara nga klani serbomadh i Beogradit, revizionistët sovjetikë s'folën fare, sikur të mos kishte ngjarë asgjë.

Lakenjtë e tyre bullgarë e mbyllën krejt pipkën. Gjithë bota foli, raportoi, komentoj, kurse sovjetët dhe bullgarët jo. Pse vallë?

Për t'i thënë botës:

a. «Ne jemi nga ata që nuk përzihe mi në punët e brendshme të të tjerëve, siç po na akuzoni vazhdimisht».

b. «Le t'i zgjidhin vetë shqiptarët dhe jugosllavët punët e tyre».

Këto janë dy aspekte formale për sy e për faqe të sovjetiko-bullgarëve, që e shtynë Jugosllavinë të mbyllë gojën kundër tyre dhe na bën ne shqiptarët t'ua çjerrim këtë maskë.

Si qëndron realiteti që ne duhet ta demaskojmë?

1. Sovjetikët janë shumë të interesuar që marrëdhëniet në mes Jugosllavisë dhe Shqipërisë të acarohen, mundësisht deri në kulm.

2. Një situatë e tillë u sjell sovjetikëve një sërë

<sup>1</sup> «Ngjarjet e Kosovës dhe bashkëpunimi i fshehtë sovjetiko-serbomadh». «Zëri i popullit», 5 qershor 1981.

avantazhesh: Dobëson Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë, që është në shkoqitje dhe në kontradikta të thella nacionale, ekonomike, politike dhe shtetërore; do-bëson edhe Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë, që është një bastion i papërkulur kundër revizionizmit modern sovjetik, imperializmit amerikan dhe reaksionit botëror; prish këtë lloj stabiliteti në Ballkan dhe kërcënon me një turbullirë dhe pasiguri krahun juglindor të NATO-s.

3. Në këtë lojë të fshehtë sovjetikët mbështetin klanin serbomadh të Beogradit kundër shqiptarëve të Jugosllavisë dhe kundër Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

S'flasin për çka ngjet në Kosovë, që të mbështetin klanin serbomadh dhe të mos dobësohet Serbia dhe kjo të imponojë hegjemoninë e saj mbi klanin tjetër slloveno-kroat që është properëndimor (pro SHBA-së).

4. Klani serbomadh është për centralizmin burokratik. Klani kroato-slloven është për vetadministrimin titist. Sistemi vetadministrues e ka dobësuar ekonomikisht dhe politikisht klanin serbomadh. Rankoviçi dhe klani i tij u likuiduan. Sovjeti e mbështeti në kohën e tij klanin e Rankoviçit derisa, në një moment, e quajti këtë «më pozitivin», «kënduesin e himnit sovjetik».

Pas vdekjes së Titos klani serb kërkon revanshin kundër klanit kroato-slloven. Në mes të dy klaneve më të fuqishme ka kontradikta të thella që do të thellohen akoma më shumë. Sovjetët janë së toku në komplot me serbomëdhenjtë. Heshtja e sovjetëve për shtypjen e shqiptarëve nga serbët ndihmon klanin serb për të dobësuar klanin kroato-slloven dhe për të ndryshuar sistemin vetadministrues në një sistem borgjez burokratik. Bullgarët dhe çështjen maqedone sovjeti i ka në zap, i ka si një pion që e shtyn ose e tërheq sipas koniunkturave që do të krijohen.

Këtë komplot të madh dhe të egër sovjeto-serbomadh duhet ta demaskojmë. Ai është nga më të rrezikshmit për Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe për Ballkanin.

Opinionin botëror në përgjithësi dhe kancelaritë e botës janë pro «republikës së Kosovës» dhe aprovojnë qëndrimet tona, jo për sytë tanë të bukur, por se janë kundër këtij komploti, se janë për këtë statukuo në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë, se janë jo për hegjemoninë serbe. «Republika e Kosovës» e dobëson Republikën Socialiste të Serbisë dhe forcon statukuonë e Federatës Jugosllave, ajo u prish planet strategjike sovjetikëve.

**E MARTË**  
**2 QERSHOR 1981**

## **EMIGRANTË KOSOVARE, SERBËT JU QUAJNË TERRORISTË**

### **Shënime**

Historia dhe arsyet e emigracionit ekonomik shqiptar nga Kosova, Maqedonia dhe Mali i Zi.

1. Mjerimi ekonomik në vatrat tuaja dhe papunësia e madhe kronike dhe pa shpresa shërimi ju detyroi ju, ose ju detyruan të emigronit në cilindo shtet të botës që ju pranonte në punët më degraduese, pra, që ju pranonte si shërbëtorë dhe si skllevër të kohëve moderne.

2. Josip Broz Titoja e ka inkurajuar emigracionin jashtë dhe të papunët në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë i kategorizoi në dy grupe: të papunët e thjeshtë të brendshëm dhe të papunët emigrantë, që i dëbonte jashtë të shpërndarë në të katër anët e botës, të cilët edhe i hiqte qafe, edhe i shfrytëzonte.

Regjimi i falimentuar titist kishte nevojë për kredi, kishte nevojë për devizë. Duke marrë kredi ai u mbush deri në grykë në borxhe. Klikat në fuqi vodhën nga këto sa deshën dhe vendin e shitën te të huajt. Ato krijuan devizë me turizmin dhe popullin e degjeneruan, vendasit i hodhën jashtë në emigracion për t'u bërë skllevër të të huajve dhe për të marrë devizë prej tyre.

Regjimi i falimentuar titist nënshkroi marrëveshje të veçanta me shtetet ku ju dërgoi t'ju thithin djersën

dhe gjakun tuaj. Ai krijoi kudo edhe konsullatat e veta që t'ju kontrollonte dhe t'ju kërcënonte. Regjim i ri dhe metodik i skllavërimit shpirtëror dhe trupor.

Emigracioni më i madh jugosllav është ai shqiptar. Kjo tregon mjerimin e madh ekonomik të shqiptarëve të Jugosllavisë, por tregon edhe një veprim të madh politik të regjimit titist — të shpartallojë pjesën e kombit shqiptar që është lënë me forcë brenda kufijve jugosllavë, ta hallakatë atë nëpër botë me anën e dëbimit me forcë dhe në masë dhe ta dëbojë nga tokat e veta me anë të emigracionit. Politika e vjetër e kralëve serbë vazhdon me kralët e rinj titistë.

Në çdo vend të botës ku ju rropateni, o shqiptarë, regjimi titist ka ngritur edhe klube ku ju detyron të veni të shkruheni. Në to ju indoktrinojnë dhe ju kërcënojnë që, po nuk bëtë siç ju këshillon klubi (UDB-ja), atëherë ju heqin pasaportën dhe ju konsiderojnë si pa atdhe, me masa UDB-ashe ju kërcënojnë edhe kundër familjeve tuaja në atdhe.

Atdheun tuaj, Kosovën, serbomëdhenjtë e mbytën në gjak. Ata ju vranë në mënyrë barbare shtazarake motrat, gratë, vëllezërit, baballarët dhe kalamanët tuaj, sepse këta kërkonin të drejtat e tyre. Burgjet e Kosovës janë plot, njerëz të gjymtuar nga torturat ka atje plot, shtetrrethimi vazhdon i egër, por Kosova dhe gjithë shqiptarët që jetojnë në trevat e tyre u rezistojnë dhe do t'u rezistojnë edhe më me forcë terrorit dhe dhunës serbomadhe.

Pse ju jeni solidarë dhe mbroni popullin tuaj, propaganda jugosllave ju cilëson «terroristë». Ju mos u tutni nga sharjet e serbëve. Po të mos mbroni vëllezërit dhe motrat tuaja, po të mos mbroni kombin tuaj, as që mund të quheni shqiptarë.

Ju jeni kurdoherë korrektë e të drejtë me ligjet e vendit ku punoni, por popullit të këtyre vendeve duhet t'u thoni se «barbarizmat e serbomëdhenjve ne nuk mund

t'i durojmë më. Na kanë shpallur luftë, ne po u përgjigjemi».

Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë i ka mbrojtur dhe do t'i mbrojë të drejtat e vëllezërve shqiptarë që jetojnë në Jugosllavi. Po të mos e bëjmë këtë, ne do të bëjmë një krim dhe do të jemi tradhtarë të kombit tonë. Këtë le ta dinë jugosllavët dhe gjithë bota, bile edhe gazeta franceze «Lë Mond», edhe gazeta italiane «La Stampa», të shitura te jugosllavët.

Përpara gjenocidit jugosllav në Kosovë Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë ngriti zërin e saj që jugosllavët të ndalonin vrasjet, torturat, burgimet, ndjekjet dhe shtypjen e kosovarëve. Atyre u bëmë thirrje të ulin gjakrat, të ruajnë gjakftohtësinë, të mos armiqësohen me shqiptarët. Jugosllavët na akuzojnë se ndërhyjmë në punët e tyre të brendshme, se është Shqipëria socialiste që nxit kosovarët, që ju nxit ju vëllezër kosovarë dhe të viseve të tjera në emigracion, të mbron motrat dhe kalamitet tuaj që po jua vrasin serbët. Ne as e kemi bërë dhe as e bëjmë këtë, por gjithë bota duhet ta ketë të qartë se Shqipëria është një komb, se shqiptarët janë një popull dhe jo ashtu siç thonë e siç i duan Hërljeviçi, Ristiçi, Stamboliçi, Kolishevski, Vukmanoviçi dhe Fadil Hoxha e Xhavit Nimani. Shqipëria nuk do të lejojë kurrë që «bota» të luajë me fatin e saj, siç e përshkruajnë revista «NIN» dhe gazeta «Politika» të policisë sekrete jugosllave dhe sidomos serbomëdhenjtë. Shqipëria nuk do të lejojë kurrë që të bëhet një Palestinë e mjeruar, por është e do të mbetet trime me fletë.

E MARTË  
2 QERSHOR 1981

## PËRGJIGJE GAZETËS «POLITIKA» TË BEOGRADIT

### Shënime për shokun Ramiz

Të shkruhet një artikull<sup>1</sup> kundër shpifjeve të gazetës «Politika» të Beogradit lidhur me provokacionin e kurdisur nga vetë jugosllavët në ambasadën e tyre në Tiranë.

Përveç kësaj, të shkruhen edhe disa artikuj të tjerë demaskues për shkrimet e kësaj gazete, siç janë ato nën etiketën: «Nga dosja e marrëdhënieve jugosllavo-shqiptare», «Principialiteti afatgjatë i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë», «Piemonti shqiptaromadh në Kosovë, në Maqedoni e në Mal të Zi».

(Për sa i përket çështjes së marrëdhënieve në mes Jugosllavisë dhe Shqipërisë pas vitit 1948, të cilat gjoja na u diktuan nga Stalini dhe Informbyroja, të thuhet se ne kemi shkruar vëllime të tëra. Por këtyre do t'u kthehemi përsëri me librin «Titistët» të shokut Enver Hoxha.)

1. Për artikullin e parë lidhur me shkrimin e «Politikës», «nga dosja e marrëdhënieve jugosllavo-shqiptare», të rilexohen dy artikuj mbi Jugosllavinë të botuara në Vepra, vëll. 33<sup>2</sup> dhe të hidhen poshtë pretendimet rreth

1 «Mbi ngjarjen e ambasadës jugosllave në Tiranë» — Përgjigje gazetës «Politika» të Beogradit — «Zëri i popullit», 3 qershor 1981.

2 a. «Jugosllavia titiste në rrugëkryq» («Zëri i popullit», 2 gusht 1966). Enver Hoxha. Vepra, vëll. 33, f. 243.

«favoreve» që na kanë bërë jugosllavët në «marrëdhëniet tregtare». Të tregohet e vërteta rreth këtyre marrëdhënieve<sup>1</sup>. Këtë pjesë të artikullit ta bëjnë shokët e Ministrisë së Tregtisë dhe ta shohin shokët e Kryesisë së Qeverisë.

Këtu të dalë që në këtë fushë ne jemi treguar realistë, kemi qenë për fqinjësi të mirë dhe kemi bërë koncesione ne dhe jo titistët.

2. Artikulli i dytë duhet të jetë ai që kemi rënë dakord ta bëjë Dritëro Agolli<sup>2</sup>. Të theksohet se jugosllavët na akuzojnë për lidhjet tona të drejta me Kosovën, të cilat ata i cilësojnë «kanale të shovinizmit».

Këtu duhet të mos harrojmë të vëmë praktikën shtetërore se si u vendosën «këto kanale» dhe të hedhim poshtë shpifjet e gazetës jugosllave. Kjo praktikë diplomatike është në favorin tonë, pse, në rast se nuk gabohem, jugosllavët nuk donin të përmendej Kosova.

Të vihet fakti se ne zhvillim marrëdhënie të tilla edhe me Maqedoninë e me Malin e Zi: kemi vajtur edhe ne, kanë ardhur edhe ata në simpoziume në rang republikane të njëri-tjetrit.

3. Artikulli i fundit është demaskimi i zërave mbi të ashtuquajturin «Piemonti shqiptaromadh»<sup>3</sup>.

Në këtë artikull duhet të bëhet një historik i shkurtër i përpjekjeve për unitet të Italisë. Jugosllavët e përçmojnë luftën për unitet historik të popullit italian, kurse ne si marksistë revolucionarë e çmojmë atë. Ne çmojmë

b. «Kush përgjigjet për krimet e gjenocidit në Kosovë?» («Zëri i popullit», 31 gusht 1966). Enver Hoxha. Vepra, vëll. 33, f. 254.

1 «E vërteta mbi marrëdhëniet ekonomike-tregtare midis Shqipërisë e Jugosllavisë». «Zëri i popullit», 12 qershor 1981.

2 «Kush është kundër bashkëpunimit kulturor midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë?». «Zëri i popullit», 7 qershor 1981.

3 «Piemonti i mirëfilltë, «Piemonti» jugosllav dhe «Piemonti shqiptaromadh». «Zëri i popullit», 9 qershor 1981.

si revolucionarë veprën e madhe të Mazinit, «Italia fara da sé», veprën heroike të Garibaldit, veprën e pavdekshme të Verdit dhe, pse jo, edhe të Kamilo Benso Kavurit.

I ashtuquajtur i Piemonti në versionin e ri jugosllav me krijimin e një shteti shumëkombësh, synon të afirmojë idenë e Serbisë së madhe.

«Piemonti italian» luftoi për unitetin e një kombi kundër austriakëve habzburgas dhe shtetit papal, kurse «Piemonti jugosllav» i ri i pasluftës së Dytë Botërore futi nën shtetullën e tij edhe popuj e vende që nuk i përkitnin.

Prandaj «Piemonti shqiptaromadh» është një falsitet historik që i përshtatet si një *gant* «Piemontit serbomadh» ose «Piemontit jugosllavomadh».

P.S.

Ju kujtoj se duhen përfunduar artikujt, për të cilët ju kam dhënë tezat:

1. Artikullin kundër deklaratave të njëfarë profesori Nikolla Pano në Universitetin e Bostonit mbi çështjen e emigrantëve shqiptarë<sup>1</sup>.

2. Artikullin kundër sovjeta-bullgarëve për marrëveshje të heshtur me serbomëdhenjtë<sup>2</sup>.

3. Artikullin në përgjigje të artikullit të profesorit të Sorbonës Mishel Obin në gazetën «Lë Mond»<sup>3</sup>.

1 «Emigrantët ekonomikë kosovarë kanë qenë dhe do të jenë të pandarë nga vendi dhe populli i tyre». «Bashkimi», 10 qershor 1981.

2 «Ngjarjet e Kosovës dhe bashkëpunimi i fshehtë sovjeta-serbomadh». «Zëri i popullit», 5 gusht 1981.

3 «Mite përballë realitetit». «Drita», 28 qershor 1981.

**E MARTË**  
**2 QERSHOR 1981**

## **TË NDALOHEM SA MË PARË RAPREZALJET DHE TERRORI I POLICISË SERBE NË KOSOVË**

Në artikujt e «Zërit të popullit» të datave 8 e 23 prill dhe të 17 majit<sup>1</sup> në mënyrë miqësore dhe në kuadrin e politikës së marrëdhënies të fqinjësisë së mirë, opinionin e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë ka kërkuar nga Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë që të ndalohen terrori, vrasjet, masakrat, torturat dhe burgimet në masë të kosovarëve nga ana e policisë serbe.

Asgjë s'u bë dhe asgjë s'po bëhet. Frikësimi dhe terrori kundër shqiptarëve po shtohen çdo ditë. Me urdhër të policisë serbe të Beogradit po arrestohen, po burgosen dhe po torturohen studentë, mësues, profesorë dhe qytetarë shqiptarë në Kosovë dhe në çdo vend të Jugosllavisë ku jetojnë të tillë. Në çdo skaj të Jugosllavisë po flitet me urrejtje për shqiptarët. Kjo e kalon çdo masë dhe është bërë e padurueshme, është kthyer në një tragjedi të vërtetë.

Udhëheqja tradhtare shqiptare e Kosovës, shërbëtore

1 a. «Pse u përdor dhuna policore dhe tanket kundër shqiptarëve në Kosovë?» (8 prill 1981).

b. «Kush e nxit armiqtë në midis popujve të Jugosllavisë?» (23 prill 1981).

c. «Kërkesa për t'i njohur Kosovës statusin e republikës është e drejtë» (17 maj 1981).

e serbomëdhenjve, po kategorizon shqiptarët dhe i fut në skeda si në kohët më të egra, bile edhe më të egër se të kohës së Rankoviçit.

Pyesim: Do ta vazhdojë qeveria serbomadhe e Republikës Socialiste të Serbisë dhe qeveria federative jugosllave këtë veprim të egër e barbar?

Do ta durojnë më këtë dhunë dhe këtë terror kosovarët dhe gjithë shqiptarët e Jugosllavisë që të vriten, të burgosen, të torturohen dhe vajzat e bijtë e tyre më të mirë të skedohen si kriminelë? Ne kemi bindjen se shqiptarët në Jugosllavi nuk do ta durojnë më këtë gjendje.

Ne jemi dhe do të jemi me ta deri në fund, derisa të triumfojnë arsyeja dhe drejtësia. Arsyeja dhe drejtësia nuk po duken nga ana jugosllave. Ata kanë përgjegjësinë për çka mund të ngjasë. Llafet, shpifjet dhe akuzat kundër nesh, kosovarëve dhe gjithë shqiptarëve që jetojnë në Jugosllavi, nuk shërbejnë më. Opinionin botëror e konsiderojmë të sqaruar. Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë nuk është më as ajo e 1912-s, e 1913-s dhe e 1918-s dhe as ajo e Lidhjes së Kombeve. Kohët kanë ndryshuar, nuk mund të luhet më me fatet e shqiptarëve dhe të kombit shqiptar.

Mbi këto që shkrova këtu, bisedova me Ramizin. Këto probleme do t'i shtroj edhe në mbledhjen e ardhshme të Byrosë Politike, se i konsideroj shumë të rëndësishme dhe parimore.

**E MARTË**  
**2 QERSHOR 1981**

## **MBI GJENDJEN NDËRKOMBËTARE**

### **Teza të veçanta për raportin e Kongresit të 8-të**

Këto ditë fillova të punoj për kapitullin mbi gjendjen ndërkombëtare të projektit të raportit të Komitetit Qendror që do të mbaj në Kongresin e 8-të të Partisë. Sot formulova disa nga tezat që do të shtjelloj në të.

**Situata ndërkombëtare është e mbarsur me luftë të përgjithshme dhe me luftëra lokale. Ajo është e mbarsur edhe me revolucion.**

E dyta duhet të përballojë të parën, të pengojë luftën e përgjithshme dhe luftërat lokale, të nxitura nga imperialisto-revizionistët dhe borgjezia reaksionare vendase.

Konkretisht si duhet të veprojnë popujt për t'i ndalur këto luftëra të padrejta dhe, në pamundësi që t'i ndalojnë, si duhet t'i kthejnë në kryengritje revolucionare.

Kush i shkakton luftërat, cilat janë arsyet e vërteta të luftërave imperialiste dhe të luftërave lokale.

Si përgatiten këto luftëra, si manipulohen masat e gjera që hidhen në zjarrin e luftërave grabitqare. Politika, propaganda, armatimet, demagogjia dhe vetë «frika e luftës» përdoren për të nxitur luftën.

Si zhvillohet dhe thellohet kriza e përgjithshme botërore. Cilat janë fushat kryesore ku kjo krizë po the-

llohet dhe si manifestohet në botën e kapitalit, në ç'forma e me ç'konsekuenca në jetën e popujve.

Ç'forma ka marrë, aktualisht, kapitalizmi botëror, roli i bankave, roli i shumëkombësëve, gara e armatimeve, blloqet ushtarake dhe si konkluzion rindarja e botës në mes imperialistëve.

Vartësia e popujve dhe e sovranitetit të shteteve të ndryshme të kapitalizmi botëror. Ndryshimet në vartësi, kontradiktat, kompromiset koniunkturale.

Neokolonializmi. Superfuqitë, fuqitë kapitaliste të industrializuara dhe shtetet që shfrytëzohen për lëndët e para. Të parët e të dytët u pasuruan, shfrytëzuan pa llogari lëndët e para të popujve dhe të shteteve gjoja sovrane, u arrit në krizën e superprodhimit, të superfitimeve dhe në gjendjen katastrofike aktuale.

Vendet furnizuese të lëndëve të para filluan edhe ato të zhvilloheshin, të investonin në vendet e tyre dhe të shkaktonin për fuqitë imperialiste krizën e energjetikës dhe të lëndëve të para.

E MARTË  
2 QERSHOR 1981

## MBLEDHJA E HELSINKIT DHE QËLLIMET E REVIZIONISTËVE JUGOSLLAVË

### Teza

Për të hedhur poshtë shpifjet e revizionistëve jugosllavë lidhur me qëndrimin e vendit tonë ndaj mbledhjes së Helsinkit për «sigurimin evropian», kur të pihen kushtet, të shkruhet një artikull<sup>1</sup>, i cili të mbajë parasysht këto çështje:

a. Ne kemi shkruar artikuj për këtë mbledhje. Të realizohen dhe përsëri të vihen në dukje arsyet e vërteta përse ne nuk morëm pjesë në të dhe dënuam synimet e fuqive të mëdha, të Bashkimit Sovjetik dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që e organizuan dhe e manipuluan atë. Koha na dha neve të drejtë.

Ç'rezultate dhanë Helsinki dhe mbledhjet e tjera që e pasuan atë?!

b. Pas gjenocidit jugosllav në Kosovë, revizionistët jugosllavë «zbuluan» arsyen «e vërtetë» përse gjoja ne nuk shkuam në Helsinki, se «nuk donim statukuonë e kufijve të sotëm të Evropës». Pra, sipas tyre, «do të ngri-

<sup>1</sup> Artikull i veçantë nuk rezultoi të jetë botuar. Çështja është ezauruar me një paragraf në artikullin «Mbi ngjarjen e ambasadës jugosllave në Tiranë» — Përgjigje gazetës «Politika» të Beogradit — botuar në gazetën «Zëri i popullit» më 3 qershor 1981.

nim atje rivendikime territoriale kundrejt Jugosllavisë».

Ky është një montazh titist i paqenë dhe i paargumentuar, i kurdisur për të mbuluar vrasjet dhe persekutimet e kosovarëve dhe të të gjithë shqiptarëve që jetojnë në tokat e veta në Jugosllavi.

c. Kjo tregon, nga ana tjetër, se jugosllavët e dinë mirë që Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë është e qepur me pe të bardhë, është një shtet me shumë kombësi, i krijuar nga fuqitë imperialiste dhe me intrigat e tyre, duke marrë nëpër këmbë fatet e popujve të tjerë.

Nga ana tjetër, Jugosllavia është zhytur në një krizë të madhe ekonomike. Forma shtetërore e vetadministrimit ka krijuar konflikte ndërnacionale dhe në udhëheqje. Këtë kërkon të fshehë Jugosllavia, duke na akuzuar ne, pse nuk shkuam në Helsinki!

d. Të demaskohet me këtë rast revista «NIN» që na bën historikun e lindjes së Shqipërisë dhe e mbyll artikullin me pak fjalë kështu: U bë ç'u bë kundër Shqipërisë, u copëtua, u shqye nga fuqitë imperialiste, nga malazetë, nga serbët, nga cari rus etj., ky problem duhet të mbyllet dhe shqiptarët e Jugosllavisë e Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë s'kanë pse bëjnë fjalë, të rrinë «sus».

«Kosova s'ka të drejtë të kërkojë që të bëhet republikë» dhe Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë s'na paska të drejtë as të mbrojë të drejtat e shqiptarëve në Jugosllavi, pse për jugosllavët «kjo është ndërhyrje që synon përçarjen e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë».

dh. Të goditet ashpër teza e «NIN»-it mbi gjenezën dhe unitetin e kombit dhe të shtetit shqiptar. As nuk mund të barazohet uniteti me luftë të kombit dhe i shtetit shqiptar (megjithëse të gjitha shtetet i ka pasë kundër) me unitetin e kombit dhe të shtetit jugosllav (megjithëse të gjitha shtetet i ka pasë pro tij).

Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë është një mozaik kombesh pa kurrfarë lidhjeje uniteti kombëtar, kurse Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë ka qenë, është dhe do të jetë një, e fortë, e pandarë dhe në unitet si në kohë, ashtu edhe në hapësirë. Dashkan ose s'dashkan jugosllavët, kjo është kështu dhe do të jetë kështu.

E MËRKURË  
3 QERSHOR 1981

## TRAKTATI I SHËN-STEFANIT DHE LOJA E RREZIKSHME ME HARTA NGA QEVERIA REVIZIONISTE E REPUBLIKËS POPULLORE TË BULLGARISË

Shënime

Duke pasur parasysh pretendimet shoviniste të revizionistëve bullgarë t'u përmendim indirekt edhe jugosllavëve, ndoshta me anë të shtypit, se «tokat nga iks vend, deri në ipsilon vend», që i paraqesin si pjesë të Maqedonisë, janë shqiptare, të banuara denbabaden nga shqiptarë dhe që në asnjë kohë nuk janë quajtur maqedonase. Kush i aneksonte këto toka dhe skllavëronte popullin autokton shqiptar, i cilësonte ata «maqedonas bullgarë» ose «maqedonas jugosllavë».

Kjo ide bazë do të dalë indirekt, duke atakuar Traktatin e Shën-Stefanit (të këqijat që ky i solli Shqipërisë, të mirat që i solli Bullgarisë, avantazhet Jugosllavisë dhe dëmet Greqisë).

Në këtë ekspozë të shkurtër, por precize, duhet të dalë përcaktimi «historik» i Maqedonisë së Vardarit dhe i Maqedonisë së Egjeut. As në njërin, as në tjetrën nuk bëjnë pjesë tokat shqiptare që u përcaktuan më lart nga ne. Ato kanë qenë dhe mbeten kurdoherë toka shqiptare, të banuara nga etni shqiptare, pavarësisht

nga emërtimet e pushtuesve të ndryshëm dhe që bëheshin monedhë tregu nga fuqitë e mëdha imperialiste.

Pasi të shtrojmë problemin në mënyrë historike dhe në vërtetësinë shkencore, të dalim te loja e rrezikshme e «hartave bullgare», gjoja historike, por kurdoherë shovinisto-bullgaromadhe për pretendime mbi këtë farë Bullgarie dhe Maqedonie që arrin deri në brigjet e Adriatikut, duke përfshirë edhe një pjesë të madhe të Shqipërisë.

E dënojmë rëndë dhe e demaskojmë këtë akt shovinist bullgaromadh, prapa të cilit qëndron hija e rëndë e mareshalit Kulikov<sup>1</sup>. Por kjo nuk është harta e parë bullgare e Shën Stefanit. Ekziston edhe një hartë tjetër bullgare e botuar në Sofje, në të cilën gjithë Shqipëria socialiste është inkuadruar brenda kufijve të Federatës Jugosllave. Ishte ky premtimi bullgar që «Shqipëria socialiste të bëhej republika e shtatë e Jugosllavisë». Prapa këtij premtimi bullgar në vitin 1960 qëndronte hija e rëndë e Malinovskit dhe e klounit tragjik Nikita Hrushov.

Protestat tona: Të shihet praktika në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe fjalimi im mbajtur në Mbledhjen e 81 partive komuniste e punëtore në Moskë 1960, ku unë sulmoj Zhivkovin për çështjen e botimit në Bullgari të një harte të Ballkanit, ku Shqipëria përfshihet brenda kufijve të Jugosllavisë, dhe Hrushovin për mbledhjen e Sremska Mitrovicës, ku banditi Rankoviç na sulmon ne e ku ndodheshin edhe ambasadori sovjetik e ai i Bullgarisë<sup>2</sup>. Po këtu qëndron edhe çështja e Kosovës, e cila mund të përdoret me këtë rast, por mund të përdoret edhe në ndonjë rast tjetër.

Për sa i përket mbledhjes së Sremska Mitrovicës

1 Mareshal revizionist sovjetik, kryekomandant i forcave agresive të Traktatit të Varshavës.

2 Shih: Enver Hoxha. Vepra, vëll. 19, f. 450-451.

të theksojmë se si Hrushovi përkëdhel Rankoviçin serbomadhe dhe klanin e tij prorus<sup>1</sup>.

Konkluzioni i këtij shkrimi duhet të jetë një demaskim i bullgarëve pa dalë në mbrojtje ose në atake të kërkesave të tyre mbi Maqedoninë aktuale që është punë e jugosllavëve dhe e grekëve, por, me këtë rast, atje të vëmë mirë në dukje atë që thamë më lart, se në këtë ose në atë «Maqedoni» ekzistojnë toka shqiptare të banuara nga populli shqiptar autokton. Shkrimi të mos ketë as aluzionin më të vogël të rivendikimit territorial.

### Dokumente që duhen përdorur:

Vepra, vëll. 19.

a. Notë verbale dhënë ambasadorit sovjetik në Tiranë mbi qëndrimin antimarksist të ambasadorit sovjetik e të atasheut ushtarak në Beograd, lidhur me mitingun në Sremska Mitrovica, 3 korrik 1960.

b. Mbi mbledhjen e Sremska Mitrovicës dhe mbi hartën e dytë bullgare. Shih dhe praktikën e notës protestë qeverisë bullgare.

c. Fjalimi në Mbledhjen e 81 partive, ku ndodhet përcaktimi mbi çështjen e Kosovës dhe viseve të tjera nga ne.

P. S.

Harta e Shën-Stefanit duhet të na vijë nga Sofja dhe duhet studiuar.

1 Shih: «Ngjarjet e Kosovës dhe bashkëpunimi i fshehtë sovjetico-serbomadhe», «Zëri i popullit», 5 qershor 1981.

**MBI PËRGATITJEN E NJË ARTIKULLI TEORIKO-  
-HISTORIK NË FORMË POLEMIKE TË RREPTË  
KUNDËR SULMEVE PA BAZA QË NA BËJNË  
SHOVINISTËT E TËRBUAR TË BEOGRADIT**

**Shënime (vazhdim<sup>1</sup>)**

Mendoj të përgatitim një material edhe kundër revizionistëve bullgarë. Siç e vë në dukje në shënimet që shkrova dje, pa iu drejtuar drejtpërdrejt jugosllavëve, qëllimi kryesor është që t'u themi këtyre se në Maqedoni janë përfshirë toka shqiptare ku jeton një popullatë e madhe shqiptare. Kjo është ideja që do të hidhet në artikull për të atakuar bullgarët në lidhje me hartën që kanë botuar me rastin e përvjetorit të Traktatit të Shën-Stefanit. Sipas kësaj harte, kufijtë e shtetit të tyre bullgarët i shtyjnë deri në Adriatik.

Në artikull ne ta atakojmë këtë botim dhe të vëmë në dukje se, nga pikëpamja e etnisë, në Maqedoni (mund të quhet ajo e Egjeut apo e Vardarit, qoftë Maqedoni e thjeshtë), ekzistojnë toka dhe popullsi shqiptare dhe të përcaktojmë qartë kufijtë se brenda cilit territor jeton kjo popullsi. Titulli i materialit mendoj të jetë: «Traktati i Shën-Stefanit dhe loja e rrezikshme me harta nga qeveria revizioniste e Republikës Popullore të Bullgarisë».

Nuk është hera e parë që bullgarët nxjerrin të tilla

<sup>1</sup> Shih në këtë vëllim f. 509.

botime. Ata edhe një herë tjetër, para vitit 1960, kanë shtypur një hartë të Ballkanit ku tërë Shqipërinë e kanë futur brenda kufijve të Jugosllavisë. Kjo ishte një dhuratë që i bëhej atëherë Titos. Në këtë hartë Shqipëria figuron si republikë e shtatë e Jugosllavisë.

Në material, siç kam shkruar dje, të shfrytëzohen ndërhyrjet që kam bërë kundër këtyre veprimeve, në fjalimin që mbajta përpara përfaqësuesve të 81 partive në vitin 1960 në Moskë, pastaj edhe nota që i drejtua në atë kohë qeverisë bullgare. Po fjala që kam mbajtur përpara përfaqësuesve të 81 partive në vitin 1960 në Moskë është më e fortë.

Nesër në «Zërin e popullit» do të botohet artikulli me titullin «Ngjarjet e Kosovës dhe bashkëpunimi i fshehtë sovjeto-serbomadh». Në këtë artikull t'i referohemi ngjarjes në Sremska Mitrovica, duke përdorur edhe frazat më të forta që janë përdorur në protestën që kemi bërë në atë kohë kundër ambasadorit sovjetik dhe atashehut që morën pjesë në mitingun e Sremska Mitrovicës dhe dëgjuan me qetësi të madhe, me fjalë të tjera, me qëndrimin e tyre, miratuan, mbështetën publikisht tezat e xhelatit Rankoviç, i cili midis të tjerave për vendin tonë tha se «Shqipëria është e rrethuar me tela me gjemba, atje sundon çizmja e kufitarit etj...».

Për sa u përket artikujve që do të përgatiten nga Aleks Buda e të tjerë kuadro, me siguri që do të jenë të mirë dhe mund të botohen, por duket që jashtë nuk po u vihet si duhet veshi ngjarjeve që po zhvillohen në lidhje me Kosovën. Para disa ditësh u përgatit një artikull nga një grup profesorësh që ishte i mirë<sup>1</sup>, edhe ai i Ismail Kadaresë<sup>2</sup> ishte akoma më i mirë, por po

<sup>1</sup> «Zëri i shkencës dhe era e shovinizmit». «Zëri i popullit», 26 maj 1981.

<sup>2</sup> «Kultura shqiptare në shënjestër të shovinizmit serbomadh». «Zëri i popullit», 29 maj 1981.

konstatohet se këtyre nuk u është bërë jehonë nga shtypi ndërkombëtar, vihet re një «lodhje» nga ana e tij, bile duket sikur kërkon të lërë përshtypjen se shumë ka folur për ngjarjet tragjike të Kosovës, megjithëse, siç po shikoj mbi materialet tona të fundit, prapë mund të ketë komente.

Vihet pyetja: Përse e mban shtypi botëror këtë qëndrim? Kjo tendencë rënieje e shtypit botëror në trajtimin e ngjarjeve të Kosovës shpjegohet me atë që Perëndimi synon ta mbrojë Jugosllavinë, megjithatë shikon që jugosllavët, në politikën që ndjekin, nuk kanë baza. Nga ana e tyre jugosllavët flasin e do të flasin më shumë, prirja e tyre është të na sulmojnë ne nga të katër anët, shkruan apo nuk shkruan shtypi botëror për ngjarjet që po zhvillohen. Sulmet që ata bëjnë kundër Kosovës dhe Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë i bëjnë për opinionin e tyre të brendshëm, por mundësisht edhe për jashtë, pse, sa më shumë të përhapet fjala e tyre, le të dëgjohet, mendojnë ata, mirë është, kush të besojë, të besojë, po edhe atij që nuk beson, prapë diçka do t'i mbetet në mendje nga propaganda e madhe që po bëjnë.

Tani është koha që të përdorim për polemikë faktet historike. Prandaj, pasi të përgatitim të gjithë këta artikuj që kemi në duar, duhet të shkruajmë edhe një material tjetër të gjatë, që të mos botohet përnjëherë pas këtyre që jemi duke përgatitur, por pas ca kohe. Në këtë artikull të fillojmë të shpjegojmë teorikisht ç'do të thotë «irredentizëm», ç'do të thotë «nacionalizëm» dhe ç'do të thotë «shovinizëm». Së pari t'i shpjegojmë si kuptohen këto nocione në Jugosllavi dhe si kuptohen në Shqipëri, në Shqipërinë «e vogël» o në Shqipërinë «e madhe», cilat janë arsyet e lindjes së tyre, ku i kanë bazat, të bëjmë me këtë rast një bilanc se ku ka ekzistuar «shovinizmi» ose «nacionalizmi» më i theksuar, te

populli serb, në mbretërinë serbo-kroato-slllovene dhe në regjimin titist, apo te shqiptarët që jetojnë në trojet e veta në Jugosllavi dhe pastaj në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Ne duhet të flasim për luftën e madhe e të vazhdueshme që kanë bërë gjithë shqiptarët për të siguruar pavarësinë e tyre kombëtare, të shkruhet në formë polemike për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit dhe për padrejtësitë e mëdha që i janë bërë popullit tonë, nga kush janë bërë këto padrejtësi, që kanë qenë rezultat i intrigave të mëdha të serbomëdhenjve, të monarkisë serbo-kroato-slllovene. Atëherë nacionalizmi i tërbuar dhe shovinizmi kanë qenë tek ata aq tepër të theksuar sa që nga ana e tyre janë bërë krime të mëdha kundër popullit shqiptar në përgjithësi dhe në veçanti kundër pjesës së madhe të popullit shqiptar që fuqitë e mëdha e lanë brenda kufijve të mbretërisë serbo-kroato-slllovene. Këtu duhet të flasim për çështjen e marrëveshjes midis Stojadinoviçit me Çianon, të vëmë në dukje tezat e Çubrilloviçit dhe aplikimin e tyre për asgjësimin komplet të shqiptarëve. Domethënë nocioni i nacionalizmit integral nga ana e serbomëdhenjve ka synuar në likuidimin e shqiptarëve në Jugosllavi, që kanë qenë miliona, veprim që ka rezultuar me vrasje në masë të tyre. Këtu duhet t'i themi, se janë të vërteta historike dhe kanë ekzistuar.

Të vihen pastaj në dukje shpërnguljet e mëdha të qindra mijë shqiptarëve në Turqi dhe të mijëra të tjerëve që erdhën në Shqipëri, në ujdi me regjimin e saj të asaj kohe, duke financuar për këtë qëllim mbretërinë e Zogut.

Shqiptarët kanë pasur arsye të mëdha të luftonin për pavarësinë e atdheut të tyre dhe të kundërshtonin këtë nacionalizëm ekskluziv të egër dhe likuidator të një populli të tërë. Këtu ne t'ua hedhim fajin jugosllavëve.

Erdhi Lufta e Dytë Botërore, u realizua komploti Stojadinoviç-Çiano dhe u krijua «Shqipëria e madhe», të cilën Partia e Punës e Shqipërisë e luftoi, por atë e luftuan edhe kosovarët. Fakt është që në fillim kosovarët nuk kishin besim te jugosllavët dhe kishin të drejtë. Ata dyshonin që serbët dhe kushdo qoftë nga kombësitë e tjera sllave në Jugosllavi, do t'u jepnin atyre në të ardhmen të drejtat kombëtare. Dhe hyrja e shqiptarëve të Kosovës në luftën nacionalçlirimtare u bë, por u bë me vonesë dhe s'ishin vetëm veprimet e ballistëve kosovarë në luftën nacionalçlirimtare, por ishin më të tmerrshme lufta e veprimet e çetnikëve në Mal të Zi, në Serbi dhe në Kroaci që e frenuan këtë gjë. Në artikull të vëmë në dukje që shqiptarët në Jugosllavi kuptuan që «Shqipëria e madhe» e Musolinit duhej të fitohej me gjak, se ajo s'ishte e Musolinit, por ishte ajo Shqipëri që duhej të ekzistonte dhe ishte e drejtë të ekzistonte.

Në këto çështje të hidhemi në sulm, të mos qëndrojmë më në pozitat e mëparshme, t'i shpjegojmë këto historikisht. Dhe pas gjithë këtyre qëndrimeve të egra nacionaliste e shoviniste të jugosllavomëdhenjve kundër popullit shqiptar që jeton në Jugosllavi, me qëllim që të fitohej besimi te ky popull, Titoja bëri deklaratën që kemi përmendur. Të tregojmë përsëri çfarë tha ai në atë kohë, duke vënë njëkohësisht në dukje se premtimet e tij nuk u mbajtën. Kurse Moshe Pijade mbajti një qëndrim më elastik, më pak radikal nga ai i Titos, kur deklaroi se pas luftës në Jugosllavi duhej të krijohesh një republikë e Kosovës, por që as kjo nuk u bë. Po pse nuk u realizua as kjo? Nuk u realizua pse veproi shovinizmi serbomadhi, qëllimet e afirmuara në Jajcë u ndryshuan, u zbatua hakmarrja kundër shqiptarëve, duke i akuzuar këta si ballistë dhe jugosllavomëdhenjtë bënë kështu gjenocidin e parë kundër shqiptarëve të Jugosllavisë. Këtu duhet të vihet çfarë vranë e sa vranë, që ne i dimë, po

që duhet t'i fiksojmë në këtë dokument. Kjo ndodhi në vitin 1945.

Pastaj erdhi gjenocidi tjetër i Rankoviçit i vitit 1966 që është shënuar, për të cilin është folur në materialet e mia dhe tani përsëri duhet të merren.

Ç'tregon kjo? Kjo tregon se shovinizmi dhe nacionalizmi serbomadhi dhe jugosllavomadhi kundër shqiptarëve në Jugosllavi ka qenë i tmerrshëm, sa që ka arritur deri në gjenocid. Këndeji lind vetvetiu dëshira e irredentizmit nga ana e tyre. Këtë dëshirë të irredentizmit e kanë shkaktuar tek ata shovinizmi dhe nacionalizmi i tërbuar serbomadhi e jugosllavomadhi.

U pa ky gabim i tmerrshëm i kryer në vitin 1966 dhe banda e Rankoviçit u dënua, po s'ishte ai i vetmi që e bëri këtë gjenocid, që u përsërit aktualisht nga po ata njerëz dhe me të njëjtën prejardhje. Këto akte çnjerëzore shoviniste dhe nacionaliste të tërbuara vazhduan me po atë virulencë në brezat pasardhës të atyre që vetëquhen socialistë dhe që akuzojnë shqiptarët për nacionalizëm, për shovinizëm dhe irredentizëm.

Të gjitha kërkesat e shqiptarëve, të cilët nga periudha e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit e gjer tani janë vrarë me qindra e mijëra e janë shtypur e persekutuar, janë evidente dhe të domosdoshme, pse atyre nuk u është njohur asnjë e drejtë, përveç së drejtës shumë të kufizuar për çështjen e arsimit që u është dhënë vonë, por që edhe në këtë drejtim tani po vërehet prirja për kufizime të tjera të mëtejshme etj., etj.

Këtej duhet të dilet me konkluzionin që këtu nga ana e shqiptarëve nuk ka asnjë fije nacionalizëm, as shovinizëm, as irredentizëm, por irredentizmi e merr këtë formë, të cilën e ka shkaktuar nacionalizmi integral dhe shovinizmi serb, që ka qenë dhe është i dënueshëm. Shqiptarët, pra, janë krejt pa faj në këtë mes dhe, megjithëse nuk janë aspak fajtorë, ata shtypen e vriten në

një regjim të ashtuquajtur socialist, që nuk është veçse një regjim barbar.

Shqipëria nga ana e vet ka kërkuar, vazhdon e do të vazhdojë deri në fund të kërkojë që t'u jepet të drejtat që u takojnë me kushtetutë vëllezërve tanë në Jugosllavi. Minimalja që kanë kërkuar ata është t'i njihet Kosovës statusi i republikës. Këtë ka mbrojtur Shqipëria, e cila mund të thoshte edhe më shumë dhe e ka këtë të drejtë të flasë më shumë dhe këtu ta shpjegojmë psenë, mbasi nuk kemi të bëjmë me një çështje thjesht minoriteti. Për një minoritet të vogël, kur këtij i jepet të gjitha të drejtat demokratike etj. në vendin ku jeton, mund edhe duhet të mos bëhet problem, por, në qoftë se ky minoritet, sikur edhe i vogël të jetë, shtypet, atëherë vëllezërit e tyre që kanë fituar lirinë, pavarësinë, që kanë krijuar shtetin e tyre sovran, e kanë për detyrë që ta mbrojnë. Kurse shqiptarët në Jugosllavi nuk janë minoritet, ata janë me miliona, janë një popull i tërë, gati sa vetë Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë.

Në këtë drejtim ne duhet të bëjmë një sulm, sepse jugosllavomëdhenjtë duan të na vënë me shpatulla në mur, me qëllim që, në qoftë se ne do të flasim për mbrojtje të vëllezërve tanë në Jugosllavi, të na quajnë irredentistë, nacionalistë, shovinistë e çfarë të duash. Por shqiptarët që jetojnë në Jugosllavi janë vëllezërit tanë, janë pjesë e një kombi. Këtë ne e kemi thënë dhe e themi.

Ne duhet ta kthejmë këtë sulm në disfavor të tyre, të shpjegojmë ç'janë shovinizmi dhe nacionalizmi, kemi qenë a s'kemi qenë ne shovinistë e nacionalistë, ta argumentojmë këtë çështje me fakte, me qëndrimet tona dhe të vëmë në dukje se të tillë kanë qenë ata. Gjithashtu, të argumentojmë me fakte të njohura botërisht edhe si kanë vepruar jugosllavomëdhenjtë dhe se ka qenë pikërisht qëndrimi i tyre barbar që ka bërë të lindë te shqip-

tarët irredentizmi, absolutisht i domosdoshëm për mbrojtjen e ekzistencës së vet.

Me gjithë këto, të vihet në dukje në materialin tonë se ne kemi dashur dhe dëshirojmë miqësinë dhe marrëdhënie të fqinjësisë së mirë me Jugosllavinë Federative, pa ndërhyrë në punët e saj të brendshme, por, kur shohim se atje, po bëhen gjithë këto masakra të përgjakshme dhe në vazhdimësi të theksuara kundër popullsisë shqiptare që jeton në këtë vend, atëherë kjo çështje mund të quhet çfarë të duash, por emrin e ka kështu si themi ne.

Ky duhet të jetë një material me rëndësi, teorik dhe historik, në formë polemike të ashpër, me qëllim që jugosllavët, kur të përdorin termat «shovinizëm», «nacionalizëm» ta kenë të qartë se demaskojnë veten, ta dinë se ne nuk e quajmë këtë nacionalizëm dhe shovinizëm në kuptimin teorik të fjalës, po kur flasim për Kosovën e kosovarët, flasim për Shqipërinë dhe ju themi se ju keni shkëputur një pjesë të kësaj Shqipërie. Ne ju themi: Pse nuk e bëtë ju në kohën e duhur referendumin, që populli i Kosovës të vetëvendoste? Ne ju pyesim: Përse nuk i jepni Kosovës statusin e republikës, kur është thënë që kjo duhet t'i jepet? Këtë ju e quani nacionalizëm, por jo, nuk është nacionalizëm. Të vërtetohet edhe teorisht që ky nuk është nacionalizëm.

Përgatitja e këtij materiali ka rëndësi shumë të madhe. Në të duhet të ngremë edhe çështjen përse revista «NIN», siç i kupton ajo, numëron të gjitha krimet që janë bërë kundër popullit shqiptar dhe më në fund e mbyll ligjëratën me fjalët që «u bë ç'u bë në të kaluarën, mbledhja e Helsinkit i vuri kapakun, ajo vendosi statukuonë». Jo. Helsinki aspak s'i vuri kapakun këtij problemi. Asnjë traktat i padrejtë i nënshkruar nga ana e imperialistëve nuk mund t'i vërë kapakun një çështjeje kaq të madhe, ku gjysma e një populli të tërë, që jeton në to-

kat e veta, të shtypet egërsisht. Helsinki vendosi dhe mbi të drejtat e njeriut. Jugosllavëve nuk u ndihet zëri për këtë dhe vazhdojnë të shtypin egërsisht popullsinë shqiptare prej afro 2 milionësh dhe të shkelin të drejtat e saj.

Në artikull të theksojmë se nuk janë këto arsyt që jep «NIN»-i që ne nuk morëm pjesë në mbledhjen e Helsinkit, por, meqenëse ju na akuzoni, se nuk paskëshim shkuar për këtë arsye, po ju japim përgjigjen edhe për këtë çështje.

E ENJTE  
4 QERSHOR 1981

## NGJARJET E KOSOVËS DHE BASHKËPUNIMI I FSHEHTË SOVJETO-SERBOMADH

Iu dërgua gazetës «Zëri i popullit», që ta botojë nesër, një artikull për të demaskuar bashkëpunimin e fshehtë antishqiptar midis revizionistëve jugosllavë dhe atyre sovjetikë lidhur me ngjarjet në Kosovë.

## RRETH KOMPLOTTIT ANTISHQIPTAR SOVJETO-SERBOMADH

Të shkruhet një artikull bazë për këtë komplot:

«Flota sovjetike në Mesdhe dhe ankorimi i anijeve të saj në portet jugosllave»<sup>1</sup>. (Skemë-ide.)

Drejtimit strategjike të këtij komploti:

a. Sulmi kundër porteve jetike italiane në Mesdhe dhe në detin Adriatik.

b. Forcimi (kalimi me forcë), i kanalit të Otrantos nga jugu dhe nga veriu.

c. Synime sulmi dhe pushtimi i porteve shqiptare, sidomos i Vlorës dhe i Durrësit.

ç. Ndihmë dhe mbështetje në mësymjen serbo-malazeze mbi Shkodrën dhe Shqipërinë e Veriut.

d. Ndihmë dhe mbështetje forcave serbomadhe kundër kroato-sllovenëve dhe aleatëve të tyre të mundshëm.

**Mali i Zi për sovjetikët hyn në kuadrin serbomadh. Politika e vjetër e knjaz Nikollës dhe e Sazonovit.** Prandaj portet kryesore ku ankorohen anijet luftarake sovjetike janë Spliti, Dubrovniku, Kotorri ose Tivari.

**Armatimet sovjetike furnizuar me kohë dhe tash jugosllavëve dhe pjesët e tyre të ndërrimit.**

a. Sasitë dhe llojet kryesore të tyre.

<sup>1</sup> «Çfarë kërkojnë flotat ushtarake të superfuqive në portet jugosllave?». «Zëri i popullit», 1 korrik 1981.

b. Përpjesëtimet e këtyre armatimeve me armët e vendeve të tjera si ato amerikane ose të ndonjë shteti tjetër.

c. Mundësisht shpërndarja e llojeve të ndryshme të tyre.

ç. Drejtimit kryesore të aerodromeve.

d. Oficerët madhorë të shtabeve më të shumtë në vende kyç dhe të ç'kombësie janë?

e. Repartet ushtarake janë të përziera me efektive të republikave të ndryshme apo jo?

**Artikulli tjetër për marrëdhëniet ekonomike<sup>1</sup>.** Jugosllavia, «dëgjuese» dhe pjesëmarrëse në KNER. (Ajo nuk është pranuar atje as të «vëzhgojë» dhe as të supervizojë të tjerët, që gjoja i quan të rrezikshëm.)

a. Jugosllavia merr kredi dhe teknologji nga Bashkimi Sovjetik dhe nga pjesëtarët e tjerë të KNER-it.

b. Jugosllavia blen dhe jep informata të çdolloyta, nën maskën e marrëdhënieve ekonomike. Ajo është një proksenet i kalibrit të madh që kur ka qenë gjallë Titoja, është ura në mes amerikanëve dhe sovjetikëve. Të dy rivalët e mëdhenj e shfrytëzonin Titon dhe ky tregohet *versatil*, sipas koniunkturave. Miqësia Jugosllavi-Rumani, Tito-Çausheku, ishte ndërtuar në këto baza. Sa vdiq Titoja, edhe Çausheku u fut në hije. Të dy shtetet janë në krizë të madhe ekonomike dhe politike. Vlera e tyre si proksenetë ra. Çausheku dhe Rumania *de facto* i janë nënshtruar ligjit sovjetik.

Jugosllavia si federatë tani po përpëlitet, por klani serbomadh i ruan fijet e komplotit të fshehtë me sovjetikët. Maqedonia dhe Mali i Zi janë në suazën dhe marrin frymë me mushkëritë serbe.

Sovjeti në këto dy republika investon. Ai ka filluar

<sup>1</sup> «Marrëdhëniet ekonomike midis Jugosllavisë e Bashkimit Sovjetik dhe komploti ruso-serbomadh». «Zëri i popullit», 12 korrik 1981.

të investojë edhe në Kosovë, por këtë s'mund ta ketë kurrë me vete. Prandaj popullsia e saj shtypet e gjakoset nga Serbia.

Investimet ekonomike, dhënia e armatimeve, informacioni i KGB-së, i përgatitur nga elementë të kamufluar si «specialistë», «ekonomistë» dhe «ndërtues», janë fijet e komplotit, që mund të përdoren në momentin e volitshëm për sovjeto-serbomëdhenjtë për të pasur përnjëherë në dorë frontin unik tokësor: Serbi-Maqedoni-Mal i Zi kundër Shqipërisë, Greqisë, Dardaneleve dhe Turqisë së Evropës.

Në këtë artikull duhet të përcaktojmë afërsisht:

a. Sasinë dhe kreditë që i janë dhënë Jugosllavisë nga sovjeti etj.

b. Ku janë investuar këto kredi dhe në ç'republika janë investuar më shumë?

c. Niveli i shkëmbimeve tregtare dhe të çfarë lloji janë këto shkëmbime në sasi dhe në vlefte? Mallrat e blera janë materiale strategjike apo jo? Si është bërë ndarja e tregtisë në mes Jugosllavisë dhe vendeve satelite?

ç. Si qëndrojnë shkëmbimet që bëjnë në mes tyre këto vende në kuadrin e eksperiencës tekniko-shkencore-arsimore-kulturore dhe politiko-partie.

Këta duhet të jenë artikujt që plotësojnë demaskimin e komplotit sovjeto-serbomadh dhe zbulojnë fijet e hapëta dhe njëkohësisht të fshehta të komplotit sovjeto-serbomadh. Këto çështje duhet të zhvillohen dhe të faktohen me dokumentacione që ekzistojnë në ministrinë tona të ndryshme.

Të dhënat e nevojshme duhet të mblidhen e të klasifikohen. Kur t'i kemi në dorë këto të dhëna, atëherë do të caktojmë edhe kuadro të kualifikuar, që t'i formulojnë definitivisht artikujt, të cilët duhet të jenë të një niveli të lartë politik, ushtarako-strategjik, ekonomik etj.

## P.S.

Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë hiqet e paangazhuar, por në fakt ekonomikisht është e angazhuar nga të dyja superfuqitë. *De jure* ajo është deklaruar jashtë blloqeve, por *de facto* dhe në mënyrë të fshehtë ekziston komploti sovjeto-serbomadh. Kjo është një aleancë e njëanshme. Logjika ta do që Shtetet e Bashkuara të Amerikës të mos rrinë më duarlidhur përpara kësaj gjendjeje, ato duhet të mbështetin klanin kroato-slloven.

Propagandohet rreziku sovjetik që është real, po në fshehtësi të tij ekziston komploti sovjeto-serbomadh.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë deklaruar se do të protestojnë për një veprim sovjetik në Jugosllavi, do të marrin masa etj., por në luftë për ta mbrojtur Jugosllavinë ato nuk do të angazhohen. Të paktën ky ka qenë versioni zyrtar i kohës së Karterit.

**E PREMTE**  
**5 QERSHOR 1981**

## **JUGOSLLAVIA TITISTE, E SËMURA E BALLKANIT, MANOVRON T'I VËRË ZJARRIN GADISHULLIT BALLKANIK**

**Intriga serbo-ruse nxit armiqësinë shqiptaro-greke**

### **Shënime<sup>1</sup>**

Ja ç'thoshte Tanjugu dje, më 4 qershor: «Tirana, nëpërmjet misioneve të saj diplomatike në Uashington dhe në selinë e Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork, si dhe nëpërmjet institucioneve të ndryshme shkencore dhe universitare në SHBA, ka shpërndarë një hartë politike të «Shqipërisë së madhe», në të cilën fut edhe territore të Epirit grek, duke përfshirë qytetet Janinë, Igumenicë, Konicë etj., që i quan «rajoni i Çamërisë» së pushtuar nga Greqia, dhe shtonte se, për këtë gjë në parlamentin grek i është bërë një pyetje ministrit të Punëve të Jashtme dhe se gazeta «Akropolis» ka botuar një koment kundër «ekspansionizmit shqiptar» dhe «persekutimeve të minoritetit grek në Shqipëri» etj.

— Është një intrigë nga më të ndyrat dhe nga më të rrezikshmet kjo që po kurdis policia e fshehtë politike

---

<sup>1</sup> Këto shënime janë kthyer në artikull. Shih: «Jugosllavia titiste, e sëmura e Ballkanit, nxit armiqësinë shqiptaro-greke». «Zëri i popullit», 11 qershor 1981.

serbe (UDB-ja) e lejuar nga qeveria e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë me reaksionin më të zi shovinist grekomadh që jeton në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

— Shpifjet e UDB-së jugosllave skenarin e vënë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pikërisht në Uashington, ku ne nuk kemi mision dhe ku misioni ynë pranë Kombeve të Bashkuara nuk mund të shkojë, sepse nuk lejohet të dalë asnjë hap jashtë zonës së Manhatanit, të caktuar apostafat për njerëzit e misionit tonë. Gjoja këta të fundit, këto të ashtuquajtura harta i kanë shpërndarë edhe në selinë e Kombeve të Bashkuara. Por kjo është lehtësisht e kontrollueshme nga organet e saj për të zbuluar gënjeshtren e rrezikshme. Njerëzit që i kanë vënë këtu e kanë për detyrë të hetojnë çështjen dhe të denoncojnë autorët.

— Me këtë shkrim nuk kemi për qëllim të polemizojmë me zonzën Cuderos<sup>1</sup> që i ka bërë një pyetje në parlament zotit Micotaqis. Ajo ka të drejtë t'i bëjë jo një, por njëqind e një pyetje dhe i përket zotit Micotaqis t'i japë përgjigje për to.

— As nuk dëshirojmë, gjithashtu, të polemizojmë me ato organe të shtypit grek që përmend Tanjugu për të ilustruar intrigën e tij të rrezikshme, të polemizojmë për pretendimet e tyre absurde mbi rivendikimet e tokave shqiptare, që ata i quajnë «Vorio-Epir». Kjo histori ka vdekur me kohë, është pa fat dhe nuk ka as më të voglin shans që të përdoret si mollë sherri nga qeveria jugosllave dhe policia e saj e fshehtë për të kurdisur zbulimin «gjenial» të hartës misterioze të përgatitur prej tyre.

— Asnjëherë grupi reaksionar grekomadh qoftë në

---

<sup>1</sup> Virgjinia Cuderos, anëtare e Partisë Socialiste Demokratike Greke.

Greqi, qoftë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nuk ka pushuar të shpifë. Shumë gjëra të këqija kanë thënë ata kundër shqiptarëve, shumë krime na kanë vënë në kurriz kundër minoritetit grek që jeton i lumtur në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë, harta të ndryshme kanë shtypur për të përcaktuar «kufijtë deri ku shtrihej Vorio-Epiri» i tyre, por asnjëherë nuk kanë botuar ata ndonjë hartë për të ashtuquajturat rivendikime territoriale tonat në Greqi për të kërkuar Artën, Prevezën, Janinën e deri në Follorinë, ose edhe më tej, siç pretendon Tanjugu. Jo vetëm kaq, por asnjëherë shtypi i tyre dhe cilado qeveri greke nuk ka folur për një çështje të tillë, pse as ka pasur pretendime nga ana jonë dhe nuk është ngritur asnjëherë kjo çështje nga ne.

— Si pa gjë të keqe, një mëngjes, pas ngjarjeve tragjike që jugosllavët shkaktuan në Kosovë, ku për të tretën e për të katërtën herë policia e fshehtë dhe ushtria serbe zbatuan një gjenocid të tmerrshëm kundër shqiptarëve që jetojnë në trojet e tyre në Jugosllavi, na nxorën se gjoja ne shqiptarët paskemi shpërndarë në Uashington dhe në selinë e Kombeve të Bashkuara një «hartë, ku brenda kufijve të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, kemi inkluduar edhe Çamërinë»!

— «Shpikje gjeniale» e policisë satanike jugosllave për të prishur miqësinë e mirë që ekziston në mes Shqipërisë socialiste dhe Greqisë demokratike, gjë që nuk u leverdis qeverisë jugosllave dhe aleatëve të tyre të fshehtë sovjetikë, të cilët e kurdisin këtë veprim për të fshehur gjenocidin në Kosovë dhe për të «vërtetuar» se «shqiptarët jo vetëm që po ndërhyjnë në punët e brendshme të Jugosllavisë, por ata po ndërhyjnë dhe kanë rivendikime territoriale edhe në Greqi» dhe, që të plotësojnë teoremën, konkludojnë se «shqiptarët janë nacionalistë, shovinistë, irredentistë». E këshillojmë policinë e fshehtë serbe që ta shtrijë «këtë shovinizëm shqip-

taromadh» edhe në Turqi, ku banojnë shqiptarë, pse jo edhe në Itali ku 5 shekuj më parë kanë emigruar atje arbëreshë. Pra edhe për këto mund të bëhen harta dhe të shpërndahen në rrugët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, apo të ndonjë vendi tjetër.

— Ne u themi jugosllavëve se miqësia e popullit shqiptar me popullin grek ka qenë në shekuj nga më të mirat dhe nga më të singërtat. Po ashtu edhe sot po rindërtohet një miqësi e tillë që ju më kot po përpiqeni ta prishni me aleatët tuaj. (Të bëhet një historik i kësaj miqësie, të mos harrohet të vihen citate nga tonat dhe nga grekët.)

— Një miqësi e tillë s'ka ekzistuar kurrë me serbo-mëdhenjtë, pse këta kanë qenë dinakë, shovinistë dhe shtypës. (Të flitet për bisedën e Titos me mbretin e Greqisë në Korfuz, për bisedën e Hrushovit me djalin e Elefter Venizellosit. Të flitet që në kohën e tij, pikërisht pas Luftës së Dytë Botërore, Caldarisi, një shovinist i tërbuar antishqiptar, i dëboi nga tokat e tyre çamët, i hodhi në Shqipëri, por është e drejtë të themi që as i griu me mitraloza dhe as i shtypi me tanke, siç po bëni ju serbomëdhenj me shqiptarët e Jugosllavisë.)

— Pikërisht për të fshehur krimet e përgjakshme që po bëni në Kosovë, ju flisni me gojën e ndonjë gazetari shovinist vorioepirot, i gatshëm dhe i paguar nga ju për «krimet, për gjenocidin dhe për gjysmën gati të të gjithë minoritetit grek të futur në burg» nga ana jonë!

— Zotërinj agjentë jugosllavë, kjo gënjeshtër dhe shpifje është shumë e trashë, por këto trillime tuaja ne nuk i gjejmë të dëmshme për veten tonë, sepse ato, në fakt, ju demaskojnë ju në sy të opinionit botëror dhe ne i botojmë që t'ju njohë mirë edhe populli grek, edhe populli shqiptar, edhe minoriteti grek.

— Si jeton minoriteti grek në atdheun e tij, në

**E PREMTE**  
**5 QERSHOR 1981**

## **JUGOSLLAVIA TITISTE, E SËMURA E BALLKANIT, MANOVRON TI VËRË ZJARRIN GADISHULLIT BALLKANIK**

**Intriga serbo-ruse nxit armiqësinë shqiptaro-greke**

### **Shënime<sup>1</sup>**

Ja ç'thoshte Tanjugu dje, më 4 qershor: «Tirana, nëpërmjet misioneve të saj diplomatike në Uashington dhe në selinë e Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork, si dhe nëpërmjet institucioneve të ndryshme shkencore dhe universitare në SHBA, ka shpërndarë një hartë politike të «Shqipërisë së madhe», në të cilën fut edhe territore të Epirit grek, duke përfshirë qytetet Janinë, Igumenicë, Konicë etj., që i quan «rajoni i Çamërisë» së pushtuar nga Greqia, dhe shtonte se, për këtë gjë në parlamentin grek i është bërë një pyetje ministrit të Punëve të Jashtme dhe se gazeta «Akropolis» ka botuar një koment kundër «ekspansionizmit shqiptar» dhe «persekutimeve të minoritetit grek në Shqipëri» etj.

— Është një intrigë nga më të ndyrat dhe nga më të rrezikshmet kjo që po kurdis policia e fshehtë politike

<sup>1</sup> Këto shënime janë kthyer në artikull. Shih: «Jugosllavia titiste, e sëmura e Ballkanit, nxit armiqësinë shqiptaro-greke». «Zëri i popullit», 11 qershor 1981.

serbe (UDB-ja) e lejuar nga qeveria e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë me reaksionin më të zi shovinist grekomadh që jeton në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

— Shpifjet e UDB-së jugosllave skenarin e vënë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pikërisht në Uashington, ku ne nuk kemi mision dhe ku misioni ynë pranë Kombeve të Bashkuara nuk mund të shkojë, sepse nuk lejohet të dalë asnjë hap jashtë zonës së Manhatanit, të caktuar apostafat për njerëzit e misionit tonë. Gjoja këta të fundit, këto të ashtuquajtura harta i kanë shpërndarë edhe në selinë e Kombeve të Bashkuara. Por kjo është lehtësisht e kontrollueshme nga organet e saj për të zbuluar gënjeshtren e rrezikshme. Njerëzit që i kanë vënë këtu e kanë për detyrë të hetojnë çështjen dhe të denoncojnë autorët.

— Me këtë shkrim nuk kemi për qëllim të polemizojmë me zonjën Cuderos<sup>1</sup> që i ka bërë një pyetje në parlament zotit Micotaqis. Ajo ka të drejtë t'i bëjë jo një, por njëqind e një pyetje dhe i përket zotit Micotaqis t'i japë përgjigje për to.

— As nuk dëshirojmë, gjithashtu, të polemizojmë me ato organe të shtypit grek që përmend Tanjugu për të ilustruar intrigën e tij të rrezikshme, të polemizojmë për pretendimet e tyre absurde mbi rivendikimet e tokave shqiptare, që ata i quajnë «Vorio-Epir». Kjo histori ka vdekur me kohë, është pa fat dhe nuk ka as më të voglin shans që të përdoret si mollë sherri nga qeveria jugosllave dhe policia e saj e fshehtë për të kurdisur zbulimin «gjenial» të hartës misterioze të përgatitur prej tyre.

— Asnjëherë grupi reaksionar grekomadh qoftë në

<sup>1</sup> Virgjinia Cuderos, anëtare e Partisë Socialiste Demokratike Greke.

Greqi, qoftë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nuk ka pushuar të shpifë. Shumë gjëra të këqija kanë thënë ata kundër shqiptarëve, shumë krime na kanë vënë në kurriz kundër minoritetit grek që jeton i lumtur në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë, harta të ndryshme kanë shtypur për të përcaktuar «kufijtë deri ku shtrihej Vorio-Epiri» i tyre, por asnjëherë nuk kanë botuar ata ndonjë hartë për të ashtuquajturat rivendikime territoriale tonat në Greqi për të kërkuar Artën, Prevezën, Janinën e deri në Follorinë, ose edhe më tej, siç pretendon Tanjugu. Jo vetëm kaq, por asnjëherë shtypi i tyre dhe cilado qeveri greke nuk ka folur për një çështje të tillë, pse as ka pasur pretendime nga ana jonë dhe nuk është ngritur asnjëherë kjo çështje nga ne.

— Si pa gjë të keqe, një mëngjes, pas ngjarjeve tragjike që jugosllavët shkaktuan në Kosovë, ku për të tretën e për të katërtën herë policia e fshehtë dhe ushtria serbe zbatuan një gjenocid të tmerrshëm kundër shqiptarëve që jetojnë në trojet e tyre në Jugosllavi, na nxorën se gjoja ne shqiptarët paskemi shpërndarë në Uashington dhe në selinë e Kombeve të Bashkuara një «hartë, ku brenda kufijve të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, kemi inkluduar edhe Çamërinë»!

— «Shpikje gjeniale» e policisë satanike jugosllave për të prishur miqësinë e mirë që ekziston në mes Shqipërisë socialiste dhe Greqisë demokratike, gjë që nuk u leverdis qeverisë jugosllave dhe aleatëve të tyre të fshehtë sovjetikë, të cilët e kurdisin këtë veprim për të fshehur gjenocidin në Kosovë dhe për të «vërtetuar» se «shqiptarët jo vetëm që po ndërhyjnë në punët e brendshme të Jugosllavisë, por ata po ndërhyjnë dhe kanë rivendikime territoriale edhe në Greqi» dhe, që të plotësojnë teoremën, konkludojnë se «shqiptarët janë nacionalistë, shovinistë, irredentistë». E këshillojmë policinë e fshehtë serbe që ta shtrijë «këtë shovinizëm shqip-

taromadh» edhe në Turqi, ku banojnë shqiptarë, pse jo edhe në Itali ku 5 shekuj më parë kanë emigruar atje arbëreshë. Pra edhe për këto mund të bëhen harta dhe të shpërndahen në rrugët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, apo të ndonjë vendi tjetër.

— Ne u themi jugosllavëve se miqësia e popullit shqiptar me popullin grek ka qenë në shekuj nga më të mirat dhe nga më të singertat. Po ashtu edhe sot po rindërtohet një miqësi e tillë që ju më kot po përpiqeni ta prishni me aleatët tuaj. (Të bëhet një historik i kësaj miqësie, të mos harrohet të vihen citate nga tonat dhe nga grekët.)

— Një miqësi e tillë s'ka ekzistuar kurrë me serbo-mëdhenjtë, pse këta kanë qenë dinakë, shovinistë dhe shtypës. (Të flitet për bisedën e Titos me mbretin e Greqisë në Korfuz, për bisedën e Hrushovit me djalin e Elefter Venizellosit. Të flitet që në kohën e tij, pikërisht pas Luftës së Dytë Botërore, Caldarisi, një shovinist i tërbuar antishqiptar, i dëboi nga tokat e tyre çamët, i hodhi në Shqipëri, por është e drejtë të themi që as i griu me mitraloza dhe as i shtypi me tanke, siç po bëni ju serbomëdhenj me shqiptarët e Jugosllavisë.)

— Pikërisht për të fshehur krimet e përgjakshme që po bëni në Kosovë, ju flisni me gojën e ndonjë gazetari shovinist vorioepirot, i gatshëm dhe i paguar nga ju për «krimet, për gjenocidin dhe për gjysmën gati të të gjithë minoritetit grek të futur në burg» nga ana jonë!

— Zotërinj agjentë jugosllavë, kjo gënjeshtër dhe shpifje është shumë e trashë, por këto trillime tuaja ne nuk i gjejmë të dëmshme për veten tonë, sepse ato, në fakt, ju demaskojnë ju në sy të opinionit botëror dhe ne i botojmë që t'ju njohë mirë edhe populli grek, edhe populli shqiptar, edhe minoriteti grek.

— Si jeton minoriteti grek në atdheun e tij, në

Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë. (Të bëhet një pasqyrë.)

— Këtë e kanë vizituar nënshtetas grekë të çdo rangu e të çdo profesioni të ardhur nga Greqia. Ata janë futur brenda në minoritet, kanë biseduar lirisht me minoritarët, kanë ngrënë bukë në shtëpitë e tyre, kanë kënduar dhe kanë hedhur valle së bashku dhe kanë shkruar e po shkruajnë vazhdimisht me simpati të madhe për popullin shqiptar dhe për çka kanë parë e kanë dëgjuar në Shqipëri dhe në minoritet. Me siguri ata do të indinjohen për shpifjet e përbindshme të titistëve jugosllavë.

— Dashkan nuk dashkan jugosllavët dhe aleatët e tyre, marrëdhëniet në mes Shqipërisë dhe Greqisë janë forcuar dhe do të forcohen në çdo fushë të jetës. (Të gjenden citate nga të miat në këtë drejtim, të vihen citate nga njerëz politikë, punonjës të arteve dhe të kulturës greke që kanë vizituar Shqipërinë dhe sidomos minoritetin.)

— Si konkluzion, të hidhet poshtë me indinjatë ky trillim i poshtër që është vazhdë e shumë trillimeve të tjera të titistëve.

Në fund të vihet Jugosllavia, pjellë e Traktatit të Versajës, e cila, megjithëse popujt e saj bënë një luftë heroike kundër nazifashizmit, trashëgoi, ruajti dhe po hedh në tryezë të lyer me gjak të gjitha intrigat që u përmblohdën në kohën e tyre në emrin «Problemet ballkanike». Jugosllavia titiste dhe sidomos ajo pastitiste po orvatet ta kthejë Ballkanin dhe vetë Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë në një fuçi baruti. Faktet tregojnë që brenda në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë në mes klaneve të ndryshme, ekzistojnë përçarje që mund të shpërthejnë në përleshje ndërnacionale. Me Bullgarinë mosmarrëveshjet kanë filluar për Maqedoninë, Kosovën e gjakosën, Shqipërinë po e sul-

mojnë pa arsye dhe, në bashkëpunim me vorioepirotët, nxitin edhe grindjet e vjetra greko-shqiptare.

— Jugosllavia ka ndezur fitilin dhe ka filluar zjarrin. Nga ana jonë po bëhet çmos që të ndalohet katastrofa që duan të shkaktojnë jugosllavët, por ata çdo ditë e më shumë po i shkallëzojnë veprimet kundër shqiptarëve që jetojnë në Jugosllavi dhe kundër Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

— Ne paralajmërojmë me këtë rast opinionin botëror të mos qëndrojë asnjans, as edhe indiferent, sepse mund të ngjasin gjëra të pariparueshme. Por, po ngjau gjë, dhe jo për fajin tonë, do të dëmtohet jo vetëm Jugosllavia, por edhe paqja në Evropë, mundet edhe në botë, të vihet në rrezik. Nuk duhet të përsëritet Sarajeva!

Pësimet duhet të bëhen mësim për njerëzimin dhe ngjarja e Sarajevës do të bëhet mësim kur të studiohen me objektivitet dhe realisht shkaqet që e shkaktuan atë dhe çka ngjau pas kësaj ngjarjeje. Sidoqoftë me fatin e Shqipërisë socialiste dhe me shqiptarët që jetojnë në Jugosllavi nuk do të luhet dot më si pas Sarajevës, ashtu edhe pas Traktatit të Versajës.

**EMIGRANTËT EKONOMIKË KOSOVARË KANË QENË  
DHE DO TË JENË TË PANDARË NGA VENDI  
DHE POPULLI I TYRE**

Redaksisë së gazetës «Bashkimi» i dërguam sot artikullin me titull «Emigrantët ekonomikë kosovarë kanë qenë dhe do të jenë të pandarë nga vendi dhe populli i tyre» që do të botohet në numrin e saj të nesërm.

**PIEMONTI I MIRËFILLTË, «PIEMONTI» JUGOSLLAV  
DHE «PIEMONTI SHQIPTAROMADH»**

Sot u botua në gazetën «Zëri i popullit» artikulli me titullin «Piemonti i mirëfilltë, «Piemonti» jugosllav dhe «Piemonti shqiptaromadh», ku hidhen poshtë shpifjet antishqiptare të udhëheqësve titistë për ngjarjet në Kosovë.

## JUGOSLLAVIA TITISTE, E SËMURA E BALLKANIT, NXIT ARMIQËSINË SHQIPTARO-GREKE

Artikulli me titull «Jugosllavia titiste, e sëmura e Ballkanit, nxit armiqësinë shqiptaro-greke», që ia dërguam sot redaksisë së gazetës «Zëri i popullit», demaskon rreptë përpjekjet e titistëve jugosllavë për të futur spica e përçarje midis nesh dhe Greqisë nëpërmjet shpërndarjes së hartave gjeografike të falsifikuara. Artikulli do të botohet nesër.

## FLET KRYEPOLICI SERB

Raporti i Franjo Hërlejeviçit<sup>1</sup> është me tërë kuptimin e fjalës një raport policor, një raport i kryetarit të një agjensure të fshehtë, që me rrjetën e tij të merimangës ka mbuluar gjithë shqiptarët në Jugosllavi, brenda dhe jashtë saj. Ai është një raport i paskrupullt dhe i paturpshëm, në të cilin pa dorashka i tregohen opinionit jugosllav dhe atij botëror mënyrat dhe format që përdor UDB-ja për të vënë në vëzhgim total një popull të tërë, siç është populli shqiptar që jeton në Jugosllavi, si dhe atë pjesë të këtij populli që është dëbuar nga Jugosllavia dhe është shitur si plaçkë tregu, siç veprojnë negrieristët modernë.

Përveç asaj në këtë raport vihet në dukje pa skrupull se si, me anë të konsullatave e të klubeve, policia serbomadhe ka organizuar në vendet e huaja agjunkturën e saj, jo vetëm për të kontrolluar, indoktrinuar dhe tmerruar qytetarët e saj, por ka organizuar dhe ushtron kontroll edhe mbi ambasadat e tjera në të gjitha ato vende me të cilat ka lidhje diplomatike, duke krijuar kështu brenda tyre një agjunkturë spiunazhi të shumëllojtë.

<sup>1</sup> Sekretar shteti për Punët e Brendshme të RSFJ. Raporti i mbajtur në Këshillin Federativ të Kuvëndit të RSFJ, më 9 qershor 1981.

## NUK DO TË LEJOJMË KURRË TITISTËT JUGOSLLAVË TË VRASIN, TË BURGOSIN E TË TORTUROJNË VËLLEZËRIT TANË KOSOVARË

Sot morën fund diskutimet në Plenumin e 10-të të KQ të Partisë «Mbi projekt-direktivat e Kongresit të 8-të të PPSH për planin e shtatë pesëvjeçar të zhvillimit të ekonomisë e të kulturës së RPS të Shqipërisë për vitet 1981-1985». Duke i mbyllur këto diskutime, pasi dhashë mendimet e mia për projekt-direktivat, midis të tjerave thashë se zhvillimin tonë e kemi bërë duke çarë pa u ndalur përmes rrethimit e bllokadës imperialisto-revizioniste, përmes presioneve të krizave ekonomike nga jashtë, përmes luftës me armiqtë e sabotatorët e brendshëm e të jashtëm.

Në këtë rrugë, pas ngjarjeve të Kosovës, po ndeshemi me një presion të ri në rritje të revizionistëve jugosllavë, të cilët, të tërbuar nga dështimet e njëpasnjëshme në politikën e tyre të brendshme e të jashtme dhe të brejtur nga kontradiktat e pakapërcyeshme, në ujdi me socialimperializmin sovjetik dhe me gjithë armiqtë e tjerë të vendit tonë socialist dhe të marksizëm-leninizmit po orvaten të na dëmtojnë, të na pengojnë e të na krijojnë vështirësi.

Nëpërmjet shtypit dhe në rrugë të tjera Partia dhe populli janë vënë në dijeni të plotë të këtyre ngjarjeve, të masakrave të përgjakshme fashiste të shovinistëve

serbomëdhenj, si dhe të qëndresës heroike të rinisë e të popullit të Kosovës, që edhe një herë u çori maskën, para gjithë opinionit botëror, revizionistëve jugosllavë dhe sistemit të tyre të kalbur kapitalist, të ashtuquajtur vetadministrues. Partia jonë, si kurdoherë, do t'i përkrahë në rrugë të drejtë marksiste-leniniste vëllezërit tanë shqiptarë të një kombi, që jetojnë të patundur nga asnjë rrebesh e furtunë në trojet e tyre mijëravjeçare.

Ka gati tre muaj që shtypi jugosllav po bën sulme dhe trillime policore e banditeske kundër Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, duke e akuzuar atë për faje të paqena kurrë dhe me akte terroriste të organizuara nga policia e fshehtë jugosllave, sikurse ishte plasja e dinamitit në ambasadën jugosllave në Tiranë.

Përveç këtyre, policia e fshehtë jugosllave (UDB-ja), me falsifikime dhe intriga përpiqet të vërë në grindje Shqipërinë socialiste me Greqinë fqinje. Këtu nuk dua të përmend terrorin e egër që po vazhdon veçanërisht në Kosovë, si dhe provokacionet e shumta që u bëhen njerëzve tanë që udhëtojnë përmes Jugosllavisë.

Të tëra këto nuk na çuditin aspak, pse Partia dhe populli ynë i kanë njohur prej kohësh kush janë titistët jugosllavë, këta armiq të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, të Partisë sonë dhe të marksizëm-leninizmit. Ata kanë qenë dhe mbeten një agjenturë në duart e imperializmit botëror.

Por dëshiroj këtu të flas pak për dy fjalime që kanë mbajtur kryepolici serb i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë këto ditët e fundit, Franjo Hërljeviç, përmbajtja e të cilit pasqyrohet plotësisht edhe me raportin që bëri zëvendëssekretari për Punët e Jashtme të Jugosllavisë, Milorad Peshiç po në të njëjtën ditë. Dy raporte këto me të njëjtën përmbajtje, po ndërsa i fundit është i veshur me frazeologji diplomatike, ai i Hërljeviçit është një raport me tërë kuptimin

e fjalës policor, një raport kryetari të një agjencie të fshehtë që ka mbuluar me rrjetën e tij të merimangës gjithë shqiptarët e Jugosllavisë, brenda dhe jashtë saj. Ai është një raport i paskrupullt dhe i paturpshëm, me të cilin pa dorashka i tregohen opinionit jugosllav dhe atij botëror mënyrat dhe format që përdor UDB-ja për të vënë në vëzhgim total një popull të tërë, siç është populli shqiptar që jeton në Jugosllavi, si dhe atë pjesë të këtij populli që e ka dëbuar nga Jugosllavia dhe e ka shitur si plaçkë tregu, siç veprohet me negrierët modernë.

Në këtë raport vihet në dukje pa asnjë skrupull se si me anë të konsullatave e të klubeve policia serbomadhe ka organizuar në vendet e huaja agjencurën e saj jo vetëm për të kontrolluar, indoktrinuuar dhe tmerruar qytetarët e saj, por ka organizuar e ushtron kontroll edhe mbi ambasadat e tjera në të gjitha ato vende me të cilat Jugosllavia ka lidhje diplomatike, duke krijuar kështu një agjencurë spiunazhi të shumëllojtë brenda tyre. Policia e fshehtë jugosllave është kthyer në një Mafia të rrezikshme ndërkombëtare, në një lozhë masonike si P-2 që u zbulua në Itali, por me përmasa ndërkombëtare. Kjo P-2 jugosllave financohet nga banka të ndryshme të kapitalit botëror dhe i shërben atij me informacione të shumëllojta, që nga informacioni ekonomik e deri tek ai politik dhe ushtarak.

Ky rrjet spiunazhi jugosllav ka komprometuar njerëz me influencë të përhershme ose të përkohshme në vende të ndryshme dhe i ka bërë këta vegla qorre në dorë të atij shteti imperialist që i paguante kësaj agjencie jugosllavësh, të shpërndarë si diplomatë nëpër botë, dhe shtetit të saj sa më shumë ryshfete në dollarë, rubla e monedha të tjera, në formë kredish ose peshqeshesh.

Nga diskutimet e të gjithë njerëzve jugosllavë në çdo lloj forumi duket qartë se në Jugosllavi mbizotëron

opinion i policisë sekrete të këtij vendi. Të gjithë flasin me gjuhën e saj, gjë që tregon se populli jugosllav dhe gjithë shteti jugosllav janë nën darën e UDB-së. Atje flitet për «liri» e «demokraci» për të mbuluar pushtetin e policisë.

Në fillim të ngjarjeve të Kosovës kishte edhe zëra të autorizuar jugosllavë që në mes të tjerave linin të kuptohej se çka ngjau në Kosovë kishte edhe baza ekonomike. Tani kjo arsye e madhe u hoq nga goja dhe u vendos ligji i policisë: «Për çka ngjau në Kosovë, përgjegjëse është Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë me thirrjen për «Shqipërinë e madhe», me «organizimin» e qendrave të spiunazhit në Kosovë e në emigracionin kosovar jashtë, me «bashkëpunimin» e saj me të arratisurit politikë ballistë, zogistë, ustashë dhe çetnikë, me profesorët shqiptarë që dërgonte në Kosovë, me librat shqip» etj., etj. Të gjitha këto shpifje e trillime të UDB-së janë përhapur në mbarë Jugosllavinë.

Përveç kësaj na doli parulla e policisë jugosllave se ajo «u gjet në befasi, se kishin humbur vigjilencën dhe qenë treguar zemërgjerë me Shqipërinë, pse kishin shpresë se... ajo do të bëhej titiste në politikë, në ideologji» etj. Parulla e UDB-së që predominon në të gjitha shtresat jugosllave është: «Luftë kundër shovinizmit, nacionalizmit e irredentizmit shqiptar». S'ka tjetër armik, s'ka asnjë tjetër shovinizëm në Jugosllavi. UDB-ja hapur ka përcaktuar programe dhe masa terrori kundër shqiptarëve, të cilët klasifikohen në skeda e nëpër kompjuterë. «Krizën e madhe të regjimit titist e ka mbuluar kriza kosovare» dhe UDB-ja serbe dominon skenën jugosllave.

Jugosllavia ka filluar të mbarojë, ajo po diskreditohet, ajo do të thërrmohet në mos nga jashtë, nga brenda. UDB-ja mendon si polici se me veprimet e saj do të zhdukë kontradiktat e brendshme me egërsinë e pashembullt që ushtrohet prej saj kundër shqiptarëve të

Jugosllavisë. E kundërta do të ngjasë. Ajo mendon se, duke akuzuar e duke shpifur për Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë, do të kthejë në favorin e saj opinionin botëror. Por e kundërta ka ngjarë dhe në të ardhmen kjo do të theksohet më shumë.

Shqiptarët që jetojnë në vatrat e tyre në Jugosllavi zor se përulen përpara barbarisë së UDB-së dhe ne kurrrë nuk do t'i lejojmë titistët të vrasin, të burgosin dhe të torturojnë vëllezërit tanë kosovarë etj. Ne do të mbrojmë atdheun tonë socialist, Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe marksizëm-leninizmin.

Byroja Politike e Komitetit Qendror dhe Qeveria e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë kanë mbajtur qëndrime në organin qendror të Partisë, «Zërin e popullit», për të gjitha këto probleme, si dhe në gjithë shtypin tjetër të vendit. Qëndrimet tona, mendojmë ne, kanë qenë të përshtatshme, serioze dhe gjakftohte dhe, nga ana jonë, është kërkuar nga qeveria jugosllave që kjo të ndalojë terrorin dhe politikën e gjenocidit kundër shqiptarëve që jetojnë në Jugosllavi, të cilëve t'u jepen të gjitha të drejtat brenda kushtetutës. Këto qëndrime janë në përputhje të plotë me vendimet e Kongresit të 7-të të Partisë sonë dhe me ato të Komitetit Qendror të saj.

E MËRKURË

17 QERSHOR 1981

## QËNDRIMET AKTUALE E TË MËVONSHME QË DUHET TË MBAJMË PËR ÇËSHTJEN E KOSOVËS

Fill pas Plenumit të fundit<sup>1</sup> të Komitetit Qendror, që aprovoi raportin e Byrosë Politike «Mbi projektdeklarativat e Kongresit të 8-të të PPSH për planin e shtatë pesëvjeçar të zhvillimit të ekonomisë e të kulturës së RPSSH 1981-1985», bisedova me shokët për qëndrimet që do të mbajmë me Jugosllavinë pas kësaj dhe veçanërisht për çështjen e Kosovës. Ata ishin dakord me çështjet që shtrova unë.

1. Qëndrimet tona me Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë nuk ndryshojnë. Atë që kemi deklaruar, ne do ta mbajmë për aq kohë, në atë mënyrë e gjerësi që do ta mbajnë edhe ata me ne.

Qëndrimet ideologjike kundër revizionizmit jugosllav dhe politikës që rrjedh prej saj, ne nuk i ndryshojmë. Do të demaskojmë çdo manifestim të tyre, që Partia jonë do ta gjejë të nevojshme.

Marrëdhëniet tregtare do t'i ruajmë kur janë me leverdi reciproke. Asnjëherë nuk duhet të lejojmë që jugosllavët të propagandojnë, siç bënë këto kohët e fundit, duke thënë se në tregtinë me ne, ata na paskëshin qenë hovardarë dhe na paskan nxjerrë nga viti i keq!

Marrëdhënie kulturore me Republikën Socialiste

<sup>1</sup> Plenumi i 10-të i KQ të PPSH.

Federative të Jugosllavisë dhe, brenda saj, edhe me Kosovën, tani për tani ne nuk duhet të kemi. E para, se ata sulmuan kulturën tonë si «shqiptaromadhe, shoviniste dhe irredentiste» dhe e bënë atë shkaktare të turbullirave në Kosovë. E dyta, në kushtet e tanishme kulturore jonë socialiste po të shkojë në Kosovë, nëpërmjet formave të ndryshme, do të jetë e kufizuar dhe e kontrolluar nga UDB-ashët serbë e kosovarë. Ne nuk kemi aspak ndër mend të ndërtojmë një kulturë sipas qejfit të Jugosllavisë. Vajtja jonë në Kosovë e në vise të tjera ku banojnë shqiptarë në Jugosllavi, do të përdoret nga titistët kurdoherë si mjet për të na akuzuar, siç na kanë akuzuar. Gjithashtu për të regjistruar deri edhe duartrokitjen në shfaqje. Në këto kushte, ndihmën tonë në fushën e kulturës dhe të arsimit për shqiptarët që jetojnë në tokat e veta në Jugosllavi, duhet ta japim nëpërmjet radios dhe televizionit tonë. Ne mund të shkojmë në ndonjë mbledhje shkencore në RSFJ në qoftë se na ftojnë dhe ata, po të duan, të vijnë në mbledhje të tilla që bëhen te ne, kur t'i ftojmë.

2. Polemika që zhvilluam me revizionistët jugosllavë për ngjarjet tragjike në Kosovë, ishte e domosdoshme pse duheshin mbrojtur vëllezërit dhe motrat tona kosovare, duhej demaskuar gjenocidi serbomadhe në Kosovë, duhej mbrojtur me vendosmëri Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë dhe Partia e Punës e Shqipërisë që serbomëdhenjtë i akuzuan «si nxitëse të revoltave në Kosovë» etj., etj.

Polemika jonë u bë në kohë, ishte e drejtë, e ashpër, demaskuese dhe këshillonte gjakftohtësinë, «uljen e gjakrave», zgjidhjen e të drejtave të kosovarëve dhe të shqiptarëve në vise të tjera në Jugosllavi, në rrugë të drejtë dhe me drejtësi.

Qëndrimet tona të matura, gjakftohte dhe parimore, kundrejt histerisë shpifëse jugosllave dhe veçanërisht

serbomadhe, bënë që opinioni dhe diplomacia botërore të na jepnin të drejtë neve dhe të dënonin qëndrimet politike dhe veprimet barbare të jugosllavëve në Kosovë dhe kundër RPSSH e PPSH.

Jugosllavët u diskredituan politikisht në të gjithë botën, u demaskua demagogjia e gjithë politikës së tyre, të brendshme dhe të jashtme.

Ne fituam në opinionin ndërkombëtar, jugosllavët humbën. Ne fituam edhe në opinionin e brendshëm jugosllav dhe, pavarësisht nga propaganda shurdhuese, serbomëdhenjtë humbën. Kontradiktat në udhëheqjen jugosllave u thelluan, klani kroato-slloven u tregua prudent në sulmet kundër Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, kurse klani serb u përpoq me të gjitha mjetet që RPSSH ta përdorte si «kokë turku», brenda dhe jashtë Jugosllavisë. Nuk ia arriti dot qëllimit. Edhe para 4 ditësh Stane Dolanci tha se qëndronte në mendimin e tij të parë «se Shqipëria nuk ka gisht në ngjarjet në Kosovë». Në këtë intervistë të tij të fundit, Stane Dolanci shprehu dhe mjaft kontradikta të tjera me veprimet e LK të Serbisë etj. Intervista në fjalë, e dhënë në televizion, nuk u botua në shtyp.

Pse? Kuptohet vetvetiu.

Qëndrimet tona të matura dhe parimore bënë efektin e tyre në Kosovë, u dhanë zemër kosovarëve dhe, në të njëjtën kohë, penguan edhe vrullin gjakatar të ushtrisë jugosllave dhe të UDB-së.

Jugosllavët, në rrugë të gabuar, të hutuar dhe të çoroditur në politikën e brendshme e të jashtme, bënë gafa pas gafash, aksione dhe trillime agjenturore si «bombat në ambasadën jugosllave në Tiranë», «harta për Çamërinë» etj., që nuk i besoi njeri dhe që vetë shtypi ndërkombëtar i demaskoi si false e të trilluara nga jugosllavët.

Çështja e Kosovës u bë problem ndërkombëtar. Ajo

tronditi Jugosllavinë dhe do të ketë rrjedhime edhe në republikat e saj të tjera, në grindjet në mes tyre.

3. Pozitat tona ndërkombëtare, që kanë qenë të forta, u forcuan edhe më shumë.

Serbomëdhenjtë vazhdojnë dhe do të vazhdojnë goditjet e tyre në Kosovë. Ne nuk i ndalojmë dot. Ata do t'i vazhdojnë ato duke i mbuluar me gënjeshtërën se rezistencën e kosovarëve vazhdon «ta nxitë Shqipëria» me artikujt që vazhdon të botojë.

Ne duhet t'ua heqim këtë armë, të ulim ca polemikën, pse të gjitha çështjet i kemi sqaruar, të gjitha pozicionet e drejta i kemi zënë. Ua lëmë kështu në dorë jugosllavëve krimet që bënë dhe që mund të vazhdojnë të bëjnë në Kosovë.

Ata shpresojnë që ta përdorin vazhdimisht «kokën e turkut». Ne ua heqim këtë mundësi. Bota le të shohë se ne as i kemi nxitur dhe as i nxitim ato që ngjanë e që mund të ngjasin në Kosovë. Dalin akoma më në pah arsyet dhe kush i shkaktoi ngjarjet tragjike të Kosovës.

Jugosllavët duan një «eskalejshën»<sup>1</sup> në mosmarrëveshjet me ne. Kjo u intereson edhe socialimperialistëve sovjetikë, miq e aleatë të serbomëdhenjve në këtë çështje delikate, u intereson sovjeto-serbëve që dje i ngritën shkëmbimet e tyre tregtare në 32 miliardë dollarë.

Bota do të shohë, siç e ka parë edhe deri tani, pjekurinë e shtetit tonë socialist dhe kalbëzimin e shtetit jugosllav, i cili i përngjet Perandorisë së vjetër Austro-Hungareze të Habsburgëve, që dominonte mbi dhjetëra shtete, kombe, kombësi e interesa të ndryshëm e që më në fund u shkoq si kalliri i krimbur i një misri të vjetër. Si Franc Jozefi, edhe Titoja që mbante emrin e Josipit, e katandisi Jugosllavinë në këtë ditë që ndodhet sot dhe që do të marrë të tatëpjetën më me vrap edhe nesër.

<sup>1</sup> Anglisht: escalation — shkallëzim.

E SHTUNË  
20 QERSHOR 1981

## PËRSE SHPIF E TRILLON KUNDËR VENDIT TONË SERBOMADHI MINIÇ

Para pak ditësh, duke iu përgjigjur pyetjeve të një redaktori të televizionit të Beogradit, serbomadhi i njohur Milosh Miniç<sup>1</sup> foli kundër nesh, ose, siç tha ai, kundër «grupit të Enver Hoxhës» dhe dënoi politikën tonë të jashtme e të brendshme.

Ky serbomadh, që kur filluan ngjarjet tragjike në Kosovë, po qëndron në pararojë të sulmeve kundër Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Partisë sonë dhe neve. Kësaj radhe ai na akuzoi për «ndërrhyrje në punët e brendshme të Jugosllavisë», na akuzoi se gjithë lidhjet tona zyrtare me Kosovën kishin qëllime «shoviniste», «diversioniste» dhe përfaqësonin «irredentizmin shqiptaromadh». Duke «përcaktuar» politikën tonë ai tha se ajo është «borgjezo-ruajaliste», ose, më eaktësisht, «borgjezo-monarkiste». Na quajti stalinistë, tha se praktika e Qeverisë te ne është «staliniste» dhe «anarkronike». Me fjalë të tjera, siç e përcaktoi ai, Shqipëria përfaqëson «një deviacion të revolucionit», «një deviacion të socializmit», që, shtoi ai, «është vërtetuar disa herë në histori».

«Grupi i Enverit», tha Miniçi, që «zbaton një regjim terrori» dhe që është «i izoluar nga e gjithë bota», punon

<sup>1</sup> Anëtar i Kryesisë së KQ të LKJ dhe kryetar i Këshillit Shoqëror Federativ për Marrëdhëniet Ndërkombëtare.

që nga viti 1948 për «destabilizimin» e RSFJ, por, shtoi ai, «Enveri dhe irredentizmi i tij nuk e tundin dot Jugosllavinë, të cilën s'e kanë destabilizuar as shtete të tjera më të fuqishme» etj.

Pse Miniçi tani flet kaq shumë, me vend e pa vend? Pse shpif dhe trillon kaq trashë kundër vendit tonë?

Nga halli.

1. Si «njeri i specializuar» i diplomacisë jugosllave, siç hiqet, si ish-ministër i Jashtëm i Jugosllavisë, si diplomat që nën Titon ka shitur mend sa andej këndeje me «këshillat e urta» të amerikanëve, tani ka marrë përsipër të ngrejë nga varri, ku është futur, regjimin titist me sistemin e vetadministrimit, me «shtetin e pavarur» dhe me «kampionin e pavarësisë së popujve».

2. Çështja e Kosovës demaskoi në sytë e shteteve të botës të gjithë politikën false dhe çnjerëzore jugosllave. Kancelaritë e botës i dënuan veprimet barbare të shovenëve jugosllavë dhe na dhanë të drejtë neve. Ky ishte një qëndrim paradoksal: armiqtë tanë na japin të drejtë neve, dhe miqtë e jugosllavëve i dënojnë dhe i qortojnë këta.

Kjo gjendje e krijuar i dërrmoi titistët jugosllavë dhe prandaj përpiqen të dalin nga kjo situatë.

3. Por problemi i Kosovës është shkëndija e kontraktave të mëdha që kanë shpërthyer me kohë dhe preludi i atyre që do të shpërthejnë edhe më me forcë paskëtaj. E gjithë «fusha jugosllave», si një fushë naftë e gazi, do të marrë zjarr. Po falimenton i gjithë sistemi dhe tok me të edhe Federata.

Kosova ishte një faktor së cilës serbomëdhenjtë i vunë një kapuç «irredentizmi», «shovinizmi nacionalist shqiptaromadh» etj., por ç'kapuç do t'i vënë vallë luftës në gjirin e vetë sistemit të vetadministrimit, të nacionalizmit ekonomik, të proteksionizmit republikan, shkaktërrimit të tregut jugosllav, inflacionit, papunësisë e të gjitha të këqijave të sistemit të tyre të kalbur? Të

gjitha këto janë kthyer në grindje të thella politike në mes klaneve të ndryshme në udhëheqjen e Federatës, ku çdo grup e klikë mbron «shtetin e vet».

4. Për ngjarjet në Kosovë shovinistët serbomëdhenj gjetën «kokën e turkut», Shqipërinë, e cila, «lufton për destabilizimin e Jugosllavisë». Ky ishte «kori» që u ngrit në qiell. Këtij çekani ata vazhdojnë t'i bien, por nuk i beson njeri. Prandaj thërret e lutet Miniçi: «Besonani ne se janë shqiptarët ata që i bëjnë këto gjëra. Mos harroni Stalinin, regjimin e tij! Enver Hoxha është stalinist! Enveri, Cola Dragoçeva dhe Gjilasi janë një!». Ky është një nga qëllimet e fjalimit të Miniçit.

5. Ai dhe të tjerët kanë për qëllim edhe të na provokojnë, që ne të vazhdojmë t'u përgjigjemi e kjo t'u shërbejë serbomëdhenjve të bëjnë shkallëzimin e provokacionit dhe të komplotit të fshehtë me revizionistët sovjetikë kundër nesh. Mirëpo ne i zumë të gjitha kyçet dhe armiqtë serbë po grijnë kot e pa baza. Qëndrimet tona aprovohen, të tyret dënohen.

6. Një qëllim tjetër është të fshehin katastrofën dhe bankrutën e brendshme në të cilën përpëlitën. Kjo vërteton tezat e Partisë së Punës të Shqipërisë. Grindja në mes tyre po thellohet. Ne tani kalojmë në demaskimin e tyre me fjalët e tyre dhe fjalët e tyre vërtetojnë tezat tona. Ne, me taktikën tonë të re, ua heqim në sy të opinionit botëror dhe armën e «kokës së turkut».

7. Atyre u duhet «kjo armë» për të përballuar te lashet e mëdha të mëvonshme, që parashikojnë, se nuk ka si të mos sjellë të tilla telashe sistemi i tyre politik-ekonomik i falimentuar.

T'ua heqim edhe këtë armë! Të vazhdojmë, në këtë fazë, demaskimin e tyre me fjalët e tyre.

Kjo shërben për të zgjuar opinionin jashtë dhe brenda dhe vërteton drejtësinë e tejpamësinë e Partisë së Punës të Shqipërisë.

**E HËNË**  
**22 QERSHOR 1981**

**SITUATA NDËRKOMBËTARE ËSHTË E MBARSUR  
ME LUFTË TË PËRGJITHSHME DHE ME LUFTËRA  
LOKALE, PO AJO ËSHTË E MBARSUR  
EDHE ME REVOLUCION**

**Skema e përgjithshme e kapitullit për gjendjen  
ndërkombëtare të raportit të Kongresit të 8-të**

Revolucioni duhet të përballojë, të pengojë si luftën e përgjithshme, ashtu edhe luftërat lokale të nxitura nga imperialisto-revizionistët dhe nga borgjezia reaksionare vendase.

Konkretisht si duhet të veprojnë popujt për t'i ndaluar këto luftëra të padrejta dhe, kur janë në pamundësi që t'i ndalojnë, si duhet t'i kthejnë ato në kryengritje revolucionare.

Kush i shkakton luftërat, cilat janë arsyt e vërteta të luftërave imperialiste dhe të atyre lokale.

Si përgatiten këto luftëra, si manipulohen masat e gjera që hidhen në zjarrin e luftërave grabitëse. Politika, propaganda, armatimet, demagogjia dhe vetë «frika e luftës» përdoren për të nxitur luftën.

Si zhvillohet dhe si po thellohet kriza botërore. Cilat janë fushat kryesore ku kjo krizë vazhdon të thello-

het dhe si manifestohet kjo në botën e kapitalit, në ç'forma e me ç'konsekuenca në jetën e popujve.

Ç'forma ka marrë aktualisht kapitalizmi botëror. Roli i bankave, roli i shumëkombësive, gara e armatimeve, blloqet ushtarake dhe si konkluzion rindarja e botës në mes imperialistëve.

Vartësia e popujve dhe e sovranitetit të shteteve të ndryshme nga kapitalizmi botëror. Ndryshimet në vartësi, kontradiktat dhe kompromiset koniunkturale.

Neokolonializmi. Superfuqitë, fuqitë kapitaliste të industrializuara dhe shtetet që shfrytëzohen prej tyre për lëndët e para. Të parat e të dytat janë pasuruar, ato kanë shfrytëzuar pa llogari lëndët e para të popujve dhe të shteteve gjoja sovrane, sa u arrit në krizën e superfitimeve dhe në gjendjen katastrofike aktuale.

Edhe vendet furnizuese të lëndëve të para filluan të zhvilloheshin, të investonin në vendet e tyre, gjë që, për fuqitë imperialiste, shkaktoi krizën e energjetikës dhe të lëndëve të para.

Huatë që imperialistët u kanë dhënë vendeve të varfra përfaqësojnë armatimet dhe investimet në industri, që shfrytëzonin popujt dhe vendet ku jepeshin këto kredi, por bëheshin, po ashtu, konkurrentë të huadhënësit për lëndët e para.

Kjo shkaktoi krizën më të rëndë dhe të papërballueshme dot nga huamarrësit, si Jugosllavia, Polonia e të tjera vende të botës. U shtuan kontradiktat, u rritën inflacioni, papunësia dhe vartësia.

Teoritë e ndryshme për të mbuluar këtë proces të kalbëzimit të kapitalizmit botëror.

Si do të dilet nga kjo krizë? Pikëpamja kapitalisto-borgjeze dhe pikëpamja e Partisë së Punës të Shqipërisë, pikëpamje marksiste-leniniste.

Dalim në përgjithësi me politikën e jashtme dhe të brendshme të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të diktaturës së proletariatit në vendin tonë.

Pse e luftojnë revizionistët modernë sovjetikë, jugosllavë, kinezë e të tjerë Partinë e Punës të Shqipërisë dhe vendin tonë socialist?

Pse opinioni përparimtar e respekton dhe e mbron socializmin në Shqipëri me të mirat, por edhe me mungesat e përkohshme të zhvillimit?

Pse shtete të ndryshme, në vende dhe me sisteme të ndryshme, e ndjekin me kujdes dhe e simpatizojnë politikën e jashtme të shtetit tonë?

**E MARTE**  
**23 QERSHOR 1981**

## **PROBLEME TË MËDHA TË KOHËS**

### **Mendime, teza për raportin e Kongresit të 8-të**

Ç'kuptojmë ne me revolucion, me rezistencë popullore, me luftëra nacionalçlirimtare, me aleanca, me kompromise?

Ç'kuptojmë ne me socializëm?

Pse quhet revizionizëm modern dhe ç'do të thotë revizionizëm?

Revizionim i teorisë së Marksit, i teorisë së marksizëm-leninizmit.

Diktaturë e proletariatit apo jo diktaturë e proletariatit?

Sistemi socialist i bazuar në teorinë marksiste-leniniste do të thotë ndërtim i sistemit socialist si në Bashkimin Sovjetik para ardhjes së hrushovianëve në fuqi, apo ta revizionosh këtë sistem me një tjetër?

Cilat janë sistemet ekonomike kryesore? Sistemi kapitalist, sistemi socialist dhe sistemi pseudosocialist i vet-administrimit me shumë variante.

Në vendin tonë po ndërtohet socializmi sipas mësimëve të marksizëm-leninizmit. Kjo do të thotë se ne po zbatojmë marksizëm-leninizmin në kushtet e vendit tonë. Përsëri edhe kjo e fundit do të thotë se ne ruajmë parimet e socializmit shkencor, por njëkohësisht luftojmë, siç na këshillojnë Marksi dhe Lenini, jo vetëm kundër deformimeve të parimeve që rrjedhin nga mbeturinat e vjetra borgjeze kapitaliste të konceptimit të pronës socialiste të përbashkët, të organizimit të vjetër të punës, të drejtimit burokratik, të shpërndarjes së prodhimit, të mënyrës së tregtimit etj., por edhe duke u ruajtur nga këto të këqija. Për këtë na duhet t'i njohim si shfaqen ato në zhvillimin dhe në perfeksionimin e sistemit socialist të ne dhe si duhet t'i luftojmë ne dhe t'i ndreqim ato.

Nuk i analizojmë si duhet dhe nuk i kuptojmë shumë herë si duhet këto të këqija që deformojnë sistemin tonë dhe shumë herë arrijmë të mendojmë se këto të këqija janë anësore dhe s'mund të bëhen kurrë inhereente të sistemit tonë. Mirëpo kjo ngjau në Bashkimin Sovjetik, në Jugosllavi dhe në Kinë.

Ne, pra, nisemi nga sistemi ynë socialist për të demaskuar revizionizmin modern, sistemin aktual ekonomik revizionist sovjetik që shërben si një model, po kështu vetadministrimin, edhe ky sistem ekonomik revizionist. Këtu ne shohim dhe demaskojmë thelbin e vetadministrimit jugosllav (pse ka edhe sisteme të tjera të tilla, si ai algerian etj.).

Për vetadministrimin jugosllav «prona shoqërore e mjeteve të prodhimit përbën shkallën më të lartë të pronës socialiste», «shkalla e fundit përfaqësohet nga prona shtetërore». Për jugosllavët kjo e fundit, në fund

të fundit, mund të përcaktohet si një lloj kapitalizmi shtetëror nga i cili lind një «kastë e re burokratike», që në fakt, në mënyrë kolektive, disponon të drejtën mbi pronën (teoria e Kardelit). Sipas tij prona shtetërore nuk zhduku vartësinë e punëtorit nga kapitali, megjithëse ky u quajt «social».

Raporti kapitalist — fitime dhe rrogë punëtori u zëvendësua me akumulacion shtetëror — rroga e punëtorit. Me fjalë të tjera në të dy sistemet, sipas Kardelit, punëtori mbeti kurdoherë rrogëtar.

Sipas vetadministrimit jugosllav «mjetet e prodhimit i përkasin gjithë shoqërisë». Shteti në të mbetet vetëm një garant dhe çështja e dytë, shoqëria, mjetet e prodhimit «u përkasin punëtorëve të çdo ndërmarrjeje që i përdorin dhe i drejtojnë vetë drejtpërdrejt».

Çështja e parë, «prona e përbashkët e mjeteve të prodhimit», në praktikën dhe në teorinë e vetadministrimit jugosllav, do të thotë që e drejta e pronësisë zbatohet nga të gjithë pjesëtarët e shoqërisë dhe kjo ia mohon cilitdo, edhe shtetit, të drejtën ta kundërshtojë zbatimin e së drejtës kolektive. Janë, pra, punëtorët e kolektivit që e drejtojnë ndërmarrjen drejtpërdrejt ose me ndërmjetësinë e të deleguarve të zgjedhur.

Por ngjet që interesat e një ndërmarrjeje të tillë nuk korrespondojnë në mënyrë spontane me interesat e gjithë shoqërisë. Që ta kthejnë gjoja këtë vështirësi, teoricienët e vetadministrimit jugosllav krijuan konceptin «planifikimi demokratik» dhe këtë demokraci e quajtën «vetadministrues». Me këtë mendonin se do të zhduknin egoizmin e bazës së ndërmarrjes në interesin e përgjithshëm shoqëror.

Por, që të arrihet kjo, parashikohet që punonjësit e bazës të kenë një ndërgjegje të lartë kolektive që të mund të lidhin interesat e vegjël me ata të të gjithë shoqërisë.

E gjithë kjo strukturë dhe gjithë ky teorizim i vet-administrimit jugosllav nuk ka gjetur asnjë bazë, çdo gjë, duke u transformuar, ka dështuar totalisht dhe gjithë ekonomia jugosllave, tok me sistemin e saj vet-administrues, është sot në konfuzion, në kaos, në ban-krutë.

Principet e vetadministrimit jugosllav.

Në fillim autonomia lokale ishte pararoja e vet-administrimit. Më 1949 iu dha autonomi e plotë çdo kra-hine, rrethi, komune, duke përdorur gjoja të zgjedhurit dhe u zhdukën të gjitha organet e qeverisjes të kontro-luara dhe të drejtuara nga shteti. Goditja e parë e cen-tralizmit. Autogjestionioni është reaksion kundër marksi-zëm-leninizmit ose «stalinizmit».

Autonomia e rajoneve dhe organizimi i këshillave popullorë lindi gjatë luftës nga baza, kurse vetadminis-trimi u vendos nga lart.

Pra këshillat nacionalçlirimtarë (pushteti), u shndër-ruan në këshillat e punëtorëve.

Më 1950 u ligjërua vetadministrimi mbi ndërmarr-jet shtetërore nga punëtorët. Ligji u quajt «fabrikat punëtorëve». Shteti i «transferoi uzinat për punëtorët» dhe kjo u bë me ngadalë, pra drejtimi nga këshillat e punëtorëve është i kufizuar.

## REVIZIONIZMI KINEZ

### Shënime për raportin e Kongresit të 8-të të PPSH

Pas Kongresit të 7-të të saj, Partisë sonë iu desh të luftonte hapur e me vendosmëri marksiste-leniniste edhe kundër revizionizmit kinez dhe bazës së tij ideolo-gjike, maocedunidesë.

Sikurse dihet, për njëfarë kohe Partia jonë ka pa-sur lidhje e kontakte të afërta me Partinë Komuniste të Kinës, sidomos në atë periudhë kur udhëheqja e saj hyri në konflikt të hapur me revizionistët hrushovianë, kon-flikt të cilin, në fakt, ajo e kishte filluar për arsye të caktuara e me qëllime të caktuara e jo nga baza mark-siste-leniniste. Edhe me shtetin kinez ne kemi pasur marrëdhënie të mira e miqësore.

Përse Partia jonë ndërmori luftën e saj të vendo-sur kundër këtij revizionizmi të ri? Ajo e ndërmori këtë luftë sepse për Partinë tonë kishin rëndësi të madhe thelbi teoriko-politik i kësaj miqësie, kishte rëndësi çë-shtja e luftës për ruajtjen e pastërtisë së teorisë sonë shkencore, marksizëm-leninizmit, çështja e socializmit dhe e revolucionit.

Që në kontaktet e para midis Partisë sonë dhe Par-tisë Komuniste të Kinës, nga viti 1956, ne konstatuam se në vijën e kësaj partie kishte lëkundje, qëndrime kontradiktore e pragmatiste, shmangie nga parimet e

marksizëm-leninizmit e shfaqje të tjera të rrezikshme e të dëmshme. Në kundërshtim me sa dëshironim e shpresonim ne, këto lëkundje e qëndrime kontradiktore erdhën duke u thelluar gjithnjë më shumë. Kjo gjë, siç e kemi sqaruar në shumë dokumente tonat, e detyroi Partinë e Punës të mbante qëndrim vigjilent dhe të ndiqte me kujdes zhvillimet politike, të brendshme e të jashtme, të Partisë Komuniste të Kinës e të Republikës Popullore të Kinës.

Për mjaft çështje konkrete politike e për probleme të ndryshme parimore, ideologjike e politike, që prekën gjithë lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare, Partia jonë nuk ka qenë dakord me qëndrimet e Partisë Komuniste të Kinës dhe mospajtimet e veta ia ka shprehur asaj në kohën e duhur e në rrugë marksiste-leniniste. Megjithëkëtë, në këto raste ne asnjëherë nuk dolëm me polemikë të hapur e publike ndaj kinezëve. Këtë nuk e bëmë as për oportunizëm, as për frikë. Ne vepruam kështu, sepse respektonim parimet themelore të marrëdhënieve midis dy partive motra marksiste-leniniste dhe, siç thamë më lart, ngaqë shpresonim e mendonim se udhëheqja e Partisë Komuniste të Kinës do t'i kuptonte qëllimet tona të mira, do t'i shikonte gabimet e veta dhe do të ecte në rrugën e shëndoshë, siç e donin interesat e revolucionit, të socializmit e të komunizmit. Por nuk ndodhi ashtu siç gjykonim ne, dhe nuk mund të ndodhte në rrugën në të cilën ecte udhëheqja kineze. E nisur nga pozita nacionaliste e kundërrevolucionare, nga pozitat e partisë «mëmë», ajo u hodh kundër nesh dhe veproi nga të njëjtat baza e me të njëjtat mjete diversioniste si revizionistët jugosllavë e ata sovjetikë. Në këtë situatë neve nuk na mbeti rrugë tjetër veçse të fillonim kritikën dhe demaskimin e hapur të revizionizmit kinez, të mbronim qëndrimet e drejta parimore të Partisë sonë, të mbronim marksizëm-leninizmin.

Revizionizmi kinez është një korrent oportunist në lëvizjen komuniste botërore dhe maocedunideja, baza e tij, është një ideologji me tipare arkaike, një amalgamë teorish të vjetra kineze të Konfucit e të Mencit dhe teorish të reja të perifrazuara, pa një lidhje organike e strukturore, të lyera me frazeologji marksiste.

Maocedunideja përfaqëson një ideologji hegjemoniste të sundimit botëror, të bazuar në një bagazh teoremash dhe mendimesh heterogjene, kontradiktore dhe pragmatiste.

Në ujërat e kësaj ideologjie lundronte barka kineze sa djathtas e majtas, me një drejtim të çoroditur kur Kina filloi ndërtimin e shtetit të ri kinez të dalë nga lufta çlirimtare.

Teoria që udhëhiqte Kinën e re nuk ishte marksizëm-leninizmi. Penelatat marksiste të fasadës të linin përshtypjen e rreme se ekzistonin disa tipare të socializmit shkencor. Ato pengonin që të dalloheshin qartë deviacionet e vazhdueshme, pse notohej në një det të tillë plot dallgë kundërshtimesh me marksizëm-leninizmin dhe me teoritë e tjera. Kjo përbënte atë lëkundshmëri, atë mospërcaktim të sistemit politik dhe ekonomik që ndiqte Kina.

Kur në Kinë theksohej roli i diktaturës së proletariatit, nën të fshihej dhe zhvillohej diktatura e grupeve rivale dhe e personaliteteve. Kur theksohej roli udhëheqës i Partisë, nën të fshihej një organizim kaotik dhe një udhëheqje e paqenë e saj. Kur flitej për hegjemoninë e klasës punëtore, roli udhëheqës në fakt i lihej fshatarësisë, sepse ishte ideologjia e saj mikroborgjeze që sundonte në Kinë. Kur flitej për ndryshimin e strukturave klasore, në thelb asgjë nuk lëvizte nga vendi.

Ekonomia kineze ecte duke çaluar rëndë pa orientime dhe perspektiva të qarta, pavarësisht nga ekzistenca e njëfarë plani që as për së largu nuk kishte tiparet

shkencore dhe ca më pak të një plani të bazuar në një sistem të centralizuar. Bile ai nuk kishte as tiparet e një plani të decentralizuar. Ekonomia kineze ecte për inerci.

Në këtë organizim dhe në këtë ideologji pa shtyllë kurrizore dominonte ideja e hegjemonizmit të shtetit të madh kinez, që «ishte thirrur nga historia» të përfaqësonte modelin e ri të shoqërisë socialiste, të përfaqësonte «marksizëm-leninizmin e kohërave të reja» që ishte maocedunideja.

Duhej të dallonim në këtë zhvillim të Kinës se nën petkun e «revolucionit» fshihej kundërrevolucioni, se nën petkun e maocedunidesë fshihej antimarksizmi, fshihej një rrymë e revizionizmit modern që kërkonte forma e struktura politike, ideologjike, organizative dhe shtetërore të përshtatshme për «kontinentin kinez» dhe për aspiratat e tij kapitaliste e imperialiste.

«Antiimperializmi», «antisovjetizmi», «antiamerikanizmi» i Kinës së Mao Ce Dunit, që alternoheshin midis tyre, ishin koniunkturalë. Ata nuk ishin bindje ideologjike, nuk ishin parimorë për balancimin e pushteteve të fuqishme në botë, një lojë me fuqitë politiko-ushtarakë imperialiste për fuqizimin e Kinës në skakierën botërore.

Me këto botëkuptime, me këto qëndrime eklektike e oportuniste, si në planin e brendshëm të Kinës, ashtu edhe në atë të jashtëm, u zhvillua Revolucioni Kulturor Proletar i hunvebinëve dhe tani po zhvillohet «revolucion» revanshist i pleqve reaksionarë e të gjitha mbeburinave të Kinës së vjetër. Mbi këta hapa u hartua teoria e pafat e «tri botëve» dhe e «aleancave të këtyre tri botëve», u bënë kthesat e forta kineze në politikën ndërkombëtare me rrjedhime shumë të rrezikshme për paqen botërore.

Iu desh Partisë sonë një kohë pak a shumë e gjatë që të dallonte këtë rrugë antimarksiste të Partisë Ko-

muniste të Kinës dhe të shtetit kinez, me të cilin ne kishim marrëdhënie të mira miqësore. Për Partinë tonë kishte rëndësi të madhe thelbi teoriko-politik i kësaj miqësie, kishte rëndësi çështja e luftës për ruajtjen e pastërtisë së marksizëm-leninizmit, çështja e socializmit dhe e revolucionit.

Në fillim ne bëmë një luftë parimore me debate, si në mes shokësh, por gradualisht ajo u ashpërsua për arsye të qëndrimeve antimarksiste të Kinës. Kjo ishte një luftë pa lëshime nga ana e Partisë së Punës të Shqipërisë, por edhe një luftë e pabarabartë dhe e vështirë. Po të mos bëhej kjo luftë, rrezikohej ndërtimi i socializmit në Shqipëri.

Rëndësia e luftës së Partisë së Punës të Shqipërisë qëndronte në atë se ajo rrëzoi dy mite: atë të Kinës, si vend ku ndërtohej socializmi, dhe atë të maocedunidesë, si marksizëm-leninizmi i kohës sonë. Në këtë luftë, për të mbrojtur parimet, Partia jonë nuk mori parasysh asnjë vështirësi ekonomike që mund t'i krijohesh vendit.

Maocedunideja, e propaganduar si «zhvillimi i mëtejshëm i marksizëm-leninizmit», mund të influenconte, siç influençoi, në lëvizjen komuniste ndërkombëtare dhe veçanërisht në disa parti marksiste-leniniste. Këto parti, për shumë rrethana, duke mos mundur dot t'i bënin një analizë të thellë kësaj rryme ideologjike revizioniste, mendonin se te Kina e madhe dhe te Mao Ce Duni kishin prijësit e revolucionit proletar, ndihmësit e vendosur në luftën kundër imperializmit amerikan e social-imperializmit sovjetik, mbrojtësit e natyrshëm të luftërave të drejta nacionalçlirimtare të popujve.

Duhej të bëhej, pra, një luftë parimore dhe e vendosur për të zhgënjyer të gënjerit. Këtë luftë e ndërmori Partia e Punës e Shqipërisë. Ky është një fakt i jetuar dhe i vërtetuar si në kohën kur rronte vetë Mao Ce Duni, ashtu edhe pas vdekjes së tij. Nga kjo luftë

Shqipëria socialiste nuk u izolua në botë, siç pretendojnë revizionistët jugosllavë. E kundërta ngjau, Partia e Punës e Shqipërisë dhe Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë i forcuan akoma më shumë pozitën e brendshme dhe ndërkombëtare.

Në këtë luftë për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit, të revolucionit dhe për kundërshtimin e ideologjisë pseudomarksiste të maocedunidesë luftuan me mençuri, me vendosmëri revolucionare dhe dhanë një kontribut të vlefshëm edhe parti të tjera motra marksiste-leniniste.

Demaskimi i Kinës si një vend josocialist dhe i maocedunidesë si një teori antimarksiste zhdukuri një iluzion të rrezikshëm në lëvizjen marksiste-leniniste, ashtu siç ngjau edhe me revizionizmin sovjetik, jugosllav dhe me rrymat e tjera reaksionare revizioniste.

Çdo maskim, çdo falsifikim, çdo devijim nga teoria shkencore e marksizëm-leninizmit nuk mund ta ketë jetën të gjatë. Ai shpejt ose vonë do të demaskohet, pse bie në kundërshtim me idealet e klasës punëtore, të popujve që luftojnë për çlirim, për demokraci të vërtetë, për socializëm, për një shoqëri të re pa shfrytëzues dhe të shfrytëzuar.

Partia e Punës e Shqipërisë edhe në të ardhmen do të vazhdojë me konsekuencë luftën parimore për demaskimin e plotë të revizionizmit kinez, për të vënë një kufi të qartë e të prerë midis marksizëm-leninizmit dhe ideve antimarksiste të Mao Ce Dunit. Pa denoncuar e hedhur poshtë maocedunidenë, pa luftuar e çrrënjësuar çdo ndikim të saj në lëvizjen revolucionare nuk mund të flitet seriozisht për luftë kundër revizionizmit kinez dhe as kundër revizionizmit modern në tërësi, nuk mund të konsolidohet e të zhvillohet si duhet lëvizja marksiste-leniniste dhe të çohet përpara me sukses çështja e revolucionit.

## SISTEMI KAPITALISTO-REVIZIONIST JUGOSLLAV

### Shënime

Revizionizmi jugosllav nuk u shkaktua si një reaksion kundër «stalinizmit» dhe si rrjedhim i veprimeve të Informbyrosë. Revizionizmi jugosllav ka rrënjë të thella, shumë më përpara ngjarjeve, të cilave ia veshin prejardhjen e tij.

Fenomeni jugosllav nuk është një shfaqje e ngjarjeve të vitit 1948, por një botëkuptim kapitalist, që nuk u zhduk gjatë Luftës Nacionalçlirimtare që bënë popujt e Jugosllavisë. Pas luftës ai mori përcaktime të reja në një shtet me shumë shtete, me shumë nacionalitete, ku problemet shoqërore-politike ishin të gjalla, të ndryshme, antagonistë dhe lufta e armatosur kundër nazifashistëve nuk mund t'i zhdukte rrënjësisht efektet që do të kishin më vonë.

Lufta Nacionalçlirimtare Jugosllave, pa mohuar rëndësinë dhe zgjerimin e saj, nuk u bë e njëjlojtë në ashpërsi dhe në vendosmëri në të gjitha ish-pjesët kryesore të Jugosllavisë së vjetër, e cila u ruajt edhe në kufijtë e rinj të republikave të federuara. Nga ana tjetër, lufta e popujve të Jugosllavisë paraqitet si një luftë kompakte vetëm kundër okupatorëve nazifashistë, por ajo zvogëlohet kundër reaksionit të brendshëm, sidomos atij çetnik dhe ustash, bashkëpunëtorëve të rën-

dësishëm të okupatorëve. Në këtë gjë nuk duhet harruar ku i ka burimet forca e madhe e reaksionit ustasho-çetnik, në cilin sistem është formuar, sa thellë i ka rrënjët, sa të zhvilluara i ka botëkuptimet socialo-politiko-kulturore në ato vende dhe në ata popuj, që ishin me kohë të formuar si shtete kapitaliste të bashkuara në Mbretërinë Serbo-Kroato-Slllovene, ku rivalitetet e klaneve qenë shndërruar edhe në rivalitete në mes popujve dhe kombësive të ndryshme që formonin Jugosllavinë mbretërore dhe formojnë edhe atë federative.

Fizikisht lufta nacionalçlirimtare e mundi reaksionin serbo-kroat, por mbetej një punë shumë e madhe, një punë dhe luftë shumë më e madhe për zhdukjen e rivaliteteve, të botëkuptimeve kapitaliste dhe mikroborgjeze, që u shtoheshin rivalitetet akoma të pazhdukura ndërmjet kombeve, republikave dhe kombësive. Këto probleme të mëdha nuk mund të zgjidheshin me disa mbledhje dhe vendime të rëndësishme që përcaktuan të ardhmen e Jugosllavisë. Ato duhej të zbatoheshin në jetë në një Jugosllavi shumëkombëshe të shkatërruar nga lufta dhe kjo e zhvilluar jo njësoj në të gjitha skajet e Jugosllavisë, siç duan ta paraqesin jugosllavët. Lufta nacionalçlirimtare zgjidhi globalen, por duheshin zgjidhur edhe veçoritë që formonin këtë global.

Çështja kapitale e së ardhmes së Jugosllavisë së re nuk mund të zgjidhej «kavalierçe» dhe pa një orientim e pjekuri të madhe politike, organizative dhe ekonomike, të bazuar vendosmërisht në teorinë shkencore të marksizëm-leninizmit. Këtë vepër të madhe do ta kryente vetëm një Parti Komuniste e Jugosllavisë, e fortë dhe me parime të qarta marksiste-leniniste. Ekzistonte një Parti Komuniste e Jugosllavisë, por kjo nuk i kishte këto tipare, as i kaliti këto gjatë kohës së luftës, përkundrazi edhe ato që kishte i humbi në kohën e pas-

luftës, kur nga rrethanat ishte e thirrur të rindërtonte Jugosllavinë e re në rrugën socialiste.

Po të dëgjosh lavdërimet e titistëve dhe të borgjezisë reaksionare jugosllave, që ka pasur dhe ka interes që Jugosllavia të arrinte në këtë shkallë që është sot, dilet në konkluzionin se një parti e tillë ka ekzistuar dhe ekziston. Në këtë gjykim euforik ramë edhe ne, komunistët shqiptarë, veçanërisht gjatë kohës së luftës dhe në vitet e para të pasçlirimit. Por në këtë gjykim nuk ramë vetëm ne dhe kjo kishte logjikën e saj, luftën heroike të popujve të Jugosllavisë.

Pas çlirimit të Jugosllavisë forma dhe brendia e marrëdhënieve në mes Jugosllavisë dhe vendeve socialiste tregoi gradualisht dhe në vazhdim se ecuria e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe udhëheqja e saj, Partia Komuniste e Jugosllavisë, po devijonin nga parimet marksiste-leniniste të përcaktuara gjatë luftës nacionalçlirimtare dhe si në teori, si në qëndrimet politike, ashtu edhe në ndërtimin e socializmit u dukën shmangie të mëdha dhe një arrogancë e mendjemadhësi e huaj për komunistët dhe për një parti komuniste. Ishte e qartë që kjo rrugë e ndjekur do të përfundonte në çarje, siç ndodhi, jo për fajin as të Byrosë Informative, as të Stalinit dhe të «stalinizmit», sikurse duan ta cilësojnë marksizëm-leninizmin jugosllavët titistë dhe miqtë e tyre. Titistët kthyen kursin drejt kapitalizmit. Kthesa e tyre duhet të bëhej dhe u bë, duke adoptuar dhe duke i hyrë një ndërtimi «të ri» ekonomik-shoqëror dhe një forme të re qeverisjeje shtetërore të përshtatshme me kursin antisocialist, siç ishte ai i sistemit të vetadministrimit jugosllav. Ky në fakt nuk ishte një sistemi i ri as socialist dhe as jugosllav, por prejardhjen e vet e kishte nga prudonizmi, nga anarkistët, si Bakunini dhe Kropotkini, aq shumë dhe keqas të demaskuar në

kohën e tyre nga Marksi, më vonë nga Lenini, pastaj edhe nga Stalini.

Deviacioni jugosllav si nga titistët, ashtu edhe nga borgjezia dhe kapitalizmi botëror, u trumbetua si një «periudhë e re», si një «brazdë e re» e çarë nga Titoja për ndërtimin e një «socializmi të ri», «human», krejt në kundërshtim me teoritë e Marksit dhe me teorinë dhe praktikën e leninizmit.

Çdo gjë ndryshoi në Jugosllavinë e ashtuquajtur socialiste dhe këto ndryshime duhet të kërkohen në bazën politiko-sociale të Jugosllavisë jo shumë, por dobët të përgatitur nga lufta nacionalçlirimtare me një botë-kuptim të ri marksist-leninist, botëkuptim, kuptohet, që nuk e kishte, nuk e ndërtoi dhe nuk e kaliti Partinë Komuniste të Jugosllavisë.

Titistët kanë bërë e shkruar «historinë dhe historikun» e të gjitha partive komuniste të botës, por historinë e partisë së tyre komuniste dhe më vonë ndryshimin e emrit të saj në Lidhje të Komunistëve të Jugosllavisë nuk e kanë shkruar. Kurse biografinë e Titos mund ta gesh në dhjetëra në mos në qindra libra. Është lehtë të kuptohet arsyeja për këto.

Kthesës jugosllave drejt kapitalizmit, natyrisht, iu bë një reklamë e shfrenuar, një hosana e papërskruar dhe «Barabait» një lavdë e madhe, e shoqëruar dhe e financuar nga imperializmi dhe kapitalizmi botëror. Me ngjyra dramatike u reklamua se Jugosllavinë gjoja do ta sulmonte me armë Stalini, u fry megalomania pan-jugosllave si «kampionë dhe shembull udhëheqëse e popujve të botës në luftën e tyre çlirimtare», u vunë, po ashtu, në zbatim vrasjet, burgosjet, torturat, internimet e kampet e përqendrimit dhe u ligjërua klasifikimi i njerëzve në «informbyroistë» dhe në partizanë të Titos. Këtu fillon diktatura e klanit reaksionar që zëvendësoi

diktaturën e proletariatit, së cilës nuk iu dëgjua asnjëherë emri në Jugosllavinë e pasluftës.

Çdo gjë që kishte filluar, me tiparet e para të socializmit, u ndal në vend pas devijimit revizionist jugosllav dhe filloi kursi i ri i një sistemi të ri shoqëror, ekonomik, i vetadministrimit jugosllav, «fabrikat punëtorëve», «këshillat e punëtorëve», «decentralizimi i ekonomisë dhe i planifikimit» etj., që shkurtimisht do t'i vëmë në dukje më poshtë, se vetëm kështu mund të kuptohet ç'është revizionizmi modern jugosllav, si një rrezik për vetë popujt e Jugosllavisë, por edhe si një luftëtar i vendosur i kapitalizmit botëror, armik i revolucionit dhe i socializmit.

I gjithë sistemi vetadministrues duhej të ruante në formë dhe në emërtimet e ndryshme të strukturës dhe të superstrukturës qenien «marksiste». Në Jugosllavi thuhej se çdo gjë ndërtohej krejt e re, «sipas teorisë së Marksit», teori që «nuk e kishte kuptuar dhe zbatuar as Lenini» (këtë gjë në Jugosllavi nuk e pohojnë hap-tazi, ata e lënë të kuptohet), e që, sipas titistëve, e kishte deformuar Stalini.

Vetadministrimi liberalizoi pushtetin. Me fjalë të tjera një sistem i tillë, siç u vendos gjatë luftës dhe deri në vitin 1948 kur u bë çarja, nuk mund të ekzistonte më si pushtet i këshillave popullorë, me të gjitha prerogativat e tij, siç i kanë përcaktuar Marksi dhe Lenini, por duhej zëvendësuar me këshillat e punëtorëve, pse i pari ishte etatist-burokratik, që lindi një «burokraci dhe një shtresë të borgjezisë së re», kurse këshillat e punëtorëve qenkëshin një pushtet «më i vërtetë, më i afërt i teorisë së Marksit», pse «janë vetë punëtorët që drejtojnë dhe qeverisin drejtpërdrejt» dhe jo me ndër-mjetësinë e shtetit, që, natyrisht, sipas logjikës jugosllave, duhet të rezultojë se nuk është i tyre. Shteti aktual

jugosllav na qenka vetëm një «garant» që ky «sistem i ri» të mos preket, «të mos shkoqet fizikisht» dhe «për këtë Federata mban në duart e veta ushtrinë, UDB-në, politikën e jashtme dhe asgjë tjetër».

Pra sistemi i vetadministrimit e decentralizoi pushetin e diktaturës së proletariatit, e liberalizoi atë, ai ishte i «proletarëve» dhe u bë i «punëtorëve», ishte «i dalë nga lufta, i dalë nga baza», por tash ky sistem kërkon ndryshim, kërkon zhvillim «dialektik» dhe atë e pollën «kokat e mëdha» Tito, Kardel «nga lart».

Roli udhëheqës i partisë në këtë sistem duhej të zhdukej dhe në fakt ai u venit. Partisë iu la vetëm njëfarë roli i shpëlarë edukues, pa asnjë zë në gjithë kapitullin. Në dukje partia nuk u zhduk, por në realitet u bë e paqenë dhe u emërtua «Lidhja e Komunistëve», me qëllim që në emërtim të ishte sa më afër emërtimit të krijuar nga Marksi, por në realitet për t'u larguar sa më shumë nga roli që Marksi dhe Lenini i përcaktojnë partisë komuniste. Sipas titistëve, pra, Jugosllavia ka hyrë në një etapë kur nuk duhet të ekzistojë më diktatura e proletariatit. Partia komuniste nuk duhet të ketë më ato prerogativa që ka në fazën e kalimit nga etapa e socializmit për në komunizëm, pse atje paskan kaluar në etapën e komunizmit (gjë që nuk pohohet), pse vetë vetadministrimi që u ndërtua, gati ka rregulluar çdo gjë të etapës së fundit më të përparuar të shoqërisë.

Vetadministrimi, që i solli Jugosllavisë «gjithë këto të mira», zhduku, gjithashtu, luftën e klasave brenda në parti, brenda në Jugosllavi dhe jashtë saj, vetëm ushtria dhe UDB-ja atje nuk u «vetadministruan», por ndodhen në një dorë për çdo eventualitet, për t'u përdorur kur kosovarët «të dezekuilibrojnë, ose të destabilizojnë Federatën».

Vetadministrimi vetvetiu i ka edukuar punëtorët dhe punonjësit e gjithë Jugosllavisë «me një ndërgjegje

shumë të lartë politike, ideologjike, morale dhe etike» dhe i ka bërë ata «të denjë» për këtë etapë «të përparuar». Çdo mbeturinë mikroborgjeze, çdo mentalitet borgjezo-kapitalist, çdo ndjenjë e pronës private, çdo ndjenjë nacionaliste, shoviniste, republikane, lokaliste ose fetare është «e huaj» për Jugosllavinë titiste. Vetadministrimi jugosllav rrëshqet si në gjalpë, jo drejt socializmit, siç po trumbetohet, por drejt kapitalizmit, ku tash ka hyrë kokë e këmbë, *de facto* dhe *de jure*. Të gjitha këto struktura janë ligjëruar.

Vetadministrimi jugosllav ka krijuar shtresën e saj të borgjezisë kapitaliste, e cila drejton, planifikon, manipulon punëtorët, lëndët e para, fitimet, akumulimet dhe shpërndarjen.

Punëtorët atje kanë «hapëset e kashtës», por në emrin e tyre, në emër të «demokracisë vetadministruese», nëpërmjet «trusteve» me emra në dukje vetadministrues, por me brendi kapitaliste, «zhvillohet», «planifikohet», grabitet ekonomia «pronë e gjithë popullit». Bankat vetadministruese lozin rolin e kapitalit financiar njëlloj si në shtetet kapitaliste. Këto banka, të lidhura me bankat e jashtme, manipulojnë me fitime të mëdha, për vete dhe për kaptalet e huaja, shuma kolosale, që përfaqësohen nga depozitimet e trusteve vetadministruese, nga ndërmarrjet vetadministruese dhe nga kreditë prej dhjetëra miliardë dollarësh, që merren hua nga jashtë. Pra kapitali financiar i brendshëm dhe ai i jashtëm drejton, udhëheq e shfrytëzon në fakt ekonominë jugosllave të vetadministruar.

Të gjitha të këqijat e ekonomisë kapitaliste lulëzojnë në Jugosllavinë titiste të vetadministruar. Këtu ekzistojnë, natyrisht, tregu i lirë, konkurrenca, ngritja e çmimeve, bankruta dhe mbyllja e mijëra ndërmarrjeve të vogla jorentable. Ndërmarrjet e mëdha në Jugosllavi, si kudo në vendet kapitaliste, hanë të voglat dhe

kështu me dhjetëra mijë punëtorë hidhen në rrugë dhe shtohet numri i të papunëve. Gati një milion jugosllavë, në mos më shumë, kanë shkuar jashtë vendit si emigrantë ekonomikë. Inflacioni në Jugosllavinë e vetadministruar ka marrë përpjesëtime katastrofike. Monopoli ekonomik republikan, që përbëhet nga monopoli i ndërmarrjeve dhe i trusteve të vetadministruara, gjoja nga këshillat e punëtorëve, ose nga të deleguarit e tyre, është kthyer në një shoqërim politik dhe nacionalizëm republikan, që kalon jo vetëm nga një republikë në tjetrën, por nga një rreth, nga një krahinë dhe nga një ndërmarrje në tjetrën.

Në Jugosllavinë titiste cilido si individ, si grup, si republikë përpiqet kush të pasurohet më shumë dhe më shpejt në kurrizin e tjetrit.

Këto janë frytet e këqija të revizionizmit jugosllav dhe të sistemit të tij të vetadministrimit punëtor.

E MARTË  
30 QERSHOR 1981

## SHËNIM

Nesër në gazetën «Zëri i popullit» do të botohet artikulli me titull: «Çfarë kërkojnë flotat ushtarake të superfuqive në portet jugosllave?».

## PESË GABIMET E TITISTËVE NDAJ ÇËSHTJES SË KOSOVËS

### Panoramë<sup>1</sup>

Problemi i Shqipërisë dhe i shqiptarëve, si komb e si shtet, përbën një problem historik, politik, ekonomik dhe etnik të vetëm. Populli shqiptar ka etnogjenezën dhe formacionin e vet kombëtar të përcaktuar në shekuj, me të gjitha tiparet e duhura të një kombi, ka historinë, zhvillimin ekonomik, kulturën dhe zakonet e veta kombëtare shumëshekullore, politikën e tij etj.

Këto karakteristika të kombit shqiptar janë zhvilluar e afirmuar në luftë të gjatë e të vazhdueshme, nga e cila kanë kaluar edhe kombe e shtete të tjera të botës.

Gjatë gjithë këtij zhvillimi të gjatë historik disa popuj janë zhdukur, disa janë asimiluar nga popuj më të fuqishëm, shumë të tjerë janë unifikuar në vorbullën e historisë dhe kanë formuar një shtet të vetëm e të përbashkët.

Historia ka njohur forma të ndryshme shtetesh e me emërtime të ndryshme, mbretëri e perandori që herë

<sup>1</sup> Këtë panoramë shoku Enver Hoxha e ka shkruar në kohën kur përgatiste kapitullin «Gjendja ndërkombëtare dhe politika e jashtme e RPSSH» të raportit për Kongresin e 8-të të PPSH.

janë zhdukur e herë janë zëvendësuar me të tjera, ka njohur popuj që janë robëruar nga popuj të tjerë, popuj e kombe të copëtuara sipas interesave të fuqive më të mëdha ose nëpërmjet luftërash grabitqare imperialiste, ose me anë traktatesh diplomatike në interes të fituesit e në dëm të të mundurit. Në mënyrë të veçantë popujt e vendet e vogla që humbisnin, shtypeshin dhe robëroheshin, bëheshin plaçkë tregu e fuqive të mëdha fituese.

Në një lojë të tillë të rrezikshme e me pasoja të rënda i kishin futur fuqitë e mëdha veçanërisht popujt e Ballkanit.

Populli shqiptar ka luftuar pa pushim e në shekuj kundër armiqve të egër e shumë më të mëdhenj në numër. Në të gjitha këto luftëra shekullore, humbjesh e fitoresh, vite robërie, populli shqiptar asnjëherë në historinë e tij nuk e humbi qenien e vet si komb. Përkundrazi, në çdo rrethanë e ka manifestuar atë me një vitalitet të jashtëzakonshëm e shembullor. Ai nuk e humbi as unitetin e tij dhe as qenien e vet si një shtet në formim dhe në zhvillim.

Perandoritë botërore dhe fuqitë e mëdha nuk e zhdukën dot etninë kompakte të shqiptarëve, as nuk mundën dot ta asimilnin, t'i zhduknin kulturën, gjuhën, doket, zakonet dhe bindjet e tij. Pra, as latinët, as sllavët, as osmanët nuk mundën t'i mposhtnin, t'i asimilnin ose t'i zhduknin shqiptarët si popull e si komb. Po, ata e shkelën, e robëruan, por nuk e mposhtën dot.

Kështu ngjau edhe me Perandorinë Austro-Hungareze pas Luftës së Parë Botërore, me Traktatin e Versajës, me perandoritë e Musolinit e të Hitlerit. Këtë e vërteton vetë qenia e popullit shqiptar. Historia tregon se i vetëm, pa asnjë përkrahje nga fuqitë e huaja, të cilat i ka pasur kurdoherë kundër, ai ka luftuar me sukses për lirinë e kombit të vet, të kompaktësisë së tij, ka luftuar për mbrojtjen e kulturës dhe të pavarësisë si

shtet sovran dhe i pavarur nga kurrkush, për të drejtat e tij të natyrshme e të ligjshme. Kurdoherë vetëm lufta dhe gjaku i tij, i derdhur si lumë, kanë bërë që të arrihej fitorja.

E njëjta gjë po ngjet aktualisht edhe me qëndrimet dhe sjelljet e shovinizmit serbomadn ndaj një pjese të madhe të popullit shqiptar, që padrejtësitë e fuqive imperialiste e kanë lënë jashtë kufijve të atdheut të tij mëmë.

Padrejtësitë e imperialistëve kundër Shqipërisë dhe popullit shqiptar, sot ata që kanë përfituar nga këto padrejtësi, i quajnë si gjëra «të drejta» dhe, anasjelltas, kërkesat që këto padrejtësi të korrigjohen, ata nuk mungojnë t'i quajnë «padrejtësi».

E tillë është logjika e tyre e padrejtë, reaksionare. Por, kur flet në përgjithësi për çlirimin e popujve, për lirinë dhe të drejtat e tyre, kur flet për të drejtat e njeriut, nuk mund të harrosh dhe të mos kërkosht të zbatohen të drejtat e një populli konkret për lirinë, pavarësinë dhe vetëvendosjen e tij, nuk mund t'i kufizosh ose t'i bastardosh kulturën dhe zakonet e tij, nuk mund të zhdukësh të kaluarën dhe historinë e tij. Ose je, ose nuk je për këto të drejta. Dy qëndrime për çështje të mëdha e parimore nuk mund të ketë. Ne shqiptarët jemi të vendosur për të drejtat që duhet të kenë popujt, ne jemi që këtyre çështjeve jetike t'u shkohet me drejtësi, me gjakftohtësi, me arsytetime të shëndosha dhe të argumentuara, deri në fund.

I ka kaluar koha politikës së dikurshme që ushqente e mbronte padrejtësitë kundër një populli, kundër gjysmës së një populli unik ose kundër një pakice minoritare. Ka kaluar, gjithashtu, edhe koha kur bëhej si donin «më të mëdhenjtë», kur duhej t'i thoshe «të bardhës e zezë», pse kështu ua kishte qejfi «këtyre të mëdhenjve».

Sot, të paktën populli shqiptar, qoftë ai që jeton në atdheun e tij socialist, në RPSSH, qoftë shqiptarët që jetojnë në trojet e veta në Jugosllavi, nuk lejojnë që ndokush t'i marrë nëpër këmbë. Kjo është e qartë dhe duhet të jetë akoma më e qartë për të gjithë, dhe sidomos aktualisht, në epokën e kalbëzimit të kapitalizmit dhe të revolucioneve proletare.

Akuzat pseudoteorike për «nacionalizëm», «irredentizëm» etj. që përdorin shovinistët serbomëdhenj kundër RPSSH dhe kundër shqiptarëve që jetojnë në Jugosllavi, janë gënjeshtër dhe perde tymi për të fshehur realitetin e gjërave, për të përjetësuar padrejtësitë e dukshme të bëra kundër shqiptarëve, për t'ia përshtatur këto shpifje e gënjeshtër një politike të ndërtuar gjoja në mbrojtje të «pavarësisë» së shteteve nga superfuqitë dhe nga blloqet e tyre politik-ushtarake, «për mosangazhimin» dhe për ndërtimin «e një socializmi specifik», «socializëm» që krijon disnivelet ekonomike, grindjet dhe meritë nacionaliste e shoviniste në mes popujve, gjenocidin dhe dhunën më të egër kapitalisto-fashiste. Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë ka një politikë të saj të jashtme dhe të brendshme. Ajo ka kaluar nga disa sisteme të ndryshme ekonomike, të cilat kanë pasur strukturën dhe superstrukturën specifike me ndryshimet e mëdha që rrjedhin nga përbërja e vetë RSFJ.

Titistë-revizionistët jugosllavë kanë arritur deri aty sa të mendojnë se të gjithë të tjerët duhet t'u besojnë atyre, të ndjekin shembullin e tyre. Ata mendojnë se zgjidhjet që u kanë dhënë ata problemeve të shumta e të koklavitura nacionale, formulat e tyre të alambikuara për politikën e jashtme, të cilat i kanë grumbulluar në një doktrinë të vetme kundërrevolucionare, janë të adoptueshme nga të gjithë.

Megalomania, e pompuar nga rrethanat e përshtatshme ndërkombëtare, për t'u imponuar diçka shteteve

dhe popujve, e ka pasë kthyer udhëheqjen jugosllave, me dhe pa Titon në krye, në një qendër me një sensibilitet politiko-ideologjik aq të sëmurë saqë po e çon RSFJ në disfata të njëpasnjëshme.

Kushdo që kritikon, dhe kjo është një e drejtë e pamohueshme e kujtdo, politikën revizionisto-kapitaliste të Jugosllavisë, taksohet si heretik, si anakronik, si dogmatik, i mbyllur e i izoluar nga bota, i panevojshëm dhe i tepërt për të rrojtur në këtë botë etj., etj.

Sipas titistëve, çdo popull, çdo komb, çdo shtet, që «të rrojë», «të lulëzojë», «të përparojë» duhet të formulojë një vijë politike e qëndrime të brendshme e të jashtme dhe t'i zbatojë ato si të jugosllavëve, pse vetëm këto po i «lëkundin themelet» e superfuqive imperialiste, se vetëm futja në borxhe deri në grykë ndaj të fuqishmëve, vetëm «portat e hapura» për shfrytëzim të pamëshirshëm nga ana e kapitalit botëror, janë rrugët «më të drejta», «më adapte» dhe të kohës për jugosllavët e sipas tyre edhe për gjithë të tjerët.

Titistët kanë gjetur edhe formulën gjoja më të përshtatshme të akuzës «staliniste» kundër atyre që jo vetëm nuk i ndjekin, po i kritikojnë, i demaskojnë dhe i luftojnë këto teorizime, këto sisteme antisocialiste, anti-revolucionare të jugosllavëve.

Mirëpo kjo formulë u shërben pak dhe vetëm për një kohë të shkurtër, pse koha vërteton çdo orë dhe çdo çast se teoria shkencore e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit nuk është efemere, as e çastit, as e koniunkturave, por një teori që u ka qëndruar dhe u qëndron rrebesheve të kohëve. Ajo demaskon kapitalizmin dhe rendin e tij të urryer, udhëheq popujt në revolucion, në luftëra nacionalçlirimtare, në luftë kundër shtypjes dhe shfrytëzimit, kundër nënshtrimit ndaj borgjezisë gjakpirëse dhe sistemit të tij shfrytëzues, grabitës, shtypës.

I gjithë zhvillimi aktual i botës dhe konsekuencat e

këtij zhvillimi, shpjegohen dhe vërtetohen shkencërisht, ashtu siç i kanë parashikuar mësuesit tanë të mëdhenj, klasikët e marksizëm-leninizmit.

Problemi nacional, në mënyrë të veçantë, shumë i komplikuar nga rrethanat dhe zhvillimet e historisë, kurrë nuk mund të gjejë zgjidhje të drejtë veçse në një shoqëri të re socialiste, vetëm nga një frymëzim dhe zbatim rigoroz i ideologjisë marksiste-leniniste. Në këtë kuptim a është zgjidhur drejt çështja nacionale e kombeve dhe e kombësive në Jugosllavinë «e re» të pasluftës së Dytë Botërore? Ne themi jo. Përse? Sepse në Jugosllavi nuk ka ekzistuar asnjëri nga këta faktorë determinantë, nuk është nisur nga një analizë marksiste-leniniste e gjendjes shoqërore politike, ekonomike dhe kushtetuese dhe këndeje të dilej në atë zgjidhje të drejtë të çështjes së koklavitur nacionale brenda RSF të Jugosllavisë së pasluftës së Dytë Botërore.

Popujt e Jugosllavisë luftuan kundër pushtuesve italianë dhe hitlerianë. Të gjithë popujt e Jugosllavisë duhej të bashkoheshin në këtë luftë nacionalçlirimtare nën udhëheqjen e Partisë Komuniste të Jugosllavisë. Dhe këtë mund të themi se e bënë në përgjithësi. Iu desh popujve jugosllavë të luftonin edhe kundër bashkëpunëtorëve të pushtuesve, çetnikëve, ustashëve, borgjezisë reaksionare slovene, bullgare dhe reaksionarëve shqiptarë. Kjo luftë, për sa i përket intensitetit, natyrisht ishte e diferencuar. Gjatë luftës duhej të hideshin edhe bazat e pushtetit të ri, nga forma dhe nga përmbajtja të pasluftës, dhe ky ishte «pushteti i këshillave nacionalçlirimtarë». Ky pushtet filloi të vendosej gjatë gjithë kohës së luftës nacionalçlirimtare dhe u pranua e funksionoi në përgjithësi deri në shpëputjen e Jugosllavisë nga kampi i socializmit, periudhë që nuk na intereson këtu.

Partia Komuniste e Jugosllavisë, që udhëhoqi luftën

nacionalçlirimtare, luftoi për çlirimin e tërësive të tokave që përbënin mbretërinë serbo-kroato-slllovene. Në hapësirën e kësaj mbretërie jetonin popuj të ndryshëm, kombe dhe kombësi të ndryshme. Mbretëria serbo-kroato-slllovene formohej nga etni të ndryshme, secila me historinë e vet e me bindje politike të ndryshme. Mbretëria serbo-kroato-slllovene ishte një shtet i krijuar nga fuqitë imperialiste, u përgjigjej interesave të tyre dhe favorizonte popujt më të fuqishëm që e formonin atë. Natyrisht, ky grumbullim shtetesh nën një monarki, ku hegjemone ishte Serbia, u ndërtua nën shembullin e Perandorisë Austro-Hungareze, kundër së cilës u luftua dhe u fitua. Pra, Lufta e Parë Botërore shkatërroi një perandori, atë të Habsburgëve, dhe nga ajo krijoi një «perandori» tjetër më të vogël, që kishte, në mos më shumë, po ato tipare shfrytëzuese dhe shtypëse si e para, me një drejtim politik vartës të caktuar nga Franca dhe koalicioni fitues aleat kundër perandorisë së Giomit II.

Natyrisht, regjimi që do të ndërtohej pas Luftës së Dytë Botërore, duhej të ndryshonte rrënjësisht, jo vetëm nga forma, por sidomos nga përmbajtja, nga ajo e monarkisë së vjetër serbo-kroato-slllovene. Forma e regjimit të ri, siç deklarohet, do të ishte një republikë e federuar me tiparet e një regjimi të vërtetë demokratik, domethënë do të realizohej, në baza leniniste, bashkimi i disa republikave, të krijuara nga popuj të ndryshëm, në bazë të parimit të vetëvendosjes nga bashkimi deri në shkëputje.

Ky parim i madh i zgjidhjes së çështjes së madhe e të koklavitur të nacionaliteteve të ndryshme, më parë të shtypura, që u çliruan duke luftuar, domethënë ai i vetëvendosjes për bashkim deri në shkëputje, nuk u zbatua në Jugosllavi. Përkundrazi, predominoi parulla «bashkim-vëllazërim». Nga lart u sanksionua dhe u im-

ponua ideja e vjetër e bashkimit nën hegjemoninë serbo-kroato-slllovene, por këtë herë të maskuar nën parullat «çlirimtare», të «unitetit», të «bashkimit» *de facto* dhe *de jure* nëpërmjet mbledhjeve të AVNOJ-t<sup>1</sup>. Në këto mbledhje vullneti i vetëvendosjes së popujve nga bashkimi deri në shkëputje as nuk u kërkua, as nuk u caktuan format dhe procedurat me anën e të cilave duhej të zbatohet ky vullnet në një formacion të ri shtetëror, me shumë kombe dhe kombësi. Kështu vullneti i popullit shqiptar që jetonte e luftonte në Jugosllavi për «vetëvendosje deri në shkëputje», që u aprovua në mbledhjen e parë themeluese të Këshillit Nacionalçlirimtar të Kosovës e të Metohisë, mbajtur në Bujan më 31 dhjetor 1943 deri më 2 janar 1944, nuk u mor parasysh nga udhëheqja kryesore e Partisë Komuniste të Jugosllavisë, u cilësua si e paqenë, e gabuar, jo në frymën e vendimeve të AVNOJ-t në Jajcë edhe pse gjatë luftës po kjo udhëheqje kishte propaganduar me të madhe se do të respektonte «të drejtat e popujve» dhe «barazinë nacionale». Zhvillimet e mëvonshme treguan se ajo e kishte bërë këtë propagandë për të mbuluar qëllimet e saj të fshehta shoviniste e për të mashtruar popujt e ndryshëm që përbënin Jugosllavinë. Në fakt edhe në mbledhjen e dytë të AVNOJ-t, në Jajcë, në nëntor 1943, publikisht u shpall se do të ndiqej «politika e barazisë së popujve», por në të vërtetë aty u aprovua një politikë tjetër, shoviniste e kundërrevolucionare në dëm të popujve e të kombeve joserbe që ndodheshin brenda kufijve të ish-Jugosllavisë së Karagjorgjeviçëve, prandaj ato u mbajtën tepër sekret nga opinioni publik dhe nga aleatët e Jugosllavisë në atë kohë. Pikërisht në bazë të këtyre vendimeve të fshehta, Kosova dhe viset e tjera shqiptare do të qëndronin brenda kufijve të Jugosllavisë

1 Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar i Jugosllavisë.

së vjetër dhe nuk do të lidheshin me mëmëdheun e tyre, Shqipërinë e re, që dilte nga një luftë po aq e lavdishme, në mos më shumë se ajo e jugosllavëve, dhe pavarësisht nga vullneti i shprehur i shqiptarëve në Jugosllavi.

Bashkimin me Shqipërinë, pra, e vendosi mbledhja historike e Bujanit, ndërsa titistët vendosën të kundërtën, duke shkelur të gjitha vendimet gjoja parimore që kishin marrë me aq solemnitet në mbledhjet e ndryshme «kushetuese» gjatë kohës së luftës. Ata shkelën parimet themelore të marksizëm-leninizmit, ose i deformuan ato për një veprim jokonform zgjidhjes së drejtë të çështjes nacionale në Federatën e re Jugosllave.

**Ky ishte gabimi i parë i rëndë politik dhe ideologjik i titistëve në punën e tyre për formimin e shtetit të ardhshëm jugosllav, në zgjidhjen e çështjes nacionale që ekzistonte në Jugosllavinë e vjetër dhe një shkelje e rëndë e parimit leninist të vetëvendosjes së popujve.**

Si rrjedhim i këtij gabimi të parë të madh parimor, u bë gabimi i dytë po aq parimor në përcaktimin e kombeve dhe të kombësive, domethënë në përcaktimin e «kombit» dhe të «pakicave kombëtare». Kush duhej të quhej komb dhe kush duhej të quhej pakicë? Në ç'baza duhej të përcaktohej etnia, «etni e mirëfilltë» dhe «etni jo e mirëfilltë», siç po teorizojnë aktualisht serbomëdhenjtë?

Edhe në shtetin e ri këto probleme ruajtën zgjidhjen e vjetër, atë të monarkisë serbo-kroato-slllovene dhe në bazë të kësaj zgjidhjeje u formua edhe shteti i republikave të federuara të Jugosllavisë së re të pasluftës. Pra, nga lart u përcaktuan: Republika Socialiste e Serbisë, ajo e Kroacisë, e Slllovenisë, e Bosnjë-Hercegovinës dhe e Malit të Zi. U krijua edhe një republikë e re, me shumë nacionalitete, që u emërtua Republika Socialiste e Maqedonisë.

Republikës serbe, si kurdoherë, iu ruajt në «pronësi» pjesa më e madhe e territoreve shqiptare, Kosova, e cila u quajt pa dorashka «krahinë» e Serbisë. Më vonë, pas protestave të vendosura të bujshme të kosovarëve dhe pas gjenocidit që u bë gjatë kohës së Rankoviçit, iu ndryshua emërtimi në «Krahinë Autonome e Serbisë». Por edhe kjo ishte përsëri një zgjidhje antimarksiste dhe nacional-shoviniste, ishte një emërtim politik fiktiv, gjoja për të dobësuar rrymën serbomadhe me rrëzimin e grupit të Rankoviçit. Krijimi i dy «krahinave autonome», ajo e Vojvodinës dhe ajo e Kosovës (në krahinën e Vojvodinës kishte me të vërtetë një minoritet të vogël hungarez dhe serbët bënin shumicën, kurse në «Krahinën Autonome» të Kosovës mbi 80 për qind ishin shqiptarë autoktonë), u konsiderua nga titistët si një zgjidhje «e drejtë», por në fakt ajo nuk zgjidhte gjë, pse zgjidhja që iu dha, nuk ndryshonte nga gjendja e parë: Serbia i ruante nën sjetullat e saj këto dy krahina.

**Gabimi i tretë i madh ka të bëjë me zgjidhjen që iu bë problemit të kombit ose të «kombësisë shqiptare». Çështja është të përcaktohej: Ekzistonte një komb shqiptar apo një «pakicë kombëtare shqiptare» dhe ç'do të bëhej me shqiptarët?**

Pas luftës së vendosur antifashiste që u bë, si në Shqipëri, ashtu edhe në Jugosllavi, ky problem shtrohej ndryshe. Popujt e të dy vendeve luftuan së bashku kundër të njëjtit armik. Luftën e tyre Nacionalçlirimtare e udhëhoqën dy parti komuniste, Partia Komuniste e Shqipërisë dhe Partia Komuniste e Jugosllavisë. Kjo luftë çlirimtare e përbashkët duhej t'i zhdukte padrejtësitë e së kaluarës, duhej zhdukur skllavëria e popujve, veçanërisht e shqiptarëve, që vuanin nën regjimin e monarkisë serbomadhe; kishte ardhur koha të zgjidhej çështja e popullit shqiptar dhe e tokave shqiptare të aneksuara Jugosllavisë, jo në kuadrin e Republikës Socialiste Fede-

native të Jugosllavisë, por jashtë saj dhe konkretisht me bashkimin e tyre me Shqipërinë, aleate në Luftën Nacionalçlirimtare, dhe kur në të dy vendet ndërtohej e njëjta shoqëri e re, «demokracia e re» që nuk ishte veçse fillimi i ndërtimit të shoqërisë socialiste. Kjo nuk u bë nga ana e jugosllavëve.

Zgjidhja që u adoptua dhe u vendos, nuk ishte një zgjidhje marksiste-leniniste, por një zgjidhje nacionalisto-shoviniste, pro nacionalizmit dhe shovinizmit serb, ishte një vendim arbitrar jashtë parimeve të vendosura e të shpallura gjatë kohës së luftës ndaj shqiptarëve në Jugosllavi, si një pjesë kompakte e kombit shqiptar, që jetonin ngjitur me atdheun mëmë, Shqipërinë e re socialiste. Kurse për RSFJ ky vendim i padrejtë dhe arbitrar ishte një *fait accompli*. Në vitin 1946 Titoja këtë veprim antimarksist, edhe pse ishte dakord se «Kosova dhe viset e tjera me popullsi shqiptare në Jugosllavi janë toka shqiptare, që i përkasin Shqipërisë dhe duhet t'i kthehen asaj», e mbuloi me justifikimin pa asnjë bazë se «një gjë të tillë nuk mund ta bëjmë tash për tash, sepse nuk e kuptojnë dot serbët». Me fjalë të tjera, Titoja mbronte tezën se mund të shkeleshin parimet, por s'duhej të preleshin dëshirat e serbomëdhenjve. Koha tregoi se titistët jo vetëm nuk kishin në mend ta zgjidhnin drejt çështjen e shqiptarëve të Jugosllavisë, por plani i tyre reaksionar dhe aneksionist, me afat ca më të gjatë, ishte që çështjen e shqiptarëve ta zgjidhnin globalisht, duke e futur edhe Shqipërinë socialiste në suazën e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë si një republikë të shtatë të saj. Ky plan djallëzor shovinist aneksionist është i dokumentuar.

**Gabimi i katërt i madh i Titos dhe i udhëheqjes jugosllave, lidhur me çështjen nacionale, ishte manipulimi pa skrupull dhe shovinist i pjesës së kombit shqiptar që jetonte në trojet e veta në Jugosllavi dhe përdorimi**

**i tij si plaçkë tregu për rregullimin e interesave të klaneve të ndryshme që do të formonin «Jugosllavinë e re».**

Nga komb shqiptarët u quajtën «kombësi», u bënë «minoritet» dhe si në regjimet e vjetra kapitaliste të kralëve serbë, të cilët luanin me fatin dhe të drejtat e popujve që përbënin Jugosllavinë, popullsia shqiptare që jetonte si etni e madhe në tokat e veta në Jugosllavi, të lidhura si një tërësi me kufijtë e atdheut mëmë, u nda si në pazar në tri pjesë: një pjesë, më e madhja, iu la Republikës Socialiste të Serbisë, një pjesë, për ta fuqizuar si me popullsi (këtë herë «minoritet» shqiptar), edhe me territor (kurdoherë shqiptar) iu dha Republikës Socialiste të Maqedonisë, që u krijua rishtas, dhe pjesa tjetër iu ngjiti Republikës Socialiste të Malit të Zi, republikës më miniskylë e më të varfër si në tokë, ashtu edhe në popullsi, për ta forcuar disi edhe këtë me një «minoritet» shqiptar dhe me toka shqiptare.

Pra, në sistemin «e ri» shtetëror jugosllav, shqiptarët jo vetëm u shpartalluan si unitet kompakt që ishin edhe në kohën e mbretërisë së Karagjorgjeviçëve, por vazhdoi shfrytëzimi dhe shtypja nacionale nga ana e republikave që iu ngjitën. Tash shqiptarët në çdo republikë konsideroheshin e trajtoheshin si «minoritet» ose si «kombësi», siç e pagëzuan fjalën «minoritet». Bile titistët, për të mbuluar veprimet e tyre antisocialiste në këto çështje dhe për të dhënë përshtypjen se ishin jo vetëm «parimorë», por tejparimorë, konsideruan si «kombësi» më vete edhe besimtarë, deri edhe arixinjtë nomadë.

Gjithçka në këtë drejtim synonte në dobësimin e unitetit etnik shqiptar, në pakësimin e çfarëdo të drejte kombëtare e kushtetuese që u takonte jashtë asaj që kishte vendosur triniteti serbo-kroato-sllaven ose triniteti Tito-Kardel-Rankoviç. Shqiptarët në Jugosllavi ishin vënë totalisht në pozita nënshtruese dhe vartëse nga të tjerët, nga sistemi republikan dhe nga ai federativ.

Edhe më vonë, kur rrethanat politike e kërkuan që të «liberalizohesh» disi kjo gjendje absolutisht reaksionare mbi Kosovën, duke e quajtur atë «Krahinë Autonome e Kosovës», ajo mbeti kurdoherë pjesë e Serbisë. «Autonomia» ishte një emërtim fiktiv, për galerinë.

Është e kuptueshme dhe duket qartë se nga ky ndërtim republikan dhe federativ, elementi shqiptar u përdor, në një përpjesëtim të madh, për krijimin e dy republikave të Federatës, asaj të Maqedonisë dhe të Malit të Zi. Me fjalë të tjera, në forma të reja të maskuara, gjoja socialiste, vihej në zbatim plani i vjetër serbomadhi i shpartallimit të kombit shqiptar, të formuluar aq qartë nga akademiku monarkist e më vonë titist Çubrilloviq, një shovinist i tërbuar e antishqiptar i egër.

Edhe përpjekja e dështuar titiste për ta gëlltitur edhe RPSH në suazën e Federatës Jugosllave, nuk ishte veçse një variant i ri i projektit të vjetër të dy ministrave, të serbomadhit dhe fashistit Stojadinoviç.

Çdo kërkesë legale e shqiptarëve, brenda ligjeve dhe brenda kushtetutës në fuqi, nga autoritetet jugosllave konsiderohej krim. Kundër kërkesave të ligjshme, veçanërisht të kosovarëve, është përdorur terrori e dhuna policore dhe ushtarake, gjenocidi, burgu, kampet e përqendrimit, torturat. Kështu ngjau në pragun e çlirimit të Jugosllavisë, kur Ushtria Nacionalçlirimtare Jugosllave bëri «spastrime» dhe vrau me mijëra e me mijëra kosovarë, pa bërë dallim, nën pretekstin se ishin «ballistë» shqiptarë. Që në atë kohë, për të shtuar terrorin kundër shqiptarëve, u shfrytëzua lufta kundër parullës së «Shqipërisë së madhe», parullë që vazhdon të përdoret gjerësisht edhe sot për të damkosur çdo kërkesë të drejtë të shqiptarëve që jetojnë në Jugosllavi dhe çdo mbrojtje që u bëhet nga ana e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë të drejtave të shqiptarëve që u shkelen e u merren nëpër këmbë nga jugosllavët.

Në këtë logjikë titiste, të ushqyer nga një urrejtje e thellë kundër çdo gjëje shqiptare, shqiptarët janë «nacionalistë», «shovinistë», «irredentistë», «shqiptaromëdhenj» etj., kurse vetë ata, jugosllavët, dhe veçanërisht serbët, janë «marksistë të kulluar e parimorë», që çdo gjë e kanë zgjidhur dhe e zgjidhin drejt në çdo drejtim e në çdo kohë, ata dhe vetëm ata kishin e kanë të drejtë, kishin e kanë të drejtë edhe kur shfrytëzonin e shfrytëzojnë barbarisht shqiptarët, edhe kur i vrisnin e i vrasin nëpër rrugë e nëpër kampe me shumicë, edhe kur i hidhnin e i hedhin jashtë në emigracion me qindra mijë shqiptarë! Çdo mizori nga ana e tyre përfaqësonte e përfaqëson «drejtësi» dhe çdo kërkesë drejtësie nga shqiptarët ishte dhe është «padrejtësi»!

Pas vitit 1948, serbët dhe e gjithë Jugosllavia titiste bënë një gjenocid të ri kundër shqiptarëve në Jugosllavi. Me mijëra veta të pafajshëm u vranë nga UDB-ashët e serbit Rankoviç, të tjera vrasje pasuan në vitet e mëvonshme. Qëllimi ishte t'i kallnin tmerrin popullsisë shqiptare që jetonte në Jugosllavi, ta nënshtronin atë totalisht derisa të pengonin seriozisht dhe ta reduktonin në minimum zhvillimin e gjuhës amtare shqipe, kulturën, doket, zakonet shqiptare, të zhduknin edhe historinë e tij shekullorë. I tillë ishte programi i tyre, politika e terrorit dhe e shfarosjes që përdorën titizmi dhe serbomëdhenjtë kundër shqiptarëve. Ky është një realitet që asgjë nuk e mbulon dot.

Është e kuptueshme se shqiptarët në Jugosllavi nuk iu nënshtruan këtij terrori. Por as edhe Republika Popullore e Shqipërisë nuk qëndroi duarlidhur e nuk bëri sehir. Pa ndërhyrë në punët e brendshme të Jugosllavisë, ajo e demaskoi këtë sistem shtetëror kapitalist revizionist, e demaskoi këtë politikë shovinisto-fashiste dhe mbrojtje me vendosmëri të drejtat e vëllezërve shqiptarë në Jugosllavi.

Titoja, i detyruar nga rrethanat politike të brendshme dhe të jashtme, nga dështimet e bujshme të sistemit shtetëror që po ndërtonte, dhe nga disfatat e mëdha që po pësonte në fushën ekonomike, atunë shqiptare e ka përdorur disa herë. Në fillim ai e përdori atë për të ndërtuar sistemin republikan federativ, më vonë për të dobësuar klanin serbomadh në Federatë, në vitin 1966 nëpërmjet goditjes të grupit serbomadh të Rankoviçit, më vonë të grupit të serbomadhit tjetër, Nikeziçit, për të «liberalizuar» disi frenat dhe zinxhirët që lidhnin Kosovën.

Kjo taktikë përfaqësonte periudhën e demagogjisë titiste, aq shumë të dëshiruara në atë kohë krize nga ku kalonte Jugosllavia.

Por shqiptarët në Jugosllavi nuk patën shumë iluzion, pse, çka u jepej, ishte një gjë infime përpara të drejtave të mëdha që u ishin mohuar e rrëmbyer. Megjithatë ata ditën të përfitonin nga kjo pauzë e terrorit, për të zhvilluar dijen, kulturën, shkencën, për t'u shkolluar dhe për të ngjitur, brenda ligjeve që vazhdonin të qëndronin mbi kokën e tyre si shpata e Damokleut, shkallën e humnerës ku i kishte zhytur titizmi dhe regjimi i tij barbar.

Zhvillimi i kulturës, i arsimit dhe njohja me historinë e popullit shqiptar, nuk ecnin njësoj si në Kosovë, në Maqedoni dhe në Mal të Zi. Në këto dy republikat e fundit vazhdoi e ashpër shtypja dhe cungimi në maksimum i çdo të drejte elementare, kurse në krahinën e Kosovës, pavarësisht nga varfëria e madhe ekonomike, zhvillimi i arsimit dhe i kulturës shqiptare patën një dalje të dukshme nga errësira serbomadhe që mbretëronte aty. Ndërkaq Serbia shqetësohej dhe kafshonte frenat si një kafshë e egër. Ç'po ngjiste dhe aq pak sa po ngjiste në Kosovë, Serbia shoviniste e shihte me një zemërim që e përmbante me zor, e shihte me syrin e revanshit të shovinizmit serbomadh të përhershëm.

Sistemi ekonomik jugosllav, vetadministrimi, një sistem kapitalist anarkosindikalist, kaloi nga një disfatë në tjetrën dhe arriti kulmin e një bankrute ekonomike, që solli me vete të gjitha të këqijat e një regjimi kapitalist, i cili qëndron në këmbë me lëmoshat e fuqive të mëdha. Ai krijoi kaosin ekonomik, krijoi shfrytëzuesit dhe të shfrytëzuarit, çorganizoi drejtimin shtetëror, ekonominë, tregun, jetën e gjithë Jugosllavisë, krijoi kontradiktat politike të brendshme dhe nxori më në pah rivalitetet serbo-kroato-slllovene, lindën, u zhvilluan dhe u futën në veprim kontradiktat në mes republikave e krahinave dhe lufta për hegjemoni ekonomike dhe politike brenda Jugosllavisë. Sistemi ekonomik i vetadministrimit polarizoi të pasurit dhe të varfrit në shkallën panfederative, në shkallë republike dhe krahinore, deri në bazë, në ndërmarrjet më të vogla vetadministruese. Ky sistem antisocialist solli papunësi, inflacionin e madh, ngritjen e çmimeve e shumë të këqija të tjera, që rrjedhin nga një kapitalizëm i vogël i vënë nën vartësinë e një kapitalizmi të madh botëror, i zhytur i tëri në një krizë katastrofale të superprodhimit.

I gjithë ky degjenerim ekonomik, brenda vendit solli në mënyrë të pashmangshme degjenerimin moral dhe politika e jashtme e Jugosllavisë, me ato teorizime false revolucionare, u bë një bartëse e thjeshtë e politikës së superfuqive, veçanërisht e asaj të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe e aleatëve të saj perëndimorë.

Rrezikshmëria e politikës së jashtme jugosllave do të ecte dhe eci krahas me rrezikshmërinë e politikës së superfuqive. Ajo do t'u adaptohej dhe iu adaptua situatave që krijonte në botë kjo politikë luftënxitëse e imperializmit të Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Sovjetik. Politika titiste e ashtuquajtur «jashtë blloqeve», «e paangazhuar» ishte një politikë «arriviste» me shu-

më pretendime dhe e pompuar nga kapitalizmi botëror, të cilit i interesonin si sistemi ekonomik jugosllav, që nuk kishte asgjë socialiste dhe revolucionare, ashtu edhe superstruktura e këtij pseudosistemi socialist, që ndihmonte zhvillimin e neokolonializmit, vartësinë e popujve nga zgjedha ekonomike e politike e borgjezisë kapitaliste ndërkombëtare në aleancë me borgjezinë sunduese të brendshme në vende të veçanta.

Titizmi ishte dhe është bartësi dhe qerrja që transporton kudo në botë kundërrevolucionin, oportunitetin në politikë dhe degjenerimin moral e intelektual të shoqërisë.

Në këtë Jugosllavi të çoroditur kapitaliste Kosova dhe tërësia e kombit shqiptar, që i është atashuar padrejtësisht Jugosllavisë, nga gjendja ekonomike mbeti më e varfra nga çdo republikë e krahinë tjetër. Sistemi vetadministrues në Kosovën e ashtuquajtur autonome nuk veproi, Republika Socialiste e Serbisë e pengoi jashtëzakonisht shumë zhvillimin ekonomik të Kosovës, për të mos folur për «minoritetet shqiptare» që vegjetonin në Mal të Zi dhe në Maqedoni.

Investimet e pakta që u bënë në Kosovë, synonin kryesisht nxjerrjen e lëndëve të para të nëntokës së pasur të Kosovës dhe të gjitha këto dërgoheshin në Serbi, në Kroaci dhe në Slloveni, ku përpunoheshin, pse pikërisht në këto republika ishin investuar kreditë prej miliarda dollarësh të marra nga të huajt. Kosova ishte kthyer në një koloni e republikave në fjalë, të cilat merrnin pjesën e luanit nga gjaku dhe djersa e shqiptarëve dhe këtyre u linin thërrimet. Këto thërrime ndaheshin nga elementi antishqiptar dhe titist që udhëhiqte krahinën, ndërtoheshin disa hotele luksoze, ndonjë spital ose stadium i madh dhe këto vetëm në Prishtinë dhe në ndonjë qytet tjetër, sa për t'u hedhur hi syve kosovarëve. Bujqësia ishte lënë krejtësisht pas dore. Asnjë in-

vestim nuk bëhej, papunësia ishte e madhe, çmimet ishin të pakapshme, falimentimi ishte në rend të ditës, një-rëzit e punës nuk merrnin rrogat në rregull, çdo gjë shitej me kredi, çdo gjë ishte e pasigurt si nga ana materiale, ashtu edhe nga ana politike. Mosbesimi i kosovarëve ndaj regjimit shtypës dhe shfrytëzues ishte i madh dhe thellohej çdo ditë e më shumë. Varfëria e popullit kosovar kishte arritur kulmin: me dhjetëra mijë veta linin familjet, tokën dhe merrnin rrugën e mërgimit të detyruar ekonomik në vendet kapitaliste, ku punonin në punë të rëndomta, shërbëtorë, lustraxhinj, fshesarë e punë të tjera degraduese.

Policia sekrete serbe u qëndronte kosovarëve mbi kokë, kontrollonte dhe vëzhgonte çdo fjalë dhe çdo veprim të tyre. Masat policore binin si breshër mbi kosovarët dhe ca më shumë mbi shqiptarët që mbetën në Maqedoni dhe në Mal të Zi. Por fakt është se i gjithë ky reaksion i egër serbomadhi, i gjithë ky mjerim ekonomik nuk e theu, nuk e mposhti ndjenjën e mbrojtjes, ndjenjën e kombit, ndjenjën e flaktë patriotike të shqiptarëve të Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi. Populli shqiptar dhe sidomos brezi i ri, nuk u prekën nga degjenerimi moralo-politik e shoqëror që kishte mbuluar Jugosllavinë anembanë. Faktet, ngjarjet e zhvilluara kohët e fundit në Kosovë e në viset e tjera shqiptare e treguan dhe e vërtetuan këtë realitet patriotik revolucionar që shovinizmi serbo-kroato-slloven e cilëson «kundërrevolucionar», «nacionalist», «shovinisto-shqiptaromadhi», «irredentist» e të tjera. Pikërisht këto dy botëkuptime krejtësisht të kundërta në praktikë e në teori u përplasën në demonstratat e fundit në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare. Këto demonstrata nuk janë as të parat, as të fundit, por ishin nga më të vetëdijshmet, më të organizuarat dhe më të përgjakshmet. Është plotësisht e dukshme se ato që

shkaktuan zemërimin dhe revoltimin e shqiptarëve, veçanërisht në Kosovë, krahas gjendjes së vështirë ekonomike, lënies në varfëri të viseve të banuara nga shqiptarët, ishin zhvillimi i paktë e i njëanshëm i industrisë dhe i bujqësisë, diskriminimi nacional nga ana e serbëve, maqedonasve dhe malazezve, papunësia, emigrimi në masë i detyruar në Turqi, në Evropë, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës e në kontinente të tjera. Demonstratat që u zhvilluan në të gjithë territorin e Kosovës dhe jehona e tyre edhe në shqiptarët e Maqedonisë dhe të Malit të Zi, ishin masive dhe jo sporadike ose rezultat i një «grushti kundërrevolucionarësh» të organizuar nga «irredentizmi reaksionar» i jash-tëm. Për t'i dhënë «më konsistencë» kësaj gënjeshtre, serbomëdhenjtë shtuan edhe një arsye tjetër «të madhe e të vërtetë», nxitjen nga «shovinizmi shqiptaromadhi i Tiranës»!

Të gjitha këto, që janë shpifje dhe gënjeshtra, bëheshin për të mbuluar arsyet e vërteta të demonstratave të kosovarëve dhe të justifikonin masat e përgjakshme shtypëse që ndërmori dhe vazhdon të marrë me një intensitet të egër UDB-ja, ushtria dhe policia e fshehtë jugosllave.

Kërkesat e punëtorëve, të studentëve, të mësuesve, të profesorëve dhe të të gjithë popullit të Kosovës ishin kërkesa ekonomike dhe politike. Ato ishin të ligjshme, brenda kushtetutës jugosllave. Të drejtat e shqiptarëve ishin shtypur dhe ishin marrë nëpër këmbë, vazhdonte diskriminimi ekonomik dhe politika nën petkun e vetad-ministrimit, gjë që në realitet siguronte administrimin dhe shfrytëzimin ekonomik e politik të Kosovës nga RS e Serbisë dhe republikat e tjera dhe jo nga vetë kosovarët.

Në një gjendje të tillë shpirtërore, ekonomike dhe në këtë diskriminim politik demonstruesit kërkuan statusin e republikës për krahinën e tyre.

**Kjo kërkesë e natyrshme dhe e drejtë si për nga sasia e popullsisë, ashtu dhe nga faktorët e tjerë që për-bëjnë një komb, si nga forma ligjore dhe kushtetuese, për të qëndruar si republikë brenda Federatës, u shtyp me egërsi dhe u mbyt në gjak. Ky ishte gabimi i pestë i madh i udhëheqjes reaksionare të RSFJ dhe veçanërisht i serbomëdhenjve.**

Në qoftë se ndiqet zhvillimi dialektik i formimit të RSFJ dhe analizohen gabimet që janë bërë njëra pas tjetrës kundër shqiptarëve në Jugosllavi, medoemos do të arrihet në aktin e fundit të dramës, ku duket e tërë intriga e saj.

Çdo gjë tregon se vendimet e para «kushtetuese» që u morën nga udhëheqja e Partisë Komuniste të Jugosllavisë, në formë dukeshin «të drejta». Ato të krijojnë përshtypjen se çdo gjëje, si çështjes së republikave, të Federatës, të kombeve dhe të pakicave kombëtare në mbarimin e luftës do t'u jepej zgjidhje e drejtë, në rrugë marksiste-leniniste. Por nuk ndodhi kështu. Parimet u shkelën. Çdo gjë u zgjidh nga lart në mënyrë të gabuar në bazë të disa vendimeve antimarksiste. Popujt e Jugosllavisë do të formonin secili nga një republikë më vete, pse ata ishin «kombe», ndërsa popujt e tjerë, siç ishte populli shqiptar, që atdheun e tyre mëmë e kishin jashtë kufijve të Jugosllavisë së kralëve serbë ose Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, që u krijua pas luftës, do të quheshin «pakica», ose «kombësi», kështu u kategorizuan ato që të mos dukej hileja, nuk kishin të drejtë të formonin republikë.

Në bazë të dokumenteve që njihen gjatë kohës së luftës dhe fill pas Çlirimit, për përcaktimin e këtyre problemeve të mëdha duhet të ketë pasur debate në udhëheqjen e Partisë Komuniste të Jugosllavisë. Moshe Pijade, për shembull, ka qenë dhe ka propozuar që shqiptarët që jetojnë në Jugosllavi e që ishin afro 2

milione veta, të formonin një republikë. Kjo, siç u duk, nuk u pranua, pse, në qoftë se bëhej kjo dhe ndiqej parimi «i vetëvendosjes deri në shkëputje», do të arrihej në aprovimin e vendimit të Konferencës së Parë Nacionalçlirimtare të Kosovës e të Metohisë që u mbajt në Bujan, domethënë jo vetëm që i gjithë territori shqiptar në Jugosllavi duhej të formonte një republikë më vete, por, në qoftë se vendosej parimi i vetëvendosjes, kjo do të thoshte bashkim me Shqipërinë.

Këtu u shkel parimi socialist dhe jo vetëm kaq, por u shkua edhe më tej, u kalua, siç thamë, nga gabimi në gabim: entiteti shqiptar u nda në tri pjesë nga lart pa pyetur njeri. Në emër të «socializmit» u kalua edhe tej gjendjes së kohës së monarkisë kur shqiptarët ishin një popull i shtypur, por në një njësi unike.

Udhëheqja jugosllave e dalë nga lufta nacionalçlirimtare nuk mori aspak parasysh edhe faktin tjetër me rëndësi të madhe: Shqipërinë socialiste që luftoi kundër okupatorëve nazifashistë, fitoi lirinë dhe pavarësinë e që dërgoi edhe ushtritë e saj për të ndihmuar në çlirimin e popujve të Jugosllavisë. Pra, si Shqipëria edhe Jugosllavia ishin në pozita të barabarta, prandaj, në qoftë se do të ndiqej rruga e vërtetë e zgjidhjes së drejtë, marksiste-leniniste, formimi i «një republike të dytë të shqiptarëve» në Jugosllavi, përkrah Republikës Popullore të Shqipërisë, jo vetëm që s'duhej të kishte vend, por tokat e shqiptarëve, të aneksuara padrejtësisht Jugosllavisë së vjetër, duhej t'i ktheheshin Shqipërisë së re demokratike dhe aleate e popujve të Jugosllavisë. Nuk u bë as njëra, as tjetra, përkundrazi, tokat shqiptare, dhe popullsia shqiptare në Jugosllavi u nxorën në ankand dhe u ndanë sipas vendimeve nga lart për të rregulluar proporcionet e republikave të tjera. U veprua kështu edhe pse çështja shqiptare nuk kishte ngjasi me pakicat e tjera kombëtare në Jugosllavi, që ishin të vogla, sido-

mos me hungarezët e Vojvodinës ose me pakicën rumune ose turke që jo vetëm ishin me të vërtetë pakica, por atdheu mëmë i tyre ishte bërë mbështetje e nazistëve gjermanë.

Titoja, në bisedimet që pati me mua në vitin 1946 për çështjen e Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi, me fjalë të rreme la të kuptohet se zgjidhja që ishte vendosur ishte e përkohshme, ndërsa kjo jo vetëm s'ishte kështu, por siç kam thënë edhe më lart, Titoja dhe bashkëpunëtorët e tij shovinistë kishin plane të tjera të fshehta akoma më të avancuara e më anti-shqiptare: të krijonin një republikë të shtatë brenda Federatës, ku të inkludohej edhe Shqipëria. Kështu për ta «zgjidhej» një herë e «mirë» problemi për të gjithë shqiptarët.

Për realizimin e këtyre planeve punuan emisarët e Titos që nga Tempoja e Velimir Stoiniçi, Rankoviçi me agjenturën e tij, Koçi Xoxen, Pandi Kriston e të tjerë. I gjithë ky plan djallëzor dështoi dhe u demaskua keqas në sajë të vigjilencës së Partisë sonë, të qëndrimit të saj të vendosur e heroik.

Shqipëria socialiste shpëtoi nga një rrezik i madh, por gjendja në Kosovë dhe në viset e tjera të banuara nga shqiptarët në Jugosllavi u rëndua pa masë. Kosova mbeti një krahinë e shtypur e Serbisë dhe pjesa tjetër, në Maqedoni e në Mal të Zi, pësoi po të njëjtin fat.

Siç dihet, rrethanat dhe rivalitetet në mes Titos dhe grupit serbomadsh shkaktuan rrëzimin e Rankoviçit dhe dhënien Kosovës të statusit të krahinës «autonome», por kurdoherë nën Serbinë. Me këtë, fare pak gjëra ndryshuan për shqiptarët. Pati vetëm një «liri» pak më të madhe në zhvillimin e arsimit dhe të kulturës dhe asgjë tjetër. Por edhe ky zhvillim dhe kjo e drejtë e cunguar, para demonstratave të fundit në Kosovë dhe një vit pas vdekjes së Titos u duk qartë se nuk ishin aspak të dë-

shiruara për serbomëdhenjtë. Goditjet në Kosovë treguan fytyrën e vërtetë të shovinizmit serb, egërsinë shekullore të tij kundër shqiptarëve, kulturës dhe zhvillimit të tyre të shumanshëm. Por këto demonstrata treguan pjekurinë dhe guximin e shqiptarëve për të kërkuar statusin e republikës brenda RSFJ dhe mbrojtjen e tyre si komb me të drejta të barabarta si kombet e tjera të RSFJ, mbrojtjen e lirive e të drejtave politike, ekonomike dhe kulturore brenda sistemit ekzistues të vetadministrimit. Të gjitha këto kërkesa ligjore u quajtën «kundërrevolucionare», «irredentiste», «nacionaliste» etj. dhe se gjoja kishin për qëllim shkatërrimin e Federatës. Në fakt këto akuza ishin false dhe tregonin se bazat e Federatës ishin të dobëta dhe të ndërtuara shumë keq, pse ishin baza nacionaliste dhe shoviniste.

Titistët serbomëdhenj nuk munguan të akuzonin RPSSH si faktori kryesor i ngjarjeve në Kosovë. Marrëdhëniet arsimore dhe kulturore të vendosura zyrtarisht dhe bashkërisht midis nesh dhe Kosovës, ata i cilësuan si punë «subversive nacionaliste» nga ana jonë dhe «mungesë» vigjilence nga ana e serbëve. As njëra, as tjetra nuk ishin e nuk janë të vërteta. E vërteta është se me veprimet e egra kundër kosovarëve e gjithë shqiptarëve në Jugosllavi dhe shpifjet e sulmet kundër RPSSH, ata dënonin gjestin «liberal të Titos» ndaj Kosovës dhe vinin përsëri në zbatim ligjin rankoviçian kundër shqiptarëve.

Çështja e Kosovës është një tragjedi. Ne do të mbrojmë të drejtat legjitime të vëllezërve tanë dhe kjo nuk është ndërhyrje në punët e brendshme të Jugosllavisë.

POGRADEC, E ENJTE

2 KORRIK 1981

## ÇËSHTJA E KOSOVËS DHE E TOKAVE SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI

### Shënime<sup>1</sup>

Kur flasim për Kosovën dhe kosovarët nuk kemi parasysh vetëm atë, si krahinë gjeografike, por çështjen e të gjitha tokave dhe të të gjithë shqiptarëve që jetojnë brenda kufijve aktualë të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, ngjitur me kufijtë e atdheut mëmë, Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Në kuptimin më të gjerë e më të plotë këtu është fjala për Shqipërinë dhe për shqiptarët si komb që përbën një problem historik, politik, ekonomik dhe etnik të vetëm. Populli shqiptar ka etnogjenezën dhe formacionin e vet kombëtar të përcaktuar në shekuj, të gjitha tiparet e duhura të një kombi, ka historinë, zhvillimin ekonomik, kulturën dhe zakonet e veta kombëtare shumëshekullore, politikën e tij etj.

Ky është një realitet i pakundërshtueshëm si në planin historik, ashtu edhe në atë politik.

Problemi i shqiptarëve që jetojnë në tokat e tyre në Jugosllavi, nuk është problem i një «minoriteti», i ardhur apo i vendosur diku në një zonë vakuum si emigracion ekonomik, as i shkaktuar nga dyndja e Pe-

<sup>1</sup> Këto shënime, me disa shkurtime, shoku Enver Hoxha i ka përdorur në raportin e Kongresit të 8-të të PPSH.

shiruara për serbomëdhenjtë. Goditjet në Kosovë treguan fytyrën e vërtetë të shovinizmit serb, egërsinë shekullore të tij kundër shqiptarëve, kulturës dhe zhvillimit të tyre të shumanshëm. Por këto demonstrata treguan pjekurinë dhe guximin e shqiptarëve për të kërkuar statusin e republikës brenda RSFJ dhe mbrojtjen e tyre si komb me të drejta të barabarta si kombet e tjera të RSFJ, mbrojtjen e lirive e të drejtave politike, ekonomike dhe kulturore brenda sistemit ekzistues të vetadministrimit. Të gjitha këto kërkesa ligjore u quajtën «kundërrevolucionare», «irredentiste», «nacionaliste» etj. dhe se gjoja kishin për qëllim shkatërrimin e Federatës. Në fakt këto akuza ishin false dhe tregonin se bazat e Federatës ishin të dobëta dhe të ndërtuara shumë keq, pse ishin baza nacionaliste dhe shoviniste.

Titistët serbomëdhenj nuk munguan të akuzonin RPSSH si faktori kryesor i ngjarjeve në Kosovë. Marrëdhëniet arsimore dhe kulturore të vendosura zyrtarisht dhe bashkërisht midis nesh dhe Kosovës, ata i cilësuan si punë «subversive nacionaliste» nga ana jonë dhe «mungesë» vigjilence nga ana e serbëve. As njëra, as tjetra nuk ishin e nuk janë të vërteta. E vërteta është se me veprimet e egra kundër kosovarëve e gjithë shqiptarëve në Jugosllavi dhe shpifjet e sulmet kundër RPSSH, ata dënonin gjestin «liberal të Titos» ndaj Kosovës dhe vinin përsëri në zbatim ligjin rankoviçian kundër shqiptarëve.

Çështja e Kosovës është një tragjedi. Ne do të mbrojmë të drejtat legjitime të vëllezërve tanë dhe kjo nuk është ndërhyrje në punët e brendshme të Jugosllavisë.

POGRADEC, E ENJTE

2 KORRIK 1981

## ÇËSHTJA E KOSOVËS DHE E TOKAVE SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI

Shënime<sup>1</sup>

Kur flasim për Kosovën dhe kosovarët nuk kemi parasysh vetëm atë, si krahinë gjeografike, por çështjen e të gjitha tokave dhe të të gjithë shqiptarëve që jetojnë brenda kufijve aktualë të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, ngjitur me kufijtë e atdheut mëmë, Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Në kuptimin më të gjerë e më të plotë këtu është fjala për Shqipërinë dhe për shqiptarët si komb që përbën një problem historik, politik, ekonomik dhe etnik të vetëm. Populli shqiptar ka etnogjenezën dhe formacionin e vet kombëtar të përcaktuar në shekuj, të gjitha tiparet e duhura të një kombi, ka historinë, zhvillimin ekonomik, kulturën dhe zakonet e veta kombëtare shumëshekullore, politikën e tij etj.

Ky është një realitet i pakundërshtueshëm si në planin historik, ashtu edhe në atë politik.

Problemi i shqiptarëve që jetojnë në tokat e tyre në Jugosllavi, nuk është problem i një «minoriteti», i ardhur apo i vendosur diku në një zonë vakuum si emigracion ekonomik, as i shkaktuar nga dyndja e Pe-

<sup>1</sup> Këto shënime, me disa shkurtime, shoku Enver Hoxha i ka përdorur në raportin e Kongresit të 8-të të PPSH.

randorisë Osmane dhe as nga rritja e natyrshme demografike e shqiptarëve që i shqetëson Maltusët e rinj serbomëdhenj. Shqiptarët në Jugosllavi përbëjnë një etni, një popull të formuar në shekuj, që ka historinë, gjuhën, kulturën e vet, një popull autokton, të cilin, siç dihet, fuqitë e mëdha imperialiste e copëtuan, e shkëputën nga mëmëdheu i vet dhe ia aneksuan Jugosllavisë. Këtë askush nuk mund ta fshehtë. Çdo interpretim tjetër i këtij problemi e i kësaj çështjeje është arbitrar, është një shtrembërim, një falsifikim i rëndë e i dëmshëm i historisë. Prandaj problemi i kombit shqiptar, i popullit shqiptar dhe veçanërisht i shqiptarëve në Jugosllavi, që janë një pjesë e madhe përbërëse e popullit shqiptar, ka qenë dhe është një problem i vetëm historik.

Populli shqiptar ka luftuar pa pushim e në shekuj kundër armiqve të egër e shumë më të mëdhenj në numër. Në të gjitha këto luftëra shekullore, humbjesh e fitoresh, vite robërie, populli shqiptar asnjëherë në historinë e tij nuk e humbi qenien e vet si komb. Përkundrazi, në çdo rrethanë e ka manifestuar atë me një vitalitet të jashtëzakonshëm e shembullor. Ai nuk e humbi as unitetin e tij dhe as qenien e vet si një shtet në formim dhe në zhvillim.

Perandoritë botërore dhe fuqitë e mëdha nuk e zhdokën dot etninë kompakte të shqiptarëve, as nuk mundën ta asimilonin, t'i ndërrojnë kulturën, gjuhën, doket dhe zakonet. Këtë e vërteton vetë qenia e popullit shqiptar. Historia tregon se, i vetëm, pa asnjë përkrahje nga fuqi të huaja, të cilat i ka pasur kurdoherë kundër, ai ka rezistuar dhe ka luftuar me sukses për lirinë e kombit të vet dhe për kompaktësinë e tij, ka luftuar për mbrojtjen e pavarësisë si shtet sovran, të kulturës së tij dhe të të drejtave të tij të natyrshme e të ligjshme. Kurdoherë vetëm lufta dhe gjaku i tij i derdhur kanë bërë që të arrihej fitorja.

Në Luftën e Dytë Botërore populli shqiptar dhe popujt e Jugosllavisë luftuan së toku e në aleancë të ngushtë armësh kundër pushtuesve fashistë italianë e gjermanë. Edhe shqiptarët që jetonin në Jugosllavi, luftuan me heroizëm tok me ne dhe me të gjithë popujt e Jugosllavisë kundër të njëjtëve armiq. Jo vetëm luftuan së toku, por Ushtria jonë Nacionalçlirimtare u shkoi në ndihmë partizanëve jugosllavë e vëllezërve kosovarë dhe në tokat e tyre derdhi gjakun e bijve e të bijave të popullit shqiptar. Ne vepruam siç na mësonte Partia Komuniste e Shqipërisë, me ndërgjegje e me frymë të lartë internacionaliste. Ne mendonim se kështu do të arrihej fitorja e çlirimit nga popujt e të dy vendeve tona, do të zhdukej robëria dhe do të ndreqeshin gabimet tragjike të historisë së kaluar. Ne besonim se pas fitores çdo gjë do të zgjidhej në rrugën marksiste-leniniste. Garanci për këtë ishin partitë komuniste që udhëhiqnin Luftën Nacionalçlirimtare në të dy vendet. Por bindja jonë te «komunizmi e internacionalizmi» i udhëheqësve jugosllavë, besimi te fjalët e tyre nuk u vërtetuan. Në fakt, udhëheqja e Partisë Komuniste të Jugosllavisë nuk e shikoi kurrë drejt e në rrugë marksiste-leniniste çështjen e së ardhmes së shqiptarëve në Jugosllavi, prandaj edhe do ta zgjidhte, siç e zgjidhi gabim e shtrembër, në rrugë nacionaliste dhe shoviniste, plotësisht antimarksiste.

Zgjidhja e gabuar e kësaj çështjeje të madhe e parimore filloi që në mbledhjen e dytë të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar të Jugosllavisë, mbajtur në Jajcë në nëntor të vitit 1943, ku viset shqiptare në Jugosllavi u përdorën si një mjet për të rregulluar përmasat tokësore e të popullsisë së republikave të Federatës, veçanërisht të Serbisë, të Maqedonisë dhe të Malit të Zi. E ardhmja e shqiptarëve të Jugosllavisë u vendos *a priori* nga lart, pa aprovimin dhe vetëvendosjen e popullit

shqiptar të Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi dhe pa as më të voglin konsultim me aleaten e popujve të Jugosllavisë, e interesuar drejtpërsëdrejti në këtë çështje, Shqipërinë popullore. Udhëheqja e Partisë Komuniste të Jugosllavisë, në kundërshtim me «politikën e barazisë nacionale» të shpallur në mbledhjen e dytë të AVNOJ-t në Jajcë, shkeli pa të drejtë vullnetin e shqiptarëve në Jugosllavi, të shprehur në mbledhjen themelvënëse të Konferencës së Parë të Këshillit Nacionalçlirimtar për Kosovën dhe Metohinë, mbajtur në Bujan më 31 dhjetor 1943 deri më 2 janar 1944, që ishte në përputhje me të drejtën e «vetëvendosjes deri në shkëputje» të popujve që përbënin Jugosllavinë dhe që ishte përcaktuar në dokumentet themelore të Partisë Komuniste e të Lëvizjes Nacionalçlirimtare Jugosllave.

Për sa i përket konsultimit me Shqipërinë popullore për zgjidhjen e këtij problemi historik, udhëheqja jugosllave e quante *a priori* të panevojshëm. Ajo ishte kundër një konsultimi të tillë, pse e dinte që një diskutim parimor, marksist-leninist e miqësor në mes udhëheqjeve të të dy vendeve tona, duke marrë parasysh edhe vullnetin e lirë të shqiptarëve që banonin në trojet e tyre në Jugosllavi, do të çonte në një zgjidhje të drejtë dhe aspak shovinisto-arbitrare e nacionaliste si ajo që ndërmoi udhëheqja jugosllave.

Ky është gabimi bazë, themelor me karakter nacionalist e shovinist i udhëheqjes revizioniste jugosllave që u pasua nga gabime të tjera po aq të rënda në lidhje me zgjidhjen e çështjes nacionale, të ardhmen e shtetit të ri të Jugosllavisë, dhe në këtë kuadër edhe me të drejtat e ligjshme e të natyrshme të shqiptarëve, të cilët akuzohen tani nga serbomëdhenjtë si «shovinistë», «nacionalistë» e «irredentistë». Në këtë zgjidhje shumë të gabuar dhe antileniniste të çështjes nacionale në Jugosllavi dhe sidomos të entitetit shqiptar prej afro 2 mi-

lionë banorësh, gati sa gjithë popullsia e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, e kanë burimin ngjarjet e kohëve të fundit në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare në Jugosllavi.

Problemi nacional, në mënyrë të veçantë, shumë i komplikuar nga rrethanat dhe zhvillimet e historisë, kurrë nuk mund të gjejë zgjidhje të drejtë veçse në një shoqëri të re socialiste, vetëm nga një frymëzim dhe zbatim rigoroz i ideologjisë marksiste-leniniste. Asnjëri nga këta faktorë determinantë nuk ekzistonte në Jugosllavi, prandaj edhe problemi nacional, në kuadër të gjerë e në kuadër të ngushtë, as u zgjidh dhe as mund të zgjidhej e të zgjidhet në rrugë të drejtë. Ky është një realitet i pakontestueshëm, pavarësisht nga betimet për konsum publik të krerëve titistë.

Shovinizmi serb, malazez e ai maqedonas që në fillim ndoqën ndaj shqiptarëve një politikë nacionaliste të egër, shtypëse e diskriminuese, në të gjitha drejtimet, në arsim, në kulturë, në ekonomi etj.

Edhe në periudhën kur në mes vendit tonë dhe Jugosllavisë dhe të dy partive kishte marrëdhënie të mira, problemi i shqiptarëve në Jugosllavi ishte një «gjyle hekuri» në këmbët e jugosllavëve. Kërkesat e pakënaqësitë e shqiptarëve as nuk shqyrtoheshin, as nuk zgjidheshin politikisht në rrugën e mirëkuptimit, por me dhunë, me masa të egra administrative. Shqiptarët akuzoheshin për nacionalizëm dhe kjo, natyrisht, bëhej për të fshehur shovinizmin dhe nacionalizmin serb. Asgjë nuk mund t'i mbulojë e t'i justifikojë raprezaljet e përgjakshme kundër shqiptarëve më 1945, më 1966 e përsëri më 1981, diskriminimin e tyre, lënien në varfëri, shtypjen nacionale, mohimet e dallimet e mëdha në fushën e arsimit dhe të kulturës në Kosovë e në viset e tjera shqiptare në Jugosllavi. Rënia në fatkeqësi e grupit serbomadhtë Rankoviçit, e më vonë e grupit tjetër serbomadhtë

Nikeziçit, shënojnë periudhën e demagogjisë politike të titistëve ndaj Kosovës dhe kosovarëve. Nevoja për balancimin e forcave të ndryshme brenda Federatës, çoi në njëfarë rishikimi formal të statusit të Kosovës, e cila nga krahinë e thjeshtë e Serbisë, u emërtua krahinë «autonome» e saj.

Me dashje ose pa dashje të serbëve, kjo situatë e re u dha mundësi shqiptarëve në Jugosllavi, dhe sidomos kosovarëve, të zgjerimin arsimin, të ngrinin Universitetin e Prishtinës, të zhvillonin kulturën, të mësonin historinë e popullit të tyre, të vendosnin kontakte dhe marrëdhënie arsimore-kulturore dhe ekonomike me Shqipërinë, në bazë të ligjeve të Federatës dhe të marrëveshjeve zyrtare midis Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë. Por baza ekonomike e Krahinës Autonome Socialiste të Kosovës mbeti përsëri shumë e dobët, u la pas dore. Pasuritë e saj përsëri u shfrytëzuan pa skrupull nga republikat e tjera të Federatës, sidomos nga Serbia. Të gjitha «zgjdhjet» që u paraqitën me bujë të madhe gjatë kësaj periudhe ishin të shpëllara, ishin koniunkturale e të dobishme për Beogradin dhe Shkupin. Sipas rastit, pa u thënë hap-tazi, ato konsideroheshin ose si «lëshime oportuniste të Titos», siç ndodhte me serbët, ose si «fitore të arritura në sajë të Titos», siç trumbetoheshin nga udhëheqës shqiptarë të Krahinës Autonome Socialiste të Kosovës. Ndërsa masat e shqiptarëve nuk patën shumë iluzione, pse ajo çka u jepej ishte një gjë infime përpara të drejtave të mëdha që u ishin mohuar e rrëmbyer.

Ngjarjet që kanë ndodhur pas vdekjes së Titos kanë treguar se sa gabim e në ç'rrugë antimarksiste ishte zgjidhur çështja nacionale në Jugosllavi dhe veçanërisht çështja e shqiptarëve. Kërkesave të tyre të ligjshme brenda kushtetutës, iu dha një grusht i rëndë dhe i përgjakshëm nga ana e udhëheqjes shoviniste serbe dhe

e të gjithë udhëheqjes jugosllave pas demonstratave që u bënë në Kosovë në mars e në prill të këtij viti. Tash më shumë se kurdoherë tjetër mbi kosovarët dhe gjithë shqiptarët në Jugosllavi, përveç gjendjes ekonomike të mjeruar që i ka mbuluar, rëndon edhe shtypja e egër nacionale. Mbi ta është vendosur ligji i terrorit policor, janë derdhur policia, milicia dhe ushtria serbe, burgjet janë mbushur plot me të rinj e të reja. Masat që janë marrë e po merren, shkojnë jo vetëm drejt zhdukjes së çdo të drejte të ligjshme, por edhe drejt shkombëtarizimit të shqiptarëve në Jugosllavi. Sot kërkesa të tilla janë publike, bëhen në instancat më të larta republikane e federative të Jugosllavisë e nga personalitete zyrtare serbe e jugosllave nga më të lartat. Nga shqiptarët vetëm kush flet pro shovinizmit serbomadh, ka të drejtë të hajë një krodhë bukë në RSFJ të vetadministruar.

Ç'kërkuan, në fund të fundit, shqiptarët në demonstratat masive që u zhvilluan në qytete e fshatra të ndryshme në Kosovë?

Shqiptarët në Jugosllavi më se një herë, me demonstrata paqësore dhe pa demonstrata, kanë kërkuar që gjendja e tyre kushtetuese, ekonomike dhe social-kulturore, të ndreqej, të vihej në rrugë të drejtë, brenda ligjeve të Federatës, ata kërkuan të kenë statusin e republikës brenda RSFJ. Ata në asnjë mënyrë, gjatë këtyre demonstratave, nuk kanë dashur të arrihej në situatat në të cilat i çoi punët udhëheqja revizioniste serbe dhe RSFJ, ata nuk kërkuan as shkëputjen nga Federata, as bashkimin me Shqipërinë. Por kërkesave të drejta e të ligjshme të studentëve, punëtorëve, fshatarëve e intelektualëve kosovarë, as ua vuri veshin kush. Jo vetëm kaq, por ata si edhe herë të tjera kur kanë paraqitur kërkesa të tilla të ligjshme e të drejta, u cilësuan si nacionalistë, u persekutuan dhe u mbytën në gjak. Asnjë zgjidhje politike nuk u është dhënë këtyre

kërkesave dhe as që mund t'u jepej, në rast se bisedohet jo si midis të barabartëve, por si midis padronit të plotfuqishëm dhe çirakut të tij të bindur. Asnjëherë e për asgjë themelore nuk është marrë mendimi i drejt-përdrejtë i popullit shqiptar që jeton në Jugosllavi. Kurdoherë është marrë mendimi i aristokracisë së re titiste të Kosovës.

Por a mund të zgjidhen kështu këto probleme në kohën tonë? Kurrresi. Është e pamundur të mbahet në varfëri e në mjerim një popull, toka e të cilit është e begatë dhe grabitet nga të tjerët. Është e pamundur të mbash nën frikën e tankeve e të bajonetave një popull trim si shqiptarët. Është e pamundur ta shtrembërosh ose ta zhdukësh historinë dhe kulturën e tij të lashtë. Është e pamundur t'ia zhdukësh ndjenjën patriotike dhe dashurinë për mëmëdheun. Jugosllavët të gjitha kërkesat e shqiptarëve në këto drejtime i quajnë nacionalisto-shoviniste-irredentiste, kurse veprimet e egra shtypëse të vetat i quajnë «socialiste», humane! Kjo është me të vërtetë e çuditshme!

Nuk e shohim të arsyeshme të bëjmë këtu krahasime historike, siç bëjnë shpesh krerët serbomëdhenj dhe shërbëtorët e tyre kur ne mbrojmë të drejtën e vëllezërve tanë shqiptarë në Jugosllavi. Por theksojmë se opinioni publik botëror i gjykon ato mbështetur në faktet dhe qëndrimet e çdo pale, ndërsa historia i regjistron e i përjetëson për t'ua treguar brezave të ardhshëm. Krahasimet i bën vetë jeta dhe pikërisht këto krahasime janë therëse e dërrmuese për jugosllavët.

E kemi thënë hapur dhe e përsëritim se po të ecet në rrugën që ka zgjedhur dhe po ndjek udhëheqja aktuale jugosllave, kundërshtimet e shqiptarëve do të vazhdojnë, do të rriten dhe do të acarohen akoma më shumë. Vetëm një zgjidhje e menduar mirë e çështjes nacionale, pa pasione nga të dyja palët, një zgjidhje që të

pranohet e të aprovohet nga populli i Kosovës e likuidon këtë situatë shumë të ndërlikuar, të cilën e kanë krijuar jo kosovarët, por shovinizmi serbomadh. Kosovarët dhanë zgjidhjen më të drejtë e më të përshtatshme në këto situata të vështira për Jugosllavinë dhe për veten e tyre. Kërkesa për t'i njohur Kosovës statusin e republikës brenda Federatës, është një kërkesë e drejtë, ajo nuk e cenon ekzistencën e Federatës. Krerët serbë e jugosllavë në vend që të arsyetonin, dërguan tanket, gjakosën popullin dhe tash po zhvillojnë në shkallë të gjerrë të famshmin diferencim, domethënë hetimin policor: kush ishte pro e kush kundër demonstratave. Kjo mënyrë veprimi, më parë me terror, pastaj gjoja me diferencim, do të thotë të përpiqesh të frikësosh masat, që nuk frikësohen, të zhdukësh patriotizmin, që nuk zhduket, të kesh iluzionin se ke qetësuar gjendjen, por ke ngjallur mërinë dhe zemërimin, të mendosh se ke sjellë «njerëz të besuar» në pushtet, të cilin e ke spastruar nga «nacionalistët» etj., por ke hedhur të gjithë popullin në rezistencë të heshtur, që nesër më me forcë do ta ngrejë zërin kundër mizorive që po i bëhen. Këtë situatë s'duan ta kuptojnë udhëheqësit jugosllavë, dhe cilindo që i këshillon se këto probleme nuk mund të zgjidhen kurrë me terror dhe me dhunë, e akuzojnë «për ndërhyrje në punët e tyre të brendshme» edhe pse ato nuk janë vetëm të tyret dhe kanë konsekuenca të rrezikshme edhe për të tjerët. Qëndrimet jo vetëm të paarsyeshme, por tmerrësisht të gabuara ndaj ngjarjeve në Kosovë, sollën rrezikun e madh të rishfaqjes dhe të acarimit të kontradiktave në mes shqiptarëve dhe serbëve. Sigurisht këto armiqtësi e kontradikta kanë ekzistuar prej kohësh, dhe dihet ku e kanë burimin: në mbrojtjen e një kauze të padrejtë nga ana e jugosllavëve dhe në shovinizmin e madh që vërshon si një lumë me «dallgë të mëdha e mbytëse».

Tash, pse ne i themi hapur këto të vërteta dhe kërkojmë me insistim që ky problem i zgjidhur gabim të ristudiohet me gjakftohtësi dhe të mos shkohet në dhunë e në terror, pse kërkojmë t'u jepet fund persekutimeve dhe të lirohen djemtë dhe vajzat kosovare, na quajnë «shovinistë» dhe Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë e akuzojnë se ndërhyjnë në punët e brendshme të Jugosllavisë, bile atë e akuzojnë se nxit turbullirat në Kosovë e gjetkë! Dhe si i nxit ajo këto turbullira? Njëpërmjet marrëdhënieve arsimore e kulturore zyrtare! Shkohet deri atje sa të thuhet se Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë bën kauzë të përbashkët me reaksionin politik shqiptar në mërgim, të cilin ne e kemi luftuar dhe e luftojmë me të gjitha forcat tona.

Asnjëherë nuk kemi ndërhyrë në punët e brendshme të Jugosllavisë. E kundërta ka ndodhur nga ana e Jugosllavisë. Revizionistët jugosllavë komplotuan për likuidimin e udhëheqjes së Partisë Komuniste të Shqipërisë dhe për inkuadrimin e Shqipërisë në Federatën Jugosllave si republikë të shtatë të saj, duke menduar që me këtë zgjidhnin një herë e mirë dhe në rrugë aneksoniste e imperialiste problemin e gjithë kombit shqiptar. Por këto komplete as u realizuan, as do të realizohen ndonjëherë. Shqipëria s'është e s'do të bëhet kurrë një mjet rregullimi për të qetësuar konfliktet e kontradiktat midis klaneve jugosllave. Ajo sot ka zot popullin e saj, një popull që për nga vitaliteti, trimëria dhe atdhedashuria s'do t'ia dijë nga askush.

Shqipëria nuk ka bërë ndonjëherë rivendikime tokësore ndaj Jugosllavisë, asnjë kërkesë për rektifikim kufijsh nuk gjen në dokumentet tona. Por kemi deklaruar dhe deklarojmë solemnisht se duke shtruar problemin kështu dhe duke mbajtur këtë qëndrim, s'kemi mohuar dhe as do të mohojmë kurrë faktin se në Jugoslla-

vi rron një pjesë e madhe e kombit dhe e popullit shqiptar. Në këtë kuptim ne kemi mbrojtur dhe do të mbrojmë edhe në të ardhmen, me të gjitha forcat e në rrugën marksiste-leniniste, të drejtat e ligjshme të vëllëzëve tanë shqiptarë matanë kufirit dhe kjo nuk është ndërhyrje në punët e brendshme të Jugosllavisë. Kjo është e drejta jonë e pamohueshme.

Ekziston edhe një e vërtetë tjetër. Pas luftës, në vitin 1946, një delegacion i vendit tonë, që kryesoja unë, bëri vizitën e parë zyrtare në Jugosllavi. Në bisedimet zyrtare që u zhvilluan me këtë rast me Titon, ky i fundit kërkoi të dinte se ç'mendoja unë për zgjidhjen e çështjes së Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi. Unë i dhashë mendimin e palës shqiptare se Kosova dhe viset e tjera të banuara nga shqiptarët i përkasin Shqipërisë dhe duhet t'i kthehen kësaj. Shqiptarët luftuan që të ketë një Shqipëri të lirë e sovranë, së cilës tani duhet t'i bashkohen edhe viset shqiptare të Jugosllavisë. Presidenti Tito u përgjigj: «Jam dakord me pikëpamjen tuaj, por tash për tash nuk mund ta bëjmë dot këtë gjë, sepse serbët nuk do të na kuptojnë». Ky premtim zyrtar i Titos për këtë problem të madh e parimor nuk u shoqërua me asnjë veprim të mëtjetshëm nga ana e jugosllavëve. Çdo gjë ishte mashtrim nga ana e tyre. Bile Josip Brozi as nuk më ftoi që me këtë rast të veja e të vizitoja Kosovën, por më çoi të shikoja Kroacinë e Slloveninë. A ka këtu sinqeritet, qëllime të mira, qëndrim komunist? Jo. Përkundrazi, hipokrizi dhe përpjekje për të mbuluar krimet e kryera, shkeljen e të drejtave të një populli të tërë dhe për të fshehur komplotet për të ardhmen. Titoja dhe klika e tij shoviniste e mësuan qëndrimin e hapur të udhëheqjes shqiptare ndaj problemit të shqiptarëve në Jugosllavi, pra ndaj në asnjë mënyrë nuk deshën që kjo udhëheqje të takohej me vëllëzërit shqiptarë në Jugosllavi e të më-

sonde nga goja e tyre problemet që i shqetësonin dhe t'u thoshte atyre qëndrimin e vet të vendosur përkrah të drejtave të tyre.

Ja përse ne kemi thënë e themi se gjithë periudha e marrëdhënieve «të mira» me Jugosllavinë ka qenë periudha e kompleteve të jugosllavëve kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe kjo në të gjitha fushat.

Prishja e miqësisë midis Shqipërisë e Jugosllavisë e ka burimin pikërisht në politikën me qëllime të këqija dhe në komplotet e rrezikshme, shovinisto-imperialiste, aneksioniste të Jugosllavisë ndaj shqiptarëve e Shqipërisë nën sundimin e Titos. Ne e kemi luftuar dhe vazhdojmë ta luftojmë e ta demaskojmë politikën shoviniste antishqiptare jugosllave dhe teorinë pseudosocialiste që është në bazë të sistemit vetadministrues jugosllav. Ne kemi të drejtë ta themi hapur pikëpamjen tonë për këtë. Këtë të drejtë e kanë edhe të tjerët të shfaqin pikëpamjet e tyre, ashtu siç i kanë për sistemin tonë. Në këto baza janë ndërtuar marrëdhëniet tona shtetërore me Jugosllavinë. Në këto baza janë ndërtuar ato edhe me shtetet e tjera. Për sa u përket jugosllavëve ata kurrë nuk e kanë mbyllur gojën kundër nesh. Përkundrazi, kemi dëgjuar prej tyre të gjitha llojet e shpifjeve e të akuzave, haptazi e prapa krahëve deri në skutat më të largëta të botës.

Çështja e Kosovës është një tragjedi. Ne do të mbrojmë të drejtat legjitime të vëllezërve tanë dhe kjo nuk është ndërhyrje në punët e brendshme të Jugosllavisë. Jugosllavët duhet të pushojnë terrorin dhe persekutimet ndaj shqiptarëve, të likuidojnë shtypjen nacionale dhe t'u jepen shqiptarëve të gjitha të drejtat që u takojnë.

## GORSHKOVI NË JUGOSLLAVI

Tanjugu njofton se një delegacion i marinës luftarake të socialimperialistëve sovjetikë, i kryesuar nga komandanti i saj, admirali Gorshkov, është për vizitë zyrtare e miqësore në Jugosllavi. Ai ka pasur bisedime me zyrtarët më të lartë të ushtrisë jugosllave duke përfshirë shefin e shtatmadhorisë, admiralin Mamula, si dhe sekretarin për Mbrojtjen Federative, Nikolla Lubçiç.

Gjatë bisedimeve, siç thotë Tanjugu, janë shkëmbyer mendime për «bashkëpunimin e mëtejshëm midis marinave luftarake» të të dy vendeve. Këto bisedime «janë zhvilluar në një atmosferë të përzemërt e miqësore». Tash, delegacioni sovjetik do të bëjë vizita edhe në disa njësi e institucione të marinës luftarake jugosllave.

Vigjilencë! Vigjilencë! Aleanca ushtarake sovjetojugosllave përfaqëson një gjarpër me dy kokë!

**POGRADEC, E HËNË**  
**6 KORRIK 1981**

### **DEKLARATA KOMPROMETUESE TË DUSHAN DRAGOSAVACIT**

Dushan Dragosavaci, një nga krerët e udhëheqjes revizioniste jugosllave, në një fjalim që mbajti në Plitvicë, me rastin e 40-vjetorit të «kryengritjes së përgjithshme të armatosur», në mes të tjerave tha edhe këto:

1. «Lufta jonë popullore, pa marrë parasysh kushtet e ndryshme specifike si dhe mossukseset e përkohshme në disa krahina e në disa periudha, ishte një luftë e përbashkët e të gjitha kombeve e kombësive të Jugosllavisë».

Me këtë, me siguri ai e ka fjalën për Kosovën dhe viset e tjera që banohen nga shqiptarë, pse atje, sipas tij, «ekzistonte tendenca shqiptaromadhe».

2. «As nuk kemi krijuar edhe as nuk mund të krijojmë republika prej kombësive, sepse kjo do të përbënte krijime artificiale të kombeve të veçanta dhe dy shtete nga një komb».

Me këtë ai do të thotë se nuk mund të krijohej dhe nuk mund të krijohet një republikë e re shqiptare kur ekziston një e tillë. Po të bëhej kjo, atëherë, sipas tij, Kosova dhe viset e tjera shqiptare, të aneksuara Jugosllavisë nga fuqitë dhe traktatet imperialiste, duhet të bashkoheshin me Shqipërinë, prandaj çështja u zgjidh në rrugë shoviniste serbomadhe.

Sipas Dragosavacit, kjo «nuk mund të bëhet sot»

pasi do të shpërbënte Federatën, pse kushtetuta e tyre flet për njëfarë «bashkim-vëllazërim» dhe për një të drejtë të vetëvendosjes «deri në shkëputje». Prandaj jugosllavëve nuk u intereson një republikë e Kosovës, pse kjo është një etapë në bashkimin e shqiptarëve që jetojnë në tokat e tyre në Jugosllavi, dhe pastaj, bashkimi i tyre me Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Këtë shovinistët jugosllavë s'e pranojnë, pse as kanë qenë dhe as janë marksistë, por janë nacionalistë e shovinistë.

**POGRADEC, E MARTE**

**7 KORRIK 1981**

## **FORCOHET ALEANCA USHTARAKE SOVJETO-JUGOSLLAVE**

Akoma nuk ka marrë fund jehona e vizitës së delegacionit të marinës luftarake sovjetike me në krye komandantin e saj, admiralin Gorshkov, kur agjencia Tanjug njofton se dje në Beograd arriti për vizitë «zyrtare e miqësore» një delegacion tjetër ushtarak sovjetik, kësaj radhe i kryesuar nga drejtori i drejtorisë qendrore politike të ushtrisë dhe marinës luftarake të Bashkimit Sovjetik, gjeneral armate Jepishev, mik i vjetër i titistëve. Nëse nuk gaboj, vite më parë, ai ka qenë ambasador në Jugosllavi.

Jepishevi dhe grupi i tij u pritën nga Nikolla Lubičiç. Biseda midis tyre, e cila ka kaluar në një «atmosferë të përzemërt e miqësore», kishte të bënte «me marrëdhëniet e bashkëpunimit midis forcave të armatosura të të dy vendeve mike».

Ç'janë këto vizita kaq të shpeshta midis dy «vendeve mike» dhe me në krye shefat kryesorë të marinës e të ushtrisë socialimperialiste sovjetike në Jugosllavi?

Ne shqiptarët jemi të bindur se asgjë e mirë nuk pritet nga vizita e bashkëpunime të tilla ushtarake, prandaj rritim vigjilencën dhe gatishmërinë tonë që asgjë të mos na gjejë në befasi e të papërgatitur.

Pa dashur t'i ekzagjeroj gjërat, por, duke u nisur edhe nga përvoja historike, forcimi i marrëdhënieve

ushtarake midis socialimperialistëve sovjetikë dhe revizionistëve jugosllavë nuk mund të shkëputet nga politika dhe synimet e komplotet antishqiptare ruso-serbe sidomos tash, pas acarimit të gjendjes në Kosovë dhe ngritjes së vëllezërve tanë kosovarë kundër shtypjes politike dhe shkatërrimit ekonomik të serbomëdhenjeve.

## SHËNIM

Nesër në gazetën «Zëri i popullit» botohet artikulli me titull: «Marrëdhëniet ekonomike midis Jugosllavisë e Bashkimit Sovjetik dhe komploti ruso-serbomadh».

## MBI VETADMINISTRIMIN JUGOSLLAV

## Shënime

Marksii dhe Engelsii «vetadministrimin punëtor», që është një rrymë filozofike utopiste anarkosindikaliste, e kanë dënuar si një rrymë antisocialiste. Sistemi jugosllav i vetadministrimit, si sistem ekonomik-shoqëror dhe politik në pushtet, tregoi sa i saktë ishte përcaktimi si antisocialiste që i bënë Marksii dhe Lenini teorisht dhe politikisht kësaj rryme anarkosindikaliste.

Vetadministrimi punëtor jugosllav vetëm në teori ka emrin punëtor, në praktikë ai është antipunëtor, është antisocialist. Ky sistem, pavarësisht nga zhurma që bëjnë titistët, nuk e lejon klasën punëtore as të drejttojë, as të administrojë. Ai ka krijuar kastën e vet drejtuese e administruese, e cila gjoja varet e kontrollohet nga të ashtuquajturit të deleguar të punëtorëve. Por ky është një mashtrim e një bluf i madh. Këta të ashtuquajtur të deleguar të punëtorëve bëjnë kauzë të përbashkët me klikën e burokratëve dhe të teknokratëve në fuqi, në kurriz të klasës punëtore e të masave të tjera punonjëse. Në fakt, në Jugosllavi, çdo ndërmarrje vetadministruese është një organizatë e mbyllur në aktivitetin e saj ekonomik, ndërsa politika e administrimit të saj është në duart e grupit udhëheqës, i cili, njëlloj si në çdo vend

tjetër kapitalist, manipulon fondet e akumulimit, vendos për investimet, rrogat, çmimet dhe shpërndarjen e prodhimit. Pretendohet se i gjithë ky veprim ekonomik-politik gjoja aprovohet nga punëtorët nëpërmjet të deleguarve të tyre. Por edhe ky është një veprim formal e mashtrues. Janë administratorët profesionistë ata që bëjnë ligjin dhe politikën në organizatën vetadministruese që nga baza deri lart në republikë. Roli drejtues dhe administrativ ekonomik-shoqëror dhe politik i punëtorëve, i klasës së tyre është reduktuar në minimum, për të mos thënë është zhdukur fare.

Jo vetëm kaq, por, duke nxitur partikularizmin, lokalizmin nga ai republikan deri në atë krahinor e lokal, **sistemi vetadministrues likuidoi unitetin e klasës punëtore**, i vuri punëtorët në luftë me njëri-tjetrin, si individë, duke ushqyer egoizmin dhe, si kolektiv, duke ushqyer konkurrencën midis ndërmarrjeve. Ai nxiti edhe egoizmin ekonomik republikan. E gjithë kjo krijoi autarkinë në ekonomi, krijoi anarkinë në prodhim, në shpërndarjen e fitimeve dhe të investimeve, në treg, në çmimet, çoi në inflacion e në papunësi të madhe.

**Qenia e klasës punëtore në udhëheqjen e sistemit vetadministrues punëtor në Jugosllavi është e paqenë, është një iluzion i rremë, një utopi. Klasa punëtore si e tillë nuk është as e bashkuar, as në drejtim, ajo nuk është më as hegjemone. Është likuiduar diktatura e proletariatit, e domosdoshme në këtë fazë të kalimit nga socializmi në komunizëm, është venitur edhe roli udhëheqës i partisë së saj komuniste. Në këtë sistem, pra, klasa nuk është në udhëheqje, diktatura e saj është likuiduar, udhëheqja e saj, partia komuniste, ose siç quhet në këtë vend Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë, nuk drejton as pushtetin, as ekonominë, as kulturën, as punën shoqërore. Drejtimi politik, kulturor, ekonomik në këtë sistem antisocialist, anarkosindikalist bëhet gjoja**

nga punëtorët drejtpërdrejt. Kjo, gjithashtu, është e gënjeshtërt, pse në fakt ai bëhet nga tjetërkush.

Në këtë sistem shpartallimi të përgjithshëm dikush tjetër mori pozita dominuese e drejtuese politike. Ajo është kasta e re e burokratëve politikë dhe e teknokratëve të shtresave të inteligjencies ose të aristokracisë së borgjezuar punëtore, mbi të cilët nuk ekziston as edukim, as kontroll politik. Ata nuk kanë as moral proletar.

Kjo shtresë burokratike e re vetëtrumbetohet si «armike» e burokracisë etatiste, kurse ajo është një burokraci akoma më e rrezikshme se e para dhe lulëzon e forcohet në një decentralizim të ekonomisë së planifikuar shtetërore, në një sistem që ka krijuar pronën private dhe ka lejuar zhvillimin e saj, që ka likuiduar unitetin e klasës punëtore, **aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse nën udhëheqjen e klasës punëtore**, ka likuiduar udhëheqjen politike, rolin hegjemon të klasës punëtore që, siç na mëson marksizëm-leninizmi, realizohet nëpërmjet partisë së saj, partisë komuniste.

Pra, sistemi ekonomik jugosllav i vetadministrimit punëtor në asgjë nuk mbështetet në marksizëm-leninizmin, ai nuk ka asgjë të përbashkët me sistemin socialist, çdo gjë të tij e ka braktisur. **Është e natyrshme se ky sistem, për të justifikuar e për të mbrojtur veten, do të kërkonte e do të gjente ideologjinë e përshtatshme kapitaliste, nacionalizmin republikan që ka hartuar deri dhe ligjet e rregulloret e veta për ta mbrojtur pronën e tij.** Janë krijuar kështu ekonomi kombëtare që konkurrojnë dhe luftojnë kundër njëra-tjetrës. Mbulesa pseudosocialiste e vetadministrimit punëtor nuk mund të fshehë kontradiktat e thella që i ka shkaktuar vetë sistemi i vetadministrimit.

Prandaj, pavarësisht nga teorizimet e pafund, afatet eksperimentale dhe miliarda dollarët që investon bor-

gjezia imperialiste botërore, një sistem i tillë josocialist, që ka zëvendësuar diktaturën e proletariatit me një diktaturë borgjezësh nacionalistë burokratë e teknokratë, që ka likuiduar unitetin e klasës punëtore, udhëheqjen e saj në politikë, në ekonomi dhe në kulturë, që e ka bërë të paqenë aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse, nuk mund të qëndrojë në këmbë.

**Nacionalizmi borgjez është instaluar pajdash në Jugosllavi dhe parulla «bashkim-vëllazërim», një parullë që ishte e drejtë gjatë luftës nacionalçlirimtare, kur luftohej kundër pushtuesve dhe reaksionit të vendit për një shoqëri të re të bazuar në marksizëm-leninizmin, nuk mund të zëvendësojë parimet e mëdha marksiste-leniniste që përcaktojnë dhe rregullojnë organizimin e shoqërisë në rendin socialist.** Parulla «bashkim-vëllazërim» në sistemin aktual jugosllav që përçan e shpërndan çdo gjë, është një parullë pa as më të voglin efekt uniteti. «Bashkim-vëllazërimi» i popujve të ndryshëm, i kombeve dhe i kombësive, i republikave dhe i krahinave nuk mund të ketë vlerë veçse në një federatë që udhëhiqet nga ideologjia marksiste-leniniste dhe nga një sistem ekonomik me të vërtetë socialist, me një plan unik të centralizuar demokratik dhe që i përmbahet zhvillimit të luftës së klasave brenda dhe në arenën ndërkombëtare.

Sistemi ekonomik-shoqëror dhe politiko-shtetëror, që ndërtuan Tito-Kardeli, nuk erdhi vetëm si pasojë e kundërshtimeve me Informbyronë. Ai është pjellë e kontraktave midis pikëpamjeve liberalo-oportuniste e kundërrevolucionare të udhëheqjes jugosllave me teorinë marksiste-leniniste mbi ndërtimin e shtetit dhe të shoqërisë socialiste. Kundërshtimeve të tyre parimore me teorinë marksiste-leniniste Titoja dhe banda e tij u dhënë ngjyrën e kundërshtimit ndaj Stalinit në fillim dhe ndaj sistemit socialist sovjetik më vonë.

Fill pas luftës, udhëheqja jugosllave u përpëlit shumë për të gjetur rrugën e ndërtimit të shoqërisë jugosllave me shumë kombësi, por nuk e gjente dot. Kështu koha deri në prishjen me Bashkimin Sovjetik dhe me vendet e demokracisë popullore, për Jugosllavinë ka qenë një periudhë kaotike, ku përplaseshin rrymat marksiste-leniniste me ato oportuniste si në infrastrukturë, ashtu edhe në superstrukturë. Dominoi rryma oportuniste-liberale e Tito-Kardelit dhe kështu u përpunua sistemi i vetadministrimit punëtor, i cili çoi në liberalizimin e sistemit ekonomik të pushtetit shtetëror, liberalizoi të gjitha fushat dhe aspektet e superstrukturës. Dëlgadalë në Jugosllavi në thelb mori formë kapitalizmi me pamje të jashtëme një socializëm specifik. Sistemi i vetadministrimit punëtor jugosllav në vend që të bashkonte, ndau dhe përçau. Bashkimi federativ nuk kishte baza teorike marksiste-leniniste, prandaj, pa asnjë dyshim, do të lindnin, siç lindën, antagonizmat nacionalë. Vetë sistemi i bartte këto kontradikta, ushqente separatizmin e kombeve dhe të kombësive, të republikave dhe të krahinave në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë.

Edhe euforia që ngjallën kreditë e shumta të kapitalizmit botëror, shpërdorimi i tmerrshëm i këtyre kredive në favor të udhëheqjes kryesore për të kënaqur gustot dhe kapriçiot borgjeze e megalomane, shpërndarja e pabarabartë dhe pa kritere të shëndosha midis republikave të ndryshme, krijoi disnivele ekonomike në republika e në krahina, disnivele që i favorizonte vetë sistemi dhe ekonomia e decentralizuar, pa një plan unik.

Ky sistem nuk do të kishte jetë të gjatë po të mos e kishin ndihmuar dy faktorë: antisovjetizmi i udhëheqjes jugosllave, që nuk ishte tjetër veçse antimarksizmi e antileninizmi i saj, dhe mbështetja ekonomike me anë kredish të mëdha dhe të gjithanshme nga ana e vendeve kapitaliste.

Por, në të njëjtën kohë, këta dy faktorë nuk mund ta forconin këtë sistem antisocialist. Përkundrazi, ata do ta dobësonin, siç e dobësuan, do ta çonin, siç e çuan, në bankrutë ekonomike dhe politike. Titoja, Kardeli dhe njerëzit që e pasonin, e shuan luftën e klasave ose ia shndërruan drejtimin dhe zhvilluan e zhvillojnë luftën pro sistemit vetadministrues, kundër «informbyroistëve», kundër «burokratëve», «stalinistëve», «dogmatikëve». Në të vërtetë këtu është fjala për luftën e elementëve kapitalistë kundër marksizëm-leninizmit, të sistemit kapitalist kundër sistemit socialist.

Fajin për falimentimin e këtij sistemi dhe të gjitha të këqijat që lindën prej tij, që u trashën e u bënë katastrofike, Kardeli me Titon ia hidhnin «mosperfekcionimit» sa duhet të vetë sistemit, ndërgjegjes së punonjësve «që nuk është ngritur akoma sa duhet», ekzistencës së burokracisë etj. Ata e shihnin falimentimin e sistemit të tyre antisocialist, por nuk mund të tërhiqeshin dot prapa. Prandaj janë paliative edhe të gjitha masat që mori Titoja që kur ishte gjallë për drejtimin e Federatës e të republikave pas vdekjes së tij. Erdhi edhe vdekja e Titos dhe bashkë me të edhe zhdukja e euforisë dhe falimentimi i sistemit. Tash Jugosllavia titiste ka hyrë dhe ndodhet në një krizë të madhe strukturore, ekonomike, politiko-morale.

**POGRADEĆ, E MËRKURË**

**15 KORRIK 1981**

## **REFLEKSIONE**

Ne, shqiptarët, si popull, si Parti, si pushtet kurdoherë kemi qenë e jemi kundër luftërave imperialiste, kundër çdo lufte të padrejtë që synon robërimin, gjakosjen dhe shfrytëzimin e popujve. Kjo ka arsytet e veta konkrete historike. Gjatë gjithë jetës së tij, populli shqiptar ka vuajtur shumë nga luftëra të tilla, që janë bërë drejtpërsëdrejti në dëm të lirisë, të integritetit territorial dhe të pavarësisë së tij kombëtare. Ato, pa asnjë përjashtim, e kanë gjakosur, i kanë sjellë shfrytëzim dhe e kanë copëtuar. Ky është një realitet i pamohueshëm.

Këto luftëra populli ynë i ka përballuar me heroizëm dhe ka luftuar me vendosmëri e pa u epur kundër armiqve të egër për të mbrojtur lirinë, pavarësinë, integritetin, kulturën, qenien e vet, atë çka ka qenë dhe është e tij. Në të njëjtën kohë, gjatë këtyre luftërave, ai ka mësuar edhe si të luftojë më mirë, ka fituar eksperiencë për t'i kuptuar problemet që i dilnin përpara — qëllimet, taktikat, planet e komplotet e armiqve të jashtëm dhe të brendshëm dhe, mbi këtë bazë, ka ditur si të ndërtojë taktikat e rezistencës së vet për t'u bërë ballë armiqve dhe ligësive të tyre. Edhe ky është një realitet. Të dallosh miqtë nga armiqtë, miqtë e rremë nga miqtë e vërtetë, është një çështje eksperience. «Kush pëson, mëson» thotë populli ynë. Ai, po ashtu, thotë: «Lumi fle, hasmi s'fle». Të dyja këto sentenca, këto

mësimet të mëdha kanë lindur mbi mendimet e thella filozofike të popullit, janë rezultat i eksperiencës së madhe të jetës së vetë popullit tonë dhe e kanë udhëhequr atë gjatë gjithë historisë së tij të lashtë.

Lufta e një populli për ekzistencë kombëtare nuk varet e nuk mund të varet nga kombinacionet dhe intrigat diplomatike të shteteve të tjera, qofshin ato të mëdha apo të vogla. Ajo varet nga vetëdija e vetë popullit, kur ai arrin të kuptojë cilat janë të drejtat e interesat e vërtetë të tij, të ketë besim në forcën e vet në çdo kohë dhe në çdo situatë dhe me vullnet të hekurt, me logjikë të shëndoshë e me luftë revolucionare të dijë t'i mbrojë këto të drejta e këta interesa. Vetëm atëherë forca e popullit bëhet e pamposhtur, qindfishohet dhe shpërthen si një uragan i papërmbajtshëm.

Ne shqiptarët kemi ecur në një rrugë të tillë. Historia e vërteton këtë, ndryshe ne nuk do të ekzistonim, pushtuesit do të na kishin asimiluar, armiqtë do të na kishin zhdukur; ndryshe nuk do të arrinim të ndërtonim një shoqëri më të përparuar, shoqërinë socialiste ku populli është në fuqi. Populli ynë, nën udhëheqjen e Partisë, me këtë eksperiencë të pasur luftërash dhe përpjekjesh për liri luftoi dhe arriti të fitojë e të ndërtojë shoqërinë e re. Dhe jo vetëm kaq, por është i vendosur ta zhvillojë më tej këtë shoqëri dhe nuk do të lërë t'i shpëtojë më nga dora e t'ia grabitë ndokush, cilido armik, i madh ose i vogël, i vjetër ose i ri që të jetë, lirinë, pavarësinë dhe fitoret e arritura.

Ne e dimë se ka njerëz e forca të huaja që Shqipërinë dhe popullin e saj nuk e durojnë dot dhe nuk duan që ai të ekzistojë, nuk duan që populli shqiptar të ndërtojë jetën e tij ashtu siç e ka vendosur ai vetë, nuk u pëlqen që një Shqipëri e vogël të rrojë si një shtet socialist në mes të një oqeani shtetesh kapitaliste me etiketa të ndryshme.

Por s'kanë ç'i bëjnë Shqipërisë socialiste. Kohët, raportit i forcave kanë ndryshuar shumë në favor të popullit tonë dhe të Shqipërisë. Ata po, mund ta sulmojnë Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë nga jashtë, dhe këtë as e harrojmë, as e neglizhojmë, por edhe ne do të mbrohemi dhe dimë si të mbrohemi e të fitojmë. Gjatë gjithë historisë së tij populli shqiptar ka ditur si të mbrohet. Unitetin e luftës për mbrojtje të popullit tonë Partia jonë e Punës e ka pasuruar dhe kalitur më tej akoma. Edhe vetë marksizëm-leninizmi na mëson se popujt që luftojnë për të mbrojtur lirinë dhe pavarësinë e tyre bëjnë luftë të drejtë, prandaj janë të pamposhtshëm. I tillë është edhe populli shqiptar. Mund të përpiqen të na çajnë, të marrin kalanë nga brenda, por kjo, sa të jetë Partia e Punës e Shqipërisë, parti e vërtetë marksiste-leniniste në udhëheqje të popullit shqiptar, nuk do të ngjasë. Kalaja jonë nuk është si kalatë e ëndrrave të tyre. Ajo është ndërtuar mbi truallin tonë me gjakun dhe djersën e bijve të kësaj toke, nga duart tona. Ajo s'ka të çara, s'ka zgavra, nuk është ngritur me lëndë të skaduara e të degjeneruara. Ajo është në gjendje t'u bëjë ballë, siç u ka bërë, të gjitha dallgëve të luftës që janë derdhur mbi të. Armiqtë imperialistë, socialimperialistë e të tjerë mund të përpiqen ta devijojnë Partinë tonë, siç devijuan parti të tjera, por as kjo s'do të ngjasë te ne, se Partia e Punës e Shqipërisë nuk largohet për asnjë çast, në asnjë kohë e për asnjë çështje nga teoria e marksizëm-leninizmit dhe nga normat leniniste të jetës së saj. Pikërisht ky qëndrim i vendosur, kjo besnikëri e patundur ndaj marksizëm-leninizmit e ruan Partinë tonë të pastër, e bën atë të fortë. Ajo është e lidhur ngushtë me popullin, ekziston, rron dhe lufton për të mirën e popullit, nga i cili ka lindur dhe ky ndjek e shikon çdo ditë rolin e madh udhëheqës të Partisë në përparimin e vendit dhe

në ngritjen e mirëqenies së vet ekonomike, shoqërore dhe kulturore.

Është, pra, e qartë përse populli shqiptar është kundër luftërave grabitqare imperialiste. Ai ka përjetuar në kurrizin e tij pasojat e rënda e të tmerrshme të tyre. Prandaj populli ynë, Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë janë për paqen në mes popujve. Eksperienca shekullore e popullit shqiptar dhe ideologjia jonë marksiste-leniniste, që udhëheq çdo veprim të Partisë së Punës të Shqipërisë, flasin qartë për rrugën e tyre të drejtë në këtë çështje të madhe, pavarësisht se ç'thonë kundërshtarët e vërtetë të paqes midis popujve.

Populli ynë kurrë nuk ka sulmuar popuj të tjerë, kurrë nuk ka lakmuar e nuk ka prekur atë çka është e të tjerëve, përkundrazi, edhe pse ka qenë viktimë e synimeve dhe e qëllimeve të këqija e grabitqare të disave prej tyre, ai u ka shkuar në ndihmë. Ky, gjithashtu, është një realitet që nuk mund të mbulohet nga asnjë lloj propagande e demagogjie. Në shtyp e në libra ngjarjet historike dikush mund edhe t'i paraqesë në të kundërtën e tyre, por jo historinë e vërtetë, pse ajo përjetësohet në gjirin e vetë popujve, nga vetë popujt, që ua kalojnë brezave njëri pas tjetrit.

Por ne e dimë dhe e kemi të qartë se paqja në mes popujve nuk arrihet pa luftën e drejtë revolucionare të vetë popujve kundër atyre që nuk e duan këtë paqe, pse nuk duan lirinë, sovranitetin e popujve, nuk duan që popujt t'u shpëtojnë zinxhirëve të rëndë të robërisë dhe të shfrytëzimit barbar që fuqitë kapitaliste ua kanë hedhur në qafë prej shekujsh. Pikërisht këtu ndahen rrugët midis popujve që duan lirinë e tyre të plotë dhe shtypësve e grabitësve të tyre imperialistë. Kjo është një luftë klasore, e brendshme dhe në platformë ndërkombëtare. Në këtë luftë armiqte e popujve, kapitalistët e çdo ngjyre dhe të çdo kalibri, luftojnë

të ruajnë grabitjen dhe sundimin mbi popujt, ndërsa këta të fundit luftojnë të fitojnë të drejtat e tyre dhe t'i japin fund përgjithmonë shfrytëzimit të njeriut nga njeriu.

Kapitalistët kanë ideologjinë e tyre që i udhëheq në luftën grabitqare, të padrejtë kundër popujve, por edhe popujt kanë ideologjinë e tyre, marksizëm-leninizmin, idetë e pavdekshme të Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit që i udhëheqin ata drejt çlirimit nga kapitali.

Këndeji lindin kontradiktat dhe lufta në mes dy rendeve që përfaqësojnë e mbrojnë dy sisteme shoqërore, kapitalizmin dhe socializmin, sisteme këto me qëllime e interesa krejt të kundërt, në luftë e në antipod të njëri-tjetrit për sa u përket rrugëve të zhvillimit të së ardhmes së njerëzimit. Këtu e ka burimin edhe politika e shteteve me sisteme të ndryshme të botës. Politika e shteteve borgjeze, kapitalisto-revizioniste i shërben klasës borgjeze që sundon në to. Ky sundim realizohet nëpërmjet një strukture e superstrukture që shtyp e shfrytëzon klasën punëtore, fshatarësinë dhe masat e tjera punonjëse të vendit. Ky sundim realizohet edhe nëpërmjet aleancave të çfarëdolloji që bën borgjezia kapitalisto-revizioniste me shtetet e mëdha kapitaliste, imperialiste dhe socialimperialiste.

Forca e infrastrukturës së shteteve të ndryshme me sisteme kapitaliste e me nuanca, në formë dhe në emërtime shtetërore, është e ndryshme dhe varet nga disnivelet në potencialin ekonomik-shoqëror që krijon zhvillimi i pabarabartë. Përpjekja për t'i mënjanuar këto disnivele dhe pasojat e tyre krijon kontradikta në vetë gjirin e klasës borgjeze në fuqi, shtresa e përfaqësues të ndryshëm të së cilës, nëpërmjet manovrave politike e demagogjike kërkojnë që klasës së tyre të mos i shkasë

kurrë pushteti nga duart. Këto manovrime mashtruese, tepër të rrezikshme për popujt, ata i mbulojnë me të ashtuquajturat liri demokratike brenda sistemit kapitalist me luftën që bëjnë secila nga këndi i vet, «për të drejtat e zgjedhësve të masave punonjëse» që bëhet deri në parlament nga partitë e ndryshme me etiketa të çfarëdollojta etj. Por këto parti s'kanë dhe s'përfaqësojnë asgjë demokratike. «Lufta» midis tyre është luftë klanesh politiko-financiare, luftë fjalësh, luftë korridoresh e sallonesh që zhvillohet jo në interes të masave punonjëse, as në interes të zgjedhësve. Përkundrazi, përfaqësuesit e këtyre partive, deputetët e zgjedhur «me votime të lira e demokratike», sapo futen në parlament aprovojnë ligje krejtësisht në favor të borgjezisë dhe për të mbrojtur kapitalet e saj të pafund, pra për t'i zgjatur jetën sundimit të saj mbi masat punonjëse.

Në shoqërinë kapitaliste kundërshtimet midis rrymave politike, reformat ekonomike që shpallin partitë e ndryshme borgjeze, shërbejnë vetëm për të siguruar pushtetin ose për ta ndarë atë, si dhe fitimet kolosale në kurriz të masave. Këtyre vetëm u krijojnë iluzionin se gjoja luftohet për interesat e tyre, ndërsa në fakt e në thelb luftohet për varfërimin e pandërprerë të masave, për shfrytëzimin e gjakut dhe të djersës së tyre.

Kështu, në shoqërinë borgjeze kapitalisto-revizioniste thellohet polarizimi midis shtypësve dhe të shtypurve, shfrytëzuesve e të shfrytëzuarve. Një raport i tillë marrëdhëniesh klasore ekziston edhe në mes shteteve kapitaliste e revizioniste. Më të mëdhenjtë, më të fuqishmit ekonomikisht e ushtarakisht në forma të ndryshme bëjnë ligjin mbi shtetet kapitaliste e revizioniste më të vogla. Vartësia ekonomike që u imponohet të vegjëlve nga më të mëdhenjtë, sjell pa asnjë dyshim vartësinë dhe nënshtrimin e gjithanshëm politik. Pavarësia e këtyre shteteve është fiktive dhe shërben vetëm për

të zbukuruar kushtetutat e për të mashtruar popujt. Sot është një realitet i padiskutueshëm fakti që një numër shtetesh kapitalisto-revizioniste janë të varura e të angazhuara me superfuqitë imperialiste dhe me politikën e tyre me një mijë fije të ndërlikuara dhe jo vetëm nëpërmjet organizmave ushtarakë, si NATO-ja dhe Traktati i Varshavës, ose bashkimeve monopoliste ekonomike, si Tregu i Përbashkët Evropian e KNER-i. Edhe shtetet e tjera kapitalisto-revizioniste, që nuk bëjnë pjesë në këto blloqe, nuk janë aspak të pavarura e të pangazhuara nga fuqitë e mëdha e superfuqitë imperialiste dhe socialimperialiste. Këto shtete, të ashtuquajtura të pavarura, janë futur në borxhe të pafund te fuqitë e mëdha kapitaliste. Si rrjedhim, dhe për këtë nuk ka asnjë dyshim, pavarësia e tyre politike nuk mund të qëndrojë në këmbë, pse dihet që nuk ka pavarësi politike pa pavarësi ekonomike. Këtë e vërteton praktika e kaluar dhe e sotme ndërkombëtare. Po të mos veprohte në mënyrë të hekurt ky ligj i pashkruar kapitalist në marrëdhëniet e nënshtrimit midis atij që jep e atij që merr para ose mall me kredi e me borxhe, nuk do të ekzistonin presionet e gjithanshme të të mëdhenjve ndaj të vegjëlve, të shumë të pasurve e të pasurve ndaj të varfërve e shumë të varfërve, nuk do të ekzistonte paqëndrueshmëria në politikën e shteteve, nuk do të ekzistonte lufta për tregje, neokolonializmi, ndërhyrjet e një shteti në punët e brendshme të një tjetri, siç po ndodh në të katër anët e botës deri në konflikte të armatosura të përgjakshme lokale. Vetë kriza e përgjithshme përcakton vartësinë zinxhir politiko-ekonomike të shteteve kapitalisto-revizioniste.

T'u fshihet popujve kjo situatë e nënshtrimit politiko-ekonomik, të mos u tregohen atyre arsytet dhe burimet e këtij instabiliteti të përgjithshëm politik në botë, të mos u bëhet e qartë kush i shtyp e kush i shfry-

tëzon, t'u fshihen me lloj-lloj formulimesh politike anti-shoqërore e antirevolucionare armatimi i madh e i pa-ndërprerë i superfuqive dhe i fuqive imperialiste, si dhe përgatitjet e tyre të ethshme për luftë, është një krim i madh e i pafalshëm kundër njerëzimit.

Tellallë që krijojnë «organizata pacifiste», ku gjoja mblidhen e flasin me zë të lartë për çështjet e çarmatimit e të paqes, që i ndajnë popujt në «të paangazhuar», në shumë «botëra» apo në «vende të pazhvilluara», ka plot, por të gjitha këto nuk pengojnë që imperialistët dhe socialimperialistët, të cilët nuk pyesin për asnjë forum e mbledhje ndërkombëtare, të ecin përpara në politikën e tyre hegjemoniste e ekspansioniste. Ata vazhdojnë të sundojnë mbi popuj e vende të tjera, të ndajnë zonat e influencës politike, ekonomike e ushtarako-strategjike, të korrin fitime kolosale nga shitja nëpërmjet një tregtie të imponuar të mallrave stok dhe të armatimeve të të gjitha llojeve dhe disa thërrime nga këto fitime t'ua japin në formë kredish e investimesh disa shteteve, të përkrahin ato qeveri që janë më të disponueshme t'i binden politikës së tyre imperialiste, të mbajnë nën zgjedhje popullin dhe vendin e vet dhe, sa të jetë e mundur, t'u japin superfuqive dhe shteteve kapitaliste të zhvilluara sa më shumë koncesione për të shfrytëzuar pasuritë e tyre kombëtare. Kështu këto varen krejtësisht nga kreditë që u japin fuqitë imperialiste.

Sot në botë po zhvillohen, po thellohen e po shtohen në gjerësi e në thellësi kontradikta të shumta. Ekzistojnë kontradikta të thella e të ashpra në mes superfuqive, në mes superfuqive dhe vendeve kapitaliste të industrializuara, në mes tyre dhe vendeve të tjera të botës me sisteme e emërtime të ndryshme e të çuditshme, si «vende në zhvillim», «të pazhvilluara», «të prapambetura», «të varfra» etj., etj. Të gjitha këto e bëjnë

më të rrezikshme gjendjen e përgjithshme. Në të njëjtën kohë e gjithë bota kapitalisto-revizioniste është e zhytur në një krizë të paparë kurrë, ekonomike, politike e morale.

Borgjezia kapitaliste dhe ajo revizioniste po bëjnë përpjekje të gjithanshme që pasojat katastrofale të kësaj krize t'i hedhin mbi kurrizin e masave punonjëse e të popujve të vendeve të tyre e të vendeve të tjera dhe të ruajnë të paprekura fitimet e veta. Prandaj kjo krizë rëndon në radhë të parë mbi masat punonjëse që, edhe pse janë prodhuese të të mirave materiale, shtypen nga klasa shfrytëzuese.

Kjo tendencë e borgjezisë i thellon akoma më shumë kontradiktat e saj klasore me proletariatin dhe me masat punonjëse, thellon hendekun midis të pasurve e të varfërve, ashpëron kontradiktat ndër imperialiste, ato midis «aleatëve» në grupimet kapitaliste e revizioniste, midis metropolit e vendeve koloniale e neokolonialiste.

Sot kontradikta më e madhe, më e ashpër është ajo në mes kapitalizmit botëror dhe klasës punëtore e masave punonjëse të të gjitha vendeve të botës. Kjo kontradiktë në regjimet kapitalisto-revizioniste është e pazgjidhshme. Në këtë fushë zhvillohet luftë konkrete, nacionalçlirimtare, për çlirim shoqëror, për reforma, zhvillohen greva, demonstrata me karakter politiko-ekonomik. Të gjitha këto kanë tronditur e po tronditin çdo ditë e më shumë themelet e borgjezisë kapitaliste botërore, rritin dhe afrojnë situatat revolucionare, revolucionet.

Në arenën ndërkombëtare po zhvillohen forma të ndryshme lufte nga të dyja anët. Është rritur e ashpërsuar përdorimi i dhunës, i kërbacit, i demagogjisë kapitalisto-revizioniste. Në arsenalin e armëve të borgjezisë kapitaliste, të frikësuar nga vala e revolucioneve, ka gjetur përhapje korrupsioni i klikave, të fshehta e në fuqi, me të gjitha mjetet e propagandës, është përhapur e përhapet degjenerimi intelektual dhe moral. Borgjezia

po përdor, gjithashtu, armën e saj të preferuar në kohë krize, terrorizmin, me të cilin përpiqet të njollosë, në sy të popullit të revoltuar, ndjenjën e zjarrit të çlirimit nga prangat e kapitalit dhe, duke identifikuar terrorizmin me veprimtarinë e revolucionarëve të vërtetë, përpiqet të frikësojë masat, t'i largojë ato nga revolucioni, të ruajë rendin e vet shtypës, të dalë pa dhimbje të mëdha nga kriza e rëndë vdekjeprurëse.

Kundër këtyre masave të egra lufte e dhune të borgjezisë kapitaliste po lufton me mjetet e saj bota e punës, bota që kërkon çlirim shoqëror e kombëtar.

Në këtë kaos krize ekonomike, politike e morale për ta, armiqtë imperialistë e revizionistë bëjnë shumë zhurmë rreth «gjendjes e pozitës së izoluar» të vendit tonë. Por a është e izoluar Shqipëria nga bota e jashtme, siç pretendojnë e dëshirojnë revizionistët e çdo ngjyre dhe armiqtë e ndryshëm imperialistë?

Përgjigjja varet nga ç'pozita klasore dhe politike e shikon këtë çështje.

Nga pozitrat tona shtetërore, ideologjike dhe politike Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë asnjëherë s'ka qenë, nuk është e nuk do të jetë e izoluar. Ne kemi marrëdhënie diplomatike me shumicën e shteteve të botës dhe asgjë nuk pengon që të kemi të tilla marrëdhënie edhe me ato shtete me të cilat akoma nuk kemi. Me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me Bashkimin Sovjetik nuk duam ne të kemi lidhje të tilla. Po kështu edhe me Anglinë dhe me Republikën Federale të Gjermanisë, që i detyrohen Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë e para arin e grabitur dhe e dyta dëmshpërblimet e luftës.

Kështu qëndron puna edhe për marrëdhëniet tona tregtare reciproke me shumë shtete kapitalisto-revizioniste. Tregtia në mes nesh dhe shteteve në fjalë bëhet

me klering ose «kesh». Edhe në këtë drejtim nuk ka asnjë izolim.

Me shumë shtete kapitaliste, kur na leverdis nga ana politike dhe kur është dakord edhe pala tjetër, ne kemi dhe zhvillojmë edhe marrëdhënie kulturore, shkëmbime eksperiencë në fushën e arsimit, të kulturës dhe të teknikës. Zgjerimi i aktiviteteve në këto fusha nga ana jonë varet vetëm nga mundësitë materiale. Pra, edhe në këtë fushë nuk ka asnjë izolim.

Për sa i përket zhvillimit të turizmit, ne këtë nuk e bëjmë as në atë shkallë, as në ato forma dhe as për ato qëllime fitimprurëse dhe njëkohësisht degjenerimi, siç e bëjnë vendet kapitaliste dhe revizioniste. Ne praktikojmë turizmin e miqve e të dashamirësve të Shqipërisë socialiste, të njerëzve të ndershëm nga vende e shtete që mbajnë qëndrime miqësore dhe korrekte ndaj vendit tonë. Te ne turizmi nuk është industri dhe mjet korrupsioni e vagabondazhi. Dhe pse turizmi te ne nuk është i tillë, armiqtë thonë se Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë «është një vend i mbyllur, i izoluar». Por kur e përse kanë folur mirë për popullin shqiptar dhe për Shqipërinë armiqtë tanë imperialistë e revizionistë? Kur nuk kanë shpifur ata për politikën tonë, për historinë tonë të vjetër e të re, për fitoret tona? Por popullin shqiptar dhe Shqipërinë s'i ka gjetur gjë. Përkundrazi, autoriteti dhe prestigji i tyre janë ngritur gjithnjë e më lart. Pra, nga pikëpamja jonë dhe e së vërtetës ne nuk jemi e nuk do të jemi kurrë të izoluar. Imperialistëve dhe revizionistëve u kemi thënë dhe ua përsëritim se Shqipëria nuk është han me dy porta ku të hyjë derri dhe dosa. Qytetet, malet, fushat, brigjet e atdheut tonë socialist nuk janë të përshtatshme për mënyrën e degjeneruar e të shëmtuar të jetesës e të të menduarit të tyre.

Ne e dimë se shtetet revizioniste (Jugosllavia, Ba-

shkimi Sovjetik etj.) dhe shtetet kapitaliste e quajnë shtetin tonë të izoluar nga bota, sepse ai nuk ka hyrë e nuk hyn në rrethin e tyre, nuk varet ekonomikisht prej tyre, nuk merr kredi, nuk futet tek ata në borxhe, nuk është i varur politikisht prej tyre, nuk lejon të shkelet pavarësia dhe sovraniteti dhe nuk ndryshon as regjimin shtetëror dhe as ideologjinë e vet marksiste-leniniste. Kjo kështu ka qenë e kështu do të jetë edhe në të ardhmen.

Sipas opinionit të disave nga këto shtete, Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë që bën një politikë të sajën, të pavarur në çdo fushë e në çdo rrethanë, është diçka anakronike. Edhe këtë ne e kuptojmë. Për ta është anakronike që shteti ynë i diktaturës së proletariatit nuk është në krizë, nuk influencohet nga kriza e madhe botërore, që shteti ynë ka stabilitet politik, që ekonomia jonë zhvillohet çdo vit, çmimet e asgjëje nuk ngrihen, nuk ka as papunësi, as emigracion politik, as greva ekonomike e demonstrata politike siç ka nga të katër anët e botës, në të gjitha shtetet kapitalisto-revizioniste.

Po mund të themi se Shqipëria me rendin e shoqërisë që ndërton është një rast i izoluar nga shtetet e ndryshme të cilat janë në krizë politike, ekonomike e morale. Për këtë arsye dhe për këtë gjendje kaq të mirë dhe të shëndoshë të ne, po, ata kanë të drejtë të thonë se ne jemi «të izoluar» nga ata dhe nga të këqijat e regjimeve dhe të politikës së tyre.

Prandaj Shqipëria, qoftë edhe kaq e vogël siç është, me politikën e saj parimore të pavarur, me guximin e saj dhe me rezultatet e prekshe luan një rol të dyfishtë politiko-shoqëror në arenën ndërkombëtare — nga njëra anë demaskon rendin dhe politikën kapitalisto-revizioniste, nga ana tjetër luan rol konstruktiv, revolucionar, inkurajues për popujt e botës që luftojnë për çlirimin e tyre nga zgjedha e kapitalit.

Me këtë rol të madh duhet parë çështja është apo jo e izoluar Shqipëria socialiste.

Shqipëria socialiste dhe Partia e Punës e Shqipërisë që e udhëheq atë, i duan, i respektojnë dhe i mbrojnë popujt e të gjithë botës dhe këta, nga ana e tyre, janë në unitet me ne. Shqipëria e vogël socialiste është bërë shembull dhe shpresë e madhe për masat punonjëse. Në këto kondita e në këto rrethana nuk mund, pra, të flitet për izolim të Shqipërisë. Të izoluar, të diskredituar, të urryer nga popujt janë kapitalistët, revizionistët, imperialistët dhe socialimperialistët. Pikërisht këta përpiqen ta paraqesin si të izoluar Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë, deformojnë pa sukses zërin e saj të drejtë, fitoret e saj dhe kjo, në fund të fundit, bën pjesë në përpjekjet e tyre që të izolojnë vetë teorinë marksiste-leniniste, ta quajnë atë të vjetruar, anakronike. Në këtë kuadër ata përpiqen të vërtetojnë se «socializmi mund të ndërtohet» duke u udhëhequr nga çfarëdo ideologji reformiste, oportuniste, deri edhe nga ajo fashiste.

Shtetet kapitalisto-revizioniste në kuptimin e gjerë nuk i shqetëson një vend dhe një popull i vogël si yni, por i shqetëson shumë ideologjia që udhëheq popullin tonë, i shqetëson shoqëria e vërtetë socialiste që po ndërtohet me sukses të ne, ku nuk njihen perturbacione politike, ekonomike, ku zhvillohet një kulturë e shëndoshë. Prandaj armiqtë e popujve përpiqen ta paraqesin të deformatuar gjendjen e shëndoshë moralo-politike të popullit tonë dhe të zvogëlojnë përparimin e madh e të pandërprerë ekonomiko-shoqëror të vendit tonë.

Lufta e të gjithë armiqve të popujve kundër vendit tonë socialist nisët nga të njëjtat pozita klasore, por në intensitetin e saj ka edhe dallime. Kjo ndodh sepse vërtet midis armiqve të socializmit, midis kapitalistëve dhe revizionistëve ka unitet, por ka edhe divergjenca, ka luftë dhe grindje. Midis shteteve të mëdha dhe të vogla, midis

vendeve shumë të zhvilluara dhe atyre më pak të zhvilluara dhe aspak të zhvilluara, ka, gjithashtu, luftë dhe grindje.

Në epokën e sotme të krizës së madhe të kapitalizmit, shtetet kapitalisto-revizioniste gjenden në vartësi politiko-ekonomike nga njëri-tjetri. Sigurisht më të fortët e më të mëdhenjtë janë më pak të ndërvarur nga më të dobët dhe më të vegjlit, por të gjithë janë sensibil e të prekshëm nga kontradiktat që shkojnë duke u acaruar në mes tyre. Këto kontradikta kanë efektin e tyre politik dhe ekonomik dhe shprehen në qëndrimet e çdo shteti, brendapërbrenda dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare midis shteteve të ndryshme.

Epoka e sotme mund të konsiderohet si epoka e destabilizimit total të kapitalizmit, e paqëndrueshmërisë në politikë, e pasigurisë së përgjithshme dhe e perspektivave të errëta e të paqarta për të ardhmen. Mbizotëron ideja e luftës, sepse shkohet drejt saj me anë të luftërave imperialiste e jo të drejta, qofshin këto dhe lokale, që nxiten nga imperialistët dhe socialimperialistët. Mendohet se nëpërmjet luftës do të zgjidhen kontradiktat e thella e të acaruara që i brejnë.

Në politikën e shteteve kapitalisto-revizioniste dhe në demagogjinë sociale të kësaj politike popujt nuk mund e nuk duhet të kenë besim. Ajo që popujt duhet të shohin qartë në mes fakteve konkrete, në mes mjegullës së dendur me të cilën superstruktura e regjimit kapitalisto-revizionist mbulon vizionin, deformon realitetin, gënjen njerëzit dhe përpiqet të errësojë rrugën e revolucionit nuk janë format e jashtme të strukturës së shteteve kapitalisto-revizioniste, por është përmbajtja, thelbi i kësaj strukture, armë në duart e kujt është dhe cilës klase i shërben.

Kjo përbën një problem të madh, të rëndë, të vështirë për t'u zgjidhur, po ai nuk është i parealizueshëm.

Forcat që i vihen përballë grushtit kapitalist janë më të mëdha e më të fuqishme. Vetëm duhet të arrihet zgjimi i tyre i plotë, të kalitet vetëdija dhe të realizohet organizimi i këtyre forcave në plan kombëtar e ndërkombëtar. Deviza ku qëndron forca e kapitalizmit është politika «përça e sundo». Nëpërmjet saj ai shtyp më të dobët dhe e mban atë në pamundësi të kundërshtojë, e lidh me një mijë fije që gjithë jetën të jetë skllav si individ, si popull dhe si shtet, e shfrytëzon sa më shumë dhe i krijon iluzionin se jeton në një «botë të lirë», «demokratike» ku duhet të jetë i kënaqur për atë jetë të mjeruar që bën dhe këtë t'ia dijë për të mirë padronit të vet. Kësaj devize popujt duhet t'i vënë përballë parullën e lavdishme të Marksit: «Proletarë të të gjitha vendeve, bashkohuni!», parullë që i ka futur tmerrin borgjezisë kapitaliste në çdo epokë.

Asgjë në këtë zhvillim kaotik dhe të pabarabartë nuk ecën përpara pa luftë dhe pa përpjekje të shumëllojta në mes shtypësve dhe të shtypurve, shfrytëzuesve dhe të shfrytëzuarve. Shtetet kapitaliste janë në garë për epërsi midis njëri-tjetrit. Në të shumtën e rasteve, për arsye të interesave, kjo garë midis tyre zhvillohet në mosmarrëveshje. Kush është superior, kush arrin t'i vërë këmbën tjetrit dhe ta rrëzojë, kush arrin të vendosë ligjin, të bëjë të pranohet politika e tij e dominimit, ai paraqitet më i zgjuari, më politikani. Megjithëkëtë edhe pozitat e tij sunduese nuk mund të durojnë gjithë kohën, sepse ai krijon dy lloj kundërshtarësh: kundërshtarë nga klasa e vet për pozita sunduese dhe në revanshin për fitime kapitaliste dhe kundërshtarin e madh, klasën punëtore dhe masat e gjera punonjëse, që, me çfarëdo forme lufte klasore, e brejnë nga brenda rendin kapitalist dhe i shkaktajnë të çara dhe disfata të njëpasnjëshme.

E prirë nga fitimet e jashtëligjshme, nga prirja për robërimin e popujve dhe për manipulimin pa skrupull

të gjakut dhe të djersës së tyre, bota kapitaliste nuk do të gjejë asnjëherë stabilitet në asnjë fushë të jetës. Masat punonjëse, pavarësisht nga përparimet e arritura dhe që janë fryt i mundit e i djersës së tyre, janë të ekskluduar nga çdo fitim; ato janë polarizuar dhe si të tilla janë kundërshtarë të përhershme të shtypjes çnjerëzore të borgjezisë kapitaliste.

Në këtë realitet gërryes, disfatash dhe instabiliteti ekonomik-politik, shtetet kapitalisto-revizioniste përpiqen t'u gjejnë ndonjë zgjidhje të përkohshme problemeve më akute e më të rrezikshme. Por zgjidhjet që ofrojnë ata, nuk mund të jenë të kënaqshme, pse ato janë të njëanshme për sa i përket synimit dhe gjenden në një terren shumë të lëkundshëm nga tërmetet popullore. Antagonizmat e mëdhenj në gjirin e kapitalit dhe ata në mes borgjezisë dhe klasës punëtore e masave punonjëse, i bëjnë këto zgjidhje antipopullore të paefektshme.

I parë në këtë prizëm klasor, zhvillimi aktual i botës kapitaliste të çon në njohjen më reale të politikës që përdor kapitali për të zgjatur jetën e vet, të metodave dhe të taktikave të luftës së tij kundër popujve.

Shtetet e ndryshme në botë, të çfarëdo rendi shoqëror qofshin, kanë politikën e tyre të jashtme. Kjo bazohet në disa parime që kanë karakter klasor, që përfaqësojnë dhe i shërbejnë klasës në fuqi dhe u adaptohen rrethanave politike që krijohen brenda vendit dhe në marrëdhëniet me shtetet e tjera, pra në arenën ndërkombëtare. Ka nga këto shtete që, në disa momente e rrethana, dalin me një politikë «të pavarur» nga të tjerët, të ndryshme në disa aspekte, të përkohshme dhe koniunkturale për arritjen e disa koncesioneve të caktuara politike, ekonomike dhe ushtarake. Këto ndryshime në formë dhe disa herë edhe në përmbajtje, pasqyrojnë for-

cën ose dobësinë e klasës borgjeze në fuqi në një shtet dhe influencën e njërit shtet mbi tjetrin, që rrjedh nga rënia ose ngritja e potencialit ekonomik dhe ushtarak të tyre. Parimi i fitimit dhe i dominimit, stabiliteti ose jo i gjendjes së një vendi kapitalisto-revizionist, bëjnë që politika e këtyre shteteve të jetë e lëkundshme dhe e prirë drejt më të fortit, më të fuqishmit. Kjo çon në vartësi ekonomike dhe politike të një shteti borgjez ndaj një shteti tjetër borgjez, ose në grupimin e një sërë shtetesh kundër grupimit të disa shteteve të tjera rivale. Pavarësisht nga kontradiktat që kanë në mes tyre, këto shtete borgjeze kanë tregues të përbashkët që i detyrojnë të mbështetin njëri-tjetrin, por kanë dhe tregues të tjerë të kundërt që i brejnë përbrenda marrëdhëniet midis tyre, që krijojnë turbullira, mungesë stabiliteti ekonomik, revolta politike, të cilat, për pasojë, dobësojnë lidhjet e përgjithshme e të dyanshme. Aktualisht këto fenomene ndërshtetërore midis vendeve kapitaliste kanë marrë një zhvillim të pafrenueshëm dhe të vështirë për t'i koordinuar, për t'i harmonizuar, për t'i stabilizuar. Rendi kapitalist, pra, është jo vetëm në krizë të madhe ekonomike, por edhe politike.

Marrëdhëniet në prodhim dhe politika që i mbështet ato, në çdo shtet kapitalist, të marrë veças apo në marrëdhëniet ndërkombëtare në mes tyre, janë në transformime të vazhdueshme katastrofike. Çdo gjë që ngjet në cilindo shtet, patjetër influencën në shtetet e tjera. Metamorfozat, ndryshimet, krizat ekonomike dhe politike që ndodhin në një shtet të fuqishëm kapitalist, patjetër kanë reperkusione zinxhir në të gjitha shtetet e tjera të varura nga kjo fuqi, edhe pse ato paraqiten gjoja të pavarura prej saj drejtpërdrejt. Këtyre fenomeneve, këtij zhvillimi kaotik u është gjetur një gjuhë justifikuese e mbushur me teori të ndryshme, të nuancuara sipas rrethanave, vendeve e tendencave. Të gjitha këto teori

mbajnë etiketën «demokratike», «revolucionare» dhe, në praktikë, shoqërohen me krijim organizatash nga më të ndryshmet, për të dhënë përshtypjen se luftohet kundër të këqijave të kohës. Në të vërtetë bota aktualisht ndodhet përpara faktit që të këqijtë luftojnë të këqijtë. Kështu të gjithë armatosen e në të njëjtën kohë të gjithë «luftojnë kundër çarmatimit», të gjithë thonë se «janë kundër luftës», por secili prej tyre, me mënyrat dhe mjetet e veta, mjaft herë edhe të përbashkëta, lufton për të minuar paqen; të gjithë ata flasin për mosndërrhyrjen në punët e brendshme të të tjerëve, por të gjithë, në një mënyrë ose në një tjetër, me armë, me politikë, me diplomaci dhe me «kavalerinë e dollarit» e të kredive të çfarëdollojta ndërhyjnë në mënyrë brutale në punët e brendshme të të tjerëve. Për të gjitha këto veprime kriminale e të dënueshme, borgjezia ka krijuar dhe metodën e paraqitjes së gjërave, një etikë të veçantë rreth shprehjes së mendimeve dhe të qëllimeve të hapëta dhe të fshehta në politikë e në praktikë. Kush del nga forma dhe brendia e kësaj etike, ai është «heretik», «i padëshirueshëm», armik i «botës së qytetëruar»!

Cilido qoftë, individ, popull, shtet apo klasë jo në fuqi, duhet të ecë me domosdo në rrugën e përcaktuar nga oligarkia kapitaliste, «e plotfuqishme», e zonja vetëm ajo të gjejë «zgjidhje të drejtë» për çdo problem jetik në shtete dhe në popuj. Këtë hegjemoni absolute përpiqen ta ruajnë dhe ta bëjnë të përjetshme në teori e në praktikë imperializmi, socialimperializmi dhe kapitalizmi monopolist botëror.

Ne mendojmë se kjo hegjemoni duhet luftuar e duhet shkatërruar pa mëshirë. Duhet dalë nga rrethi vicioz i skllavërimit shpirtëror, ekonomik, politik modern. Ky skllavërim modern është vepër mizore e klasës borgjeze kapitaliste dhe e rendit të saj ekonomikopolitik që ka krijuar. Shkatërruese e kësaj hegjemonie kapitaliste është

klasa punëtore e çdo vendi, janë masat e gjera punonjëse që shtypen e shfrytëzohen. Marksizëm-leninizmi duhet t'i udhëheqë të gjitha këto masa në revolucion për jetën e re të vërtetë socialiste pa shfrytëzues dhe pa të shfrytëzuar.

Shqipëria socialiste është pjellë e revolucionit proletar. E udhëhequr nga teoria marksiste-leniniste, ajo ka ndërtuar shoqërinë e re, shoqërinë socialiste. Kurdoherë e vazhdimisht Partia e Punës e Shqipërisë është bazuar në teorinë e Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit, e ka zbatuar atë pa lëkundje, pa devijime, pa frikë dhe në kundërshtim e në luftë pa kompromis me ideologjitë kapitalisto-revizioniste.

Edhe politika e jashtme e shtetit tonë të diktaturës së proletariatit është një politikë që udhëhiqet nga parimet e marksizëm-leninizmit dhe të internacionalizmit proletar. Ajo është parimore dhe e palëvizshme në strategjinë e saj. Kjo politikë përkrah lëvizjen revolucionare të klasës punëtore e të proletariatit botëror për çlirim nga kapitali, pra është kundër këtij të fundit, kundër politikës së tij të shtypjes dhe të shfrytëzimit, kundër strukturës dhe infrastrukturës së tij, përkrah luftën e popujve për liri, pavarësi, përparim shoqëror e socializëm dhe mbështetet në solidaritetin e tyre. Është kundër çdo formë të agresionit e të ndërhyrjes ushtarake të një shteti kundër një shteti tjetër, është kundër shfrytëzimit kolonial, të tutelës, të diktatit dhe të hegjemonisë, të shtypjes kombëtare e të dallimit racor. I përmbahet parimit të vetëvendosjes së popujve, të ushtrimit të sovranitetit të plotë kombëtar dhe të barazisë së të gjitha vendeve në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Pra, orientimet kyç të politikës së jashtme të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë janë përkrahja e çlirimit të popujve nga çfarëdo zgjedhe dhe shfrytëzimi nga forca të brendshme dhe të jashtme reaksionare,

lufta kundër luftërave imperialiste dhe kundër çdo lufte tjetër të padrejtë, lufta për çarmatimin dhe paqen e vërtetë, lufta për miqësinë e popujve në mes tyre dhe për demaskimin e armiqve të çdollojtë e të çfarëdo mjeti që përdorin ata për ta sabotuar këtë miqësi dhe mirë-kuptim në mes popujve.

Ashtu siç po vepron borgjezia reaksionare kapitaliste e revizioniste dhe shtetet e saj kundër Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, ashtu edhe kjo vepron kundër tyre. Shtetet borgjezo-kapitalisto-revizioniste politikën e drejtë revolucionare nga pozitat e palëkundshme të teorisë sonë, e quajnë ndërhyrje në punët e tyre të brendshme, kurse politikën e tyre komplotuese e sabotuese kundër popujve nuk e quajnë ndërhyrje në punët e brendshme tonat, por një politikë të drejtë e normale, tashmë të afirmuar në opinionin botëror. Por ngjet që nuk është kështu. Opinioni botëror, masat e gjera të popujve nuk i pranojnë botëkuptimet borgjeze revizioniste që fshehin gënjeshtren, shtypjen dhe shfrytëzimin. Masat që dëgjojnë dhe kuptojnë qëndrimet tona politike për shumë probleme ndërkombëtare, reflektojnë, bëjnë krahasime për gjendjen e paraqitur, peshojnë arsyetimet tona dhe ato të kundërshtarëve tanë dhe aprovojnë, përkrahin e adoptojnë qëndrimet tona. Është pikërisht kjo arsyeja e madhe dhe e vërtetë që i shqetëson antimarksishtet dhe revizionistët modernë të të gjitha ngjyrave. Ndryshe ata nuk do të shpifnin kundër qëndrimeve politike të drejta të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe të Partisë së Punës të Shqipërisë. Këtë ata e bëjnë se politika jonë, nga pozitat e klasës punëtore dhe e mbështetur në marksizëm-leninizmin, demaskon politikën e tyre pseudomarksiste që vepron nga pozita kapitaliste. Në sajë edhe të këtij demaskimi, masat e gjera punonjëse shikojnë se pavarësisht nga forma e jashtme, struktura dhe superstruktura e shteteve revizioniste është

e njëjtë me ato të shteteve të tjera kapitaliste. Në jetë brendia, thelbi dhe rezultatet e tyre janë në unitet.

Pikërisht pse Partia e Punës e Shqipërisë dhe shteti ynë e demaskojnë dhe e luftojnë si politikisht, ashtu edhe me shembullin pozitiv të ndërtimit me sukses të socializmit në Shqipëri rendin kapitalist (me të dy emërtimet që ka, kapitalist dhe revizionist), ata kanë emër të nderuar në botë jo vetëm në gjirin e klasës punëtore, por edhe midis elementëve përparimtarë të borgjezisë, në rini dhe midis intelektualëve.

Zëri i fuqishëm i Partisë së Punës të Shqipërisë i shqetëson shumë revizionistët modernë, pse në politikë e në teori ai bie në kundërshtim me përpjekjet e tyre për ta kaluar revizionizmin si «marksizëm të rinovuar» e të përshtatshëm për kohën e sotme, kur, gjithnjë, sipas tyre, duhet shpëtuar shkatërrimi i shoqërisë kapitaliste dhe duhet ruajtur prona private mbi mjetet e prodhimit, duhet evituar revolucioni proletar, domethënë marrja e pushtetit nga klasa punëtore. Revizionistët modernë nuk duan që marksistë-leninistët t'ua demaskojnë këtë punë të tyre sabotuese. Prandaj demaskimin që Partia jonë e Punës u bën teorive antimarksiste, rendeve ekonomiko-shtetërore të revizionistëve modernë dhe politikës së tyre të brendshme e të jashtme prokapitaliste, revizionistët modernë e quajnë ndërhyrje në punët e tyre të brendshme. Po kjo neve aq na bën.

Partia dhe shteti ynë proletar jo vetëm sot e jo vetëm tash, por që në ditët e para të themelimit të tyre kanë deklaruar publikisht se do të zbatojnë një politikë të jashtme parimore e të hapur, të fqinjësisë së mirë e të marrëdhënieve me të gjitha shtetet mbi bazën e barazisë, të respektimit të sovranitetit, të mos-ndërhyrjes në punët e brendshme dhe të dobisë reciproke. Dhe kësaj politike ata i janë përmbajtur pa asnjë lëkundje. Por ata kanë bërë, gjithashtu, të qartë për

cilindo që dëshiron të dëgjojë, se një politikë e tillë nuk do të thotë as lëshim, as heqje dorë nga lufta e vendosur për mbrojtjen e ideologjisë sonë udhëheqëse, marksizëm-leninizmit, nga lufta kundër imperializmit e kapitalizmit grabitqar, nga përkrahja e luftërave të drejta për çlirim shoqëror të proletariatit ndërkombëtar dhe e luftërave nacionalçlirimtare të popujve kundër kolonializmit e neokolonializmit.

Askush dhe asnjë forcë nuk mund t'i pengojë Partinë e Punës dhe Qeverinë e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë që të thonë mendimin e tyre jo vetëm për problemet e ngjarjet politike që u interesojnë drejtpërsëdrejti e që kanë të bëjnë me interesat e lartë të atdheut tonë socialist, Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, por edhe për çështje e ngjarje të përgjithshme botërore, pse edhe këto u përkasin të gjithëve e jo vetëm disave.

Në zbatimin konsekuent të kësaj politike, Partia dhe shteti ynë nuk nisen nga interesa koniunkturalë, për t'i bërë qejfin e për t'i shërbyer kësaj apo asaj fuqie të huaj, të madhe apo të vogël. Në këtë politikë ata nuk nxiten nga ndonjëra prej tyre, por edhe nuk harrojnë asnjëherë parimet e strategjisë bazë të mbrojtjes së lirisë dhe të interesave të popujve, të kauzës së proletariatit ndërkombëtar e të revolucionit të tij. Ajo, pra, nuk e ndryshon strategjinë e vet sipas koniunkturave të çastit. Këndej rrjedh stabiliteti i politikës sonë dhe drejtësia e qëndrimeve tona.

Politika jonë e jashtme nuk i imponohet askujt. Megjithëkëtë të shumtë janë njerëzit në botë, bile edhe kancelari të ndryshme diplomatike, që kërkojnë të marrin dijeni e ta njohin këtë politikë dhe qëndrimet tona, sepse në to ata shohin diçka origjinale që s'e kanë shtetet e tjera (qofshin ato kapitaliste apo revizioniste): vërtetësinë, pjekurinë dhe guximin për t'i thënë hapur

mendimet e veta. Një politikë të tillë të hapët, të drejtë dhe të peshuar nuk mund ta bëjë asnjë shtet kapitalisto-revizionist, për shkak të kompleksitetit të varësive politike e ekonomike, të influencave fetare e të kontradiktave klasore nga të cilat vuan. Shqipëria socialiste nuk vuan nga ndonjë kompleksitet i tillë faktorësh shtrëngues e pengues dhe pikërisht këtu qëndron forca e influencës së saj. Ka edhe të tjerë që me zor e kuptojnë politikën dhe pozitën tonë, habiten si mundet një vend i vogël si Shqipëria të bëjë një politikë të tillë që, sipas gjykimit dhe përcaktimit të tyre, ka gjëra të mira dhe të vërteta, të cilat s'i thonë dot të tjerët, por i thonë vetëm shqiptarët.

Partia e Punës e Shqipërisë është një Parti e fortë jo nga numri i anëtarëve të saj, por nga ideologjia marksiste-leniniste që e frymëzon dhe e udhëheq. Po kështu Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë është një shtet i fortë jo nga madhësia e territorit, as nga numri i madh i popullsisë, por nga fakti se ajo jeton, lufton dhe ndërton shoqërinë e re socialiste, se Parti e popull te ne janë në unitet të plotë, të ndërgjegjshëm ç'po bëjnë, ku shkojnë dhe si do të shkojnë. Ata i kanë të qarta problemet e mëdha, kardinale të jetës: e sotmja të ndërtohet e sigurt, pa harruar të kaluarën, dhe duke parashikuar e përgatitur të ardhmen.

Dikush mund të mendojë se një ecje e tillë e përkohshme është anormale, jo e rregullt, e lidhur me jetën dhe punën e disa udhëheqësve dhe se «nuk mund të dillet» nga radha e zhvillimit që ka krijuar shoqëria borgjeze kapitaliste dhe sufibrët<sup>1</sup> e saj, revizionistët modernë. Edhe në këtë çështje ata gabohen rëndë, se nuk duan, nuk e shohin dot forcën e madhe të socializmit dhe të doktrinës sonë ngadhënjimtare marksiste-lenin-

1 Nga frëngjishtja — vartësit.

niste, që shkallmon shoqërinë e vjetër dhe ndërton shoqërinë e re, nuk e njohin as Partinë e Punës, as popullin tonë, nuk njohin e nuk mund të kuptojnë lidhjen mendore, shpirtërore e materiale që është çelikusur midis tyre.

Instabiliteti i madh i shoqërisë kapitaliste, e zhytur në krizë të shumanshme, është vepër pikërisht e popujve të pakënaqur dhe e luftës së tyre kundër sistemit skllavërues dhe, s'ka asnjë dyshim, e frymëzimit që u jep ideologjia revolucionare, marksizëm-leninizmi, për të gjetur rrugën e drejtë e të vërtetë në mesin e errësirës në epokën moderne.

Ne komunistët shqiptarë jemi të ndërgjegjshëm për vështirësitë që hasim e do të hasim në rrugën tonë, por në të njëjtën kohë jemi plotësisht të bindur se do t'i kalojmë ato, sepse jemi në rrugë të drejtë. Çdo hap ne e hedhim të matur e të sigurt, pasi i peshojmë e i llogaritim gjërat mirë, jemi të qartë se në ç'periudhë rrojmë, vëzhgojmë me sy kritik marksist-leninist ndryshimet dhe zhvillimet që pëson bota, përpiqemi jo pa sukses t'i gjejmë në mënyrë korrekte këto zhvillime, duke përcaktuar anët pozitive dhe negative të tyre dhe duke përfutur nga të parat e duke luftuar të dytat. Në vartësi e në përforcim të strategjisë sonë revolucionare dhe të palëkundshme, ndërtojmë taktikat tona, të cilat nuk janë as të paprincipia, as vetëm të çastit.

Baza më e madhe e të gjitha fitoreve të përbashkëta të popullit dhe të Partisë së Punës të Shqipërisë jemi ne, komunistët shqiptarë, bij dhe bija të këtij populli, që e njohim atë me të mirat e me hallet e tij. Këtu i kanë themelet e shëndosha arritjet tona politike, ekonomike dhe kulturore. Në vendin tonë shoqëria socialiste u ndërtua nga një popull i lashtë, por njëkohësisht i ri, plot vullnet, zgjuarsia dhe trimëri. Atë e ka mësuar historia të luftojë për lirinë e vet, për një jetë të mirë,

për drejtësinë. Historia e ka mësuar popullin tonë të dallojë popujt nga udhëheqësit e këqij, shtypës, dinakë; kjo e ka mësuar popullin shqiptar t'i dojë popujt e tjerë, kurrë të mos u bëjë keq, por vetëm mirë, që ai kurrë të mos bëhet vegël e ndonjërit për të shtypur të tjerët, por të luftojë për të drejtat e tij dhe të të tjerëve. Këto virtyte të larta shqiptarit ia rrënjosi më thellë, ia përforcoi, ia bëri akoma më të kuptueshme e më të qarta, pjesë të gjakut të tij të pastër, Partia dhe ideologjia e saj marksiste-leniniste.

Populli ynë është një popull i thjeshtë dhe punëtor që nuk e ka për zakon të mburret përpara kurrkujt e për asgjë. Ai ka kuptuar se pavarësia dhe fitoret e korrura duhet të mbrohen ashtu si u fituan, me armë në dorë e, po të jetë nevoja, edhe me gjak, dhe të zhvillohen më tej me forcat e pasuritë e veta, me luftë e me përpjekje. Disa mendojnë se një gjë e tillë nuk mund të bëhet, nuk mund të rrohet pa borxhe, pa kredi nga kapitalistët e revizionistët. Kjo nuk është e vërtetë. Liria, pavarësia e vërtetë e kuptuar drejt nga një popull dhe e zhvilluar drejt nga udhëheqja e tij, e nxjerr atë në mirëgenie, e zhvillon, e bën të ndërgjegjshëm për fatet e veta. Borxhet, kreditë e huaja asnjëherë s'kanë qenë dhe s'janë në interes të popujve. Ato u sjellin popujve të gjitha fatkeqësitë. Borxhet dhe kreditë janë litar në grykë për popujt. Këtë e vërteton më së miri jeta e përditshme në vende afër e larg nesh.

Rruga e ndritur e popullit shqiptar është rruga e të gjithë popujve që luftojnë për çlirim kombëtar e social, për socializëm. Dhe popujt e botës që luftojnë me të gjitha mundësitë dhe format, janë aleatët e fuqishëm të Shqipërisë së vogël, por të pamposhtur, socialiste. Kjo i forcon pozitën e drejtë të politikës sonë marksiste-leniniste, autoritetin e vendit tonë në arenën ndërkombëtare. Në këtë kuadër ne duhet të forcojmë pa pushim Partinë

tonë të Punës, Republikën tonë Popullore Socialiste, të fuqizojmë ekonominë, të rritim mirëqenien e masave punonjëse, të ngremë nivelin kulturor, të vazhdojmë të ndërtojmë me sukses shoqërinë e re, shoqërinë socialiste.

E PREMTE  
7 GUSHT 1981

### «KOSOVA REPUBLIKË»

Sipas teoricienëve jugosllavë, siç del nga një artikull i botuar më 30 korrik në gazetën «Borba» të Beogradit, të cilin unë e lexova dje, «me parullën «Kosova republikë» doli në shesh edhe teza për të ashtuquajturën lidhje vertikale e të gjithë pjesëtarëve të kombësive shqiptare nga bashkësia shoqëro-politike në të cilën punojnë e jetojnë. **Kjo do të thotë organizim politik sipas parimit të kombësisë dhe jo sipas parimit territorial...**».

Problemi është i qartë, ai vihet me kokë poshtë e me këmbë lart. Ose, më mirë, atij i këputen edhe koka edhe këmbët. Kështu fshihet realiteti objektiv historik. Viset e banuara nga shqiptarët në Jugosllavi janë një unitet organik qoftë sipas parimit të kombësisë, qoftë sipas atij territorial.

Ç'thotë Lenini për këtë realitet historik, a mund të na thoni zotërinj jugosllavë? Ju e deformoni Leninin për të mbrojtur një tezë nacionaliste dhe skllavëruese, tezën tuaj shoviniste.

Ç'gjë antileniniste ka në parullën «Kosova republikë» dhe lidhja vertikale e të gjithë pjesëtarëve të kombësisë shqiptare në kuadrin e Federatës? Asgjë, veçse kjo ju prish juve «kuadrin» e gabuar mbi të cilin është ndërtuar Federata juaj. Dhe ja, ju e thoni vetë: «**Kjo në thelb do të thotë përqendrim territorial i kombësisë shqiptare në Jugosllavi nën një «ombrellë», domethënë**

aneksim i pjesëve të Serbisë, të Maqedonisë dhe të Malit të Zi në «rajonet kompakte shqiptare» në «republikën e Kosovës». A mund të flitet për «zgjidhje të problemit nacional shqiptar në Jugosllavi», kur vetë KQ i LKJ jo vetëm e ka përdorur çështjen shqiptare si gur shahu, por kur thotë se «republika e Kosovës» do të aneksojë pjesë të tri republikave, të Serbisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi dhe kur vë në thonjëza «rajonet kompakte shqiptare»? Jo. Kështu mohohet në fakt çështja shqiptare edhe si kombësi, edhe si territor.

Në këtë artikull «Borba» thotë, gjithashtu, se «republika e Kosovës» bëhet shteti i dytë kombëtar shqiptar, por në kuadrin e Jugosllavisë.

Po Lufta Nacionalçlirimtare që bënë të dy popujt tanë, përse u bë, që të krijohej një shtet apo dy shtete shqiptare? Po t'u referohemi tezave të Leninit dhe bisedimeve të mia me Titon për këtë problem, duhet të kishte një shtet shqiptar e jo dy.

Sipas nesh krijimi i një shteti shqiptar është zgjidhja e drejtë, sipas jugosllavëve kjo është «reaksonare, nacionaliste, nacional-izolacioniste, nacional-shoviniste». Logjikë reaksionare kjo e vënë me kokë poshtë!

Viset shqiptare dhe populli shqiptar mund të copëtohen midis tri republikave, por të realizohet uniteti i tyre në «një republikë të Kosovës», «kjo (sipas «teoricinëve të mëdhenj» të «Borbës») do të thotë copëtim artificial mekanik dhe shthurje e bashkësisë shumëkombëshe». Mbi të gjitha organi «teorik» i LSPJ<sup>1</sup> thotë se «kjo (republika e Kosovës) do të ishte baza për mbylljen e kombësisë shqiptare në kornizat e «etnisë» së vet dhe vendosja e «murit kinez» midis territorit të saj dhe popujve të tjerë të Jugosllavisë». Arsye e fortë kjo për copëtimin e territoreve shqiptare! Arsyetim shovinist e

<sup>1</sup> Lidhja Socialiste e Punonjësve të Jugosllavisë.

skllavërues i pohuar me gojën e tyre, që nuk ka ku të shkojë më tej.

Ky arsyetim reaksionar ndjek logjikën e vet të hekurt.

«Republika e Kosovës është një shkëputje izoluese nga jeta dhe nga komunikimi brenda Jugosllavisë dhe si shtet kombëtar i rindërtuar përsëri do të jetë shumëkombësh». Kjo, sipas tyre, do të thotë se shqiptarët e Jugosllavisë janë të egër e nuk kanë nocionin e bashkëjetesës me pakica të tjera. E qartë, vazhdim logjik i tezës reaksionare të Vlladan Gjorgjeviçit se «Shqiptarët janë njerëz me bisht».

Duke u nisur këtej, «Borba» thotë: «Shqiptarët do të kenë prirje të absolutizohen interesat e kombësisë shqiptare, e cila do të forcojë pozitën ose shtetin e porsakrijuar. Kjo do të bëjë që pjesëtarët e kombeve dhe të kombësive të tjera në këtë shtet të rikrijuar të gjenden në pozitën e pakicave kombëtare në raport me kombësinë shqiptare». Ky na qenka një krim i madh! Ndërsa që shqiptarët të jenë pakica kombëtare në Serbi, në Maqedoni dhe në Mal të Zi, kjo për mendimin e politikanëve «të zgjuar» jugosllavë është normale dhe e natyrshme. Bile këta zotërinj shkojnë edhe më tej: «Kjo do të çonte në përleshje reciproke dhe në nxitjen e shovinizmit, pasojë e së cilës do të ishte sundimi i më të madhit e i më të fortit mbi grupet nacionale më të vogla e më të dobëta». Në qoftë se jugosllavët e thonë këtë për shqiptarët, atëherë është njësoj dhe për serbët, maqedonasit dhe malazeztë. Këtë e thotë «Borba», nuk e themi ne. Ja se si me logjikën e tyre shoviniste të çoroditur dhe pa dashur ata vërtetojnë katërcipërisht shtypjen aktualisht të shqiptarëve si pakicë nga serbët, maqedonasit dhe malazeztë.

Tok me logjikën shoviniste vjen kërcënimi edhe për të tjerët. «Mosmarrëveshjet nacionale në kuadrin e «re-

publikës së re» nuk mund të zgjidheshin, por do të ngri-  
nin krye kombet dhe kombësitë më të mëdha në numër  
sesa kombësia shqiptare» etj.

Me fjalë të tjera shqiptarët e Jugosllavisë prej 2  
milionë vetash, s'kanë të drejtë të kërkojnë zgjidhje për  
problemet që kanë. Këto ua kanë zgjidhur dhe ua zgji-  
dhin serbomëdhenjtë!

POGRADEC, E DIEL

9 GUSHT 1981

## PËR MARRËDHËNIET TONA ME TURQINË

### Shënime<sup>1</sup>

Populli shqiptar dhe populli turk gjatë historisë së  
tyre kanë pasur lidhje miqësore e afiniteti me njëri-  
-tjetrin. Populli turk, me një histori e kulturë të lashtë,  
ka pasur respekt të madh për trimat e Shqipërisë, për  
dijetarët, filozofët, burrat e shtetit, arkitektët, shkrim-  
tarët dhe poetët shqiptarë ose me origjinë shqiptare, të  
cilët kanë dhënë kontributin e tyre në përpjekjet përpa-  
rimtare të popullit turk.

Populli shqiptar ka një admirim dhe respekt të ve-  
çantë për Mustafa Qemal Ataturkun, këtë personalitet e  
burrë shteti të shquar, i cili me kurajë të madhe dhe i  
frymëzuar nga mendimi demokratik përparimtar, e çliroi  
Turqinë dhe popullin e saj trim nga kompleksi robëruar  
ndaj popujve të tjerë të perandorisë së sulltanëve, konso-  
lidoi unitetin dhe pavarësinë e vërtetë të kombit turk,  
e futi Turqinë në rrugën e demokracisë e të progresit.

Populli shqiptar ka njohur ndjenjat e dashamirë-  
sisë së Qemal Ataturkut për Shqipërinë, i cili iu kundër-  
vu mbretit Zog, tiran i popullit shqiptar.

Miqësia e sinqertë e popullit turk ndaj popullit  
shqiptar dhe frymëzimi i lartë i Ataturkut duket aq  
qartë në strehimin vëllazëror të qindra mijë vëllezërve  
tanë kosovarë të dëbuar nga tokat e tyre në Jugosllavi.  
Ne e falënderojmë popullin vëlla turk për këtë dhe për  
miqësinë e tij ndaj popullit shqiptar, miqësi që është  
reciproke.

<sup>1</sup> Për raportin e Kongresit të 8-të të PPSH.

E HËNË  
10 GUSHT 1981\*

## PËR LINDJEN E MESME, PËR LUFTËN E POPUJVE ARABË

### Shënime

Në kapitullin për gjendjen ndërkombëtare në raportin e Kongresit të 8-të të Partisë, patjetër do t'u kushtojmë vend, aq sa na lejojnë kushtet, edhe ngjarjeve që lidhen me Lindjen e Mesme. Të theksojmë midis të tjerave:

1. Lufta e popujve arabë kundër pushtuesve izraelitë dhe padronëve të tyre amerikanë ka marrë përmasa e intensitet më të madh. Në qendër të kësaj lufte qëndron populli heroik palestinez, i cili prej dhjetëra vjetësh e në kushte jashtëzakonisht të vështira, po zhvillon një betejë titanike për t'u rikthyer në atdheun e vet të grabitur nga izraelitët, për të siguruar të drejtën që të jetojë i lirë e i pavarur në tokën e vet amtare.

2. Revolucioni i popullit iranian kundër monarkisë feudale të Pahlevëve dhe padronit të saj, imperializmit amerikan, përbën një grusht të rëndë mbi imperializmin në përgjithësi. Ai fshiu me fshesë të hekurt shahun e regjimin e tij mesjetar dhe flaku jashtë padronët e tij amerikanë. Këtë disfatë të madhe politike që pësuan, Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk janë në gjendje ta riparojnë as me rrugë diplomatike, as me shantazhe ekonomike, as edhe me ndërhyrje ushtarake.

— Në Iran imperializmi amerikan humbi një burim naftë nga më të rëndësishmit, fitimet kolosale që kishte prej saj, si dhe besimin si protektor i pathyeshëm që kishin tek ai «aleatët» arabë të Gjirit Persik.

— U lëkund kompromisi egjiptiano-izraelit i Kemp Dejvidit, lindën mosmarrëveshje të hapëta dhe të nënujshme me partnerët e NATO-s.

3. Me trimëri e guxim lufton populli i Afganistanit kundër socialimperialistëve sovjetikë dhe shërbëtorëve të tyre vendas për të rifituar pavarësinë e vet kombëtare.

Ne kemi qenë e jemi në krah të luftës së drejtë antifeudale e antiimperialiste të popullit iranian, në krah të luftës së drejtë të popullit palestinez e të popujve të tjerë arabë, si dhe të rezistencës së guximshme të popullit të Afganistanit për çlirimin e vendit nga pushtuesit sovjetikë.

## KINA — VEND PELEGRINAZHI PËR ISH-PRESIDENTËT AMERIKANË

Ish-presidenti Xhimi Karter mbërriti në Pekin për një vizitë prej 10 ditësh, me ftesë të qeverisë kineze. Për këtë njofton agjencia HSINHUA.

Në Kinë për vizita çlodhjeje e për t'u njohur me kuriozitetet kineze, por edhe për punë, sidomos për biznes, përveç Karterit deri tani kanë ardhur të gjithë ish-presidentët e gjallë, pra Fordi e Niksoni. Zakonisht, në këto vizita, ata kanë qenë ngarkuar edhe nga presidenti në fuqi për t'u sjellë mesazhe personale udhëheqësve kinezë.

Kinën e kanë vizituar edhe të gjithë ish-nënpresidentët, lëre pastaj delegacione zyrtare politike, ushtarake, diplomatike e ekonomike të niveleve të larta, si dhe gjithfarëlloj përfaqësuesish të monopoleve e të bankave të mëdha amerikane.

Të gjithë i tërheqin bukuritë natyrore të Kinës, përkëdheljet e udhëheqësve kinezë, sendet e vjetra e të çmuara që u dhurohen dhe, mbi të gjitha, tregu i madh e i pasur kinez.

## PËR MARRËDHËNIET ME JUGOSLLAVINË

### Shënime<sup>1</sup>

Serbomëdhenjtë po shpifin në lidhje me korrektësinë tonë në marrëdhëniet me Jugosllavinë, prandaj në rastin e parë e të përshtatshëm t'u thuhet publikisht sa vijon:

Kemi pasur dhe dëshirojmë të kemi marrëdhënie shtetërore me leverdi reciproke në fushën e shkëmbimeve tregtare me Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë. Kemi qenë korrektë dhe kemi respektuar kontratat, marrëveshjet dhe normat ndërkombëtare që rregullojnë këto marrëdhënie. Jugosllavët, nga ana e tyre, mjaft herë jo vetëm nuk kanë bërë asgjë në favorin tonë, siç pretendojnë, por përkundrazi, janë treguar jo-korrektë në realizimin e angazhimeve dhe të marrëveshjeve të nënshkruara.

Për sa u përket marrëdhënieve kulturore midis vendeve tona, në këto situata të rënda terrori dhe persekutimi të egër që ushtrohet ndaj shqiptarëve që jetojnë në Jugosllavi, janë të zorshme të zhvillohen si duhet. Të ndiqen e të burgosen në mënyrë të padrejtë e të jashtëligjshme shqiptarët në Jugosllavi vetëm e vetëm pse janë treguar entuziastë për kulturën dhe artin shqiptar, që janë edhe të tyret, pse kanë duartrokatur ansamblet

<sup>1</sup> Shih në këtë vëllim, f. 655.

tona e pse ne kemi duartrokatur ansamblet dhe përfaqësuesit e kulturës, të artit e të shkencës të Kosovës e të viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi, këto janë veprime në të vërtetë shoviniste, absurde dhe krejtësisht të papranueshme. Të tilla gjëra ngjasin vetëm në Jugosllavinë e ashtuquajtur vetadministruese. Është e kuptueshme se në këto kushte ne nuk do të pranojmë asnjëherë të bëhemi shkaktarë që të mbushen burgjet e Serbisë e të Maqedonisë me shqiptarë të pafajshëm vetëm pse duan kulturën dhe artin e tyre kombëtar.

Në asnjë vend të botës nuk ngjet si në Jugosllavi që korrektësia në marrëdhëniet kulturore të shpërblehet me shpifje për shqiptarët e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe me raprezalje ndaj shqiptarëve që jetojnë në Jugosllavi. Për shovenët serbë e maqedonas kultura dhe arti shqiptar na qenkan reaksionarë, nacionalistë dhe irredentistë. Por historia dhe kultura e popullit shqiptar nuk mund të zhvillohen sipas dëshirave të serbomëdhenjve të Beogradit. Ato krijohen dhe zhvillohen nga vetë populli shqiptar. Ne kemi respektuar, respektojmë e do të respektojmë kulturën dhe artin përparimtar të kombeve e të vendeve të tjera, këtë kërkojmë të bëjnë edhe të tjerët për tonën.

Ne jemi të bindur se popujt e botës së qytetëruar, dhe tok me ta edhe popujt e Jugosllavisë, nuk i pranojnë këto veprime që servirin serbomëdhenjtë dhe i kuptojnë qëllimet e djallëzitetë e tyre të mbrapshta e antishqiptarë.

## SHËNIM

Dje kryeministri i Izraelit, Menaem Begin, mbërriti në Uashington për të biseduar me presidentin amerikan Regan.

Si çdo herë tjetër, edhe kjo vizitë lidhet me kërkesën e qeverisë izraelite për mbështetje politike e ushtarake nga ana e imperializmit amerikan në prapun e aventurave të saj të reja antiarabe.

Në fakt, gjatë gjithë këtyre kohëve të fundit ushtria izraelite ka vazhduar bombardimin e qendrave të banuara palestineze në Liban, ka vazhduar terrorizimi i palestinezëve, si dhe çifutizimi i tokave të tyre. Janë shtuar provokacionet ushtarake kundër Libanit e vendeve të tjera arabe.

Siç po duken shenjat, Izraeli po përgatitet për goditje të reja ushtarake jo vetëm kundër palestinezëve, por për një ndërhyrje ushtarake në shkallë të gjerë në Liban, bile edhe për provokacione ndaj forcave ushtarake siriane që ndodhen në këtë të fundit.

## SHËNIM

Kam shkruar për vizitat e delegacioneve të marinës luftarake e të ushtrisë socialimperialiste sovjetike në korrik të këtij viti në Beograd si dhe për forcimin e bashkëpunimit të të dy vendeve në këtë fushë. Sot agjencia Tanjug njofton se dy kryqëzorë të Flotës së 6-të Amerikane arritën në portin Gruz të Dubrovnikut për «pushime».

Ecejaket e flotave ushtarake sovjetike e amerikane në portet jugosllave janë pasojë e portave të hapura për të dyja superfuqitë imperialiste dhe e politikës së «ekuilibrit» dhe të mosangazhimit titist të Jugosllavisë.

## SHËNIM

Bisedova me shokun Ramiz për shpifjet që jugosllavët po bëjnë ndaj qëndrimit tonë korrekt në marrëdhëniet me Jugosllavinë e, veçanërisht, në fushën e marrëdhënieve kulturore. I dhashë disa shënime, që duhet të përdoren në një intervistë nga Komiteti Shqiptar për Marrëdhënie Kulturore me Botën e Jashtme<sup>1</sup> për të demaskuar e për të hedhur poshtë këto shpifje.

---

<sup>1</sup> «Shtypja dhe mohimi i kulturës kombëtare të shqiptarëve në Jugosllavi nuk mund të mbulohen me shpifje kundër RPS të Shqipërisë», intervistë e kryetarit të Komitetit Shqiptar për Marrëdhënie Kulturore e Miqësore me Botën e Jashtme, dhënë korrespondentit të ATSH-së. «Zëri i popullit», 19 shtator 1981.

## VRANË SADATIN

Në kohën kur po zhvillohej një paradë ushtarake në Kajro, një komando ushtarësh egjiptianë qëlloi dhe vrau Anvar el Sadatin.

U zhdruk kështu një fashist, një kameleon politik. Mori fund pa lavdi karriera aventurore e një vegle të amerikanëve, këto kohët e fundit, pse më parë ai ishte vegël e sovjetikëve. Sadati vazhdimisht ka luajtur kartën e reaksionit botëror. Ai ishte aleat i Hitlerit, u takua e u mor vesh edhe me Romelin, ishte mik me hrushovianët, u puth me Izraelin, u bë armik i popujve arabë, u lidh me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me strategjinë e tyre në Lindjen e Mesme.

Kush e vrau Sadatin?

Terroristë si ai vetë.

Do të shohim kujt do t'ia vënë gishtin. Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Izraelit vrasja e tij nuk u interesonte. Sovjetikëve po, u interesonte, për strategjinë e tyre globale dhe për atë në Lindjen e Mesme, ku situata u ndërlikua më tepër se ç'ishte. Drejtpërsëdrejti i interesonte Kadafit të Libisë, i cili nën «ombrellën» e sovjetikëve rrethoi Egjiptin me aleancat që bëri me Sirinë, me Etiopinë dhe me Jemenin e Jugut. Ai sulmonte hapur Sadatin dhe Nimeirin e Sudanit. Libia sulmoi dhe pushtoi edhe Çadin. Në një shkallë më të largët, u ka interesuar dhe vendeve të tjera arabe, që

janë pro palestinezëve dhe kundër Izraelit. Këtyre vendeve arabe u interesonte edhe për shantazh kundër amerikanëve.

Vrasja e këtij aventurieri u bë, pra, nga aventurierë të tjerë për interesat e aventurierëve të tjerë më të mëdhenj. Edhe para kësaj vrasjeje, situata ishte e rrezikshme, por tani ajo bëhet edhe më e rrezikshme. Superfuqitë janë përleshur midis tyre dhe po futin botën, çdo ditë e më shumë, në rrugën e luftës bërthamore.

Edhe popujt duhet ta forcojnë luftën kundër luftënxitësve dhe veglave të tyre.

**E MËRKURË**  
**14 TETOR 1981**

## **ARMATIME AMERIKANE PËR USHTRINË KINEZE**

Ish-sekretari i shtetit për Mbrojtjen, Harold Braun, në krye të një delegacioni ekspertësh të institutit të kërkimeve ushtarake «Xhon Hopkins», që me siguri përfaqëson dhe mbron interesat e monopoleve amerikane të prodhimit të armatimeve, ndodhet në Kinë. Siç njofton agjencia HSINHUA, Brauni dhe grupi i tij janë pritur nga zëvendëskryetari i Këshillit të Shtetit dhe ministër i Mbrojtjes i Kinës, «i famshmi» Gën Biao.

Edhe pse kinezët flasin fare pak për qëllimet e kësaj vizite, nga shtypi amerikan del se misioni i Braunit është t'i shesë Kinës armatime moderne duke përfshirë armë antitanke, radarë, raketa kundërajrore, ordinatore elektronike e të tjera.

Duke pasur parasysh se një nga objektivat e udhëheqjes revizioniste, socialimperialiste kineze është «modernizimi i ushtrisë», kuptohet se makina ushtarake kineze është sot si një lubi gati të përpijë çfarëdolloj armësh që mund t'ia japin amerikanët nga stoqet e tyre të armëve të mbetura nga lufta në Vietnam ose edhe nga armët moderne, të cilave u ka kaluar afati i mbajtjes sekret. Ka kush paguan për këto armatime, punonjësit kinezë, mbi kurrizin e të cilëve bie e gjithë pesha e politikës kundërrevolucionare të Ten Hsiao Pinit dhe bandës së tij. Harold Brauni ka deklaruar se Kina dhe Shtetet e Bashkuara «kanë të njëjtët interesa (kuptohet

kundërrevolucionarë) për një numër të madh çështjesh. Përputhja e pikëpamjeve të të dy vendeve në fushën strategjike është e jashtëzakonshme».

Kinezët aprovojnë me heshtje.

**E HËNË**  
**19 TETOR 1981**

## SHËNIM

Gjendja shumë e rëndë ekonomike, politike dhe shoqërore në Poloni, pasojat e vijës revizioniste dhe kundërvolucionare të Partisë Punëtore të Bashkuar Polake u shprehën sot me një krizë të re në udhëheqje, rrjedhojat e të cilës me siguri do të jenë të mëdha e të rënda. Agjencia polake e lajmeve njoftoi se «sekretari i parë i KQ të PPB Polake, Stanislav Kania, dha dorëheqjen në plenumin e 4-t të partisë». Këtë dorëheqje plenumi e paska miratuar dhe në vend të tij paska zgjedhur gjeneralin Wojcieh Jaruzelski, kryeministër e ministër i Mbrojtjes. Pra, Kania dha «dorëheqjen» dhe Jaruzelski «u zgjodh» sekretar i parë i KQ të PPB Polake! Tani ushtria është plotësisht në komandë edhe mbi partinë. Punë revizionistësh.

**E MËRKURË**  
**21 TETOR 1981**

## QEVERI E RE NË GREQI

Andrea Papandreu, kryetar i partisë «Lëvizja Socialiste Panhelenike», e cila fitoi në zgjedhjet e përgjithshme parlamentare, formoi qeverinë e re greke dhe sot bëri betimin përpara presidentit Karamanlis.

Gjatë fushatës elektorale, Papandreu ka bërë shumë premtime si për sa i përket kapërcimit të pasojave të rënda të krizës ekonomike, siç janë papunësia, çmimet e larta, rënia e nivelit të jetesës, pra për ndryshime në gjendjen e rëndë ekonomike të vendit, por edhe në fushën e politikës së jashtme.

Tani të shohim a do ta mbajë e sa do ta mbajë ai fjalën e dhënë gjatë kësaj fushate.

## PRITJE DELEGACIONESH TË HUAJA

Në selinë e Komitetit Qendror prita sot delegacionet e partive komuniste (marksiste-leniniste) motra që kanë ardhur në vendin tonë për të marrë pjesë në punimet e Kongresit të 8-të të Partisë.

## GODITJE TË VAZHDUESHME PUSHTUESVE SOVJETIKË

Edhe pse jam shumë i zënë me punimet e Kongresit të Partisë, lexoj me vëmendje lajmet e agjencive të ndryshme, jo vetëm për të parë jehonën e punimeve të Kongresit tonë, por edhe për të ndjekur ngjarjet kryesore ndërkombëtare.

Këto ditë kam vënë re se patriotët afganë kanë zhvilluar përlëshje të përgjakshme me pushtuesit socialimperialistë sovjetikë dhe kanë futur në dorë një rajon të tërë në afërsitë e kryeqendrës së provincës veriore të Takharit. Aksionet e patriotëve janë shtuar shumë edhe brenda në Kabul, ku kanë goditur Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe burgun e tmerrshëm të Pul el Sharkit. Patriotët kontrollojnë një numër rrugësh që lidhin Kabulin me krahinat kryesore të vendit, ku ka përqendrim të mëdha ushtarake sovjetike, e sidomos atë që shpie në drejtim të kufirit me Bashkimin Sovjetik. Në një aeroport, në afërsitë e Kabulit, patriotët kanë rrezuar një helikopter të sovjetikëve.

Ushtria sovjetike dhe mbeturinat e ushtrisë kukull afgane paskan filluar një ofensivë të gjerë «për të çliaruar» Kandaharin, qyteti i dytë më i madh i Afganistanit, i cili prej më se dy muajsh mbahet nga forcat patriotike.

U lumtë patriotëve afganë! Rezistenca dhe lufta e tyre patjetër do të kurorëzohen me fitore.

E HËNË  
23 NËNTOR 1981

## SHËNIME

Në lajmet që kam lexuar dje e sot në axhanset e Agjencisë Telegrafike, më kanë bërë përshtypje këto:

Brezhnjevi ka shkuar në Bon për vizitë e bisedime me kancelarin gjermanoperëndimor Schmid. Pritja zyrtare, si zakonisht e ngrohtë me ceremoni e nderime, veç masat e sigurimit paskan qenë jashtëzakonisht të mëdha. Pritja nga ana e masave popullore, me protesta të shumta e të vazhdueshme kundër politikës agresive social-imperialiste të Bashkimit Sovjetik. Parullat kryesore gjatë rrugëve nga ka kaluar ai, siç thonë agjencitë e lajmeve, kanë qenë: «Jashtë rusët nga Afganistani!», «Vdekje Brezhnjevit!».

Sa poshtë e hodhën Bashkimin e dikurshëm Sovjetik, aq shumë të dashur për popujt, renegatët dhe kundërvolucionarët e tipit Brezhnjev e kompani!

Një nga ushtarakët e lartë socialimperialistë sovjetikë, që mbeti majë aeroplanit për të shkuar herë në njërin, herë në tjetrin kryeqytet të vendeve «aleate» të Bashkimit Sovjetik, është edhe mareshali Kulikov, kryekomandant i Traktatit ushtarak agresiv të Varshavës. Aktualisht ai ndodhet për «vizitë pune» në Bullgari.

Zyrtarisht thuhet se kudo atë e presin me nderime,

por udhëtimet e tij, në të vërtetë, janë të lidhura me shqetësimet për të mos thënë me kundërshtimet e ndryshme ndaj politikës aventuriere ushtarake e shtrënguese ekonomike të krerëve të Kremlinit.

Kulikovit, pra, i duhet të bredhë sa andej-këndeje për t'ia shtrënguar ca vidhat makinës së Traktatit të Varshavës, që të mos dezintegrohet plotësisht.



## TREGUESI I LËNDËS

### A

*Afganistani — gjendja e bren-  
dashme. Lufta e popullit afgan  
kundër agresorëve sovjetikë —*

5-6, 16-17, 22-24, 41-42, 54-  
-55, 140, 221, 223, 231, 233-  
-234, 281, 331, 357, 663

*Afrika — nga zhvillimi politik  
e shoqëror. Planet dhe veprim-  
taria e fuqive imperialiste e  
revizioniste në këtë kontinent  
dhe lufta e popujve afrikanë  
kundër tyre —*

37-38, 58, 84-  
-85, 133-134, 145-146, 191

*Afrimi dhe bashkëpunimi ki-  
no-amerikan —*

9-10, 23-24, 82-  
-83, 88-89, 112, 137-138, 149-  
-151, 193-194, 216, 650, 658-  
-659

*Agjentura, spiunazhi i vendeve  
imperialiste e revizioniste —*

5, 16, 135, 144-145, 220, 341-  
-342, 419, 425-426, 428, 435,  
488-491, 528-529, 533-535,  
537-540

*Aleanca dhe rivaliteti sovjeto-  
amerikan —*

8, 15-16, 22-23,  
55-57, 116, 138, 149-150, 152,  
170-171, 182-183, 192, 218-  
-226, 269

*Aleanca Kinë-Japoni-SHBA —*

135, 198

*Ambasada jugosllave në Tira-*

*në; provokimet e saj kundër  
RPSSH —* 78, 480, 481-482, 484-  
-485, 488-492, 499, 543

*Ambasadat e RPSSH:*

— në Jugosllavi — 61, 62,

78-79, 327, 425-429, 461, 484

— në Itali — 241, 242, 246-

-248, 249

— në Austri — 13, 471-472,

474

— në Francë — 468

— në Turqi — 59

*Ambasada të vendeve imperia-  
liste e revizioniste dhe qëndri-  
met e tyre ndaj RPSSH —*

220, 229, 247-248, 341-342,

396, 469-470, 473

*Amerika Latine — nga zhvilli-  
mi politik e shoqëror i saj —*

35, 58, 84-85, 146

*Anglia — politika e jashtme  
imperialiste e saj. Bllokimi i  
arit shqiptar nga qeveria angle-*

*ze —* 26, 117, 118, 144-145, 187,  
202, 226-227, 260, 417-420,

423

*Armatimi, «Çarmatimi», armët  
bërthamore; gara e armatimit  
të fuqive imperialiste dhe re-*

*vizioniste —* 9-10, 23-24, 85-86,

193-194, 215, 221, 226-227,

232, 256, 267-269, 273-274,

362, 522-523, 624, 634, 658

*Azia — nga zhvillimi politik e shoqëror* — 22, 27, 35, 58, 84-85, 112, 133-134, 145-146

## B

*Balkani — probleme politiko-shoqërore të Ballkanit* — 11, 52, 176, 177, 395, 431, 444, 492, 493-495, 512-513, 526-531, 571

*Bashkimi Sovjetik në periudhën e Lenin e të Stalinit* — 143, 400

*Bashkimi Sovjetik socialimperialist*

— strategjia globale dhe politika e jashtme socialimperialiste — 70, 133, 151-152, 180, 181, 190, 218, 221-225, 234, 265-266, 281, 323-324, 400, 626-627

— politika hegjemoniste ndaj vendeve revizioniste, kontradiktat me to — 47-48, 116, 176-177, 192-193, 206-207, 254-256, 259, 263-264, 265-266, 273-274, 279-280, 282-283, 315-322, 353-354, 393, 400, 492-493

— marrëdhëniet me Vietnamin, me Kinën, me Kamboxhian dhe me Laosin — 111-112, 218-219

— agresioni ushtarak socialimperialist sovjetik në Afganistan — 16-17, 22-24, 53-54, 180, 185, 233-234, 269, 281, 357, 663

— politika demagogjike ndaj Iranit, Egjiptit, çështjes palestineze e vendeve të tjera të Lindjes së Mesme

— 28, 53-54, 181-182, 192-193, 222-223, 483

— qëndrimet armiqësore ndaj RPSSH — 446, 493-494, 524, 608-609, 619-620, 628, 629-630

*Shih edhe:* Aleanca dhe rivaliteti sovjetiko-amerikan; Superfuqitë; synimet dhe veprimet e tyre imperialiste

*Bllloqet dhe flotat ushtarake imperialiste e revizioniste* — 53, 58, 67-68, 113, 116-117, 523, 654

*Borgjezia. Borgjezia e re në vendet revizioniste* — 11, 18-20, 27-30, 35-37, 198-199, 205, 264-265, 277-285, 314-315, 353-354, 563, 625-626, 634-635

*Bullgaria; qëndrimet armiqësore të revizionistëve bullgarë kundër RPSSH* — 11, 317, 318, 393, 493, 494, 509-511, 512-513, 530-531

## D

*Demokracia borgjeze* — 94, 136, 271, 302-304, 347-348, 468-469, 621-622, 631, 634

*Demonstratat dhe grevat në vendet imperialiste e revizioniste* — 165-166, 224-225, 228, 234-235, 255-256, 261-283, 314-315, 331, 344-345, 362, 365, 388, 424-425, 436, 448-449, 587-588, 596-497, 599-600, 625

*Diplomacia e vendeve borgjeze e revizioniste* — 16, 57, 426

## E

*Engels, Frederik* — 37, 142, 148, 155, 159, 166, 611

*Egjipti — gjendja e brendshme; marrëdhëniet e kontradiktat me vendet e tjera* — 20, 55-56, 191, 237, 267, 656-657

*Eurokomunizmi dhe lufta kundër tij* — 142, 152-155, 160-162, 168-169, 241, 244, 246-248, 249-250

*Evropa, «Evropa e Bashkuar», «sigurimi evropian»* — 35-36, 41, 57, 145-147, 186-193, 230, 232-233, 254, 256-258, 268, 279-280, 506-507

## F

*Fashizmi — fashistët e kohës së sotme, lufta kundër tyre* — 49, 138, 161-162, 315, 347, 458

*Feja në vende kapitaliste e revizioniste. Gjallërimi i fesë në Poloni* — 17-18, 24-30, 38-42, 90-91, 224, 235-236, 264-265, 269-272, 276, 281-284, 313-315, 352-353

*Franca — nga zhvillimi historik i Francës. Marrëdhëniet dhe kontradiktat e saj me vendet e tjera* — 56-57, 69, 89, 117, 118, 133-134, 187-188, 191-192, 222, 226, 230-233, 254-260, 268-270, 271-274, 300-301, 467-468, 475

## G

*Greqia — gjendja e brendshme; marrëdhëniet me RPSSH dhe me vendet e tjera* — 52,

56, 232-233, 439, 528-529, 530, 661

— e ashtuquajtura parti komuniste m-l e Greqisë — 129-130

## Gj

*Gjermania*

— para dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore — 11, 571, 576, 656

— RD Gjermane — 255, 256, 279, 281, 285, 317, 318, 321, 322, 459

— RF e Gjermanisë — politika e jashtme. Qëndrimi ndaj dëmshpërblimeve të luftës për RPSSH — 56-57, 89, 117, 118, 187-188, 191-192, 212, 222, 226-227, 231, 232-233, 254-261, 268-270, 271-274, 285, 459, 470, 664

## I

*Imperializmi — strategjia globale; kontradiktat dhe kriza në gjirin e tij* — 57, 91-92, 115-116, 133, 135-136, 139, 185-186, 190-191, 226-227, 233-234, 267, 270-271, 281-282, 360-361, 408, 445, 571-572, 594, 619-620, 624-625, 629-630, 632-634, 636-637

*Internacionalja e Tretë Komuniste (Kominterni)* — 122-123, 125

*Irani — gjendja e brendshme dhe revolucioni iranian. Lufta kundër veprimtarisë armiqësore të SHBA dhe të reaksionit* — 22, 28-34, 39-43, 53-54, 179-184, 222-223, 229-230,

**Italia**

- gjendja e brendshme dhe politika e jashtme; marrëdhëniet e kontradiktat me vendet e tjera — 59, 188-189, 226-227, 231, 233-234, 256-257
- marrëdhëniet me RPSSH. Provokacioni i presidentit italian kundër vendit tonë — 59-60, 241, 246, 247-248, 249
- Izraeli — vegël e imperializmit; politika e tij agresive kundër vendeve arabe* — 55-56, 191, 267, 383, 653

**J**

*Japonia — politika e jashtme e imperializmit japonez. Marrëdhëniet dhe kontradiktat me vendet e tjera* — 82, 89, 118, 136-137, 139, 194, 226-227

**Jugosllavia**

- Lufta Nacionalçlirimtare e popujve të Jugosllavisë dhe ndihma e Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare për çlirimin e tokave të Jugosllavisë — 210-211, 388-389, 394, 403-404, 412, 432, 434-435, 446-447, 459, 460, 516, 561-562, 575-576, 590-591, 595-596
- gjendja e brendshme politike, ekonomike e shoqërore në Jugosllavi. Konfliktet nacionale — 44-52, 148-149, 176, 195-196, 197, 198-201, 203-207, 209-210, 226, 251-253, 280, 332, 368, 380-381, 408, 412-415, 432,

- 443-444, 454, 493-495, 496-497, 507-508, 530-531, 539-540, 543, 546-547, 562-563, 561-568, 573-574, 585, 586-590, 591-592, 611-616
- revizionistët jugosllavë agjentë të imperializmit. Politika demagogjike ndaj lëvizjeve çlirimtare e revolucionare të popujve — 44-45, 51-52, 63-77, 113-115, 140, 144-145, 147-148, 152, 195, 214-217, 388, 443, 492, 563-564, 585-586
- qëndrimet armiqësore të revizionistëve jugosllavë ndaj kosovarëve dhe shqiptarëve të tjerë që jetojnë në trojet e veta në Jugosllavi — 195, 204, 358, 367-368, 369, 371-379, 381-382, 385-389, 391-392, 397, 398-399, 407-408, 429-430, 434-436, 442, 446-447, 453-454, 456-458, 472-473, 496-498, 502-503, 506-507, 536-537, 546-547, 572, 576-584, 588, 595-597, 599-601, 603-604, 643-646
- qëndrimet dhe veprimtaria komplotuese e armiqësore kundër PPSH e RPSSH — 48, 78, 210-211, 388-389, 391-392, 394, 397-400, 405-407, 425-429, 430-432, 434-437, 440-443, 444, 445-446, 447-448, 453-454, 459-460, 461, 465-466, 481-482, 486, 488-491, 499-500, 524, 526-527, 535, 537-538, 545-547, 556, 573, 588, 592, 602, 608-609, 628, 651-652, 655

**K**

*Kapitalizmi — kontradiktat dhe kriza në gjirin e tij* — 15-16, 92-93, 115-116, 157-158, 192, 200, 219, 223-224, 226-235, 281, 445, 504-505, 621-623, 625-626, 630-631

**Kina**

- gjendja e brendshme politike, ekonomike dhe shoqërore — 99-100, 102, 136-138, 145-146, 149-151, 226, 291-292, 311-312, 338-339, 557-558
  - strategjia globale, synimet imperialiste të Kinës — 134-139, 218-219, 224, 310-358
  - politika demagogjike e revizionistëve kinezë ndaj lëvizjeve dhe luftërave çlirimtare e revolucionare të popujve — 9-10, 82-83, 140
  - marrëdhëniet e kontradiktat me Vietnamin — 83, 101-102, 107-109, 111-112
  - kontradiktat me revizionistët sovjetikë — 127, 193-194
  - marrëdhëniet me Kamboxhian e Laosin — 83, 107-108, 134
  - marrëdhëniet me revizionistët jugosllavë e rumunë — 139-140
- Kina — Partia Komuniste (revizioniste) e Kinës*
- konfuzioni politik, ideologjik e organizativ në Parti (vijat, komplotet, kontradiktat, lufta për pushtet) — 81-83, 94-98, 99-102,

- 127-128, 149-151, 292-310, 325-326, 334-336, 338-340, 346-350, 555-556
- Maoedunideja. Qëndrimi i klikës së Ten Hsiao Pinit ndaj Mao Ce Dunit — 102, 112, 149-150, 158, 309, 311-312, 332, 334-336, 557-560
- «banda e të katërve», gjyqi kundër saj, kundër «bandës së të dhjetëve» e të tjerëve — 290-312, 334, 339, 346-347

*Klasa punëtore dhe roli i saj historik. Qëndrimet demagogjike të revizionistëve ndaj klasës punëtore* — 28-30, 33-36, 64, 92-93, 124-125, 154, 155-156, 159-163, 228, 234-235, 238-239, 244-245, 279, 284, 314, 318, 322, 344-345, 351-352, 611-612, 635

*Klasat dhe lufta e klasave. Trajtimi antimarksist i këtij problemi nga revizionistët* — 39-40, 99-100, 159-160, 239, 304-305, 620-623, 632-633

*KNER-i* — 230, 264, 266, 283, 315-316, 317, 323-324, 523, 623

*Kolonializmi, neokolonializmi; lufta kundër tyre* — 17-18, 37-39, 115, 137-138, 505, 551, 586-587, 623-624

*Kontradiktat në vendet imperialiste e revizioniste* — 40, 52, 56-57, 64, 91-93, 117-118, 133-139, 183-184, 190-193, 220-222, 226-227, 230-235, 254-262, 271, 504-505, 621-623, 630-634

**Kosova dhe trojet e tjera me popullsi shqiptare në Jugosllavi**

- traditat patriotike, luftarake e revolucionare të kosovarëve e shqiptarëve të tjerë që banojnë në trojet e veta në jugosllavi — 40-41, 377-378, 382, 391-392, 399, 447-448, 563
- qëndrimet gllabëruese të shovinizmit serbomadh dhe të fuqive imperialiste ndaj viseve shqiptare në Jugosllavi — 372, 375-376, 378-379, 380-381, 386-387, 412, 413, 414, 493, 502-503, 530-531, 571, 581-586, 595-596, 651-652
- problemi i etnisë, kërkesat për zhvillim ekonomik, shoqëror e kulturor dhe të drejta të barabarta me kombësitë e tjera në Jugosllavi. Kërkesa e Statusit të republikës për Kosovën — 365, 366, 367-368, 369, 372-376, 386, 390-391, 393-394, 402, 415, 433-434, 437-438, 444, 446-450, 455, 460, 468, 476, 497-498, 543-544, 570, 576-578, 587-590, 593-594, 596-601
- emigrimi dhe dëbimi i shqiptarëve nga Kosova dhe nga viset e tjera shqiptare në Jugosllavi — 398, 452-453, 496-498, 532, 587-588
- marrëdhëniet e Kosovës me RPSSH dhe veprimet antishqiptare të revizionistëve jugosllavë — 395-

-397, 414-415, 432-433, 447-448, 450-452, 464-466, 515, 517-518, 598, 651-652

*Shih edhe:* Jugosllavia — qëndrimet armiqësore të revizionistëve jugosllavë ndaj kosovarëve dhe shqiptarëve të tjerë që jetojnë në trojet e veta në Jugosllavi; Politika e jashtme e RPSSH — qëndrimi parimor m-l ndaj Kosovës dhe shqiptarëve të tjerë që jetojnë në trojet e veta në Jugosllavi

*Kreditë, huatë, ndihmat imperialiste e revizioniste; karakteri demagogjik e gllabërues i tyre* — 47-48, 114, 192, 197, 216, 218-221, 251-252, 265-266, 268-269, 285, 315, 319-320, 443-444, 474-475, 505, 549, 623-624, 641-642

*Kryengritjet popullore* — 16-18, 21-22, 25-26, 28-30, 32-33, 37-38, 42-43, 50, 52, 165-166, 222-224, 504

**L**

*Lenin, Vladimir Iliç* — 73, 122, 124, 127, 130, 142, 143, 148, 154, 155-156, 159, 163, 166, 228, 262, 355, 362, 375, 552, 564, 565, 566, 611, 643, 644

*Lëvizja marksiste-leniniste ndërkombëtare*

- probleme të taktikës, të strategjisë e të unitetit në partitë m-l; bashkëpunimi internacionalist ndërmjet tyre dhe lufta kundër shmangieve e devijimeve

nga m-l — 17-18, 28-30, 34-35, 126-132, 154, 155-162, 164-169, 194, 235-236, 238-239, 284, 350, 351

- puna e partive m-l me masat, me punëtorët, me rininë dhe me organizatat shoqërore; problemi i aleancave me to — 155-156, 159-164, 236-237, 244-245, 344-345
- Partia Komuniste e Brazilit — 243-245
- Partia Komuniste e Gjermanisë (marksiste-leniniste) — 121-126, 131, 172-174, 175-178, 344
- Partia Komuniste e Spanjës (marksiste-leniniste) — 359
- Partia Komuniste Punëto-re e Fshatare e Iranit («Tufan») — 29, 34-35, 103-106
- Partia Komuniste e Italisë (marksiste-leniniste). Kontaktet dhe bashkëpunimi i saj me revizionistët — 128-129

*Lëvizjet dhe luftërat nacional-çlirimtare e revolucionare të popujve* — 16-19, 22-30, 35-36, 54-56, 91-93, 190, 194, 218, 224, 227-228, 234-239, 625-626, 631-632, 642, 648

*Lindja e Mesme. Politika dhe veprimtaria e fuqive imperialiste e revizioniste në këtë zonë* — 17-19, 22, 52, 54-56, 133, 191, 222, 648-649

*Lufta — shkaqet, shkaktarët e shpërthimit të luftërave* — 63-64, 67-68, 134-135, 227, 235-

-236, 268-269, 319-322, 362, 504, 548

**M**

*Marksizëm-leninizmi*

- armë e busull për udhëheqje e veprim — 18, 28, 64, 124-125, 131, 155, 159, 201, 234-236, 394-395, 574, 619, 621, 635
- mbrojtja dhe zbatimi i m-l nga PPSH dhe partitë m-l. Veprimtaria armiqësore e revizionistëve kundër tij — 75-76, 142, 154-155, 552

*Marks, Karl* — 37, 73, 124, 142, 148, 155, 159, 166, 362, 375, 405, 551, 552, 564, 565, 566, 611, 631

*Mbrojtja e atdheut, forcimi i aftësive mbrojtëse të vendit. Traditat patriotike të popullit shqiptar* — 50, 60, 180-181, 459-460, 515, 570-572, 594, 617-620, 636-637, 640-643

*Ministria e Punëve të Jashtme e RPSSH* — 13, 61, 212, 467, 468, 477, 480, 481, 488, 510

*Ministria e Tregtisë së Jashtme e RPSSH* — 242, 500

*Minoriteti grek në Shqipëri. Qëndrimi m-l i PPSH dhe i shtetit ndaj tij* — 529-530

**N**

*Nacionalizmi, problemi nacional, nacionalizmi borgjez* — 28, 42-43, 72-73, 375, 514-515, 518-519, 570-571, 574-577, 597, 614-615, 643

*Nafta. Kriza e naftës në botë.*

*Lufta e vendeve borgjeze e revizioniste për burimet e naftës*  
— 15, 52-53, 54, 56-57, 170, 222, 229-230

NATO — 51-52, 67-68, 88, 115-117, 176, 183, 186, 189-190, 192-193, 223-224, 230-232, 256, 267, 319, 322-323, 623-624

## O

*Organizata e Kombeve të Bashkuara* — 68, 69-70, 87-88, 116

## P

*Palestina, problemi palestinez*  
— 267, 383, 483, 648, 653

*Partia e Punës e Shqipërisë*  
— vija m-l e saj për problemet e revolucionit, të ndërtimit socialist e të mbrojtjes së vendit — 123, 126, 158, 180-181, 194, 284, 289, 440, 618-620, 635-639  
— solidariteti, ndihma e përkrahja internacionaliste e saj për lëvizjen m-l — 103-106, 121-132, 172-174, 175-178, 244-245, 359  
— lufta e saj kundër:

— revizionizmit modern — 142-143, 152-153, 158, 394-395, 440, 552, 637-638

— revizionizmit jugosllav — 47-48, 64-77, 79-80, 143, 176, 194-195, 198-201, 214-217, 424-425, 440-441, 534, 541, 553-554, 561-569, 573-575, 611-616  
— revizionizmit sovjetik —

11-12, 127, 143, 360, 362, 446

— revizionizmit kinez — 127-128, 143, 158-159, 555-560

— eurokomunizmit — 142, 152-154, 168-169, 244, 246-250

*Partitë komuniste marksiste-leniniste*

*Shih:* Lëvizja marksiste-leniniste ndërkombëtare

*Politika e jashtme e RPSSH*

— qëndrimet parimore m-l në marrëdhëniet me vendet e tjera. Forcimi i pozitës dhe i autoritetit të PPSH dhe RPSSH në botë — 43, 56-58, 168-169, 354-355, 405-406, 428-429, 431-433, 440-441, 444-445, 450-451, 470-471, 474-476, 503, 515, 542-543, 626-629, 635-639

— lufta kundër imperializmit, revizionizmit e reaksionit dhe përkrahja e mbështetja e lëvizjeve dhe e luftërave çlirimtare e revolucionare të popujve — 11-12, 170-171, 179-180, 194, 235-239, 361-362, 394-395, 440, 569, 614, 619-621, 626-629, 635-636

— qëndrimi parimor m-l ndaj Kosovës dhe shqiptarëve të tjerë që jetojnë në trojet e veta në Jugosllavi — 207-208, 358, 370, 371-379, 385-409, 424-438, 447-453, 455-456, 463, 464-466, 468, 472-479, 489-490, 498, 502-503, 511-512, 515-

-516, 536-540, 544-547, 573, 576-584, 593-594, 600-604, 643-645

— marrëdhëniet dhe qëndrimet e saj:

— ndaj Jugosllavisë — 51-52, 78-79, 177, 377-379, 384-402, 411, 414-415, 426-430, 432-433, 440-442, 445, 450-453, 482, 484-485, 490-492, 500-501, 517-518, 541-542, 583, 602-604, 651-652

— ndaj Greqisë — 58, 475, 486-487, 528-529, 530, 537  
— ndaj Italisë — 59-60, 241-242, 246-248, 249-250, 486-487, 500-501

— ndaj Turqisë — 59, 475, 647

— ndaj Bullgarisë — 479

— ndaj Kinës — 555-556

— ndaj RF të Gjermanisë; problemi i dëmshpërbliemeve të saj për RPSSH — 13, 14, 61-62, 177, 212, 470-477, 626

— ndaj Francës — 467-468

— ndaj Anglisë. Problemi i bllokimit të arit shqiptar nga qeveria angleze — 14, 202, 626

— dënimi i agresionit sovjetik në Afganistan dhe përkrahja e luftës çlirimtare të popullit afgan — 5-6, 170-171, 236, 649

— përkrahja e revolucionit iranian dhe e luftës së popullit të këtij vendi kundër imperializmit amerikan — 170, 178, 180-184, 236-237, 342-343, 648-649

*Polonia — kriza politike dhe ekonomike, grevat. «Solidarnosti»* — 224-225, 255-256, 261-285, 313-324, 344-345, 351-356, 660

*Propaganda dhe shtypi borgjezo-revizionist, lufta kundër tyre* — 22, 46-47, 264, 274, 285, 338-339, 361-362, 474-475, 477, 513, 514, 626

*Propaganda dhe shtypi i RPSSH; propaganda për botën e jashtme* — 5-6, 7, 284-285, 289, 424, 429-434, 464-466, 468-473, 478-479, 512-520

## R

*Revizionizmi modern*

— revizionistët modernë tradhtarë të m-l dhe armiq të popujve. Strategjia globale dhe veprimtaria e tyre kundër revolucionit e socializmit — 35-37, 57, 142-143, 145-148, 149-153, 155-156, 162, 360-361, 400, 408, 625-626, 630-631, 637  
— marrëdhëniet dhe kontradiktat ndërmjet vendeve revizioniste — 47-48, 115, 117, 133, 139-140, 152-153, 192-193, 235, 256, 263-264, 265, 273, 278, 279-281, 320-322, 353, 621-623  
— qëndrimet armiqësore kundër RPSSH — 628, 629-630, 636-637

*Revolucioni; rruga ngadhënjimtare e tij* — 34-35, 37-38, 41-42, 66, 72-73, 77, 88, 208, 228, 355-356, 400, 548

*Rumania — gjendja e brendshme; pozita dhe marrëdhëniet*

e saj me vendet revizioniste —  
140, 279, 317, 322

## S

*Socialdemokracia, partitë bor-  
gjeze dhe aristokracia e klasës  
punëtore; lufta kundër tyre* —  
35-36, 154, 157-158, 160-161,  
235

*Stalin, Josif Visarionoviç* —  
95, 124, 127, 130, 142, 143,  
144-145, 148, 151, 154-156,  
159, 166, 191, 192, 210, 213,  
375, 405, 499, 547, 563, 564,  
565

*Superfuqitë; synimet dhe ve-  
primet e tyre imperialiste* —  
15, 68-69, 91-93, 113-114, 133,  
176, 177, 226, 505, 549, 623-  
625

## Sh

*Shovinizmi, shovinistët dhe  
lufta kundër tyre* — 134-135,  
349, 377, 392-393, 399-401,  
435-436, 455, 458, 475-476,  
514-519, 545-547, 576, 580-  
583, 597-598, 645-646

*Shtetet e Bashkuara të Ameri-  
kës*

- strategjia globale, politika  
e luftës dhe e agresionit,  
përpjekjet për të vendosur  
hegemoninë mbi vendet e  
tjera dhe kontradiktat me  
to; kriza e imperializmit  
amerikan — 42, 46-47, 53-  
54, 70, 84-93, 115-116, 133,  
143-146, 150, 179-184, 185-  
194, 213-217, 228-232, 258,  
271, 319-320, 341-342, 364
- qëndrimet dhe veprimtaria  
e tyre armiqësore kundër

Shqipërisë — 417-420

*Shih edhe:* Afrimi dhe  
bashkëpunimi kino-ameri-  
kan; Aleanca dhe rivali-  
teti sovjeta-amerikan; Su-  
perfuqitë; synimet dhe ve-  
primet e tyre imperialiste

## T

*Traktati i Varshavës* — 47-48,  
51-52, 67-68, 115-117, 176,  
192-193, 223-224, 230, 232,  
255, 264, 268, 280-283, 315-  
316, 318-319, 321-324, 353-  
354, 479, 623-624

*Tregtia e jashtme e RPSSH*  
— 59-60, 395-396, 486-487,  
541-542, 627

*Tregu i Përbashkët Evropian,  
kontradiktat në gjirin e tij* —  
186-192, 230, 232-233, 323,  
623-624

## V

*Vendet arabe — lufta e popuj-  
ve arabë për liri e përparim  
dhe veprimtaria e fuqive im-  
perialiste e revizioniste në këtë  
rajon* — 17-20, 35-43, 55-56,  
91, 222-223, 229-230, 648-649

*Vendet «e paangazhuara», ven-  
det e «botës së tretë» dhe  
«vendet në zhvillim»; marrë-  
dhëniet dhe kontradiktat në  
gjirin e tyre* — 71, 113-118,  
135, 361, 408, 558, 624-625

*Vietnami — gjendja e brend-  
shme, bisedimet me Kinën dhe  
marrëdhëniet me Kamboxhian*  
— 107-122

*Vigjilenca revolucionare* — 11-  
20, 50, 60, 180-181, 194, 208,  
280, 605

## TREGUESI I EMRAVE

### A

*Alia, Ramiz* — 7, 13, 119, 170,  
172, 173, 174, 202, 241, 242,  
243, 327, 345, 346, 351, 358,  
359, 370, 410, 416, 424, 427,  
438, 464, 499, 503, 655

*Agolli, Dritëro* — 500

*Adenauer, Konrad* — 254

*Ali (kalifi ~)* — 22

*Amazonas, Zhoao* — 243-245

*Amin, Hafizullah* — 16

*Aref, Abdul Salam* — 21

*Arruda, Dionis* — 243

*Asad, Hafëz* — 237

*Aust, Ernst* — 121, 172-174, 175,  
176, 177-178, 359

### B

*Babjush, Eduard* — 224, 266,  
271, 273

*Baftjar, Shapur* — 32

*Bajron, Xhorxh Gordon* — 421-  
422

*Bakalli, Mahmut* — 453

*Bakariç, Vladimir* — 206, 406

*Bakr, Ahmet Hasan al* — 21

*Bakunin, Mihail* — 563

*Bazargan, Mehdi* — 32, 34

*Begin, Menaem* — 653

*Biti, Pirro* — 241

*Bjerut, Boleslav* — 264

*Boçari, Marko* — 421

*Boletini, Isa* — 377, 465

*Bonoparti, Napoleon* — 301

*Brand, Vili* — 255

*Brauder, Earl* — 143, 145-148,  
149

*Braun, Harold* — 9-10, 661

*Brezhnjev, Leonid* — 10, 48, 197,  
201, 223, 231, 254, 255, 267-268,  
400, 483, 664

*Brzezinski, Zbignjev* — 84-90,  
117, 274

*Buda, Aleks* — 513

### C

*Caldaris, Konstandin* — 529

*Cuderos, Virginia* — 527

*Curri, Bajram* — 377, 465

### Ç

*Çan Kai Shi* — 145, 302

*Çausheku, Nikolae* — 332, 523

*Çen Hsi Lien* — 95

*Çen Jou Ju* — 290

*Çerçill, Uinston* — 145

*Çian Çin* — 291, 292, 293, 294,  
296, 333, 334, 339

*Çiano, Galeaco* — 515, 516

*Çi Ten Kuei* — 95

*Çubrilloviq, Vaso* — 457, 515,  
582

Çu De — 293  
Çu En Lai — 145, 150, 290, 292,  
293, 295, 296, 297-298, 306,  
307, 308, 309, 334, 346-347,  
348

## D

Dalles, Xhon Foster — 219  
Dan, F.I. — 122  
Danton, Zhorzh Zhak — 301  
Dantreg (konti~) — 301  
Daud (princi~) — 5, 16  
Dejvis, Edmund — 421, 423  
Demirel, Sulejman — 59  
D'Estën, Zhiskar Valeri — 89,  
118, 188, 191, 223, 230, 231-  
-232, 233, 234, 254-255, 258,  
267, 268  
Dë Gol, Sharl — 230, 254  
Dinuçi, Fosko — 129, 173  
Dolanc, Stane — 206, 381-382,  
384-390, 393, 406, 453, 472-473,  
543  
Dragoiçeva, Cola — 546  
Dragosavac, Dushan — 371, 372,  
393, 606  
Dubçek, Aleksandër — 272, 316  
Duraku, Emin — 377  
Dushani, Stefan — 459, 465  
Dushi, Hajdar — 377

## E

Eçevit, Bulent — 59  
Eskarpit, Robert — 288, 467

## F

Faisal, Ibn Azis — 21  
Fam Van Dong — 110  
Fan Ji — 96  
Faruk (mbret i Egjiptit) — 20  
Fazllija, Asllan — 367

Fonten, Andre — 180  
Ford, Xherald — 363, 650  
Frashëri, Abdyl — 377  
Frashëri, Naim — 377

## G

Galica, Azem — 377  
Galica, Shote — 377  
Gandi, Indira — 24, 201  
Garibaldi, Xhuzepe — 501  
Gën Biao — 658  
Gierek, Eduard — 224, 255,  
263-267, 270-274, 282-285, 316-  
-317, 354, 356  
Giom II (Vilhelm II) — 576  
Gomulka, Vladislav — 264-265,  
282, 354, 356  
Gorshkov, S.A. — 605, 608  
Gotbzadeh, Sadek — 236  
Grliçkov, Aleksandër — 63-77,  
79

## GJ

Gjilas, Milovan — 209-210, 405,  
406, 455, 547  
Gjorgjeviç, Vlladan — 645  
Gjuranoviç, Veselin — 78, 389-  
-390

## H

Hoxha, Nexhmije — 243, 369,  
421, 423  
Hasan (imami~) — 22  
Heng Samrin — 109  
Hërljeviç, Franjo — 461, 488-  
-491, 498, 535, 537-538  
Hitler, Adolf — 11, 222, 310,  
423, 571, 656  
Honeker, Enrik — 255, 268, 285  
Hoxha, Fadil — 327, 367, 498  
Hrushov, Nikita — 44, 95, 182,  
510-511, 529

Hua Kuo Fen — 10, 81-82, 100,  
102, 108, 109, 112, 150-151,  
297, 306, 308-309, 311-312, 332-  
-333, 334-335, 346-347  
Huan Hua — 101, 111  
Hu Jao Pan — 96  
Hysein, Sadam — 483  
Hysen (imami~) — 22

## I

Idriz I, Muhamed al-Mahdi al-  
-Sanusi — 21

## J

Jan Te Çio — 96  
Jao Ven Juan — 294, 296  
Jarosheviç, Piotr — 266, 273  
Jaruzelski, Vojçieh — 660  
Jegielski, Nicislav — 263  
Jeh Çien Jin — 292, 296, 306,  
307, 334-336, 346-347  
Jeng Sari — 108  
Jepishev, Aleksei — 608  
Jovanoviç, Bllazhe — 204  
Jozef, Franc — 547  
Ju Çiu Li — 96

## K

Kapo, Hysni — 286, 377  
Kadare, Ismail — 513  
Kadaf, Mohamer — 21, 56, 237,  
656  
Kadar, Janosh — 316  
Kania, Stanislav — 354, 660  
Karagjorgjeviçë (dinastia~) —  
47, 199, 413, 577, 581  
Karamanlis, Konstandin — 661  
Kardel, Eduard — 44-45, 144-  
-145, 403, 405, 406, 553, 566,  
581, 614-616

Karmel, Babrak — 9  
Karter, Xhimi — 8, 23-24, 46,  
53-54, 56, 86, 89, 90, 170, 179-  
-180, 181, 182-183, 194, 201,  
213-217, 218, 220, 222, 223,  
228, 231, 232, 254, 256, 258,  
271, 277-278, 337, 650

Karriljo, Santiago — 154  
Kasem, Abdyl Kerim — 21  
Kastro, Fidel — 201, 216  
Katon — 458  
Kavur, Kamilo Benso — 501  
Kened, Xhon — 219, 337, 364  
Këlcyra, Ali — 105  
Khomein, Ajatollah — 22, 24,  
27-28, 32, 34, 42, 55, 82, 105,  
106, 178, 236

Kieu Samfan — 108-109  
Kim Ir Sen — 108-109  
Kipling, Ryduard — 422  
Kisinger, Henri — 120, 337  
Klemanso, Zhorzh — 198-199,  
380  
Koculi, Qazim — 105  
Koh, Horst Ditrih — 121, 172,  
175, 176, 178  
Kolishevski, Llazar — 393, 429,  
498

Kolombi, Kristofor — 213  
Kolombo, Emilio — 242, 256-  
-257  
Kollokotroni, Theodor — 421  
Komatina, Branko — 491  
Kosiga, Francisko — 231  
Kristo, Pandi — 591  
Kropotkin, Pjotër — 563  
Kulikov (marshalli~) — 510,  
664-665  
Ku Mu — 96  
Kupi, Abaz (Bazi i Canës) —  
173

**L**

La Fajet, Mari Zhozef — 301  
 La Fonten, Zhan — 458  
 Le Zuan — 110  
 Li Hsien Nien — 292, 296, 306-307  
 Lin Biao — 95, 291, 292-296, 305-306, 309, 325-326  
 Lin Li Kuo — 325  
 Liu Shao Çi — 95-98, 112, 150, 290, 293, 305-307, 309, 335, 347, 348  
 Lubičiç, Nikolla — 206, 605, 608  
 Luigji i 13-të, Luigji i 14-të — 300

**LL**

Lleshi, Haxhi — 246, 247, 249

**M**

Myftiu, Manush — 249, 250  
 Musai, Selam — 377  
 Malinovski, Rodion — 510  
 Mamula (admirali) — 605  
 Mao Ce Dun — 81, 83, 95-98, 136, 137, 145, 150, 158, 290, 292-293, 295-296, 304-311, 334-335, 347, 348, 559  
 Marko, Raul — 359  
 Markoviç, Dragutin — 206  
 Mazarin, Xhulio — 300  
 Mazini, Xhuzepe — 501  
 Mesmer, Pjer — 467  
 Micotaqis, Konstandin — 527  
 Mihajloviç, Drazha — 145, 209, 210  
 Miliez, Pol — 286, 287  
 Milton — 423  
 Miniç, Milosh — 206, 425-429, 432-433, 434-435, 453, 454, 455, 545-547

Miteran, Fransua — 467  
 Mugosha, Dushan — 435-436  
 Muhamed (profeti) — 27  
 Musadek, Mohamed — 31, 223, 341  
 Musolini, Benito — 247, 459, 516, 571

**N**

Nagib, Muhamad — 20  
 Nagi, Imre — 316  
 Nase, Nesti — 61, 62, 212  
 Naser, Gamal Abdel — 20, 21, 26, 114  
 Nehru, Xhavarharlal — 114  
 Nguyen Van Xhiap — 110  
 Nikeziç, Marko — 204, 406, 584, 598  
 Nikolla (knjaz) — 522  
 Nilson, Riçard — 220, 337, 650  
 Nimani, Xhavit — 367, 498  
 Nimeir, Xhafar — 656  
 Nkruma, Kvame — 114

**O**

Obin, Mishel — 501  
 Obranoviç (dinastia) — 47

**P**

Pahlevë (dinastia) — 30-31, 236, 342, 648  
 Pahlevi, Reza Muhamed — 28, 170, 220  
 Pano, Nikolla — 501  
 Papakongos, Kostis — 439  
 Papandreu, Andrea — 661  
 Paveliç, Ante — 209  
 Pertini, Sandro — 241, 246, 247-248, 249, 250  
 Peshiç, Milorad — 537  
 Petion, Zherom — 301  
 Pijade, Moshe — 434, 453, 516, 589

Pjetër (mbret i Jugosllavisë) — 145  
 Plaka, Sokrat — 327, 484  
 Pol Pot — 108-110  
 Ponjatovski — 274  
 Pons Pilati — 180  
 Popoviç, Koça — 204, 209, 406  
 Popoviç, Miladin — 377, 435, 453  
 Prizreni, Ymer — 377

**Q**

Qemal, Ataturk (Mustafa) — 647

**R**

Rankoviç, Aleksandër — 45, 204, 209, 403, 405, 447, 503, 510-511, 513, 517, 581, 583, 584, 591  
 Regan, Ronald — 278, 337, 342, 363, 364, 597, 653  
 Ristiç, Dushko — 498  
 Rishelië, Armand dy Plesis — 300  
 Robespier, Maksimilian — 301  
 Romel, Ervin — 20, 656

**S**

Sadat, Anvar el — 20, 222, 237, 656  
 Sadr, Bani — 82, 103-106, 236  
 Said, Nuri — 21  
 Sazanov, Sergei — 522  
 Sends, Bobi — 416  
 Sihanuk, Norodom — 109  
 Simonik (profeti) — 200  
 Skënderbeu, Gjergj Kastrioti — 431, 445, 465  
 Spartak — 37  
 Stamboliç, Petar — 206, 454, 455, 456-457, 498

Stoiniç, Velimir — 591  
 Stojadinoviç, Milan — 516, 582  
 Strobel, Franc — 128  
 Sukarno, Ahmed — 114  
 Sun Jat Sen — 299  
 Suslov, Mihail — 48

**SH**

Shah, Mohamed Zaher — 5, 16  
 Shariat, Ali — 32  
 Shehu, Mehmet — 62, 78, 212, 240  
 Shekspir, Uiliam — 423  
 Shmid, Helmut — 174, 178, 190-191, 218, 223, 232, 234, 254-255, 256-257, 267-268, 474, 475, 664

**T**

Taraki, Muhamed Nur — 16  
 Tempo, Vukmanoviç — 393, 406, 498, 591  
 Ten Hsiao Pin — 10, 81-82, 101-102, 108, 112, 135-136, 150, 193-194, 290, 292-293, 296-299, 305-312, 335-336, 347, 348-349, 658  
 Tito, Josip Broz — 44-48, 63-77, 113-115, 147-148, 195-196, 198-201, 203-206, 209-211, 213-217, 251, 380, 385, 403, 406, 434, 437-438, 453, 494, 513, 516, 566, 580-581, 584, 591-592, 603-604, 614-616  
 Topulli, Çerçiz — 377  
 Tripallo, Miha — 204  
 Trudo, Pjer Eliot — 180  
 Truman, Herri — 213

**TH**

Theçer, Margaret — 180

**V**

Vales, Les — 263, 349, 352,  
355, 356  
Van Dun Hsin — 95  
Van Hun Ven — 293-294, 296  
Velluhiotis, Aris — 439  
Venizellos, Elefter — 529  
Verdi, Xhuzepe — 501  
Vidiç, Dobrivoje — 206, 375-  
-376, 393, 454, 455  
Vishinski, Stefan — 271-272  
Vokshi, Sulejman — 377  
Vu Fa Hsien — 294  
Vu Teh — 95

**X**

Xoxe, Koçi — 591

**XH**

Xhonson, Lindon — 219-220

**Z**

Zia ul Hak — 24  
Zogu, Ahmet — 418, 515, 647

**ZH**

Zhivkov, Todor — 48, 510  
Zhober, Mishel — 467-468

**TREGUESI GJEOGRAFIK DHE I EMËRTIMEVE TË TJERA****A**

Abadan (Iran) — 33  
Aden (Jemeni i Jugut) — 26  
«Akropolis» (gazeta) — 526  
Aleksandri (Egjipt) — 20  
Algjeri — 19, 40, 222  
Angolë — 141, 221  
Arabia Saudite — 21, 54, 337  
Artë (Greqi) — 487, 528  
ATSH (agjencia e lajmeve) —  
— 427, 664  
Australi — 8  
Austri — 470, 475, 486  
AVNOJ (Këshilli Antifashist  
Nacionalçlirimtar Jugosllav) —  
380, 403, 434, 577-579, 595-  
-596  
Azerbajxhan — 43

**B**

Bagdad — 21  
Bahia (Brazil) — 243  
Bari (Itali) — 145, 210, 486  
«Bashkimi» (gazeta) — 501,  
532  
Belgjikë — 323  
Beograd — 61, 117, 198, 214,  
217, 367, 374, 381, 384, 387,  
392-393, 435-436, 484, 492, 502,  
598, 654  
Bihaç (Jugosllavi) — 380

Bolonjë (Itali) — 249  
«Borba» (gazeta) — 400-401,  
643-645  
Bosnjë (Jugosllavi) — 204, 375,  
381, 413, 578  
Bruksel — 387  
Bujanë (Tropojë) — 435, 577,  
578, 590, 596  
Bullgari — 279, 322

**C**

CIA — 31, 53, 56-57, 90, 341-  
-342  
Cisjordani — 337, 383

**Ç**

Çad — 656  
Çamëri — 526, 528  
Çekosllavakia — 225, 272, 279,  
281, 316, 317, 318, 320, 321,  
322  
Çikago (SHBA) — 373  
«Ç'të bëjmë?» (libri), V. I.  
Lenin) — 122

**D**

Dancig (Poloni) — 315  
Dardanele (ngushtica) — 524  
Deti Adriatik — 248, 512, 521  
Deti i Kuq — 26

Dubrovnik (Jugosllavi) — 523,  
654  
Durrës — 444, 486, 522

## E

Elbasan — 486  
El Salvador — 213  
Emiratet e Gjirit Persik — 21,  
27, 54  
Epiri i Jugut — 487  
Eritre (Etiopi) — 54  
Etiopi — 27, 54, 141, 221, 656  
«Eurokomunizmi është anti-  
komunizëm» (libri ~,  
Enver Hoxha) — 119, 142-169,  
241, 244, 246, 247, 248, 250

## F

Ferizaj (Jugosllavi) — 382  
Filipine — 111  
Fiume (Jugosllavi) — 388  
Follorinë (Greqi) — 528

## G

Gadishulli Arabik — 28  
Gadishulli Iberik — 233  
Gafsa (Tunizi) — 56  
Gaza (rripi~) — 337  
Gdansk (Poloni) — 224, 261-  
263, 271, 272, 274-275, 278  
Gdania (Poloni) — 224, 261-262,  
271, 278  
Golan (Siri) — 337

## GJ

Gjiri Persik — 31, 53, 54, 87,  
191, 222, 230, 337, 649  
Gjirokastër — 114

## H

Hani i Hotit (Shkodër) — 485  
Hanoi — 110  
Helsinki — 436, 506-507  
Hercegovinë (Jugosllavi) — 204,  
375, 381, 413, 578  
Hiroshimë (Japoni) — 144  
«Hrushovianët» (libri ~,  
Enver Hoxha) — 240, 287, 288,  
289  
HSINHUA (agjencia e lajme-  
ve~) — 9, 94, 95, 99, 290,  
338, 363, 650, 658  
Hungari — 279, 281, 317, 318,  
322

## I

Igumenicë (Greqi) — 526  
«Imperializmi dhe revolucioni»  
(libri~, Enver Hoxha) — 155,  
244  
Irak — 21  
Islamabad (Pakistan) — 54

## J

Jajcë (Jugosllavi) — 516, 577,  
595-596  
Janinë (Greqi) — 487, 526, 528  
Jemeni i Jugut — 26, 54, 222,  
656  
Jemeni i Veriut — 26, 54  
Jordani — 483  
«Junajtid Stejts njuz end uërllid  
riport» (revista~) — 84

## K

Kabul — 9, 223, 331, 357, 663  
Kakavijë (Gjirokastër) — 486,  
487  
Kamboxhia — 108-109  
Kanada — 8, 189

Kanali i Korfuzit — 202, 419-  
420  
Kanali i Otrantos — 522  
Kandahar (Afganistan) — 357,  
663  
«Kapedan Aris» (libri~, K.  
Papakongos) — 439  
Kapshticë (Korçë) — 486  
Karinti (Austri) — 390  
Kartagjenë — 458  
Kavajë — 39  
KGB — 524  
Koblenc (R.F. e Gjermanisë)  
— 300  
Kom (Iran) — 33  
Konferenca e Jaltës (shkurt  
1945) — 67  
Kongresi i Përmetit (24 maj  
1944) — 418  
Konicë (Greqi) — 526  
Koreja e Jugut — 459  
Koreja e Veriut — 459  
Korfuz (Greqi) — 529  
Kotorr (Jugosllavi) — 522  
Kroaci (Jugosllavi) — 46, 49,  
207, 384, 454, 516, 562, 578,  
586  
Kubë — 117  
Kurani — 25, 27

## L

«La guerre dans la guerre»  
(libri~, M. Gjilas) — 209  
Lagunë (ishulli~, Itali) — 233  
Laos — 83, 108, 134  
«La Stampa» (gazeta~) —  
498  
«Lë Mond» (gazeta~) — 180,  
498, 501  
Lëvizja Babide — 26  
Lëvizja e Vahabitëve — 26  
Liban — 383, 653

«Liberation» (gazeta~) — 100,  
101  
Libi — 20-21, 56, 656  
Lidhja Shqiptare e Prizrenit —  
465, 515, 517  
Lipjan (Jugosllavi) — 382  
Lufta e Dytë Botërore (1939-  
-1945) — 45, 134, 136-137, 142,  
143, 516, 595  
Luginat e Pamirit — 9  
Luksemburg — 187  
Lumi Danub — 387  
Lumi Dravë — 387  
Lumi Savë — 387  
Lushan (Kinë) — 292-293, 296

## M

Mali i Zi — 46, 49, 204, 374,  
381, 395, 396, 413, 428, 437,  
448, 454, 486, 496, 500, 516,  
523, 524, 578, 581, 582, 584,  
586, 587, 588, 591, 595, 645  
«Manifesti Komunist» (vep-  
ra~, K. Marks, F. Engels) —  
124  
Maqedoni — 46, 48, 49, 204, 207,  
374, 381, 393, 395, 396, 413,  
428, 437, 448, 454, 496, 500,  
509-511, 512-513, 523, 530, 578,  
581-583, 584, 586, 591, 595,  
645  
Marok — 19  
Marrëveshja e Kemp Dejvidit  
— 191, 222, 230, 231, 256, 267,  
337, 649  
«Mbi bazat e leninizmit» (ve-  
pra~, J.V. Stalin) — 124  
Mesollongji (Greqi) — 421  
Metohi (Jugosllavi) — 434, 435,  
577, 590, 596  
ML (Military Liaison) — 417,  
419

Mongoli — 294, 296, 325, 326  
Moskë — 191, 218, 223, 231,  
254, 267, 483

## N

Nabatjeh (Liban) — 383  
Nagasaki (Japoni) — 144  
«NIN» (revista) — 409, 498,  
507, 520

## O

Obiliq (Jugosllavi) — 382  
Okshtun (Dibër) — 421  
Oman — 54, 337  
OPEK — 328  
Oqeani Indian — 26, 53  
«Ottobre» (gazeta) — 129

## P

Pakistan — 55  
Paris — 243  
Partia «Baas» — 21  
Partia «Tudeh» — 29, 223  
Pekin — 9, 290, 295, 325, 332,  
334, 346, 363  
Perandoria Austro-Hungareze  
— 544, 571, 576  
Perandoria e Mesit (Kinë) —  
299, 301-302, 303, 310  
Perandoria Romake — 37  
«Plani Marshall» — 145-146,  
147  
Plitvicë (Jugosllavi) — 606  
Podujevë (Jugosllavi) — 367,  
382  
Pogradec — 243  
«Politika» (gazeta) — 213,  
216, 488-489, 491-492, 498, 499  
Portet e Balltikut — 224, 261-  
262, 263, 271, 274, 278, 282-  
283  
Portugali — 233

Prevezë (Greqi) — 487, 528  
Prishtinë (Jugosllavi) — 367,  
382, 435, 586  
Pula (Jugosllavi) — 388  
Pul el Shark (Afganistan) —  
663

## R

Radiotelevizioni i Prishtinës —  
477  
Radiotelevizioni Shqiptar —  
464, 465, 466, 477  
Radio Zagrebi — 388, 392, 399  
Radio «Zëri i Amerikës» — 478

## RR

«Rreziku anglo-amerikan për  
Shqipërinë» (libri) —  
Enver Hoxha) — 417, 423

## S

SALT-2 — 8  
San-Francisko (SHBA) — 363  
Sao Paulo (Brazil) — 243  
Sarajevë (Jugosllavi) — 531  
Sarandë — 444  
SAVAK — 30-32  
Serbi — 46, 49, 207, 373, 380-  
381, 384, 396, 455-457, 465,  
476-477, 495, 496, 502-503, 524,  
562, 576, 578-579, 582, 584,  
595, 598, 645  
Sibëri — 259  
Sinai (Egjipt) — 337  
Singapor — 111  
Siri — 21, 40, 55, 656  
Slloveni — 46, 384, 454, 562,  
586  
Sofje — 510  
Somali — 27, 117  
Spanjë — 233  
Split (Jugosllavi) — 522

Sremska Mitrovica (Jugosllavi)  
— 510-511, 513  
Strugë (Jugosllavi) — 485

## SH

Shangai (Kinë) — 295  
Shçeçin (Poloni) — 261-263, 278  
Shëngjin (Lezhë) — 444  
Shkodër — 522  
Shkolla e Partisë «V.I. Lenin»  
— 178  
Shkup (Jugosllavi) — 598  
Shuttgart (RF e Gjermanisë) —  
387

## T

Tabas (Iran) — 179, 182, 229  
Tabriz (Iran) — 32, 33  
Tajlandë — 109, 111  
Tanjug (agjencia e lajmeve) —  
63, 195, 213, 215, 393, 425,  
488, 526, 527-528, 605, 608,  
654  
Teheran — 32-33, 53, 179, 183,  
185, 220, 229, 341  
Tel-Aviv — 383  
Tir (Liban) — 383  
Tiranë — 129, 247, 248, 449,  
484, 485, 492  
«Titistët» (libri) —  
Enver Hoxha) — 499  
Tivar (Jugosllavi) — 522  
Traktati i Londrës i vitit 1915  
— 379, 380  
Traktati i Shën-Stefanit —  
479, 509, 512  
Traktati i Versajës — 45, 198,  
379, 380, 530-531  
Trieste (Itali) — 388  
Tunizi — 19-20, 56  
Turqi — 58-59, 399, 475, 647

## U

Uashington — 364, 527, 528, 653  
UDB, OZNA — 48, 385-386, 392,  
435, 488, 490, 491, 497, 526-  
527, 535, 537-540, 542, 583,  
588  
Ulan-Bator — 326  
Universiteti i Prishtinës — 365,  
452, 464, 466, 598  
UNRRA — 144, 417, 419  
Urale (malet) — 134

## V

Varshavë — 231, 254, 267  
Vaterlo (Belgjikë) — 181  
Venecia (Itali) — 233  
Venezuelë — 56  
Visi (ishulli) — Jugosllavi) —  
210  
Vjenë — 61, 301  
Vlorë — 369, 444, 522  
Vojvodinë (Jugosllavi) — 49,  
579, 591  
Volorekë (Pogradec) — 244  
«Vorio Epir» — 527-528  
Vozhdovac (Jugosllavi) — 63,  
68, 76

## Z

Zagreb (Jugosllavi) — 388  
«Zëri i popullit» (gazeta) —  
79, 181, 249, 344, 385, 387,  
399, 410, 411, 414, 416, 430,  
434, 462, 464, 477, 485, 501,  
502, 513, 521, 533, 534, 540,  
569, 610

## ZH

«Zhenminzhibao» (gazeta) —  
94, 96, 97, 338, 339

## L E N D A

1980

Faqe

1. — **3 janar 1980.** Mbështetim luftën e popullit të Afganistanit kundër pushtuesve sovjetikë ..... 5
2. — **3 janar 1980.** Jashtë agresorët nga Afganistani! ..... 7
3. — **5 janar 1980.** Agresioni ushtarak sovjetik në Afganistan dhe imperializmi amerikan ..... 8
4. — **6 janar 1980.** Sekretari i Departamentit Amerikan të Mbrojtjes në Pekin ..... 9
5. — **15 janar 1980.** Mendime-teza për një artikull ..... 11
6. — **26 janar 1980.** Dëmshtëpërblimeve të luftës nga RF e Gjermanisë t'u kushtohet kujdesi i duhur ..... 13
7. — **30 janar 1980.** Përsëri për çështjen e dëmshtëpërblimeve dhe për arin e grabitur nga anglezët ..... 14
8. — **Janar 1980.** Ngjarjet që po zhvillohen në vendet myslimane duhet të shikohen në dritën e materializmit dialektik e historik ..... 15
9. — **13 shkurt 1980.** Panoramë e gjendjes ndërkombëtare ..... 44

	Faqe
10. — <b>19 shkurt 1980.</b> Problemi i dëmspërblimeve nga Republika Federale e Gjermanisë duhet trajtuar mbi baza të studiuara e serioze .....	61
11. — <b>21 shkurt 1980.</b> «Frymëzimi» i fundit i titizmit në pragun e vdekjes së «babait» të tij .....	63
12. — <b>22 shkurt 1980.</b> T'ua presim oreksin titistëve jugosllavë .....	78
13. — <b>22 shkurt 1980.</b> Pësia e Kinës «së madhe» nuk rëndon në balancën botërore .....	81
14. — <b>28 shkurt 1980.</b> Mendime mbi intervistën e Zbignjev Brzezinski .....	84
15. — <b>29 shkurt 1980.</b> Lajme sensacionale nga Kina .....	94
16. — <b>5 mars 1980.</b> Në Kinë kapitalizmi po vendoset me ritme të shpejta .....	99
17. — <b>8 mars 1980.</b> Mbi PK të Punëtorëve e Fshatarëve të Iranit .....	103
18. — <b>10 mars 1980.</b> Bisedime për fasadë .....	107
19. — <b>16 mars 1980.</b> Politika e «mosangazhimit» — një kështjellë e ndërtuar mbi rërë .....	113
20. — <b>21 mars 1980.</b> Shënim .....	119
21. — <b>22 mars 1980.</b> Kisingeri zbulon shumë gjëra për Kinën .....	120
22. — <b>24 mars 1980.</b> Tezat e PK të Gjermanisë (marksiste-leniniste) .....	121
23. — <b>31 mars 1980.</b> Sot në botë nuk mund të ruhet statukuojë .....	133
24. — <b>Mars 1980.</b> Cili duhet të jetë objektivi	

i librit «Eurokomunizëm apo eurorevizionizëm» .....	142
25. — <b>9 prill 1980.</b> Të mbrojmë luftën e drejtë antiimperialiste të popullit iranian .....	170
26. — <b>11 prill 1980.</b> Mbi tezat e PK të Gjermanisë (marksiste-leniniste) .....	172
27. — <b>15 prill 1980.</b> Bisedë e përzemërt me shokët e PK të Gjermanisë (marksiste-leniniste) .....	175
28. — <b>27 prill 1980.</b> Akt banditesk i Karterit që pësoi disfatë të turpshme .....	179
29. — <b>30 prill 1980.</b> Mbi situatën ndërkombëtare .....	185
30. — <b>4 maj 1980.</b> Vdiq Titoja .....	195
31. — <b>7 maj 1980.</b> Një ceremoni maskaradë .....	197
32. — <b>10 maj 1980.</b> Mbretërimi i monarkut Tito mori fund .....	198
33. — <b>23 maj 1980.</b> Të demaskojmë qëndrimin antishqiptar të Anglisë .....	202
34. — <b>23 maj 1980.</b> Trashëgimia e Titos .....	203
35. — <b>8 qershor 1980.</b> Një libër që dëshmon për gabimet politiko-ideologjike e ushtarake të Titos .....	209
36. — <b>12 qershor 1980.</b> Përsëri mbi çështjen e dëmspërblimeve gjermane .....	212
37. — <b>24 qershor 1980.</b> Xhimi Karteri zbulon «Amerikën» .....	213
38. — <b>1 korrik 1980.</b> Helmut Shmidi në Moskë .....	218
39. — <b>1 korrik 1980.</b> Thellohet kriza e madhe ekonomike botërore .....	226
40. — <b>10 korrik 1980.</b> Shënim .....	240
41. — <b>14 korrik 1980.</b> Presioneve në u përgjigjemi zjarr për zjarr .....	241

	Faqe
42. — <b>25 korrik 1980.</b> Bisedë me shokun Amazonas .....	243
43. — <b>2 gusht 1980.</b> Përgjigje e merituar presidentit të Italisë .....	246
44. — <b>7 gusht 1980.</b> Ngjarjet dhe ndodhitë në Itali vërtetojnë drejtësinë e tezave tona .....	249
45. — <b>14 gusht 1980.</b> Jugosllavia po falimenton .....	251
46. — <b>14 gusht 1980.</b> Franca dhe Gjermania Federale nuk i nënshtrohen diktatit të Karterit .....	254
47. — <b>1 shtator 1980.</b> Çfarë fshihet prapa grevave të punëtorëve të porteve polake të Balltikut? .....	261
48. — <b>22 shtator 1980.</b> Letër nga Pol Miliezi .....	286
49. — <b>30 shtator 1980.</b> Shënim .....	287
50. — <b>30 shtator 1980.</b> Shënim .....	288
51. — <b>18 tetor 1980.</b> Përvoja e madhe e Partisë është arma më e fuqishme në duart e popullit e të komunistëve .....	289
52. — <b>20 nëntor 1980.</b> Gjyqi i të gjallëve e i të vdekurve, gjyqi i Mao Ce Dunit .....	290
53. — <b>Nëntor 1980.</b> Ngjarjet në Poloni dhe pasojat e tyre të brendshme e të jashtme .....	313
54. — <b>4 dhjetor 1980.</b> Versioni mongol i rrëzimit të avionit kinez të Lin Biaos .....	325
55. — <b>5 dhjetor 1980.</b> Shënim .....	327
56. — <b>20 dhjetor 1980.</b> Shënim .....	328
<b>1 9 8 1</b>	
1. — <b>2 janar 1981.</b> Populli afgan nuk nënshtrohet .....	331

	Faqe
2. — <b>2 janar 1981.</b> Maos iu prish qetësia e varrit .....	332
3. — <b>9 janar 1981.</b> Maocedunideja — një femijë i dështuar, me shumë baballarë .....	334
4. — <b>10 janar 1981.</b> Kisingeri përsëri në Lindjen e Mesme .....	337
5. — <b>19 janar 1981.</b> Ç'po ndodh në Kinë?! .....	338
6. — <b>22 janar 1981.</b> Grusht i rëndë arrogancës amerikane .....	341
7. — <b>26 janar 1981.</b> Aleancat mund të bëhen vetëm nën udhëheqjen e partisë marksiste-leniniste .....	344
8. — <b>31 janar 1981.</b> Çfarë pasqyroi gjyqi i «të katërve» në Pekin? .....	346
9. — <b>7 shkurt 1981.</b> Mbi karakterin e grevave të klasës punëtore në Poloni .....	351
10. — <b>24 shkurt 1981.</b> Veprime terroriste të ushtrisë sovjetike në Afganistan .....	357
11. — <b>10 mars 1981.</b> Të demaskojmë manovrat shkombëtarizuese të jugosllavëve kundër popullsisë shqiptare .....	358
12. — <b>14 mars 1981.</b> Shënime .....	359
13. — <b>16 mars 1981.</b> Shënime për artikullin mbi Kongresin e 26-të të PK të BS .....	360
14. — <b>24 mars 1981.</b> Shënim .....	363
15. — <b>30 mars 1981.</b> Atentat kundër Reganit .....	364
16. — <b>1 prill 1981.</b> Demonstrata të fuqishme politike në Kosovë .....	365
17. — <b>2 prill 1981.</b> Acarohet gjendja në Kosovë .....	366
18. — <b>3 prill 1981.</b> Përleshje të reja e të fuqishme në qytetet e Kosovës .....	367
19. — <b>4 prill 1981.</b> Titistët sillen egër me demonstruesit kosovarë .....	369

	Faqe
20. — <b>5 prill 1981.</b> Byroja Politike diskuton mbi ngjarjet në Kosovë .....	370
21. — <b>7 prill 1981.</b> Çfarë pohon e çfarë mohon zoti Dragosavac .....	371
22. — <b>11 prill 1981.</b> Shqiptari nuk e ka duruar kurrë robërinë .....	380
23. — <b>11 prill 1981.</b> Palestinezët kundërshtojnë terrorin izraelit .....	383
24. — <b>17 prill 1981.</b> Arsyet e vërteta të gjendjes dhe të ngjarjeve të kohëve të fundit në Jugosllavinë titiste .....	384
25. — <b>18 prill 1981.</b> Shënim .....	410
26. — <b>22 prill 1981.</b> Kush e nxit armiqësinë midis popujve të Jugosllavisë? .....	411
27. — <b>26 prill 1981.</b> Udhëheqja jugosllave ka humbur krejtësisht toruan .....	412
28. — <b>5 maj 1981.</b> A bon entendeur salut .....	416
29. — <b>5 maj 1981.</b> Cili duhet të jetë qëllimi i kapitullit të fundit të librit për misionet e huaja në Shqipëri .....	417
30. — <b>5 maj 1981.</b> Shtojcë për bisedën me gjeneralin Dejvis në fshatin Okshtun të Dibrës .....	421
31. — <b>6 maj 1981.</b> Shënime .....	423
32. — <b>8 maj 1981.</b> Si t'i çminojmë e si t'i shpartallojmë akuzat antishqiptare të titistëve lidhur me ngjarjet në Kosovë .....	424
33. — <b>8 maj 1981.</b> Një libër që hedh dritë mbi rezistencën e popullit grek gjatë Luftës së Dytë Botërore .....	439
34. — <b>9 maj 1981.</b> Si t'i çminojmë e si t'i	

	Faqe
shpartallojmë akuzat antishqiptare të titistëve lidhur me ngjarjet në Kosovë .....	440
35. — <b>12 maj 1981.</b> Intrigantët titistë, shpifës e gënjeshtarë të njohur .....	461
36. — <b>13 maj 1981.</b> Përsëri mbledhje e Byrosë Politike për ngjarjet në Kosovë .....	462
37. — <b>16 maj 1981.</b> Kërkesa për t'i njohur Kosovës statusin e republikës është e drejtë .....	463
38. — <b>21 maj 1981.</b> Veprim shovinist dhe obskurantist i serbomëdhenjve ndaj lidhjeve kulturore me Kosovën .....	464
39. — <b>22 maj 1981.</b> Duhet të punojmë që opinionin publik ndërkombëtar të jetë në favor të çështjes së Kosovës .....	467
40. — <b>23 maj 1981.</b> Provokacion i ambasadës jugosllave .....	480
41. — <b>24 maj 1981.</b> Do të përballojmë me sukses provokacionet e armiqve revizionistë .....	481
42. — <b>27 maj 1981.</b> Vrasësi i palestinezëve në Moskë .....	483
43. — <b>27 maj 1981.</b> Përgjigje protestave të revizionistëve jugosllavë .....	484
44. — <b>30 maj 1981.</b> T'u dalim përpara vështirësive që jugosllavët po na nxjerrin në tregti .....	486
45. — <b>31 maj 1981.</b> Mbi ngjarjen e ambasadës jugosllave në Tiranë .....	488
46. — <b>1 qershor 1981.</b> Mbi bashkëpunimin e fshehtë sovjeta-serbomadh .....	493
47. — <b>2 qershor 1981.</b> Emigrantë kosovarë, serbët ju quajnë terroristë .....	496

	Faqe
48. — <b>2 qershor 1981.</b> Përgjigje gazetës «Politika» të Beogradit .....	499
49. — <b>2 qershor 1981.</b> Të ndalohen sa më parë raprezaljet dhe terrori i policisë serbe në Kosovë .....	502
50. — <b>2 qershor 1981.</b> Mbi gjendjen ndërkom-bëtare .....	504
51. — <b>2 qershor 1981.</b> Mbledhja e Helsinkit dhe qëllimet e revizionistëve jugosllavë .....	506
52. — <b>3 qershor 1981.</b> Traktati i Shën-Stefanit dhe loja e rrezikshme me harta nga qe-veria revizioniste e Republikës Popullore të Bullgarisë .....	509
53. — <b>4 qershor 1981.</b> Mbi përgatitjen e një artikulli teoriko-historik në formë polemike të rreptë kundër sulmeve pa baza që na bëjnë shovinistët e tërbuar të Beogradit .....	512
54. — <b>4 qershor 1981.</b> Ngjarjet e Kosovës dhe bashkëpunimi i fshehtë sovjeta-serbomadh .....	521
55. — <b>5 qershor 1981.</b> Rreth komplotit anti-shqiptar sovjeta-serbomadh .....	522
56. — <b>5 qershor 1981.</b> Jugosllavia titiste, e së-mura e Ballkanit, manovron t'i vërë zja-rrin Gadishullit Ballkanik .....	526
57. — <b>9 qershor 1981.</b> Emigrantët ekonomikë kosovarë kanë qenë dhe do të jenë të pandarë nga vendi dhe populli i tyre .....	532
58. — <b>9 qershor 1981.</b> Piemonti i mirëfilltë, «Piemonti» jugosllav dhe «Piemonti shqiptaromadh» .....	533

	Faqe
59. — <b>10 qershor 1981.</b> Jugosllavia titiste, e së-mura e Ballkanit, nxit armiqësinë shqip-taro-greke .....	534
60. — <b>10 qershor 1981.</b> Flet kryepolici serb .....	535
61. — <b>16 qershor 1981.</b> Nuk do të lejojmë kurrë titistët jugosllavë të vrasin, të burgosin e të torturojnë vëllezërit tanë kosovarë .....	536
62. — <b>17 qershor 1981.</b> Qëndrimet aktuale e të mëvonshme që duhet të mbajmë për çështjen e Kosovës .....	541
63. — <b>20 qershor 1981.</b> Përse shpif e trillon kun-dër vendit tonë serbomadhi Miniç .....	545
64. — <b>22 qershor 1981.</b> Situata ndërkom-bëtare është e mbarsur me luftë të përgjithshme dhe me luftëra lokale, po ajo është e mbarsur, edhe me revolucion .....	548
65. — <b>23 qershor 1981.</b> Probleme të mëdha të kohës .....	551
66. — <b>24 qershor 1981.</b> Revizionizmi kinez .....	555
67. — <b>25 qershor 1981.</b> Sistemi kapitalisto-revi-zionist jugosllav .....	561
68. — <b>30 qershor 1981.</b> Shënim .....	569
69. — <b>2 korrik 1981.</b> Pesë gabimet e titistëve ndaj çështjes së Kosovës .....	570
70. — <b>2 korrik 1981.</b> Çështja e Kosovës dhe e tokave shqiptare në Jugosllavi .....	593
71. — <b>4 korrik 1981.</b> Gorshkovi në Jugosllavi .....	605
72. — <b>6 korrik 1981.</b> Deklarata komprometuese të Dushan Dragosavacit .....	606
73. — <b>7 korrik 1981.</b> Forcohet aleanca ushtarake sovjeta-jugosllave .....	608
74. — <b>11 korrik 1981.</b> Shënim .....	610

75. — <b>14 korrik 1981.</b> Mbi vetadministrimin jugosllav .....	611
76. — <b>15 korrik 1981.</b> Refleksione .....	617
77. — <b>7 gusht 1981.</b> «Kosova republikë» .....	643
78. — <b>9 gusht 1981.</b> Për marrëdhëniet tona me Turqinë .....	647
79. — <b>10 gusht 1981.</b> Për Lindjen e Mesme, për luftën e popujve arabë .....	648
80. — <b>26 gusht 1981.</b> Kina — vend pelegrinazhi për ish-presidentët amerikanë .....	650
81. — <b>1 shtator 1981.</b> Për marrëdhëniet me Jugosllavinë .....	651
82. — <b>7 shtator 1981.</b> Shënim .....	653
83. — <b>11 shtator 1981.</b> Shënim .....	654
84. — <b>18 shtator 1981.</b> Shënim .....	655
85. — <b>7 tetor 1981.</b> Vranë Sadatin .....	656
86. — <b>14 tetor 1981.</b> Armatime amerikane për ushtrinë kineze .....	658
87. — <b>19 tetor 1981.</b> Shënim .....	660
88. — <b>21 tetor 1981.</b> Qeveri e re në Greqi .....	661
89. — <b>30 tetor 1981.</b> Pritje delegacionesh të huaja .....	662
90. — <b>3 nëntor 1981.</b> Goditje të vazhdueshme pushtuesve sovjetikë .....	663
91. — <b>23 nëntor 1981.</b> Shënime .....	664
Treguesi i lëndës .....	669
Treguesi i emrave .....	679
Treguesi gjeografik dhe i emërtimeve të tjera .....	685